#1 NEW YORK TIMES BESTSELLER

ARTHUR HAILEY



BOSËT E DOLLARIT

PARATHËNIE

Njihet tashmë se shkrimtarët realistë kritikë të shekullit të kaluar shkruan një letërsi të drejtpërdrejtë, nisur së pari nga qëllimi i madh për t'u futur pa stërhollime në thelbin e fenomeneve negative e antinjerezore që po shfaqte ngjitja galopante e shoqërisë borgjeze dhe së dyti, që të mund të komunikojnë sa më hapur me masën e lexuesve, pra, përsëri me një pikësynim të lavdërueshëm: ta bëjnë letërsinë e vet sa më demokratike. Shtegu i madh që çelën ata në historinë e letërsisë botërore u ndoq nga dhjetëra e dhjetëra shkrimtarë deri në ditët tona, duke e pasuruar fondin e letërsisë me shumë e shumë vepra monumentale. Romani «Bosët e dollarit» ka për autor një nga bashkëkohësit tanë, trashëgimtar i shumë tipareve të mira të letërsisë realiste klasike e më të re.

Arthur Hailey, me qëllim, preferon të mos operojë as me simbole, e as me konvencione letrare. Kjo lloj letërsie, gjithsesi, ka vështirësitë e saj të mëdha, sepse rrezikohet më hapur nga fotografizmi përshkrimor apo natyralizmi. Por, kur realizohet me cilësi të lartë artistike, është ndoshta letërsia më e lexuar, më demokratike; Edhe vetë Hejli është një prej shembujve. Po e ilustrojmë këtë mendim me librin që kemi tani në dorë: «Bosët e dollarit». Nga viti 1975 kur u botua për së pari në Amerikë e deri më 1979, ishte përkthyer në 27 gjuhë dhe ishin shitur në të katër anët e botës mbi 3 milionë kopje, shifër kjo mjaft e rrallë në radhën e botimeve të sotme, pa përmendur edhe një version të ekranizuar mjaft të suksesshëm.

Natyrisht, midis këtyre shkrimtarëve ka edhe shumë e shumë lidhje të tjera, ashtu siç ka dallime të shumta, të cilat do t'i nxirrte në pah një studim i imët që kuptohet se nuk e ka vendin këtu. Ky vështrim fare i shkurtër na duhej për ta kuptuar më mirë Hailey e njëkohësisht për të pohuar edhe një herë se shkrimtarët realistë vijnë gjithmonë si nevojë e

kohës, për të qenë veprat e tyre dokument i epokës kur janë shkruar, si dhe për të përballuar invazionin gjithnjë e më të intensifikuar të letërsisë komerciale, dekadente e reaksionare. Si të tilla, lidhjet gjenetike që kanë me njëri-tjetrin brezat e shkrimtarëve realistë veç sa e rritin më tej personalitetin e secilit, e bëjnë më origjinal.

Çdo shkrimtar shkon te platforma e tij ideoartistike në mënyrën e vet, e cila gjithsesi, në thelb, është e pangjashme me atë të shkrimtarëve paraardhës apo bashkëkohës. Për ta shtjelluar më tej këtë mendim, po ndalemi në disa nga momentet më të rëndësishme të jetës së Hailey. Lindi më 1920 në Luton, një qytet i vogël rreth 40 km në veri të Londrës, në një familje punëtorësh. Në moshën 14 vjeçare, i detyruar nga gjendja e vështirë ekonomike, hyri në punë, që të mund t'i ndihmonte sadopak prindërit. Megjithatë, pasion dominues i tij mbetet libri, që mbushte kështu njëfarësoj boshllëqet e shkollës. Pak vjet më vonë, kur Evropa u hodh në zjarrin e luftës që e ndezën fashistët, ai mobilizohet dhe deri në vitin 1945 lufton si pjesëtar i flotës ajrore angleze në frontin kundër Gjermanisë naziste. Mandej për dy vjet merret me punëra të rëndomta në industrinë e automobilave, pastaj emigron në Kanada, ku zë vend si komisioner pronash të patundshme, më vonë redaktor i një reviste që merrej me çështje të tregtisë, administrator i një shoqërie reklamash, derisa u vendos në Toronto dhe i hyri rrugës mjaft të vështirë të gazetarisë profesioniste. Në vitin 1952, kur mori fund dominioni britanik, ai ruajti shtetësinë kanadeze. Për herë të parë u shfaq para lexuesit si shkrimtar në vitin 1959 me romanin «Diagnoza e fundit». I bie të ishte 39 vjeç, moshë në të cilën shumica e shkrimtarëve të mëdhenj të shekullit tonë e kishin shkruar një pjesë të mirë të veprës së vet dhe kishin fituar një emër ndërkombëtar. Ky krahasim të bën të pyesësh: A dilte i vonuar ai në arenën letrare?

Sot, më pak se 30 vjet më pas, përgjigjesh pa ngurrim se jo. Po përmendim disa nga romanet e tij që e pasuan «Diagnoza e fundit»: «Në sferat e larta», «Hoteli», «Aeroporti», «Rrotat», «Manjatët e parasë» që po botohet te ne me titullin «Bosët e dollarit» etj. Gjithashtu, ndërkohë, ka shkruar edhe disa skenarë filmash televizivë. Ky ritëm i shpejtë afirmimi e ka një shpjegim, ku kryesor, sigurisht, është talenti, pastaj vjen puna këmbëngulëse, por nuk mund të lihet kurrsesi pas dore, edhe përvoja shumë e pasur jetësore e autorit, që buron, veç të tjerash, edhe nga ai ballafaqim i tij i pamëshirshëm me vështirësitë qysh në moshë fare të re. Gazetaria e pasuroi më tej këtë përvojë të shkrimtarit, e thelloi njohjen e tij realiste mbi botën e, njëkohësisht, i shërbeu si një ushtrim i dobishëm shumë në rrugën e njohjes së teknikave të të shkruarit. Tërë këta faktorë, të bashkuar në një, na dhanë romanin e tij të parë që e përmendëm më lart i cili tërhoqi menjëherë vëmendjen e lexuesit të gjerë dhe të kritikës. Nuk ishte aspak mosha e tij që ndikoi për të mos u përsëritur termi jo fort i pëlqyer nga autorët «shkrimtar i ri». Ishin vlerat e romanit dhe emri i fituar tashmë si publicist.

Në dy romanet që erdhën më pas, «Hoteli» dhe «Aeroporti», një ndihmë të madhe i dha edhe botuesi i tij, i cili, duke e njohur mirë tashmë natyrën krijuese të Hailey, duke e ditur se ai nuk i drejtohej asnjë subjekti pa e njohur mirë që në gjenezën e vet, i mori përsipër të gjitha shpenzimet që Hailey të kthehej në shkrimtar profesionist. U fillua me «Hotelin». Botuesi i pagoi romancierit qëndrimin për disa muaj në hotelet më të mëdha e më luksoze të Amerikës, ku ai do të gjente materialin për romanin e ri. Paraja nuk i shkoi dëm. Romani me të njëjtin

titull u botua më 1965 dhe pati një sukses të jashtëzakonshëm. Fill më pas u bë edhe film. Në këtë roman Hailey bën përpjekje t'i heqë vernikun e ndritshëm jetës që shkohej në këto hotele dhe nxori në diell banalitetin, korrupsionin moral dhe intrigat mesjetare që thurnin klientët qesembushur të tyre. Pikërisht për këtë mesazh që solli gjeti edhe mirëpritjen entuziaste të lexuesit të gjerë, i cili, duke qenë kaq masiv, nuk mund të përbëhet kurrsesi prej një kategorie të caktuar të populllsisë. Siç merret me mend, ai roman shkoi më së shumti tek ai lexues, të cilit të ardhurat e veta nuk ia lejonin të shijonte komoditetet e këtyre hoteleve. Suksesi i «Hotelit» qe inkurajues për shkrimtarin dhe botuesin që ta vazhdonin këtë përvojë në aeroportin «Illinais», më i madhi i SHBA-së. Hailey, thamë, gjatë Luftës së Dytë Botërore shërbeu në aviacion. Pra, nuk ishte pa njohuri në fushën e aeronautikës. Një roman me këtë temë kishte lindur prej vitesh në kokën e tij. Tani, me sa duket, kishte ardhur koha të konkretizohej në letër. Qëndrimi për disa muaj në këtë aeroport i dha subjektin e njërit nga romanet më të njohura jo vetëm të këtij autori, por edhe të krejt letërsisë amerikane të këtyre tri dekadave të fundit. (Që nga fundi i viteve pesëdhjetë, Hailey, duke ruajtur gjithnjë shtetësinë kanadeze, jeton dhe punon në SHBA), me titullin e thjeshtë «Aeroporti». Kritika e shumë vendeve ku është botuar ky roman thotë se aty Hailey arriti një shkallë të lartë në aftësinë për ta zbërthyer botën e brendshme të personazheve, duke u përpjekur ta analizojë personazhin sa më gjerësisht në kontekstin e rrethanave sociale ku jeton. Megjithatë, te ky roman, më shumë se te romanet që vijnë më pas, Hailey nuk ka dalë dot jashtë kufizimeve esenciale botëkuptimore, të cilat e çojnë në

mënyrë të pashmangshme edhe në mjaft përfundime të gabuara.

Këto marrëdhënie me botuesin e vet amerikan ai i vazhdoi edhe në vitet e mëvonshme. Po e sjellim si shembull për të treguar se kjo praktikë është një nga mënyrat më të përhapura sidomos në SHBA për t'i shfrytëzuar autorët dhe për t'i përpunuar ata, që me veprat e veta të mos shkojnë më larg se sa i intereson botuesit borgjez, megjithëse në raste shkrimtarësh seriozë si Hailey kjo nuk është gjithnjë e mundur. Ky investim fillestar i siguron pronarit të shtëpisë botuese të drejtën të diktojë kushtet e veta në kontratën me autorin. Ai i imponon autorit zgjidhje të gatshme në subjektet që do të trajtojnë, i fut idetë dhe moralin që i intereson të propagandojë. Të ndalemi për një çast vetëm te romanet e Hailey. Aty gjithmonë do të kesh një mbyllje me hepi-end, ku gjithçka zgjidhet më së miri, gjë që vjen ndesh me zgjidhjet në jetën reale që shpesh mund të jenë edhe tragjike. Gjithkush e kupton se ky hepiend nuk vjen thjesht nga kufizimet e botëkuptimore të shkrimtarit, por është ende i injektuar nga jashtë artificialisht. Duke arsyetuar kështu kupton edhe një dobësi tjetër që del edhe te romani «Bosët e dollarit».

Autori përpiqet t'i krijojë lexuesit iluzionin e një jete pa andralla ekonomike të qytetarit amerikan, por herë-herë realizmi i artit të tij del më i fortë dhe atëherë shohim si zbulohen fragmente të jetës së vërtetë, me plot ngushtime e halle që bëjnë masat e gjera të këtij supershteti.

Kjo shfaqet siç thamë edhe te «Bosët e dollarit» që është njëri nga romanet e tij të fundit në vështrim kronologjik, por i quajtur nga opinioni letrar i shumë vendeve si më kritiku. Kësaj here Hejli hyn në sferat më të larta të oligarkisë financiare amerikane, i sigurt se aty ndërthuren të gjitha interesat e klasave, grupeve dhe individëve të

shoqërisë, që nga njerëzit e thjeshtë, që me mundim të madh heqin diçka mënjanë dhe e depozitojnë në bankë, për ta pasur në pleqërinë e mëvonshme, kur t'u jenë shterur forcat, pasi e dinë se nuk do të ketë kush t'u gjendet pranë, e deri te presidenca federale. Njëkohësisht prapa dyerve metalike të bankës thuren intriga në dy plane: edhe brenda për brenda bosëve për pushtet, edhe në kurriz të popullit. Këto intriga autori i paraqet edhe me të pandashmet e veta: korrupsionin e thellë moral, pabesitë e presionet nga më të ligat. Për ta krijuar sa më të plotë këtë tablo, shkrimtari ka ndërtuar një roman shumëplanesh, në të cilin gjen vendin e vet dhe shtjellohet, aq sa ta përcjellë mesazhin e vet, çdo personazh.

Edhe në këtë roman, Hailey përdor ballafaqimin e kategorive morale të së mirës me të keqen. Dhe kjo ka dy arsye: e para, ai e kupton me të drejtë që ato nuk mund të ekzistojnë pa njëra-tjetrën, duke arritur kështu në mënyrë intuitive te përfundimi dialektik, dhe, së dyti, zgjidh teknikisht problemin e demaskimit të negatives. Nuk e merr vetë përsipër si autor, gjë që do të ishte edhe më e vështirë, edhe më pak e efektshme artistikisht, por fut në lojë një personazh të së njëjtës staturë, të cilit ia ngarkon këtë barrë. Te «Bosët e dollarit» ky personazh quhet Aleks Vandervurti. Aleksi është antipodi i Rosko Hejuordit dhe bartës i botëkuptimit të shkrimtarit. Si i tillë, Aleksi bëhet në mënyrë të pashmangshme bartës i hapësirës dhe kufizimeve të këtij botëkuptimi. Themi Aleksi, sepse tek ai mbështetet autori për të pohuar se e ardhmja nuk i përket çnjerëzores (Rosko), por të kundërtës së saj. Ky përfundim i tij është i drejtë dhe human. Ndërsa rruga që servir ai për të dalë në këtë majë të ëndërruar dhe analiza që i bën gjendjes

konkrete nga ku sigurohet dhe ushqehet ekzistenca e këtyre dy të kundërtave, nuk është gjithnjë e drejtë. Kjo e vërtetë bëhet e dukshme sidomos tek një personazh tjetër. Margoti, që është edhe njëfarë plotësimi ideor i Aleksit në konceptimin e autorit. Jo rastësisht këta të dy edhe dashurohen e bashkëjetojnë. Por, duhet shtuar se ndaj Margotit autori është më realist. Sot në SHBA, nën presionin ngulmues çorientues të kapitalit me të gjitha instrumentet e veta më të rafinuara se kurrë, ka gjetur mjaft përhapje, sidomos te shtresat e mesme, ku bën pjesë edhe Margoti, reformizmi. Dihet se një shërbim të madh reformizmit i ka bërë dhe i bën edhe revizionizmi i ish-partive komuniste perëndimore. Prandaj thamë se Margoti është një plotësim i mëtejshëm si figurë artistike e Aleksit dhe të dy së bashku përbëjnë personazhin e dëshiruar të autorit për të përfaqësuar pozitiven. Margoti nuk arrin ta zbulojë dialektikisht burimin e kontradiktave dhe, për pasojë, të tregojë edhe si dilet në zgjidhjen e tyre. Kësisoj ajo mendon se gjithçka mund të zgjidhet brenda marrëdhënieve ekonomiko-shoqërore ekzistuese. Në këtë kuptim, ky personazh është personazhi tipik utopik i letërsisë së realizmit kritik që është shkruar në të kaluarën e që shkruhet edhe sot në botë.

Botimi i këtij romani në shqip do ta zgjerojë më tej informacionin e lexuesit tonë për letërsinë përparimtare që shkruhet sot në botë. Ky roman do të zerë vend me dinjitet pranë botimeve të tjera nga letërsia e huaj bashkëkohëse.

Besnik Mustafaj

Në qofsh e pasur, je e varfër
sepse, si një gomar me ar ngarkuar
ti arin mban veç gjer në fund të udhës
dhe vdekja të shkarkon.

Shekspir, *«Masë për masë»*

Ndryshku bren thesarin e mbi të vepron,
por ari, i vënë në punë, ar përfton.

Shekspir, *«Venusi dhe Adonisi»*

1.

Shumë kohë më pas, dy ditët e javës së parë të tetorit do të mbeteshin të gjalla dhe plot dhimbje në kujtesën e shumë njerëzve. Ishte pikërisht e marta e asaj jave kur plakun Ben Roseli, president i Bankës "Ferst Merkëntajll Ëmerikën Benk" dhe nipi i themeluesit të saj, dha një njoftim sa befasues, aq edhe tronditës, i cili bëri jehonë në çdo cep të bankës e edhe shumë më gjerë. Të nesërmen, të mërkurën, në filialin kryesor të qendrës u zbulua prania e një hajduti. Ky ishte fillimi i një vargu ngjarjesh që pak kush mund t'i parashikonte dhe që do të përfundonin me rrënim financiar, tragjedi njerëzore dhe vdekje.

Njoftimi i presidentit të bankës erdhi krejt papritur; çuditërisht, asgjë nuk kishte rjedhur më parë në publik. Ben Roseli i kishte telefonuar disa prej drejtuesve të tij kryesorë herët në mëngjes, duke i kapur disa në shtëpi duke ngrënë mëngjes, e të tjerë sapo kishin mbërritur në punë. Kishte edhe nga ata që nuk ishin pjesë e stafit drejtues, por thjesht punonjës të vjetër, të cilët plaku Ben i konsideronte miq. Për secilin prej tyre, mesazhi ishte i njëjtë: "Ju lutem, ejani në sallën e mbledhjeve të Këshillit Drejtues, në Kullën Qendrore, në orën 11:00".

Tani, të gjithë përveç Benit ishin mbledhur në sallë, rreth njëzet veta, dhe po bisedonin me zë të ulët nëpër grupe duke pritur. Të gjithë qëndronin në këmbë; askush nuk guximoi të ishte i pari që të tërhiqte karrigen nga ajo tryezë shkëlqyese drejtorësh, e cila ishte më e gjatë se një fushë skuashi dhe kishte vend për dyzet persona.

Një zë i prerë e ndërpreu bisedën.

— Kush e autorizoi këtë?

Të gjithë kthyen kokat. Rosko Hejuard, zëvendëspresidenti ekzekutiv dhe kontrollori i përgjithshëm, po i drejtohej një kamarieri me uniformë të bardhë, që kishte ardhur nga dhoma e ngrënies së zyrtarëve të lartë. Burri kishte hyrë me ibrikë sherry (verë e fortë) dhe po ua hidhte nëpër gota. Hejuardi, një figurë e rreptë dhe autoritare në Bankën FMA, ishte një

kundërshtar i rrebtë dhe i betuar i alkoolit. Ai pa me kuptim orën, me një gjest që tregonte qartë: "Jo vetëm që po pini, por po pini që pa gdhirë".
Disa që kishin zgjatur duart drejt gotave të sherry-t, i tërhoqën mbrapsht.
— Janë udhëzimet e zotit Roseli, zotëri, — deklaroi kamarieri.
— Dhe porositi posaçërisht sherry-n më të mirë.
Një burrë me trup të bëshëm dhe i veshur me stil, me një kostum ngjyrë gri të hapur, u kthye dhe tha me lehtësi:
— Sido që të jetë ora, nuk ka kuptim të refuzosh më të mirën.
Aleks Vandervort, me sy blu, flokë biondë dhe me pak thinja në tëmtha, ishte gjithashtu zëvendëspresident ekzekutiv. Pamja e tij miqësore dhe pa doreza, si dhe sjellja e tij e shpenguar dhe moderne, fshihnin natyrën e tij të prerë dhe të vendosur. Dy burrat — Hejuard dhe Vandervort — përfaqësonin nivelin e dytë të menaxhimit, menjëherë nën presidentin. Edhe pse të dy ishin me përvojë dhe të aftë për të bashkëpunuar, ata ishin, në shumë drejtime, rivalë. Rivaliteti i tyre dhe pikëpamjet e ndryshme ndiheshin në të gjithë bankën, duke bërë që secili të kishte mbështetësit e vet në nivelet më të ulëta.
Tani Aleksi mori dy gota sherry dhe njeren ia kaloi Eduina D'Orsit, një zeshkane shtatgjatë dhe elegante, e cila ishte gruaja me pozicionin më të lartë drejtues në FMA. Eduina vuri re vështrimin qortues të Hejuardit drejt saj. "E po, nuk ka ndonjë rëndësi të madhe", mendoi ajo. Roskoja e dinte mirë që ajo ishte besnike e kampit të Vandervortit.
— Faleminderit, Aleks, — tha ajo dhe mori gotën.
Pati një moment tensioni, por më pas të tjerët ndoqën shembullin e saj. Fytyra e Rosko Hejuardit u mblodh nga zemërimi. Dukej sikur do të thoshte diçka tjetër, por ndërroi mendje.
Nga dera e sallës së keshillit,Nolan Uejnrajti,njeri nga të dy funksionarët zezakë të ftuar per te marrë pjesë në mbledhje,i ngarkuar me detyrën e drejtorit të shërbimit të sigurisë, me pamjen impozante të një Otelloje, njoftoi me zë të lartë:
— Zonja D'Orsej dhe zotërinj, zoti Roseli.

Mërmëritja e bisedave pushoi.

Ben Roseli hyri në sallë me një buzëqeshje të lehtë, ndërsa hidhte sytë mbi tërë grupin e të pranishmëve. Si zakonisht, pamja e tij kishte edhe karakteristikat e figurës dashamirëse të një babai, edhe atë të afaristit me parime të forta, të cilit mijëra bashkëqytetarë i kanë besuar ruajtjen e parave të tyre. Edhe vetë veshja e tij e pasqyronte këtë natyrë të dyfishtë: kostum i zi i bankierit, me jelekun që s'mungon kurrë, si edhe zinxhiri i hollë prej ari i orës. Veç kësaj, të bënte shumë përshtypje ngjashmëria e tij me Roselin e parë — Xhovanin — i cili e kishte themeluar bankën para një shekulli, në bodrumin e një magazine artikujsh ushqimorë. Banka e riprodhonte kokën prej patrici të Roselit, me flokët e tij të dendur e të argjendtë dhe mustaqet e mëdha, në librezat e kursimit dhe në *travellers' cheques*[1]), si simbol ndershmërie. Po kështu, i tij ishte edhe busti që zbukuronte sheshin «Roseli» që ndodhej para bankës.

Flokët e thinjur dhe mustaqet e Ben Roselit ishin pothuajse po aq të dendura dhe impozante sa ato të Xhovanit: moda e kishte plotësuar ciklin e saj gjatë shekullit që kishte kaluar dhe ishte kthyer përsëri në pikënisje. Mirëpo ajo që nuk mund ta jepte asnjë riprodhim, ishte karakteri që i kishte dalluar të gjithë Roselët, i cili, bashkë me shpirtin e iniciativës dhe një energji të pashtershme, e kishte ngritur bankën në majat ku kishte arritur. Por atë ditë, Ben Roselit i mungonte gjallëria e tij e zakonshme. Ai ecte duke u mbështetur në një bastun; asnjëri nga të pranishmit s'e kishte parë ndonjëherë kështu.

Ai zgjati dorën për të tërhequr njërën nga karriget e rënda, por Nolan Uejnrajti, që ndodhej më pranë tij, që më i shpejtë, e rrotulloi karrigen me shpinëzën nga tryeza. Duke mërmëritur një falënderim, presidenti u ul.

Ben Roseli bëri një gjest me dorë nga të pranishmit, duke thënë:

— Kjo nuk është një mbledhje zyrtare dhe nuk do të zgjatet shumë. Mund të uleni, po deshët. Ah, faleminderit!

— Falënderimi i drejtohej kamarierit, nga i cili kishte marrë

një gotë sherri. Kamerieri doli nga salla, duke mbyllur derën prapa tij.

Dikush lëvizi nga vendi një karrige për Eduina d'Orsejin dhe një numër i vogël nga të pranishmit u ulën gjithashtu, por pjesa më e madhe qëndruan në këmbë.

Aleks Vandervurti tha:

— Sigurisht që jemi këtu për ndonjë rast gëzimi — dhe ngriti gotën për të uruar, — por, për çfarë?

Një buzëqeshje e lehtë u formua përsëri në buzët e Ben Roselit.

— Ashtu do të doja edhe unë, Aleks, të kishte qenë për një rast gëzimi, por është thjesht për një rast, kur ndihet nevoja për të pirë pak alkool. — Ai heshti për disa çaste dhe në sallë mbretëroi një gjendje e re tensioni. Tani ishte e qartë për të gjithë se nuk ishte fjala për një mbledhje të zakonshme. Fytyrat e të pranishmëve pasqyronin pasiguri, shqetësim.

— Puna është se s'kam të gjatë, — shtoi Ben Roseli. — Ky është mendimi i mjekëve. E pashë me vend që t'ju vija në dijeni. — Ngriti gotën, e vështroi një çast dhe piu një gllënjkë sherri.

Nëse deri në këtë çast, në sallë kishte mbretëruar një qetësi e zakonshme, tashmë ajo u kthye në diçka të rëndë, shtypëse. Askush nuk fliste dhe as lëvizte. Dëgjoheshin vetëm zhurma të jashtme, që arrinin të mbytura gjer në sallë: trokitja e dobët e një makine shkrimi, zukatja e një aparati për ajër të kondicionuar, vikama e një avioni reaktiv në ngjitje.

Beni plak u përkul përpara, duke u mbështetur në bastunin e tij dhe shtoi:

— Të mos rrimë tani kështu, të stepur. Të gjithë ne jemi miq të vjetër, prandaj dhe ju thirra këtu. Dhe... për t'ju hequr mundimin që të pyesni, ajo që ju thashë është krejt e sigurt. Po të qe se kishte edhe një mundësi të vetme për të qenë ndryshe, do të kisha pritur. Për sa i përket pyetjes tjetër që, ndoshta, po bëni në mendjen tuaj... është fjala për kancer në mushkëri, në një stad mjaft të shtyrë, siç më kanë thënë. Ka të ngjarë që të mos i kap krishtlindjet. — Ai heshti përsëri dhe

menjëherë u dukën qartë tek ai shenjat e një dobësie dhe lodhjeje të madhe. Pastaj shtoi me zë më të ulët: — Dhe, tani që e dini, mund të vini në dijeni edhe të tjerët; kohën dhe mënyrën i zgjidhni vetë.

Eduina d'Orseji mendoi se përsa i përkiste kohës s'kishte gjë për të zgjedhur. Menjëherë sapo të zbrazej salla, ajo që kishin dëgjuar aty do të përhapej në të gjithë bankën dhe jashtë saj, po aq shpejt sa përhapet zjarri në pyll. Shumë do të prekeshin nga ky lajm: disa në ndjenjat e tyre; të tjerë, në mënyrë më prozaike. Vetë ajo kishte mbetur si e shastisur dhe e ndjente se edhe të tjerë nga të pranishmit ishin në të njëjtën gjendje.

— Zoti Ben, — ia nisi me zë të pasigurt njëri nga më të moshuarit, Pop Monroi, nëpunës i vjetër në seksionin e administratës fiduciare. — Zoti Ben, na dërrmuat fare. Them se askush s'di ç'djall të thotë.

U dëgjua një mërmëritje, pothuajse një rënkim, që shprehte miratim dhe solidaritet.

Mbi të gjitha këto u dëgjua zëri i Rosko Hejuardit:

— Ajo që mundet dhe duhet të themi, — në tonin e administratorit financiar kishte një timbër qortimi, mbasi të tjerët duhej ta kishin lënë atë të merrte fjalën i pari, — është se: ndonëse të prekur dhe të trishtuar nga ky lajm i tmerrshëm, ne shpresojmë dhe urojmë që të ketë një mundësi gabimi dhe shprese përsa i përket afatit të parashikuar. Sikurse dihet, rrallë ndodh që mendimet e mjekëve të jenë të sakta dhe shkenca e mjekësisë mund të bëjë hapa të mëdhenj përpara, të ndalë, bile të shërojë...

— Rosko, e thashë më parë se nuk mund të ketë mundësi dyshimi, — e ndërpreu Ben Roseli, duke lënë të dukeshin shenjat e para të nervozizmit. — Dhe, përsa u përket mjekëve, më kanë vizituar më të mirët. Besoj se s'ke dyshim për këtë, apo jo?

— Sigurisht që s'kam, — u përgjigj Hejuordi, — por duhet të mos harrojmë se ekziston një fuqi më e madhe se mjekët dhe se është detyrë e të gjithë neve, — fjalët e fundit i shoqëroi me një vështrim kuptimplotë rreth e qark sallës, —

t'i lutemi zotit për përdëllim ose, së paku, për t'ju lënë më shumë se sa besoni ju.

Me një pamje të zhgënjyer, plaku ia priti:

— Kam përshtypjen se zoti e ka marrë tanimë vendimin e tij.

Aleks Vandervurti tha:

— Ben, ne të gjithë jemi shumë të tronditur. Veçanërisht mua më vjen keq për atë që thashë pak më parë.

— Për rastin e gëzimit? Harroje atë! Ti nuk dije gjë. — Plaku qeshi për një çast. — Pastaj, pse jo? Jeta ime ka qenë e bukur. Nuk ndodh kështu me të gjithë. Prandaj, kjo është sigurisht një arsye për ta festuar. — Ai preku xhepat e xhaketës së tij dhe, pastaj, hodhi sytë rreth e përqark.
— A ka ndonjëri ndonjë cigare? Mjekët ma kanë ndaluar duhanin.

U zgjatën disa duar me paketa cigaresh. Rosko Hejuordi ndërhyri:
— Jeni i sigurt se nuk po e shkelni?

Ben Roseli e vështroi me shpoti, por nuk iu përgjigj. Të gjithë e dinin se, ndërsa plaku i vlerësonte aftësitë e Hejuordit në punën e tij në bankë, marrëdhëniet e tyre nuk kishin arritur kurrë deri në atë pikë sa të quheshin marrëdhënie miqësore.

Aleks Vandervurti ia ndezi cigaren presidentit. Sytë e tij, sikurse të shumë të tjerëve në sallë, ishin të përlotur.

— Në raste të këtilla, — tha Beni, — ka gjëra për të cilat ia vlen të jesh i kënaqur. Një nga këto është se je i paralajmëruar dhe, kështu, ke mundësinë për të rregulluar disa gjëra të vogla, që mund të kenë mbetur pezull. — Tymi i cigares së tij ngrihej rrathë-rrathë. — Natyrisht, nga ana tjetër, njeriu ndien edhe keqardhje për mënyrën se si janë zhvilluar disa gjëra. Ai rri e vret mendjen edhe për këto.

Të gjithë e kishin të qartë se për çfarë keqardhjeje ishte fjala: Ben Roseli s'kishte trashëgimtar. Djali i vetëm i ishte vrarë gjatë Luftës së Dytë Botërore; pak kohë më parë i ishte

vrarë një nip, që premtonte shumë për të ardhmen, gjatë humbjeve të mëdha e pa kuptim të luftës së Vietnamit.

Plaku filloi të kollitej. Nolan Uejnrajti, që ishte më pranë tij, ia hoqi cigaren nga gishtat që i dridheshin dhe e shuajti. Tani u pa qartë se sa i dobët ishte në të vërtetë Ben Roseli dhe sa shumë e kishte lodhur mundimi që kishte bërë atë ditë.

Askush nuk mund ta dinte akoma, por kjo ishte hera e fundit që ai vinte në bankë.

Të gjithë u ngritën njëri pas tjetrit t'i shtrëngonin dorën, duke zgjedhur fjalët që zakonisht thuhen në të tilla raste. Kur erdhi radha e Eduina d'Orsejit ajo e puthi lehtë në faqe dhe Beni i shkeli syrin.

2.

Rosko Hejuordi qe një nga të parët që u largua nga salla e këshillit. Nga sa kishte mësuar pak çaste më parë, ai kishte dy synime urgjente.

Njëri ishte që të sigurohej një kalim jo i vështirë i autoritetit në duar të tjera, mbas vdekjes së Ben Roselit. Synimi i dytë ishte të siguronte emërimin e vet në postin e presidentit.

Hejuordi ishte që tani një kandidat i fortë. I tillë ishte edhe Aleks Vandervurti dhe, në personelin e bankës, ky i fundit mund të kishte një numër më të madh pasuesish. Sidoqoftë, Hejuordi mendonte se kishte përkrahje më të madhe në këshillin administrativ dhe në atë mbështetej sidomos për të arritur qëllimin e tij.

I mprehtë në çështjet që kishin të bënin me politikën bankare dhe me një mendje të disiplinuar dhe që s'tundej nga pikësynimi i caktuar, ai kishte filluar ta planifikonte fushatën e tij gjatë kohës që mbledhja ishte akoma në zhvillim e sipër.

Mbërriti në zyrën e tij, të përbërë nga dhoma të veshura me tapiceri ngjyrë bezhë të errët, nga dritaret e të cilave dukej poshtë një pamje jashtëzakonisht e bukur e qytetit. Mbasi u ul

te tryeza e punës, thirri zonjën Kellëgen; më e vjetra e dy sekretareve të tij, i dha me të shpejtë disa udhëzime.

Së pari: ajo duhej të lidhej me telefon me të gjithë këshilltarët e jashtëm, me të cilët ai donte të fliste me radhë. Ai kishte në tryezë para tij një listë të këshilltarëve. Veç kësaj nuk donte ta shqetësonin në asnjë rast, me përjashtim të thirrjeve telefonike të posaçme.

Një udhëzim tjetër ishte që, kur të dilte, zonja Kellëgen ta mbyllte derën. Kjo ishte një gjë jo e zakonshme, mbasi funksionarët e FMA-së, për traditë e mbanin derën të hapur, traditë kjo që kishte filluar para një shekulli dhe kishte qenë e respektuar gjithnjë nga Ben Roseli. Kjo traditë duhej të hiqej. Në këto çaste, sekreti kishte rëndësi të dorës së parë.

Hejuordi kishte vënë re menjëherë në mbledhjen e mëngjesit se, përveç funksionarëve më të lartë të bankës; aty ishin të pranishëm vetëm dy anëtarët e këshillit administrativ të FMA-së. Të dy ata ishin miq personalë të Ben Roselit — pa dyshim kjo ishte edhe arsyeja se përse kishin qenë ftuar të merrnin pjesë në mbledhje. Mirëpo, nga kjo dilte se, deri në atë çast, pesëmbëdhjetë këshilltarë nuk kishin fare dijeni për vdekjen e Ben Roselit që do të ndodhte së shpejti. Hejuordi do të kujdesej që këta të pesëmbëdhjetë të njoftoheshin për këtë nga vetë ai.

Ai mbështetej në dy mundësi: së pari, faktet ishin aq të papritura dhe tronditëse, saqë një aleancë instinktive do të krijohej ndërmjet atij që e merrte lajmin dhe atij që e jepte. Së dyti, disa këshilltarë mund të pezmatoheshin se nuk i kishin informuar më parë, sidomos ndaj disave nga nëpunësit e thjeshtë të FMA-së, që ishin vënë në dijeni në sallën e këshillit. Rosko Hejuordi kishte ndërmend ta shfrytëzonte këtë pezmatim.

Ra zilja e telefonit të brendshëm. Ai filloi me thirrjen e parë, e cila u ndoq nga një e dytë dhe, pastaj, edhe një tjetër. Disa këshilltarë ishin jashtë qytetit, por Dora Kellëgen, e aftë dhe me përvojë, po i gjente njërin pas tjetrit.

Mbas një gjysmë ore të kësaj pune, Rosko Hejuordi u lidh me të nderuarin Harold Ostin dhe filloi, me zë serioz e gjithë gjallëri, ta vinte në dijeni për sa kishte ndodhur:

— Këtu, në bankë, natyrisht, jemi të tronditur dhe të prekur thellë. Ajo që na tha Beni na duket krejt e pamundur, joreale.

— O perëndi!, — zëri në telefon pasqyronte akoma turbullimin e shprehur një çast më parë nga Hejuordi. — Dhe e dha vetë këtë lajm! — Harold Ostini ishte një nga shtyllat e qytetit, sikurse kishte qenë, që prej tre brezash, fisi i tij. Veç kësaj, mjaft kohë më parë, ai kishte qenë edhe anëtar i Kongresit (nga kjo e kishte edhe titullin «I nderuar», përdorimin e të cilit e inkurajonte). Tani ai ishte pronari i agjencisë publicitare më të madhe të shtetit dhe një nga këshilltarët më të vjetër të bankës, me një ndikim të madh në këshillin administrativ.

Komenti i Ostinit mbi njoftimin e bërë personalisht i dha Hejuordit rastin që i nevojitej për ta hapur bisedën.

— E kuptoj fare mirë atë që do të thuash lidhur me mënyrën e njoftimit dhe, sinqerisht, edhe mua m'u duk si diçka jo e zakonshme. Më shumë më shqetësoi fakti që këshilltarët nuk ishin vënë në dijeni të parët. Mendoj se kështu duhej të ishte bërë. Por, meqë nuk u veprua kështu,mendova se ishte detyra ime të të njoftoja menjëherë ty, si edhe të tjerët. — Fytyra serioze dhe e rreptë e Hejuordit shprehte përqendrim, ndërsa sytë e tij bojë hiri, prapa lenteve pa skelet, ishin të ftohtë.

— Jam i një mendjeje me ty, Rosko, — tha Ostini. — Mendoj se duhej të ishin vënë në dijeni. Ndërkaq, e vlerësoj mjaft mendimin tënd.

— Faleminderit, Harold. Në rrethana si këto, njeriu nuk mund ta dijë kurrë me saktësi se ç'është më mirë të bëhet. E vetmja gjë e sigurt është se dikush duhet të marrë frerët në dorë. Por... një arsye tjetër për të cilën mendoj se duhen njoftuar këshilltarët, është se ky lajm i trishtueshëm lidhur me Benin do të ketë një efekt të tmerrshëm dhe, së shpejti, do të ketë marrë dhenë.

— S'ka dyshim për këtë, — u shpreh i një mendjeje i nderuari Harold. — Ka shumë të ngjarë që, gjer nesër, shtypi të jetë vënë në dijeni dhe të fillojë nga pyetjet.

— Pikërisht ashtu. Dhe një publicitet i gabuar do të mund të ngjallte shqetësim te depozituesit tanë dhe t'u shkaktonte aksioneve tona humbjen e ndonjë pike.

— Hm.

Rosko Hejuordi e ndjente se si po vërtetoheshin mendimet në mendjen e këshilltarit. Klani i Ostinëve, të cilin e përfaqësonte i nderuari Harold, zotëronte një numër të madh aksionesh të FMA-së.

Pa humbur asnjë çast, Hejuordi shtoi:

— Natyrisht, po qe se këshilli administrativ vepron në mënyrë energjike për të siguruar pronarët e aksioneve dhe depozituesit, si edhe publikun në përgjithësi, efekti i kësaj që ndodhi do të mund të ishte i papërfillshëm.

— Përveçse për miqtë e Ben Roselit, — ia kujtoi Harold Ostini me ton të ftohtë.

— Nuk e kisha fare fjalën për humbjen e personit në vetvete. Të siguroj se dhimbja që ndiej për këtë është po aq e thellë sa ajo që ndien cilido tjetër.

— Po ti, Rosko, ç'mendon për të gjitha këto?

— Në përgjithësi, Harold jam i mendimit se duhet siguruar... vazhdimësia e udhëheqjes. Posti drejtues nuk duhet të mbetet bosh as edhe një ditë të vetme.

Hejuordi vazhdoi:

— Me gjithë respektin që kam për Benin dhe dhemshurinë që e gjithë ndjejmë për të duhet të them se, për një kohë shumë të gjatë; kjo bankë është parë si një institucion i drejtuar nga një person i vetëm. Sigurisht që kjo strukturë ka vite që ka ndryshuar, sepse s'ka bankë që të mund të bëjë pjesë midis njëzet bankave më të rëndësishme të kombit, duke vazhduar të drejtohet në mënyrë individuale. Mirëpo, jashtë saj, ka njerëz që mendojnë se kështu veprohet. Ja sepse këshilltarët, pavarësisht se sa të trishtueshme dhe të dhimbshme janë këto çaste, kanë rastin për të vepruar dhe për ta shembur këtë legjendë.

Hejuordit i dukej se gati-gati e ndjente se si tjetri po mendohej me dhelpëri, para se të përgjigjej. Ai edhe e shihte në mendjen e tij: i pashëm, tipi i «plajboj»[1]) jo më i ri, i veshur në një mënyrë që bie shumë në sy dhe me flokët e dendur ngjyrë hiri të errët, që ishin të modës në atë kohë. Kishte shumë të ngjarë që, si zakonisht, ai të ishte duke pirë një puro të madhe. Mirëpo, i nderuari Harold s'ishte aspak mendjelehtë dhe e mbanin për njeri të aftë dhe të mprehtë në çështjet tregtare. Më në fund, ai tha:

— Them se mendimi yt përsa i përket vazhdimësisë së udhëheqjes është i drejtë dhe jam i një mendjeje me ty se duhet caktuar pasardhësi i Ben Roselit dhe, ndoshta, që emri i tij të njoftohet bile para vdekjes së Benit.

Hejuordi dëgjonte me vëmendje, ndërsa tjetri vazhdoi:

— Dhe mendoj se ti je personi i përshtatshëm, Rosko. Ka kohë që e kam pasur këtë mendim. Ti i ke cilësitë e nevojshme, përvojën, bile edhe forcën e karakterit. Prandaj, të siguroj për përkrahjen time. Veç kësaj, ka edhe anëtarë të tjerë të këshillit, të cilët mund t'i bind të veprojnë si unë. Mendoj se do ta dëshiroja një gjë të tillë.

— Të jam shumë mirënjohës...

— Natyrisht që, si kundërpeshë, rastësisht mund të të kërkoj ndonjë quid pro quo..[2]

— Shumë e drejtë.

— Në rregull! Ne të dy kuptohemi shumë mirë.

Ndërsa po e ulte receptorin, Rosko Hejuordi mendoi se biseda kishte qenë mjaft e kënaqshme. Harold Ostini ishte njeri i çiltër dhe e mbante fjalën e dhënë.

Edhe bisedat e mëparshme telefonike kishin qenë gjithashtu të kënaqshme. Pak më vonë, duke folur me një këshilltar tjetër, Filip Xhohensenin, president i Mid Kontinent Ruber, Hejuordit iu paraqit një rast tjetër i favorshëm. Pa iu kërkuar një gjë e tillë, Xhohenseni tha se nuk ishte kurrsesi në favor të Aleks Vandervurtit, idetë e të cilit i dukeshin se nuk përputheshin aspak me ato të pranuarat botërisht.

— I tillë është nga çdo pikëpamje Aleksi, — tha Hejuordi. — Natyrisht, ka disa probleme personale. Nuk di të them se sa të varura nga njëra-tjetra janë këto dy gjëra.

— Çfarë lloj problemesh?

— Punë grash. Nuk ka lezet të flasësh për...

— Kjo është e rëndësishme, Rosko, dhe, midis nesh, vazhdo!

— Ja, në radhë të parë, Aleksi ka vështirësi në jetën bashkëshortore. Së dyti, është ngatërruar edhe me një grua

tjetër. Së treti; kjo grua është një veprimtare e së majtës. Për të flitet shpesh në shtyp, por jo me një përmbajtje që mund të jetë e dobishme për bankën. Shpeshherë e pyes veten se sa ndikim mund të ketë ajo mbi Aleksin. Siç thashë edhe më parë, nuk ka lezet të flasësh për...

— Bëre mirë që ma the, Rosko, — e ndërpreu Xhohenseni. — Këto janë gjëra që anëtarët e këshillit duhet t'i dinë. E së majtës, eh?

— Po. Quhet Margot Brekën.

— Më duket se kam dëgjuar të flitet për të dhe, ajo që kam dëgjuar, s'më ka pëlqyer fare.

Hejuordi buzëqeshi.

Mirëpo, ai u kënaq më pak me dy telefonatat e tjera. Së pari u lidh me njërin nga këshilltarët që ndodheshin jashtë qytetit, Leonard L. Kingsudin, president i këshillit të Northam Steltit.

Kur Hejuordi i sugjeroi se këshilltarët e bankës duhej të kishin qenë njoftuar të parët për këtë çështje, Kingsudi, i cili e kishte nisur karrierën e tij si shkrirës në një uzinë çeliku, tha:

— Mos më thuaj marrëzira, Rosko. Edhe unë do të kisha vepruar njëlloj si Beni: Do të njoftoja, së pari, njerëzit më të afërt dhe, pastaj, këshilltarët si dhe të tjerët që njerëzit veç kujtojnë se ç'janë.

Sa për mundësinë e një rënieje të aksioneve të FMA-së, kundërveprimi i Kingsudit qe:

— E pastaj? Sigurisht, shtoi ai, — me t'u mësuar lajmi, FMA-ja do të humbasë në bursë një ose dy pikë. Kjo do të ndodhë sepse pjesa më e madhe e operacioneve bëhen për llogari të njerëzve pa ndonjë vlerë, që nuk dinë të dallojnë histerizmin nga realiteti. Por, është po aq e sigurt se aksionet do të ngrihen përsëri, brenda një jave, sepse vlera aty është

dhe banka është solide dhe, të gjithë ne që bëjmë pjesë në të e dimë mirë këtë gjë.

Gjatë vazhdimit të bisedës, Kingsudi tha:

— Rosko, kjo lojë që po luan është po aq e tejdukshme sa xhami i pastruar mirë i një dritareje; prandaj, për të kursyer kohën e ne të dyve, po e bëj sa më të qartë pozitën time. Ti je administrator shumë i mirë. Nga të gjithë ata që kam njohur, je më i afti për manovrimin e shifrave e të parave. Dhe po qe se ndonjë ditë do të doje të kaloje te Northami, me një pagë më të madhe dhe me të drejtën për të blerë aksione të emetuara rishtas, me parapëlqim kundrejt të tjerëve, do të lëviz tërë personelin që të të siguroj ty postin më të mirë, Po të bëj një ofertë dhe një premtim. E kam seriozisht.

Presidenti i këshillit të Northam Stelit vazhdoi, duke mos ia vënë veshin mërmëritjes me falënderime të Hejuordit:

— Por, Rosko, pavarësisht nga zotësia jote, dua të bëj të qartë diçka: ti nuk i ke të dhënat e nevojshme për të qenë në krye dhe për të drejtuar krejt një institucion. Së paku, kështu mendoj unë dhe këtë do ta vë në dukje kur të mbledhet këshilli administrativ i FMA-së, për të vendosur se kush do të jetë pasardhësi i Benit. Një gjë tjetër që mund të të them që tani është se, për postin në fjalë, unë do të doja Vandervurtin. Mendoj se duhet ta dish këtë.

Me zë të qetë, Hejuordi u përgjigj:

— Të jam mirënjohës për sinqeritetin, Leonard.

— Në rregull. Dhe po qe se do të mendosh seriozisht për atë ofertën, më telefono.

Rosko Hejuordi s'kishte aspak ndërmend të punonte te Northam Steli. Ndonëse paratë për të ishin të rëndësishme, krenaria nuk e lejonte ta pranonte ofertën, mbas mendimit të hidhur të shprehur pak më parë nga Leonard Kingsudi. Veç

kësaj, Hejuordi kishte besim të plotë se do ta shtinte në dorë postin e parë të drejtimit të FMA-së.

Zilja e telefonit ra përsëri. Kur ai ngriti receptorin, Dora Kellëgeni e njoftoi se edhe një këshilltar tjetër ishte në linjë:
— Zoti Flloid Le Berre.

— Flloid, — ia nisi Hejuordi, me zë të ulët e serioz, — më vjen shumë keq që jam unë që po të jap një lajm kaq të trishtueshëm e tragjik.

3.

Të gjithë pjesëmarrësit e asaj mbledhjeje të rëndësishme nuk u larguan aq shpejt sa Rosko Hejuordi. Disa qëndruan për një kohë jashtë sallës duke biseduar, ndonëse ishin mjaft të tronditur.

Pop Monroi, nëpunësi i vjetër i administratës fiduciare, i tha me zë të ulët Eduina d'Orsejit:

— Kjo është një ditë e trishtuar, shumë e trishtuar.

Eduina pohoi me kokë. Ajo nuk ishte akoma në gjendje të fliste. Kishte shumë miqësi me Ben Roselin, i cili, nga ana e tij, kishte qenë krenar për pozitën në të cilën ajo ishte ngjitur në bankë.

Aleks Vandervurti u ndal pranë Eduinës dhe i tha, duke treguar me dorë zyrën e tij që gjendej pak më tutje, në korridor:

— Si thua, a po vjen pak nga unë?

— Me gjithë qejf, — u përgjigj ajo me mirënjohje.

Zyrat e funksionarëve më të lartë të bankës ndodheshin në të njëjtin kat me sallën e këshillit — në katin e 36-të të gratacielit të Drejtorisë Qendrore të FMA-së. Zyra e Aleks Vandervurtit, si të gjitha të tjerat, kishte një pjesë të rezervuar për mbledhjet jozyrtare. Aty, Eduina mbushi një filxhan kafe

nga një makinë automatike, ndërsa Vandervurti nxori llullën dhe e ndezi. Ajo vërejti gishtat e tij se si lëviznin me shkathtësi, pa lëvizje të tepërta. Ai kishte duar të shkurtra e të gjëra, siç ishte edhe trupi i tij, me gishtat që mbaronin me thonj të trashë, por të mbajtur mirë.

Marrëdhëniet shoqërore ndërmjet tyre vazhdonin prej kohe. Ndonëse Eduina, e cila drejtonte degën kryesore të qytetit, ishte disa shkallë poshtë Aleksit në hierarkinë e bankës ai e kishte trajtuar gjithmonë si të barabartë dhe, shpeshherë, për çështjet që kishin të bënin me degën që ajo drejtonte, merrej vesh drejtpërdrejt me të, pa marrë parasysh shkallët burokratike që i ndanin.
— Aleks, — tha Eduina, — desha të të them se ke pamjen e një skeleti.

Një buzëqeshje e kënaqur ndriçoi fytyrën e tij të mbushur e të lëmuar.

— Shihet, eh?

Aleks Vandervurti shkonte shumë shpesh në pritje të ndryshme dhe i pëlqenin shumë ushqimet dhe verat e zgjedhura. Mirëpo, për fat të keq, shtonte peshë me lehtësi, prandaj, herë pas here mbante dietë, siç po bënte edhe në këtë periudhë.

Me një marrëveshje të heshtur, ata iu shmangën subjektit që ishte në mendjen e të dyve.

Ai e pyeti:

— Si venë punët këtë muaj në degën tuaj?

— Shumë mirë dhe jam optimist edhe për vitin e ardhshëm.

— Lidhur me vitin e ardhshëm, ç'mendim ka Luisi?

Luis d'Orseji, i shoqi i Eduinës, ishte botues dhe drejtor i një buletini financiar me tirazh të madh.

— Ai është mjaft pesimist. Parashikon një ngritje të përkohshme të vlerës së dollarit dhe, pastaj, një rënie të vazhduar, ashtu siç ndodhi me stërlinin angleze. Luisi thotë gjithashtu se, ata që pretendojnë në Uashington se rënia ka marrë fund, janë optimistë të ngjashëm me ata profetët e rremë që shihnin «dritën në fund të tunelit» në Vietnam.

— Jam i një mendjeje me të, sidomos përsa i përket dollarit. A e di Eduina, një nga metat e sistemit bankar amerikan është se ne nuk i kemi inkurajuar klientët tanë që të mbajnë depozitime me valuta të huaja: franga zvicerane, marka gjermane, etj., siç bëjnë për shembull bankat evropiane. Sigurisht, kjo bëhet nga shoqëritë e mëdha, sepse ato janë në gjendje të ngulin këmbë për një gjë të tillë dhe, nga ana tjetër, bankat tona nxjerrin fitime të majme nga valutat e huaja. Mirëpo rrallë ndodh që një gjë e tillë të bëhet edhe nga depozituesit e vegjël dhe të mesëm. Po të kishim nxitur krijimin e depozitimeve me valuta evropiane, para dhjetë ose edhe vetëm pesë vjetëve, disa nga klientët tanë do të kishin fituar, në vend që të humbisnin nga zhvlerësimi i dollarit.

— Nuk do të kishte qenë në kundërshtim me një gjë të tillë ministria e Thesarit e Shteteve të Bashkuara?
— Ka të ngjarë që kjo të ndodhte, por presioni i publikut do ta kishte detyruar të hiqte dorë.

Eduina pyeti:

— A e ke ngritur ndonjëherë çështjen e shtimit të numrit të njerëzve që disponojnë llogari në valutë të huaj?

— U përpoqa një herë ta bëja një gjë të tillë, por ma mbyllën gojën. Sado i dobët qoftë dollari, bankat amerikane e konsiderojnë atë të shenjtë. Ne u kemi imponuar njerëzve konceptin prej struci, atë të futjes së kokës në rërë, duke mos parë realitetin, gjë që atyre u kushton para. Vetëm një numër i

vogël njerëzish, të rrahur me vaj e uthull, patën mprehtësinë të hapnin llogari pranë ndonjë banke sviceranе, para zhvlerësimit të dollarit.

— Shpesh kam menduar, — tha Eduina, — për faktin se, çdo herë që ka ndodhur një zhvlerësim, bankierët e dinin që më parë se ai ishte i pashmangshëm. Megjithatë, ne s'u kemi thënë ose sugjeruar kurrë, ndonjëherë klientëve tanë, me përjashtim të disa të privilegjuarve, që t'i shisnin dollarët.

— Një veprim i tillë mbahej si antipatriotik. Bile edhe Beni...

Aleksi e la fjalën në mes. Ata qëndruan në heshtje për disa çaste.

Nëpërmjet dritareve, në faqen lindore të zyrës së Aleksit, ata mund të admironin panoramën e qytetit të madh të perëndimit të mesëm. Në radhë të parë vinin kanionet e qendrës afariste, ndërtesat më të mëdha të së cilës ishin pak më të ulëta se grataçieli i Drejtorisë Qendrore të Fërst Merkentajll Ëmerikën Benkut. Përtej qendrës afariste gjarpëronte, në trajtën e një S-je të dyfishtë, lumi i gjerë, me trafikun e tij të dendur dhe me ujin, që edhe sot si gjithnjë qe bojë hiri, për shkak të ndotjes. Lëmshi i ngatërruar i urave mbi lumë, i vijave hekurudhore dhe i arterieve, hapej pastaj si me kordele të zgjatura, që shtriheshin në largësi në drejtim të periferisë së zonës industriale dhe lagjeve të jashtme, që ishin të mbuluara me një shtresë mjegulle dhe, prandaj më shumë mund të merreshin me mend se sa të shiheshin. Përtej lumit, por para zonës industriale dhe lagjeve të jashtme shtrihej rajoni i banesave të asaj pjese të qytetit, një labirint ndërtesash të vjetëruara e të këqija, që disa e kishin mbiquajtur: turpi i qytetit.

Në mes të këtij rajoni të fundit ngrihej lart një ndërtesë e re, e madhe, si edhe skeleti prej çeliku i një tjetre.
Eduina i tregoi ata me dorë dhe tha:

— Po të isha në gjendjen e Benit dhe po të doja të më kujtonin për diçka, do të më pëlqente që kjo të bëhej nëpërmjet këtë rajoni lindor.

— Ashtu mendoj dhe unë. — Vështrimi i Aleksit ndoqi atë të Eduinës. — Sigurisht që po të mos kishte qenë Beni, e gjithë kjo do të kishte mbetur vetëm një mendim dhe asgjë më shumë.

Rajoni Lindor ishte një projekt urbanistik ambicioz, që synonte të kryente rregullimet e nevojshme në qendër të qytetit. Ben Roseli i kishte dhënë këtij projekti përkrahjen financiare të FMA-së dhe Aleks Vandervurti përgjigjej drejtpërdrejt për veprimet financiare lidhur me të. Dega e madhe kryesore e qytetit, e drejtuar nga Eduina, merrej me hua ndërtimesh dhe hipoteka.

— Po mendoja, — tha Eduina, — për ndryshimet që do të bëhen këtu. — Qe gati duke shtuar: mbas vdekjes së Benit.

— Do të ketë, sigurisht, ndryshime dhe, ndoshta ndryshime të mëdha. Shpresoj që asnjëri prej tyre të mos ketë të bëjë me Rajonin Lindor.

Eduina psherëtiu thellë:

— S'ka kaluar as një orë që prej çastit që Beni na tha...

— Dhe ne po diskutojmë për çështje të ardhshme të bankës, para se t'i jetë hapur varri. S'ke ç'i bën, Eduina, duhet bërë. Edhe Beni vetë këtë pret nga ne. Disa nga vendimet e rëndësishme duhen marrë shpejt.

— Duke përfshirë edhe pasardhësin e presidentit.

— Ky është njëri prej tyre.

— Një pjesë e mirë nga ne, në bankë, shpresojnë që në këtë post të caktohesh ti.

— Sinqerisht edhe unë ashtu shpresoj.

Por ajo që ata të dy nuk thanë ishte se Aleks Vandervurti mbahej nga të gjithë si trashëgimtari i caktuar i Ben Roselit. Mirëpo, jo kaq shpejt. Aleksi punonte në Fërst Merkentajll Ëmerikën Benk vetëm që prej dy vjetësh. Ai kishte qenë më parë funksionar në Rezervën Federale dhe vetë Ben Roseli ia kishte mbushur mendjen të largohej prej andej dhe të vinte të punonte tek ai, duke e bërë të shpresonte se një ditë do të mund të arrinte në krye të bankës.

«Mbas nja pesë vjetësh, — i kishte thënë atëherë plaku Ben Aleksit, — dua t'ia dorëzoj stafetën dikujt që të jetë në gjendje të trajtojë me sukses operacione bankare të mëdha dhe të dijë t'u tregojë klientëve se ku qëndrojnë përfitimet e tyre kryesore, sepse kjo është e vetmja mënyrë që mund të sigurojë suksesin në punën e një bankieri. Por ky njeri nuk duhet të jetë vetëm një teknik i përsosur. Personi që unë do të zgjedh për të drejtuar bankën nuk duhet të harrojë kurrë se depozituesit e vegjël, individët e veçantë që derdhin në bankë kursimet e tyre, kanë përbërë gjithmonë themelet tona të shëndosha. E keqja me bankierët e sotëm është se ata të rrinë shumë larg, s'janë fare të afrueshëm.»

Ben Roseli e kishte thënë qartë se nuk po bënte një premtim përfundimtar, por kishte shtuar: «Kam përshtypjen, Aleks, se ti je tipi i njeriut që na duhet. Le të punojmë së bashku për njëfarë kohe dhe, pastaj, shohim e bëjmë.»

Kështu, Aleksi kaloi te FMA-ja, duke sjellë përvojën e tij dhe një nuhatje të fortë lidhur me teknikat e reja bankare. Brenda një kohe të shkurtër, këto dy cilësi e kishin bërë të shquhej. Veç kësaj, kishte parë se shumë nga pikëpamjet e tij përputheshin me ato të Ben Roselit.

Në të vërtetë, mësimin e parë në teknikën bankare Aleksi e kishte marrë shumë kohë më parë nga telashet e të atit; një emigrant holandez që ishte vendosur si fermer, në Minesota.

Pieter Vandervurti e kishte ngarkuar veten me barrën e një huaje bankare dhe punonte shtatë ditë në javë, nga agimi gjer në perëndim të diellit, për të shlyer interesat e saj. Më në fund, i varfëruar, ai vdiq nga puna e tepërt. Atëherë, banka shiti tokat e tij, duke nxjerrë jo vetëm interesat e prapambetura, por edhe investimin e saj fillestar. Përvoja e të atit i kishte treguar Aleksit, nëpërmjet dhimbjes së tij, se ç'vend i përshtatshëm ishte ana tjetër e sportelit të bankës.

Më në fund, shtytja vendimtare drejt karrierës bankare i ishte dhënë Aleksit të ri nga një bursë studimi e universitetit të Harvardit dhe nga kryerja e studimeve në ekonomi me përfundime të shkëlqyera.

— Ka akoma mundësi që çdo gjë të bëhet siç shpresojmë ne, — tha Eduina d'Orseji. — Mendoj se këshilli do të zgjedhë presidentin e ri.

— Po, — u përgjigj Aleksi, me një pamje krejt të papërqendruar. Ai po mendonte për Ben Roselin dhe për të atin; të dy ata gërshetoheshin në mënyrë të çuditshme në kujtimet e tij.
— Vjetërsia e shërbimit nuk është gjithçka.

— Mirëpo ka peshën e vet.

Në mendjen e tij, Aleksi shqyrtoi mundësitë që paraqiteshin. Ai e dinte se kishte talent dhe përvojën e nevojshme për të drejtuar FMA-në, por kishte të ngjarë që këshilltarët të preferonin dikë me një periudhë më të gjatë shërbimi. Rosko Hejuordi, për shembull, kishte njëzet vjet që punonte në atë bankë dhe, megjithëse marrëdhëniet e tij me Ben Roselin nuk kishin qenë dhe aq të mira, ai kishte mjaft përkrahës në këshillin administrativ.

Deri një ditë më parë, kishte shumë të ngjarë që në atë post të caktohej Aleksi. Tani gjendja nuk ishte më e njëjtë.

Ai u ngrit në këmbë dhe zbrazi llullën.

— Duhet të filloj nga puna.

— Edhe unë.

Por kur mbeti vetëm, Aleksi u ul përsëri dhe u zhyt në mendime.

Eduina hyri në një ashensor që e shpuri nga kati i 36-të, poshtë, në sallën kryesore, me një arkitekturë të ndërmjetme midis Linkoln Sentërit dhe kishës Sikstine. Salla ishte plot me njerëz: nëpunës plot nxitim, klientë që drejtoheshin për në zyrat e ndryshme, turistë. Ajo iu përgjigj përshëndetjes miqësore të një roje.

Nëpërmjet xhamit të përkulur të fasadës, Eduina mund të shihte sheshin «Roseli», me pemët e tij, stolat, vendin e rrethuar me bustin e Xhovani Roselit dhe shatërvanin që hidhte lart currila uji. Në verë, sheshi ishte një vend takimi; ku nëpunësit e zyrave të qendrës hanin drekën, por tani ai kishte një pamje të shkretë dhe jomikpritëse. Një erë vjeshte e ftohtë dhe me lagështi ngrinte lart vorbulla të vogla gjethesh e pluhuri dhe kalimtarët nxitonin të futeshin në vende të mbyllura, të ngrohta.

Kjo ishte periudha e vitit që i pëlqente më pak Eduinës; një periudhë melankolike, dimri që po trokiste tashmë te dera, një periudhë vdekjeje.

Ajo ndjeu të përshkohej nga një e rrëqethur dhe u drejtua për te «galeria», e mbuluar me moketë dhe me një ndriçim të ëmbël, që lidhte grataçielin e Drejtorisë Qendrore me degën kryesore të qytetit të FMA-së, një ndërtesë luksoze, me një kat të vetëm.

Kjo ishte mbretëria e saj.

4.

Atë të mërkurë; puna në degën kryesore të qytetit filloi si zakonisht.

Eduina d'Orseji, që ishte atë javë përgjegjëse turni, arriti në bankë me kohë, në ora 8:30, një gjysmë ore para se të hapeshin për publikun portat e mëdha prej bronzi. Si drejtoreshë e degës kryesore të FMA-së, Eduina mund të mos bënte shërbim turni, por vetë ajo donte të vepronte si të gjithë të tjerët. Kjo gjë tregonte gjithashtu se ajo nuk priste, si grua, asnjë privilegj — lidhur me këtë, ajo kishte qenë gjithmonë shumë e kujdesshme gjatë të pesëmbëdhjetë vjetëve që kishte kaluar në Fërst Merkentajll Ëmerikën Benk. Veç kësaj, turni i takonte një herë në dhjetë javë.

Te hyrja anësore, ajo futi dorën në çantën e saj bojë kafe, duke kërkuar çelësin. E gjeti nën një grumbull sendesh të ndryshme; të kuq buzësh, portofol, letra krediti, kuti pudre, krehër, një listë gjërash për t'u blerë, etj. — Në çantën e saj kishte gjithnjë një çrregullim të madh. Para se të përdorte çelësin, ajo verifikoi nëse ishte aty sinjali «rrugë e lirë». Sinjali ishte në vendin e vet: një copë karton i vogël, i verdhë, i vënë te një dritare në mënyrë që të mos binte në sy. Kartoni i vogël ishte vënë aty para disa minutash nga portieri, i cili kishte për detyrë të vinte çdo ditë para të gjithëve. Në qoftë se brenda gjithçka ishte rregull ai e vendoste sinjalin në një vend dhe në një mënyrë që personeli që do të vinte më vonë, të mund ta shihte. Por, në rast se vjedhësit ishin futur brenda gjatë natës dhe prisnin të zinin pengje — të parin portierin — është e qartë se aty nuk do të ndodhej asnjë sinjal, kështu që mungesa e tij do të shërbente si alarm. Në këtë rast, personeli duke ardhur mbas portierit jo vetëm që nuk do të hynte, por do të kërkonte menjëherë ndihmë.

Për shkak të vjedhjeve të çdo lloji, gjithnjë e më të shpeshta, pjesa më e madhe e bankave përdornin tanimë sinjalin «rrugë e lirë», llojin dhe pozicionin e të cilit e ndryshonin shpesh.

Sapo hyri, Eduina shkoi drejt një sporteli, të mbërthyer me mentesha në mur, dhe e hapi. U duk butoni i një zileje, të cilin ajo e shtypi sipas një kodi të paracaktuar — dy shtypje të

gjata, tri të shkurtra, një të gjatë. Në këtë mënyrë,në centralin e kontrollit të shërbimit të sigurimit pranë Drejtorisë Qendrore, tani e dinin se alarmi i dhënë para një çasti nga hyrja e Eduinës mund të mos përfillej dhe se në bankë gjendej një funksionar i autorizuar. Edhe portieri, duke hyrë, duhej të përdorte kodin e tij.

Mbasi të kishte marrë sinjale të ngjashme nga degët e tjera të FMA-së, centrali i kontrollit e ndërronte sistemin e alarmit nga «gatishmëri» në «qetësi».

Në rast se përgjegjësi i turnit ose portieri gabonin në transmentimin e kodit, centrali i jepte alarmin policisë. Mbas pak minutash, dega e bankës do të gjendej e rrethuar.

Sikurse bëhet edhe me sistemet e tjera të alarmit, kodet ndryshoheshin shpesh.

Kur çdo gjë ishte e qetë dhe në rregull, bankat e ndjenin veten të sigurta me këtë metodë sinjalizimi dhe mungesa e sinjalit tregonte se diçka nuk ishte si duhej. Në këtë mënyrë, një nëpunës banke, i zënë peng, e jepte alarmin me vetë mosveprimin e tij.

Tani po hynin funksionarë dhe nëpunës të tjerë para syrit vigjilent të portierit me uniformë, që kishte zënë vend te porta anësore.

Njëri nga veteranët e bankës, me flokë të bardhë, i quajtur Totenho iu afrua Eduinës duke i thënë:

— Mirëmëngjes, zonja D'Orsej. Ai ishte kryetar zyre dhe përgjegjëj për personelin dhe mbarëvajtjen e punës në degën e bankës. Kishte një fytyrë të gjatë e të zymtë, që e bënte t'i ngjante një kanguri të vjetër. Sa më shumë që afrohej data e pensionit, aq më shumë shtoheshin edhe trishtimi e pesimizmi i tij i zakonshëm: e mërziste mosha e tij dhe për këtë dukej sikur ua vinte fajin të tjerëve. Eduina dhe Totenhoi përshkruan së bashku katin përdhes të degës së bankës dhe,

pastaj, zbritën një palë shkallë të gjera, të veshura me moketë, që të shpinin në bodrumet. Përgjegjësi i turnit përgjigjej, ndër të tjera, edhe për mbikëqyrjen e hapjes e të mbylljes së «thesarit».

Ndërsa po prisnin te dera e bodrumit kohën e nevojshme që i duhej bravës të hapej, Totenhoi tha me zë të trishtuar:

— Thuhet se zoti Roseli është duke vdekur. A është e vërtetë?

— Kam frikë se ashtu është. — Dhe ajo i tregoi shkurtimisht se ç'kishte ndodhur në mbledhjen që ishte bërë një ditë më parë.

Natën e fundit, në shtëpi, ajo vetëm për këtë gjë kishte menduar, por tani, në mëngjes, ishte e vendosur të përqendrohej në punën e bankës. Edhe vetë Beni kështu do të kishte dashur të bëhej.

Totenhoi mërmëriti diçka të trishtueshme, të cilën ajo nuk mundi ta kuptonte.

Eduina kontrolloi orën e saj me atë të murit. Ora ishte 8:40. Mbas disa sekondash, një kërcitje e lehtë përbrenda portës masive prej çeliku të kromuar tregoi se brava, e rregulluar mbrëmjen e kaluar, para mbylljes së degës së bankës, në mënyrë që të mbetej e kyçur tërë natën, ishte hapur vetë. Vetëm tani mund të formohej kombinimi që lejonte hyrjen në bodrume.

Duke përdorur një buton tjetër të fshehur, Eduina i sinjalizoi centralit të kontrollit se porta e bodrumeve po hapej — hapje normale, jo me forcë.

Eduina dhe Totenhoi, pranë njëri-tjetrit para portës, bënë nga një kombinim të ndryshëm. Asnjëri prej tyre nuk e dinte kombinimin e tjetrit dhe asnjëri prej tyre nuk mund ta hapte vetëm portën e bodrumeve.

Ndërkaq kishte ardhur edhe Majlls Istini, nënkryetar i zyrës. Ai ishte një djalë i ri, i pashëm, me paraqitje të rregullt. Istini ishte gjithmonë i gëzuar, në kundërshtim me trishtimin e përhershëm të Totenhoit. Eduina e shihte me sy të mirë Istinin. Bashkë me këtë të fundit ishte edhe një nëpunës i thesarit, detyra e të cilit ishte të mbikëqyrte gjatë tërë ditës transformimet e parave, qoftë si hyrje apo si dalje. Gjatë gjashtë orëve të punës, nëpër duart e tij do të kalonin rreth një milion dollarë në bankënota e monedha, si dhe njëzet milionë të tjerë në çeqe.

Eduina u tërhoq disi; nëpunësi i thesarit dhe Majlls Istini çelën së bashku portën e madhe, kanatet e së cilës, duke u hapur, lëvizën me një përpikëri të përsosur. Ajo do të rrinte e hapur deri sa të mbyllej dega kryesore e bankës.

— Sapo më telefonuan, — i tha Istini kryetarit të zyrës. — Sot mungojnë dy arkëtarë të tjerë.

Fytyra e trishtuar e Totenhoit u ngrys edhe më shumë.

— Grip? — pyeti Eduina.

Për shkak të një epidemie që ishte përhapur në qytet gjatë dhjetë ditëve të fundit, banka kishte pasur mjaft mungesa në personelin e saj veçanërisht në arkëtarë.

— Po, grip — u përgjigj Majlls Istini.

Totenhoi tha me ton të vajtueshëm:

— Të më zinte, së paku, mua. Do të bija në shtrat dhe do të lija dikë tjetër të vriste mendjen se kë të caktonte në sportelet e mbetura pa njeri.

Pastaj, u kthye nga Eduina dhe e pyeti:

— Ngulni këmbë që ta hapim patjetër sot?

— Duket se këtë presin nga ne, apo jo?

— Mirë atëherë, arkëtarët që mungojnë, do të zëvendësohen nga vetë ne. I pari caktohesh ti, — i tha ai Majlls Istinit. — Prandaj merr një kasetë me para dhe përgatitu për të pritur publikun. Nuk ke harruar të numërosh, apo jo?

— Jo, gjer në njëzet, — tha Istini. — Shpresoj t'ia dal në krye, ndonëse nuk i kam këpucët e hendbollit.

Eduina buzëqeshi. Nuk kishte dyshim për punën e mirë të Istinit të ri. Ai kryente si duhej çdo punë që merrte përsipër. Vitin tjetër, kur të dilte në pension Totenhoi, ajo, sigurisht, do të caktonte atë për ta zëvendësuar.

Istini iu përgjigji, po me buzëqeshje.

— S'ka arsye të shqetësoheni, zonja D'Orsej. Di të numëroj mirë dhe nuk jam i keq si lojtar rezervë. Mbrëmë megjithëse u stërvita në hendboll vetëm për tri orë rresht, munda ta mbaj mend rezultatin.

— Por, a fituat?

— Sigurisht. Njëzet me zero.

Eduina ishte në dijeni edhe të një pasioni tjetër të Istinit, pasion që kishte qenë i dobishëm për bankën: studimi dhe koleksionimi i bankënotave dhe monedhave. Në fakt, ishte Majlls Istini që u bënte nëpunësve të rinj të degës bankare bisedën e parë orientuese. Atij i pëlqente të hidhej në përshkrimin e kurioziteteve historike, si p.sh. faktin se paraja letër dhe inflacioni ishin shfaqur për herë të parë në Kinë. Ai shpjegonte se rasti i parë i inflacionit që njihej kishte ndodhur në shekullin e trembëdhjetë, kur perandori mongol, Kublai Khan duke mos qenë në gjendje të paguante ushtarët e tij me monedha metalike, përdori një vegël druri për të shtypur para letër, duke krijuar kështu, valutën e parë të okupacionit. Për fat të keq, u shtypën aq shumë para, saqë, mbas pak kohe, u

bënë krejt të pavlefshme.
— Ka njerëz që mendojnë, — shtonte ai me ton sarkastik, — se dollari po pëson tani të njëjtin fat të parave mongole.

Falë studimeve të tij, Istini ishte bërë gjithashtu eksperti i degës kryesore të bankës për paratë e falsifikuara dhe bankënotat e dyshimta ia tregonin, për t'i marrë mendimin.

Të tre: Eduina, Istini dhe Totenhoi, i ngjitën përsëri shkallët që lidhnin bodrumet me katin përdhes.

Ndërkaq, jashtë degës së bankës, dy roja të armatosura po shkarkonin disa thasë jute me bankënota, nga një makinë transporti e blinduar.

Kur ishte fjala për sasira të mëdha parash, këto i sillnin gjithmonë herët në mëngjes, mbasi ishin transportuar akoma dhe më herët nga Rezerva Federale, te thesari qendror i Fërst Merkentajll Ëmerikën Benkut. Prej aty, shpërndaheshin pastaj për në degët e ndryshme. Arsyeja e shpërndarjes brenda së njëjtës ditë, ishte e thjeshtë: Paratë me tepricë, të mbajtura në bodrumet, nuk sillnin ndonjë përfitim dhe, nga ana tjetër, ekzistonte rreziku i humbjeve dhe vjedhjeve.

Drejtorët e degëve bankare synonin që, as të mos u mungonte sasia e duhur e parave, dhe as të mos i kishin me tepricë.

Një degë e rëndësishme, si ajo e FMA-së, dispononte një gjendje arke prej një gjysmë milioni dollarësh. Shuma prej një çerek milioni, që kishte mbërritur, tani ishte diferenca mesatare, e nevojshme për një ditë pune.

Totenhoi iu ankua rojave:

— Shpresoj të keni sjellë para më të pastra se ato që kemi marrë këto kohët e fundit.

— Ua përcolla ankesën tuaj, zoti Totenho, atyre të arkës qendrore, — iu përgjigj njëri nga rojat. Ky ishte një djalë i ri

me flokë të gjatë të zinj, që i dilnin jashtë beretës, mbi jakën e uniformës. — Ata thanë se bile ju i kishit telefonuar vetë, — shtoi djaloshi. — Se, unë për vete kur marr para; as vë re nëse janë të pastra apo jo.

— Për fat të keq, — ia priti Totenhoi, — disa nga klientët tanë nuk janë të këtij mendimi.

Bankat ishin në garë me njëra-tjetrën për të marrë, nëpërmjet Rezervës Federale, para të reja që vinin nga qendra e prerjes dhe e shtypjes së tyre. Një numër çuditërisht i madh klientësh, i mbiquajtur «zotërinjtë e mëdhenj», nuk i pranonin bankënotat jo të pastra dhe kërkonin të reja, ose, së paku, të mos ishin pis. Fatmirësisht, kishte të tjerë që nuk merakoseshin për një gjë të tillë dhe arkëtarët kishin urdhër t'i hiqnin qafe, sa më parë që të ishte e mundur, bankënotat jo të pastra dhe të mbanin ato më të rejat për klientët që i kërkonin.

— Thuhet se ka në qarkullim një sasi shumë të madhe monedhash të falsifikuara, me cilësi shumë të lartë. Ndoshta, do të mund t'ju sjellim juve një tufë prej tyre, — tha roja i dytë, duke i shkelur synë shokut të tij.

— Ky lloj nderi s'ka ç'na duhet, — ia priti Eduina. — Po na vijnë si tepër nga këto lloj parash.

Vetëm një javë më parë, në degë ishin zbuluar gati një mijë dollarë në bileta të falsifikuara — para të derdhura në bankë — por, se nga kush, nuk dihej. Kishte shumë të ngjarë që këto para të kishin mbërritur aty nëpërmjet një numri të madh depozituesish — disa prej tyre do ta kishin pësuar vetë nga këto bankënota dhe, pastaj, ia kishin kaluar bankës humbjet e tyre; të tjerët nuk dinin gjë fare që bankënotat ishin të falsifikuara, gjë që nuk ishte për t'u çuditur, pasi cilësia e falsifikimit ishte mjaft e lartë.

Agjentët e Shërbimit Sekret të SHBA-së, që e kishin diskutuar këtë problem me Eduinën dhe Majlls Istinin, kishin qenë me të vërtetë të preokupuar.

— Nuk ka pasur kurrë ndonjëherë tjetër para të falsifikuara në mënyrë kaq të përsosur dhe nuk ka pasur kurrë kaq shumë në qarkullim, — kishte pohuar njëri prej tyre. Sipas një vlerësimi të matur, një vit më parë ishin prodhuar bileta të falsifikuara me një vlerë prej tridhjetë milionë dollarësh, pa llogaritur ato që nuk zbulohen fare.

Anglia dhe Kanadaja ishin burimet kryesore të dollarëve amerikanë të falsifikuar. Agjentët kishin thënë gjithashtu se një sasi e pabesueshme qarkullonte në Evropë. «Dhe atje nuk është aq lehtë të zbulohen falsifikime të tilla. Prandaj u thoni miqve tuaj që shkojnë në Evropë, të mos pranojnë banknota amerikane. Ka shumë të ngjarë që ato të mos kenë asnjë vlerë.»

Roja e armatosur që kishte folur i pari, filloi ngarkimin e thasëve.*

— Mos kini merak, o miq, këto janë para të vërteta.

Të dy rojat zbritën shkallët që të shpinin në bodrumet. Eduina u drejtua për te tryeza e saj e punës mbi platformë. Aktiviteti po shtohej në të gjithë bankën. Portat kryesore ishin hapur dhe klientët e parë të mëngjesit po hynin në një numër gjithnjë e më të madh. Platforma, që sipas traditës ishte e rezervuar për funksionarët e gradës së lartë, ishte e veshur me moketë në ngjyrë të kuqe të mbyllur. Tryeza e punës e Eduinës, që ishte më e madhja dhe më impozantja, kishte në të dy krahët dy flamurë: në të djathtë, atë të Shteteve të Bashkuara dhe, në të majtë, flamurin e shtetit.

Kur ulej aty, Eduina kishte shpeshherë përshtypjen se ndodhej në stacionin e televizionit, gati për të bërë, para telekamerave, ndonjë njoftim solemn.

Dega bankare e madhe e qytetit, ishte moderne. Ndërtesa ishte rindërtuar para nja dy vjetësh — kur ishte ngritur pranë saj gratacieli i Drejtorisë Qendrore — pa pyetur për shpenzimet dhe duke zgjedhur arkitektët më të mirë. Si përfundim, aty mbizotëronte ngjyra e kuqe e errët dhe ajo e moganit, me një nuancë të lehtë ari dhe vetë ndërtesa paraqiste një kombinim komoditeti për klientët, kushtesh të shkëlqyeshme pune dhe luksi të pasur. Eduina thoshte nganjëherë me vete se luksi i pasur të jepte njëfarë avantazhi.

Ndërsa po zinte vend, me elegancën e saj të zakonshme të lëvizjeve, në poltronën e rrotullueshme me shpinore të lartë, ajo kaloi dorën për të rregulluar flokët. Në të vërtetë, kjo nuk ishte e nevojshme; si gjithmonë, paraqitja e saj ishte pa asnjë të metë.

Eduina filloi të shqyrtonte një numër dosjesh, që përbëheshin nga kërkesa huash për shuma më të mëdha nga sa ishin të autorizuar të jepnin funksionarët e tjerë të degës së bankës. Ajo vetë ishte e autorizuar të jepte hua deri në një shumë prej një milion dollarësh, për çdo rast të veçantë, me kusht që edhe dy funksionarë të tjerë të degës të ishin të një mendjeje, gjë që asnjëherë nuk përbënte pengesë. Për shuma më të mëdha, kërkesat i paraqiteshin zyrës së kreditit të Drejtorisë Qendrore.

Te Fërst Merkentajll Ëmerikën Benku, sikurse në cilindo institucion bankar, sasia e huasë që një funksionar mund të sanksiononte, përcaktonte pozitën e tij në hierarkinë e bankës dhe quhej «vlera e siglës», mbasi sigla e tij i jepte miratimin e fundit çdo propozimi huaje.

Për funksionin e saj si drejtoreshë, «vlera e siglës» së Eduinës ishte shumë më e lartë se zakonisht, por pasqyronte përgjegjësinë e saj në drejtimin e degës së rëndësishme të qytetit. Në degët më të vogla, drejtori mund të miratonte kërkesa huash prej dhjetë mijë deri në një gjysmë milioni dollarësh sipas aftësisë dhe vjetërsisë së tij në punë. Eduinën e

zbaviste gjithmonë mendimi se vlera e siglës përcaktonte një sistem kaste, me prerogativat dhe privilegjet përkatëse. Në zyrën e kreditit të Drejtorisë Qendrore, një zëvendësdrejtor, me një autoritet të kufizuar në vetëm 50 mijë dollarë, kishte një tryezë pune të zakonshme dhe punonte bashkë me të tjerë, në një sallë të madhe. Në shkallën hierarkike, menjëherë mbi të, vinte një inspektor i zyrës së kreditit, sigla e të cilit kishte autoritet gjer në një çerek milioni dollarë dhe kishte një tryezë pune më të madhe, në një dhomë të vogël, të veçuar me xhama.

Një zyrë si duhet, me derë e dritare, ishte një e drejtë që i përkiste një nënkryeinspektori të zyrës së kreditit, vlera e siglës së të cilit ngrihej deri në një gjysmë milioni dollarë. Ai kishte të drejtë gjithashtu, të mbante një tryezë pune të madhe, një pikturë në vaj në mur, një bllok shënimesh me emrin e tij të shtypur në çdo faqe, t'i vinte falas çdo ditë një kopje e gazetës «Uoll Strit Zhurnëll» dhe, në shenjë respekti, t'i lustroheshin këpucët çdo mëngjes. Kishte gjithashtu një sekretare, e cila i shërbente edhe një nënkryeinspektori tjetër të zyrës së kreditit.

Më në fund, në krye të shkallës hierarkike ishte kryeinspektori, sigla e të cilit ishte e vlefshme për një milion dollarë, i cili punonte në një zyrë në qoshe të ndërtesës, me dy dritare, dy piktura në vaj dhe kishte një sekretare që ishte vetëm në shërbimin e tij. Fletët e bllokut të shënimeve e kishin në relief emrin e tij. Veç kësaj ai gëzonte të drejtën t'i lustroheshin këpucët çdo mëngjes, të merrte falas gazetën e përditshme, si dhe revista e botime të tjera periodike; të përdorte makinën e bankës për qëllime shërbimi, të hante drekën në sallën e funksionarëve të lartë.

Eduina i gëzonte pothuajse të gjitha këto privilegje, por nuk kishte përfituar kurrë nga e drejta e lustrimit të këpucëve.

Atë mëngjes, ajo shqyrtoi dy kërkesa për hua; miratoi njërën dhe shënoi me laps disa pyetje të tjera, ndërsa te kërkesa e tretë, u bllokua krejtësisht.

E habitur, dhe me ndjenjën e një koincedence të çuditshme mbas ngjarjeve të ditës së mëparshme, ajo e lexoi përsëri të gjithë materialin.

Nëpunësi që e kishte përgatitur materialin, iu përgjigj thirrjes së Eduinës në telefonin e brendshëm.

— Këtu Kesëlmeni.

— Të lutem, Klif, mund të vish pak këtu?
— Si urdhëron. — Nëpunësi në fjalë, që ndodhej gjashtë tryeza pune larg saj, vështroi nga Eduina, duke thënë: — Dhe e vë me bast që e di se për çfarë më doni.

Mbas pak çastesh, ndërsa po ulej pranë tryezës së saj të punës, ai i hodhi një vështrim dosjes së hapur dhe tha:
— Nuk u gabova, punë e ngatërruar, apo jo?

Klif Kesëlmeni ishte i shkurtër, bur me trup të rregullt; me fytyrë të rregullt e të shëndetshme dhe buzëqeshje të ëmbël. Huamarrësit e donin, sepse dinte t'i dëgjonte dhe tregonte mirëkuptim. Por, ai ishte dhe ekspert në çështjet që kishin të bënin me huatë, me një gjykim të shëndoshë.

— Shpresoj, — tha Eduina, — që kjo kërkesë të jetë vetëm një shaka, ndonëse shaka e tmerrshme.

— Rrëqethëse do të ishte më e përshtatshme, zonja D'Orsej. Mirëpo, megjithëse duket marrëzi, ju siguroj se është një çështje reale.

Kesëlmeni bëri me shenjë nga dosja.
— I vura të gjitha faktet, sepse e dija se do t'i donit. Sigurisht që i keni lexuar raportin dhe sugjerimet e mia.

— Seriozisht propozoi që të japim hua tërë ato para për një qëllim të tillë?

— Pa dyshim, seriozisht për vdekje...
Ai u ndal papritur, pastaj vazhdoi:
— Më falni! Nuk doja të bëja humor me gjëra rrëqethëse, por jam i bindur se ju duhet ta miratoni kërkesën për hua.

Në dosje ishin shënuar të gjitha. Një përfaqësues prodhimesh farmaceutike, i quajtur Gosbërn, 43 vjeç, me punë në atë qytet, kishte bërë një kërkesë për një hua prej njëzet e pesë mijë dollarësh. Ishte i martuar që prej shtatëmbëdhjetë vjetësh. Shtëpia ku banonin Gosbërnët, në një lagje të jashtme të qytetit, ishte pronë e tyre dhe mbi të kishte vetëm një hipotekë të vogël. Ata kishin te FMA-ja një llogari të përbashkët që prej tetë vjetësh. Gjatë gjithë kohës, me ta s'kishte lindur asnjë lloj problemi. Më parë kishin marrë një hua më të vogël, të cilën e kishin shlyer në rregull. Informatat për Gosbërnin, qoftë përsa i përkiste punës, ashtu edhe gjendjes ekonomike, ishin të mira.

Qëllimi i kësaj huaje të re ishte blerja e një kapsule të madhe të paoksidueshme, në të cilën do të vendosej trupi i vajzës së Gosbërnëve, Andreinës, që kishte vdekur para gjashtë ditësh, në moshën pesëmbëdhjetë vjeçare, nga një tumor malinj në veshka. Trupi i Andreinës ndodhej tani te një agjenci funeralesh, i konservuar në akull, në temperature shumë të ulët. Gjakun ia kishin nxjerrë menjëherë pas vdekjes dhe e kishin zëvendësuar me një solucion të ngjashëm me gjakun, por që nuk ngrin, i quajtur dimethylsulfoksid.

Kapsula prej çeliku ishte projektuar posaçërisht për të përmbajtur azot të lëngshëm në një temperaturë nën zero. Trupi i mbështjellë me një fletë alumini, do të zhytej në këtë solucion.

Një kapsulë e këtij lloji — në të vërtetë një shishe vigane, e njohur me emrin «cryo-crypt», gjendej në Los Anxhelos dhe do të sillej prej andej me avion, po të miratohej huaja e bankës. Rreth një e treta e shumës do të shërbente si

parapagim për mbajtjen e kapsulës në bodrumin e posaçëm dhe për të ndërruar, një herë në katër muaj, azotin e lëngshëm.

— A keni dëgjuar për shoqatat krionike? — e pyeti Kesëlmeni Eduinën.

— Pak gjëra. Duhet të jetë diçka pseudoshkencore dhe jo me emër shumë të mirë.

— Me të vërtetë, jo me emër shumë të mirë dhe, patjetër, pseudoshkencore. Por fakti është se grupet krionike kanë shumë pasues dhe e kanë bindur Gosbërnin se, kur shkenca mjekësore do të jetë zhvilluar më shumë dhe do të ketë arritur në një stad më të përparuar — ta zëmë pas pesëdhjetë ose njëqind vjetësh — akulli, në të cilin është Andreina, do të shkrihet, ajo do të nxirret jashtë, do të kurohet, do të shërohet dhe do të sillet prapë në jetë. Meqë ra fjala, krionikët kanë një moto: «Ngrirje — pritje — ringjallje».

— E tmerrshme, — tha Eduina.

— Në përgjithësi, jam i një mendjeje me ju, — pranoi Kesëlmeni. — Por, le ta shohim çështjen nga pikëpamja e tyre. Ata kanë besim në këtë gjë. Veç kësaj, ata janë njerëz në moshë të pjekur, mjaft të zgjuar, shumë fetarë. Dhe, kush jemi ne, si bankë, për të lozur rolin e gjykatësit dhe jurisë? Sipas mendimit tim, e vetmja gjë që na takon të bëjmë, është të shohim nëse Gosbërni mund ta shlyejë apo jo huanë. I kam studiuar me kujdes shifrat dhe them se Gosbërni është në gjendje ta bëjë këtë gjë dhe do ta bëjë. Ka mundësi që ai të jetë pak i marrë, mirëpo e kaluara vërteton se është një i marrë që i paguan borxhet.

Megjithëse me njëfarë mosdashje, Eduina shqyrtoi gjendjen ekonomike të Gosbërnit, të ardhurat dhe shpenzimet e tij.
— Do të jetë një përpjekje dhe sakrificë shumë e madhe financiare nga ana e tyre.

— Gosbërni e di këtë, por ngul këmbë se mund t'ia dalë në krye. Ka filluar që tani të marrë përsipër punë jashtë orarit zyrtar. Edhe e shoqja po kërkon punë.

— Ata kanë edhe katër fëmijë më të vegjël, — tha Eduina.

— Po.

— A u është vënë në dukje se, këta katër fëmijë do të kenë, së shpejti, nevojë për para për në kolegj dhe për kaq gjëra të tjera dhe se këto njëzet e pesë mijë dollarë do të ishin më të dobishëm për ata?

— Këtë e bëra unë, — u përgjigj Kesëlmeni. — Kam pasur dy biseda të gjata me Gosbërnin. Por, sipas tij, të gjithë pjesëtarët e familjes e kanë rrahur dhe shqyrtur këtë çështje dhe, më në fund, kanë marrë vendim. Ata janë të bindur se sakrificat që do të bëjnë nuk do të jenë të kota, po qe se do të japin mundësinë për ta kthyer Andreinën një ditë në jetë. Veç kësaj, fëmijët tanë gjithashtu, se, kur të rriten, do ta marrin vetë ata përgjegjësinë e trupit të motrës së tyre.

— O zot! — Mendimet e Eduinës u kthyen përsëri te dita e mëparshme. Kur t'i vinte koha, vdekja e Ben Roselit do të ishte një gjë dinjitoze. Kurse, kjo mënyrë veprimi e kthente vdekjen në diçka të shëmtuar, në një tallje. A ishte e drejtë që paratë e bankës, pra, pjesërisht të Benit, të dëshmoheshin për një qëllim të tillë?

— Zonja D' Orsej, — tha Kesëlmeni, — ky material ka qëndruar dy ditë në tryezën time. Në fillim, kundërveprimi im qe i njëjtë me tuajin. E tërë kjo punë është marrëzi. Por, pastaj, e mendova mirë dhe ndërrova mendim. Sipas meje, ky është një rrezik i pranueshëm.

Rrezik i pranueshëm. Në thelb, mendoi Eduina, Klif Kesëlmeni kishte të drejtë, sepse rreziqet e pranueshme përbëjnë vetë shpirtin e bankës. Ai kishte të drejtë gjithashtu, kur thoshte se banka nuk duhej t'i vishte vetes petkun e

gjykatësit dhe të jurisë, përsa u takonte çështjeve krejtësisht personale.

Natyrisht, mund të ndodhte që pranimi i këtij rreziku të veçantë të përfundonte me një humbje për bankën, por sigurisht që për këtë, nuk do t'i vihej faji Kesëlmenit. Rezultatet e punës së tij, gjatë kohës që kishte shërbyer në bankë, ishin të mira; «fitoret» e tij kishin qenë shumë më të mëdha, me numër, se humbjet. Në fakt, një periudhë shërbimi që përmbante vetëm fitore shikohej me njëfarë mosmiratimi, sepse një nëpunësi që merrej me një numër shumë të madh huash të vogla s'kishte se si të mos i ndodhte që disa prej tyre të përfundonin jo mirë. Në rastin e kundërt, ai mund të kishte bile telashe, kur kompjuteri do të njoftonte Drejtorinë Qendrore se ai po pësonte humbje për shkak të qëndrimit të tij tepër të matur.

— Mirë, — tha Eduina. — Megjithëse vetë ideja e kësaj pune më tmerron, do ta përkrah mendimin tënd.

I vuri siglën dhe Kesëlmeni u kthye te tryeza e tij e punës.

Në këtë mënyrë, me përjashtim të këtij rasti: një vajze që do të mbahej në një kapsulë me akull, ajo ditë kishte filluar si çdo ditë tjetër e zakonshme.

Dhe ashtu mbeti gjer në orët e para të pasdites.

Ditët që hante drekë vetëm, Eduina shkonte në bufenë e Drejtorisë Qendrore, që gjendej nën katin përdhes. Lokali ishte i zhurmshëm, ushqimi as i mirë e as i keq, por shërbimi i shpejtë dhe ajo mund të mbaronte punë në pesëmbëdhjetë minuta.

Mirëpo, atë ditë, ajo kishte si mysafir një klient dhe prandaj shfrytëzoi privilegjin e funksionit të saj, duke shkuar me të në sallën e ngrënies së veçantë të funksionarëve të lartë, në njërin nga katet e sipërme të grataçielit të FMA-së. Mysafiri ishte

administratori i magazinës më të madhe të qytetit dhe kishte nevojë për një hua me afat të shkurtër, prej tre milionë dollarësh, për të mbuluar një deficit arke të shkaktuar, ose nga një rënie e vogël e shitjeve, ose nga shpenzimet më të mëdha se zakonisht, që ishin bërë për blerjen e artikujve të krishtlindjeve.

— Oh, ky inflacion i mallkuar! — u ankua administratori, duke ngrënë suflé me spinaq. Pastaj, duke lëpirë buzët, shtoi: — Por do t'i marrim prapë paratë tona, brenda dy muajve të ardhshëm, bashkë me interesin. Santa Klausi[1]) është gjithmonë bujar me ne.

Magazina në fjalë ishte një kliente e rëndësishme e FMA-së; megjithatë, Eduina i zhvilloi bisedimet në mënyrë të tillë, që përfundimi i tyre të ishte i favorshëm për bankën. Mbas disa kundërshtimesh të vogla të klientit, kushtet u pranuan, kur ata kishin filluar të hanin ëmbëlsirën. Tre milionë dollarë e kalonin kufirin e autoritetit personal të Eduinës, por ajo nuk parashikonte të haste ndonjë vështirësi nga ana e Drejtorisë Qendrore. Po të ishte e nevojshme, për të fituar kohë, do të fliste me Aleks Vandervurtin, i cili e kishte përkrahur mendimin e saj edhe në raste të tjera, të mëparshme.

Ata po pinin kafenë, kur një kameriere u afrua te tavolina e tyre.

— Zonja D'Orsej, — tha ajo, — ju kërkon në telefon një zotëri i quajtur Totenho. Thotë se është urgjente.

Eduina kërkoi ndjesë dhe shkoi te një telefon, në një lokal ngjitur.

— S'kam lënë vend pa ju kërkuar, — u ankua Totenhoi.

— Tani më gjete. Si është puna?

— Kemi një gjendje arke që nuk kuadron për një shumë serioze, — vazhdoi Totenhoi, duke shpjeguar se një arkëtare

kishte njoftuar për këtë humbje para një gjysmë ore. Prej atij çasti, kontrolli kishte vazhduar pa ndërprerje. Eduina dalloi një nuancë paniku dhe trishtimi në zërin e tij dhe e pyeti se për çfarë shume ishte fjala.

Ajo dëgjoi se si ai u përcoll.

— Gjashtë mijë dollarë.

— Po vij menjëherë.

Brenda më pak se një minute, mbasi i kërkoi ndjesë mysafirit të saj, Eduina hyri në ashensor për të zbritur në katin përdhes.

5.

— Me sa mund të kuptoj unë, — tha Totenhoi, me fytyrë të ngrysur, — e vetmja gjë që ne dimë me siguri është se të gjashtë mijë dollarët nuk janë atje ku duhej të ishin.

Shefi i zyrës ishte njëri nga të katër personat e ulur rreth tryezës së punës të Eduina d'Orsejit. Të tjerët ishin: Eduina, i riu Majlls Istin, ndihmësi i Totenhoit, dhe një arkëtare e quajtur Huanita Nunjez.

Pikërisht në arkën e Huanita Nunjezit mungonin paratë. Kishte kaluar një gjysmë ore prej çastit kur Eduina ishte kthyer në degën kryesore të bankës. Ndërsa të tjerët po e vështronin, ajo iu përgjigji Totenhoit:
— Ajo që thoni është e vërtetë, por ne mund të bëjmë edhe më shumë se kaq. Dua të rishikojmë gjithçka përsëri, me qetësi dhe vëmendje.

Ora ishte pak më shumë se tre pasdite. Klientët ishin larguar. Portat e jashtme ishin mbyllur. Në degën kryesore të bankës, veprimtaria vazhdonte si zakonisht, ndonëse Eduinës i kishin rënë në sy vështrimet që hidhnin herë pas here fshehurazi drejt tyre nëpunësit e tjerë, që e kishin kuptuar tanimë se diçka serioze duhej të kishte ndodhur.

Ajo mendoi përsëri se kishte shumë rëndësi që të ruante gjakftohtësinë dhe të analizonte edhe hollësinë më të vogël. Donte t'i kushtonte vëmendjen më të madhe nuancave të zërit e të qëndrimit, sidomos atyre të zonjës Nunjez.

Nga ana tjetër, Eduina e kishte të qartë se, brenda një kohe shumë të shkurtër, ajo duhet të vinte në dijeni për sa kishte ndodhur, Drejtorinë Qendrore. Mbas këtij hapi, do të hynte në veprim Shërbimi i Sigurimit të Bankës dhe, ndoshta, FBI-ja. Por, sa kohë që kishte ende një mundësi për të gjetur qetësisht një zgjidhje të kësaj çështjeje, pa kërkuar ndihmën e artilerisë së rëndë, ajo ishte e vendosur të mos e linte atë pas dore.

— Në qoftë se nuk keni kundërshtim, zonja D'Orsej, po filloj unë, pasi mua më njoftoi Huanita të parin — tha Majlls Istini, i cili e kishte humbur gjallërinë e tij të zakonshme.

Me një lëvizje të kokës, Eduina i tha se mund të fillonte.

Mundësia e mungesës së një sasie parash, u tha Istini tre të tjerëve, i ishte njoftuar pak minuta para orës dy të pasdites. Në atë kohë, Huanita Nunjezi i ishte afruar dhe i kishte thënë që mendonte se në arkë i mungonin gjashtë mijë dollarë.

Për shkak të mungesave në punë të personelit, atë ditë, edhe Majlls Istini kryente punën e arkëtarit. Në fakt, ai gjendej vetëm dy sportele larg Huanita Nunjezit dhe kjo e fundit e kishte vënë në dijeni pikërisht atje, mbasi kishte mbyllur kasetën e saj.

Atëherë, Istini kishte mbyllur gjithashtu kasetën e tij dhe kishte shkuar te Totenhoi.

Tani, tregimi i fakteve u vazhdua nga Totenhoi, i cili kishte një pamje akoma më të ngrysur e të trishtuar se zakonishit.

Ai kishte shkuar menjëherë te zonja Nunjez dhe kishte folur me të. Që në fillim, ai s'kishte pasur besim në saktësinë e shifrës së dhënë nga arkëtarja, sepse, edhe po të pranohej se

ajo dyshonte për zhdukjen e një sasie të hollash, në atë çast ishte krejtësisht e pamundur të dihej se sa e madhe ishte kjo sasi.

Shefi i zyrës theksoi se Huanita Nunjezi kishte punuar në arkë gjatë tërë ditës dhe e kishte filluar punën me pak më shumë se dhjetë mijë dollarë, që i kishte marrë nga thesari. Në arkën e saj ishin bërë derdhje dhe kryer tërheqje që nga ora nëntë e mëngjesit, ora kur ishte hapur banka, gjë që do të thoshte se ajo kishte punuar për gati pesë orë, me përjashtim të pushimit të drekës prej dyzet e pesë minutash dhe, gjatë kësaj kohe, arkëtarët kishin qenë shumë të zënë med punë për shkak të numrit të madh të njerëzve në bankë. Për më tepër, atë ditë, derdhjet kishin qenë më të mëdha se zakonisht, kështu që shuma e të hollave në kasetën e Nunjezit, pa marrë parasysh çeqet, mund të ishte ngritur deri në njëzet e pesë mijë dollarë. Për rrjedhojë, arsyetonte Totenhoi, si mundej zonja Nunjez të ishte e sigurt se, jo vetëm mungonin të holla, por bile edhe ta dinte shumën e tyre me aq saktësi?

Eduina tundi kokën. Të njëjtën pyetje i kishte bërë vetes edhe ajo.

Pa rënë në sy, ajo filloi ta shikonte me vëmendje gruan e re: shtatvogël, e dobët, me ngjyrën e lëkurës të errët, jo tamam e bukur, por me një forcë tërheqëse provokuese. Origjina e saj portorikane ishte e qartë, gjë që e vërtetonte edhe theksi i saj i fortë. Deri në atë çast, ajo kishte folur pak, duke dhënë vetëm përgjigje të shkurtra, kur e kishin pyetur.

Ishte vështirë të përcaktoje me siguri se ç'njeri ishte Huanita Nunjezi. «Ajo duket një tip jo i afrueshëm, — mendoi Eduina, — së paku nga pamja e jashtme.» Me përjashtim të atij njoftimi të parë, ajo s'kishte shtuar asnjë të dhënë tjetër. Që nga çasti që ishin mbledhur, fytyra e saj kishte marrë një shprehje të zymtë dhe armiqësore. Herë pas here, vëmendja e saj shpërndahej, pikërisht sikur të ishte mërzitur dhe ta konsideronte atë mbledhje si një humbje

kohe. Mirëpo ishte edhe e shqetësuar, dhe këtë e tregonin duart që i mbante të shtrënguara dhe rrotullimi pa ndërprerje që i bënte një unaze martese të hollë prej ari.

Pasi u kishte hedhur një sy karakteristikave të saj, Eduina d'Orseji kishte mësuar se Huanita Nunjezi, 25 vjeçe, ishte e martuar, por e ndarë, me një vajzë të vogël trevjeçare. Ajo punonte në Fërst Merkentajll Ëmerikën Bank që prej gati dy vjetësh, gjithnjë si arkëtare. Ajo që nuk ishte shënuar në karakteristikat, por që Eduinës i kujtohej ta kishte dëgjuar, ishte se Nunjezi i përballonte vetë shpenzimet e mbajtjes së të bijës dhe se kishte pasur dhe, ndoshta, kishte akoma vështirësi ekonomike për shkak të disa borxheve të lëna nga i shoqi, që e kishte braktisur.

Megjithëse dyshonte që Nunjezi të mund të dinte se sa para mungonin, vazhdoi Totenhoi, ai e kishte hequr nga sporteli dhe pastaj «e kishte mbyllur me kyç», bashkë me kasetën e saj.

Të ishe «i mbyllur me kyç», përbënte në të vërtetë një mbrojtje për arkëtarin e interesuar dhe ishte procedura e zakonshme që ndiqej në raste të tilla. Kjo do të thoshte se arkëtarin e shponin, bashkë me kasetën e tij dhe një makinë llogaritëse, në një dhomë të vogël, të mbyllur dhe atje ai duhej të bënte bilancin e të gjitha operacioneve të ditës.

Totenhoi kishte pritur jashtë.

Mbas pak, ajo e kishte thirrur dhe i kishte thënë se arka nuk kuadronte. Mungonin pikërisht gjashtë mijë dollarë.

Totenhoi kishte thirrur atëherë Majlls Istinin, dhe të dy kishin bërë një verifikim të dytë, në prani të Huanita Nunjezit. Ata kishin arritur në përfundimin se njoftimi i saj kishte qenë i saktë. S'kishte dyshim se në arkë mungonin të holla dhe shuma që mungonte ishte pikërisht ajo që kishte thënë Nunjezi që në fillim.

Atëherë Totenhoi i kishte telefonuar Eduinës.

— Kjo na kthen përsëri aty nga u nisëm, — tha Eduina. — A ka ndokush ndonjë mendim tjetër?

E mori fjalën Majlls Istini:

— Në rast se nuk i vjen keq Huanitës, do të doja t'i bëja edhe disa pyetje të tjera.

Eduina i dha lejë me një lëvizje të kokës.

— Përpiqu të kujtohesh mirë, Huanita, — tha Istini, — mos ke bërë gjatë ditës së sotme HD me arkëtarët e tjerë?

Sikurse të gjithë ata e dinin, HD do të thoshte hua me para në dorë ndërmjet arkëtarëve. Ndodhte shpesh që, gjatë punës, një arkëtari t'i mbaroheshin banknotat ose monedhat metalike të një lloji të caktuar dhe, kur një gjë e tillë ndodhte në mes të valës së punës, në vend që të shkonin gjer te thesari për të tërhequr të tilla, arkëtarët e ndihmonin njëri-tjetrin duke «blerë» ose «shitur» para. Për t'i shënuar këto HD, përdorej një formular i veçantë. Mirëpo nganjëherë nxitimi ose pakujdesia bëheshin gabime, kështu që në fund të ditës së punës një arkëtar mund të kishte njëfarë shume mangut dhe, një tjetër, të njëjtën shumë tepër. Megjithatë kishte pak të ngjarë që kjo shumë të ngrihej deri në gjashtë mijë dollarë.

— Jo, — u përgjigj ajo, — asnjë. Sot, jo.

— Mos i është afruar rastësisht arkës sate ndokush nga personeli, — nguli këmbë Majlls Istini, — i cili të ketë pasur mundësi të marrë para?

— Jo.

— Kur erdhe tek unë herën e parë, — vazhdoi Istini, — për të më thënë se mungonte një shumë të hollash, sa kohë më parë e kishe vënë re këtë?

— Para disa minutave.

Eduina ndërhyri:

— Sa kohë mbas pushimit të drekës, zonja Nunjez?

Gruaja e re ngurroi dhe u duk më pak e sigurt me vetveten.

— Nja njëzet minuta.

— Le të flasim për kohën para se të shkonit për të ngrënë drekën, zonja Nunjez, — vazhdoi Eduina. — A besoni që paratë të mungonin që në atë kohë?

Gruaja e re lëvizi kokën në shenjë mohimi.

— Si mund të jeni e sigurt?

— E di.

Përgjigjet e prera dhe njërrokshe të gruas së re po fillonin ta nervozonin Eduinën. Veç kësaj, qëndrimi i saj armiqësor, pa asnjë shenjë dëshire bashkëpunimi, që e kishte vënë re më parë, dukej tani edhe më i theksuar.

Totenhoi përsëriti pyetjen kritike:

— Si munde, mbas drekës, të dije jo vetëm se mungonin të holla, por dhe saktësisht edhe shumën e tyre?

Fytyra e vogël e gruas së re mori një pamje sfide.

— E dija.

Heshtja mbretëroi për pak çaste, një heshtje plot mosbesim.

— A mendon se gjatë ditës mund t'i kesh dhënë gabimisht ndonjë klienti gjashtë mijë dollarë tepër?

— Jo.

— Kur u largove nga sporteli, para se të shkoje për të ngrënë drekë, — tha Majlls Istini, — shpure kasetën tënde

poshtë te thesari, mbylle bravën me kombinacion dhe e le atje. Kështu, apo jo?

— Ashtu.

— A je e sigurt se e mbylle?

Gruaja e re lëvizi kokën në shenjë pohimi.
— A ishte e mbyllur brava me kombinacion e shefit të zyrës?
— Jo, ishte e hapur.

Edhe kjo ishte normale. Brava me kombinacion e shefit të zyrës, mbasi vihej çdo mëngjes në pikën «hapur», qëndronte zakonisht ashtu gjatë tërë ditës.

— Dhe, kur u ktheve nga dreka, kaseta jote ishte akoma në bodrum dhe akoma e mbyllur?
— Po.
— A e di njeri tjetër kombinacionin tënd? Ia ke thënë rastësisht ndokujt?
— Jo.

Pyetjet pushuan për një çast. Eduina mendoi se personat e tjerë ishin ndoshta duke rikaluar në mendjen e tyre procedurat e ndryshme që ndiqeshin te thesari.

Kaseta për të cilën kishte folur Majlls Istini ishte në të vërtetë një kasafortë portative, e vendosur mbi një mbështetëse me rrota dhe mjaft e lehtë për t'u zhvendosur pa vështirësi. Disa banka e quanin karrel arke. Çdo arkëtar ishte pajisur me një të tillë dhe çdo karreli i ishte vënë një numër në vend të dukshëm dhe, zakonisht, përdorej nga i njëjti person. Kishte dhe disa karrela rezervë, që përdorshin në rast nevoje. Njërin prej tyre kishte përdorur atë ditë Majlls Istini.

Sa herë që hynin ose dilnin nga bodrumi, të gjithë karrelët kontrolloheshin nga një kryearkëtar i thesarit, që regjistronte hyrjen dhe daljen e tyre. Pa verifikimin e kryearkëtarit të thesarit, ishte e pamundur të fusje ose të nxirrje një karrel, ose të merrje atë të një tjetri, gabimisht ose me dashje. Gjatë natës

dhe pushimeve të fundit të javës, porta masive e bodrumeve ishte e vulosur dhe e mbyllur më mirë se sa varri i një faraoni.

Çdo karrel kishte dy brava me kombinacion, që s'mund të hapeshin në asnjë mënyrë po të mos njihej kombinacioni. Njëra prej tyre manipulohej nga arkëtari, tjetra nga shefi i zyrës ose zëvendësi i tij. Prandaj, çdo mëngjes, hapja e karrelit bëhej në prani të dy personave. Arkëtarët ishin urdhëruar të mësonin përmendsh kombinacionin e vet dhe të mos ia tregonin atë askujt, ndonëse kombinacioni mund të ndryshohej kurdo që një arkëtar do ta kërkonte një gjë të tillë. I vetmi regjistrim me shkrim i çdo kombinacioni mbahej në një zarf të dyllosur, me dy firma, që ruhej, së bashku me të tjerët, në një kasetë sigurimi. Dylli i zarfit hapej vetëm në rast se arkëtari vdiste, sëmurej, ose pushohej nga puna.
Këto masa bënin që vetëm përdoruesi i autorizuar i karrelit ta dinte kombinacionin dhe, në këtë mënyrë, qoftë arkëtarët, qoftë banka ishin të mbrojtur kundër vjedhjes.

Një tjetër karakteristikë e këtyre karrelave të sofistikuar ishte një sistem alarmi i vendosur brenda tij. Kur një karrel vihej në vendin e tij, pranë arkëtarit, një kontakt e lidhte me një instalim elektrik të posaçëm. Brenda karrelit ishte fshehur një mekanizëm alarmi, nën një grumbull bankënotash, të quajtura «para-karrem».

Arkëtarët ishin udhëzuar të mos e përdornin asnjëherë paranë-karrem për veprimet normale, por, në raste vjedhjeje, të dorëzonin së pari këto para. Vetë heqja e tyre nga vendi, vinte në veprim një çelës, që, nga ana e tij, i jepte alarmin Shërbimit të Sigurimit të bankës dhe policisë, të cilët ndërhynin brenda pak minutave. I njëjti çelës vinte gjithashtu në veprim kamerat e fshehura në faqen e sipërme të mureve. Numrat e serive të parave-karrem ishin regjistruar, që të mund të përdoreshin, më vonë, si material prove.

Eduina pyeti Totenhonë:

— Ishin paratë-karrem midis të gjashtë mijë dollarëve?

— Jo, — u përgjigj ai. — Paratë-karrem ishin të paprekura. E verifikova këtë.

Ajo tha me vete: «Asnjë shpresë për të zbuluar diçka në këtë drejtim.»

Majlls Istini iu drejtua edhe një herë arkëtares:

— Huanita, a të shkon mendja në ndonjë mënyrë, me anën e së cilës ndokush të ketë pasur mundësi të marrë paratë nga karreli yt?

— Jo, — u përgjigj Huanita Nunjezi.

Duke e vërejtur me shumë vëmendje ndërsa përgjigjej, Eduina pati përshtypjen se po dallonte tek ajo një ndjenjë frike. Po qe se kjo ishte e vërtetë, kishte arsye të forta për të qenë e trembur, sepse s'ka bankë që të mbyllë sytë aq lehtë, kur është fjala për një shumë kaq të madhe.

Eduina s'kishte më dyshim për paratë që mungonin: ato i kishte vjedhur Nunjezi. S'kishte shpjegim tjetër. Tani, vështirësia qëndronte në të zbuluarit se si ishte kryer kjo.

Një mundësi ishte që Huanita Nunjezi t'ia kishte dhënë paratë nga sporteli një bashkëpunëtori. Një gjë e tillë s'do të ishte vënë re nga askush. Gjatë një dite pune intensive, kjo do të ishte dukur si një tërheqje e zakonshme. Nga ana tjetër, kishte mundësi që ajo t'i kishte fshehur paratë dhe t'i kishte nxjerrë jashtë bankës gjatë pushimit të drekës, megjithëse, në një rast të tillë, rreziku do të kishte qenë më i madh.

Një gjë duhet ta kishte të qartë zonja Nunjez: ajo do ta humbiste vendin e saj të punës, pavarësisht nëse vërtetohej se i kishte vjedhur paratë apo jo. Ishte e vërtetë se mbylleshin sytë për gjëra të vogla në arkë, që konsideroheshin si gabime

normale dhe të parashikuara. Mesatarja vjetore e tillë për çdo arkëtar ishte prej tetë dollarësh «plus» ose «minus». Zakonisht nuk ndodhte asgjë, me kusht që çdo gabim të mos kalonte një shumë prej njëzet e pesë dollarësh. Por askush me një humbje arke më të madhe nuk mbahej më në punë dhe arkëtarët e dinin mirë këtë.

Natyrisht, Huanita Nunjezi duhej ta kishte pasur parasysh këtë fakt dhe të kishte menduar se gjashtë mijë dollarë në dorë ia vlenin humbjen e vendit të punës, edhe në rast se do të kishte vështirësi për të gjetur një vend tjetër. Sidoqoftë, Eduinës i vinte keq për të. Me sa dukej, ajo duhej të kishte qenë në një gjendje të dëshpëruar. Ndoshta, shkaku që e kishte shtyrë në një veprim si ky kishte të bënte me fëmijën e saj.

— Me kaq, nuk besoj se ka gjë tjetër që mund të bëjmë, — tha Eduina. — Duhet të njoftoj drejtorinë. Vazhdimi i hetimeve do të bëhet nën drejtimin e saj.

Ndërsa po ngriheshin të tre në këmbë, ajo shtoi:

— Zonja Nunjez, rrini dhe pak, ju lutem.

Gruaja e re u ul përsëri në vendin e saj.

Kur të tjerët qenë larguar mjaft dhe nuk mund të dëgjonin ç'thuhej, Eduina tha me një ton, të cilit me dashje i kishte dhënë një tingull të paanshëm:

— Huanita, mendova se ky mund të ishte për ne çasti për një bisedë të sinqertë me njëra-tjetrën, ndoshta si mikesha.

Eduina e kishte frenuar padurimin e saj të mëparshëm. Sytë e zinj të gruas së re ishin ngulur me vëmendje mbi sytë e saj.

— Jam e sigurt se i keni menduar mirë dy gjëra. Së pari: do të bëhet një hetim i hollësishëm, në të cilin do të thirret edhe FBI-ja, sepse banka jonë është e lidhur me Rezervën Federale.

Së dyti, një gjë është e pashmangshme: dyshimet do të bien mbi ju.

Mbas një pauze, Eduina vazhdoi:

— Dua të jem e sinqertë me ju, kuptoni?

— Kuptoj, por unë s'kam marrë para.
Eduina vuri re se gruaja e re vazhdonte ta rrotullonte unazën e saj të martesës me nervozizëm.

Tani, Eduina i zgjodhi fjalët me kujdes, e ndërgjegjshme se duhej të ishte e vëmendshme për t'iu shmangur një padie të drejtpërdrejtë, që, në të ardhmen, mund të shndërrohej në një ngatërresë ligjore në dëm të bankës.

— Sado që të vazhdojnë hetimet, Huanita, është pothuajse e sigurt se e vërteta do të dalë në shesh, qoftë edhe për vetë faktin se zakonisht kështu ndodh. Hetuesit janë njerëz që i shqyrtojnë çështjet me imtësi. Ata kanë gjithashtu përvojë dhe janë shumë këmbëngulës.

E reja përsëriti me ton të fortë:

— Nuk i kam marrë unë paratë.

— Nuk thashë se i keni marrë ju, por ajo që dua të them është që, në qoftë se dini diçka më shumë nga ato që keni thënë, tani është koha për të folur, për të ma thënë mua sa kohë që jemi duke biseduar këtu qetësisht. Pastaj, s'do të kemi më rast tjetër. Do të jetë tepër vonë.

U duk sikur Huanita Nunjezi qe gati të fliste sërish. Eduina ngriti njërën dorë.

— Jo, më dëgjoni gjer në fund. Po ju bëj një premtim. Në rast se paratë i kthehen bankës, le të themi, jo më vonë se nesër, nuk do të ketë asnjë veprim ligjor, asnjë ndjekje gjyqësore. Për të qenë e sinqertë, duhet ta bëj të qartë se personi që ka marrë paratë nuk do të ketë mundësi të punojë

më këtu. Por asgjë tjetër nuk do të ndodhë. Për këtë garantoj unë. Huanita, keni gjë për të më thënë?

— Jo, jo, jo! Betohem për kokën e sime bije! — Sytë e saj lëshonin shkëndija dhe fytyra i kishte marrë flakë nga zemërimi. — Po ju them se nuk kam marrë para, as tani dhe as kurrë ndonjëherë.

Eduina psherëtiu.

— Mirë. Kaq për tani. Por, ju lutem të mos largoheni nga banka, pa më njoftuar.

U duk sikur Huanita Nunjezi qe gati për të shpërthyer në një protestë tjetër, por, me një ngritje të lehtë të supeve, ajo u kthye dhe u largua.

Nga tryeza e saj e punës mbi platformë, Eduina ngriti kokën dhe hodhi një sy përreth. Kjo ishte bota e saj e vogël, për të cilën ajo përgjigjej. Personi i degës kryesore të bankës po bënte bilancin dhe po regjistronte operacionet e ditës. Megjithatë, një verifikim paraprak kishte treguar se asnjë arkëtar — në kundërshtim me ç'ishte shpresuar në fillim — nuk kishte në arkë një tepricë prej gjashtë mijë dollarësh.

Zhurmat dobësoheshin në ndërtesën moderne: dëgjoheshin, sikur vinin nga larg, një pështëritje zërash, një fështëritje letrash, tingëllima monedhash metalike, trokitja e një makine llogaritëse. Eduina mendoi se ajo do ta kujtonte atë javë për një kohë të gjatë, për dy arsye. Pastaj, duke e ditur se çfarë duhej të bënte, ajo ngriti receptorin e njërit prej telefonave që ishin në tryezën e saj të punës dhe formoi një numër të brendshëm.

— Seksioni i sigurimit, — u përgjigj një zë gruaje.
— Zotin Uejnrajt, ju lutem, — tha Eduina.

Kjo ishte dita e dytë që Nolan Uejnrajti e kishte të vështirë të përqendrohej në punë.

Drejtorin e shërbimit të sigurimit e kishte prekur thellë lajmi i dhënë në mbledhjen e së martës në mëngjes, sepse që prej më se dhjetë vjetëve, ai dhe Ben Roseli ushqenin për njëri-tjetrin ndjenja miqësore dhe respekti reciprok.

Por këto marrëdhënie s'kishin qenë gjithmonë të tilla.

Një ditë më parë, mbasi u kthye nga salla e këshillit në zyrën e tij, që ishte më e thjeshtë dhe shihte mbi një baxhë, Uejnrajti i kishte thënë sekretares të mos e shqetësonin për pak kohë. Dhe, pastaj, ishte ulur në tryezën e punës, i trishtuar, i zymtë, duke sjellë ndërmend ndeshjen e tij të parë me vullnetin e Ben Roselit.

Kjo kishte ndodhur para dhjetë vjetëve. Nolan Uejnrajti sapo ishte emëruar shef i policisë së një qyteti të vogël, në veri të shtetit. Më parë, kishte qenë toger i repartit hetimor të policisë, në një qytet të madh, dhe karakteristikat e tij të shërbimit ishin shumë të mira. Ai i kishte cilësitë dhe të dhënat e nevojshme për të komanduar dhe, po të merret parasysh atmosfera që ekzistonte në atë periudhë, kishte të ngjarë që në emërimin e tij të kishte ndihmuar fakti se ishte zezak.

Pak kohë mbas gradimit të Uejnrajtit, Ben Roselin e kishte ndaluar policia, ndërsa po përshkonte me veturën e tij periferinë e atij qyteti të vogël. Shpejtësia, e regjistruar në aparatin përkatës, kishte qenë 80 milje në orë. Një polic i kishte dorëzuar një urdhër për t'u paraqitur për masat disiplinore, për shkelje të kodit rrugor.

Ndoshta sepse ishte i matur dhe i kujdesshëm në fusha të tjera, Ben Roselit i pëlqenin makinat e shpejta dhe i ngiste ashtu siç e kishin menduar vetë projektuesit e tyre — duke e shtypur gjer në fund pedalin e gazit.

Një urdhër paraqitjeje për shkelje të kufirit të lejuar të shpejtësisë ishte një gjë e zakonshme për të. Me t'u kthyer në

drejtorinë e FMA-së, ai ngarkoi zyrën e sigurimit të bankës që ta rregullonte këtë çështje. Për afaristin më të fuqishëm të të gjithë shtetit, shumë gjëra mund të rregulloheshin, siç ishin rregulluar edhe shumë herë të tjera.

Të nesërmen, urdhri i paraqitjes i ishte nisur me postë drejtorit të degës së FMA-së, në qytetin e vogël ku ishte lëshuar, që ishte rastësisht edhe këshilltar bashkiak dhe kishte ndikuar shumë në emërimin e Nolan Uejnrajtit si shef i policisë.

Drejtori këshilltar kishte shkuar në komisariatin e policisë për ta rregulluar këtë çështje. Ishte treguar shumë i sjellshëm dhe në fytyrë nuk i ndahej buzëqeshja, por Nolan Uejnrajti qe treguar i patundur.

Mbasi s'ia kishte dalë në krye me buzëqeshje, këshilltari i kishte vënë Uejnrajtit në dukje se, si i ri në postin e tij, ai kishte nevojë për miq dhe se mospranimi për të bashkëpunuar nuk ishte, sigurisht, rruga më e mirë për t'i gjetur ata. Mirëpo, Uejnrajti kishte ngulmuar në qëndrimin e vet.

Atëherë këshilltari, duke e hequr këtë petk dhe duke veshur atë të drejtorit të degës së bankës, i kishte përmendur shefit të policisë kërkesën që ai i kishte drejtuar FMA-së për t'i dhënë një hua hipotekore që do ta lejonte të hapte shtëpi në atë qytet dhe të sillte të shoqen dhe familjen. Ashtu si rastësisht, drejtori i degës së bankës kishte përmendur se zoti Roseli ishte president i FMA-së.

Nolan Uejnrajti ishte përgjigjur se nuk shihte as lidhjen më të vogël midis një urdhri paraqitjeje për shkelje shpejtësie dhe një kërkese huaje.

Në kohën e duhur, zotit Roseli — në vend të të cilit në gjykatë ishte paraqitur avokati i tij — i ishte vënë një gjobë dhe një kërkesë huaje. Në kohën e duhur, zotit Roseli — në vend të të cilit në gjykatë ishte paraqitur avokati i tij — i ishte vënë një gjobë e madhe dhe një shënim me vërejtje në

patentën e tij, për shkelje të madhe të kufirit të lejuar të shpejtësisë. Ai ishte tërbuar nga zemërimi.

Gjithashtu, në kohën e duhur, kërkesa për hua e Nolan Uejnrajtit ishte hedhur poshtë nga Fërst Merkëntaill Ëmerikën Benku.

S'kishte kaluar as një javë dhe Uejnrajti, duke përfituar nga fakti se presidenti i FMA-së krenohej se ishte gati të priste këdo, ishte paraqitur te zyra e Ben Roselit, në katin e 36-të të gratacielit të bankës.

Kur e pa, Ben Roseli u habit: askush s'i kishte thënë më parë se ai ishte zezak. Sidoqoftë kjo s'kishte ndonjë rëndësi për bankierin, zemërimi i të cilit s'ishte ulur aspak për shkak të shënimit poshtërues në patentë — i pari që i ishte bërë gjatë gjithë jetës së tij.

Uejnrajti e kishte paraqitur çështjen me gjakftohtësi dhe duhet thënë pa ia ngrënë hakun se Ben Roseli s'kishte ditur asgjë për kërkesën për hua të shefit të policisë ose hedhjen poshtë të saj nga banka. Veprime të këtilla kryheshin, sigurisht, nga njerëz me poste më të ulëta. Sidoqoftë, ai kishte nuhatur se në këtë rast mund të ishte bërë padrejtësi dhe kishte urdhëruar t'i sillnin në çast fashikullin e Nolan Uejnrajtit, të cilin e kishin shqyrtuar në prani të tij.

— Vetëm për kureshti, — kishte thënë më në fund Ben Roseli, mbasi kishte mbaruar së lexuari, — çfarë keni ndërmend të bëni, në rast se nuk jua japim huanë?

Përgjigjja e Uejnrajtit kishte qenë e prerë:

— Do të luftoj. Së pari, do të zë një avokat dhe do t'i drejtohem Komisionit të të Drejtave Qytetare. Edhe po qe se nuk del gjë nga kjo, do të bëj çmos për t'ju shkaktuar kokëçarje.

Ishte e qartë se fliste seriozisht dhe bankieri ia kishte pritur shkurt:

— Kërcënimet s'ecin me mua.

— S'po bëj kërcënime. Ju më bëtë një pyetje dhe unë u përgjigja.

Ben Roseli kishte ngurruar për një çast dhe, pastaj, kishte vënë firmën, duke thënë:

— Kërkesa juaj pranohet.

Para se Uejnrajti të largohej, bankieri e kishte pyetur:

— Po tani, ç'do të ndodhë po qe se më zënë përsëri në zonën tuaj për shkelje shpejtësie?

— Do të zbatojmë përsëri rregulloren. Po qe se do të vërtetohet se është fjala përsëri për ngjarje të rrezikshme, ka të ngjarë që të përfundoni brenda.

Ndërsa po vështronte policin duke dalë nga zyra, Ben Roseli kishte menduar (gjë që ia kishte thënë vite më vonë Uejnrajtit): «Dobig rrugësh! Do të vijë dita që të të shtie në dorë!»

Kjo s'ndodhi aspak në atë mënyrë që e kishte menduar ai atëherë, por në një mënyrë tjetër.

Mbas dy vjetësh, kur banka po kërkonte për shërbimin e saj të sigurimit një shef, që të ishte, simbas fjalëve të drejtorit të kuadrit, «i ashpër dhe krejtësisht i pakorruptueshëm», Bën Roseli kishte thënë: «Njoh unë një njeri të tillë».

Pak kohë më vonë, Nolan Uejnrajtit i ishte bërë një ofertë, kishte nënshkruar kontrata përkatëse dhe ai kishte shkuar të punonte te FMA-ja.

Që prej asaj kohe, Ben Roseli dhe Uejnrajti s'kishin pasur mosmarrëveshje të tjera. Drejtori i ri i shërbimit të sigurimit e kryente me aftësi detyrën e tij dhe, për ta bërë sa më mirë, ishte regjistruar edhe në një shkollë nate, ku ndiqte një kurs mbi teknikën bankare. Nga ana e tij, Roseli nuk i kishte kërkuar kurrë të shkelte kodin e tij të ngurtë moral dhe thirrjet lidhur me shkeljet e shpejtësisë i rregullonte gjithnjë dhe jo nëpërmjet shërbimit të sigurimit të bankës, duke kujtuar se Uejnrajti s'dinte gjë për to, ndërsa zakonisht, ai i merrte vesh. Ndërkaq, miqësia ndërmjet tyre kishte vazhduar të rritej dhe, mbas vdekjes së gruas së Ben Roselit, Uejnrajti dhe plaku Ben hanin shpesh darkë së bashku dhe, pas darkës, luanin shah gjer natën vonë.

Në njëfarë mënyre, kjo kishte qenë një lloj ngushëllimi edhe për Uejnrajtin, mbasi martesa e tij kishte përfunduar në ndarje, pak kohë pas kalimit të tij te FMA-ja. Përgjegjësitë e tij të reja dhe takimet me plakun Ben ndihmonin për të mbushur boshllëkun e krijuar.

Gjatë këtyre takimeve, ata bisedonin edhe për bindjet e tyre personale, duke ushtruar ndikim mbi njëri-tjetrin, nganjëherë pa e kuptuar as ata vetë. Kishte qenë pikërisht merita e Uejnrajtit — ndonëse askush tjetër s'e dinte këtë përveç atyne të dyve — që presidenti i bankës kishte vendosur të përdorte autoritetin e tij personal dhe paratë e FMA-së, në favor të zhvillimit të Rajonit Lindor, që ndodhej pikërisht në atë lagje të lënë pas dore të qytetit, ku kishte lindur Uejnrajti dhe kishte kaluar vitet e moshës së tij djaloshare. Kështu, si dhe shumë të tjera në bankë, edhe Nolan Uejnrajti kishte kujtimet dhe keqardhjen e tij lidhur me Ben Roselin.

Edhe atë të mërkurë, gjendja e tij shpirtërore vazhdonte të ishte e rëndë dhe, mbasi e kaloi mëngjesin, i trishtuar dhe i zymtë te tryeza e tij e punës, duke iu shmangur njerëzve që nuk donte t'i takonte, Uejnrajti shkoi të hante drekë, vetëm, në një restorant të vogël, në anën tjetër të qytetit, ku vinte nganjëherë, kur donte të largohej disi nga atmosfera e bankës. U kthye prej andej në kohë për të shkuar në një takim që kishte me Vandervurtin.

Vendi i takimit ishte reparti i letrave të kreditit **Kiçarrxh** të FMA-së, që ndodhej në gratacielin e Drejtorisë Qendrore.

Letrat e kreditit **Kiçarrxh** ishin vënë për herë të parë në qarkullim nga FMA-ja, e cila po vepronte tani së bashku me një grup të fuqishëm bankash të tjera në SHBA, Kanada dhe përtej Oqeanit. Si madhësi, **Kiçarrxhi** vinte menjëherë mbas **Benk Ëmerikënët** dhe **Master-Çarrxhit**. Te FMA-ja, përgjegjësinë e repartit **Kiçarrxh** e kishte Aleks Vandervurti.

Vandervurti kishte ardhur para kohe dhe, kur mbërriti Nolan Uejnrajti, ai ndodhej në Qendrën e Kreditit, duke vëzhguar operacionet në veprim e sipër. Kur u takua me të shefi i sigurimit të bankës, Aleksi i tha:

— Më pëlqen shumë të vij këtu për të parë. Është shfaqja më e mirë falas në të gjithë qytetin.

Në një dhomë të madhe që dukej si një sallë koncertesh, të ndriçuar dobët dhe me muret dhe tavanin të veshur me material që dobëson zhurmat, gjendeshin nja pesëdhjetë operatorë, kryesisht gra. Çdonjëri prej tyre kishte përpara një tastierë, përsipër së cilës ndodhej një tub katodik, i ngjashëm me kinoskopin e televizorit.

Pikërisht në këtë sallë u jepej ose u refuzohej krediti i kërkuar pronarëve të letrave të kreditit **Kiçarrxh**.

Kur një letërkrediti **Kiçarrxh** paraqitej dikuj, për të paguar mallra ose shërbime të ndryshme, kreditori mund ta pranonte atë pa ndrojtje, në qoftë se shuma për t'u paguar nuk kalonte një kufi të paracaktuar. Ky kufi ndryshonte, por zakonisht, ishte midis njëzet e pesë dhe pesëdhjetë dollarëve. Për një shumë më të madhe ishte e nevojshme të merrej autorizim, por për këtë nuk duheshin më shumë se disa sekonda. Kërkesat për autorizim i drejtoheshin me shumicë të madhe qendrës së kreditit gjatë njëzet e katër orëve të ditës dhe shtatë ditëve të javës. Ato vinin nga çdo shtet i SHBA-së e Kanadaja, ndërsa një varg teleksesh merrte kërkesat e nja tridhjetë vendeve të huaja, duke përfshirë edhe disa nga rajoni ruso-komunist. Ashtu sikurse, dikur, krijuesit e Perandorisë Britanike himnizonin me krenari ngjyrat «kuq, bardhë, blu», kështu edhe krijuesit e perandorisë ekonomike të Kiçarxhit tregonin të njëjtin entuziazëm për ngjyrat «blu, gjelbër, ar» — ngjyrat ndërkombëtare të letrave të kreditit Kiçarxh.

Procedurat e miratimit kryheshin me shpejtësi supersonike.

Kudo që të ndodheshin, tregtari ose cilido tjetër mund t'i telefononte drejtpërdrejt numrit të posaçëm të Qendrës së Kreditit në grataçielin e Drejtorisë Qendrore të FMA-së. Thirrja telefonike i kalohej automatikisht një operatori të lirë, fjalët e para të të cilit ishin: «Numrin tuaj në Dhomën e Tregtisë, ju lutem».

Mbasi merrte përgjigje, operatori e shtypte në tastierë numrin, i cili dilte njëkohësisht në ekranin sipër. Pastaj i vinte radha numrit të letërkreditit dhe shumës së kreditit të kërkuar.

Më në fund, operatori shtypte një buton, që ia shpinte të dhënat një llogaritësi elektronik, i cili sinjalizonte në çast «PRANUAR» ose «REFUZUAR». Rasti i parë do të thoshte se klienti ishte i mirë dhe, për rrjedhojë, krediti autorizohej; i dyti, se pronari i letërkreditit kishte pagesa të prapambetura

dhe, prandaj, i ishte prerë krediti. Meqenëse normat që rregullonin dhënien e kreditit nuk ishin aq të rrepta, mbasi bankat kanë interes të huajnë para, pranimet ishin në numër shumë më të madh se refuzimet. Pastaj, operatori e njoftonte tregtarin dhe, ndërkaq, kompjuteri bënte regjistrimin përkatës të këtij veprimi. Në një ditë të zakonshme, Qendrës i bëheshin pesëmbëdhjetë mijë thirrje të tilla.

Aleks Vandervurti dhe Nolan Uejnrajti kishin vënë kufje që të mund të ndiqnin bisedat ndërmjet tregtarëve dhe operatorëve.

Shefi i shërbimit të sigurimit preku krahun e Aleksit dhe i bëri me shenjë drejt një ekrani. Pastaj, ai ndërroi vendet e spinave të të dyja kufjeve në prizat përkatëse. Në ekranin e treguar nga Uejnrajti kishte dalë një mesazh i kompjuterit, me shkronja të ndritshme: «Letërkrediti i vjedhur».

Operatori, me qetësinë e tij profesionale, u përgjigj: — Letërkrediti që ju kanë paraqitur, na rezulton të jetë i vjedhur. Po patët mundësi, e mbani aty personin që e ka sjellë dhe thërrisni policinë. Na e dërgoni letërkreditin. Kiçarxhi do t'ju paguajë një shpërblim prej tridhjetë dollarësh, po ta bëni këtë.

Vandervurti dhe Uejnrajti mundën të dëgjonin një pëshpëritje bisede dhe, pastaj, një zë që njoftonte:

— Maskarai, sapo ia mbathi nga dyqani, por munda t'ia shkëpus letërkreditin. Po jua dërgoj me postë.

Tregtari dukej të ishte i kënaqur nga mendimi i tridhjetë dollarëve. Nga ana tjetër, edhe Kiçarxhi kishte përfituar, sepse një letërkrediti e vjedhur, që mbetej në qarkullim, mund të përdorej në mënyrë të paligjshme për blerje artikujsh të ndryshëm me një vlerë shumë më të madhe se ajo shumë.

Uejnrajti e hoqi kufjen dhe po ashtu bëri edhe Vandervurti.

— Puna ecën mirë, — tha Uejnrajti, — kur na njoftojnë dhe mund ta programojmë kompjuterin në përputhje me të

dhënat. Për fat të keq, shumica e këtyre veprimeve të paligjshme bëhen para se të na jetë njoftuar humbja ose vjedhja e një letërkrediti.

— Por, prapëseprapë, ne e kemi një paralajmërim kur blerjet bëhen në një numër tepër të madh.

— E drejtë. Po të bëhen dhjetë blerje në ditë, kompjuteri na jep alarmin.

Të dy ata e dinin se shumë pak pronarë letrash krediti bënin më shumë se gjashtë ose shtatë blerje brenda një dite, prandaj një letër e tillë krediti mund të klasifikohej si «KA SHUMË TË NGJARË TË JETË E PALIGJSHME», edhe në rast se pronari i saj i vërtetë nuk ishte akoma në dijeni që s'e kishte më.

Megjithëse ishin marrë këto masa, një letërkrediti Kiçarxh, e humbur ose e vjedhur, po të përdorej me dinakëri, shërbente akoma për blerje të paligjshme që mund të kapnin një shumë prej njëzet mijë dollarësh, gjatë një jave, ose gjatë gati shtatë ditëve që kalonin ndërmjet vjedhjes ose humbjes dhe njoftimit që i bëhej bankës. Vjedhësit e letërkrediteve parapëlqenin biletat e avionëve për udhëtime të gjata dhe arkat me shishe likeri. Qoftë biletat, qoftë edhe arkat me shishe likeri, mund të shiteshin me çmime të rastit. Një metodë tjetër ishte marrja e një veture me qira — sidomos e një veture luksi, të shtrenjtë — duke përdorur një letërkrediti të vjedhur ose të falsifikuar. Vetura çohej në një qytet tjetër, ku ajo pajisej me targë dhe lejeqarkullimi të falsifikuara dhe, pastaj shitej ose eksportohej. Agjencia, që e kishte dhënë me qira, nuk i shihte më kurrë as veturën e saj dhe as klientin. Një tjetër marifet ishte blerja e stolive të çmuara në Evropë me anë të një letërkrediti — të vjedhur ose të falsifikuar — të mbështetur me një pasaportë, gjithashtu të falsifikuar — dhe, pastaj, këto stoli të çmuara futeshin kontrabandë në Shtetet e

Bashkuara, për t'u shitur përsëri. Në të gjitha këto raste, të gjitha dëmet binin mbi bankën që administronte letërkreditet.

Si Vandervurti, ashtu edhe Uejnrajti, e dinin se vjedhësit përdornin metoda të ndryshme për të mësuar nëse një letërkrediti e caktuar, që dispononin, mund të përdorej akoma, apo ishte «djegur». Një nga metodat më të zakonshme ishte t'i jepnin njëzet e pesë dollarë një kryekamerieri që të shihte listën rezervate që banka u shpinto çdo javë tregtarëve dhe restoranteve, e cila përmbante të dhënat e letërkrediteve, jo të rregullta. Në rast se letërkrediti në fjalë nuk figuronte ende në atë listë, ajo mund të përdorej akoma për një varg tjetër blerjesh.

— Po humbasim shumë para këto kohët e fundit, — tha Nolan Uejnrajti. — Shumë më tepër se zakonisht. Kjo është një nga gjërat për të cilat doja të bisedoja.

Ata u drejtuan në një zyrë të veçantë, që Uejnrajti e kishte rezervuar për ta përdorur atë pasdite. Drejtori i shërbimit të sigurimit të bankës e mbylli derën. Të dy burrat kishin pamje mjaft të ndryshme. Vandervurti, biond, pak a shumë i ngjallur, i flashkët; Uejnrajti, me flokë dhe lëkurë të zezë, i gjatë, i zhdërvjellët, me trup të fortë e muskuloz. Të ndryshme ishin edhe karakteret e tyre, gjë që nuk pengonte të kishin marrëdhënie të mira.

— Le të luajmë një lojë pa para, — i tha Nolan Uejnrajti nënpresidentit ekzekutiv të FMA-së, duke hedhur njërën pas tjetrës mbi tryezën e punës, ashtu siç bën një lojtar pokeri kur ndan letrat, tetë letërkredite Kiçarxh prej plastike. — Katër nga këto letërkredite janë të falsifikuara, — tha ai. — A mund t'i veçosh të mirat nga të këqijat?

— Sigurisht. Kjo është e lehtë. Në ato që janë të falsifikuara, emri i titullarit del me shkronja të ndryshme dhe ...

Vandervurti u ndal dhe filloi ta shikonte me vëmendje më të madhe grupin e letërkrediteve.

— Për perëndi! Te këto këtu, jo. Shkronjat kanë pamje të njëjtë te të gjitha.

— Pothuajse të njëjtë. Po të dish kë kërkosh, me ndihmën e një lente, mund të gjesh ndryshime të vogla. Uejnrajti nxori një lente, i ndau letërkreditet në dy grupe, dhe i tregoi Vandervurtit ndryshimet në shkronjat e emrit të shtypura në relief te letërkreditet e vërteta, që nuk ishin identike me shkronjat e përdorura në ato të falsifikuarat.

Vandervurti tha:
— Tani i shoh ndryshimet, por, pa lente, nuk do t'i kisha dalluar kurrë. Po në rrezet ultravjollcet, si duken letërkreditet e falsifikuara?
— Krejtësisht të njëjta si të mirat.
— Sa keq!
— Shumë muaj më parë, duke ndjekur shembullin e Emerikën Ekspresit, një shenjë e padukshme ishte shtypur në faqen e prapme të çdo letërkrediti Kiçarxh. Ajo bëhej e dukshme vetëm kur ndriçohej nga rrezet ultravjollcet. Qëllimi ishte që të sigurohej një sistem i thjeshtë dhe i shpejtë për të verifikuar vërtetësinë e saj. Por, tani, edhe kësaj metode ia kishin gjetur ilaçin.
— Sigurisht, shumë keq, — u tregua në një mendjeje Uejnrajti. — Dhe këto janë vetëm katër copë. Kam edhe nja pesëdhjetë të tjera, të cilat mundëm t'i shtinim në dorë mbasi qenë përdorur me sukses në dyqane për shitje me pakicë, restorante, për të blerë bileta avionesh, likere, mallra të ndryshme. Dhe të gjitha janë falsifikimet më të mira që janë bërë gjer më sot.
— Është bërë ndonjë arrestim?
— Jo, deri tani, asnjë. Sapo dëgjojnë se po telefonohet lidhur me letërkreditin, vjedhësit ia mbathin nga dyqani, nga agjencia ajrore, ose nga cilido vend tjetër, ashtu siç ndodhi para disa

minutave. Veç kësaj, edhe po qe se arrestojmë disa prej tyre, kjo nuk do të thotë se i jemi afruar burimit të letërkrediteve të falsifikuara; ato shiten dhe rishiten shumë herë për të mbuluar gjurmët.

Aleks Vandervurti mori njërën nga letërkreditet e falsifikuara, në ngjyrë blu, të gjelbër dhe ari, dhe filloi ta kthejë dhe ta vështrojë nga çdo anë.
— Edhe veshja plastike duhet të jetë krejtësisht e njëjtë.
— Është bërë nga të njëjtat fletë, me po atë material që përdor banka. Këtë material e kanë vjedhur dhe, prandaj, s'ka se si të mos jenë të mira.

Shefi i sigurimit të bankës vazhdoi:
— Ndërkaq, ndoshta kemi zbuluar një gjurmë të burimit të letërkrediteve të falsifikuara. Para katër muajsh, njërin nga furnitorët tanë e vodhën. Vjedhësit u futën në magazinen

e siguruar, ku mbahen fletët plastike dhe morën treqind prej tyre.

Vandervurti lëshoi një fishkëllimë të lehtë. Vetëm me një fletë mund të visheshin gjashtëdhjetë e gjashtë letërkredite Kiçarxh. Pra, kjo ishte potencialisht baraz me gati njëzet mijë letërkredite të falsifikuara.

— I kam bërë edhe unë llogaritë, — tha Uejnrajti. Ai bëri me shenjë nga letërkreditet e falsifikuara në tryezë. — Ato që kemi zbuluar gjer tani janë vetëm maja e ajsbergut dhe mund të përfaqësojnë, në përgjithësi, një humbje prej dhjetë milionë dollarësh në derdhje, para se të jenë hequr të gjitha nga qarkullimi. Po të tjerat? Ato për të cilat s'kemi ende dijeni dhe që mund të jenë dhjetë herë më shumë?

— E kam të qartë.

Aleks Vandervurti filloi të ecë poshtë e lart në zyrën e vogël, i thelluar në mendime.

Që në fillim, kur dolën për herë të parë letërkreditet, bankat që i nxirrnin kishin pësuar humbje të mëdha, për shkak të vjedhjeve e mashtrimeve. Në fillim vidheshin pako të tëra me letërkredite, të cilat përdoreshin për të bërë qejf në kurriz të bankave që i kishin nxjerrë. Pastaj kishin filluar të rrëmbenin disa ngarkesa postare, për të cilat kërkonin shpërblim. Bankat e paguanin, duke e ditur se dëmi do të kishte qenë shumë më i madh në qoftë se letërkreditet do të shpërndaheshin në rrethet e keqbërësve e të gangsterëve dhe do të përdoreshin prej tyre. Si veçori ironike, mund të përmendet fakti se, në 1974, shoqëria ajrore Pan Emerikën Eruujs u kritikua ashpër nga shtypi dhe publiku, kur pranoi se i kishte paguar vjedhësit për të siguruar kthimin e sasive të mëdha të biletave të pambushura, që kishin qenë vjedhur. Qëllimi i shoqërisë ajrore ishte që të shmangte humbjet shumë më të mëdha që do të shkaktoheshin nga përdorimi i paligjshëm i biletave. Mirëpo, ata që e kishin kritikuar shoqërinë ajrore nuk e dinin se disa nga bankat më të mëdha të kombit vazhdonin të bënin, vite me radhë, të njëjtën gjë.

Pak nga pak, këto lloj vjedhjesh të letërkrediteve u pakësuan, por vjedhësit kishin kaluar tanimë në projekte dhe mënyra veprimi më të stërholluara. Një prej tyre ishte falsifikimi. Letërkreditet e para të falsifikuara ishin punuar në një mënyrë pak a shumë trashamane dhe mund të kuptoheshin me lehtësi, por cilësia e tyre ishte përmirësuar deri në atë pikë saqë — siç e kishte pohuar Uejnrajti — duhej një ekspert për të dalluar ndryshimin midis atyre që ishin të vërteta dhe atyre të falsifikuara.

Me marrjen e masave të sigurimit për të mbrojtur letërkreditet, vjedhësit u shmangeshin atyre ose sulmonin në një pikë tjetër të dobët. Kështu, për shembull, në një letërkrediti të një tipi të ri, e vënë në qarkullim kohët e fundit, fotografia e pronarit ishte ndryshuar simbas një kodi të caktuar. Për sytë e zakonshëm, fotografia nuk ishte veçse një

grumbull njollash, nga të cilat s'dallohej asgjë, por, e futur në një aparat të posaçëm, fotografia bëhej e qartë dhe pronari i letërkreditit mund të identifikohej. Ky sistem dukej të ishte, tani për tani, i frutshëm, por Aleksi s'kishte as dyshimin më të vogël se organizata kriminale do të gjente shumë shpejt mënyrën për ta kopjuar atë.

Herë pas here kryheshin arrestime personash, të cilëve u gjendeshin letërkredite të vjedhura ose të falsifikuara, por këta përfaqësonin vetëm një pjesë shumë të vogël të gjithë kësaj tregtie të paligjshme. Për sa u përket bankave, problemi kryesor ishte numri i pamjaftueshëm i policëve dhe i detektivëve. Me të vërtetë, ata nuk mjaftonin.

Aleksi i ndali ecejaket e tij në zyrë.

— A ka mundësi, — pyeti ai, — që këto falsifikime të fundit të jenë kryer nga ndonjë organizatë?

— Jo vetëm që ka mundësi, por kjo është e sigurt. Duhet të jetë patjetër një organizatë, meqë produkti i fundit i nxjerrë është me cilësi aq të lartë. Dhe e gjithë kjo punë kërkon para, makina, teknikë, një sistem shpërndarjeje. Nga ana tjetër, ka shenja të tjera që të çojnë po aty.

— Për shembull?

— Sikurse e dini, — vazhdoi Uejnrajti, — unë i kam mbajtur lidhjet që kam pasur në të kaluarën me agjencitë e zbulimit. Kohët e fundit, në të gjithë Perëndimin e Mesëm është vërtetuar një rritje e madhe e falsifikimeve të valutës, të çeqeve për udhëtarë, letërkrediteteve — si tonat, ashtu edhe të bankave të tjera. Është shtuar gjithashtu shumë veprimtaria lidhur me tituj pronësie dhe çeqe të vjedhura dhe të falsifikuara.

— Dhe mendon të ketë një lidhje midis këtyre gjërave dhe humbjeve tona me letërkreditet Kiçarxh?

— Le të themi se ka mundësi.
— Ç'bën shërbimi i sigurimit?
— Po bëjmë ç'mundemi. Sa herë që zbulojmë një letërkrediti Kiçarxh, që përdoret në mënyrë të paligjshme, e sinjalizojmë dhe përpiqemi të ndjekim gjurmët e saj drejt burimit. Numri i letërkrediteve që janë shtënë prapë në dorë dhe i ndjekjeve gjyqësore për fitime të paligjshme është rritur sivjet nga njëri muaj në tjetrin. I keni të gjitha shifrat në raportet e mia. Mirëpo, një çështje si kjo kërkon hetime në shkallë të gjerë dhe unë s'kam as personelin dhe as fondet e nevojshme për një gjë të tillë.

Aleks Vandervurti buzëqeshi trishtueshëm.
— E parashikoja se do të arrinim te çështja e fondeve.

Nuk e kishte të vështirë ta merrte me mend se ç'do të thoshte Nolan Uejnrajti. I njihte mirë problemet që e mundonin atë.

Uejnrajti, si drejtor i shërbimit të sigurimit të FMA-së, ishte ngarkuar që të mbronte bankën nga çdo lloj krimi, si aty, në grataçielin e Drejtorisë Qendrore, ashtu edhe në çdo degë të saj. Vitet e fundit, këshilli administrativ e kishte vlerësuar gjithnjë e më shumë rëndësinë e shërbimit të sigurimit dhe ia kishte shtuar fondet, ndonëse ato ishin akoma të pamjaftueshme. Kjo dihej nga të gjithë në Drejtorinë Qendrore, por, duke qenë se ky shërbim nuk siguronte të ardhura, vendi i tij në listën e përparësisë për dhënien e fondeve suplementare ishte shumë poshtë.

— Nolan, mendoj se do të kesh përgatitur shifra dhe propozime, siç e ke zakon të bësh gjithmonë.

Uejnrajti nxori një fletë, që e kishte me vete.
— Këtu janë të gjitha. Nevoja më e ngutshme është për dy detektivë me kohë pune të plotë për seksionin e letërkrediteve. Veç kësaj, kërkoj fonde për marrjen në punë të

një informatori të fshehtë, i cili do të ketë për detyrë të gjejë burimin e këtyre letërkrediteve të falsifikuara, si edhe të zbulojë, brenda bankës, pikën nga ku dekonspirohet dhe përhapen lajme.

Vandervurti u duk i habitur.
— Mendon se mund të gjesh njeri?

Kësaj radhe qe Uejnrajti ai që buzëqeshi.
— Sigurisht që nuk është rasti për të botuar një lajmërim në rubrikën «Oferta bashkëpunimi» të gazetave, por jam i gatshëm t'ia hyj kësaj pune.

— Në rregull. Do t'i shqyrtoj me vëmendje propozimet e tua dhe do të bëj çmos për t'i përkrahur. A mund t'i mbaj këto letërkredite?

Drejtori i shërbimit të sigurimit pohoi me kokë.
— A mendon edhe për ndonjë gjë tjetër? — pyeti Vandervurti.

— Vetëm një gjë: nuk besoj se ndokush këtu në bankë, duke përfshirë edhe ty, e merr seriozisht problemin e fitimeve të paligjshme me letërkreditet. Sigurisht që përgëzojmë njëri-tjetrin sepse i kemi mbajtur humbjet nën tre të katërtat e një përqindshit të xhiros së përgjithshme, por kjo e fundit është rritur në një masë jashtëzakonisht të madhe dhe përqindja relative e humbjeve është mbajtur konstante, ose, bile, është rritur gjithashtu. Kam dëgjuar se, vitin e ardhshëm, seksioni *Kiarxh* do të kapë një xhiro prej tre miliardë dollarësh.

— Shpresojmë që kështu të bëhet.

— Atëherë, duke zbatuar të njëjtën përqindje, humbjet do të ngriheshin në më se njëzet e dy milionë dollarë.

Vandervurti tha me ton të ftohtë:

— Ne parapëlqejmë të flasim për këtë, me përqindje. Në këtë mënyrë nuk duket ndonjë gjë e madhe dhe këshilltarët nuk alarmohen.

— Një qëndrim mjaft cinik.

— Po, ashtu është.

Megjithatë, mendoi Aleksi, ky është qëndrimi i bankave, i të gjitha bankave. Vetë ato nuk donin t'i jepnin rëndësi problemit të falsifikimeve të letërkrediteve, duke i pranuar humbjet si një kuotë që paguhej për vazhdimin e veprimtarisë në këtë fushë. Po të kishte ndodhur në një sektor tjetër të bankës, vetëm brenda një viti, një humbje prej shtatë milionë e gjysmë dollarësh, në këshillin administrativ do të ishte bërë hataja. Por, lidhur me letërkreditet, këto «tre të katërtat e një përqindshit» në favor të kriminalitetit, pranoheshin ose liheshin qetësisht në heshtje. Rruga tjetër që mbetej ishte ajo e një lufte të pamëshirshme kundër krimit, gjë që do të kishte qenë shumë më e kuptueshme. Natyrisht se në këtë rast mund të thuhej që kjo pikëpamje e bankave s'qëndronte, mbasi, në fund të fundit, ata që humbisnin nga falsifikimet ishin pronarët e letërkrediteve, të cilët paguanin më shumë detyrime për shpenzime të përgjithshme. Sidoqoftë, nga pikëpamja financiare, ky qëndrim ishte në rregull.

— Ka çaste, — tha Aleksi, — kur e gjithë kjo punë e letërkrediteve më vjen në majë të hundës. Mirëpo, unë jetoj në një hapësirë të ngushtë, që ndodhet ndërmjet kufijve të asaj që mendoj se mund të bëj, përsa u përket ndryshimeve, dhe asaj që e di se nuk kam mundësi të bëj. Këtu përfshihet edhe përparësia e dhënies së fondeve. Ai preku me dorë fletën që Uejnrajti kishte lënë në tryezën e punës dhe tha:
— Ma lër mua. Të premtoj se do të bëj ç'është e mundur.
— Nëse, së shpejti, nuk do të kem lajme për këtë, nuk do të më mbetet tjetër veçse të plas nga inati.
Aleks Vandervurti u largua, por Nolan Uejnrajti u vonua edhe

pak nga një thirrje telefonike. Drejtori i shërbimit të sigurimit ishte i lutur të lidhej menjëherë me zonjën D'Orsej, drejtoreshë e degës kryesore të bankës.

— Fola me FBI-në, i tha Nolan Uejnrajti Eduina d'Orsejit.
— Nesër do të dërgojnë këtu dy agjentë të posaçëm.
— Pse jo sot?
Nolani u ngërdhesh.
— E po s'na ka vdekur njeri dhe as ka plasur koburja. Veç kësaj, ata atje kanë një problem: diçka që quhet mungesë personeli.
— Këtë e kemi të gjithë.
— A mund t'i lë, atëherë, nëpunësit të shkojnë në shtëpi? — ndërhyri Majlls Istini.
— Po, me përjashtim të vajzës, — u përgjigj Uejnrajti. — Dua të flas përsëri me të.
Po afrohej mbrëmja dhe kishin kaluar dy orë që kur Uejnrajti, mbas thirrjes së Eduinës, kishte marrë drejtimin e hetimeve. Gjatë kësaj kohe, ai kishte ndjekur të njëjtën rrugë që kishin bërë para tij funksionarët e degës së bankës, duke marrë në pyetje arkëtaren, Huanita Nunjezin, Eduina d'Orsejin, shefin e zyrës, Totenhonë dhe zëvendës shefin, të riun Majlls Istin.
Ai kishte biseduar edhe me arkëtarë të tjerë, që atë mëngjes, kishin punuar pranë sportelit të Nunjezit.
Për të mos tërhequr vëmendjen e nëpunësve të tjerë, Uejnrajti kishte kaluar në një sallë mbledhjesh, që ndodhej në pjesën e prapme të ndërtesës së bankës. Pikërisht aty gjendej tani, me Eduina d'Orsejin dhe Majlls Istinin.
Asgjë e re s'kishte dalë në dritë, me përjashtim të konstatimit se mund të ishte fjala për vjedhje, prandaj, simbas ligjit federal, duhej të thirrej FBI-ja. Në raste të tilla, siç e dinte mirë Uejnrajti, ligji nuk zbatohej gjithmonë në mënyrë

rigoroze. FMA-ja dhe bankat e tjera i klasifikonin shpeshherë vjedhjet e parave si «zhdukje misterioze» dhe, në këtë mënyrë, këto incidente mund të rregulloheshin brendapërbrenda, duke iu shmangur padive dhe publicitetit. Kështu, nëpunësi që dyshohej për vjedhje, pushohej nga puna me një motivacion zyrtar, ku përmendeshin arsye të tjera dhe jo ajo që kishte ndodhur në të vërtetë. Dhe, meqënëse ishte në interesin e fajtorit që ta mbante gojën mbyllur, një numër rastesh vjedhjesh çuditërisht i madh mbahej i fshehtë edhe brenda vetë bankës.

Mirëpo, sasia e parave që mungonte në këtë rast — duke pranuar të ishte fjala për një vjedhje — përbënte një shumë tepër të madhe dhe flagrante që mund të mbahej e fshehtë. Nga ana tjetër, nuk dukej të ishte më as punë me mend të humbisje kohë, duke shpresuar të siguroje ndonjë të dhënë tjetër. Uejnrajti e dinte se FBI-ja do të zemërohej po qe se do të thirrej disa ditë mbas ngjarjes për të bërë hetimet në gjurmë që, atëherë, do ta kishin humbur vlerën e tyre. Ndërkaq, në pritje të ardhjes së agjentëve federalë, ai vetë kishte ndërmend të bënte gjithçka që ishte e mundur.

Kur po dilnin Eduina dhe Majlls Istini nga salla e mbledhjeve, zëvendës shefi i zyrës i tha tërë zell:

— Po ju dërgoj zonjën Nunjez.

Mbas disa çastesh, te pragu i derës u duk Huanita Nunjezi, me trupin e saj të vogël e të zhdërvjellët.

— Hyni, hyni, — i tha Uejnrajti. — Mbylleni derën dhe uluni. Kishte folur me ton zyrtar, në përshtatje me funksionin e tij. Instinktivisht e kuptonte se një ton miqësor i gënjeshtërt nuk do ta mashtronte vajzën.

— Dua ta dëgjoj përsëri tërë ngjarjen. Le ta shohim prapë një për një.

Huanita Nunjezi, si më parë, kishte një pamje të zymtë dhe

armiqësore, në të cilën po fillonin të dukeshin tanimë shenja lodhjeje. Ajo protestoi:
— E kam treguar tri herë fund e krye!
— Ndoshta herët e tjera ke harruar ndonjë gjë.
— S'kam harruar asgjë!
— Atëherë, kjo do të thotë se do të kemi një tregim të katërt dhe, kur të vijnë ata të FBI-së, një të pestë dhe, ndoshta pastaj, edhe një të gjashtë. Uejnrajti nuk e hiqte vështrimin nga sytë e saj dhe vazhdonte të fliste me ton autoritar, por pa e ngritur zërin. «Po të kisha qenë në shërbim të policisë, mendoi ai, do të më ishte dashur t'i shpjegoja asaj të drejtat që gëzon.» Por, ai nuk bënte pjesë në polici dhe, prandaj, nuk ia tha ato. Nganjëherë, në raste si ky i fundit, një shërbim i brendshëm sigurimi kishte disa avantazhe nga të cilat nuk përfitonte policia.

— Unë e di se ç'mendoni ju, — tha vajza. — Ju mendoni se kësaj radhe do të them diçka të ndryshme dhe, kështu, ju do të mund të provoni se kam gënjyer.

— Por, a keni gënjyer?

— Jo!

— Atëherë, përse bëheni merak?

Ajo u përgjigj me zë të dridhur:

— Sepse jam e lodhur dhe do të doja të shkoja në shtëpi.

— Ashtu do të doja edhe unë. Dhe, po të mos mungonin këto gjashtë mijë dollarë, të cilët, siç e pranoni vetë, më parë i kishit, tani do ta kisha mbaruar ditën time të punës dhe do të isha duke u kthyer në shtëpi. Mirëpo, paratë janë zhdukur dhe ne duam t'i gjejmë dhe t'i shtiem në dorë përsëri. Prandaj, më flisni edhe një herë për pasditen e sotme. Kur ju ra në sy për herë të parë se diçka s'ishte në rregull?

— Siç jua thashë, njëzet minuta mbas pushimit të drekës.

Uejnrajti dalloi një shprehje përbuzjeje në sytë e saj. Më parë, kur e kishin marrë në pyetje, ai kishte konstatuar se qëndrimi i saj ishte më dashamirës kundrejt tij se sa kundrejt të tjerëve. Pa dyshim, duke qenë ai zezak dhe ajo portorikane, ajo kishte pandehur se ata mund të ishin aleatë, ose, së paku, se ai do të tregohej më i butë. Mirëpo, vajza nuk e dinte se, kur ishte fjala për të bërë hetime, për Uejnrajtin s'kishte fare rëndësi ngjyra e lëkurës. Dhe as nuk donte të dinte për problemet personale që ajo mund të kishte. Eduina d'Orseji i kishte përmendur ato, por, sipas Uejnrajtit, asnjë problem personal nuk mund të shfajësonte vjedhjen ose mungesën e ndershmërisë.

Ndërkaq, Huanita kishte pasur të drejtë kur mendonte se ai synonte ta zinte në gabim, në një paraqitje të ndryshme të ndonjë fakti që binte në kundërshtim me ç'kishte thënë më parë. Dhe një gjë e tillë mund të ndodhte, me gjithë kujdesin e saj të madh. Ajo ishte ankuar se e ndjente ve ten të lodhur dhe Uejnrajti, si hetues me përvojë që ishte, e dinte se, kur fillon ta ndiejë veten të lodhur, fajtori ka mundësi të bëjë gabime gjatë marrjes në pyetje; në fillim, një gabim të parëndësishëm, pastaj një tjetër dhe pastaj edhe një tjetër, deri sa e sheh veten të zënë në një rrjetë gënjeshtrash dhe thëniesh, në kundërshtim me njëra-tjetrën.

Duke e pyetur veten nëse një gjë e tillë do të ndodhte tani, Uejnrajti vazhdoi me pyetjet.

U desh një kohë prej treçerek ore për t'i treguar ngjarjet, gjatë së cilës tregimi i Huanitës qe krejtësisht i njëjtë me atë të mëparshmin. Ndonëse i zhgënjyer, sepse nuk kishte zbuluar asgjë të re, Uejnrajtit i bëri mjaft përshtypje saktësia e vajzës. Përvoja e tij e kaluar në polici e shtynte të mendonte se një saktësi e tillë mund të kishte dy shpjegime: ose ajo po thoshte të vërtetën, ose e kishte përsëritur dhe provuar aq shumë herë

dhe me kujdes tregimin, sa që tani mund ta thoshte pa as më të voglin ndryshim. Hipoteza e dytë dukej të ishte shpjegimi më i pranueshëm, sepse, zakonisht nga njëri tregim te tjetri i një të pafajshmi ka gjithmonë ndryshime të vogla. Kjo është një simptomë që dedektivët kërkojnë gjithnjë ta zbulojnë.

Më në fund, Uejnrajti tha:

— Në rregull, kaq, tani për tani. Nesër do të bëni provën me makinën e së vërtetës. Këtë gjë e rregullon banka.

Ai e kishte thënë këtë kalimthi, me ton indiferent, por duke vazhduar ta vëzhgonte, për të parë ndonjë kundërveprim të mundshëm. Mirëpo, sigurisht që nuk e priste një kundërveprim aq të menjëhershëm dhe të furishëm.

Fytyra e vogël brune e vajzës u ndez flakë. Ajo u ngrit me vrull nga karrigia.

— Jo, nuk do ta bëj! Nuk do ta bëj atë provë!

— Pse jo?

— Sepse është një fyerje!

— Nuk është fyerje. Plot njerëz e bëjnë atë. Në qoftë se je e pafajshme, makina do ta provojë.

— Unë s'kam besim te një makinë e tillë dhe as te ju. Nuk flas më!

Ai nuk dinte spanjisht dhe, duke dyshuar se do të ishte diçka fyese, tha:

— S'keni arsye të mos më besoni. I vetmi qëllim që kam është të zbuloj të vërtetën. — Por, ju e dëgjuat të vërtetën dhe nuk arritët ta kuptoni! Si të gjithë të tjerët, ju besoni se i kam marrë unë paratë. Ç'kuptim ka t'ju them përsëri se nuk i kam marrë unë?

Uejnrajti u ngrit. Ai hapi derën e zyrës së vogël që të dilte ajo.

— Të sugjeroj që, gjer nesër, — e këshilloi ai, — ta rishikosh qëndrimin tënd lidhur me provën. Refuzimi do të përbënte një veprim që nuk do të ishte në favorin tënd.

Ajo e shikoi drejt në sy.

— Nuk jam e detyruar ta bëj, apo jo?

— Jo.

— Atëherë, nuk do ta bëj.

Ajo doli nga zyra me hapa të shkurtër e të shpejtë. Mbas një çasti edhe Uejnrajti doli, pa u nxituar, dhe u kthye në sallën kryesore të degës së bankës.

Pjesa më e madhe e personelit ishte larguar, dritat ishin pakësuar dhe, jashtë, errësira kishte rënë tanimë mbi ditën e ftohtë e me lagështirë të vjeshtës.

Huanita Nunjezi shkoi në gardërobë për t'u ndërruar. Kur u kthye, ajo nuk denjoi t'i hidhte as edhe një vështrim Uejnrajtit. Majlls Istini, që po priste me një kyç në dorë, hapi portën kryesore.

— Huanita, — tha ai, — ka ndonjë gjë që mund të bëj për ty? A të të çoj në shtëpi me makinë?

Pa folur, ajo tundi kokën në shenjë mohimi dhe doli në rrugë.

Duke shikuar nga një dritare, Nolan Uejnrajti e pa të shkonte drejt stacionit të autobusit, nga trotuari tjetër. Ai mendoi se po të kishte pasur më shumë personel, do të kishte caktuar njeri ta ndiqte, ndonëse nuk besonte të dilte gjë nga kjo. Ajo ishte e zgjuar dhe nuk do ta tradhtonte veten, as duke i dorëzuar paratë një tjetri, para syve të të gjithëve, dhe as duke i fshehur ato në një vend që mund të merrej lehtë me mend.

Uejnrajti ishte i bindur se vajza nuk i kishte paratë me vete. Ajo ishte tepër dinake e nuk do ta rrezikonte veten në një mënyrë të tillë. Veç kësaj, bankënotat do të formonin në trup një xhungë, që do të ishte vështirë të fshihej. Gjatë bisedës dhe mbas saj, ai e kishte vëzhguar me vëmendje: rrobat i rrinin ngjitur mbas trupit të saj të vogël dhe nuk dalloheshin fryrje të dyshimta. Kur kishte dalë nga banka, nuk kishte pasur ndonjë pako, por vetëm çantën e saj të vogël. Uejnrajtit po i mbushej mendja se në këtë mes duhej të kishte një bashkëpunëtor. Ai s'kishte më pothuajse asnjë dyshim se Huanita Nunjezi ishte fajtore. Mospranimi i saj për të bërë provën e makinës së të vërtetës, së bashku me faktet e shenjat e tjera, gati e kishin bindur për këtë. Duke sjellë ndërmend kundërveprimin e furishëm që kishte ndodhur para disa minutave, ai dyshoi se e gjithë ajo skenë kishte qenë e paramenduar, e përgatitur që më parë. Nëpunësit e bankës e dinin se kur dyshohej për vjedhje, përdorej makina e të vërtetës dhe këtë duhej ta dinte edhe Nunjezi, si të gjithë të tjerët. Prandaj, ajo mund ta kishte parashikuar që një gjë e tillë do të kërkohej dhe ta kishte përgatitur atë skenë që ndodhi pak më parë.

Duke sjellë ndërmend pastaj se ajo kishte vështruar me përbuzje dhe se, më parë, qëndrimi dhe pamja e saj linin të kuptohej se shpresonte për një lloj solidariteti midis atyre të dyve, Uejnrajti ndjeu të përshkohej nga një valë zemërimi. Ai vuri re se po shpresonte, me një këmbëngulje dhe dëshirë jo të zakonshme që, të nesërmen, agjentët e FBI-së ta shtrydhnin mirë dhe, më në fund, ta bënin të pohonte. Por kjo nuk do të ishte punë e lehtë. Ajo ishte koskë e fortë.

Ndërkaq, Majlls Istini e kishte mbyllur përsëri portën kryesore. Iu afrua Nolan Uejnrajtit dhe tha me ton të gëzuar:
— Si thoni, është koha që të shkojmë të lajmë duart, apo jo!

Drejtori i shërbimit të sigurimit pohoi me kokë. — Ç'ditë e vështirë!

U duk sikur Istini deshi të thoshte edhe diçka tjetër, por pastaj ndërroi mendje.

Uejnrajti e pyeti:
— Mos deshe të thoshe edhe diçka tjetër?

Istini ngurroi përsëri dhe, pastaj, tha:
— Ashtu është. Këtë s'ia kam thënë deri tani askujt, pasi mund të jetë vetëm një përshtypje që kam pasur.
— Ka të bëjë, në njëfarë mënyre, me paratë që janë zhdukur?
— Ka mundësi.

Toni i Uejnrajtit u bë disi më i rreptë.
— Atëherë, pavarësisht në je i sigurt apo jo, duhet të ma thuash.

Nënkryetari i zyrës pohoi me kokë.
— Në rregull.

Uejnrajti po priste. — E marr me mend që zonja D'Orsej t'jua ketë thënë se Huanita Nunjezi është e martuar. I shoqi e ka braktisur, si dhe vajzën e tyre.
— Po, më kujtohet.
— Kur jetonte akoma me të, i shoqi i Huanitës vinte herë pas here këtu, për ta parë. Kam folur me të nja dy herë. Me sa di unë, ai quhet Karlos.
— E, pastaj?
— Më duket se e pashë sot këtu, në bankë.
Toni i Uejnrajtit u bë i mprehtë:
— Jeni i sigurt?
— Mjaft i sigurt, ndonëse jo aq sa të mund të pohoj një gjë të tillë në gjyq. Mund të them se më ra në sy dikush, i cili m'u duk si ai dhe, pastaj, nuk mendova më për të. Isha mjaft i zënë me punë dhe, nga ana tjetër, s'kisha arsye për t'u marrë përsëri

me të, të paktën, deri pak kohë më parë.
— Sa ishte ora, kur e pe?
— Kishte kaluar gati gjysma e orëve të punës.
— Dhe a e pe këtë njeri, që t'u duk se ishte i shoqi i Huanita Nunjezit, t'i afrohej sportelit të saj?
— Jo, nuk e vura re. — Fytyra e bukur e Istinit u ngrys. — Siç thashë më parë, nuk e vrava më mendjen për këtë gjë. E vetmja gjë që mund të pohoj është që, në rast se me të vërtetë ka qenë i shoqi, ai nuk ishte shumë larg nga Huanita.
— Kjo është e gjitha?
— Po. — Majlls Istini shtoi me një ton sikur të kërkonte ndjesë: — Më vjen keq që s'kam t'ju them gjë tjetër.
— Sidoqoftë, bëre mirë që ma the. Mund të jetë e rëndësishme.

Në rast se Istini s'kishte gabuar, mendoi Uejnrajti, prania e të shoqit të Nunjezit në degën e bankës, mund të mbështeste hipotezën e tij përsa i përkiste një bashkëpunëtori të jashtëm. Ndoshta ajo dhe i shoqi ishin bashkuar përsëri, ose takoheshin herë pas here. Ndoshta ajo ia kishte dhënë paratë të sporteli, sikur të ishte fjala për një klient të zakonshëm, dhe ai i kishte nxjerrë jashtë bankës, për t'i ndarë pastaj midis tyre. Kjo ishte një mundësi konkrete, e ela mund të shqyrtohej dhe të hetohej nga FBI-ja.

— Le të flasim për diçka tjetër, — tha Istini. — E gjithë dega e bankës sot fliste për zoti Roselin. Mësuam për njoftimin që bëri mbi sëmundjen e tij. E ndiejmë veten shumë të trishtuar. Uejnrajti e vështroi djaloshin, i cili zakonisht ishte aq i qeshur e i gëzuar. Mirëpo, në atë çast, sytë e tij kishin një shprehje ankthi.

Uejnrajti vuri re, me një rrahje të befasishme të ndërgjegjes, se hetimet për vjedhjen e kishin bërë ta harronte Ben Roselin. Tani ia ndjeu një zemërim të madh, nga mendimi që vjedhja

kishte ndodhur në një rrethanë si kjo dhe do të linte në të shenjën e saj të shëmtuar.

Me një përshëndetje dhe një «natën e mirë», drejtuar Istinit, ai hapi me çelësin e tij universal portën e galerisë dhe u kthye përsëri në grataçielin e Drejtorisë Qendrore.

Nga trotuari përballë, Huanita Nunjezi — një figurë e vockël në sfondin e grataçielit të Ërst Merkëntaill Ëmerikën Benkut dhe të sheshit «Roseli» — po priste akoma autobusin.

E kishte vënë re Uejnrajtin, që po e vëzhgonte nga një dritare e bankës dhe ndjeu njëfarë lehtësimi kur fytyra e tij u zhduk prej andej, ndonëse e kuptonte se kjo ndjenjë lehtësimi ishte vetëm e përkohshme dhe se fatkeqësia e asaj dite do të vazhdonte përsëri të nesërmen, po aq e rëndë dhe e dhimbshme — ndoshta, edhe më shumë.

Frynte një erë e ftohtë, e cila e përshkonte me lehtësi pardësynë e saj të hollë dhe, duke pritur, ajo po dridhej. Autobusi, që merrte zakonisht, ishte nisur dhe ajo shpresonte që tjetri të mos vonohej.

Huanita e dinte se të dridhurat ishin shkaktuar pjesërisht nga frika, sepse, në atë çast, ajo e ndjente veten më të trembur dhe të tmerruar se kurrë ndonjëherë tjetër në jetën e saj.

E kishte pushtuar një frikë e madhe dhe s'dinte nga t'ia mbante.

S'dinte ç'të bënte, sepse nuk kishte as idenë më të vogël se si ishin zhdukur paratë.

Huanita e dinte mirë se ajo vetë as kishte vjedhur, as i kishte dhënë gabimisht në sportel, dhe as i kishte përdorur në ndonjë mënyrë tjetër.

E keqja ishte se askush s'e besonte.

Ajo mendoi se, në rrethana të tjera, as vetë ajo s'do ta kishte besuar veten. Si mund të ishin zhdukur gjashtë mijë

dollarët? Kjo ishte e pamundur, e pamundur, dhe, megjithatë, kështu kishte ndodhur.

Gjatë asaj pasditeje, ajo kishte kaluar përsëri në mendje, disa herë me radhë, çdo gjë që kishte ndodhur, për të gjetur ndonjë shpjegim. Mirëpo nuk gjente asgjë. Falë kujtesës së saj të jashtëzakonshme, ajo kishte mundur t'i sillte ndërmend të gjitha veprimet e arkës, që ishin kryer gjatë mëngjesit dhe orëve të para të pasdites, por as shenja më e vogël nuk kishte dalë në dritë. As hipoteza më absurde nuk mund t'u jepte ndonjë shpjegim fakteve.

Nga ana tjetër, s'kishte dyshim se e kishte mbyllur kasetën e saj, kur e kishte çuar poshtë te Thesari, para se të shkonte për të ngrënë drekë dhe se, e kishte gjetur prapë të mbyllur, kur ishte kthyer. Përsa i përkiste kombinacionit, të cilin Huanita e kishte zgjedhur vetë, ajo s'ia kishte treguar askujt dhe as që e kishte shënuar ndokund, duke u mbështetur si zakonisht në kujtesën e saj.

Në njëfarë mënyre, kishte qenë pikërisht kujtesa e saj që i kishte ngatërruar edhe më shumë punët.

Huanita e kishte të qartë se nuk e kishin besuar (as zonja D'Orsej, as zoti Totenho, as Majllsi, i cili, së paku, ishte sjellë në mënyrë më të njerëzishme se të tjerët), kur, në ora dy, ajo kishte pohuar se e dinte shumën e saktë që mungonte. Ata kishin thënë se ishte e pamundur që ajo ta dinte atë.

Mirëpo, ajo e kishte ditur. Në çdo çast, ajo gjithnjë e dinte shumën që kishte në arkë, kur punonte aty, ndonëse nuk ishte në gjendje ta shpjegonte një gjë të tillë.

As ajo vetë nuk e kuptonte se si mund t'i regjistronte në mendjen e saj hyrjet e daljet e parave, por totalin e kishte aty, në kokën e saj dhe kjo gjë ndodhte pa bërë ajo as përpjekjen më të vogël. Nga sa mund të mbante mend Huanita, të katër veprimet aritmetike: mbledhja, zbritja, shumëzimi dhe

pjesëtimi, kishin qenë gjithmonë për të një gjë aq e thjeshtë dhe e natyrshme, sa të marrurit frymë.

Kur punonte në arkë dhe jepte ose merrte para nga klientët, ajo e bënte automatikisht llogarinë. Veç kësaj, e kishte bërë zakon t'i hidhte, herë pas here, një vështrim kasetës, për të verifikuar nëse shuma që kishte aty qe aq sa duhej të ishte, nëse bankënotat ishin të ndara si duhej dhe në sasi të mjaftueshme.

Edhe përsa u përkiste monedhave metalike, ajo e dinte në çdo çast totalin, ndonëse jo me të njëjtën saktësi. Nganjëherë, kur bënte bilancin e arkës, mbas një dite pune mjaft intensive, ajo vinte re se llogaria e saj mendore ishte e gabuar vetëm me një numër shumë të vogël dollarësh dhe kurrë më shumë se kaq.

Nga e kishte ajo këtë veti? Nuk dinte fare ta shpjegonte.

Ajo s'kishte shkëlqyer kurrë në shkollë. Në shkollën e mesme, të cilën e kishte ndërprerë para se ta mbaronte, notat e saj rrallë kishin qenë mbi mesataren. As në matematikë s'kishte qenë mirë: nuk arrinte të kapte thelbin e koncepteve, ndonëse kishte dhuntinë të kryente llogaritje me shpejtësinë e dritës dhe të mos i harronte kurrë numrat.

Më në fund, autobusi mbërriti, me një zhurmë të çrregullt dhe erë të keqe benzine. Huanita hipi, bashkë me njerëzit e tjerë që po prisnin. Autobusi ishte i mbushur plot; jo vetëm ndenjëset ishin të zëna, por edhe në këmbë kishte shumë njerëz. Huanita mundi të kapej te një mbajtëse dhe vazhdonte të ishte e zhytur në mendime, ndërsa autobusi përshkonte rrugët e qytetit.

Ç'do të ndodhte të nesërmen? Majllsi i kishte thënë se ishte thirrur FBI-ja. Ky mendim e mbushi përsëri me frikë, duke ia shndërruar tiparet e fytyrës në një maskë të ngrirë ankthi. Kjo

ishte e njëjta shprehje, të cilën Eduina d'Orseji dhe Nolan Uejnrajti e kishin marrë për shprehje armiqësore.

Ajo vendosi të fliste sa më pak që të ishte e mundur, ashtu siç kishte bërë atë pasdite, kur kishte parë se askush nuk e besonte.

Sa për makinën e së vërtetës, ajo nuk do të pranonte aspak. Nuk dinte asgjë se si punonin makina të tilla, por, kur njerëzit nuk e kishin besuar, s'kishin treguar mirëkuptim kundrejt saj dhe s'e kishin ndihmuar, pse një makinë — makina e bankës — do të vepronte ndryshe?

Zbriti nga autobusi, por duhej të kalonte edhe tri blloqe ndërtesash për të mbërritur te çerdhja e Estelës. Çdo mëngjes, kur shkonte në punë, e linte atje dhe në mbrëmje kalonte përsëri për ta marrë. Ajo shpejtoi hapin, duke e ditur se ishte me vonesë.

Kur hyri në sallën e vogël të lojërave, në katin përdhes të një shtëpie private vajza e vogël vrapoi drejt saj. Megjithëse ndërtesa ishte e vjetër dhe në gjendje mjaft të keqe, sikurse ndërtesat e tjera në atë zonë, lokalet e çerdhes ishin të pastra dhe tërheqëse. Kjo ishte arsyeja përse Huanita kishte zgjedhur këtë çerdhe dhe jo një tjetër, ndonëse pagesa aty ishte më e lartë dhe përbënte një barrë për të. Estela ishte plot gjallëri dhe gaz, si gjithmonë.
— Mami! Mami! Shikoje vizatimin tim! Është një tren. — Ajo fliste, duke treguar me gishtin e saj të laparosur me bojë. — Ky është një vagon. Brenda është një burrë!
Ajo ishte trupvogël, edhe për një fëmijë trevjeçar, brune si Huanita, me sy të mëdhenj të ndritshëm, që pasqyronin habinë e saj para çdo gjëje të re që zbulonte çdo ditë.
Huanita e mori në krahë dhe e korigjoi me ëmbëlsi:
— Vagon, shpirti i mamit.
Nga qetësia që mbretëronte, ishte e qartë se të gjithë fëmijët e

tjerë ishin larguar.
Te dera u duk zonjushja Ferro, pronarja dhe drejtoresha e çerdhes. Me pamje krenare dhe pak a shumë të mërzitur, ajo i hodhi një vështrim kuptimplotë orës së saj.
— Zonja Nunjez, unë pranova t'ju bëja një favor të veçantë, duke e mbajtur këtu Estelën më vonë se të tjerët, por tani është...
— Më vjen shumë keq, zonjushja Ferro, por në bankë ndodhi një ngatërresë dhe u vonova.
— Unë kam edhe përgjegjësira private. Prindët e tjerë e respektojnë orarin e mbylljes së çerdhes.
— Nuk do të ndodhë më, jua premtoj.
— Shumë mirë. Por meqë jemi këtu, zonja Nunjez, a mund t'ju kujtoj se pagesa e muajit të kaluar për Estelën nuk është shlyer akoma?
— Do ta shlyej të premten. Të premten e marr rrogën.
— E kuptoni se më vjen keq që jam e detyruar të flas për këtë. Estela është një fëmijë e dashur dhe ne jemi të kënaqur që e kemi këtu, por edhe unë kam llogaritë e mia për të shlyer...
— Sigurisht, ju kuptoj. Do ta shlyej të premten, jua premtoj.
— Kështu bëhen dy premtime, zonja Nunjez.
— E di.
— Atëherë, natën e mirë. Natën e mirë, Estelë e dashur.
Me gjithë qëndrimin e ftohtë që mbante zonjushja Ferro, çerdhja e saj ishte shumë e mirë dhe Estela e ndjente veten të lumtur atje. Huanita vendosi që paratë e çerdhes t'i nxirrte nga paga e asaj jave, siç kishte premtuar dhe, pastaj, do të bënte si të bënte gjer në pagën tjetër. Rroga e saj si arkëtare ishte 98 dollarë në javë dhe, po të zbriteshin taksat dhe kuotat e sigurimeve shoqërore, mbetej një shumë neto prej 83 dollarësh. Nga kjo shumë duhej të dilte ushqimi për të dyja,

pagesa e çerdhes së Estelës, qiraja e apartamentit të vogël, në një ndërtesë të vjetër pa ashensor, në Rajonin Lindor, pa llogaritur se ishte një muaj mbrapa në pagesën e agjencisë së huave.
Ajo qe treguar mjaft naive, para se Karlosi ta braktiste, një vit më parë, duke nënshkruar së bashku me të kontratën me agjencinë, ndërsa ai ishte larguar dhe s'ishte kthyer më, duke marrë me vete sendet që kishte blerë me këtë hua, si rroba të ndryshme, një veturë të përdorur, një televizor me ngjyra.
Kështu, që prej një viti, Huanita vazhdonte të paguante dhe, kështet që mbeteshin akoma për t'u shlyer, i dukeshin si një zinxhir që zgjatej në një të ardhme pa fund.
Duhej të shkonte pa humbur kohë në agjencinë e huave, mendoi ajo, dhe t'u propozonte një kuotë më të vogël.
S'kishte dyshim se ata do t'ia sillnin shpirtin në majë të hundës, siç kishin bërë edhe herën e fundit, por s'kishte ç'të bënte, duhej durim.
Huanita dhe Estela u drejtuan për në shtëpi. Estela hidhej e kërcente rrugës, e gëzuar e tërë kënaqësi, me dorën e saj të vockël në atë të së ëmës. Në dorën tjetër, Huanita mbante vizatimin e Estelës, të mbledhur me kujdes. Edhe pak dhe ato do të mbërrinin në apartamentin e tyre, do të hanin darkën dhe, pastaj, si zakonisht, do të luanin dhe do të qeshnin së bashku. Por, atë mbrëmje, mendoi Huanita, ajo do ta kishte të vështirë të qeshte.
Tmerri që kishte ndier më parë u bë edhe më i thellë, kur për herë të parë i shkoi mendja se ç'mund të ndodhte në rast se do të humbiste vendin e punës. Ajo u detyrua të pranonte se kishte shumë mundësi që një gjë e tillë të ndodhte.
Ajo e dinte gjithashtu se do të ishte e vështirë të gjente një punë tjetër. Asnjë bankë nuk do ta merrte më në punë dhe punëdhënësit e tjerë do të donin të dinin ku kishte punuar më

parë dhe, mbasi të mësonin për paratë e zhdukura, nuk do ta pranonin.
Si do t'ia bënte pa punë? Si do t'i përballonte shpenzimet për mbajtjen e Estelës?
Ajo u ndal menjëherë, ngriti të bijën dhe e shtrëngoi fort në krahët e saj. U lut që të nesërmen dikush ta besonte, të zbulonte të vërtetën.
Dikush, dikush.
Por kush?

9.

Edhe Aleks Vandervurti kishte dalë në qytet.

Atë pasdite, pasi ishte kthyer në zyrë, pas bisedës që kishte pasur me Nolan Uejnrajtin, Aleksi kishte filluar të ecte poshtë e lart, duke u përpjekur t'i rendiste ngjarjet e fundit në një mënyrë të tillë, që të formonin një tërësi të qartë e të kuptueshme. Njoftimi i bërë një ditë më parë nga Ben Roseli, përbënte një nga çështjet kryesore të mendimeve të tij dhe, po ashtu, edhe ngjarja e krijuar brenda bankës, si rezultat i atij njoftimi. Veç këtyre, ishin edhe ngjarjet që kishin ndodhur muajt e fundit në jetën private të vetë Aleksit.

Ecja poshtë e lart — dymbëdhjetë hapa në njërin drejtim dhe përsëri dymbëdhjetë hapa në drejtimin e kundërt — ishte një zakon i tij i vjetër. Ishte ndalur vetëm një a dy herë, për të shqyrtuar përsëri letërkreditet Kiçarxh të falsifikuara, që drejtori i shërbimit të sigurimit e kishte lënë t'i merrte me vete. Seksioni i kreditit dhe letërkreditet përbënin një barrë të re në kokëçarjet e tij — jo vetëm ato të falsifikuara, por edhe të vërtetat.

Letërkrediteve të vërteta u bëhej reklamë me një varg njoftimesh të përgatitura nga agjencia publicitare «Ostin», bocat e të cilave ishin të shpërndara gjithashtu mbi tryezën e punës. Qëllimi i këtyre njoftimeve ishte t'i nxiste pronarët e

letërkrediteve Kiçarxh ta përdornin gjithnjë e më shumë kredinë që u ishte dhënë, si dhe vetë letërkreditet.

Njëri nga këto njoftime nxiste:

Mos e vrit mendjen për paratë.
Përdor letërkreditin tënd Kiçarxh,
Dhe,
Na i lër neve kokëçarjet!

Një tjetër thoshte:

Faturat nuk të sjellin telashe
Kur thua:
«Shënoje atë në llogarinë time Kiçarxh!»

Një i tretë këshillonte:

Pse të presësh?
Që sot mund ta realizosh
Ëndrrën e së nesërmes!
Përdore llogarinë tënde Kiçarxh,
Tani!

Kishte edhe nja gjashtë të tjera, të gjitha me një stil të ngjashëm.

Aleks Vandervurtit nuk i pëlqente asnjëri prej tyre.

Sidoqoftë, ai nuk do të merrte vendim për zgjedhjen përfundimtare të njërit prej tyre. Këto njoftime, që kishin qenë fruti i një seleksionimi të mëparshëm, i ishin dërguar atij sa për dijeni. Edhe vetë vija e përgjithshme që do të ndiqej nga fushata publicitare kishte qenë vendosur shumë javë më parë nga këshilli administrativ, duke pasur si pikësynim rritjen e rentabilitetit të seksionit Kiçarxh, i cili — si çdo sistem tjetër letërkreditish — kishte pësuar humbje të mëdha në periudhën fillestare të veprimtarisë së tij.

Por Aleksi pyeste veten, nëse përputhej me qëllimet e këshilltarëve një fushatë publicitare me një karakter agresiv aq të qartë.

Ai mblodhi fletët e ndryshme me njoftimet dhe i vuri përsëri në dosjen e vogël prej kartoni, me të cilën i kishin sjellë. Në mbrëmje, në shtëpi, do t'i shihte prapë me kujdes dhe do të merrte edhe mendimin — që kishte të ngjarë të ishte me shumë spec — të Margotit. Apo duhej të priste? Por çfarë të priste?

Të priste Silian?

Edhe këtë pyetje, Aleksi ia kishte bërë vetes me mijëra herë. Hodhi sytë nga ana tjetër e qytetit, në drejtim të vendit ku gjendej Silia. Pyeti veten se ç'ishte duke bërë ajo në atë çast dhe si ishte gjendja e saj.

Kishte një mënyrë të thjeshtë për t'i mësuar këto.

U kthye te tryeza e punës, ngriti receptorin e telefonit dhe formoi një numër që e dinte përmendsh.

U përgjigj një zë gruaje:

— Qendra Klinike.

Aleksi e njoftoi se kush ishte dhe shtoi:
— Dëshiroj të flas me dr. Mekartnin.

Mbas disa çastesh, një zë burri pyeti:

— Ku je, Aleks?

— Në zyrën time. Po mendoja për Silian.

— Të pyeta, sepse kisha ndërmend të të telefonoja që të vije sot për ta parë.

— Herën e fundit që biseduam, nuk më lejove të vija.

Psikiatri e korrigjoi në mënyrë të hijshme:

— Thashë se mendoja që vizita të tjera nuk ishin të këshillueshme për njëfarë kohe. Vizitat e fundit, siç do ta mbash mend sigurisht, i bënë më shumë dëm se sa mirë.

— Po, më kujtohet. — Aleksi ngurroi për një çast dhe pastaj pyeti: — Ka ndonjë ndryshim tani?

— Po, ka. Por do të doja të kishte qenë një ndryshim për të mirë.

Kishte pasur, tanimë, aq shumë raste për të mirë e për të keq, saqë njoftime të tilla nuk i bënin më përshtypje Aleksit.

— Për çfarë lloj ndryshimi është fjala?

— Silia po mbylllet gjithnjë e më shumë në vetvete. Shkëputja e saj nga realiteti është pothuajse e plotë. Ja sepse mendoj që një vizitë nga ti ka mundësi t'i bëjë mirë. — Psikiatri e korrigjoi pastaj veten: — Së paku, nuk duhet t'i bëjë dëm.

— Shumë mirë. Do të vij në mbrëmje.

— Kur të duash, Aleks, dhe, pastaj, kalo edhe nga unë. Siç e di, ne s'kemi caktuar orar vizitash dhe jemi kufizuar me një numër shumë të vogël rregullash.

— Po, e di.

Mungesa e formaliteteve, po mendonte Aleksi, ndërsa po vendoste në vend receptorin, kishte qenë një nga arsyet që e kishin bindur të zgjidhte pikërisht Qendrën Klinike, kur, para katër vjetësh, i qe dashur të merrte atë vendim të tmerrshëm për Silian. Atmosfera e Qendrës ishte me dashje antiteza e institucioneve për kurimin e sëmundjeve mendore. Infermieret nuk mbanin uniforma. Brenda disa kufijve të mundshëm, të sëmurët ishin të lirë të qarkullonin lirisht ku të donin dhe inkurajoheshin të vendosnin vetë për çështjet që u përkisnin. Me përjashtim të disa rasteve të rralla, miqtë dhe njerëzit e afërt të të sëmurëve mund të shkonin t'i vizitonin në çdo kohë. Edhe vetë emri «Qendër Klinike» ishte zgjedhur me qëllim, në vend të emrit ngjethës «Spital Psikiatrik». Një arsye

tjeter ishte se dr. Timothi Mekartni — i ri, tërë gjallëri dhe novator në punën e tij — ishte në krye të një grupi specialistësh, terapitë e të cilëve kishin sukses aty ku metodat tradicionale dështonin.

Qendra Klinike ishte e vogël. Të sëmurët nuk i kalonin kurrë të njëqind e pesëdhjetë vetat dhe personeli ishte relativisht i madh. Në njëfarë mënyre, Qendra ishte si një shkollë, e ndarë në klasa të vogla, ku secilit student i bëhej një shërbim dhe trajtim i veçantë, që nuk mund të sigurohej gjetiu. Fantazia krijuese dhe paratë nuk mund t'i kishin bërë më të bukura dhe tërheqëse ndërtesën moderne dhe kopshtet që e rrethonin.

Klinika ishte private dhe tmerrësisht e shtrenjtë, por Aleksi kishte qenë i vendosur që në fillim që Silias t'i kushtohej kujdes i veçantë dhe t'i bëheshin kurat më të mira. Ai thoshte me vete se kjo ishte më e pakta që mund të bënte.

Gjer në mbrëmje u mor, në zyrën e tij, me punë të bankës. Pak mbas orës gjashtë, doli nga Drejtoria Qendrore dhe i dha shoferit adresën e Qendrës Klinike. Gjatë rrugës, lexoi gazetën e mbrëmjes. Një veturë e mbyllur dhe shoferi i saj, në çdo çast të gatshëm në parkun e veturave të bankës, ishte një nga privilegjet që gëzonte posti i nënpresidentit ekzekutiv dhe Aleksi e shfrytëzonte atë.

Mbërriti para ndërtesës së Qendrës Klinike, fasada e së cilës, me përjashtim të numrit të zakonshëm që ka çdo godinë, s'kishte asgjë tjetër që ta dallonte nga cilado ndërtesë e madhe banimi.

Ia hapi derën një bionde simpatike, që kishte veshur një fustan me ngjyra të ndezura e të stampuara. Aleksi e kuptoi se ishte infermiere nga distinktivi i vogël që ishte kapur mbi gjirin e saj të majtë. Ky ishte i vetmi dallim i jashtëm, i lejuar nga rregullorja, midis personelit dhe të sëmurëve.

— Doktori më tha se do të vinit, zoti Vandervurt. Po ju shpie menjëherë te gruaja juaj.

Ata përshkuan së bashku një korridor të bukur, ku mbizotëronte e verdha dhe e gjelbra. Gjatë mureve kishte vende të vogla të futura, të stolisura me lule të freskëta.

— Më thanë se ime shoqe nuk ka shenja përmirësimi, — tha Aleksi.

— Ashtu është, për fat të keq.
Infermierja i hodhi një vështrim anash. Atij iu duk se sytë e saj shprehnin keqardhje. Keqardhje për kë? Çdo herë që shkonte në Qendrën Klinike, ai ndjente t'i zhdukej gjallëria e tij e natyrshme.

Tani ndodheshin në njërën nga të tria pjesët që veçoheshin nga korpusi qendror i ndërtesës.

Infermierja u ndal para një dere.
— Gruaja juaj është në dhomën e saj, zoti Vandervurt. Ajo s'ka qenë mirë sot. E kini parasysh këtë, po qe se zonja nuk...
— E la përgjysmë fjalën, i preku lehtë krahun në kalim e sipër dhe hyri në dhomë para tij.

Qendra Klinike i vendoste të sëmurët në dhoma të veçanta ose me nga dy shtretër, simbas efektit që kishte mbi ta shoqërimi me të tjerë. Silian e kishin vënë në fillim në një dhomë dyshe, por kjo s'kishte pasur efekt të mirë. Tani ajo ishte në një dhomë vetëm, e cila, ndonëse e vogël, ishte e rehatshme dhe tërheqëse. Në të gjendeshin një divan, një kolltuk i madh me mbështetëse këmbësh, një tavolinë lojërash dhe një raft librash. Muret ishin stolisur me piktura impresioniste.

— Zonja Vandervurt, — tha infermierja me ëmbëlsi, — burri juaj ka ardhur t'ju shohë.

Nuk u pa as shenja më e vogël e ndonjë kundërveprimi, asnjë lëvizje, asnjë fjalë nga ana e të sëmurës.

Kishte një muaj e gjysmë që Aleksi s'e kishte parë Silian dhe, megjithëse priste të shihte njëfarë keqësimi, gjendja e saj e tanishme e ngriu në vend.

Silia ishte e ulur, në qoftë se kështu mund të thuhet për mënyrën se si rrinte në divan, ku ishte vendosur tërthorazi, me shpinë nga dera, e kërrusur, kokën të ulur, krahët të kryqëzuar para gjoksit, ndërsa me secilën dorë kishte kapur supin e kundërt. Edhe pjesa tjetër e trupit ishte bërë kruspull; këmbët, të përkulura, me gjunjët lart, të shtrënguar njëri me tjetrin. Ajo rrinte krejt pa lëvizur dhe e heshtur.

Aleksi iu afrua dhe i vuri dorën lehtë në sup.
— Ç'kemi, e dashur? Jam unë... Aleksi. E kam pasur mendjen te ti, kështu, erdha të të shoh.

Ajo tha me një zë të ulët, pa ngjyrë:
— Po. — Nuk bëri as lëvizjen më të vogël.
Ai rëndoi më shumë mbi supin e saj.
— Nuk do të kthehesh këndej, nga unë? Kështu do të rrimë pranë njëri-tjetrit dhe do fjalosemi.
I vetmi kundërveprim i Silias qe një rritje e dukshme e kontraktimit, një theksim edhe më i madh i qëndrimit kruspull të trupit të saj.

Lëkura e saj, vuri re Aleksi, e kishte humbur freskinë e dikurshme dhe flokët biondë ishin krehur shkel e shko; bukuria e saj e ëmbël dhe e brishtë nuk ishte zhdukur krejt, ndonëse shihej se s'do të duhej shumë kohë që kjo të ndodhte.

— Sa kohë ka që është në këtë gjendje? — e pyeti Aleksi, me zë të ulët, infermieren.

— Që dje, por kjo ka ndodhur edhe herë të tjera. — Vajza vazhdoi të fliste me ton profesional: — Kështu e ndien veten më rehat, prandaj është mirë që të bëni sikur nuk vini re gjë. Uluni dhe bisedoni me të.

Aleksi pranoi me një lëvizje të kokës. Ndërsa ai po shkonte të ulej në kolltukun e vetëm, infermierja doli në majë të gishtave dhe e mbylli derën pa zhurmë.

— E di, Silia, javën e kaluar shkova në një shfaqje baleti, — tha Aleksi. — Jepej «Kopelja». Balerina e parë ishte Natalia Makarova dhe rolin e Francit e luante Ivan Nagi. Ata kërcenin bashkë aq bukur dhe, natyrisht, muzika ishte e mrekullueshme. E gjithë kjo më solli ndërmend sa të pëlqente ty «Kopelja». Ishte një nga baletet e tua të preferuara. A të kujtohet ajo mbrëmje, pak kohë mbasi ishim martuar, kur ti dhe unë ...

Ai mund ta kujtonte akoma qartë figurën e Silias atë mbrëmje të largët, me fustanin e saj të gjatë mëndafshi, të gjelbër të çelur. Silia kishte qenë e bukur si gjithmonë, një bukuri hyjnore, e lehtë dhe delikate si një vello. Të dukej sikur një fllad i lehtë do të ta rrëmbente, sapo të hiqje sytë nga ajo. Por, në atë kohë, ai rrallë ia hiqte sytë. Kishin gjashtë muaj martesë dhe Silia ishte akoma e turpshme, kur takoheshin me miqtë e Aleksit, aq sa, nganjëherë, 'shtrëngohej fort mbas krahut të tij. Aleksi nuk i jepte rëndësi kësaj gjëje, meqenëse ajo ishte dhjetë vjeç më e re se ai. Ndruajtja e Silias kishte qenë në fillim njëra nga arsyet që kishte rënë ai në dashuri me të dhe, më vonë, ai ishte krenar për faktin se ajo kishte kaq nevojë për mbrojtjen e të shoqit. Por, me kohë, ai kishte parë se Silia vazhdonte ta ndjente veten të pasigurt — gjë që ai e quante një qëndrim pa mend — dhe kishte filluar të tregohej i padurueshëm dhe herë-herë i zemëruar. Sa pak, në mënyrë tragjike, sa pak kishte kuptuar ai! Me pak më shumë intuitë, ai do ta kishte pasur të qartë se, para njohjes së tyre, Silia kishte jetuar në një ambient krejt të ndryshëm nga ambienti i tij dhe se asgjë s'e kishte përgatitur atë për jetën shoqërore dhe familjare intensive, të cilën ai e pranonte si një gjë të zakonshme. Gjithçka ishte e re për Silian, një burim habie dhe, nganjëherë, alarmi. Ajo ishte vajzë e vetme dhe prindërit e saj kishin qenë në një gjendje ekonomike jo dhe aq të mirë dhe bënin një jetë të mënjanuar. Ajo kishte studuar në një shkollë murgeshash, pa e njohur fare aférsinë nxitëse të

shkollave të përziera, me djem e vajza. Para se të njihej me Aleksin, ajo nuk kishte pasur asnjë lloj përgjegjësie dhe përvoja e saj shoqërore ishte baras me zero. Martesa e shtoi nervozizmin e saj të natyrshëm dhe, njëkohësisht, pasiguria dhe tensioni i brendshëm ishin rritur gjithnjë e më shumë, deri sa — siç e kishin shpjeguar psikiatrët — barra e fajit për mossukseset e dështimet kishte prekur trurin e saj. Duke i analizuar ngjarjet e kaluara, Aleksi i kishte pranuar gabimet e tij. S'duhej të kishte qenë e vështirë për atë ta ndihmonte Silian, ta këshillonte, të zbuste tensionet e krijuara, ta qetësonte. Po tamam atëherë, kur duhej, ai s'e kishte bërë. Ai ishte treguar shumë më egoist, kishte qenë tepër i zënë me punë, tepër ambicioz.

— ... dhe më erdhi shumë keq, Silia, që shfaqjen e javës së kaluar, nuk e pamë bashkë.

Në të vërtetë ai kishte shkuar për ta parë «Kopeljan» me Margotini, të cilën e kishte njohur para një viti e gjysmë. Me entuziazmin e saj, Margoti e kishte mbushur jetën e Aleksit, që kishte mbetur e zbrazët për një kohë aq të gjatë. Në rast se nuk donte të pësonte edhe Aleksi ndonjë sëmundje mendore, ai — që ishte prej mishi e gjaku si të gjithë të tjerët — kishte nevojë për Margotin, ose për dikë tjetër. Kështu thoshte shpesh me vete. Apo mos ishte kjo një orvatje për të gënjyer vetveten, për ta mbytur dhe bërë të heshtë ndjenjën e fajit?

Sidoqoftë, këtu nuk ishte as koha dhe as vendi për të zënë me gojë emrin e Margotit.

— Shiko, Silia, s'ka shumë kohë që jam takuar me Harringtonët. Të kujtohen Xhoni dhe Eliza, apo jo? Më thanë se kishin qenë në Skandinavi te prindërit e Elizës.
— Po, — tha Silia, me zë të mekur.
S'e kishte ndryshuar akoma pozicionin e saj dhe trupin vazhdonte ta mbante kruspull, por, me sa duket, po e dëgjonte. Prandaj, Aleksi vazhdoi të fliste, duke përdorur për

këtë vetëm një pjesë të mendjes së tij, ndërsa pjesa tjetër pyeste: «Si ndodhi kjo? Pse?»

— Kohët e fundit, kemi pasur shumë punë në bankë.

Një nga shkaqet, mendonte ai, ndoshta kishte qenë preokupimi i tij për punën, orët e gjata, gjatë të cilave — ndërsa martesa e tyre kishte filluar të merrte të tatëpjetën — ai e linte Silian vetëm. Dhe kjo kishte ndodhur, siç e shikonte ai tani, në periudhën kur Silia kishte pasur më shumë nevojë për ndihmën e tij. Sigurisht, ajo nuk ishte ankuar asnjëherë për mungesat e tij, por ishte bërë gjithnjë e më shumë e përmbajtur dhe e druajtur, duke u zhytur në lexime librash dhe duke ngulur sytë pa mbarim në bimë dhe lule të ndryshme, sikur të donte t'i shihte duke u rritur, ndërsa, nganjëherë — papritur dhe pa ndonjë arsye të dukshme — gjallërohej përsëri, duke derdhur një lumë fjalësh, herë-herë, pa lidhje me njëra-tjetrën. Në këto periudha, Silia dukej të kishte një energji të jashtëzakonshme. Pastaj, në një mënyrë po aq të papritur, energjia zhdukej, duke e lënë të ligështuar dhe përsëri të mbyllur në vetvete. Dhe, ndërkohë, komunikimi dhe lidhjet e ngushta midis tyre dobësoheshin.

Kishte qenë pikërisht në atë kohë — dhe duke e menduar i erdhi turp përsëri — që ai kishte propozuar të ndaheshin. Silia ishte dukur shumë e tronditur dhe ai e kishte lënë një herë këtë punë, duke shpresuar se gjendja do të përmirësohej, por s'kishte ndodhur ashtu.

Vetëm më vonë, kur, pothuajse rastësisht, kishte menduar se ndoshta Silia kishte nevojë për ndihmën e një psikiatri dhe ishte konsultuar me një të tillë, ishte dukur qartë e vërteta mbi kushtet e saj mendore. Gjatë një kohe të shkurtër, ankthi dhe shqetësimet i kishin dhënë njëfarë rigjallërimi dashurisë së tij. Mirëpo, tanimë, ishte tepër vonë.

Nganjëherë, ai mendonte se, ndoshta, kishte qenë vonë që në fillim; ndoshta s'do të kishte sjellë dobi as edhe një qëndrim më i dashur dhe një mirëkuptim më i madh. Mirëpo, këtë ai s'mund ta dinte. Ai s'do të arrinte kurrë ta bindte veten se kishte bërë gjithçka që mund të bëhej dhe, prandaj, nuk do të ishte kurrë në gjendje ta zhdukte mendimin se ishte fajtor, mendim që e mundonte pa pushim.

— Duket se të gjithë, pa përjashtim, mendojnë vetëm për paratë — si t'i prishin, t'i marrin hua, t'i japin hua, megjithëse në këtë s'ka ndoshta asgjë të re dhe pikërisht për këtë janë bankat. Mirëpo, dje ndodhi një gjë e trishtuar. Ben Roseli, presidenti ynë, na tha se s'i mbetej edhe shumë për të jetuar. Ai organizoi një mbledhje dhe ...

Aleksi vazhdoi, duke përshkruar skenën në sallën e këshillit administrativ dhe reagimet që e ndoqën; pastaj, u ndal menjëherë.

Silia kishte filluar të dridhej. Trupi i luhatej sa para, mbrapa. Nga goja i dilte njëfarë rënkimi, gati si një vajtim.

Mos e kishin tronditur ato që kishte treguar ai për bankën? *Banka, ku ai kishte derdhur energjitë e tij, duke e thelluar në atë mënyrë hendekun e tyre. Në të vërtetë, në atë kohë ishte fjala për një bankë tjetër, Rezerva Federale, por për Silian bankat njësoj ishin*. Apo mos shkaku kishin qenë fjalët e tij lidhur me vdekjen e afërt të Ben Roselit?!

Beni do të vdiste së shpejti. *Edhe sa vjet akoma do të jetonte Silia? Ndoshta edhe shumë të tjerë.*

Aleksi mendoi: «Ka shumë mundësi të më përcjellë dhe mua; të vazhdojë në këtë gjendje edhe për kushedi sa kohë akoma.»

«Ka pamjen e një kafshe!»

Keqardhja, që kishte ndier gjer në atë çast, ishte zhdukur. Ai u pushtua nga zemërimi; nga zemërngushtësia idhnake që kishte shkatërruar martesën e tyre.

— Për hir të perëndisë, Silia, mundohu ta mbash veten!

Dridhja dhe rënkimet e saj vazhdonin.

Ai e urrente! Ajo s'ishte më një qenie njerëzore, por megjithatë ajo mbetej akoma pengesa midis atij dhe një jete të plotë.

Aleksi u ngrit vrullshëm nga kolltuku dhe shtypi me nervozizëm në mur butonin e një zileje, duke e ditur se do të vinin menjëherë për të ndihmuar. Me të njëjtën lëvizje, u drejtua me hapa të mëdhenj drejt derës, për t'u larguar. Hodhi sytë mbrapa, nga Silia — e shoqja, të cilën dikur e kishte dashur; në atë që ishte katandisur tani; në hendekun e thellë që ishte hapur midis atyre të dyve, që s'do ta mbushnin kurrë më. U ndal dhe shpërtheu në lot.

Qau nga keqardhja, trishtimi, ndenja e fajit. Zemërimi i çastit ishte zhdukur, urrejtja ishte shuar.

U afrua përsëri te divani dhe, duke rënë në gjunjë para saj, iu lut:

Silia, më fal! Oh, zot, më fal!

Ndjeu në sup prekjen e lehtë të një dore dhe dëgjoi zërin e infermieres së re:

— Zoti Vandervurt, mendoj se është më mirë të shkoni tani.

— Ujë apo selc, Aleks?

— Selc.

Dr. Mekartni mori një shishe nga frigoriferi i vogël i studios së tij dhe e hapi. Derdhi pak selc në një gotë që kishte mjaft uiski, dhe i shtoi akull. Ia solli gotën Aleksit dhe pastaj shtiu selcin që kishte mbetur në gotën e vet, pa liker.

Ndonëse gjatë — një metër e nëntëdhjetë, me gjoksin dhe shpatullat e një lojtari ragbie dhe duar shumë të mëdha — lëvizjet e tij ishin mjaft të shkathëta. Megjithëse i ri (Aleksi mendonte të ishte nja tridhjetë vjeç), qëndrimi dhe zëri i tij dukeshin si ato të një burri më të vjetër dhe, flokët gështenjë kishin filluar t'i thinjeshin në tëmthat. Kishte të ngjarë që kjo të kishte ndodhur, mendoi Aleksi, për shkak të një numri të

madh bisedash si kjo tani. Aleksi piu një gllënjkë uiski, me një ndjenjë mirënjohjeje.

Studioja kishte një ndriçim të ëmbël, ngjyrat më pak të forta se ato të korridorit dhe të lokaleve të tjera. Faqet e mureve ishin veshur me panele dhe njëra prej tyre ishte mbushur plot me rafte librash, ndër të cilët ishin me shumicë vepra të Frojdit, Adlerit, Jungut dhe Roxhersit.

Aleksi ishte akoma i tronditur nga takimi me Silian, ndonëse, në njëfarë mënyre, tmerri i atyre që kishte parë i dukej joreal.

Dr. Mekartni shkoi te një karrige para tryezës së tij të punës dhe e ktheu drejt kanapesë, ku ishte ulur Aleksi.
— Pikë së pari duhet të të them se diagnoza e përgjithshme e gruas sate është gjithnjë e njëjta: skicofreni katatonike. Besoj se të kujtohet që kemi biseduar disa herë për këtë.

— Po, po, më kujtohen të gjitha ato fjalët e mëdha.

— Do të përpiqem të mos përdor të tjera si ato.

Aleksi tundi lehtë gotën që të shkrihej akulli dhe piu një gllënjkë tjetër. Uiski kishte filluar t'i jepte pak ngrohtësi.

— Më thuaj diçka për kushtet e tanishme të Silias.

— Do të jetë e vështirë ta besosh, por gruaja jote, pavarësisht se si duket, është relativisht e lumtur.

— Po, — tha Aleksi, — e kam të vështirë ta besoj këtë.

Psikiatri vazhdoi me ton të qetë:

— Lumturia është një gjë relative për të gjithë njerëzit. Silia ndjen njëfarë sigurie personale, një mungesë të plotë përgjegjësie dhe nevoje për njerëz të tjerë. Ajo mund të mbyllet në vetvete çdo herë që të dojë ose të ndjejë nevojën për një gjë të tillë. Pozicioni që ajo po merr këto kohët e fundit, ai që pe dhe ti, është pozicioni fetal klasik. Marrja e

këtij pozicioni i sjell qetësi mendore, megjithëse ne, për mirëqenien e saj fizike, mundohemi me sa mundemi ta bindim të heqë dorë.

— Mirëqenie apo jo, — tha Aleksi, — fakti është se mbasi iu bënë, për katër vjet, kurat më të mira, kushtet e saj janë duke u keqësuar. — E shikoi në sy drejtorin e Qendrës Klinike dhe shtoi: — Kështu është, apo jo?

— Për fat të keq, ashtu është.

— A ka ndonjë mundësi të arsyeshme që Silia të shërohet, në mënyrë që të mund të bëjë një jetë normale ose gati normale?

— Në fushën e mjekësisë gjithçka është e mundur.

— Thashë mundësi të arsyeshme.

Dr. Mekartni psherëtiu dhe tundi kokën në shenjë mohimi.

— Jo.

— Të falemnderit për sinqeritetit.

Mbas një pauze, Aleksi vazhdoi:

— Atëherë, si përfundim del se Silia është bërë — besoj se kështu thuhet — «mysafire e përhershme». Ajo është tërhequr dhe veçuar nga raca njerëzore. Nuk di më asgjë dhe nuk e vret më mendjen për asgjë që ndodh jashtë botës së saj.
— Ke të drejtë për sa i përket shprehjes «mysafire e përhershme» — tha psikiatri, — por jo për të tjerat. Gruaja jote nuk është tërhequr nga gjithçka, së paku ende jo. Ajo di akoma diçka mbi ato që ndodhin jashtë botës së saj; e di se ka burrë dhe, bile nganjëherë, flasim për ty. Mirëpo, ajo beson se ti je krejtësisht në gjendje të kujdesesh vetë për veten tënde, pa pasur nevojë për ndihmën e saj.
— Kështu që s'interesohet për mua?
— Në përgjithësi, jo.

— Ç'do të ndjente po të mësonte se i shoqi ka bërë ndarjen nga ajo dhe është martuar përsëri?

Dr. Mekartni ngurroi një çast dhe, më në fund tha:
— Kjo do të përbënte për të shkëputjen përfundimtare nga kontakti i dobët që ka akoma me botën e jashtme. Kjo mund ta shtynte në një gjendje marrëzie të plotë.

Gjatë heshtjes që ndoqi këto fjalë, Aleksi u përkul përpara, duke e mbuluar fytyrën me të dyja duart. Pastaj, i hoqi ato dhe ngriti prapë kokën. Me një nuancë ironie në zërin e tij, tha:
— Po qe se kërkon përgjigje pa dorashka, më në fund t'i japin edhe ato.

Psikiatri tundi kokën në shenjë pohimi. Fytyra e tij kishte një shprehje serioze.
— Aleks, me një njeri tjetër nuk do të kisha folur aq hapur. Sidoqoftë, duhet të shtoj se parashikimi im mund të jetë i gabuar.
— Tim, ç'duhet bërë në një rast si ky?
— Është kjo një pyetje retorike, apo do me të vërtetë ta dish?
— Po të kërkoj mendimin tënd profesional. Shënoje në llogarinë time.
— Ç'është kjo fjalë, sonte s'do të kemi punë me llogarinë. — Dr. Mekartni buzëqeshi lehtë dhe, pastaj, tha:
— Pra, po më pyet se ç'duhet të bëjë një njeri në rrethana si tuajat. Së pari, duhet të zbulojë çdo gjë që mundet — siç ke bërë dhe ti. Pastaj, duhet të marrë vendime të mbështetura mbi çka i duket më e mirë dhe e drejtë për të gjithë, duke përfshirë edhe veten e tij. Por që të bëhet gati për të marrë këto vendime, ai duhet të ketë parasysh dy gjëra. Së pari, në rast se është njeri me karakter, ka mundësi që ndjenja e tij e fajit të jetë e tepruar, sepse një ndërgjegje që ka pasur rastin të zhvillohet, zakonisht e ndëshkon veten me më shumë rreptësi se sa lipset. Së dyti, të paktë janë ata njerëz që mund të

pretendojnë se janë shenjtorë. Ne lindim, në pjesën më të madhe, pa i pasur cilësitë e nevojshme.
Aleksi e pyeti:
— Nuk do ta zgjerosh këtë edhe më shumë? Nuk do të flasësh më hapur?
Dr. Mekartni tundi kokën.
— Vetëm ti mund t'i marrësh vendimet e tua. Mund të ecim bashkë për njëfarë kohe, por hapat e fundit duhet t'i bëjmë vetëm.
Psikiatri i hodhi një vështrim orës së tij dhe u ngrit nga karrigia. Ata i shtërnguan dorën njëri-tjetrit dhe u përshëndetën.
Jashtë Qendrës Klinike, Aleksin e priste shoferi dhe vetura e FMA-së, me motorin ndezur, brenda e ngrohtë dhe e rehatshme.
10.

— Pa dyshim, — tha Margot Brekeni, — ky është koleksioni më i ndyrë mashtrimesh dhe gënjeshtrash që kam parë ndonjëherë.
Ajo po i shikonte një e nga një, me trupin të përkulur pak përpara, bërrylat jashtë, me qëndrim agresiv, duart e mbështetura te mesi i hollë dhe kokën e vogël, por me pamje të vendosur, të zgjatur përpara. «Nga ana fizike është provokuese,» — po mendonte Aleks Vandervurti: vajzë me të vërtetë e bukur, me tipare të mprehta, por tërheqëse, mjekrën pak përpara — shprehje vullneti — buzët e holla, gjë që nuk ia pakësonte gojës sensualitetin e saj. Sytë përbënin tiparin më të fortë: të mëdhenj, të gjelbër e larushë, me qerpikë të dendur e të gjatë. Në atë çast, këta po lëshonin shkëndija. Zemërimi dhe energjia e saj e nxitën edhe më shumë dëshirën e Aleksit. Zemërimi i Margotit ishte shkaktuar nga vargu i njoftimeve të

letërkrediteve Kiçarxh, që Aleksi i kishte sjellë në shtëpi nga FMA-ja dhe që, tani, ishin të shpërndara mbi qilimin e dhomës së ndenjies të apartamentit të tij. Nga ana tjetër, prania dhe gjallëria e Margotit i sillnin Aleksit kontrastin që i duhej, pas orëve të lodhshme e të mundimshme që sapo kishte kaluar.

Ai i tha:
— E mora me mend se nuk do të të pëlqenin këto njoftime publicitare.
— Të më pëlqenin! Kam vetëm përbuzje për to!
— Pse?

Ajo i hodhi prapa flokët e saj të gjatë, ngjyrë gështenjë, me një gjest të zakonshëm, por të pandërgjegjshëm. Para një ore, ajo i kishte hequr dhe flakur tutje këpucët dhe, tani, qëndronte në këmbë vetëm me çorape, me tërë gjatësinë e saj prej një metri e gjashtëdhjetëetetë centimetra.

— Shumë mirë, shikoje këtë! — Po tregonte njoftimin publicitar që fillonte me fjalët: «Pse të presësh: që sot mund të bësh realitet ëndrrën e së nesërmes!» — Kjo është një ndyrësirë e pandershme, që synon të fusë në thes leshkot që besojnë çdo gjë që u thuhet, duke u dhënë hua. Ëndrra e së nesërmes duhet të jetë, patjetër, për çdo njeri, një gjë e kushtueshme. Përndryshe nuk do të ishte një ëndërr. Dhe askush nuk mund ta realizojë atë, me përjashtim të rastit që t'i ketë paratë në dorë, ose të jetë i sigurt se do t'i ketë brenda një kohe të shkurtër.

— Por, a nuk duhet të jenë vetë njerëzit e interesuar që të gjykojnë për këtë?

— Jo! Jo njerëzit që janë ndikuar nga këto reklama të çoroditura; njerëzit mbi të cilët ju përpiqeni të ushtroni këtë ndikim. Ata janë njerëz të thjeshtë, që binden me lehtësi; nga ata që besojnë se çdo gjë e shkruar duhet të jetë e vërtetë. E di

unë këtë. Plot nga këta më vijnë si klientë në zyrë, në zyrën time avokatore pak rentabël.

— Ndoshta këta tipa njerëzish nuk janë nga ata që kanë letrat tona Kiçarxh.

— Shiko, Aleks, ti e di mirë se kjo nuk është e vërtetë! Letërkredite kanë sot edhe njerëz që s'të shkon kurrë mendja t'i kenë, sepse ju s'keni lënë gurë pa luajtur për t'u mbushur mendjen njerëzve që të kenë nga ato. E vetmja gjë që s'keni bërë gjer tani është që t'i shpërndani në qoshet e rrugëve dhe nuk do të çuditesha që, së shpejti, ta bëni dhe këtë.

Aleksi buzëqeshi. Ai kënaqej me këto diskutime me Margotin dhe i pëlqente t'i mbante ato të zjarrta.
— Mendim i mirë. Do t'u them bashkëpunëtorëve të mi ta kenë parasysh.
— Ajo që do të dëshiroja unë të mendojnë njerëzit është kamata skllavëruese prej tetëmbëdhjetë për qind që bankat zbatojnë për letërkreditet.
— Kemi folur për këtë dhe herë të tjera.
— Po, kemi folur. Dhe unë s'kam dëgjuar asnjëherë një përgjigje të kënaqshme.
— Ndoshta s'e ke pasur aty mendjen, — ia priti Aleksi. Pavarësisht nëse ishte e këndshme në diskutime apo jo, Margoti kishte zotësinë t'ia acaronte nervat. Nganjëherë, diskutimet e tyre «të këndshme» përfundonin në grindje të vërteta.
— Ta kam thënë dhe më parë se letërkrediti është, si të thuash, diçka me vlera të shumta, pra diçka që të ofron një numër të madh shërbimesh të ndryshme. Po t'i kesh parasysh të gjitha këto shërbime, — nguli këmbë Aleksi — shihet se përqindja jonë e interesit nuk është e tepruar.
— Po, po, e tepruar është, për atë që duhet ta paguajë!
— Askush nuk është i detyruar të paguajë. Ne nuk detyrojmë

njeri të na kërkojë para hua!
— Të dëgjoj shumë mirë. Nuk është nevoja të bërtasësh.
— Në rregull.
Aleksi psherëtiu. Ishte i vendosur të mos e linte atë diskutim të dilte jashtë kontrollit. Veç kësaj, pikëpamjet e Margotit, të cilat qoftë në ekonomi, në politikë, apo në çfarëdo fushe tjetër, ishin të prirura nga e majta, e ndihmonin atë nëpërmjet paraqitjes së tyre pa dorashka dhe mendjes së saj të mprehtë prej juristeje. Profesioni i Margotit e vinte atë në kontakt me një kategori njerëzish, të cilët Aleksi nuk i njihte drejtpërdrejti: të varfrit dhe të braktisurit, që përbënin pjesën më të madhe të klientelës së saj.
Ai e pyeti:
— Një konjak tjetër?
— Po, faleminderit.
Ishte pothuajse ora dymbëdhjetë e natës. Zjarri po shuhej në oxhakun e dhomës së këndshme të ndenjes së atij apartamenti të vogël, por luksoz, prej beqari.
Një orë e gjysmë më parë, ata e kishin ngrënë aty darkën, që u ishte sjellë nga restoranti që ndodhej në katin përdhes të ndërtesës. Darka ishte shoqëruar me një verë bordo shumë të mirë, të zgjedhur nga vetë Aleksi.

Me përjashtim të vendit ku ishin të shpërndara fletët me njoftimet e letrave Kiçarxh, ndriçimi i dhomës ishte i dobët.

Mbasi i mbushi të dyja gotat, Aleksi e vazhdoi bisedën:

— Në qoftë se derdhja për letërkreditet bëhet kur merret njoftimi për pagesën e tyre, nuk paguhet asnjë interes.

— Do të thuash të shlyhet tërë detyrimi?

— Ashtu, pikërisht.

— Por, sa veta e bëjnë këtë? Zakonisht paguhet minimalja e caktuar, apo jo?

— Po, shumica paguajnë vetëm minimumin.

— Dhe pjesën që mbetet e tërheqin nga pas, si hua, gjë që është pikërisht ajo të cilën ju, bankierët, doni që ata të bëjnë, apo jo?

— Po, është e vërtetë, — pranoi Aleksi. — Por edhe bankat duhet t'i nxjerrin diku fitimet e tyre.

— Po, po, patjetër. Ka net që s'më zë gjumi, — tha Margoti, — duke pyetur veten tërë ankth nëse bankat nxjerrin apo jo fitime të mjaftueshme.

Ndërsa ai po qeshte, Margoti vazhdoi me ton serioz:

— Dëgjo, Aleks, ka mijëra njerëz që mbyten në borxhe me afat të gjatë nga përdorimi i letërkrediteve, ndonëse gjendja e tyre nuk u lejon një gjë të tillë. Shpeshherë blejmë vogëlsira, pa ndonjë vlerë të madhe, si artikuj kinkalerie, disqe gramofoni, libra, artikuj ushqimorë, e të tjera si këto. Këtë gjë e bëjmë ashtu, pa u thelluar, edhe sepse është shumë e lehtë të marrësh kredi të vogla. Mirëpo, këto shuma të vogla të marra së bashku, të cilat, po të mos ishin letërkreditet, duhet të paguheshin me para në dorë, përbëjnë një hua të madhe, një barrë të rëndë që këta njerëz të pamatur janë të detyruar ta heqin zvarrë vite me radhë.

Aleksi piu një gllënjkë konjak dhe, pastaj, u ngrit e i hodhi një dru tjetër zjarrit.

— Nuk është një problem kaq i madh, — i tha ai Margotit. — Merakosesh tepër.

Megjithatë, në vetvete, ai pranoi se një pjesë nga ato që kishte thënë Margoti qëndronin. Ndërsa dikur, siç thoshte një këngë e vjetër, ishin minatorët që ia «detyronin deri dhe shpirtin e tyre magazinës së ndërmarrjes», kohët e fundit ishte

krijuar një shtresë e re huamarrësish kronikë, që hipotekonin në mënyrë naive të ardhurat e tyre të ardhshme, vetë jetën e tyre të ardhshme, në favor të «bankës së përzemërt që ishte vetëm dy hapa larg». Njëra nga arsyet ishte se letërkreditet kishin zëvendësuar, në një shkallë të gjerë, sistemin e huave të vogla. Ndërsa dikur, njerëzve u thuhej të mos merrnin huara shumë të mëdha, tani ata vendosnin vetë për këtë gjë, shpeshherë në një mënyrë jo të urtë. Disa vëzhgues, gjë që Aleksi e dinte, ishin të mendimit se kishte qenë pikërisht sistemi i letërkrediteve që e kishte ulur shkallën e moralit amerikan.

Natyrisht, për bankat ishte më e leverdishme të jepnin para hua me anë të letërkrediteve; veç kësaj, me letërkreditet merrej një interes shumë më i lartë se sa me mënyrat e zakonshme. Në fakt, interesi total që merrte banka shpesh ngrihej në njëzet e katër për qind, meqënëse tregtarët që pranonin pagesën me anë të letërkrediteve duhej t'i paguanin bankës një shumë që ngrihej nga dy deri në gjashtë për qind.

Kishte pra arsye të forta se pse banka të rëndësishme, siç ishte Fërst Merkëntaill Emerikën Benku, i jepnin gjithnjë e më shumë rëndësi sektorit të letërkrediteve, për të rritur sa më shumë fitimet e tyre. Sigurisht që, në periudhën fillestare të kësaj pune, disa humbje të konsiderueshme ishin të pashmangshme, gjë që bankierët e quanin «dushi i ftohtë». Por, po këta bankierë ishin të bindur se, së shpejti, do të vinte një periudhë bollëku, mbas së cilës sektori i letërkrediteve do ta kalonte shumë cilindo sektor tjetër përsa i përkiste rentabilitetit.

Një gjë tjetër që e kishin parasysh bankierët ishte se letërkreditet përbënin një etapë të nevojshme në rrugën drejt STEF-it — Sistemit të Transferimit Elektronik të Fondeve — i cili do të zëvendësonte, brenda nja pesëmbëdhjetë vjetësh, morinë e tanishme pa mbarim të shkresurinave të bankës,

duke i bërë çeqet dhe librezat e llogarive të depozituara, të vjetëruara dhe të papërdorshme, siç kishte ndodhur me modelin T të Fordit.

— Mjaft me kaq, — tha Margoti. — Të dy dukemi sikur po bëjmë një mbledhje aksionistësh. — Iu afrua Aleksit dhe e puthi ëmbël në buzë.

Zjarri i diskutimit kishte filluar që më parë ta ndizte Aleksin, siç ndodhte shpeshherë gjatë debateve që kishte me Margotin. Takimi i tyre i parë kishte filluar pikërisht kështu.

Nganjëherë dukej se, sa më shumë zemëroheshin, aq më shumë merrte flakë pasioni i tyre reciprok. Mbas disa çastesh, Aleksi murmuriti:

— Mbledhjen e aksionistëve e deklaroj të mbyllur.

— Mirë... — Margoti u shkëput nga ai, duke e vështruar me djallëzi. — Mbetet akoma punë për t'u bërë... ajo çështja e njoftimeve publicitare, i dashur. Nuk do t'i lësh të arrijnë në atë gjendje në duart e publikut, apo jo?

— Jo. Them se jo.

Publiciteti i seksionit Kiçarxh kishte qenë një zhgënjim i madh, shumë i madh dhe, që të nesërmen në mëngjes, ai do të përdorte autoritetin e tij për ta ndryshuar përmbajtjen e atyre njoftimeve. Ai e dinte se e kishte pasur ndërmend që në fillim ta bënte këtë; Margoti i kishte dhënë vetëm shtytjen vendimtare.

Copa e drurit, që ai kishte vënë pak më parë në zjarr, ishte ndezur dhe po kërciste. Ata u ulën në qilimin përpara oxhakut, duke shijuar ngrohtësinë e tij dhe duke vështruar gjuhët e flakëve që ngriheshin lart.

Margoti e mbështeti kokën te supi i Aleksit dhe tha me ëmbëlsi: — Në të vërtetë, s'je dhe i keq, po të kihet parasysh se je një këmbyes prapanik valutash.

Aleksi e shtrëngoi në krahët e tij.

— Edhe unë të dua, Margot.
— Me të vërtetë? Fjalë bankieri?
— Betohem mbi taksën e skontos.
— Atëherë, më dashuro tani. — Margoti filloi të zhvishej.
Ai pëshpëriti, tërë gaz:
— Si, këtu?
— Pse jo?
Aleksi psherëtiu nga gëzimi.
— Me të vërtetë, pse jo?!
Mbas pak, provoi një ndjenjë çlirimi dhe lumturie, krejt të kundërt me ankthin e asaj pasditeje.
Edhe pastaj, ata ndenjën në krahët e njëri-tjetrit, duke ndier secili ngrohtësinë e trupit të tjetrit dhe, të dy, atë të zjarrit. Më në fund, Margoti u ngrit.
— E kam thënë dhe po e përsëris: je një dashnor me të vërtetë fort i shijshëm.
— Edhe ti je shumë e mirë, Margot, — tha Aleksi. Pastaj, ai shtoi: — A do të rrish këtu sonte?
Ajo e bënte këtë shpeshherë, ashtu sikurse shumë herë edhe Aleksi rrinte te Margoti gjer në mëngjesin e ditës tjetër. Herë pas here thoshin se ishte marrëzi të vazhdonin në atë mënyrë dhe se duhet të jetonin bashkë; por Aleksi ngurronte ta bënte këtë hap, sepse, më parë, donte të martohej me Margotin, me t'iu dhënë mundësia.

— Do të rri dhe pak, — u përgjigj ajo, — por jo tërë natën. Nesër duhet të shkoj herët në gjykatë.

Margoti shkonte shpesh në gjykatë dhe kishte qenë pikërisht në një rast të tillë, para një viti e gjysmë, që ajo ishte takuar me Aleksin. Pak kohë para takimit të tyre të parë, ajo kishte marrë përsipër mbrojtjen e gjashtë pjesëmarrësve në demonstrata, që ishin ndeshur me policinë, gjatë një manifestimi të organizuar për të kërkuar amnisti të plotë për

dezertorët e Vietnamit. Mbrojtja e saj tërë zjarr, jo vetëm e të pandehurve, por edhe e vetë kauzës së tyre, kishte tërhequr shumë vëmendjen e të tjerëve. Dhe po ashtu kishte bërë edhe fitorja e saj — lirimi i të pandehurve nga të gjitha aktakuzat — në fund të procesit.

Mbas disa ditëve, në një koktej që jepej nga Eduina d'Orseji dhe i shoqi, Luisi, në të cilin kishte një numër të madh të ftuarish, Margoti ishte rrethuar nga admirues e kritikë. Ajo kishte shkuar në koktej vetëm. Kështu kishte bërë edhe Aleksi, i cili kishte dëgjuar të flitej për të, por, vetëm më vonë, kishte mësuar se ajo ishte kushërirë e parë e Eduinës. Duke pirë *shramsbergun* e mrekullueshëm të D'Orsejve, ai kishte dëgjuar për një kohë të shkurtër diskutimin e zjarrtë e të përgjithshëm dhe, pastaj, ishte bashkuar me grupin e kritikëve. Pas pak, të tjerët ishin tërhequr, duke e lënë atë dhe Margotin vetëm, si dy gladiatorë të një dyluftimi gojor.

Në atë çast, Margoti kishte pyetur:

— Por, kush djallin jeni ju?

— Një amerikan i zakonshëm, që beson se në ushtri disiplina është e nevojshme.

— Edhe në një luftë imorale si ajo e Vietnamit?

— Ushtari nuk mund të vendosë se ç'është morale e çfarë nuk është. Ai duhet të zbatojë vetëm urdhrat. Përndryshe do të përfundohej në kaos.

— Kushdo qofshi, ju flisni si nazist. Mbas Luftës së Dytë Botërore, ne kemi ekzekutuar gjermanë që mbështeteshin në këtë vijë mbrojtjeje.

— Gjendja ishte krejtësisht e ndryshme. — S'ishte e ndryshme aspak. Në procesin e Nyrenbergut, aleatët theksuan se gjermanët duhej të kishin dëgjuar ndërgjegjen e tyre dhe të mos kishin pranuar t'u bindeshin urdhrave. Kjo është

pikërisht ajo që bënë në Vietnam ata që dëgjuan zërin e ndërgjegjes së tyre dhe dezertorët.

— Ushtria amerikane nuk po asgjësonte çifutët.

— Jo, por vetëm banorë të fshatrave, si në My Lai dhe gjetiu.

— S'ka luftë të pastër.

— Por ajo e Vietnamit ka qenë më e ndyra nga të gjitha, duke filluar nga kryekomandanti e gjer poshtë. Ja sepse shumë amerikanë të rinj, duke treguar një guxim të veçantë, ia vunë veshin ndërgjegjes së tyre dhe nuk pranuan të merrnin pjesë në të.

— Atyre nuk do t'u jepet amnisti e plotë dhe pa kushte.

— Por kjo u takon me të drejtë. Sidoqoftë, do ta sigurojnë me kohë, kur të mbizotërojë arsyeja e shëndoshë.

Ishin akoma duke diskutuar me pasion, kur Eduina kishte ndërhyrë dhe i kishte njohur. Më vonë, kishin filluar prapë të diskutonin mbi të njëjtin argument dhe e kishin vazhduar atë në veturën e Aleksit, kur ky po e shpinte në apartamentin e saj. Atje, në një çast, gati sa s'kishin përfunduar në goditje, por, përkundrazi, papritur kishin zbuluar se dëshira fizike zhdukte çdo gjë tjetër dhe kishin rënë në krahët e dashurisë tërë zjarr e pasion, duke kuptuar befas se në jetën e tyre kishte hyrë diçka e re dhe themelore.

Më vonë, si rrjedhojë e kësaj ngjarjeje, Aleksi i kishte përmbysur pikëpamjet e tij, dikur të patundshme, duke kuptuar — siç kishte ndodhur edhe me të moderuar të tjerë të zhgënjyer — talljen boshe që përmbahej në fjalët «paqe me nder» të shpallur nga Niksoni. Dhe më pas, kur po fillonin të dilnin në dritë çështja Uotergejt dhe poshtërsitë e lidhura me të, ishte bërë e qartë se ata që mbanin postet më të larta në qeveri — që kishin deklaruar: «Asnjë amnisti!» — ishin fajtorë

për poshtërsira shumë më të mëdha se cilido dezertor i Vietnamit.

Mbas këtij rasti të parë, kishte pasur edhe raste të tjera, kur argumentimet e Margotit kishin zgjeruar ose ndryshuar pikëpamjet e tij. Tani, në dhomën e fjetjes së apartamentit të tij, Margoti mori një këmishë nate nga një sirtar që Aleksi e kishte lënë vetëm për t'u përdorur nga ajo. Mbasi e veshi, e mbylli dritën.

Ata ndenjën pak në heshtje, duke shijuar afërsinë e tyre në dhomën e errët. Pastaj, Margoti tha:

— Shkove sot te Silia, apo jo?

Aleksi u kthye nga ajo, i habitur:

— Po ti, nga e di?

— E kuptova menjëherë. Çdo herë ta tregon fytyra. — Dhe shtoi: — A do të flasësh për këtë?

— Po, — tha ai, — besoj se po.

— E ndjen akoma veten si fajtor, apo jo?

— Po. — Aleksi i tregoi asaj për takimin me Silian, bisedën që kishte pasur pastaj me dr. Mekartnin dhe mendimin e psikiatrit për efektin që mund të kishin mbi Silian ndarja dhe një martesë tjetër e tij.

Margoti tha me ton energjik:

— Atëherë, nuk duhet ta bësh ndarjen.

— Po të mos e bëj, — tha Aleksi, — nuk mund të ketë asgjë përfundimtare ndërmjet teje dhe meje.

— Pa tjetër që do të ketë! Ta kam thënë me kohë: gjendja do të jetë përfundimtare në atë masë sa vetë ne do të duam të jetë e tillë. Martesa nuk është më një gjendje përfundimtare.

Kush beson sot te martesa, me përjashtim të një grushti peshkopësh pleq?

— Unë besoj, — ia priti Aleksi, — aq sa ta dëshiroj për ne të dy.

— Atëherë, le ta bëjmë këtë martesë, sipas mënyrës sonë. Unë s'kam nevojë, i dashur, për një copë letër që dëshmon se jam e martuar. Tanimë jam aq e mësuar me copa letrash të tilla saqë s'më bëjnë më përshtypje. E kam thënë një herë se dua të jetoj me ty dhe, këtë gjë, do ta bëj me gëzim e dashuri. Por s'dua të kem, ose të di që e ke ti, brejtjen e ndërgjegjes, se kam flakur në një pus pa fund atë pak gjë që mbetet nga ekuilibri mendor i Silias.

— E di, e di. Të gjitha këto që thua janë të drejta. — Por fjalëve të Aleksit u mungonte toni i bindjes.

Margoti psherëtiu me ëmbëlsi:

— Kjo gjendje që ekziston midis nesh më bën më të lumtur nga ç'kam qenë ndonjëherë në jetën time. Ti je ai që do më shumë se kaq, jo unë.

Aleksi psherëtiu gjithashtu, dhe, mbas pak, e zuri gjumi.

Kur qe e sigurt se ai po flinte mirë, Margoti u ngrit, u vesh, e puthi lehtë Aleksin dhe doli nga apartamenti.

11.

Ndryshe nga Aleks Vandervurti, Rosko Hejuordi e kaloi tërë natën në vetmi.

Por edhe tani, ai nuk po flinte ende.

Ishte në shtëpinë e tij, në banesën e tij ekstravagante me tri kate, që ndodhej në lagjen Shejker Hajts. Ishte ulur te një tryezë pune, të veshur me lëkurë në faqen e sipërme, dhe që tani ishte plot letra e shkresurina, në një dhomë të vogël, të mobiluar me njëfarë shije të matur, që i shërbente si studio.

E shoqja, Beatrisa, kishte gati dy orë që ishte ngjitur për të fjetur në katin e sipërm, në dhomën e saj të gjumit, derën e së cilës e kishte kyçur, siç bënte që prej dymbëdhjetë vjetëve, që kur kishin vendosur të flinin në dhoma gjumi të veçanta.

Hejuordi s'e kishte ndier veten asnjëherë të fyer nga fakti që ajo e mbyllte derën me kyç — ndonëse ky ishte një veprim tipik autoritar. Marrëdhëniet e tyre seksuale kishin filluar të pakësoheshin shumë kohë më parë se të merrej ky vendim, deri sa kishin përfunduar në zero.

Sa herë që Hejuordi ndodhej mendohej për këtë, ai arrinte në përfundimin se kjo ndërprerje e marrëdhënieve të tyre seksuale kishte qenë dashur nga Beatrisa. Që në vitet e para të martesës së tyre, ajo kishte shfaqur neverinë e saj mendore për këto marrëdhënie, ndonëse trupi i saj e ndjente herë pas here nevojën e tyre. Dukej sikur thoshte se, herët a vonë, forca e saj e vullnetit do ta zhdukte krejt atë nevojë aq të neveritshme. Dhe, në fakt, ashtu kishte ndodhur. Dy a tri herë, në rastet e rralla të një humori tekanjoz, Hejuordit i kishte vajtur mendja se djali i tyre i vetëm, Elmeri, pasqyronte qëndrimin e Beatrisës përsa i përkiste mënyrës se si ishte krijuar dhe lindur — si një dhunim arbitrar dhe poshtërues i intimitetit të saj trupor. Elmeri, që tani po u afrohej të tridhjetave, ekspert për çështje tregtare, shprehte mospëlqimin e tij pothuajse për çdo gjë dhe kalonte shkarazi në rrugën e jetës, si të thuash, duke i zënë hundët, për të mos ndier erën e keqe. Nganjëherë, edhe vetë Roskoi ishte i mendimit se Elmeri deri diku e tepronte.

Nga ana e tij, Hejuordi e kishte pranuar, pa protestuar, mungesën e marrëdhënieve seksuale me të shoqen, pjesërisht sepse, para dymbëdhjetë vjetëve, seksi ishte bërë për të diçka jo e domosdoshme dhe, pjesërisht, sepse ambicia në karrierën e tij bankare ishte bërë tanimë nxitja dhe forca shtytëse kryesore në jetë. Dhe kështu, si një makinë që nuk përdoret,

dëshirat e tij seksuale ishin venitur. Vetëm rrallëherë ndodhte që ato të kishin njëfarë rigjallërimi — por edhe në këto raste ishte fjala për një rigjallërim jo të vrullshëm — që i sillnin ndërmend, me njëfarë trishtimi, një periudhë të jetës së tij, mbi të cilën kishte rënë perdja shumë shpejt.

Por Hejuordi pranonte se, në anë të tjera, Beatrisa kishte qenë e dobishme për të. Ajo rridhte nga një familje shumë në zë nga Bostoni dhe, në moshën e duhur, kishte filluar të dilte në jetën shoqërore. Ajo e kishte njohur Roskonë e ri, me doreza të bardha dhe me trupin si të ngrirë në frakun e tij, pikërisht në ballon e fillestareve. Më vonë, ata kishin dalë bashkë, por gjithnjë me një shoqëruese dhe, mbas një periudhe të arsyeshme kohe që kishin kaluar si të fejuar, ishin martuar, dy vjet mbas takimit të tyre të parë.

Në martesën e tyre, të cilën Hejuordi e kujtonte me një ndjenjë krenarie, kishte marrë pjesë ajka e shoqërisë së Bostonit.

Beatrisa kishte qenë gjithnjë e një mendjeje me Roskonë përsa i përkiste rëndësisë së pozitës shoqërore. S'kishte kursyer asnjë përpjekje për ta siguruar këtë, duke shërbyer në radhët e Bijave të Revolucionit Amerikan dhe, tani, ishte sekretare e përgjithshme e kësaj organizate për të gjithë vendin. Roskoi ishte krenar për këtë funksion dhe shumë i kënaqur për kontaktet shumë të vlefshme që rridhnin prej tij. Vetëm një gjë i kishte munguar Beatrisës dhe familjes së saj të dëgjuar — paratë. Në atë çast, sikurse edhe në shumë raste të tjera, Rosko Hejuordit i vinte keq që s'kishte për grua një trashëgimtare.

Problemi kryesor i Roskoit dhe Beatrisës ishte, siç kishte qenë gjithmonë, si t'ia dilnin në krye vetëm me rrogën e tij.

Atë vit, siç tregonin shifrat, me të cilat Roskoi kishte punuar tërë mbrëmjen, shpenzimet e tyre do t'i kalonin shumë të ardhurat. Në prillin e ardhshëm, atij do t'i duhej të kërkonte një hua, për të paguar taksat, ashtu siç kishte ndodhur para një

viti, si dhe dy vjet më parë. Bile, çdo vit, përveçse në ato vite kur bënte ndonjë investim të mbarë.

Mjaft njerëz, me të ardhurha shumë më të vogla, do të qeshnin duke dëgjuar se rroga prej 65.000 dollarësh në vit e një zëvendës-drejtori të përgjithshëm banke, nuk mjaftonte për të jetuar mirë dhe, bile, për të vënë diçka mënjanë. Por, në fakt, për Hejuordin nuk mjaftonte.

Pikë së pari, taksat mbi të ardhurat përpinin më se një të tretën e shumës së përmendur. Pastaj, hipotekat e gradës së parë e të gradës së dytë mbi shtëpinë kërkonin pagesa që kapnin një shumë tjetër prej 16.000 dollarësh në vit, ndërsa taksat bashkiake thithnin dhe 2.500 dollarë të tjerë. Kështu, mbeteshin 23.000 dollarë — rreth 450 dollarë në javë — për të gjitha shpenzimet e tjera, duke përfshirë mirëmbajtjen, sigurimet, ushqimin, veshmbathjen, një veturë për Beatrisën (banka i siguronte Roskoit një veturë me shofer çdo herë që ai kishte nevojë), kujdestaren e shtëpisë që ishte njëkohësisht dhe kuzhiniere, dhuratat për shoqatat mirëbërëse, si edhe një varg shumë të gjatë shpenzimesh të tjera më të vogla, të cilat, të gjitha së bashku, kapnin një total tmerrësisht të lartë.

Shtëpia, siç e mendonte gjithnjë Hejuordi në çaste të tilla, përbënte një luks të tepruar. Që në fillim, ajo kishte qenë më e madhe se sa u duhej atyre, edhe kur Elmeri jetonte me ta. Vandervurti, rroga e të cilit ishte e njëjtë me të tijën, ishte treguar më i mençur dhe kishte marrë me qira një apartament. Mirëpo, Beatrisa e pëlqente atë shtëpi për shkak të madhësisë së saj dhe prestigjit që u sillte, s'donte aspak të dëgjonte të flitej për një zgjidhje të tillë, por as edhe Roskoi nuk e përkrahte atë.

Si përfundim, duheshin bërë shkurtime në këto apo ato shpenzime, gjë që shpeshherë, Beatrisa nuk donte ta kuptonte, duke u nisur nga mendimi se ishte e drejta e saj të kishte para dhe se, ta mërzisje me një gjë si kjo, ishte një krim i pafalshëm. Qëndrimi i saj pasqyrohej në qindra mënyra në

jetën e përditshme familjare. Në tavolinën e bukës nuk lejonte të dëshmoheshin dy herë të njëjtat peceta; të pastra ose jo, ato duheshin dërguar në pastërti mbas çdo përdorimi. E njëjta gjë ndodhte edhe me peshqirët dhe, si përfundim, pagesat për larjet dhe hekurosjet ishin të mëdha. Shpeshherë bënte biseda të largëta telefonike dhe rrallë denjonte t'i mbyllte dritat. Para disa çastesh, Hejuordi kishte shkuar në kuzhinë për të marrë një gotë qumësht: të gjitha dritat e katit të poshtëm ishin të ndezura, megjithëse kishte dy orë që Beatrisa kishte shkuar të flinte. Ai i kishte mbyllur me nervozizëm çelësat e dritave njërin pas tjetrit.

Sidoqoftë, pavarësisht nga qëndrimi i Beatrisës, faktet ishin fakte dhe kishte gjëra që Hejuordët nuk mund t'i bënin. Për shembull, pushimet. Kishte dy vjet që nuk shkonin gjëkundi. Verën e mëparshme, Roskoi u kishte thënë kolegëve të tij në bankë: «Menduam të bënim një shëtitje në Mesdhe, por, pastaj, preferuam të rrinim në shtëpi.»

Një realitet tjetër i pakëndshëm ishte se ata nuk kishin fare para mënjanë — me përjashtim të një numri aksionesh të FMA-së, që kishte të ngjarë t'i shisnin brenda një kohe të shkurtër, ndonëse shuma që do të merrnin nuk do të ishte e mjaftueshme për të mbuluar deficitin e vitit në vazhdim.

I vetmi përfundim, në të cilin arriti Hejuordi atë mbrëmje ishte se, mbasi të merrnin huanë, ata duhej t'i pakësonin sa më shumë shpenzimet, duke shpresuar në një përmirësim të gjendjes së tyre ekonomike.

Dhe një përmirësim i tillë — më se i kënaqshëm — do të bëhej shpejt, në rast se ai do të emërohej president i FMA-së.

Në Fërst Merkentajll Ëmerikën Benk, sikurse në bankat e tjera, kishte një ndryshim të ndieshëm pagese ndërmjet postit të presidentit dhe postit që vinte menjëherë pas tij. Ben Roseli

merrte 130.000 dollarë në vit. Ishte e qartë se edhe pasardhësi i tij do të merrte po aq.

Po të ndodhte kështu, kjo do të sillte dyfishimin e menjëhershëm të rrogës së tij të tanishme. Edhe sepse do t'i duhej të paguante taksa më të mëdha, shuma neto që do t'i mbetej do të mjaftonte për të zgjidhur çdo problem që kishte tani.

Duke hequr letrat, ai filloi të ëndërrojë për këtë mundësi, një ëndërr kjo që zgjati tërë natën.

E premte në mëngjes.
Në banesën e tyre, në katin më të lartë të Kullës Kaiman, një grataçiel me apartamente banimi, që ishte i modës dhe ndodhej nja dy kilometra jashtë qytetit, Eduina dhe Luis d'Orseji po hanin mëngjesin.

Kishin kaluar tri ditë që nga njoftimi i Ben Roselit mbi vdekjen e tij të afërt dhe, dy ditë nga zbulimi i zhdukjes së shumës së rëndësishme nga arka e degës kryesore të Fërst Merkentajll Ëmerikën Benkut. Nga të dyja këto ngjarje, ajo që e shqetësonte Eduinën më shumë në atë çast, ishte e dyta.

Asgjë e re nuk kishte dalë në dritë që prej të mërkurës pasdite. Gjatë gjithë ditës së enjte dy agjentë të posaçëm të FBI-së kishin marrë në pyetje, në mënyrë të hollësishme dhe intensive, personelin e degës së bankës, por pa arritur në rezultate konkrete. Arkëtarja, Huanita Nunjezi, mbetej akoma e dyshimta kryesore, por ajo s'kishte pranuar asgjë dhe vazhdonte të ngulte këmbë se ishte e pafajshme dhe të mos pranonte t'i nënshtrohej provës së makinës së të vërtetës.

Natyrisht, mospranimi i saj i shte shtonte edhe më shumë dyshimet; por, njëri nga agjentët e FBI-së i kish thënë Eduinës: «Mund të dyshojmë për të sa të duam, por s'kemi as provën më të vogël. Përsa u përket parave, edhe po të jenë fshehur në shtëpinë e saj, duhet të kemi ndonjë gjë konkrete që të mund të marrim një urdhër kontrolli. Dhe gjë konkrete nuk kemi. Sigurisht, do ta mbajmë nën vëzhgim, por, në raste

të kësaj natyre, FBI-ja nuk mund të sigurojë një mbikëqyrje të vazhduar.»

Agjentët e FBI-së do të vinin përsëri atë ditë, ndonëse tanimë dukej se s'kishin ç'të bënin tjetër.

Por banka mund të bënte diçka tjetër dhe, këtë do ta bënte: të pushonte nga puna Huanita Nunjezin. Eduina e dinte se, atë ditë, duhet ta bënte këtë. Por ajo e dinte, gjithashtu, se kjo ishte një masë e padobishme, e pakënaqshme.

U shkëput për një çast nga këto mendime, mbasi shërbyesja kishte sjellë mëngjesin — vezë të rrahura dhe fugace angleze të thekruara. Përballë saj, Luisi, prapa gazetës «Uoll Strit Zhurnëll», po llomotiste, siç bënte zakonisht, për marrëzinë e fundit të Uashingtonit, ku një nënsekretar i Thesarit kishte deklaruar para një komisioni të Senatit se Shtetet e Bashkuara nuk do të ktheheshin kurrë më në sistemin monetar të arit. Duke huazuar një shprehje të Keinesit, ai e kishte përcaktuar arin: «kjo mbeturinë e verdhë e një të kaluare barbare». Ai pohonte se ari e kishte kaluar kohën e tij, si mjet këmbimi ndërkombëtar.

— O zot, gjer ku mund të arrijë injoranca!

Ndërsa sytë i lëshonin shkëndija zemërimi nëpërmjet lenteve të syzeve me rrathë çeliku, Luis d'Orseji e flaku gazetën në dysheme, që t'u bënte shoqëri gazetave «Nju Jork Tajms», «Çikago Tribjun» dhe gazetës së Londrës «Fajnênshëll Tajms» të ditës së mëparshme, të cilave u kishte hedhur një sy të shpejtë.

Pesë shekuj mbasi të jenë kalbur dhe bërë pluhur kafshë si ai, ari do të vazhdojë akoma të përbëjë, në tërë botën, të vetmen bazë të shëndoshë për sistemin monetar! Me idiotë të tillë në pushtet, s'mund të kemi absolutisht asnjë shpresë.

Luisi kapi filxhanin e kafesë, e ngriti drejt fytyrës së tij të thatë e të zymtë, piu një gllënjkë dhe, pastaj, fshiu buzët me pecetë.

Eduina ngriti sytë nga gazeta «Krisçën Sajens Monitër», që po shfletonte.

— Sa keq që, mbas pesë shekujve, ti nuk do të jesh më gjallë që të mund të deklarosh: «Ta pata thënë!»

Luisi ishte shtatvogël, i thatë si stekë bilardoje; të jepte përshtypjen sikur të ishte i brishtë dhe gjysmë i vdekur nga urija, por nuk ishte ashtu. Fytyra e tij, në harmoni me trupin, ishte e thatë, gati si e një kufome. Lëvizjet e tij ishin të shpejta dhe zëri, në më të shumtën e rasteve, kishte një tingull padurimi. Herë pas here, Luisi bënte shaka me trupin e tij të vogël. Duke qëlluar ballin, thoshte: «Atë që natyra ua ka hequr muskujve të mi, e ka futur këtu brenda.»

Dhe ishte e vërtetë. Këtë e pranonin edhe kundërshtarët e tij. Ai ishte një kokë e madhe, veçanërisht për çështjet që kishin të bënin me paratë e financën.

Eduina nuk mërzitej me këto shpërthime zemërimi të të shoqit, në mëngjes. Së pari, në katërmbëdhjetë vjet martesë, ajo kishte mësuar se rrallë ndodhte që ato t'i drejtoheshin asaj; së dyti, e dinte se Luisi po kurdisej për artikullin që do të shtypte paradite në makinë, ku do të shante e mallkonte si një Xheremi 1) i mbushur plot me indinjatë të shenjtë, ashtu siç e donin të ishte lexuesit e buletinit të tij financiar, që dilte dy herë në muaj.

Ky buletin i shtrenjtë, që përmbante këshillat financiare të Luis d'Orsejit, drejtuar një numri të madh abonentësh në vende të ndryshme të botës, i siguronte Luisit njëkohësisht të ardhura të mira, si edhe një heshtë, që ai e kishte në dorë, për ta hedhur kundër qeverive, presidentëve, kryeministrave dhe politikanëve të ndryshëm, sa herë që nuk i pëlqenin veprimet

e tyre në lëmin ekonomik, gjë që ndodhte pothuajse gjithmonë.

Shumë afaristë që vepronin sipas teorive ekonomike moderne, duke përfshirë edhe disa funksionarë të Fërst Merkëntaill Emerikën Benkut, e përbuznin këtë buletin të pavarur, agresiv, ultrakonservator. Por, sigurisht, nuk bënin kështu abonentët entuziastë, të cilët e konsideronin Luisin si një kombinim të Moisiut dhe Medesë, në një periudhë kur sundonin ekonomistë të marrë.

Dhe kishin të drejtë, mendonte Eduina. Për ata që synonin vetëm të bënin para, Luisi ishte pikërisht njeriu, kështillat e të cilit duheshin ndjekur. Ai e kishte provuar këtë shumë herë me kështillat e tij çudibërëse, që i kishin shpërblyer bujarisht ata që i kishin ndjekur. Ari ishte një nga shembujt e shumtë. Midis talljeve dhe të qeshurave të përgjithshme, Luis d'Orseji kishte parashikuar një rritje shumë të rëndësishme të kuotës së arit në tregun e lirë. Ai kishte këshilluar gjithashtu blerjen me shumicë të aksioneve të minierave të arit të Afrikës së Jugut, kuotat e të cilave ishin në atë kohë të ulëta. Mbasi u ngrit çmimi i arit, një numër abonentësh të buletinit «D'Orsej» kishin shkruar për të njoftuar se, falë këshillave të tij, ata ishin bërë milionerë.

Me të njëjtën mprehtësi, ai kishte parashikuar gjithashtu vargun e gjatë të zhvlerësimeve të dollarit të SHBA-së, duke i këshilluar lexuesit e tij që ta kthenin të gjithë shumën që dispononin në valuta të tjera, veçanërisht në franga zvicerane dhe marka gjermane. Shumë nga ata e kishin bërë këtë, duke siguruar fitime të mëdha.
Në numrin e fundit të buletinit «D'Orsej», Luisi kishte shkruar: *«Dollari i SHBA-së, dikur një monedhë krenare dhe e nderuar, është duke dhënë shpirt, sikurse edhe vendi që ai përfaqëson. Nga pikëpamja financiare, Amerika e ka kaluar pikën, nga e cila nuk mund të kthehesh më. Falë ligjeve të marra fiskale, të menduara nga një numër politikanësh të paaftë dhe të korruptuar, që vrasin mendjen vetëm*

për veten e tyre dhe që të zgjidhen përsëri, tani gjendemi në mes të një katastrofe financiare, e cila mundet vetëm të keqësohet.

Duke qenë se qeveritarët tanë janë batakçinj e budallenj dhe publiku, i bindur, rri e vështron, pa luajtur as gishtin e vogël, ka ardhur koha që, në fushën financiare, të niset vrapi drejt barkave të shpëtimit! Çdo njeri (burrë ose grua) duhet të kujdeset për veten e vet!

Në rast se keni dollarë, mbani aq sa duhen për të paguar taksinë, ushqimin dhe pullat e postës, si edhe për çmimin e një bilete avioni, për të shkuar në ndonjë vend më të lumtur.

Në fakt, investues i urtë është ai që largohet nga Shtetet e Bashkuara dhe vendoset në një vend tjetër, duke hequr dorë nga shtetësia amerikane. Neni 877 i Kodit të Procedurës Fiskale thotë që, po qe se një qytetar i SHBA-së heq dorë nga shtetësia për të mos paguar tatimet mbi të ardhurat dhe zyra e financës mund ta vërtetojë këtë, ai duhet t'i paguajë prapësesrapë tatimet. Mirëpo, për ata që i dinë mirë këto punë, ka plot mënyra të ligjshme për t'iu shmangur kësaj pagese (Shih buletinin «D'Orsej» të qershorit të vitit të kaluar, se si mund të bëhesh ish-qytetar amerikan. Çmimi i një kopjeje: 16 dollarë, ose 30 franga zvicerane).

Shkaku për të cilin ia vlen të ndërrohet shtetësia është se vlera e dollarit të SHBA-së vazhdon të bjerë, së bashku me lirinë ekonomike të vetë amerikanëve.

Edhe në qoftë se personalisht nuk mund të largoheni jashtë shtetit, transferoni paratë tuaja përtej oqeanit. Sa kohë që është akoma e mundur (kjo mund të mos vazhdojë edhe për shumë kohë!), i shndërroni dollarët tuaj në marka gjermane, franga zvicerane, fjorina holandeze, shilinga austriake, rande jugafrikane.

Pastaj, i depozitoni këto para sa më larg kthetrave të burokratëve amerikanë, në një bankë evropiane, veçanërisht zvicerane...»

Kishte vite që Luis d'Orseji kishte sugjeruar, me mjaft bujë, rrugë të ndryshme për t'u ndjekur në këtë çështje. Buletini i tij, në numrin e fundit, vazhdonte me të njëjtin ton dhe mbyllej

me një numër këshillash lidhur me investimet. Natyrisht, asnjëra prej tyre nuk duhej bërë me monedhë të SHBA-së.

Një tjetër veprim që e kishte zemëruar sa s'bëhet Luisin kishte qenë shitja në ankand e sasive të mëdha të arit nga Thesari amerikan. «Mbas një brezi, — kishte shkruar ai, — kur amerikanët do të jenë zgjuar dhe do të kenë kuptuar se pasuria e tyre kombëtare është shitur me çmime të rëndomta, për t'i bërë qejfin mendjemadhësisë së zbrazët të teoricienëve të Uashingtonit, përgjegjësit e këtij veprimi do të damkosen si tradhtarë dhe do të mallkohen në shekuj.»

Për këtë pohim të Luisit ishte folur shumë në Evropë, por shtypi amerikan s'e kishte përmendur fare.

Tani, në tryezën e bukës, Eduina po vazhdonte leximin e gazetës «Monitër». Një artikull thoshte se Dhoma e Deputetëve po shqyrtonte një projekt-ligj për uljen e përqindjes së shlyerjes me këste të tatimeve mbi pasuritë e patundshme. Një masë e tillë mund të kishte ndikim mbi dhënien e hipotekave nga ana e bankave, prandaj ajo e pyeti Luisin mbi mundësinë që projekt-ligji të miratohej dhe të bëhej ligj.

— Asnjë! — ia priti ai shkurt. — Edhe në qoftë se do të miratohej nga Dhoma e Deputetëve, do të hidhej poshtë nga Senati. Dje, u telefonova dy senatorëve. As që duan ta marrin seriozisht një gjë të tillë.

Luisi kishte një numër jashtëzakonisht të madh miqsh dhe të njohurish, gjë që përbënte një nga arsyet e shumta të sukseseve të tij. Veç kësaj, ai ishte gjithnjë në dijeni të çdo gjëje që kishte të bënte me taksat, duke i informuar lexuesit e tij për çdo gjendje, të cilën mund ta shfrytëzonin në përfitim të tyre.

Vetë ai, ndonëse totali i të ardhurave të tij përfaqësohej me një numër me shtatë shifra, paguante çdo vit një tatim krejt simbolik mbi të ardhurat. Ai lëvdohej me krenari se kjo

shumë nuk ngrihej kurrë në më shumë se disa qindra dollarë. Këtë përfundim e arrinte duke përdorur të gjitha mënyrat e mundshme për t'iu shmangur taksave — investime në kërkime nafte, blerje pasurish të patundshme, shfrytëzime pyjesh, bujqësi, shoqëri me detyrime të kufizuara të anëtarëve të tyre, tituj të thesarit, të përjashtuar nga taksat. Të gjitha këto e lejonin të shpenzonte me të dyja duart dhe të jetonte në luks e në bollëk të madh, ndonëse — në letër — çdo vit e mbyllte me deficit.

Sidoqoftë, të gjitha këto mënyra veprimi ishin të ligjshme. «Vetëm budallenjtë e mbajnë të fshehtë shumën e të ardhurave të tyre, ose përpiqen të mashtrojnë në mënyra të tjera lidhur me taksat, — deklaronte shpesh Luisi. — Pse të rrezikohesh, kur rrugët e ligjshme për t'u bërë bisht atyre janë më të shumta se vrimat e djathit sviceran? E gjithë puna është të kuptosh se si funksionojnë ato dhe të kesh iniciativë të mjaftueshme për t'i përdorur në praktikë.»

Mirëpo, gjer në atë kohë, vetë ai nuk e kishte vënë në zbatim një nga këshillat e veta — të shkonte për të jetuar përtej oqeanit dhe të hiqte dorë nga shtetësia amerikane. Ndërkaq, ai e urrente Nju Jorkun, ku dikur kishte jetuar dhe punuar, dhe që tani e quante «strofkë të neveritshme banditësh, në kalbëzim e në falimentim e sipër, ku mbizotëron vetëkënaqësia, paaftësia dhe një atmosferë e ndotur.»

Ishte gjithashtu një iluzion, ngulte këmbë ai, të pretendoje, siç bënin banorët e tij mendjemëdhenj, se aty gjendeshin mendjet më të mëdha të kombit. Ai pëlqente më mirë Perëndimin e Mesëm, ku kishte shkuar pikërisht të jetonte dhe ku, para pesëmbëdhjetë vjetësh, kishte njohur Eduinën.

Me gjithë shembullin e të shoqit, i cili gjente mënyrën për t'iu shmangur pagesës së taksave, Eduinës i pëlqente më mirë të vepronte sipas mënyrës së saj, duke e mbushur vetë deklaratën e saj të veçantë mbi të ardhurat dhe duke paguar

shumë më tepër se Luisi, ndonëse kishte të ardhurat më të vogla. Por ishte Luisi ai që i shlyente shpenzimet e tyre të ndryshme — apartamentin, shërbyesit, dy veturat Mercedes, dhe gjëra të tjera luksi.

Eduina e pranonte ndershmërisht me vete se, standardi i lartë i jetesës që gëzonte kishte qenë një nga faktorët që e kishin bindur të pranonte të martohej me Luisin dhe të ndërtonin jetën e tyre bashkëshortore mbi një bazë pavarësie reciproke. Dhe kjo marrëveshje, si edhe karrierat e tyre përkatëse, zhvilloheshin mirë e pa ndonjë fërkim.

— Do të doja, — tha Eduina, — që nuhatja jote të arrinte të zbulonte se ku kanë përfunduar paratë që u zhdukën të mërkurën.

Luisi ngriti kokën nga pjata, që kishte filluar ta sulmonte me vrull, pikërisht sikur vezët të kishin qenë armiq.
— Pse, s'i keni gjetur akoma? Përsëri kanë mbetur me gisht në gojë ata trimat e FBI-së, që ecin qorrazi?
— Le ta zëmë se ashtu është, — tha Eduina, e cila e vuri në dijeni për rrugën pa krye në të cilën ndodhej banka dhe për vendimin e saj për ta pushuar nga puna po atë ditë arkëtaren.
— Mendoj se, pas kësaj, askush nuk do ta marrë më në punë.
— Sigurisht, një bankë tjetër jo.
— Më duket se më ke thënë që ka një fëmijë.
— Po, për fat të keq.
Luisi tha me ton të zymtë:
— Dy rekrute të reja për listat e asistencës publike që, tanimë, janë të mbushura plot.
— Dëgjo! E di se çfarë? Ruaje këtë ton prej Kasandre![1]) për lexuesit e tu.
Fytyra e Luisit u çel me një nga buzëqeshjet e tij të rralla. — Më fal. Por, nuk jam mësuar të më kërkosh këshillë. Nuk e bën shpesh një gjë të tillë.

Ky ishte një kompliment dhe Eduina i qe mirënjohëse. Një nga gjërat që vlerësonte më shumë në martesën e tyre ishte që Luisi e mbante nga pikëpamja intelektuale, të barabartë me veten e tij, ndonëse këtë gjë s'kishte thënë ndonjëherë drejtpërdrejtji. Veç kësaj, ai ishte krenar për faktin se e shoqja kishte arritur një post të lartë në hierarkinë e FMA-së, gjë që ishte edhe në ditët tona, diçka jo e zakonshme për një grua, në botën bankare, që vazhdonte të ishte në mënyrë shoviniste gjithnjë mashkullore.
— Natyrisht, nuk jam në gjendje të them se ku ndodhen paratë që mungojnë, — vazhdoi Luisi, mbasi qe menduar disa çaste, — por do të jap një këshillë që më ka vlejtur në raste që dukeshin enigmatike.
— Po të dëgjooj.
— Ja: mos ki besim tek ajo që duket e qartë.
Eduina ndjeu njëfarë zhgënjimi. Ajo e pranoi në vetvete se kishte pritur, pavarësisht se kjo gjë nuk ishte logjike, njëfarë zgjidhjeje të mbinatyrshme, kurse Luisi i kishte thënë vetëm një fjalë të urtë të përdorur dhe të stërpërdorur.

I hodhi një sy orës së saj. Ishte gati tetë.
— Faleminderit, — tha, — duhet të shkoj.
— Oh, meqë ra fjala. Në mbrëmje do të nisem për Evropë. Kthehem të mërkurën.
— Udhë e mbarë, atëherë. — Eduina e puthi dhe, pastaj, doli. Ky njoftim i befasishëm nuk e çudiste. Luisi kishte një zyrë në Zurig dhe një tjetër në Londër dhe ecejaket e tij ishin një gjë krejt e zakonshme.

Ajo hyri në ashensorin që lidhte apartamentin e tyre me garazhin e brendshëm.

Nuk i kishte dhënë rëndësi këshillës së të shoqit, por, ndërsa po shkonte me makinë në degën e bankës, fjalët «mos i

beso asaj që duket e qartë» vazhdonin t'i tingëllonin me këmbëngulje në veshë.

Mbas nja dy orësh, dy agjentët e FBI-së i raportuan Eduinës dhe Nolan Uejnrajtit. E tërë kjo punë zgjati vetëm disa minuta, sepse rezultatet e hetimeve ishin negative.

Të katër shkuan në sallën e mbledhjeve, që gjendej në pjesën e prapme të ndërtesës, ku gjatë dy ditëve të fundit, agjentët e FBI-së kishin marrë në pyetje disa nëpunës.

Më i vjetri nga të dy agjentët, i quajtur Inis, dhe që fliste me një theks të Nju Inglendit, i tha Eduinës dhe drejtorit të sigurimit të bankës:

— Bëmë ç'mundëm. Çështja mbetet e hapur dhe jemi në dispozicionin tuaj, po qe se del në dritë ndonjë fakt i ri. Në rast se do të zbuloni ndonjë gjë, natyrisht do të na njoftoni menjëherë.
— Natyrisht, — tha Eduina.
— Ah, ka një element që duhet hequr. — Agjenti konsultoi bllokun e tij të shënimeve. — I shoqi i Nunjezit… Karlosi. Njëri nga njerëzit tuaj mendonte se e kishte parë në degën e bankës pikërisht ditën që u zhdukën paratë.
— Majlls Istini, — tha Uejnrajti. — Ma thua mua dhe, pastaj, unë jua referova juve.
— Po. Ne e pyetëm Istinin për këtë. Ai e pranoi se mund të jetë gabuar. Sidoqoftë, i ndoqëm gjurmët e Karlos Nunjezit. Ai jeton në Fëniks (Arizona), ku punon në një ofiçinë mekanike. Kolegët tanë të Fëniksit e kanë marre në pyetje dhe u vërtetua se, të mërkurën, ai ndodhej në punë. Po ashtu, ishte në punë edhe ditët e tjera të javës, kështu që përjashtohet mundësia që të jetë bashkëfajtor.

Nolan Uejnrajti i shoqëroi gjer jashtë degës së bankës të dy agjentët, ndërsa Eduina u kthye te tryeza e saj e punës. E

kishte njoftuar eprorin e saj të drejtpërdrejtë në Drejtorinë Qendrore, siç ishte rregulli, për shumën që mungonte në arkë; dhe, me sa dukej, ky lajm ishte ngjitur lart, gjer te Aleks Vandervurti. Ky i fundit i kishte telefonuar mbrëmjen e kaluar, vonë, i merakosur, duke e pyetur nëse mund ta ndihmonte. Eduina e kishte falënderuar, por i kishte thënë se s'kishte nevojë për ndihmë, duke e pasur të qartë se ajo përgjigjej për degën e bankës dhe, prandaj, i takonte vetë asaj të bënte gjithçka që ishte e nevojshme.

Por, atë mëngjes, asgjë s'kishte ndryshuar.

Pak para orës dymbëdhjetë, Eduina i tha Totenhoit të njoftonte zyrën e kuadrit se Huanita Nunjezi i priste marrëdhëniet me FMA-në atë mbrëmje dhe ta likuidonte përfundimisht, duke dërguar në degën e bankës shumën që i takonte. Kur u kthye Eduina nga pushimi i drekës, çekun e kishin dërguar dhe ai ndodhej në tryezën e saj të punës.

Duke e ndier veten të shqetësuar dhe tërë ngurrim, Eduina e mori çekun dhe po e kthente e rikthente midis gishtave.

Huanita Nunjezi po punonte akoma. Një ditë më parë, vendimi i Eduinës lidhur me këtë çështje kishte shkaktuar protesta të forta nga ana e Totenhoit: «Sa më parë ta heqim qafe, aq më të sigurt do të jemi se një veprim i tillë nuk do të përsëritet.»

Edhe Majlls Istini, nga tryeza e tij e punës, kishte ngrysur vetullat, por Eduina kishte mbajtur vendimin e saj.

Tani, ajo po pyeste veten se për ç'arsye po merakosej kaq shumë për këtë incident, kur ishte e qartë se tanimë ishte koha për ta mbyllur dhe për të mos e vrarë më mendjen me të. Po, po, për të mos e vrarë më mendjen me të... Faktet e bëjnë të qartë... Përsëri i jehuan fjalet e Luisit: «Mos ki besim tek ajo që duket e qartë».
Mirëpo, si? Në ç'mënyrë?

Ajo tha me vete: «Mendohu edhe një herë. Shikoje edhe një herë të gjithë çështjen nga fillimi». Cilat ishin faktet e qarta të këtij incidenti, siç kishin ndodhur? Fakti i parë i qartë ishte zhdukja e parave. I dyti ishte se ato kapnin një shumë prej gjashtë mijë dollarësh. Katër veta ishin të një mendjeje për këto: vetë Huanita Nunjezi, Totenhoi, Majlls Istini dhe, më në fund, përgjegjësi i Thesarit. Asgjë për t'u thënë gjer këtu.

Fakti i tretë i qartë kishte të bënte me pohimin e Nunjezit, simbas të cilit ajo e dinte shumën totale që kishte në arkë që në orën 13,50, mbas një pune intensive prej gati pesë orësh në sportel dhe para se të kishte bërë bilancin. Të gjithë punonjësit e degës së bankës, që ishin në dijeni të shumës që mungonte, duke përfshirë edhe vetë Eduinën, mendonin se kjo ishte e pamundur. Që në fillim, kjo gjë kishte qenë shkaku kryesor i bindjes së tyre të përbashkët se paratë ishin vjedhur nga Huanita Nunjezi.

Shkaku kryesor ... ishte e pamundur. ... Por, a ishte e pamundur ...? Eduinës i erdhi një mendim.
Ora e murit ishte 14,10. Ajo vuri re se shefi i zyrës ishte te tryeza e tij e punës.
— Zoti Totenho, — i tha ajo, — ejani, ju lutem, pak me mua.
E ndjekur nga Totenhoi, i zymtë si gjithmonë, ajo u drejtua për te sportelet, duke përshëndetur gjatë rrugës ndonjë klient, me një lëvizje të vogël të kokës. Dega e bankës ishte plot me njerëz, siç ndodhte gjithnjë të premten pasdite, në orët e fundit të punës, para mbylljes së saj.

Huanita Nunjezi ishte në sportel. Një klient po derdhte një shumë të hollash.
Eduina i tha me zë të qetë:
— Ju lutem, mbasi të keni mbaruar me këtë klient, mbylleni sportelin dhe kasetën.

Huanita Nunjezi nuk u përgjigj dhe qëndroi e heshtur edhe kur e mbaroi punën që kishte në dorë dhe vuri në sportel

pllakën metalike me shënimin «MBYLLUR». Kur u kthye për të mbyllur bravën e kasetës, Eduina e pa shkakun e heshtjes së saj: ajo po qante dhe lotët po i rridhnin poshtë faqeve. Nuk ishte e vështirë të kuptoje arsyen se pse po ndodhte kështu. Ajo kishte pritur të pushohej atë ditë nga puna, dita e fundit e javës, dhe ardhja e papritur e Eduinës ia kishte përforcuar këtë mendim.

Eduina bëri sikur nuk i kishte vënë re lotët.

— Zoti Totenho, — tha ajo, — besoj se zonja Nunjez ka qenë duke punuar në sportel që nga ora e hapjes e gjer tani. Kështu, apo jo?

— Po, ashtu.

«Kjo periudhë kohe është e barabartë, pak a shumë, me atë të së mërkurës, mendoi Eduina, ndonëse të premten ka më shumë punë.»

Bëri me shenjë te kaseta dhe tha:

— Zonja Nunjez, ju keni ngulur këmbë shumë herë se jeni në gjendje të dini, në çfarëdo çasti, se sa para keni në arkë. A e dini tani se sa keni aty?

Gruaja e re pati një çast ngurrimi dhe, pastaj, pohoi me një lëvizje të kokës ngaqë nuk ishte akoma në gjendje të fliste, për shkak të lotëve.

Eduina shkëputi një copë letër nga cilindri i makinës llogaritëse dhe ia dha asaj:

— Shënojeni totalin në këtë.

Përsëri u vu re një ngurrim i dukshëm. Pastaj, Huanita Nunjezi mori një laps dhe shkroi : 23.765 dollarë.

Eduina ia dha copën e letrës Totenhoit.

— Ju lutem, shkoni me zonjën Nunjez dhe rrini me të gjatë kohës që ajo do të bëjë bilancin e ditës. Verifikoni llogaritë dhe krahasoni rezultatin me shumën e përgjithshme të shënuar këtu.

Totenhoi e shikoi me një pamje mosbesimi copën e letrës. — Ç'është e vërteta, jam shumë i zënë me punë dhe po qe se do të më duhej të kontrolloja çdo arkëtar...
— Kontrolloni vetëm këtë, — ia priti Eduina.
Ajo përshkoi përsëri sallën e madhe dhe u kthye te tryeza e saj e punës.
Mbas treçerek ore, Totenhoi erdhi tek ajo.
Dukej i shqetësuar dhe Eduina vuri re se i dridheshin duart.
Kishte me vete copën e letrës, të cilën e vuri para Eduinës.
Shifra e shënuar nga Huanita kishte anash një spontim me laps.
— Po të mos kisha qenë vetë aty, — tha shefi i zyrës, — nuk do ta kisha besuar. Shprehja e tij e zakonshme e zymtë ishte zhdukur; atë e kishte zëvendësuar habia.
— Ky total ishte i saktë?
— Krejt i saktë.

Eduina mbeti disa çaste pa folur, duke u munduar të vinte njëfarë rregulli në mendimet e saj. E kuptonte se, papritur, çështja kishte marrë një drejtim të ri. Deri në atë çast, dyshimet ishin mbështetur mbi pranimin e pamundësisë së Huanita Nunjezit për të bërë atë që ajo e kishte provuar tanimë, një herë e mirë, se mund ta bënte.

— Kur po vija këtu, te ju, — tha Totenhoi, — më ra ndërmend diçka. Para nja njëzet vjetëve, kam njohur në një degë banke krahinore një njeri që e kishte këtë dhunti: ai e dinte gjithmonë shumën totale që kishte në arkë. Dhe më kujtohet se kam dëgjuar të flitet për raste të tjera të ngjashme. Kjo është njëlloj sikur këta njerëz të kishin në kokën e tyre makinë llogaritëse.

— Do të kisha dashur që kujtesa juaj të kishte funksionuar mirë edhe të mërkurën, — ia priti Eduina.

Ndërsa Eduina u kthye në vendin e saj, ajo nxori bllokun e shënimeve dhe bëri një përmbledhje të shkurtër të mendimeve të veta.

Nunjezi akoma jo e shfajësuar, por më e besueshme. Ndoshta viktimë e pafajshme? Në rast se jo Nunjezi, atëherë kush?

Dikush që i di mirë procedurat e bankës dhe që mund të ketë pritur me kohë një rast të favorshëm.

Dikush nga personeli? Këtu brenda?

Por në ç'mënyrë?

Kjo do të shihet më vonë. Së pari, duhet gjetur shkaku që ka nxitur për këtë veprim, pastaj fajtori.

Shkaku nxitës? Nevojë e ngutshme për para nga dikush.

Pastaj, shkruajti përsëri me gërma të mëdha: **NEVOJË PËR PARA** dhe shtoi: *Të shqyrtohen llogaritë personale të të gjithë punonjësve të degës së bankës — SOT!*

Pastaj, ajo filloi të shfletojë me shpejtësi numëratorin telefonik të brendshëm të bankës, duke kërkuar «Inspektoratin e Kontabilitetit — Drejtorinë.»

13.

Të premten pasdite, të gjitha degët e Fërst Merkentajll Ëmerikën Benkut rrinin hapur tri orë më shumë se orari i zakonshëm.

Kështu, atë të premte, pikërisht në ora 18,00 roja i mbylli kanatet e mëdha të portës së rrugës të degës kryesore të bankës së qytetit. Klientët e paktë, që gjendeshin akoma në bankë në orën e mbylljes, u nxorën jashtë një nga një nga roja nëpër një derë të vogël, të përbërë nga një pllakë e vetme kristali.

Pikërisht, pesë minuta mbas mbylljes, te kjo derë e vogël kristali u dëgjuan një varg trokitjesh të forta dhe autoritare.

Nga brenda, roja ktheu kokën dhe pa një djalë të ri, me një pardesy të errët, që mbante në dorë një çantë lëkure. Për të tërhequr vëmendjen, ai kishte trokitur me një monedhë metalike prej pesëdhjetë sent, të mbështjellë me shami.

Kur roja iu afrua derës, djaloshi mbështeti te qelqi një dokument identiteti. Roja e verifikoi dhe, pastaj, hapi derën dhe djaloshi hyri brenda.

Atëherë, para se roja të kishte kohë për ta mbyllur derën përsëri, një grumbull njerëzish u futën brenda, sikur të kishin mbirë nga dheu me anë të ndonjë shkopi magjik. Ndërsa, para një çasti, kishte qenë vetëm një djalosh, me çantë dhe dokument identiteti, papritur u dukën dhe gjashtë veta, të ndjekur nga gjashtë të tjerë dhe, pastaj, edhe nga një grup tjetër, si praparojë. Me shpejtësi, si një përmbytje, ata u derdhën dhe u shpërndanë në degën e bankës. Njëri nga më të moshuarit, që kishte një pamje autoritare, tha me ton të prerë:
— Inspektorati i Kontabilitetit.

— Si urdhëroni, zotëri, — u përgjigji roja, duke vazhduar verifikimin e dokumenteve. Ai ishte veteran i shërbimit të sigurimit dhe kishte qenë i pranishëm edhe herë të tjera në veprime të këtilla.

Gjithsej kishin hyrë njëzet veta, gjashtëmbëdhjetë burra dhe katër gra, të cilat shkuan menjëherë në pika të ndryshme të degës së bankës.

Burri i moshuar, që kishte bërë pak më parë njoftimin mbi grupin, u drejtua nga tryeza e punës së Eduinës. Kjo e fundit, që ishte ngritur për ta përshëndetun, vështroi me një habi të dukshme rrymën e njerëzve që po hynin pa pushim.
— Zoti Bërnsajd, mos është fjala për një inspektim në stil të gjerë?
— Ashtu është, zonja D'Orsej. — Kryeinspektori hoqi pallton e madhe dhe e vari pranë platformës.

Ndërkaq, fytyrat e një pjese të nëpunësve dhe funksionarëve të degës së bankës shprehnin mërzit dhe pakënaqësi, ndërsa një pjesë tjetër murmuriste me zemërim: «Djall o punë! S'u mjaftojnë gjithë ato ditë të javës, por shkojnë e na zgjedhin pikërisht të premten!» ... «Dreqi e marrtë, sonte do të haja darkë jashtë! ... «Kush thotë se inspektorët kanë ndjenja njerëzore?»

Shumica e tyre e dinin se ç'do të thoshte një vizitë nga i tërë grupi i punonjësve të Inspektoratit të Kontabilitetit. Arkëtarët e kishin të qartë se, para se të largoheshin nga puna, duhet të bënin përsëri bilancin e arkës së tyre dhe të gjendjes së Thesarit. Llogaritarët duhet të qëndronin atje, deri sa regjistrimet e tyre të ishin verifikuar dhe të ishte bërë bilanci. Funksionarët mund të thoshin se ishin me fat, po qe se do të mund të largoheshin aty nga ora dymbëdhjetë e natës.

Inspektorët, të njerëzishëm, por të shpejtë në punë, i kishin marrë tanimë për kontroll të gjithë regjistrat. Prej këtij çasti, çdo shtesë ose ndryshim do t'i nënshtrohej një shqyrtimi të rreptë.

Eduina tha:
— Kur kërkova të bëhej një verifikim i llogarive të personelit, sigurisht që nuk mendoja një gjë të tillë.

Zakonisht, intervali midis njërit inspektim dhe tjetrit shkonte nga tetëmbëdhjetë muaj gjer në dy vjet dhe kishin kaluar vetëm tetë muaj që kur ishte bërë inspektimi i fundit i përgjithshëm i degës së bankës.

— Zonja D'Orsej, na takon neve të vendosim për mënyrën, vendin dhe kohën. — Toni i Bërnsajdit ishte, si gjithnjë, i ftohtë dhe i rezervuar. Në bankat e mëdha, Inspektorati i Kontabilitetit përbënte një sektor të pavarur, një sektor me rolin e qenit të rojës, me të drejta dhe autoritet të ngjashëm me ato të Inspektoratit të Përgjithshëm të ushtrisë. Pjesëtarët e tij nuk trembeshin nga posti a funksioni i të

tjerëve dhe, bile, edhe drejtorët, me një periudhë të gjatë vitesh shërbimi, mund të qortoheshin rëndë për çregullime të mundshme, që dilnin në dritë nga një inspektim i hollësishëm — dhe raste të tilla ndodhnin.
— Këtë e di, — tha Eduina. — Vetëm çuditem se si mundët ta organizonit kaq shpejt.

Kryeinspektori buzëqeshi, me njëfarë kënaqësie.
— Kemi metodat tona.

Por ai nuk tha se, për atë mbrëmje, ishte organizuar një inspektim i befasishëm te një degë tjetër e FMA-së. Mbas telefonatës së Eduinës, tri orë më parë, plani i mëparshëm ishte ndryshuar, ishin bërë me të shpejtë përgatitjet e duhura dhe ishin thirrur disa bashkëpunëre të jashtëm, për të plotësuar grupin.

Këto metoda, që përshkruhen në intrigat e romaneve, nuk ishin një gjë e re. Një nga detyrat kryesore të Inspektoratit ishte të sulej në degët e bankës në periudha kohe të parregullta dhe pa paralajmërim. Masa paraprake të kujdesshme dhe të ndërlikuara merreshin për të ruajtur fshehtësinë dhe një inspektor, po ta shkelte, do të kishte ngatërresa serioze. Disave u ndodhte, qoftë edhe nga pakujdesia.

Për inspektimin që do të bëhej në degën kryesore të bankës, që drejtohej nga Eduina, grupi i inspektorëve ishte mbledhur, para një ore, në sallën e një hoteli në qendër të qytetit; bile, edhe atje, vendi se ku do të shkonin ishte mbajtur i fshehtë, gjer në çastin e fundit. Mbasi ishin ndarë detyrat dhe ishin dhënë shkurtimisht udhëzimet e rastit, Bërnsajdi e të tjerët ishin drejtuar për në degën kryesore të bankës, pa rënë në sy, të ndarë në grupe të vogla prej dy-tri vetash. Deri disa minuta para kohës së caktuar, ata kishin qëndruar në tarracat e ndërtesave të afërta, ose e kishin kaluar kohën duke shëtitur, me pamje indiferente, apo duke vështruar vitrinat e dyqaneve. Pastaj, sipas zakonit, pjesëtari më i ri i grupit kishte trokitur te

porta e bankës për t'u futur brenda. Pasi kishte hyrë ai, të tjerët ishin lëshuar pas tij, si ushtarët e një regjimenti që kanë marrë urdhrin për grumbullim.

Dhe tani, të gjithë ndodheshin në vendet kyçe përkatëse.

Në vitin 1970, një nëpunës banke që ishte zënë në faj e sipër, mbasi kishte vazhduar të bënte përvetësime të paligjshme për gati njëzet vjet, kishte thënë, ndërsa po e shpinin në burg: «Inspektorët vijnë dhe dredhin zinxhirin për nja treçerek ore. Më jepni gjysmën e kësaj kohe dhe do të më mjaftonte për t'i zhdukur të gjitha provat.» Inspektorati i Kontabilitetit i Fërst Merkentajll Ëmerikën Benkut si dhe i bankave të tjera të mëdha të Amerikës së Veriut, nuk vepronte në atë mënyrë. As pesë minuta nuk kalonin prej çastit të hyrjes dhe gjer në çastin kur të gjithë inspektorët ndodheshin në vendet e caktuara, duke vëzhguar gjithçka.

I detyruar t'i nënshtrohej një situate të pashmangshme, personeli i degës së bankës plotësoi punën e ditës dhe, pastaj, u vu në dispozicion të inspektorëve.

Veprimet e verifikimit do të vazhdonin tërë javën e ardhshme, si edhe një pjesë të tjetrës, por faza kritike do të merrte fund brenda pak orëve.

— Le t'ia nisim punës, zonja D'Orsej, — tha Bërnsajdi. — Do të fillojmë me llogaritë e depozituara, si të thjeshtat, ashtu edhe të vreguarat — dhe hapi çantën, që e kishte vënë mbi tryezën e punës së Eduinës.

Aty nga ora tetë e mbrëmjes, emocioni i shkaktuar nga ardhja e befasishme e grupit të inspektorëve kishte kaluar, një sasi e madhe pune ishte kryer dhe personeli i mbetur në degën e bankës ishte pakësuar në mënyrë të dukshme. Të gjithë arkëtarët ishin larguar, ashtu edhe një pjesë e llogaritarëve. Ishte verifikuar gjendja e arkave dhe e Thesarit dhe puna për kontrollin e regjistrimeve të tjera kishte shkuar mjaft përpara.

Inspektorët ishin treguar të mirësjellshëm dhe, në disa raste, kishin vënë në dukje disa gabime të vogla, gjë që bënte pjesë në detyrën e tyre.

Ndër funksionarët që kishin mbetur akoma në bankë, ishin: Eduina, Totenhoi dhe Majlls Istini. Të dy burrat kishin qenë të zënë me kërkimin e të dhënave dhe sqarimet e përgjigjet që jepnin për çështjet që u kërkoheshin. Totenhoi po shfaqte shenja lodhjeje, ndërsa i riu Istin, i cili deri në atë çast i ishte përgjigjur çdo pyetjeje tërë gjallëri dhe buzagaz, ishte akoma po aq i freskët dhe plot energji, siç kishte qenë në fillim të inspektimit. Qe pikërisht Majlls Istini që e rregulloi t'u sillnin sanduiçe dhe kafe inspektorëve dhe personelit.

Një grup i vogël inspektorësh po merrej me shumat e depozituara e me verifikimin e llogarive dhe, herë pas here, njëri prej tyre i sillte një shënim Bërnsajdit, që s'kishte lëvizur nga tryeza e punës së Eduinës. Ky i hidhte një vështrim, bënte shenjë me një lëvizje të vogël koke dhe e fuste fletën në çantë, te dokumentet e tjera. Në ora nëntë pa dhjetë, atij i erdhi përsëri një shënim, që dukej se ishte më i gjatë nga të mëparshmit, të cilit i ishin bashkëngjitur fletë të tjera. Bërnsajdi i lexoi me vëmendje dhe, pastaj, tha:

— Zonja D'Orsej dhe unë po bëjmë një pushim. Po dalim jashtë për të ngrënë diçka.

Mbas disa çastesh, ai doli me Eduinën nga e njëjta derë nga kishte hyrë para rreth tri orëve.

Sapo dolën jashtë degës së bankës, ai tha:

— Më falni, por kjo ishte vetëm një dredhi. Kam frikë se darkës sonë, edhe po qe se na mbetet kohë për ta ngrënë, do t'i duhet të presë.

Dhe, duke parë shprehjen e habitur të fytyrës së Eduinës, shtoi:

— Po shkojmë në një takim, por nuk doja që të tjerët ta dinin.

U kthyen nga e djathta dhe u larguan nja një gjysmë blloku ndërtesash nga banka, që ishte akoma tërë drita, dhe, pastaj, morën një rrugë të caktuar për këmbësorët, që i nxori përsëri në sheshin «Roseli». Mbasi e përshkuan atë, u futën në grataçielin e Drejtorisë Qendrore të FMA-së. Nata ishte e ftohtë dhe Eduina u mbështoll më fort me mantelin e saj, duke thënë me vete se kalimi i nëndheshëm që lidhte degën e bankës me grataçielin ishte një rrugë më e shkurtër dhe e ngrohtë. Pse gjithë ky mister?!

Nënshkruan regjistrin e caktuar për hyrjet jashtë orarit të punës dhe roja e natës i shoqëroi në ashensor gjer në katin e njëmbëdhjetë. Në një tabelë ishin shënuar fjalët: SEKSIONI I SIGURIMIT, të shoqëruara me një shigjetë. Nolan Uejnrajti dhe të dy agjentët e FBI-së që ishin marrë me hetimet lidhur me zhdukjen e shumës së parave, po i prisnin aty.

Pothuajse mbas një çasti mbërriti edhe një inspektor i grupit të Bërnsajdit, i cili, me sa dukej, u kishte shkuar nga pas kryeinspektorit dhe Eduinës.

Njohjet u bënë më të shpejta. Inspektori që erdhi i fundit, një djalë i ri i quajtur Gejn, kishte sy të ftohtë dhe tërë gjallëri, vështrimit të të cilëve dukej se zor i shpëtonte gjë, prapa syzeve me skelet të madh, që i jepnin fytyrës së tij një shprehje të rreptë. Gejni ia kishte sjellë shënimet dhe dokumentet Bërnsajdit, kur ky i fundit ishte duke punuar pranë Eduinës. Me sugjerimin e Nolan Uejnrajtit, të gjashtë ata shkuan në një sallë mbledhjesh dhe zunë vend rreth një tryeze të rrumbullakët.

Bërnsajdi u tha të dy agjentëve të FBI-se:

— Shpresoj se ajo që kemi zbuluar do ta përligjë faktin që ju thirrëm kaq vonë.

Eduina e kuptoi se mbledhja duhej të kishte qenë organizuar shumë orë më parë. Ajo pyeti:

— Pra, keni zbuluar diçka?

— Për fat të keq, zonja D'Orsej, shumë më tepër se sa mund të pritej.

Mbas një shenje të Bërnsajdit, inspektori Gejn filloi të hapë mbi tryezë fletë e dokumente.

— Sipas sugjerimit tuaj, — vazhdoi Bërnsajdi me ton akademik, — verifikuam llogaritë e të gjithë personelit të degës suaj të bankës. Ajo që kërkonim ishte ndonjë e dhënë për vështirësi ekonomike të ndokujt, dhe gjetëm të dhëna mjaft bindëse.

«Flet si një mësues mendjemadh,» — mendoi Eduina; por, vazhdoi të dëgjonte me shumë kujdes.

— Ndoshta duhet të shpjegoj më parë, — vijoi Bërnsajdi, duke iu drejtuar të dy agjentëve të FBI-së, — se shumica e nëpunësve të bankës e kanë llogarinë e tyre personale pranë degës ku punojnë. Njëra nga arsyet është se llogaritë e personelit përjashtohen nga detyrimet e komisioneve bankare. Një tjetër arsye, më e rëndësishmja, është se, për huatë që u jep vartësve të saj, banka zbaton një interes të ulët, zakonisht një për qind më të vogël se interesi fillestar.

Inisi, më i moshuari nga të dy agjentët, tundi kokën në shenjë pohimi, duke thënë:

— Po, e dimë.

— Atëherë, e kuptoni se një nëpunës që ka përfituar nga këto kushte të favorshme, pra, që ka marrë hua gjer në maksimumin e mundshëm, dhe që, pastaj, ka marrë hua edhe shuma të tjera nga burime të jashtme, si agjencitë e huave, përqindja e interesit të të cilave është mjaft e lartë, e ka futur veten në një gjendje ekonomike mjaft delikate.

Inisi tha, me një tingull padurimi në zë:

— Natyrisht.

— Mirë, pra, duket se kemi gjetur një nëpunës banke, të cilit i ka ndodhur pikërisht kështu. Ai ia bëri me shenjë Gejnit, i cili ktheu me faqen lart disa çeqe të fshirë, të cilët, më parë, kishin qenë vendosur përmbys.

— Sikurse mund ta shihni, këto çeqe kanë qenë lëshuar në favor të tri agjencive të veçanta huash. Ndërkaq, me dy nga ato u lidhëm me telefon: Me gjithë derdhjet e kryera, siç e shihni këtu, të dyja llogaritë janë akoma të pashlyera. Është e arsyeshme të mendosh se edhe e treta do të na japë, nesër në mëngjes, të njëjtën përgjigje.

Gejni ndërhyri:

— Dhe këto çeqe i përkasin vetëm muajit në vazhdim. Nesër do të shohim regjistrimet e mikrofilmuara të disa muajve të mëparshëm.

— Ka një fakt tjetër me rëndësi të dorës së parë, — vazhdoi kryeinspektori. — Personi në fjalë nuk mund të ketë paguar shuma të tilla, — Ai bëri me shenjë drejt çeqeve të fshira — me anë të rrogës së bankës, shumën e së cilës ne e dimë. Prandaj, gjatë këtyre orëve të inspektimit, ne kërkuam prova të ndonjë vjedhjeje dhe, këto i gjetëm.

Gejni vendosi mbi tryezë dokumente të tjera.

... Prova për vjedhje në bankë ... të gjetura ... Eduina, pothuajse pa dëgjuar më se ç'thuhej, e kishte ngulur vështrimin te nënshkrimi i atyre çeqeve: një nënshkrim që ishte shumë i njohur për të, i qartë e i sigurt, të cilin e shihte çdo ditë.

Ai ishte nënshkrimi i Istinit, i Majllsit të ri, që i dukej aq i mirë, me aq rezultate të mira në detyrën e tij si zëvendësshef zyre, aq i dobishëm dhe i palodhshëm, bile edhe atë mbrëmje,

gjatë inspektimit; për të cilin, pikërisht atë javë, ajo kishte vendosur ta gradonte sapo Totenhoi të dilte në pension.

Shefi i Inspektoratit të Kontabilitetit vazhdoi:

— Vjedhësi ynë i vogël vepronte me dinakëri, duke mjelur llogari të palëvizshme. Pasi u zbulua një herë një veprim i tillë, nuk e patëm të vështirë të zbulonim të tjerët.

Duke folur gjithnjë me ton akademik dhe duke i bërë këto sqarime për të dy agjentët e FBI-së, ai shpjegoi se llogari të palëvizshme, si të rrjedhshme ashtu dhe të depozituara, ishin ato që bënin pak lëvizje, ose asnjë fare. Çdo bankë ka klientë, që, për arsye të ndryshme, i lënë të paprekura llogaritë e tyre për periudha të gjata kohe, nganjëherë, për shumë vite me radhë, duke pasur shpeshherë në to shuma mjaft të mëdha. Natyrisht që në llogaritë e depozituara grumbullohej një shumë nga interesi i vogël përkatës dhe, pa dyshim, ky ishte pikërisht qëllimi i shumë klientëve; mirëpo, kishte shumë të tjerë, sado e pabesueshme që dukej kjo, që e linin krejt në harresë llogarinë e tyre.

Mbas njëfarë periudhe pa veprime, pa derdhje dhe as tërheqje, banka nuk e dërgonte më fletën e nxjerrjes mujore të llogarisë dhe e zëvendësonte atë me një vjetore. Shpeshherë, edhe kjo e fundit kthehej nga posta me shënimin: «transferuar — adresë e panjohur.»

Për të ndaluar përdorimin e paligjshëm të llogarive të palëvizshme, vazhdoi kryeinspektori, merren masa të zakonshme. Skedat e tyre mbahen veçan dhe, në rast se papritur kërkohet ndonjë veprim, skeda përkatëse kontrollohet nga një nëpunës me përgjegjësi, për t'u siguruar se është në rregull. Zakonisht këto masa kanë qenë të mjaftueshme. Si zëvendësshef zyre, Majlls Istini kishte autoritet për të kontrolluar dhe miratuar veprimet e llogarive të palëvizshme. Ai e kishte shfrytëzuar këtë autoritet për të

mbuluar veprimet e tij të pandershme, vjedhjet e tij nga këto llogari.

Istini ishte treguar mjaft dinak, duke zgjedhur llogaritë që kishin më pak mundësi të shkaktonin ngatërresa. Kemi këtu një numër formularësh të falsifikuar për tërheqje, ndonëse ky falsifikim nuk është bërë shumë mirë mbasi shkrimi në të është shumë i ngjashëm me shkrimin e zakonshëm të Istinit. Pastaj, shumat transferoheshin në një llogari të sajuar, me një emër të trilluar. Edhe këtu, shkrimi duket si ai i Istinit, megjithëse, natyrisht, do të jetë i nevojshëm të merret mendimi i një eksperti kaligrafie për t'u siguruar.»

Ata i kontrolluan njërin pas tjetrit formularët e tërheqjes, duke krahasuar shkrimin në to me atë të çeqeve, që kishin parë më parë. Me gjithë orvatjen e qartë që dukej se ishte bërë për ta ndryshuar shkrimin, ngjashmëria ishte e qartë dhe e pamohueshme.

Agjenti i dytë i FBI-së, Delrimpëlli, po merrte shënime. Ai i ngriti sytë nga blloku i shënimeve dhe pyeti:

— A e keni shumën totale të tërheqjeve?

— Gjer më tani, kemi arritur në rreth tetë mijë dollarë, — u përgjigj Gejni, — por, nesër, do të kontrollojmë regjistrimet e muajve të kaluar dhe, ka të ngjarë, që të zbulojmë të tjera.
Bërnsajdi shtoi:
— Kur t'i tregojmë Istinit se ç'kemi zbuluar gjer më tani, ndoshta ai do të vendosë të na e lehtësojë punën, duke i pranuar vetë ato që janë akoma të panjohura. Zakonisht kështu ndodh kur shtiem në dorë vjedhës si ai.

«Po kënaqet me këtë mendim, — tha me vete Eduina; — me të vërtetë, po kënaqet.» Ndiente një nxitje të pakuptueshme për të mbrojtur Majlls Istinin dhe pyeti:
— A keni ndonjë mendim se kur mund të ketë filluar e tërë kjo punë?

— Nga ç'është zbuluar gjer tani, — u përgjigj Gejni, — duket se ajo po vazhdon prej së paku një viti, por ka mundësi edhe më parë.

Eduina e shikoi drejt në sy Hel Bërnsajdin:
— Kështu që, gjatë inspektimit të mëparshëm, nuk ju ra asgjë në sy. Nuk bën pjesë në detyrën tuaj edhe kontrolli i llogarive të palëvizshme?

Kjo qe njëlloj sikur të shpohej një flluskë sapuni. Kryeinspektori, flakë në fytyrë, pranoi, duke thënë:
— Po, bën pjesë. Mirëpo, ka raste që edhe neve na shpëton diçka, kur një vjedhës i ka mbuluar mirë gjurmët e tij.

— Kjo është e qartë, por, para një çasti ju thatë se shkrimi ishte i falsifikuar.

Bërnsajdi ia priti, me ton therës:
— E po, mirë, tani na ra në sy kjo.

— Mbasi ju thirra unë, — ia kujtoi Eduina.

Agjent Inisi e prishi heshtjen që kishte rënë:
— Sidoqoftë, e tërë kjo punë nuk na shpie asnjë hap përpara përsa i përket shumës që mungon në arkë që të mërkurën e kaluar.

— Vetëm se e bën Istinin të dyshimtin numër një, — tha Bërnsajdi. Dukej që e ndjente veten të lehtësuar nga fakti se mund ta drejtonte përsëri bisedën. — Dhe, ndoshta, ai do të pranojë se e ka bërë edhe këtë.

— Aspak, — ia priti Nolan Uejnrajti. — Kemi të bëjmë me një njeri shumë të djallëzuar. Nga ana tjetër, pse do ta pranonte? Ne akoma s'e dimë se si e ka bërë këtë.

Deri në atë çast, drejtori i shërbimit të sigurimit kishte thënë apo jo dy fjalë. Pas habisë së çastit të parë, shprehja e fytyrës së tij vinte duke u ashpërsuar sa me shume qe inspektorët nxirrnin dokumente dhe prova fajësie. Eduina

pyeste veten nëse Uejnrajti po mendohej për mënyrën se si ata të dy e kishin munduar dhe torturuar me pyetje mbas pyetjesh arkëtaren Huanita Nunjez, pa u besuar protestave të saj se ishte e pafajshme. Prapëseprapë, mendoi Eduina, kishte mundësi që ajo të kishte pasur lidhje me Istinin, ndonëse një gjë e tillë dukej të kishte pak të ngjarë.

Hel Bërnsajdi u ngrit dhe mbylli çantën e tij.
— Tani është çasti që inspektorati të largohet dhe të hyjë në veprim ligji.

— Dokumentet do të na nevojiten, si edhe një deklaratë me shkrim, — tha Inisi.

— Zoti Gejn do të qëndrojë këtu, në dispozicionin tuaj.

— Edhe një pyetje. A mendoni që Istini të ketë dyshim se është zbuluar?

— Nuk besoj. — Bërnsajdi hodhi sytë nga ndihmësi i tij, i cili tundi kokën në shenjë mohimi. — Jam i sigurt se jo. Ne vepruam me shumë kujdes e vëmendje për të mos lënë të kuptohej se çfarë kërkonim dhe, për të fshehur qëllimin e vërtetë të inspektimit, kërkonim shumë gjëra që, në të vërtetë, nuk na duheshin.

— Edhe unë nuk besoj, — tha Eduina.

Asaj iu kujtua me trishtim se si Majlls Istini, ndërsa ajo po dilte nga dega e bankës me Bërnsajdin, po vazhdonte punën, me qëndrimin e pamjen e tij, si gjithnjë, të gëzueshme e buzagaz. Pse e kishte bërë ai këtë? Pse?! Pse?!

Inisi tha:
— Atëherë, çdo gjë në rregull. Do ta marrim Istinin në pyetje sapo të kemi mbaruar këtu, bur nuk i duhet thënë gjë. Në bankë është ai, akoma?

— Po, — u përgjigji Eduina. — Do të jetë aty deri sa të kthehemi ne. Zakonisht, ai largohet i fundit.

Nolan Uejnrajti ndërhyri, me zë të ashpër se zakonisht. — Mbajeni atje sa më shumë që të jetë e mundur. Pastaj, e lini të kthehet në shtëpi, me bindjen se nuk është zbuluar.

Të tjerët e vështruan drejtorin e shërbimit të sigurimit me habi dhe pa e kuptuar qëllimin e tij. Veçanërisht të dy agjentët e FBI-së po e vështronin me ngulm. Nga sytë e Uejnrajtit dukej sikur kalonte një mesazh drejt tyre.

Inisi ngurroi një çast dhe, pastaj, tha:

— Në rregull. Le të bëhet ashtu.
Mbas disa minutash, Eduina dhe Bërnsajdi hynë në ashensor për të zbritur në katin përdhes.

Inisi i tha njerëzishëm Gejnit:
— Para se t'ju marrim deklaratën që folëm, a ka mundësi të na lini një çast vetëm?
— Si jo.
Inspektori doli nga salla e mbledhjeve.
Agjenti i dytë i FBI-së e mbylli bllokun e shënimeve dhe e vuri lapsin në tryezë.
Inisi iu drejtua Nolan Uejnrajtit:
— Ke ndërmend të bësh ndonjë gjë?
— Po. — Uejnrajti po ngurronte, në luftë me ndërgjegjen e tij. Përvoja i thoshte se provat kundër Istinit nuk ishin të plota dhe se duheshin plotësuar. Mirëpo, për t'i plotësuar do të ishte e nevojshme që ligji të lakohej në një mënyrë që ishte në kundërshtim me bindjet e tij. E pyeti Inisin: — Do, patjetër, ta dish?
Të dy u vështruan drejt në sy. Ata njiheshin prej shumë vitesh dhe kishin respekt për njëri-tjetrin.
— Sot nuk është punë e lehtë të gjesh prova, — tha Inisi. — Ne nuk mund të përdorim tani metodat tona të zakonshme dhe, po ta bënim këtë, ka të ngjarë që ato të ktheheshin kundër nesh.

Mbas një heshtjeje prej disa çastesh, agjenti i dytë i FBI-së tha:
— Na thuaj atë që mendon se mund të na e thuash.
Uejnrajti gershetoi gishtat, me vështrimin e ngulur tek ata. I tërë trupi i tij dukej se rrezatonte tension, ashtu siç kishte ndodhur pak më parë me zërin e tij.
— Kështu, pra, këtu kemi prova të mjaftueshme për të paditur Istinin për vjedhje. Le të themi se shuma e vjedhur është rreth tetë mijë dollarë. Sa mendoni se mund t'i japë gjykatësi për këtë?
— Duke qenë se është hera e parë, do të marrë kondicionelin, — u përgjigj Inisi. — Sa për paratë, gjykata s'do të merakoset shumë. Atje mendojnë zakonisht se bankat kanë para me tepricë dhe, veç kësaj, të gjithë e dinë se janë të siguruara.
— Ashtu është! — U pa se si gishtat e Uejnrajtit u shtrënguan edhe më shumë. — Po në qoftë se ne mund të vërtetojmë që Istini ka marrë edhe ato paratë e tjera, të gjashtë mijë dollarët e së mërkurës; po qe se mund të vërtetojmë se është përpjekur të hedhë dyshimet mbi arkëtaren dhe se gati ia doli në krye këtij qëllimi djallëzor ...?
Inisi pohoi me kokë.
— Sigurisht, po qe se mund t'i vërtetosh këto, cilido gjykatës do ta rrashte drejt e brenda. Por, a je në gjendje ta bësh këtë?
— Do të përpiqem. Dua ta shoh atë dobiç prapa hekurave!
— E kam të qartë se ç'ndien ti, — tha mendueshëm Inisi. — Edhe mua do të më pëlqente të ndodhte ashtu.
— Atëherë, bëj si të them unë. Mos e arresto Istinin sonte. Më jep kohë gjer nesër në mëngjes.
— Nuk e di, nuk di ç'të them, — murmuriti Inisi.
— Nuk e di nëse mund ta bëj këtë.
Të tre ata mbetën në heshtje për disa çaste, të pavendosur se ç'duhej bërë. Të dy agjentët e merrnin me mend, pak a shumë, se ç'kishte ndërmend të bënte Uejnrajti. Mirëpo, kur dhe gjer

në ç'pikë, qëllimi i justifikon mjetet? Veç kësaj, çfarë lirie veprimi mund t'i lejonte vetes, në ditët tona, një punonjës policie, pa e futur veten në telashe?
— Ka mundësi që Istini t'ia mbathë, po të presim gjer nesër në mëngjes, — vërejti Delrimplli. — Kjo do të na fuste, të gjithëve, në ngatërresa të mëdha.
— Dhe nuk dua, gjithashtu, të përdoren metoda brutale, — tha Inisi.
— Nuk do të ia mbathë dhe nuk do të përdoren metoda brutale. Jua garantoj unë!
Inisi i hodhi sytë kolegut të tij, i cili mblodhi supet.
— Mirë, atëherë, — tha Inisi. — Gjer nesër në mëngjes. Por, mos harro një gjë, Nolan: kjo bisedë s'është bërë.
Ai shkoi te dera dhe e hapi.
— Mund të hyni, zoti Gejn. Zoti Uejnrajt po largohet. Tani mund ta marrim deklaratën tuaj.

Një listë e nëpunësve të degës së bankës, që mbahej në seksionin e sigurimit për ndonjë rast nevoje, kishte edhe adresën dhe numrin e telefonit të Majlls Istinit.
Nolan Uejnrajti i kopjoi të dyja.
Ai e njihte atë zonë: një lagje banesash, nja tre kilometra nga qendra, e banuar nga njerëz me të ardhura mesatare. Në adresë shënohej: «Apartamenti 2 G».
Mbasi doli nga grataçieli i FMA-së, Uejnrajti hyri në një kabinë telefonike në sheshin «Roseli» dhe formoi numrin e — Istinit. Dëgjoi zilen e telefonit të binte vazhdimisht, por askush nuk u përgjigj. E dinte se Istini ishte beqar, por Uejnrajti shpresonte që edhe të jetonte vetëm.
Në qoftë se do të ishte përgjigjur ndokush, Uejnrajti do të kishte kërkuar ndjesë, duke thënë se kishte gabuar numër dhe, pastaj, do ta kishte ndryshuar planin e tij.

Duke qenë se nuk ndodhi ashtu, ai u drejtua për te garazhi i nëndheshëm i FMA-së, për të marrë veturën e tij.
Para se të dilte nga garazhi, ai hapi portbagazhin dhe nxori një portofol të madh kamoshi, të cilin e futi në xhep të brendshëm. Pastaj ndezi makinën dhe u nis.
Kur mbërriti në adresën e caktuar, e ndali veturën dhe vazhdoi rrugën në këmbë, drejt ndërtesës ku banonte Istini. Kjo ishte një ndërtesë me tre kate, e ndërtuar para nja pesëdhjetë vjetësh dhe në gjendje mjaft të keqe. Duhet të kishte nja njëzet apartamente. Portier nuk kishte. Në korridorin kryesor të hyrjes shihej një varg kutish për postën dhe butona zilesh. Dyer me xhama të dyfishtë të fusnin nga rruga në korridor, por, më tutje, ishte një derë tjetër e siguruar mirë, pa dyshim e mbyllur me kyç.
Ishte ora 10,30 e natës. Në rrugë, trafiku ishte rralluar. Në afërsi të ndërtesës nuk shiheshin këmbësorë të tjerë. Nolani hyri brenda.
Pranë kutive të letrave të postës kishte tri radhë butona zilesh dhe një telefon të brendshëm. Uejnrajti gjeti butonin me emrin ISTIN dhe e shtypi. Siç e priste, nuk u përgjigj njeri.
Duke e marrë me mend se 2 G tregonte katin e dytë, ai zgjodhi kot një buton me prefiksin 3 dhe e shtypi. Në telefonin e brendshëm u dëgjua një zë i ashpër mashkulli:
— Ej, kush është?
Emri pranë butonit ishte Epëllbaj.
— Postieri, — tha Uejnrajti. — Telegram për Epëllbajin.
— Në rregull, sille lart!

Te porta e rëndë e brendshme u dëgjua një kërcitje dhe brava u hap. Uejnrajti e hapi kanatin e derës dhe hyri me nxitim.

Përballë derës ishte një ashensor, të cilin ai vendosi të mos e përdorte. Në anën e djathtë, pa një palë shkallë. I ngjiti ato, dy e nga dy, deri në katin e dytë.

Ndërsa po ngjitej lart, po mendohej për naivitetin e njerëzve në përgjithësi. Shpresonte se ai Epëllbaji nuk do të rrinte shumë duke pritur telegramin e tij. Mund të mbetej pak i çuditur, ndoshta i zhgënjyer, por kishte mundësi t'i ndodhte edhe më keq po t'ua hapte kështu derën të panjohurve. Mirëpo, banorët e apartamenteve dhe banesave të ndryshme, pavarësisht nga paralajmërimet e herëpashershme, vazhdonin të silleshin në të njëjtën mënyrë. Natyrisht, Epëllbaji mund të dyshonte dhe të thërriste policinë, ndonëse Uejnrajti nuk besonte ta bënte këtë. Sidoqoftë, mbas disa minutash, një gjë e tillë s'do të kishte më rëndësi.

Apartamenti 2 G gjendej aty nga fundi i korridorit të katit të dytë dhe brava e derës ishte e një tipi shumë të thjeshtë. Uejnrajti nxori nga portofoli prej kamoshi një sërë çelësash të ndryshëm dhe, në orvatjen e katërt, brava u rrotullua. Ai hyri në apartament, duke e mbyllur derën prapa tij. Priti pak, deri sa iu mësuan sytë në errësirë dhe, pastaj, shkoi te dritarja uli perdet. Vetëm atëherë e ndezi dritën.

Apartamenti ishte i vogël; ishte projektuar për t'u banuar vetëm nga një person. Ai përbëhej nga një dhomë e vetme, e ndarë në pjesë simbas përdorimit. Pjesa që shfrytëzohej për të ndenjur e për të ngrënë përmbante një kanape, një kolltuk, një televizor portativ dhe një tryezë të vogël. Prapa një stende ndodhej shtrati dhe kuzhina e vockël veçohej me anën e një dere të rrotullueshme. Nga dy dyer të tjera, siç e verifikoi Uejnrajti, kalohej përkatësisht në banjë dhe te një dollap rrobash në mur. Banesa ishte e mbajtur në rregull dhe e pastër. Disa rafte librash dhe një numër vizatimesh të

stampuara në korniza, i jepnin një nuancë personale ambientit.

Pa humbur kohë, Uejnrajti filloi një kontroll sistematik të banesës.

Ndërsa punonte, ai përpiqej të qetësonte rrahjet e ndërgjegjes, të shkaktuara nga veprimet e paligjshme që po kryente. Nuk mundi t'i qetësonte plotësisht. Nolan Uejnrajti e kishte të qartë se ajo që kishte bërë gjer në atë çast ishte në kundërshtim të plotë me parimet e tij morale, me besimin e tij në ligjin dhe rendin. Por, tani, ai po vepronte nën shtytjen e zemërimit; të zemërimit dhe të vetëdijes për gabimin që kishte bërë para katër ditëve.

Edhe tani i kujtohej, me një qartësi të dhimbshme, thirrja e heshtur që shprehnin sytë e portorikanes së re, Huanita Nunjezit, kur e kishin marrë në pyetje, për herë të parë, të mërkurën e kaluar. Ishte një thirrje që thoshte, në një mënyrë që s'kishte mundësi të mos kuptohej: ti dhe unë ... ti je i zi dhe unë me lëkurë të errët. Prandaj ti, më shumë se kushdo tjetër, duhet ta kuptosh që unë këtu jam vetëm, në kushte inferioriteti e në gjendje të dëshpëruar dhe kam nevojë për ndihmë. Mirëpo ai, ndonëse e kishte kuptuar thirrjen, e kishte hedhur poshtë në mënyrë të ashpër; kështu që, mbas kësaj, shprehja e parë ishte zëvendësuar me një tjetër që shfaqte përbuzje dhe atij i kujtohej se e kishte dalluar edhe këtë në sytë e saj.

Ky kujtim i dyfishtë, bashkë me fyerjen që ndjente nga mendimi se Majlls Istini ia kishte hedhur, e bënin të ishte i vendosur për ta mposhtur atë në vetë lojën e tij, paçka se kështu ai shkelte ligjin.

Prandaj, ashtu siç e kishte mësuar përvoja në polici, Uejnrajti vazhdoi kontrollin në mënyrë metodike, duke qenë i vendosur t'i gjente provat, po qe se ato ekzistonin.

Mbas një gjysmë ore, në apartament mbeteshin shumë pak vende ku mund të fshihej diçka. Ai kishte kontrolluar kuti, sirtarë, dollapin e rrobave në mur; kishte hapur valixhe dhe i kishte kontrolluar mobiliet lart e poshtë; i kishte shikuar me kujdes kornizat e vizatimeve të stampuara, të varura në mur; kishte hequr kapakun e prapmë të televizorit dhe kishte shfletuar librat, duke vënë re se një raft i tërë ishte mbushur me libra që i kushtoheshin, siç i kishin thënë, pasionit të Istinit — studimit të parave gjatë shekujve. Përveç librave, për këtë çështje kishte edhe një album, që përmbante vizatime dhe fotografi monedhash dhe bankënotash të lashta. Por, nga të gjitha këto gjëra, asnjë provë s'kishte dalë në dritë. Më në fund, Uejnrajti i grumbulloi mobiliet në një qoshe dhe hoqi qilimin që ishte shtruar në pjesën e dhomës që ishte caktuar për të ndenjur. Pastaj, me ndihmën e një elektrike dore, ai filloi të kontrollojë me imtësi çdo centimetër të dyshemesë.

Pa llampën elektrike, nuk do t'i kishin rënë në sy të dy vijat pak më të errëta se dërrasat përreth, që tregonin vendin ku ishin bërë prerjet. Ai e shtypi lehtë sipërfaqen prej nja 30 centimetrash midis të dy vijave... dhe, në zgavrën e vogël që ndodhej nën të, pa një bllok shënimesh me lidhje të zezë dhe një grumbull bankënotash njëzet dollarëshe.

Me të shpejtë, e vuri dhogën përsëri në vendin e saj, si edhe qilimin dhe mobiljet. Numëroi paratë: ishin tamam gjashtë mijë dollarë. Pastaj, i hodhi një sy me nxitim bllokut dhe pa se ishin shënime bastesh dhe lëshoi një fishkëllimë të lehtë, duke parë shumat e mëdha që ishin vënë.

E la bllokun e shënimeve te tryeza përballë divanit — ai mund të shqyrtohej më hollësi më vonë — dhe pranë tij vendosi edhe paratë.

Gjetja e parave e kishte çuditurt. Nuk dyshonte se ishte fjala pikërisht për të gjashtë mijë dollarët e zhdukur të mërkurën e kaluar, por kishte menduar se, ndërkohë, Istini do t'i kishte ndërruar bankënotat ose ta kishte depozituar të tërë

shumën në ndonjë bankë tjetër. Sidoqoftë, përvoja e tij në polici e kishte mësuar se, shpeshherë, kriminelët bënin marrëzira, vepronin në një mënyrë që s'pritej dhe ja, kjo ishte një nga ato.

Ndërkaq, mbetej akoma për t'u mësuar se si Istini i kishte marrë nga banka dhe i kishte sjellë aty tërë ato para.

Uejnrajti i hodhi edhe një sy përqark apartamentit dhe, pastaj, e mbylli dritën. Hapi përsëri perdet dhe u ul qetë-qetë në divan, për të pritur.

Mendja e tij filloi të kalojë sa në një çështje në një tjetër, në gjysmë errësirën e apartamentit të vogël, të ndriçuar, herë-herë, vetëm nga reflekset që vinin nga rruga. Mendoi përsëri për Huanita Nunjezin dhe shprehu me vete dëshirën që të mundej, në njëfarë mënyre, ta ndreqte gabimin dhe të keqen që i kishte bërë. Pastaj iu kujtua raporti i FBI-së për të shoqin, Karlosin, që e kishin gjetur në Fëniks (Arizona) dhe mendoi se kjo informatë mund të shfrytëzohej për të ndihmuar Huanitën.

Natyrisht, kishte qenë vetëm një përrallë pohimi i Majlls Istinit, se e kishte parë në bankë Karlos Nunjezin atë ditë që u zhdukën paratë: kjo ishte një përrallë e thënë me qëllim që dyshimet të binin edhe më shumë mbi Huanitën.

Ç'dobiç i neveritshëm! Çfarë njeriu ishte ky që, në fillim, vepronte në mënyrë që dyshimet të binin mbi gruan e re dhe, pastaj, përpiqej t'ia keqësonte e rëndonte edhe më shumë gjendjen! Uejnrajti ndjeu se si grushtet po i shtrëngoheshin në mënyrë të pavetëdijshme. Tha me vete se nuk duhej ta linte veten të rrëmbehej nga ndjenjat.
Kjo ishte e nevojshme dhe ai e dinte se pse. Shkaku ishte një ngjarje e vjetër, e ruajtur thellë në kujtesën e tij, prej nga rrallëherë e nxirrte. Edhe tani, pa pasur ndonjë dëshirë të veçantë, ai e la kujtimin e asaj ngjarjeje t'i dilte përsëri para sysh.

Nolan Uejnrajti, i cili tani po u afrohej të pesëdhjetave. kishte lindur në lagjen më të varfër të qytetit dhe, që prej ditës së lindjes, çdo gjë i kishte vajtur ters. Ishte rritur në mes të luftës së përditshme për ekzistencë, me krimin — pavarësisht nëse i madh a i vogël — si të vetmen normë. Në moshën djaloshare bënte pjesë në një bandë të asaj lagjeje, pjesëtarët e së cilës i quanin ndeshjet me ligjin si shenjë burrërie.

Sikurse të tjerë para dhe pas tij nga i njëjti ambient i mjerueshëm, ai nxitej nga një dëshirë e fortë për t'u bërë dikush, për të dalë në pah në një mënyrë a një tjetër, nga errësira ku ishte zhytur. Ai s'kishte aspak përvojë dhe se njihte fare filozofinë e jetës për të zgjedhur midis rrugëve të ndryshme që i dilnin përpara, për të dalluar të mirën nga e keqja, kështu që pjesëmarrja në bandat që shkelnin ligjin në rrugë dukej se ishte e vetmja karrierë e hapur për të. Kishte të ngjarë që të bëhej — siç u bënë më vonë shumë nga moshatarët e tij — klient i zakonshëm i burgjeve.

Fakti që një gjë e tillë nuk ndodhi, kjo i detyrohej pjesërisht rastësisë dhe, pjesërisht, Bafëllhed[1]) Kellit. Bafëllhedi ishte një polic i lagjes, i moshuar, i qetë, dembel dhe jo shumë i zgjuar, i cili kishte mësuar se jeta e një polici lagjeje mund të mos pësonte gjë, në rast se ishte aq i zoti sa ta rregullonte që, çdo herë që në një pikë të caktuar ndodhnin incidente, ai të gjendej diku gjetiu dhe të vepronte vetëm kur diçka të ndodhte tamam para hundës së tij. Eprorët ankoheshin, mbasi dosja e tij tregonte se numri i arrestimeve që ai kishte kryer, në krahasim me atë të kolegëve të tjerë, ishte më i vogli i të gjithë rajonit. Mirëpo, nga ana tjetër — sipas pikëpamjes së Kellit — ishte fakt që, nga viti në vit, data e daljes në pension afrohej gjithnjë e më

shumë.
Por ja që djaloshi Uejnrajt i kishte dalë tamam para hundës një natë, kur, pa dashur, Bafëllhedi kishte shqetësuar një vizitë të bandës në një magazinë. Të gjithë të rinjtë ia kishin mbathur me nxitim, me përjashtim të Uejnrajtit, që ishte penguar dhe kishte rënë sa gjatë-gjerë, te këmbët e Bafëllhedit.
— Ç'majmun budalla e i ngathët! — ishte ankuar Bafëllhedi. — Për fajin tënd, jam i detyruar tani të rri tërë natën duke mbushur shkresurina pa fund!
Kelli urrente çdo lloj pune që i dilte përpara dhe i hante kohën e lirë një polici të gjorë.
Më në fund, ai kishte përfunduar në një kompromis. Në vend që ta arrestonte, e kishte marrë me vete, po atë natë, në një ring të palestrës së policisë, ku, sipas vetë fjalëve të tij, ia kishte bërë shpinën më të butë se barkun.
Kundërveprimi i Nolan Uejnrajtit, krejt i dërrmuar, me trupin të mpirë nga grushtet e dhimbja dhe njërin sy të fryrë — por me kartelën penale të paprekur — kishte qenë një ndjenjë e thellë urrejtjeje. Ai s'mendonte gjë tjetër, veçse si të mundej ta shtronte një herë mirë në dru Bafëllhed Kellin, qëllim ky që e bëri të shkonte përsëri në palestrën e policisë — dhe te Bafëllhedi — për të mësuar mënyrën si t'ia arrinte qëllimit. Siç e kishte kuptuar shumë kohë më vonë, kjo i kishte shërbyer për të shfryrë dufin. Ai kishte mësuar shpejt e mirë. Mirëpo, kur kishte ardhur koha për ta zëvendësuar thesin prej lëkure të stërvitjes me këtë polic mendjelehtë dhe përtac, kishte konstatuar që s'kishte më dëshirë për një gjë të tillë. Përkundrazi, kishte filluar ta donte plakun Bafëllhed, gjë që e kishte çuditur edhe atë vetë.
Kishte kaluar edhe një vit, gjatë të cilit Uejnrajti kishte vazhduar stërvitjen në boks, kishte vazhduar shkollën dhe kishte mundur të qëndronte larg ngatërresave.

Më në fund, një natë, kur ishte në shërbim, Bafëllhedi kishte ndërprerë pa dashur një vjedhje në një magazinë artikujsh ushqimorë. Pa dyshim që polici kishte mbetur më i turbulluar se të dy keqbërësit dhe, sigurisht, që nuk kishte ndërmend t'i ndalte, meqë ishin edhe të armatosur. Siç u vërtetua pastaj gjatë hetuesisë, Bafëllhedi s'ishte orvatur as të nxirrte revolverin.
Ky është transkriptimi i saktë i tekstit nga imazhi, i ndarë sipas paragrafëve:

Mirëpo, njëri nga vjedhësit, që e kishte zënë paniku, kishte shtënë dhe e kishte qëlluar Bafëllhedin në bark.

Lajmi për këtë ishte përhapur me shpejtësi dhe, në vendin e ngjarjes, ishte grumbulluar një turmë njerëzish. Midis tyre ndodhej edhe Nolan Uejnrajti.

Ai nuk do ta harronte kurrë Bafëllhedin e gjorë, që përpëlitej duke thirrur nga dhimbja e tmerrshme, ndërsa gjaku dhe zorrët i dilnin nga plaga e madhe vdekjeprurëse.

Ambulanca u vonua mjaft dhe, disa minuta para se të mbërrinte, Bafëllhedi që s'kishte pushuar së thirruri, vdiq.

Kjo ngjarje kishte lënë gjurmë përgjithmonë te Nolan Uejnrajti. Por ajo që i kishte bërë më shumë përshtypje nuk kishte qenë vdekja e Bafëlhed Kellit dhe as arrestimi dhe ekzekutimi i mëvonshëm i vjedhësit që kishte qëlluar dhe i shokut të tij. Ajo që e kishte prekur më thellë se gjithçka tjetër, duke ndikuar në zhvillimin e personalitetit të tij, kishte qenë kjo humbje e jetës për hiçgjë. Vjedhja, që kishte shkaktuar krimin, ishte një gjë e ulët, e marrë, e destinuar të dështonte; por, megjithatë, duke dështuar, dëmi që kishte bërë ishte jashtëzakonisht i madh. Ky mendim, ky koncept, kishte zënë rrënjë në mendjen e Uejnrajtit të ri. E gjithë kjo kishte sjellë një spastrim të përgjithshëm të mendimeve dhe pasioneve të tij të mëparshme, me anë të të cilit ai kishte arritur ta kuante çdo krim si diçka njëlloj negative, njëlloj

shkatërrimtare si të gjitha të tjerat dhe, më në fund — mjaft kohë më vonë — si një e keqe që duhej luftuar. Ndoshta, që në fillim, ai kishte pasur një gjurmë puritanizmi thellë në shpirtin e tij, që, tani, po dilte në sipërfaqe.

Duke kaluar nga mosha djaloshare në moshën e pjekur, ai ishte brumosur me parime të patundshme dhe, nga ky shkak, ishte bërë deri diku i vetmuar, në fillim në marrëdhëniet me miqtë dhe, pastaj, me kolegët e tij të policisë. Mirëpo, ai ishte një polic që mësonte dhe bënte karrierë me shpejtësi. Nga ana tjetër, ai ishte i pakorruptueshëm, sikurse, mbas njëfarë kohe, e kishte provuar Ben Roseli dhe bashkëpunëtorët e tij.

Dhe pastaj, edhe më vonë, në Fërst Merkëntaill Ëmerikën Benk, këto cilësi të Uejnrajtit nuk ishin dobësuar, por kishin mbetur po aq të forta.

Ndoshta drejtori i shërbimit të sigurimit ishte duke dremitur, por zhurma e një çelësi në bravën e derës së apartamentit e zgjoi plotësisht. U ngrit me kujdes dhe, pastaj, u ul në divan. Ora e tij, me fushën e ndriçuar, tregonte se s'kishte shumë kohë që kishte kaluar mesnata. Një siluetë hyri në dhomë; një refleks drite nga rruga tregoi se ishte Istini. Më pas, dera u mbyll dhe, pastaj, u dëgjua se si ai kërkonte verbazi në mur çelësin e dritës. Drita u ndez.

Istini e pa menjëherë Uejnrajtin dhe ngriu në vend nga një e papritur e tillë. Goja iu hap dhe ashtu i mbeti, ndërsa tërë gjaku i iku nga fytyra. U mundua të fliste, por fjalët i mbetën në grykë. U përcoll me zor.

Uejnrajti u ngrit, me pamje kërcënuese. Zëri i tij ishte i mprehtë si tehu i një thike:

— Sa vodhe sot?

Para se Istini të mund të përgjigjej dhe të merrte veten, Uejnrajti e zuri nga jaka e xhaketës, i bëri një gjysmë rrotullimi dhe e plasi mbi kanape.

Duke iu kthyer habia në indinjatë, i riu llomotiti:

— Kush ju futi brenda? Ç'djall bëni në . . .? — U ndal, sepse vështrimi i kishte rënë te paratë dhe portofoli i zi, aty pranë.

— Ta them unë, — tha Uejnrajti me ton të ashpër. — Erdha për paratë e bankës ose, për ato pak që kanë mbetur. — Bëri shenjë me dorë nga grumbulli i bankënotave në tryezë dhe shtoi: — Ne e dimë se ato atje janë paratë që more të mërkurën. Po qe se të intereson, po të them gjithashtu se ne dimë edhe për llogaritë e palëvizshme, si edhe për të gjitha të tjerat.

Majlls Istini e vështronte, me fytyrë të ngrirë, me një shprehje të shtangur. Një dridhje, ose njëfarë përpëlitje i përshkoi trupin. Uli kokën dhe mbuloi fytyrën me të dyja duart.

— Lëri këto! — Uejnrajti ia hoqi duart nga fytyra dhe ia ngriti kokën lart, por, pa ashpërsi, duke sjellë ndërmend premtimin që i kishte bërë Inisit. Nuk do të përdoreshin metoda brutale.

Pastaj shtoi:

— Do të shkëmbejmë nja dy fjalë bashkë, prandaj le të fillojmë menjëherë.

— Më lini vetëm një çast, — u lut Istini. — Më lini një minutë të mendohem.

— As mos e kërko këtë! — Ajo që donte pikërisht t'i shmangej Uejnrajti, ishte që t'i jepte kohë Istinit për t'u menduar dhe përmbledhur. Ai ishte i zgjuar dhe, me të drejtë, do të kishte arritur në përfundimin se rruga më e mirë do të ishte heshtja. Drejtori i shërbimit të sigurimit e dinte se, hëpërhë, ai kishte dy pika në favor. Së pari, se Majlls Istini e

kishte humbur toruan; së dyti, se vetë ai nuk pengohej nga rregullat e veprimit në raste të tilla.

Ajo që donte drejtori i shërbimit të sigurimit ishte të shtinte në dorë një provë të pakundërshtueshme për të paditur Majlls Istinin për vjedhjen e gjashtë mijë dollarëve. Një pohim me shkrim, me nënshkrimin e tij, do të ishte, në këtë rast, gjëja më e mirë që mund të bëhej.

U ul përballë Istinit, duke ia ngulur sytë:
— Kjo punë mund të zgjatet sa të duash, ose mund të kryhet shpejt. Kjo varet nga ti.

Duke qenë se s'pati përgjigje, ai mori portofolin e zi dhe e hapi.
— Le të fillojmë me këtë. — Tregoi me gisht shumat dhe datat; pranë çdo paragrafi kishte një numër të koduar. — Këto janë baste, apo jo?

Istini, akoma i shushatur, pohoi me kokë.
— Më fol për këtë.
— Kjo ishte një hua prej dyqind e pesëdhjetë dollarësh, — tha nëpër dhëmbë Majlls Istini, — mbi përfundimin e një ndeshjeje ragbie midis skuadrave të Teksasit dhe Notrë Damës. — Ai përcaktoi vlerën e kuotës. Huaja kishte qenë në favor të Notrë Damës. Teksasi kishte fituar.
— Po kjo?

Përgjigje tjetër, me gjysmë zëri:
— Një ndeshje tjetër ragbie, një humbje tjetër.
— Jepi, fol! — Uejnrajti vazhdoi të ushtrojë presion mbi Istinin, duke lëvizur gishtin në faqen e fletores.

Përgjigjet dilnin me ngadalë. Disa nga bastet kishin të bënin me ndeshje basketbolli. Aty-këtu, kishte ndonjë fitim, por humbjet ishin në numër shumë të madh. Basti më i vogël ishte prej njëqind dollarësh, më i madhi prej treqind dollarësh.

— Vije bast vetëm, apo bashkë me të tjerë?
— Me të tjerë.

— Me cilët?
— Katër veta. Punojnë, si unë.
— Punojnë në bankë?

Istini tundi kokën.
— Në vende të tjera.
— Edhe ata kanë humbur?
— Pak. Por mesatarja e tyre ishte më e mirë se imja.
— Cilët janë emrat e katër të tjerëve?
Heshtje. Uejnrajti nuk nguli aq këmbë.
— Nuk ke vënë baste në garat e kuajve. Pse jo?
— Asnjëri nga ne s'e ka bërë. Të gjithë e dinë se në garat e kuajve ka dallavere; se përfundimi është i caktuar që në fillim. Te ragbia dhe basketbolli nuk ka hilé. Kishim përpunuar një sistem. Duke vënë baste në gara të ndershme, mendonim të fitonim me lehtësi.
Shuma totale e humbjeve vërtetohet se sa pa baza kishte qenë ky mendim.
— Vinit baste vetëm te një organizator bastesh, apo te disa?
— Vetëm te njëri.
— Emri i tij?
Istini heshti.
— Ku është pjesa tjetër e parave që ke vjedhur në bankë?
Fytyra e Istinit u ngrys edhe më shumë. Ai u përgjigj me zë të prerë:
— S'është më.
— Po të tjerat?
Një lëvizje pohimi me kokë, plot trishtim.
— Do të flasim prapë për këtë. Tani, le të bisedojmë për këto para. — Uejnrajti preku me dorë të gjashtë mijë dollarët që gjendeshin midis tyre. — Ne e dimë se ti i more të mërkurën. Në ç'mënyrë e bëre këtë?
Istini ngurroi për një çast, por pastaj tha:

— Mendoj se është më mirë t'jua them.
Uejnrajti ia priti me ton të prerë:
— Mirë e ke menduar, por po humbet shumë kohë.
— Të mërkurën, — tha Istini, — kishim mungesa në personel, për shkak të gripit, dhe unë zëvendësova një arkëtar.
— Këtë e di. Vazhdo! Po pastaj?
— Para se të hapej banka, shkova poshtë te Thesari për të marrë një kasetë, një nga ato që mbahen rezervë. Atje ishte Huanita Nunjezi, që po hapte bravën e kasetës së saj. I kalova pranë dhe, pa e vënë re ajo, lexova kombinacionin.
— Po, pastaj?
— E përsërita me mend dhe, sapo pata mundësi, e shënova. Në sajë të nxitjeve të Uejnrajtit, hollësitë po dilnin në dritë, njëra pas tjetrës.
Thesari i degës së bankës ishte në një sallë të nëndheshme mjaft të madhe. Gjatë orarit të punës, një arkëtar i thesarit punonte atje, brenda një si kafazi, që ndodhej menjëherë mbrapa portës së rëndë, me bravë që hapej e mbyllej brenda një kohe të caktuar. Arkëtari ishte gjithnjë i zënë me punë, duke numëruar para, duke dhënë ose marrë pako bankënotash, duke regjistruar lëvizjet e arkëtarëve dhe përmbajtjen e karreleve të tyre. Ndërsa askush nuk mund të hynte, pa u vënë re nga arkëtari, ky i fundit s'interesohej më se çfarë bënin ata që kishin hyrë brenda.

Atë të mërkurë në mëngjes, ndërsa nga pamja e jashtme dukej i gëzuar si zakonisht, Majlls Istini e kishte pasur thikën në grykë: ai kishte nevojë të ngutshme për para. Para një jave, kishte humbur shuma të mëdha në baste dhe, disa herë me radhë, i ishin drejtuar kërkesa këmbëngulëse për të shlyer detyrimet e prapambetura.

Uejnrajti e ndërpreu:
— Ti e kishe marrë një hua nga banka, me kushtet e posaçme

të parashikuara për vartësit e saj. U kishe para hua edhe agjencive të huaja, si dhe organizuesit të basteve. Kështu është?
— Ashtu.
— Edhe ndokujt tjetër?
Istini pohoi me kokë.
— Ndonjë fajdexhiu?
Djali i ri ngurroi një çast, por pastaj e pranoi.
— Po.
— Fajdexhiu të kërcënonte?
Majlls Istini njomi buzët.
— Po. Po ashtu edhe organizuesi i basteve. Të dy vazhdojnë të më kërcënojnë. — Vështrimi i tij u kthye drejt gjashtë mijë dollarëve.

Gur mbas guri, mozaiku po formohej. Uejnrajti bëri shenjë me dorë nga paratë në tryezë.
— U ke premtuar të dyve që t'i paguash me këto?
— Po.
— Sa, secilit?
— Tre mijë.
— Kur?
— Nesër. — Istini ngriti kokën dhe shikoi me nervozizëm orën e murit dhe korigjoi veten: — Sot.
— Le të kthehemi prapë te e mërkura, — vazhdoi

Uejnrajti. — Pra, mësove kombinacionin e kasetës së Nunjezit. Po, pastaj, si e përdore atë?
Ndërsa Majlls Istini tregonte hollësitë, shihej se si çdo gjë ishte zhvilluar në një mënyrë jashtëzakonisht të thjeshtë. Mbasi kishte vazhduar punën tërë mëngjesin, ai e kishte ndërprerë atë, për pushimin e drekës, në të njëjtën kohë me Huanita Nunjezin. Para se të shkonin për të ngrënë drekën, ata i kishin shpënë karrelet e tyre poshtë, te Thesari. Të dy karrelet ishin vendosur njëri pranë tjetrit, të mbyllura.
Istini ishte kthyer shpejt nga dreka dhe kishte zbritur poshtë

menjëherë. Arkëtari i thesarit e kishte regjistruar hyrjen e tij dhe, pastaj, ishte zhytur përsëri në punën e tij. Përveç atyre të dyve, në sallën e thesarit s'kishte njeri tjetër në atë çast. Majlls Istini kishte shkuar drejt e te karreli i Huanita Nunjezit dhe e kishte hapur, duke përdorur kombinacionin që kishte shënuar më parë. I ishin dashur vetëm disa sekonda për të marrë tri pako të vogla me bankënota, me një vlerë prej gjashtë mijë dollarësh, dhe i kishte futur në xhepat e brendshëm. Fryrja e shkaktuar prej tyre nuk binte shumë në sy. Pastaj, kishte nxjerrë jashtë karrelin e tij, gjë që ishte regjistruar rregullisht nga arkëtari i thesarit, dhe ishte kthyer në punë.

Për disa çaste ra heshtja. Pastaj, Uejnrajti vërejti:

— Kështu, pra, të mërkurën pasdite, gjatë tërë kohës që ajo grua e gjorë bombardohej nga pyetje të njëpasnjëshme, disa nga të cilat i bëje vetë ti, dhe më vonë, kur biseduam ne të dy, paratë i kishe me vete?

— Po, — u përgjigj Majlls Istini. Duke iu kujtuar se sa pak e vështirë kishte qenë e gjithë kjo punë, një buzëqeshje e lehtë iu formua rreth buzëve.

Uejnrajti e pa atë buzëqeshje. Pa ngurrim dhe me një lëvizje të shpejtë, u përkul përpara dhe, e qëlloi fort Istinin në fytyrë; herën e parë me pëllëmbën dhe, pastaj, me shpinën e dorës. Goditja e dyfishtë qe aq e fuqishme, saqë Uejnrajtit i dhembi dora. Në faqen e Majlls Istinit u formuan dy shenja të mëdha mavi. Ai u zmbraps dhe u struk në kanape, ndërsa sytë po i mbusheshin me lot.

Drejtori i shërbimit të sigurimit i tha me ton të ashpër:

— Kjo shërben për të të thënë se unë nuk shoh asgjë për të qeshur në atë që i bëre bankës dhe zonjës Nunjez. Asgjë prej gjëje. — Sapo kishte mësuar dhe një veçori tjetër: Majlls Istini

kishte frikë nga dhuna fizike. Pastaj, vuri re se ora ishte një e mëngjesit.

— Puna e parë që duhet të bësh është një deklaratë me shkrim, — tha ai, — me dorën tënde, e cila të përmbajë të gjitha ato që më tregove.

— Jo! Nuk do ta bëj këtë! — Zëri i Istinit ishte tani plot me mosbesim.

Uejnrajti mblodhi supet dhe tha:

— Atëherë, s'ka arsye që të rri më këtu. — Mori të gjashtë mijë dollarët dhe filloi t'i fuste në xhep.

— Ej! Nuk mund t'i merrni ato!

— Ashtu thua ti? Nuk mundem? Pa provo një herë të më ndalosh. Do t'i shpie prapë në bankë, në arkën e depozitimeve të natës.

— Dëgjoni! Ju nuk mund të provoni... . — Istini e preu fjalën. Me shumë vonesë i ra ndërmend se numrat e serive të bankënotave nuk kishin qenë regjistruar.

— Ndoshta do të mund ta provoj se këto janë të njëjtat para që u zhdukën të mërkurën në bankë dhe, ndoshta, jo. Në rast se nuk do të jem në gjendje ta provoj, ti do të kesh mundësi të hedhësh bankën në gjyq që të t'i kthejë paratë.

Istini iu lut:

— Kam nevojë për ato tani! Sot!

— Ah, po, e kuptoj. Një pjesë për organizuesin e basteve dhe tjetrën për fajdexhinë, ose për t'ua dhënë gangsterëve që ata mbajnë në shërbim, të cilët mund t'i dërgojnë te ti. Në rregull, provoje t'u shpjegosh se si i ke humbur paratë, ndonëse kam shumë dyshim nëse do të rrinë të të dëgjojnë. — Drejtori i shërbimit të sigurimit e shikoi Istinin për herë të parë në një mënyrë tallëse. — Me të vërtetë, keq i ke punët.

Ndoshta ata do të vijnë të dy bashkë dhe do të të thyejnë secili nga një krah dhe një këmbë. S'e kanë për gjë të veprojnë kështu. Apo s'e di?

Frikë, frikë e madhe, u pasqyrua në sytë e Istinit.

— Po, e di. Duhet të më ndihmoni. Ju lutem!

Nga pragu i derës, Uejnrajti u përgjigj me ton të ftohtë:

— Do ta shoh. Mbasi të kesh bërë atë deklaratën me shkrim.

Drejtori i shërbimit të sigurimit diktonte, ndërsa Istini shkruante fjalë për fjalë ato që thoshte ai.
I nënshkruari, Majlls Broderik Istin, po e bëj këtë deklaratë me vullnetin tim. Nuk i jam nënshtruar ndonjë dhune ose kërcënimi dhune ...
Pohoj se kam vjedhur nga Fërst Merkëntaill Emerikën Benku shumën prej gjashtë mijë dollarësh, rreth orës 13.30, ditën e ... Këto para i mora dhe i mbajta fshehur në mënyrën që vijon...
Pas një çerek ore, mbas kërcënimit të Uejnrajtit që po largohej, Majlls Istini ishte dorëzuar plotësisht. Tmerri e kishte bindur të bashkëpunonte.
Tani, ndërsa Istini vazhdonte të shkruante pohimin, Uejnrajti i telefonoi Inisit, agjentit të BYROSË FEDERALE TË HETIMEVE.

Gjatë javës së parë të nëntorit, gjendja shëndetësore e Ben Roselit u rëndua edhe më shumë. Që nga njoftimi që ai kishte bërë para katër javëve, forcat e tij kishin ardhur gradualisht duke u pakësuar dhe trupi i ishte dobësuar krejt, me shtimin e shpejtë të qelizave kanceroze që përpinin inde të tjera.
Atyre që shkuan të shihnin Benin plak — duke përfshirë Rosko Hejuordin, Aleks Vandervurtin, Eduina d'Orsejin, Nolan Uejnrajtin dhe këshilltarë të ndryshëm — u bëri përshtypje shpejtësia me të cilën ishte keqësuar gjendja e tij. Ishte e qartë se nuk i mbetej më edhe shumë kohë për të jetuar.
Më vonë, nga mesi i nëntorit, kur mbi qytet kishte shpërthyer

një stuhi e fuqishme, me një erë të fortë, Ben Roselin e shpunë me ambulancë në pavionin privat të spitalit Maunt Adams. Ky udhëtim i shkurtër qe i fundit që ai bëri i gjallë. T'animë e mbanin vazhdimisht me mjete qetësuese, kështu që periudhat kur vinte në vete dhe ishte i ndërgjegjshëm pakësoheshin dita-ditës e më shumë.
Mundësia e fundit e një ndërhyrjeje, sado të vogël, nga ana e tij, në drejtimin e Fërst Merkëntaill Emerikën

Benkut, ishte zhdukur tashmë një herë e mirë. Një grup këshilltarësh të vjetër kishin vendosur, në një takim jozyrtar, që të organizohej mbledhja zyrtare e këshillit administrativ, me pjesëmarrjen e të gjithë anëtarëve, për emërimin e pasardhësit të Ben Roselit.

U caktua që mbledhja të bëhej më katër dhjetor.

Këshilltarët filluan të vinin pak para orës dhjetë. Përshëndetën njëri-tjetrin përzemërsisht, me një sjellje që pasqyronte besim të shpenguar në vetvete, e cila është karakteristikë e afaristëve që u shkojnë punët mbarë, kur kanë përreth njerëz të rangut të tyre.

Megjithatë, në krahasim me herët e tjera, përzemërsia ishte deri diku më e përmbajtur, në shenjë respekti për Ben Roselin, që ishte në shtratin e vdekjes dhe që, as dy kilometra larg tyre, po përpiqej akoma me forcat e fundit, të kapej pas jetës. Mirëpo, në fushën e tregtisë, këshilltarët e mbledhur ishin njëlloj si admiralë dhe feldmareshalë — siç kishte qenë dhe vetë Beni në kohën e tij — të cilët e dinin se cilado qoftë pengesa, veprimet tregtare, që janë ato që vajisin mekanizmat e qytetërimit, duhet të vazhdojnë. Qëndrimi i tyre dukej se thoshte: shkaku që jemi mbledhur këtu është i dhimbshëm, por, prapëseprapë, ne do ta kryejmë detyrën tonë solemne.

Kështu pra, ata hynë të vendosur në sallën e këshillit, në faqet e mureve të veshura me panela arre të së cilës ishin varur portrete dhe fotografi të disa paraardhësve, që kishin vdekur

shumë kohë më parë, por që dikur kishin qenë edhe ata njerëz të shquar.

Në ndërmarrjet e mëdha amerikane, këshilli administrativ i ngjan pak a shumë një klubi të rezervuar për anëtarët e tij. Me përjashtim të tre ose katër funksionarëve të lartë, që punojnë aty me orar të plotë pune, këshilli përmban edhe nja njëzet afaristë të njohur nga sektorë të tjerë, të cilët, nga ana e tyre, janë shpeshherë presidentë firmash ose këshilltarë administrativë.

Zakonisht, këta këshilltarë të jashtëm ftohen të bëjnë pjesë në këshillin administrativ për arsye të ndryshme, siç janë: sukseset që kanë pasur ata vetë, prestigji i ndërmarrjes që ata përfaqësojnë, ose ndonjë lidhje e fortë — zakonisht financiare — me firmën, në këshillin administrativ të së cilës bëjnë pjesë.

Afaristët e quajnë nder të madh të emërohen këshilltarë dhe, sa më e rëndësishme dhe me zë të jetë firma që I emëron, aq më e madhe është dhe lavdia. Kjo është arsyeja se pse shumë afaristë i koleksionojnë funksionet e këshilltarëve ashtu si dikur indianët koleksiononin si trofe skalpet e armiqve të tyre të vrarë. Një arsye tjetër është se këshilltarët trajtohen me një respekt të veçantë që e kënaq plotësisht krenarinë e tyre dhe, nga ana tjetër, marrin shpërblime të majme — firmat më të mëdha i japin çdo këshilltari një mijë gjer në dy mijë dollarë për çdo mbledhje; dhe normalisht, ka dhjetë mbledhje në vit.

Me prestigj të veçantë është funksioni i këshilltarit administrativ në një nga bankat më të rëndësishme. Për një afarist amerikan, të ftohesh për të bërë pjesë në këshillin e një banke të tillë është, deri diku, njëlloj si të emërohesh kalorës nga mbretëresha e Anglisë; ja sepse ky funksion është kaq i dëshiruar. Duke qenë një nga njëzet bankat më të rëndësishme të vendit, FMA-ja kishte një grup këshilltarësh të një niveli shumë të lartë.

Ose të këtij mendimi ishin ata. Aleks Vandvurti, duke vërejtur këshilltarët e tjerë që po zinin vend rreth tryezës së gjatë vezake, tha me vete se aty kishte mjaft degë të thata që duheshin prerë. Nga ana tjetër, kishte edhe konflikte interesash, mbasi disa këshilltarë — ose, më mirë, firmat përkatëse — ishin nga huamarrësit më të mëdhenj të bankës. Një nga pikësynimet e tij me afat të gjatë, në rast se do të bëhej president i FMA-së, do të ishte ta bënte këshillin administrativ më të përfaqësueshëm dhe më pak të ngjashëm me një klub, ku shkohet për të kaluar kohën e lirë.

Mirëpo, a do të bëhej ai presidenti i FMA-së, apo Hejuordi?

Të dy ishin kanidatë për këtë post. Të dy do të paraqitnin shkurtimisht sugjerimet dhe pikëpamjet e tyre. Xherom Petërtoni, nënkryetar i Këshillit, i cili do të kryesonte mbledhjen e asaj dite, e kishte marrë veças Aleksin dhe i kishte thënë:

— Si të gjithë të tjerët, ti e di se do të zgjedhim njërin nga ju të dy, ty ose Roskonë. Të dy ju jeni të mirë dhe zgjedhja nuk është e lehtë. Prandaj, të kërkoj që të na ndihmosh. Na fol, ashtu siç e mendon, për kriteret që të duken më të mira për administrimin e FMA-së.

Aleksi e kishte të qartë se Rosko Hejuordit i ishte bërë e njëjta kërkesë.

Siç e kishte zakon, Hejuordi e kishte përgatitur që më parë tekstin e fjalës që do të mbante para këshillit. I ulur përballë Aleksit, ai po e shqyrtonte tekstin me vëmendje, me fytyrën e tij të mprehtë, që kishte marrë tani një shprehje serioze, me vështrimin, prapa xhamave të syzeve pa skelet, të ngulur te fletët e shtypura para tij. Një nga cilësitë e Hejuordit ishte se, kur duhej, ai mund ta përqëndronte mendjen e tij të mprehtë, sidomos kur ishte fjala për shifra. Një herë, një koleg kishte vërejtur: «Roskoi është në gjendje të lexojë një bilanc fitimesh

dhe humbjesh, po ashtu sikurse një dirigjent orkestre lexon një partiturë, duke kapur nuancat, notat joharmonioze, pjesët jo të plota, të cilat të tjerëve nuk do t'u binin në sy.» S'kishte dyshim se, pavarësisht nga përmbajtja e fjalimit të vogël që ai kishte përgatitur për ta mbajtur atë ditë, shifrat nuk do të mungonin në të.

Aleksi nuk e dinte mirë akoma nëse, në fjalën e tij, do të përdorte shifra apo jo. Në rast se do të ishte e nevojshme të përdorte, atëherë do t'i duhej t'i thoshte nga mendja, mbasi ai s'kishte sjellë asnjë shënim me vete. Gjatë mbrëmjes së ditës së mëparshme, ai ishte menduar gjatë për këtë dhe, më në fund, kishte vendosur që, kur t'i vinte radha, të fliste instinktivisht, si t'i dukej më e volitshme, duke lënë që konceptet dhe fjalët të zënë vetë vendin e duhur.

Iu kujtua se si, pak kohë më parë, po në këtë sallë, Ben Roseli kishte njoftuar: «Puna është se s'e kam të gjatë. Ky është mendimi i mjekëve». Fjalët e tij kishin qenë një pohim — dhe akoma ashtu ishin — se gjithçka në jetë ka një fund. Fjalët e tij talleshin me cilatdo ambicie: ato të vetë atij, të Rosko Hejuordit, të të tjerëve.

Por, prapëseprapë, pavarësisht nëse në fund do të dilte se ambicia është e kotë ose jo, Aleksi kishte shumë dëshirë të bëhej president i FMA-së. Ai priste rastin që — ashtu siç kishte bërë Ben Roseli në kohën e tij, — të jepte udhëzime, të vendoste vijën që duhej ndjekur, të përcaktonte përparësinë e veprimeve dhe, me anë të të gjitha vendimeve që do të merrte gjatë tërë kohës që do të ishte në atë post, të linte prapa një kontribut të vlefshëm. Dhe, pavarësisht nga fakti se, në të ardhmen, veprimet e tij do të kishin rëndësi të madhe ose të vogël, ai do të kishte gjetur kënaqësi në vetë entuziazmin e veprimit, drejtimit, përpjekjeve, konkurimit.

Përballë tij, në të djathtë, u ul në vendin e vet i nderuari Harold Ostin. Ai kishte veshur një kostum shumë elegant, me

këmishën klasike me kopsa dhe kravatë me katrorë të vegjël. Dukej si një nga ato modelet që shihen në faqen e revistës «Plejboj». Mbante në dorë një puro të trashë, gati për ta ndezur. Aleksi e vuri re Ostinin dhe e përshëndeti me kokë. Përshëndetja iu kthye, por me një ftohtësi të dukshme.

Para një jave, i nderuari Harold kishte shkuar tek Aleksi për të protestuar për veton që ky i fundit i kishte vënë fushatës publicitare të letërkrediteve *Kiçarxh*, të përgatitura nga agjencia «Ostin». «Shtimi i tyre është miratuar nga këshilli administrativ, — kishte thënë ai. — Veç kësaj, përgjegjësit e seksionit *Kiçarxh* kishin urdhëruar që më parë për fillimin e fushatës publicitare. Nuk e di akoma nëse duhet të tërheq apo jo vëmendjen e këshillit për këtë shpërdorim posti nga ana jote.»

Aleksi i ishte përgjigjur me ton të prerë: «Pikë së pari, unë e di shumë mirë se ç'vendosin këshilltarët, se isha edhe vetë atje. Veç që ata nuk vendosën që shtesa e letërkrediteve *Kiçarxh* të shoqërohej me një fushatë publicitare të ndërtuar keq, mashtruese dhe diskredituese për bankën. Bashkëpunëtorët e tu në fushën artistike, mund të bëjnë një punë më të mirë se kjo, Harold; bile, një gjë të tillë e kanë bërë tanimë — unë i pashë dhe i miratova njoftimet e reja që kishin përgatitur. Përsa i përket asaj që ti e quan shpërdorim posti, unë mora një vendim që përfshihet krejtësisht brenda kufijve të autoritetit tim dhe, çdo herë që do të jetë e nevojshme, do të veproj në të njëjtën mënyrë. Prandaj, në rast se vendos ta ngresh këtë çështje para këshillit, bëj si të duash, por, unë mendoj që këshilltarët nuk do të të falënderojnë për këtë; bile, ka mundësi, që të më falënderojnë mua.»

Harold Ostini kishte parë shtrembër, por, pastaj, kishte vendosur të mos e zgjaste më këtë punë dhe ky kishte qenë një vendim me mend, ngaqë ndryshimi i njoftimeve publicitare «Ostin». Sidoqoftë, Aleksi e dinte se kishte krijuar një armik, ndonëse dyshonte që kjo gjë të kishte ndonjë

rëndësi të veçantë; ishte e qartë se i nderuari Harold preferonte Rosko Hejuordin dhe kishte të ngjarë që ta përkrahte atë në çdo rast.

Njëri nga përkrahësit më të fortë të Aleksit, siç e dinte edhe ai vetë, ishte Leonard L. Kingsudi, presidenti i papërmbajtur dhe energjik i këshillit të uzinave të çelikut *Northëm*, që tani ishte ulur në krye të tryezës dhe po bisedonte me kolegun që kishte pranë. Pikërisht Len Kingsudi i kishte telefonuar Aleksit, para disa javësh, për ta vënë në dijeni se Rosko Hejuordi po u kërkonte këshilltarëve të mbështesnin kandidaturën e tij. «Unë nuk them se ti duhet të bësh po ashtu, Aleks. Një vendim të tillë mund ta marrësh vetëm ti, por të paralajmëroj se propaganda e tij mund të jetë me efekt. Mirëpo, unë nuk u gënjeva; ai nuk e ka brumin për të qenë në krye dhe këtë ia thashë në mënyrë të qartë. Vetëm që, mënyra se si flet e vepron është kaq bindëse saqë shumë njerëz mund të bien brenda.»

Aleksi e kishte falënderuar Len Kingsudin për informatën që i kishte dhënë, por nuk e kishte parë me vend që ta bënte si Roskoi. Kërkesa të tilla të drejtpërdrejta mund të kishin sukses në disa raste, por mund edhe të ngjallnin një lloj kundërshtimi ndër ata që nuk pranonin presione personale në këto punë. Veç kësaj, Aleksit s'i pëlqente të bënte fushatë për veten e tij, për të zënë postin e Benit, ndërsa plaku ishte akoma i gjallë. Sidoqoftë, Aleksi e kuptonte nevojën e asaj mbledhjeje dhe të vendimeve që do të merreshin aty.

Në sallë, murmuritja e bisedave u qetësua. Dy këshilltarët e fundit, që priteshin, erdhën dhe zunë vendet e tyre. Xherom Petërtoni, i ulur në krye, goditi lehtë tryezën me një çekan të vogël dhe njoftoi:

— Zotërinj, mbledhja hapet.

Petërtoni, i cili atë ditë binte shumë në sy, zakonisht rrinte mënjanë dhe, midis funksionarëve drejtues të bankës, mbahej pak a shumë si oportunist. Ai ishte tani rreth të gjashtëdhjetave dhe afër daljes në pension. Disa vjet më parë kishte filluar punën aty, mbas shkrirjes së FMA-së me një bankë tjetër më të vogël. Që prej asaj kohe, përgjegjësitë e tij ishin pakësuar gradualisht dhe me mirëkuptim të dyanshëm. Tani, Petërtoni e kalonte një pjesë të kohës në seksionin e kreditit dhe duke luajtur golf me klientët. Golfi për të kishte përparësi aq sa Xherom Petërtoni rrallëherë gjendej në zyrë mbas orës 14,30. Funksioni i tij si nënkryetar i këshillit ishte më shumë një funksion nderi.

Pamja e tij i ngjante asaj të një zotërie fshati. Pothuajse krejt tullac, me përjashtim të një kurore qimesh, që i kishte në kafkën ngjyrë trëndafili e cila mbaronte lart me majë, shumë të ngjashme me skajin me majë të vezës. Në kontrast të fortë me pamjen e përgjithshme, vetullat i kishte të mëdha e të dendura, ndërsa sytë, poshtë tyre, bojë hiri dhe të dalë, kishin filluar të dukeshin gjithnjë si të përlotur. Veshja me *tuid*[1]) ia plotësonte edhe më shumë pamjen e një zotërie fshati. Simbas mendimit të Aleks Vandervurtit për Petërtonin, nënkryetari i këshillit kishte mendje të mprehtë, por, prej disa vjetësh, e kishte përdorur në minimum, si një motor që punon pa qenë lidhur me boshtin e transmisionit.

Siç parashikohej, Xherom Petërtoni filloi me homazhe, drejtuar figurës së Ben Roselit dhe, mbas kësaj, lexoi me zë të lartë buletinin e fundit të spitalit, që njoftonte për «rënien e energjive fizike dhe të gjendjes së përgjithshme.» Shumë nga këshilltarët shtrënguan buzët dhe tundën kokën. «Por jeta e komunitetit tonë duhet të vazhdojë,» — vijoi nënkryetari; dhe, pastaj, ai përmendi njërën pas tjetrës arsyet që e kishin bërë të nevojshme thirrjen e asaj mbledhjeje, më e rëndësishmja e të cilave ishte emërimi i shpejtë i presidentit të ri të Fërst Merkentajll Emerikën Benkut.

— Sigurisht që shumica juaj e njeh procedurën e zakonshme. — Ai njoftoi, pastaj, gjë që e dinin të gjithë, se Rosko Hejuordi dhe Aleks Vandervurti do të mbanin secili para këshillit raportin e tyre programatik dhe, pastaj, do të dilnin nga salla, për t'u dhënë mundësi këshilltarëve të diskutonin mbi kandidaturën e tyre.

— Për të vendosur se cili nga të dy do ta marrë fjalën i pari, do të përdorim kriterin e përparësisë, që na udhëheq të gjithë, që nga lindja: gërma e parë e mbiemrit. — I shkeli synë Aleksit, duke thënë: — «P»-ja më ka kushtuar shtrenjtë nganjëherë; shpresoj që ajo «V»-ja jote të mos të ketë munduar shumë.

— Jo dhe aq, — ia priti Aleksi. — Ka pasur raste kur më ka dhënë mundësinë të thosha fjalën e fundit.

Për të parën herë atë mëngjes, të qeshura u dëgjuan në sallën e këshillit. Edhe Rosko Hejuordi mori pjesë, me një buzëqeshje që dukej sikur kishte dalë, deri diku, me pahir.

— Rosko, — tha Xherom Petërtoni, — kur të jesh gati, mund të fillosh.

— Falemnderit, zoti kryetar. — Hejuordi u ngrit në këmbë, largoi karrigen mbrapa dhe kaloi me qetësi vështrimin te të nëntëmbëdhjetë këshilltarët e tjerë, të ulur rreth tryezës. Piu një gllënjkë ujë nga gota që kishte përpara, u kollit lehtë për të çliruar grykën dhe filloi të flasë me zë të qartë dhe me ton të njëjtë.

— Zotërinj, duke qenë se kjo është një mbledhje e ngushtë dhe e brendshme, për të cilën nuk do të vihet në dijeni shtypi dhe po ashtu aksionistët e tjerë, pa u zgjatur, do të vë theksin mbi atë që, sipas meje, është objektivi kryesor imi, si edhe i këshillit: rentabiliteti i *Ërst Merkëntaill Emerikën Benkut*. — Ai përsëriti duke e theksuar fort: — Rentabiliteti, zotërinj, detyra jonë me përparësi absolute.

U hodhi një vështrim fletëve që kishte përpara dhe vazhdoi: — Më lejoni ta shtjelloj këtë pikë. Simbas mendimit tim, sot, shumë vendime në fushën bankare dhe, në përgjithësi, në fushën e tregtisë, ndikohen mjaft nga çështjet shoqërore dhe kundërshtimet e grindjet që ekzistojnë në epokën tonë. Si bankier, unë mendoj se kjo është e gabuar. Me këtë, nuk dua aspak të pakësoj rëndësinë e ndërgjegjes shoqërore të personave të veçantë; imja, shpresoj se është e zhvilluar mirë. Dhe mendoj, gjithashtu, se është mirë që secili prej nesh të bëjë, herë pas here, një rishqyrtim të vlerave të veta, duke u bërë atyre ndryshime në dritën e ideve të reja, duke dhënë kështu kontributin e tij të mundshëm vetjak. Mirëpo, vija që duhet ndjekur nga një grup është një gjë krejt e ndryshme. Ajo nuk duhet t'i nënshtrohet çdo teke dhe ndryshimi që vihet re në jetën shoqërore. Po të ndodhte kështu, në qoftë se do të lejonim që ky koncept të drejtonte vendimet tona lidhur me bankën, iniciativa e lirë amerikane do të dëmtohej dhe do të shkaktohej një katastrofë për vetë bankën, sepse, si rrjedhojë e kësaj, do të vinte pakësimi i forcës sonë, vonesë në planin tonë të zhvillimit dhe pakësimi i fitimeve tona. Me pak fjalë, në të njëjtën mënyrë si institucionet e tjera, edhe ne duhet të qëndrojmë larg skenës politiko-shoqërore, me të cilën s'kemi të bëjmë, përveçse për të ditur se gjer në ç'masë ajo mund të ndikojë në gjendjen ekonomike të klientëve tanë.

Oratori buzëqeshi lehtë, duke e zbutur deri diku qëndrimin e tij serioz.

— E pranoj se këto fjalë, — vijoi ai, — po të thuheshin në publik, nuk do të ishin diplomatike dhe, sigurisht, nuk do të priteshin mirë. Do t'ju them, bile, se në publik nuk do t'i thosha kurrë. Por këtu, midis nesh, kur merren vendime themelore dhe përcaktohet vija jonë e veprimit, i quaj ato si krejtësisht realiste.

Disa këshilltarë tundën kokën në shenjë miratimi. Bile, njëri prej tyre, i entuziazmuar, qëlloi tryezën me grusht. Të tjerë, duke përfshirë Leonard Kingsudin, qëndruan me fytyrat të qeta, që nuk shprehnin asnjë lloj ndjenje a emocioni.

Aleks Vandervurti po mendohej: Pra, Rosko Hejuordi kishte zgjedhur rrugën e ballafaqimit të drejtpërdrejtë, atë të një ndeshjeje të plotë të pikëpamjeve të kundërta. Siç e kishte të qartë sigurisht edhe vetë Hejuordi, të gjitha ato që ai kishte thënë gjer në atë çast, ishin krejtësisht në kundërshtim me bindjet e Aleksit, po ashtu edhe të Ben Roselit, i cili, gjatë viteve të fundit, u kishte dhënë gjithnjë e më shumë përkrahjen e tij dhe FMA-së punimeve të ndryshme publike, si brenda vetë qytetit, duke përfshirë edhe Rajonin Lindor, ashtu edhe në shkallë shtetërore. Por Aleksi nuk kishte iluzione. Një pjesë e mirë e këshillit nuk kishte qenë, në thellësi, e një mendjeje me këto veprime të Benit dhe, sigurisht, do të përkrahte vijën e ashpër të Hejuordit, që synonte vetëm të siguronte një rentabilitet sa më të madh në të gjithë veprimtarinë e bankës. Problemi ishte: sa e madhe ishte kjo pjesë e këshillit, në favor të kësaj vije të ashpër?

Aleksi ishte i një mendjeje vetëm me njërin nga pohimet që kishte bërë Rosko Hejuordi. *Ky kishte thënë:* «Kjo është një mbledhje e ngushtë dhe e brendshme... ku merren vendime themelore dhe përcaktohet vija jonë e veprimit.»

Fjala-kyç kishte qenë «themelore».

Ndërsa, më vonë, kjo vizitë e bankës do t'u paraqitej aksionistëve dhe publikut me ngjyra të bukura dhe në një mënyrë që të vë në gjumë, me anë të raportit vjetor të përpunuar me kujdes dhe mjeteve të tjera. Mirëpo aty, brenda të katër mureve të sallës së këshillit, përcaktoheshin me fjalë të qarta pikësynimet e vërteta. Kjo ishte një nga arsyet që midis cilësive që duhet të ketë një këshilltar janë konspiracioni dhe heshtja.

— Ka një ngjasi të madhe, — vazhdoi Hejuordi, — midis asaj që sapo paraqita dhe asaj që ka ndodhur në kishën ku unë shkoj dhe nëpërmjet së cilës edhe unë jap ndonjë kontribut në shoqëri.

Në 1960, kisha jonë filloi të shpenzojë para dhe t'u kushtojë kohë problemeve të ndryshme shoqërore, veçanërisht përmirësimit të kushteve të zezakëve. Kjo u detyrohej pjesërisht presioneve të jashtme, por edhe faktit se disa anëtarë të kongregacionit tonë mendonin që kjo ishte një nismë e mirë. Në shumë pikëpamje, kisha jonë ishte bërë si një agjenci asistence sociale. Mirëpo, kohët e fundit, disa nga ne morën frenat në dorë dhe vendosëm se një aktivizim i tillë nuk ishte me vend dhe se duhej të kufizoheshim në detyrat themelore që kanë të bëjnë me kultin fetar. Prandaj shtuam numrin e ceremonive fetare, të cilat i quajmë si funksionin kryesor të kishës sonë, duke ua lënë asistencën sociale qeverisë dhe enteve përkatëse, të cilave, sipas mendimit tonë, u takon të kryejnë një punë të tillë.

Aleksi po pyeste veten nëse kishte të tjerë, ndërmjet këshilltarëve, sikurse ai vetë, që ta kishin të vështirë ta quanin asistencën sociale si një veprimtari «të papërshtatshme» për një kishë.

— Thashë se fitimet duhet të jenë pikësynimi ynë kryesor,— vazhdoi Rosko Hejuordi. — E di se disa nuk e pranojnë këtë koncept. Ata pohojnë se të kërkosh, në radhë të parë fitimet, është një kriter trashanik, miop, egoist, i përbuzshëm, i zhveshur nga çdo vlerë shoqërore, që të mund ta bënte të pranueshëm. — Buzëqeshi me keqardhje dhe, pastaj, vijoi: — Ju, zotërinj, i dini sigurisht mirë këto lloj argumentesh. E pra, si bankier, unë nuk jam aspak i një mendjeje me to. Kërkimi i fitimeve nuk është një kriter miop. Nga ana tjetër, përsa i përket kësaj banke ose cilësdo banke tjetër, rentabiliteti ka një vlerë të lartë shoqërore.

Po e shtjelloj dhe pak këtë pikë:

Çdo bankë i llogarit fitimet simbas kuotës së fitimeve të aksioneve. S'ka dyshim se këto të fundit, që natyrisht bëhen të njohura publikisht, studiohen me vëmendje të madhe nga vetë aksionistët, nga pronarët e shumave të depozituara në bankë, investuesit dhe grupet financiare kombëtare dhe të huaja. Një rritje ose pakësim i vlerës së dividendit interpretohet si një shenjë përkatësisht force ose dobësie.

Kur dividendi është i lartë, edhe besimi në bankat në fjalë është gjithashtu i madh. Mirëpo, le ta zëmë se në një kohë të caktuar, dividendi i disa bankave të rëndësishme është pakësuar. Ç'do të ndodhte në këtë rast? Do të përhapej një shqetësim dhe ankth i përgjithshëm, i cili, së shpejti, do të kthehej në alarm: depozituesit do të nxitonin të tërhiqnin fondet dhe aksionistët investimet e tyre, kështu që aksionet e këtyre bankave do të binin shumë poshtë dhe, vetë bankat, do të gjendeshin në buzë të greminës. Shkurt, do të shkaktohej një krizë publike nga më seriozet.

Rosko Hejuordi hoqi syzet dhe pastroi xhamat me një shami të bardhë liri.

— Dhe, të mos thuhet se një gjë e tillë s'mund të ndodhë. Ndodhi një herë gjatë krizës që nisi në 1929-ën, ndërsa sot, kur bankat janë më të zhvilluara dhe më të mëdha se atëherë, pasoja do të ishte një katastrofë e vërtetë.

Ja sepse, një bankë si kjo jona nuk duhet të lërë mbas dore, për asnjë çast, detyrën që ka: të sigurojë fitime për vete dhe për aksionistët e saj.

Përsëri u dëgjuan murmuritje miratimi rreth e qark tryezës. Hejuordi ktheu faqen e shënimeve.

— Si mund të sigurojmë ne, si bankë, maksimumin e fitimeve? Do t'ju them, në fillim, se si veprohet për të mos e arritur këtë qëllim.

Ne nuk do ta arrijmë këtë qëllim në rast se përzihemi në projekte, të cilat, sado për t'u admiruar qofshin përsa u përket qëllimeve të tyre, nuk kanë garanci nga ana ekonomike, ose mbajnë pa u përligjur, vite me radhë, fonde të bankës me një përqindje të vogël interesi. E kam fjalën, natyrisht, për financimin e ndërtimeve të banesave publike. Në asnjë rast nuk duhet të investojmë më shumë se sa një pjesë minimale të fondeve të bankës për hipotekat e banesave të çdo lloji, që dihet se janë me rentabilitet të vogël.

Gjithashtu, s'duhet të bëjmë lëshime dhe të pakësojmë përqindjen e interesave aktive, për shembull në favor të të ashtuquajturave pakica. Kjo është një fushë, në të cilën, në ditët tona, bankat u nënshtrohen presioneve shumë të mëdha. Ne duhet t'u rezistojmë atyre, jo për arsye raciale, por duke u nisur nga leverdia ekonomike. Kur të jetë rasti, le t'u japim hua pakicave, por kushtet dhe taksat të jenë të barabarta për të gjithë.

Nga ana tjetër, nuk duhet të merremi me çështje të ngatërruara lidhur me ambientin. Nuk është puna jonë të gjykojmë nëse klientët tanë i kryejnë punët e tyre duke i respektuar si duhet apo jo rregullat e ekologjisë. Neve na intereson vetëm që ata të gëzojnë shëndet të mirë nga pikëpamja ekonomike.

Me pak fjalë, ne nuk mund të sigurojmë rentabilitet, duke u bërë kujdestarë, gjykatës apo roja burgu të të tjerëve.

Oh, herë pas here, mundemi edhe të përkrahim me prestigjin tonë disa objektiva publike, siç janë ndërtimet e banesave popullore me kosto të ulët, punimet për përmirësimin e kushteve të ambientit, të energjisë, dhe për çështje të tjera që mund të dalin. Fundi i fundit, banka jonë ka ndikim dhe prestigj, që ne mund t'i huajmë, pa pësuar humbje ekonomike. Mund të japim edhe ndonjë hua simbolike; për këtë, kemi seksionin e marrëdhënieve publike, detyra e të cilit është pikërisht të bëjë të njohur ofertat tona dhe, nganjëherë,

edhe (ai qeshi lehtë) ... «ta teprojë pak». Por, për të siguruar një rentabilitet të vërtetë, ne duhet t'i drejtojmë gjetiu përpjekjet tona.

Çfarë kritike mund t'i bëje Hejuordit, mendonte Aleks Vandervurti, por me siguri që nuk mund të ankoheshe se nuk i kishte sqaruar sa duhej pikëpamjet e tij. Në njëfarë mënyre, fjala e tij kishte qenë një deklaratë e ndershme. Mirëpo, ajo kishte qenë gjithashtu e logaritur me dinakëri dhe, bile, në mënyrë cinike.

Shumë drejtuesve tregtarë dhe financierë, duke përfshirë mjaft nga këshilltarët që ishin mbledhur aty, nuk u pëlqenin kufizimet që i viheshin lirisë së tyre për të fituar para. Ata ndjenin përbuzje edhe kundrejt nevojës që të flitej në publik me njëfarë përmbajtjeje për të mos shkaktuar shpërthime zemërimi nga ana e shoqatave të konsumatorëve ose kritikëve tregtarë të tjerë. Pra, për ata ishte kënaqësi t'i dëgjonin bindjet e tyre të thella, të shprehura me zë të lartë dhe me fjalë të qarta.

S'kishte dyshim se Rosko Hejuordi e kishte pasur parasysh këtë faktor dhe Aleksi ishte i sigurt që, para se ta bënte këtë hap, ai e kishte logaritur se sa nga të pranishmit do të votonin në favor të tij.

Por edhe Aleksi i kishte bërë logarité e veta, simbas të cilave një pjesë e mirë e këshilltarëve mund të bënin që balanca të anonte nga ana e tij. Por, më parë, ata duheshin bindur. — Veçanërisht, — vazhdoi Hejuordi, — banka jonë duhet t'i shtojë, si në të kaluarën, lidhjet e saj me industrinë amerikane. E kam fjalën për ato industri që sigurojnë fitime të mëdha, të vazhdueshme, gjë që do të sillte edhe rritjen e fitimeve tona.

Me fjalë të tjera, jam bindur se FMA-ja përdor tani vetëm një pjesë të pamjaftueshme të fondeve të saj për financimet e

mëdha industriale dhe se një program për shtimin e kësaj kategorie investimesh duhet të vihet në zbatim menjëherë...

Ky mendim ishte diskutuar disa herë në të kaluarën nga Rosko Hejuordi, Aleks Vandervurti dhe Ben Roseli. Argumentat e Hejuordit nuk ishin të reja, por ai i paraqiti në mënyrë bindëse, duke i ilustruar me shifra dhe grafikë. Aleksi vuri re se kjo u kishte bërë përshtypje këshilltarëve.

Hejuordi vazhdoi të fliste edhe një gjysmë ore mbi shtimin e financimeve për industrinë dhe pakësimin e fondeve në favor të veprave shoqërore. E mbylli fjalimin me atë, që ai vetë e quajti «një thirrje drejtuar arsyes».

— Në ditët tona, bankat kanë sidomos nevojë për një udhëheqje energjike që të mos e lërë veten as të mposhtet nga ndjenjat dhe as të shtyhet nga kërkesat dhe presionet e publikut drejt një përdorimi «pa vend» të parave. Si bankierë, ne duhet të ngulim këmbë, duke thënë «jo», kur pikëpamjet tona për një çështje të jenë negative dhe, të themi «po», vetëm kur të shohim një mundësi konkrete fitimi. Nuk duhet të blejmë kurrë një popullaritet të fituar me lehtësi, në kurriz të aksionistëve. Përkundrazi, paratë tona dhe të atyre që i kanë depozituar te ne, duhet t'i investojmë sa mirë dhe, po qe se, si rezultat i këtij qëndrimi, do të na quanin «bankierë kokëfortë», ashtu qoftë! Unë do të isha i kënaqur të bëja pjesë në një grup të tillë.

Hejuordi u ul në mes të duartrokitjeve.

— Zoti kryetar! — Leonard Kingsudi u përkul përpara, duke ngritur dorën. — Kam disa pyetje dhe s'jam i një mendjeje me diçka.

I nderuari Harold Ostin ia priti nga ana tjetër e tryezës:

— Të shënohet në procesverbal, zoti kryetar, se unë nuk kam asnjë pyetje dhe jam plotësisht i një mendjeje me sa u tha gjer tani.

U dëgjuan disa të qeshura dhe një zë tjetër, ai i Filip Xhohansënit, president i Mid Kontinent Rabër, që shtoi:

— Jam me ty Harold. Mezi pres që të adoptojmë një vijë veprimi më të ashpër. U dëgjua dhe një zë tjetër, që tha:
— Edhe unë.
— Zotërinj, zotërinj! — Xherom Petërtoni trokiti lehtë me çekanin e vogël mbi tryezë. — Kemi përfunduar vetëm një pjesë të punës sonë. Do t'ju jap mundësi për të bërë pyetje më vonë dhe, përsa u përket pikëpamjeve të kundërta, sugjeroj që këto të shqyrtohen gjatë diskutimit tonë të fundit, kur Roskoi dhe Aleksi do të kenë dalë nga salla. Por, më parë, le të dëgjojmë Aleksin.
— Shumë nga ju më njihni mirë, qoftë si njeri, ashtu edhe si bankier, — filloi Aleksi. Qëndronte në këmbë, me trupin krejt të lirë dhe, si zakonisht, me shpatullat pak të përkulura. Herë pas here, përkulej edhe më shumë përpara, për t'u hedhur vështrimin këshilltarëve të ulur në të majtë e në të djathtë të tij. Zëri kishte tonin normal të bisedës.
— Nga ana tjetër, e dini ose duhet ta dini se, si bankier, unë nuk bëj lëshime: bankier «kokëfortë», në qoftë se ndokush pëlqen më shumë këtë fjalë. Kjo vërtetohet nga operacionet financiare që kam drejtuar për FMA-në: të gjitha me fitim; asnjëra me humbje. Është e qartë se, qoftë në fushën bankare qoftë në cilëndo fushë tjetër, kur merresh me çështje tregtie dhe ke si objektiv rentabilitetin, do të veprosh nga pozitat e forcës.
Jam i kënaqur që Roskoi e ngriti këtë argument, sepse më dha rastin që edhe unë të deklaroj besimin tim te rentabiliteti, sikurse edhe te liria, demokracia, dashuria, amësia.
U dëgjua një e qeshur e lehtë, të cilës Aleksi iu përgjigj me një buzëqeshje të shpenguar. Pastaj, e shtyti karrigen pak mbrapa, për të pasur më shumë hapësirë të lirë për lëvizje.

— Diçka tjetër lidhur me rentabilitetin e FMA-së është se ai duhet shtuar në mënyrë energjike. Por, për këtë do t'ju flas mbas pak.
Tani për tani, dua të qëndroj në sferën e bindjeve vetjake. Një nga bindjet e mia është se gjatë këtyre dhjetë vjetëve të fundit, qytetërimi ynë ka ndryshuar në një mënyrë më kuptimplotë dhe të shpejtë se në cilëndo periudhë tjetër të epokës së revolucionit industrial. Ne, tani, po shohim dhe bëjmë pjesë në një revolucion shoqëror të ndërgjegjes dhe qëndrimit ndaj vlerave të ndryshme në jetën shoqërore. Ka njerëz, të cilëve ky revolucion nuk u pëlqen; unë nuk bëj pjesë në ta; mua më pëlqen. Mirëpo, të pëlqen apo jo, ai ekziston dhe as nuk kthehet mbrapa e as zhduket.
Në fakt, forca shtytëse e kësaj dukurie është vendosmëria e shumicës së njerëzve për të përmirësuar kushtet e jetesës, për t'i dhënë fund ndotjes së ambientit dhe për të shpëtuar atë që ka mbetur nga burimet e ndryshme. Për rrjedhojë, industrisë dhe tregtisë u kërkohen vlera të reja, gjë që quhet «përgjegjësi shoqërore kolektive». Akoma dhe më i rëndësishëm është fakti se në vërtetë arrihen shkallë përgjegjësie më të larta, pa u vërtetuar humbje ose fitime të ndjeshme.
Aleksi vazhdonte të fliste, duke lëvizur në hapësirën e ngushtë midis tryezës së këshillit dhe karriges. Pyeti veten, nëse duhej të ndeshej ballë për ballë me një pikëpamje tjetër të Hejuordit, dhe vendosi që ashtu të bënte.
— Lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me përgjegjësinë dhe angazhimin, Roskoi na solli shembullin e kishës së tij. Ai tha se ata që i «morën përsëri frenat në dorë», këto ishin fjalët e tij, zgjodhën rrugën e mosangazhimit. E po, simbas mendimit tim, Roskoi dhe bashkëfetarët e tij të tjerë po ecin në mënyrë të vendosur në një drejtim të kundërt me atë që kërkon koha. Një qëndrim i tillë nuk i sjell ndonjë të mirë as çështjes së

krishtërimit dhe as punës së bankës.
Hejuordi u hodh menjëherë në këmbë, duke protestuar:
— Kjo është një çështje personale dhe një interpretim i gabuar.
I qetë, Aleksi u përgjigj:
— Përkundrazi, unë nuk besoj të jetë as njëra dhe as tjetra.
Harold Ostini goditi tryezën me grusht:
— Zoti kryetar, nuk e miratoj një qëndrim si këtë të Aleksit, që ulet gjer në vërejtje personale.
— Roskoi na ngriti këtu punën e kishës së tij, — ia priti Aleksi, — dhe unë po bëj vetëm një koment.
— Ndoshta do të ishte në interesin tënd të mos e bëje.
— Zëri i Filip Xhohensënit, i ulur përballë tij, kishte një ton të ftohtë e të prerë, — përndryshe, ne mund t'ju gjykonim ju të dy simbas njerëzve me të cilët shoqëroheni, gjë që do ta vinte Roskonë dhe kishën e tij më lart se ti.
Aleksi u skuq.
— A mund të të pyes se ç'do të thuash tamam me këto fjalë?
Xhohensëni mblodhi supet.
— Me sa di unë, mikesha jote më e ngushtë, në mungesë të gruas sate, është një veprimtare e së majtës. Duket se është kjo arsyeja që të pëlqen angazhimi.
Xherom Petërtoni trokiti përsëri në tryezë me çekanin e tij të vogël, por kësaj here më me forcë.
— Mjaft me këto, zotërinj. Kryesia e ndalon të bëhen aluzione të këtij lloji, si nga njëra anë, ashtu edhe nga tjetra.
Xhohensëni buzëqeshi. Ndaluar apo jo, tanimë shigjeta kishte qëlluar në shenjë.
Aleksi, që po zjente nga zemërimi, mendoi një herë të deklaronte me ton të prerë se jeta e tij private ishte punë e tij dhe vetëm e tij, por pastaj, vendosi ndryshe. Në rrethana të tjera, një gjë e tillë të kishte qenë e nevojshme, por jo në atë

çast. E kuptoi se kishte bërë një gabim të rëndë duke iu përgjigjur krahasimit të Hejuordit me kishën.
— Po kthehem përsëri, — tha ai, — në argumentimin tim: Si është e mundur që ne, bankierët, të mos përfillim këtë ndryshim të gjendjes? Të bësh këtë, është njëlloj sikur të ndodhesh në mes të shtrëngatës dhe të pretendosh se nuk fryn erë. Suksesi në punë tregtie, sikurse të gjithë e dini nga përvoja juaj, nuk mund të sigurohet duke mos përfillur ndryshimet, por duke i parashikuar ato dhe duke iu përshtatur me kohë kushteve. Kështu ne, si kujdestarë të parave, të ndjeshëm ndaj ndryshimeve që ndodhin në klimën monetare, duhet të shohim se nga fryn era dhe të përfitojmë duke iu përshtatur gjendjes menjëherë.
Ai e ndjente se, me përjashtim të shkarjes që kishte bërë para pak çastesh, mënyra se si e kishte nisur fjalën e tij kishte tërhequr vëmendjen e të gjithëve. Pothuajse të gjithë këshilltarët, në punën e tyre si drejtorë ndërmarrjesh, kishin pasur të bënin me ligjet lidhur me pakësimin e ndotjes, mbrojtjen e konsumatorit, vërtetësinë e fushatave publicitare, garantimin e vendit të punës të pakicave, të drejtat e barabarta të gruas. Shpeshherë, ligje të tilla miratoheshin, me gjithë kundërshtimin e ashpër të ndërmarrjeve, të drejtuara pikërisht nga këshilltarët që ishin aty të pranishëm. Por, mbas miratimit të ligjeve, këto ndërmarrje gjenin mënyrën se si t'u përshtateshin normave të reja dhe ngrinin me të madhe kontributin e tyre për mirëqenien publike. Bile disa, si Leonard Kingsudi, pohonin se përgjegjësia shoqërore kolektive ishte një gjë e mirë për tregtinë. — Në Shtetet e Bashkuara, — vazhdoi Aleksi — ka katërmbëdhjetë mijë banka, të cilat, me anë të dhënies së huave, kanë në dorë një fuqi shumë të madhe financiare. Sigurisht, kur huatë u jepen industrisë dhe tregtisë, kjo fuqi duhet të shoqërohet nga ana

jonë me njëfarë përgjegjësie! Midis kritereve të dhënies së një huaje duhet të ishte dhe niveli i sjelljes publike të atij që e kërkon. Në rast se një fabrikë kërkon të financohet, duhet studiuar nëse do të shkaktojë ajo ndotje të ambientit. Kur një artikull i ri do të hidhet në treg, duhet parë se çfarë garancish ka se ai nuk është i dëmshëm. Ç'dozë të vërtetë përmban fushata publicitare e kësaj ndërmarrjeje të caktuar? Në qoftë se duhet të zgjedhim ndërmjet ndërmarrjes A dhe ndërmarrjes B, cila nga të dyja ka pasur një qëndrim më të mirë lidhur me diskriminacionin?

U përkul përpara, duke e kaluar vështrimin rreth e rrotull tryezës vezake, për të shikuar drejt e në sy secilin nga këshilltarët.

— Është e vërtetë se, tani, këto pyetje nuk bëhen gjithmonë. Por bankat më të mëdha po fillojnë ta bëjnë këtë gjë me qëllim që operacionet e tyre të kenë një bazë të shëndoshë. Do të ishte një veprim i urtë nga ana e FMA-së, në rast se ajo do ta ndiqte këtë shembull, sepse, po ashtu sikurse udhëheqja e çdo ndërmarrjeje mund të sigurojë fitime të mëdha, edhe udhëheqja e bankës mund të arrijë suksese të rëndësishme. Ia vlen të kihet parasysh edhe diçka tjetër: Është më mirë që një gjë të tillë ta bësh tani vetë, me iniciativën tënde, se sa të jesh i detyruar më vonë nga ligji.

Aleksi heshti pak çaste, u largua një hap nga tryeza, pastaj u afrua përsëri dhe pyeti:

— Në ç'sektorë të tjerë duhet të pranojë banka jonë përgjegjësinë shoqërore kolektive?

Unë besoj, si Ben Roseli, se duhet të japim ndihmesën tonë në përmirësimin e nivelit të jetesës së popullsisë së këtij qyteti dhe të mbarë shtetit. Një mjet i thjeshtë dhe i shpejtë në këtë drejtim është financimi i ndërtimeve publike, angazhim ky, që këshilli e ka marrë lidhur me Rajonin Lindor. Por, unë jam i

bindur se angazhimi ynë duhet të bëhet, me kalimin e kohës, gjithnjë e më i madh.

I hodhi një vështrim Hejuordit dhe vazhdoi:

— Natyrisht, e di se hipotekat e banesave nuk janë burim fitimesh të mëdha. Megjithatë, ka mënyra të ndryshme që një angazhim i tillë të sjellë fitime shumë të mira.

Një mënyrë e tillë, u shpjegoi ai këshilltarëve që dëgjonin me vëmendje, ishte rritja në një shkallë të gjerë e sektorit të depozitimit të kursimeve.

— Fondet për huatë hipotekare për ndërtesat e banimit dalin tradicionalisht nga depozitimet e kursimit, sepse qoftë të parat qoftë të dytat janë investime me afat të gjatë. Ne do ta sigurojmë rentabilitetin në sajë të vëllimit të depozitimeve, të cilat do të jenë shumë më të mëdha nga të tanishmet. Në këtë mënyrë, do të arrijmë një objektiv të trefishtë: fitimin, stabilitetin ekonomik dhe një kontribut më të madh shoqëror.

Vetëm deri pak vjet më parë, bankat e mëdha tregtare, si kjo jona, e përbuznin klientelën e vogël, duke përfshirë edhe depozituesit e kursimeve me shuma të vogla, duke i konsideruar ata të parëndësishëm. Mirëpo pastaj, ndërsa ne flinim në dafina, agjencitë e kursimeve dhe të huave përfituan me mprehtësi nga rasti që ne nuk përfillëm dhe, tani, janë bërë konkurrentët tanë kryesorë. Sidoqoftë, në sektorin e kursimeve të vogla ekzistojnë ende mundësi shumë të mëdha. Ka të ngjarë që, brenda një dhjetëvjeçari, vëllimi i depozitimeve të kursimit ta tejkalojë kudo atë të logarive rrjedhëse tregtare, duke u bërë në këtë mënyrë forca monetare ekzistuese më e rëndësishme. Kursimi, — vijoi Aleksi, — është vetëm njëri nga sektorët e shumtë, në të cilin mund të rriteshin në mënyrë të konsiderueshme të ardhurat e FMA-së.

Duke lëvizur vazhdimisht, ai filloi të flasë për sektorë të tjerë të bankës, duke përshkruar ndryshimet që propozonte të bëheshin. Pjesa më e madhe e tyre ishte në raportin që ai

kishte përgatitur me kërkesën e Ben Roselit, disa javë para se presidenti të bënte njoftimin e tij tragjik. Me sa dinte Aleksi, për shkak të ngjarjeve që ishin rrokullisur njëra pas tjetrës, raporti kishte mbetur pa u shqyrtuar fare. Një nga rekomandimet e Aleksit kishte qenë që të hapeshin nëntë degë të reja në po aq krahina të ndryshme të shtetit. Një rekomandim tjetër ishte të rishikohej krejtësisht i tërë organizimi i FMA-së. Aleksi sugjeronte të kërkohej mendimi i një firme të specializuar, e cila do të vinte në dukje ndryshimet që duheshin bërë. Dhe nxori si konkluzion:

— Rendimenti ynë është më i vogël se sa duhej të ishte. Mekanizmat tona nuk punojnë si duhet, por plot me fërkime dhe kërcitje.

Aty nga fundi i fjalës së tij, ai u kthye përsëri në argumentin që u prek në fillim.

— Është e qartë, se marrëdhëniet tona bankare me industrinë duhet të vazhdojnë të jenë të ngushta. Financimet për industrinë dhe klientelën tregtare do të përbëjnë gjithmonë dy shtylla mbështetëse të veprimtarisë sonë. Por, ato nuk do të jenë të vetmet shtylla; dhe as nuk duhet të bëhen tepër të mëdha, në krahasim me të tjerat. Nga ana tjetër, nuk duhet të merakosemi aq shumë për madhësinë e shumave të depozituara, deri në atë pikë sa depozitimet e vogla ta humbasin shumë, në mendjen tonë, rëndësinë e tyre.

Themeluesi i kësaj banke pati vendosur që ta vinte bankën në shërbim të njerëzve me mundësi të kufizuara. Patjetër, gjatë një shekulli, objektivat dhe veprimtaria e bankës janë zgjeruar; por, megjithatë, edhe i biri dhe i nipi i themeluesit e patën gjithnjë parasysh qëllimin fillestar dhe nuk e harruan asnjëherë mësimin, simbas të cilit një bashkim forcash të vogla mund të përfaqësojë forcën më të madhe që ekziston.

Një rritje e menjëhershme dhe masive e sektorit të kursimit të vogël, gjë që unë ia rekomandoj këshillit ta ketë si objektiv,

do ta nderojë këtë qëllim fillestar të bankës sonë, do ta rrisë forcën tonë ekonomike dhe, duke pasur parasysh kohën që jetojmë, do të përbëjë një përfitim për publikun dhe, për rrjedhojë, edhe për vetë ne.

Siç patën bërë edhe për Hejuordin, anëtarët e këshillit duartrokitën, ndërsa Aleksi po ulej përsëri në vendin e tij. Aleksi e kuptonte se disa nga këto duartrokitje ishin vetëm për mirësjellje. Këshilltarët më entuziastë përbënin rreth gjysmën e të pranishmëve. Ai e pa se zgjedhja midis tij dhe Hejuordit ishte akoma e pasigurt, ashtu siç kishte qenë në fillim të mbledhjes.

— Faleminderit, Aleks. — Xherom Petërtoni hodhi një vështrim rreth e përqark tryezës. — Ka pyetje, zotërinj?

Pyetjet morën edhe një gjysmë ore dhe, pastaj, Rosko Hejuordi dhe Aleks Vandervurti dolën nga salla. Secili prej tyre shkoi në zyrën e tij, për të pritur vendimin e këshilltarëve.

Këshilltarët diskutuan gjer në drekë, por nuk arritën në marrëveshje. Pastaj, ata shkuan në një sallë ngrënieje të veçantë, ku i vazhduan diskutimet, duke ngrënë. S'kishin marrë ende asnjë vendim, kur një kamerier iu afrua me kujdes Xherom Petërtonit. Ai mbante në dorë një tabaka argjendi, mbi të cilën ishte një fletë e palosur.

Nënkryetari i këshillit e mori letrën, e hapi dhe e lexoi. Mbas një çasti, ai u ngrit në këmbë dhe priti deri sa bisedimet pushuan.

— Zotërinj. — I dridhej zëri. — Zotërinj, me dhimbje të thellë, ju njoftoj se presidenti ynë i shumëdashur, Ben Roseli, vdiq para disa minutave.

Pak mbas kësaj, me pëlqimin e të gjithë të pranishmëve, mbledhja u shty.

Shtypi ndërkombëtar foli shumë për vdekjen e Ben Roselit dhe, disa gazetarë, duke përdorur një shprehje të marrë nga e shkuara e afërt, e quajtën «mbarim» të një epoke.

Pavarësisht në ishte e tillë apo jo, zhdukja e tij nga skena e veprimtarisë njoftonte se edhe banka e fundit amerikane, që gjer atëherë drejtohej nga një njeri i vetëm, po i përshtatej kohës dhe po adoptonte strukturën tipike të gjysmës së dytë të shekullit të njëzet, duke ua besuar udhëheqjen e saj drejtuesve me pagesë dhe këshillit administrativ. Sa për emërimin e kreut të trupit drejtues, vendimi ishte shtyrë për në mbledhjen e këshillit që do të mbahej mbas varrimit.

Varrimi u bë të mërkurën e javës së dytë të dhjetorit. Si ekspozimi i trupit, ashtu edhe varrimi u bënë me të gjitha ceremonitë fetare dhe rregullat e kishës katolike, ashtu si i përshtatej një kalorësi papal dhe një mirëbërësi të madh, siç kishte qenë gjatë jetës së tij Ben Roseli.

Trupin e lanë të ekspozuar për dy ditë në katedralen e Shën Metjusit: një zgjedhje me vend, duke qenë se Metjui — dikur tagrambledhësi Levi — konsiderohet nga bankierët si një shenjtor, mbrojtës i tyre.

Para katafalkut dhe arkivolit të hapur parakaluan rreth dy mijë veta, duke përfshirë një të dërguar të presidentit të Shteteve të Bashkuara, guvernatorin e shtetit, ambasadorë, autoritete të qytetit, nëpunës të FMA-së, si edhe qytetarë të thjeshtë.

Mëngjesin e varrimit, mesha e përmortshme u mbajt së bashku — për të qenë brenda — nga një kryepeshkop, një peshkop dhe një imzot. Një kor i madh këndoi me zë të qetë përgjigjet e lutjeve. Katedralja ishte e mbushur plot me njerëz, por pjesa pranë altarit qe rezervuar për njerëzit e afërt dhe miqtë e Roselit. Menjëherë pas tyre, vinin këshilltarët dhe funksionarët e lartë të *Fërst Merkëntaill Ëmerikën Benkut*.

Rosko Hejuordi, i veshur thjesht, me të zeza, ishte në rreshtin e parë të grupit të bankierëve. Ai shoqërohej nga e shoqja, Beatrisa — një grua e fortë dhe autoritare — dhe nga djali i tyre, Elmeri. Hejuordi, ishte i besimit protestant; ai kishte studiuar që më parë procedurat e sakta katolike dhe ra në gjunjë me elegancë, si para se të zinte vend, ashtu edhe në kohën e daljes, mbas ceremonisë së përmortshme, ndonëse e dinte se gjunjëzimi i dytë ishte një hollësi formale, të cilin nuk e bënin as vetë katolikët. Veç kësaj, Hejuordët i dinin përgjigjet e meshës, kështu që zërat e tyre u dëgjuan të vetmuar në mes të grupit të personave që gjendeshin pranë tyre.

Midis këtyre të fundit, dy rreshta prapa Hejuordit, ishte ulur Aleks Vandvurti. Duke qenë agnostik, ai e ndjente veten krejtësisht të huaj në atë ambient. Ai po vriste mendjen se ç'do të kishte thënë Beni, ai njeri aq i thjeshtë, për një ceremoni kaq luksoze.

Në krah të Aleksit, Margot Brekëni po shikonte përqark me kureshtje. Në fillim, kishte pasur ndërmend të merrte pjesë në varrim me një grup që përfaqësonte banorët e Rajonit Lindor, por, një natë më parë kishte qenë tek Aleksi, i cili e kishte bindur ta shoqëronte. Delegacioni i Rajonit Lindor, i madh në numër, ishte diku prapa tyre, brenda turmës që mbushte katedralen.

Në krahun tjetër të Margotit ishin Eduina dhe Luis d'Orseji; ky i fundit me një shprehje të qartë mërzie në fytyrën e tij të thatë e të zbehtë. «Ka të ngjarë, — mendoi Aleksi, — që Luisi të jetë duke hartuar me mend numrin e ardhshëm të buletinit të tij financiar.» D'Orsejtë kishin shkuar në varrim së bashku me Margotin dhe Aleksin të katërt ata takoheshin shpesh, jo vetëm sepse Eduina dhe Margoti ishin kushërira, por sepse gjenin kënaqësi në shoqërine e tyre. Mbas meshës, do të merrnin pjesë edhe në ceremoninë e varrimit.

Në rreshtin para Aleksit ishin nënpresidenti, Xherom Petërtoni, dhe e shoqja.

Me gjithë indiferencën e tij ndaj liturgjisë, Aleksi ndjeu t'i mbusheshin sytë me lot, kur arkivoli i kaloi pranë, ndërsa po e nxirrnin jashtë kishës. Gjatë ditëve të fundit, ai kishte kuptuar se ndjenjat e tij për Benin kishin qenë shumë të thella. Në njëfarë mënyre, plaku kishte qenë si baba për të dhe vdekja e Benit kishte lënë, brenda tij, një zbrazësirë që nuk do të mbushej ndonjëherë.

Margoti i zuri dorën me ëmbëlsi dhe ia shtrëngoi.

Ndërsa njerëzit po dilnin jashtë, Aleksi pa Roskonë dhe Beatrisën. Ai i përshëndeti me kokë dhe përshëndetja iu kthye. Fytyra e Hejuordit mori një pamje të dhimbshme, si shenjë e zisë së përbashkët. Për një çast të shkurtër, rivaliteti i të dy nëndrejtorëve u la mënjanë.

Jashtë katedrales, trafiku i zakonshëm ishte kthyer në drejtim tjetër. Arkivoli u vendos mbi një karrocë të vdekurish, të mbuluar me lule. Të afërmit e të ndjerit dhe funksionarët e FMA-së po hipnin në limuzinat, që afroheshin njëra pas tjetrës nën drejtimin e policisë. Në krye të kortezhit që po formohej, kishin zënë vend një numër motoçiklistësh, me motorët të ndezur e plot zhurmë.

Dita ishte e zymtë dhe e ftohtë dhe era ngrinte vorbulla pluhuri. Lart, mbi gjithçka, dominonte katedralja, me kullat e saj të larta dhe fasadën shumë të madhe, të nxirë nga papastërtia e grumbulluar gjatë viteve. Parashikimet e motit thoshin se dëbora do të binte atë vit më shpejt se zakonisht, por gjer në atë kohë nuk ishte dukur akoma.

Ndërsa Aleksi bëri shenjë që të afrohej vetura e tij, Luis d'Orseji vërente, nëpërmjet gjysmë lenteve të syzeve të tij, operatorët e televizionit dhe fotografët, të cilët po merrnin në film e në fotografi njerëzit që po dilnin nga kisha. Ai vërejti:

— Për mua, e gjithë kjo është shtypëse dhe, nesër, reportazhet do të veprojnë gjithashtu në mënyrë shtypëse mbi publikun dhe aksionet e FMA-së do të bien.

Aleksi tha se ishte i një mendjeje, me anë të një murmuritjeje që tregonte njëkohësisht shqetësimin e tij. E dinte se aksionet e Fërst Merkentajll Emerikën Benkut, të kuotuara në bursën e Nju Jorkut, kishin rënë pesë pikë e gjysmë, sapo që mësuar sëmundja e Benit. Vdekja e Roselit të fundit, një emër që prej disa brezash ishte sinonim i vetë bankës, i bashkuar me pasigurinë lidhur me vijën që do të vendosej nga udhëheqja e re, kishte shkaktuar rënien e fundit të aksioneve. Dhe tani, reportazhi i varrimit mund të shkaktonte një rënie tjetër, ndonëse e gjithë kjo s'ishte aspak e logjikshme.
— Do të ngrihen përsëri, — tha më në fund Aleksi. — Fitimet janë të mira dhe, në të vërtetë, asgjë nuk është ndryshuar.
— Oh, e di, — pranoi Luisi. — Ja sepse nesër pasdite do të shpejtohem ta mbuloj gjendjen time.
Eduina u shtang:
— Si? Ke shitur aksione të FMA-së, i zbuluar?
— Sigurisht. Bile këshillova edhe disa klientë të bënin të njëjtën gjë. Tani mund të sigurohet një fitim i mirë.
Ajo protestoi:
— Luis, ne të dy e dimë se unë nuk flas kurrë me ty për çështje rezervate, por të tjerët nuk e dinë. Për shkak të punës sime në bankë, mund të të padisin për përdorim të paligjshëm informatash rezervate.
Aleksi tundi kokën.
— Jo në këtë rast, Eduina. Sëmundja e Benit nuk ishte e fshehtë.
— Kur t'i kemi dhënë fund sistemit kapitalist, — ndërhyri

Margoti, — shitja e zbuluar në bursë do të jetë njëra nga gjërat e para që do të zhduken.
Luisi ngriti vetullat lart.
— Pse?
— Sepse është krejtësisht negative, mbasi synon që dikush tjetër të humbasë. Kjo është e përbindëshme dhe s'krijon absolutisht asgjë.
— Krijon me lehtësi shtesë kapitali. — Një buzëqeshje kënaqësie e gjallëroi fytyrën e Luisit. Ai kishte diskutuar edhe herë të tjera me Eduinën mbi këtë çështje. — Gjë që nuk është e lehtë në ditët tona, së paku duke bërë investime në Amerikë.
— Prapëseprapë, nuk më pëlqen të spekulosh me aksione të FMA-së, — tha Eduina. — Në njëfarë mënyre, kjo gjë bëhet në dëmin tim.
Luis d'Orseji u bë përsëri serioz.
— Po qe kështu, e dashur, mbasi ta kem mbuluar nesër gjendjen, nuk do të merrem me asnjëherë me aksione të FMA-së. Margoti i hodhi një vështrim të mprehtë.
— E di se Luisi e mban fjalën, — tha Aleksi.
Aleksi mendonte nganjëherë për këtë bashkim të Eduinës me Luisin. Po të gjykoje nga pamja e jashtme, ai dukej një bashkim jo i goditur: Eduina, elegante, tërheqëse, e sigurt në vetvete; Luisi, i dobët e i thatë, pa asgjë tërheqëse, i mbyllur në vetvete, përveçse kur kishte të bënte me ata që i njihte mirë. Mirëpo, martesa e tyre dukej se shkonte mirë dhe të dy shfaqnin dashuri dhe respekt reciprok, siç kishte bërë pak më parë Luisi. «Ndoshta, mendoi Aleksi, të kundërtat jo vetëm që tërheqin njëra-tjetrën, por kanë edhe prirje të mbeten të bashkuara.»
Vetura e Aleksit, një kadillak nga parku i makinave të FMA-së, u fut në vargun e gjatë që po formohej para katedrales, dhe të

katër u drejtuan drejt saj.
— Do të kishte qenë një premtim më i njerëzishëm, — vërejti Margoti, — në rast se Luisi do të kishte thënë që nuk do të shiste më, i zbuluar, asnjë aksion.
— Aleks, — tha Luisi, — ç'djall ke të përbashkët me këtë socialiste?
— Në shtrat shkojmë shumë mirë, — u përgjigj Margoti. — A nuk mjafton kjo?
Aleksi shtoi:
— Dhe unë do të doja të martohesha së shpejti me të.
— Këtë ta uroj me gjithë zemër, — tha Eduina.
Ajo dhe Margoti kishin qenë mikesha që në fëmijëri, megjithëse kishin ndryshime në karakter dhe në një numër pikëpamjesh. Ajo që kishin të përbashkët ishte se, në të dyja degët e familjes së tyre, gratë ishin të forta dhe angazhimi i tyre në jetën publike ishte bërë traditë.
Eduina e pyeti Aleksin, me ton të qetë:
— Ndonjë të re nga Silia?
Ai tundi kokën:
— S'ka asgjë të re. Edhe po qe se ka diçka, kjo është për të keq.
Ndërkaq, kishin mbërritur te vetura. Aleksi i bëri me shenjë shoferit të rrinte në timon, hapi portën mbrapa dhe hipi i fundit. Brenda, ndarja prej xhami, që veçonte vendin e shoferit nga ai i pasagjerëve, ishte e mbyllur. Ata u ulën, ndërsa kortezhi filloi të lëvizë me ngadalë përpara.
Pyetja e Eduinës e kishte shtuar edhe më shumë trishtimin e Aleksit, duke i sjellë ndërmend, me njëfarë ndjenje fajësie, se së shpejti duhej të shkonte përsëri për ta parë Silian. Mbas asaj vizite molitëse, në ditët e para të tetorit, ai kishte bërë edhe një vizitë tjetër: Silia ishte mbyllur edhe më shumë në vetvete, nuk jepte as shenjën më të vogël se i njihte njerëzit rreth saj

dhe s'pushonte së qari, në heshtje. Aleksi kishte mbetur, ditë me radhë, i dërrmuar, dhe tani ngurronte ta përsëriste edhe një herë këtë gjë.

I shkoi në mend se Ben Roseli, në arkivolin në krye të kortezhit, ishte më mirë se Silia, duke qenë se jeta e tij kishte mbaruar njëherë e mirë. Ah, sikur Silia të vdiste... I turpëruar, Aleksi e largoi këtë mendim.

Dhe asgjë të re s'kishte edhe në marrëdhëniet e tij me Margotin, e cila vazhdonte të ishte në mënyrë të prerë e vendosur kundër divorcit, së paku, deri sa të bëhej e qartë se Silia nuk do ta ndjente dhe nuk do të kundërvepronte ndaj një hapi të tillë. Margoti dukej të ishte e gatshme për t'i vazhduar marrëdhëniet e tyre, ashtu siç ishin, përgjithmonë, por Aleksi ishte më pak i nënshtruar.

Luisi iu drejtua Eduinës:

— Desha të të pyes se ç'u bë me atë nëpunësin tënd të ri... atë që u zu me presh në duar... Si e quanin?

— Majlls Istin, — u përgjigj Eduina. — Procesi është vendosur të bëhet javën e ardhshme dhe unë duhet të shkoj për të dëshmuar. Nuk është gjë që më pëlqen.

— Së paku, gjetët fajtorin e vërtetë, — tha Aleksi. — Ai e kishte lexuar raportin e kryeinspektorit dhe atë të Nolan Uejnrajtit. — Por, ç'bëhet me arkëtaren, për të cilën dyshohej... zonjën Nunjez? Ajo është në rregull tani, apo jo?

— Duket se po. Kam frikë se e bëmë Huanitën e varfër të kalojë disa ditë me të vërtetë të vështira. Me të padrejtë, siç doli pastaj.

Margoti, e cila gjer në atë çast nuk po e ndiqte dhe aq mirë bisedën, u bë më e vëmendshme.

— Unë njoh një Huanita Nunjez. Një grua e re, e bukur, që banon në Rajonin Lindor. Më duket se e ka braktisur i shoqi. Ka një fëmijë.

— Duket të jetë tamam zonja Nunjez, — tha Eduina. — Po, tani më kujtohet. Ajo banon pikërisht në Rajonin Lindor.

Ndonëse ishte bërë kureshtare, Margoti e kuptoi se nuk ishte çasti për të bërë pyetje të tjera.

Ndërsa ata mbetën për pak kohë në heshtje, Eduina u zhyt në mendime. Dy ngjarjet e fundit: vdekja e Ben Roselit dhe gjesti i marrë, me të cilin Majlls Istini kishte shkatërruar jetën e vet, kishin ndodhur njëra pas tjetrës, brenda një kohe shumë të shkurtër. Të dyja këto ngjarje, që kishin të bënin me njerëz që ajo i donte, e kishin trishtuar. Por keqardhja e saj më e madhe, mendoi ajo, ishte për Benin: atij i detyronte gjithçka, ose pothuajse gjithçka. Sigurisht se karriera e shpejtë që kishte bërë në bankë i detyrohej aftësisë së saj; por Beni nuk kishte ngurruar kurrë, siç bënin shumë punëdhënës, t'i jepte një gruaje të njëjtat mundësi si burrave. Eduinën e mërzisnin parullat prej papagalli të aktivistëve të lëvizjes për emancipimin e gruas. Me sa shihte ajo, gratë bënin karrierë për shkak të seksit të tyre, që u sillte një avantazh, të cilin ajo s'e kishte kërkuar dhe as dëshiruar kurrë. Por, prapëseprapë, duhej thënë se prania e Benit kishte qenë gjithmonë garanci për një trajtim të barabartë.

Sikurse Aleksi, edhe Eduina e kishte ndier, në kishë, se si po i mbusheshin sytë me lot, ndërsa po i kalonte pranë trupi i Benit, për të shkuar në banesën e tij të fundit.

Mendimet e saj u kthyen te Majllsi. Ai ishte akoma shumë i ri, mendoi ajo, dhe mund ta ndërtonte rishtas jetën e tij mbi baza të reja, megjithëse një gjë e tillë nuk do të ishte e lehtë. Asnjë bankë nuk do ta merrte më në punë dhe askush tjetër

nuk do t'i besonte më një post me përgjegjësi. Me gjithë atë që kishte bërë, Eduina shpresonte se nuk do ta fusin në burg.

Ajo e prishi heshtjen, duke thënë:
— Gjithmonë e ndiej veten sikur kam bërë ndonjë faj, kur bëj biseda të zakonshme në një varrim.
— S'ke arsye pse ta ndiesh veten ashtu, — tha Luisi. — Mua do të më pëlqente që në varrimin tim të thuhen gjëra konkrete në vend të thënieve të zakonshme të rastit.
— Një sistem i sigurt, — sugjeroi Margoti, — do të ishte botimi i një numri lamtumire i buletinit «D'Orsej». Shoqëruesit e arkivolit do të mund t'i shpërndanin kopjet gjatë kohës që do të të përcillnin për në varreza.

Luisit iu çel fytyra:
— Ndoshta kështu do të bëj.

Kortezhi filloi të lëvizë më me shpejtësi. Motoçikletat shkuan përpara plot zhurmë; dy policë të shoqërimit kaluan me shpejtësi, për të ndaluar trafikun në kryqëzimet e rrugëve. Veturat e shtuan shpejtësinë dhe, mbas disa çastesh, kortezhi e la mbrapa katedralen e Shën Metjusit.
Dëbora, rënia e së cilës kishte qenë paralajmëruar nga shërbimi sinoptik, filloi të bjerë me flokë të vegjël dhe të rrallë.
— Me të vërtetë më pëlqen mendimi i Margotit, — ia nisi përsëri Luisi. — Një numër lamtumire i buletinit. Dhe që tani e kam gjetur titullin: «Dollari vdiq njëherë e përgjithmonë; varroseni atë, bashkë me mua!» Në atë artikull do të nxisja për krijimin e një njësie të re monetare, me të cilën të zëvendësohej dollari: «D'Orsej USA», natyrisht i bazuar në arin. Mbasi të jetë bërë kjo, mund të shpresohet se edhe pjesa tjetër e botës do të veprojë në të njëjtën mënyrë.
— Në një rast të tillë, ti do të bëheshe një monument regresioni, — tha Margoti, — dhe çdo figurë, me të cilën do

të të paraqitnin, duhet ta ketë fytyrën të kthyer mbrapa. Me një sistem monetar të bazuar tek ari, pjesa më e madhe e pasurive të botës do të ishte në duart e një numri njerëzish edhe më të vogël se sa tani, ndërsa pjesa tjetër e njerëzimit do të mbetej pa të mbathura.
Luisi shtrembëroi fytyrën.
— Perspektivë e përbuzshme, së paku, kjo e fundit. Por, do t'ia vlente barra qiranë të paguhej edhe ky çmim, për të pasur një sistem monetar të qëndrueshëm.
— Pse?
— Sepse, — iu përgjigj Luisi Margotit, — kur shemben sistemet monetare, siç po ndodh tani, janë gjithmonë të varfrit që vuajnë më shumë.
Aleksi, që ishte ulur në një ndenjëse portative para tre të tjerëve, u kthye përgjysmë për të marrë pjesë në bisedë.
— Luis, unë përpiqem të jem objektiv dhe, nganjëherë, mendimet e tua të zymta lidhur me dollarin dhe sistemin monetar më duken të arsyeshme. Mirëpo, nuk pajtohem me pesimizmin tënd total. Unë besoj se dollari mund t'i fitojë përsëri pozitat e humbura. Nuk mund të besoj se çdo sistem monetar është duke u shembur.
— Kjo ndodh sepse ti nuk do ta besosh atë, — ia priti Luisi.
— Ti je bankier. Në rast se sistemi monetar shembet, ti dhe banka jote do të mbeteshit me gisht në gojë. E vetmja gjë që do t'ju mbetej të bënit do të ishte të shisnit bankënotat tuaja të pavlefshme si letër për të veshur muret, ose si letër higjienike.
— Ç'bën kështu, Luis! — thirri Margoti.
Eduina psherëtiu.
— Ti e di mirë se kështu ndodh gjithmonë kur e provokojnë; atëherë, ç'kuptim ka ta bësh këtë?
— Jo, jo! — protestoi i shoqi. — Me gjithë respektin që kam, e dashur, dua që ato që them të priten me seriozitetin e duhur.

As nuk kam nevojë dhe as dua mëshirë!
— Por çfarë do, atëherë? — pyeti Margoti.
— Dua që të pranohet e vërteta se Amerika e ka shkatërruar sistemin e saj monetar dhe atë të mbarë botës, për shkak të politikës, lakmisë, huave. Dua që të jetë e qartë për të gjithë se mund të falimentojnë jo vetëm individë dhe ndërmarrje, por edhe kombe. Dua të kuptohet se Shtetet e Bashkuara janë shumë afër falimentimit. Ka plot shembuj në histori që na tregojnë se si dhe pse ndodh një gjë e tillë. Shikoni qytetin e Nju Jorkut! Ai është i falimentuar, ka marrë fund dhe bëhen përpjekje për t'i bërë ballë kësaj gjendjeje të dëshpëruar me anë arnash e ballomash, ndërsa anarkia është te pragu i derës. Dhe ky është vetëm fillimi. Ajo që po ndodh në Nju Jork do të përsëritet në shkallë kombëtare.
Luisi vazhdoi:
— Zhvlerësimi i plotë i një monedhe nuk është një gjë e re. Shekulli ynë është plot me shembuj që kanë si bazë të njëjtin shkak: një qeveri, e cila i jep shkas krijimit dhe zhvillimit të mikrobit të inflacionit, duke shtypur kartëmonedhë të pagarantuar nga ari ose nga ndonjë vlerë tjetër. Dhe pikërisht këtë gjë janë duke bërë Shtetet e Bashkuara që prej pesëmbëdhjetë vjetësh.
— Po, po, në qarkullim ka më shumë dollarë se sa duhej të kishte, — pranoi Aleksi. — Askush, me një çikë mend në kokë, s'ka dyshim për këtë.
Luisi tundi kokën, me fytyrë të ngrysur.
— Veç kësaj, ka më shumë hua se sa mundësia për t'i paguar. Huaja publike po rritet si një flluskë e përbindshme sapuni. Qeveritë e ndryshme amerikane kanë shpenzuar me të dyja duart, miliarda dollarë; kanë kërkuar huara, si të marra, kanë grumbulluar huara gjer në grykë dhe, pastaj, kanë përdorur makinat e shtypjes për të nxjerrë kartëmonedha të tjera, duke

e rritur kështu edhe më tej inflacionin. Edhe njerëzit, individët, e ndoqën këtë shembull. — Ai bëri me shenjë nga kreu i kortezhit dhe vazhdoi: — Bankierë, si Ben Roseli, bënë çmos për të grumbulluar, në mënyrë të marrë, huara mbi huara. Edhe ti, Aleks, me letërkreditet e tua dhe me huatë e tua, me kushte të favorshme: që të dyja këto shkaktojnë inflacion. Kur do ta mësojnë njerëzit se nuk ekzistojnë huara me kushte të favorshme? Ju them se amerikanët, si komb dhe si individë, kanë humbur një gjë që dikur e kishin: gjendjen e shëndoshë ekonomike.

— Desha të të thosha, Margot, — tha Eduina, — se Luisi dhe unë nuk diskutojmë shumë për çështje bankare e financiare, kështu që, në shtëpi, ka më shumë qetësi.

Margoti buzëqeshi:

— Luis, kur flet kështu, njeriu ka përshtypjen se po dëgjon leximin e buletinit tënd.

— Ose më mirë, — ia priti ai, — kjo i ngjan përplasjes së flatrave në një dhomë të zbrazët, ku askush s'dëgjon.

Befas, Eduina tha:

— Duket se do të kemi një varrim të bardhë. — Ajo u përkul përpara, duke vështruar nëpërmes dritares së veshur me avull, dëborën që po binte me flokë të mëdhenj. Rrugët e periferisë ishin bërë tanimë të rrëshqitshme dhe kortezhi e pakësoi shpejtësinë.

Varrezat, mendoi Aleksi, nuk duhet të jenë më larg se rreth një kilometër nga vendi ku ndodheshin.

Luis d'Orseji po u shtonte edhe diçka fjalëve që kishte thënë pak më parë.

— Kështu, pra, çdo shpresë është zhdukur njëherë e mirë për masat e gjera të popullit; loja e parave ka marrë fund. Kursimet, pensionet dhe investimet me të ardhura fikse, po e humbasin vlerën e tyre. Ora ka rënë tanimë dymbëdhjetë herë:

mesnata sapo ka kaluar dhe, tani, është koha që secili të mendojë për veten e tij, të përpiqet të mbijetojë, duke u kapur mbas ndonjë mjeti financiar shpëtimtar. Dhe të tillë ka: ekzistojnë mënyra të ndryshme për të nxjerrë fitim nga fatkeqësia e përgjithshme. Në qoftë se këto të interesojnë, Margot, i ke të përshkruara në librin tim të fundit, «Depresione dhe Kriza: Si të bësh para prej tyre». Dhe, meqë ra fjala, libri po shitet me sukses.
— Besoj se s'të vjen keq të mos e marr atë libër. Më duket, deri diku, sikur po akaparoj vaksinën në një kohë kur ka shpërthyer një epidemi murtaje bubonike.
Aleksi u kishte kthyer shpinën të tjerëve dhe po shikonte nëpërmes xhamit të përparshmë të veturës. Nganjëherë, po thoshte me vete, Luisi fryhej shumë dhe e tepronte, pavarësisht se pohimet e tij, sikurse ato që kishte bërë pak më parë, zakonisht mbështeteshin mbi një arsyetim të shëndoshë. Kishte shumë mundësi që Luisi të kishte të drejtë përsa i përkiste një katastrofe ekonomike shumë të afërt. Në rast se një gjë e tillë do të ndodhte, ajo do të ishte katastrofa më e madhe në histori.

Dhe Luis d'Orseji nuk ishte i vetmi që mendonte kështu. Po këtij mendimi ishin edhe disa ekspertë financiarë, ndonëse ky ishte një mendim jo i mirëpritur dhe i vënë, shpeshherë, në lojë, ndoshta sepse asnjëri — dhe bankierët më pak nga të gjithë të tjerët — nuk donte të besonte në një katastrofë monetare të afërt.

Por kishte dy elemente, për të cilat Aleksi ishte i një mendjeje me Luisin. Njeri ishte nevoja e një kursimi më të madh — gjë që vetë Aleksi e kishte vënë në dukje në fjalën që kishte mbajtur në këshillin administrativ, para një jave — tjetri, problemi i huave individuale në rritje, për shkak të përhapjes së gjerë të kreditit, duke përfshirë sidomos vetë letërkreditet.

Ai u kthye përsëri nga Luisi:

— Duke menduar ashtu siç mendon ti, domethënë se së shpejti do të ndodhë një katastrofë e përgjithshme dhe, duke e zënë se ti je një njeri i zakonshëm që mendon të depozitojë një shumë me dollarë amerikanë, në cilin tip banke do të vendosje t'i depozitoje paratë e tua?

Pa ngurruar, Luisi u përgjigj:

— Në një bankë të madhe. Kur ndodh një katastrofë, janë bankat e vogla ato që detyrohen t'i mbyllin dyert të parat. Kështu ndodhi në vitet 20, kur bankat e vogla binin si gjethet e fishkura, në vjeshtë, kur fryn era. Dhe kjo do të ndodhë përsëri, sepse bankat e vogla nuk kanë para në dorë, në sasi të mjaftueshme, për t'i bërë ballë panikut që do të shpërthente dhe grumbullimit të madh, të menjëhershëm e të vrullshëm të njerëzve në sportelet, për të tërhequr kursimet e tyre. Dhe, natyrisht, nuk duhet mbështetur në Rezervën Federale! Shuma që disponohet është më pak se një për qind e shumës totale të të gjitha depozitimeve në banka, gjë që nuk mjafton aspak për të mbuluar një varg falimentimesh në shkallë kombëtare.

U mendua një çast dhe, pastaj, vazhdoi:

— Por, kësaj radhe, nuk do të jenë vetëm bankat e vogla që do të falimentojnë. Do ta pësojnë edhe disa nga të mëdhatë: ato që kanë shumë miliona të bllokuara në huara të mëdha, te firmat industriale; ato që kanë një përqindje shumë të lartë depozitimesh ndërkombëtare, mbasi është fjala për para me vlerë të paqendrueshme dhe që mund të zhvlerësohen brenda ditës; ato që disponojnë sasira të vogla parash në dorë, në një kohë kur depozituesit, tepër të frikësuar, kërkojnë të tërheqin paratë e tyre. Prandaj, Aleks, po të isha unë depozituesi që ti the më parë, do të shqyrtoja me kujdes bilancin e disa bankave pak a shumë të mëdha dhe, pastaj, do të zgjidhja njërën prej tyre, me një raport të ulët

midis huave dhe depozitimeve dhe me një përqindje të lartë depozitimesh në valutë kombëtare.

— Shumë mirë! — tha Eduina. — Pikërisht këto kushte plotësohen nga FMA-ja.

Aleksi tundi kokën në shenjë pohimi:

— Po, tani për tani.

Por gjendja mund të ndryshontej, mendoi ai, në rast se këshilli pranonte propozimin e Rosko Hejuordit, për rritjen e huave për industrinë.

Këto mendime i sollën ndërmend se, mbas dy ditëve, këshilli do të thirrej përsëri, për të vazhduar mbledhjen që ishte ndërprerë para një jave.

Vetura e ngadalësoi ecjen dhe u ndal; pastaj, bëri dhe pak përpara dhe u ndal përsëri. Kishin mbërritur në varreza dhe kishin kaluar nëpër rrugët e brendshme.

Dyert e veturave të tjera po hapeshin dhe njerëzit dilnin, me çadra në duar, ose duke shtrënguar fort me dorë jakat e palltove, të përkulur e të mbledhur nga e ftohta dhe dëbora që binte. Arkivoli u nxor dhe, mbas pak, ai u mbulua me dëborë.

Margoti zuri krahun e Aleksit dhe, ata të dy, si edhe bashkëshortët D'Orsej, u bashkuan me të tjerët, në vargun e heshtur që ndiqte Ben Roselin për në varrin e tij.

Siç ishte vendosur më parë, Rosko Hejuordi dhe Aleks Vandervurti nuk morën pjesë në mbledhjen e re të këshillit. Ata ndenjën, në pritje, secili në zyrën e vet.

I thirrën pak para orës 12.00, dy orë mbas fillimit të mbledhjes. U thirr edhe drejtori i zyrës së marrëdhënieve publike, Dik Frençi, i cili do t'i lëshonte shtypit një komunikatë lidhur me emërimin e presidentit të ri të FMA-së.

Frençi kishte bërë gati dy komunikata të ndryshme, të shoqëruara secila me një fotografi.

Në intestimet e tyre përkatëse ishte shënuar:

ROSKO D. HEJUORD
ËSHTË PRESIDENTI I RI I
FËRST MERKËNTAILL ËMERIKËN BENKUT

ALEKS VANDERVURT
ËSHTË PRESIDENTI I RI I
FËRST MERKËNTAILL ËMERIKËN BENKUT

Zarfet ishin gati, me adresat. Korrierët ishin gati për t'u nisur. Kopje të njërës komunikatë ose tjetrës duhet t'u dorëzoheshin po atë pasdite agjencive të shtypit, gazetave lokale, stacioneve radiofonike dhe televizive. Disa qindra të tjera do të dërgoheshin me postë gjer në mbrëmje.

Hejuordi dhe Aleksi mbërritën njëkohësisht në sallën e këshillit dhe zunë vendet e tyre përkatëse në tryezën vezake.

Frençi qëndroi prapa shpinës së Xherom Petërtonit, që drejtonte mbledhjen.

Vendimin e marrë në atë mbledhje e njoftoi këshilltari me periudhën më të gjatë të shërbimit, i nderuari Harold Ostini.

Ai deklaroi se Xherom Petërtonhi, i cili gjer në atë kohë ishte nënkryetar i këshillit administrativ, bëhej presidenti i ri i Fërst Merkëntaill Ëmerikën Benkut dhe se ky vendim hynte në fuqi menjëherë.

Kur u bë ky njoftim, edhe vetë i sapozgjedhuri u duk deri diku i habitur.

Drejtori i zyrës së shërbimeve publike murmuriti nëpër dhëmbë: «Punë m. . .!»

Më vonë, gjatë asaj dite, Xherom Petërtoni pati biseda të veçanta me Hejuordin dhe Vandervurtin.

— Emërimi im është i përkohshëm, — i tha ai secilit prej tyre. — Ti e di mirë, se këtë post nuk e kam kërkuar unë dhe e di, gjithashtu, sikurse e dinë edhe këshilltarët, se më duhen vetëm trembëdhjetë muaj për të dalë në pension.

Puna është se këshilltarët u ndodhën në një rrugë kryq dhe nuk mundnin të vendosnin midis ju të dyve; prandaj, gjatë këtyre trembëdhjetë muajve do të kenë kohë për të marrë një vendim përfundimtar.

Se ç'do të ndodhë kur të vijë ajo ditë, aq sa dini ju, di edhe unë. Ndërkaq, kam ndërmend të vë në punë të gjitha forcat e mia dhe kam nevojë për ndihmën e ju të dyve. E di se kjo ndihmë do të më jepet, sepse kjo është në vetë interesin tuaj.

Veç kësaj, e vetmja gjë që mund t'ju premtoj është se do të kemi një vit interesant.

18.

Margot Brekeni kishte pasur të bënte me Rajonin Lindor që në kohën kur punimet nuk kishin filluar ende. Në fillim, ajo kishte qenë konsulente ligjore e një grupi qytetarësh që donin të organizonin një fushatë për miratimin e shpejtë të projektit dhe, më vonë, kishte qenë me të njëjtën detyrë pranë Shoqatës së Qiramarrësve. Veç kësaj, ajo u jepte ndihmë juridike familjeve të lagjes, kundrejt një shpërblimi qesharak, ose, më mirë të thuash, pa shpërblim fare. Ajo shkonte shpesh në Rajonin Lindor dhe, kështu, kishte pasur rastin të njihej me shumë njerëz që banonin atje, duke përfshirë dhe Huanita Nunjezin.

Tri ditë mbas varrimit të Roselit — një të shtunë, në mëngjes — Margoti u takua me Huanitën në një dyqan prodhimesh gjysmë të gatshme, që bënte pjesë në qendrën tregtare të Rajonit Lindor.

Rajoni Lindor ishte projektuar si një kompleks homogjen banesash ekonomike, disa të tjera dhe të tjera të riparuara,

mbas restaurimit që u ishte bërë ndërtesave të vjetra. Kishte dhe kënde sportive, një kinema, një teatër, si edhe dyqane e kafene. Ndërtesat e përfunduara lidheshin me shëtitoren dhe tri vendkalime për këmbësorë. Pjesë të tjera të projektit ishin në ndërtim e sipër dhe, për disa të tjera, priteshin financimet e nevojshme.
— Mirëdita, zonja Nunjez, — tha Margoti. — A pimë nga një kafe sëbashku?
U ulën në tryezën e një bari dhe, duke pirë kafe ekspres, filluan të bisedojnë: për vetë Huanitën, vajzën e saj, Estelën, e cila atë mëngjes ishte në mësimin e baletit, në shkollën e organizuar nga vetë banorët e lagjes. Huanita dhe i shoqi, Karlosi, kishin qenë nga banorët e parë të kompleksit të ri. Ata kishin zënë një apartament të vogël, në njërën nga ndërtesat e vjetra të restauruara. Mirëpo, pak më vonë, Karlosi i kishte braktisur, duke u larguar për në një drejtim të panjohur. Huanita s'kishte ndërmend, hëpërhë, të ndërronte banesë.
Por jetesa është bërë shumë e vështirë, i tregoi ajo Margotit.
— Të gjithë këtu kanë të njëjtin problem. Çdo muaj, paratë tona vlejnë më pak. Ah, ky inflacioni! Ku do të përfundojmë kështu?
«Simbas Luis d'Orsejit, — mendoi Margoti, — në krizë ekonomike dhe në anarki.» E mbajti për vete këtë mendim, por ai i solli ndërmend bisedën që kishte bërë para tri ditësh me Luisin, Eduinën dhe Aleksin.
— Kam dëgjuar, — tha ajo, — se keni pasur njëfarë ngatërrese në bankën ku punoni.
Huanita u ngrys në fytyrë. Për një çast, u duk sikur do të shpërthente në vaj dhe Margoti shtoi me nxitim:
— Më falni. Ndoshta nuk duhej t'ju pyesja për këtë.
— Jo, jo! Vetëm se, papritur, m'u kujtua... Sidoqoftë, gjithçka

mbaroi. Mund t'ju flas për të, po të doni.
— Një gjë që duhet të dini për ne, avokatët, — tha Margoti,
— është se fusim shumë hundët në punët e të tjerëve.
Huanita buzëqeshi dhe, pastaj, u bë përsëri serioze, kur filloi të përshkruante zhdukjen e gjashtë mijë dollarëve dhe ankthin e dyzet e tetë orëve që kishte kaluar. Ndërsa Margoti dëgjonte, zemërimi i saj, që rrallë vonohej shumë, shpërtheu përsëri.
— Banka nuk kishte të drejtë t'ju torturonte në atë mënyrë, pa ju dhënë mundësinë të merrnit një avokat. Pse nuk m'u drejtuat mua?
— Nuk më shkoi fare në mend.
— Kjo është e keqja. Njerëzit e ndershëm nuk mendojnë se mund të kenë nevojë për ndihmë juridike. — Margoti U mendua pak dhe, pastaj, shtoi: — Eduina d'Orseji është kushërira ime. Do të flas me të për këtë punë.
Huanita u duk e habitur.
— Oh! Nuk e dija. Por, mos i thoni gjë, ju lutem. Në fund të fundit qe pikërisht zonja D'Orsej që zbuloi të vërtetën.
— Në rregull. Në rast se nuk doni, nuk do ta bisedoj këtë gjë me Eduinën, por me një njeri tjetër, që ju nuk e njihni. Dhe, mos harroni një gjë: Në qoftë se do t'ju ndodhë përsëri ndonjë ngatërresë, çfarëdo ngatërrese qoftë ajo, më thërrisni mua. Unë do të jem gjithmonë e gatshme t'ju ndihmoj.
— Falemnderit. Po qe se më ndodh gjë, ashtu do të bëj. Patjetër, do t'ju thërras.

Një javë para krishtlindjeve, Majlls Istini doli para gjykatës Federale, i paditur për përvetësim të paligjshëm në pesë rrethana të ndryshme. Katër aktakuza ishin në lidhje me veprimet e paligjshme të kryera me llogaritë e palëvizshme, që kapnin një shumë të përgjithshme prej trembëdhjetë mijë dollarësh; e pesta i përkiste vjedhjes së gjashtë mijë dollarëve.

Gjykatës ishte i nderuari Uinslou Anderud, i ndihmuar nga një juri.
Me këshillën e avokatit, një djali të ri, që përpiqej për të mirë, por s'kishte përvojë, i caktuar nga gjykata, mbasi ishte konstatuar se Istini s'kishte asnjë mundësi ta paguante vetë avokatin, u paraqit një kërkesë pafajësie për të pesë aktakuzat. Siç u pa më vonë, këshilla kishte qenë e keqe. Përpara tërë atyre provave, një avokat më i pjekur do të kishte rekomanduar me këmbëngulje një pranim të plotë fajësie dhe, ndoshta, një marrëveshje me prokurorin, më mirë se të lejohej të dilnin në dritë, gjatë procesit, disa hollësira, sidomos orvatja e bërë nga Istini për të fajësuar Huanita Nunjezin.
Ashtu si vajtën punët, gjithçka doli sheshit.
U thirrën si dëshmitarë Eduina d'Orseji, Totenhoi, inspector Gejni dhe një koleg i tij. Agjenti i posaçëm i FBI-së, Inisi, paraqiti si provë deklaratën e nënshkruar nga Majlls Istini dhe të përpiluar në selinë lokale të FBI-së, mbasi Istinit i qe shkëputur nga Nolan Uejnrajti pohimi i plotë.

Dy javë më parë, gjatë hetuesisë, avokati i të pandehurit kishte paraqitur një kërkesë lidhur me këtë dokument, duke ngulur këmbë që të hiqej nga aktet. Kërkesa nuk ishte pranuar. Gjykatës Anderudi i kishte vënë në dukje avokatit të ri të Istinit që, para se ta bënte deklaratën, Istinit i ishin shpjeguar të drejtat e tij ligjore, në prani të dëshmitarëve.

Pohimi i mëparshëm, i shkëputur nga Nolan Uejnrajti, për mungesën e ligjshmërisë së të cilit do të kishte qenë më e lehtë të luftohej, nuk nevojitej më dhe, prandaj, nuk u paraqit.

Pamja e Majlls Istinit në gjyq e trishtoi Eduinën. Ai dukej i rraskapitur, i zbehtë dhe poshtë syve shiheshin qartë rrathë të zinj. Tërë gjallëria e tij e zakonshme ishte zhdukur; flokët e pakrehur dhe rrobat e zhubrosura përbënin një kontrast të

madh me figurën pa të meta që kishte njohur ajo. Majlls Istini dukej i plakur që nga nata e inspektimit në degën e bankës.

Dëshmia e Eduinës qe e shkurtër, por veç i përmendte qartë e drejtë të gjitha hollësitë e nevojshme. Ndërsa avokati mbrojtës po i bënte me ton të butë kundërpyetjet e rastit, ajo i hodhi sytë disa herë drejt Majlls Istinit, por ai e mbante kokën ulur, duke mos dashur të takonte vështrimin e saj.

Një dëshmitare tjetër e padisë, ndonëse pa dëshirë, qe Huanita Nunjezi. Ajo dukej shumë e tronditur dhe trupi gjykues me zor mundi t'i dëgjonte fjalët e saj. Gjykatësi ndërhyri dy herë, duke iu lutur ta ngrinte pak zërin, por këtë e bëri me një ton shumë të njerëzishëm, mbasi tanimë, pafajësia e saj në të gjithë atë çështje ishte provuar plotësisht.

Huanita nuk shfaqi ndonjë shenjë mërie kundër Istinit gjatë dëshmisë së saj dhe dha përgjigje të shkurtra, kështu që prokurori i kërkoi, herë pas here, që t'i zgjeronte. Ishte e qartë se Huanita dëshironte vetëm t'i jepte fund, sa më parë që të ishte e mundur, asaj prove të rëndë.

Avokati i të pandehurit, me një urtësi të vonuar, vendosi të hiqte dorë nga e drejta e tij për t'i drejtuar kundërpyetje.

Menjëherë pas dëshmisë së Huanitës, avokati mbrojtës, mbasi shkëmbeu me gjysmë zëri disa fjalë me klientin e tij, kërkoi të bisedonte veças me gjykatësin dhe prokurorin. Ai u lejua ta bënte këtë. Atëherë, prokurori, gjykatësi dhe avokati mbrojtës filluan një bisedë me zë të ulët, gjatë së cilës, ky i fundit kërkoi autorizimin për ta ndryshuar deklaratën e Majlls Istinit nga «jo fajtor» në «fajtor».

Gjykatësi Anderud, një tip i qetë nga pamja e jashtme, por me një vullnet të hekurt, dëgjoi në heshtje dhe tha më në fund, duke e ulur zërin të në të njëjtën lartësi me atë të të dy juristëve të tjerë, në mënyrë që juria të mos mund të dëgjonte:

— Shumë mirë. Në rast se kështu dëshiron i pandehuri, e autorizoj ndryshimin e deklaratës. Por, duhet ta paralajmëroj përfaqësuesin e mbrojtjes se, kështu si janë tani punët, kjo gjë nuk mund të ketë më ndonjë efekt të rëndësishëm, po qe se do të ketë ndonjë efekt.

Mbasi iu lut jurisë të dilte nga salla, gjykatësi pyeti Istinin, për të verifikuar në se dëshironte ta ndryshonte deklaratën e tij dhe në se i kuptonte rrjedhojat e këtij veprimi. Të gjitha pyetjeve, i pandehuri iu përgjigj me zë të mbytur:

— Si urdhëroni, zoti kryetar.

Gjykatësi e thirri, pastaj, përsëri jurinë në sallë dhe e la të lirë.

Mbasi avokati i ri i mbrojtjes kërkoi, me shumë zjarr, mëshirë për klientin e tij, duke përmendur se, në të kaluarën, ai s'kishte kryer asnjë veprim ose shkelje të ligjit, Majlls Istinin e kthyen përsëri në qeli. Vendimi do të jepej javën tjetër.

Nolan Uejnrajti, megjithëse nuk do të dëshmonte, kishte marrë pjesë në proces. Tani, ndërsa ftuesi i gjyqit lajmëronte fillimin e një procesi tjetër dhe grupi i dëshmitarëve të bankës po dilte nga salla, drejtori i shërbimit të sigurimit të FMA-së iu afrua Huanitës.

— Zonja Nunjez, a mund të flas disa minuta me ju?

Ajo e shikoi dhe, në sytë e saj kishte një përzierje armiqësie dhe indiference. Pastaj, tundi kokën dhe tha:

— Gjithçka mbaroi. Veç kësaj, duhet të kthehem prapë në punë.

Kur qenë jashtë ndërtesës së gjykatës Federale, e cila gjendej vetëm pak blloqe godinash larg FMA-së dhe degës së bankës, ai nguli këmbë:

— Po shkoni në këmbë, drejt e në bankë?

Huanita pohoi me një lëvizje të kokës.
— Ju lutem, do të dëshiroja ta bëja rrugën me ju.
Huanita mblodhi supet.
— Po qe se është, patjetër, e nevojshme.
Uejnrajti priti deri sa Eduina d'Orseji, Totenhoi dhe dy inspektorët, që po drejtoheshin gjithashtu për në bankë, kaluan një kryqëzim rrugësh dhe, pastaj, e ngadalësoi me qëllim hapin. Semafori kaloi në dritën e kuqe, kështu që Huanita dhe ai mbetën prapa.
— E dini si është puna, — tha Uejnrajti, — të kërkuarit të falur s'ka qenë kurrë një gjë e lehtë për mua.
Huanita ia priti me hidhësi:
— E pse të shqetësoheni për këtë? Ajo është vetëm një fjalë dhe nuk ka kushedi se çfarë kuptimi!
— Sepse dua ta them. Ju kërkoj ndjesë për shqetësimin që ju shkaktova, që nuk besova se po thoshit të vërtetën, ndërsa ju atë po bënit dhe kishit nevojë që dikush t'ju ndihmonte.
— Po tani, e ndieni veten mirë? E gëlltitët aspirinën tuaj të vogël? Pushoi dhimbja e vockël?
— Sigurisht që, kështu, nuk më lehtësoni gjë.
Huanita u ndal.
— Po ju, m'i lehtësuat mua? — Fytyra e saj, e vogël, provokuese, ishte ngritur lart, me sytë e ngulur në ata të Uejnrajtit. Për herë të parë, ai ia kuptoi forcën dhe vullnetin e pavarur. Vuri re, gjithashtu, me habi, sensualitetin e fortë që rrezatohej prej saj.
— Jo, nuk jua lehtësova. Ja sepse, do të doja t'ju ndihmoja tani, në rast se mundem.
— Të më ndihmoni? Në ç'mënyrë?
— Duke siguruar nga burri juaj shpenzimet për mbajtjen tuaj dhe të fëmijës. — Uejnrajti i tregoi për hetimet e FBI-së, në sajë të të cilave kishte qenë e mundur të ndiqeshin gjurmët e Karlosit dhe të zbulohej se ky i fundit gjendej në Fëniks (Arizona). — Ai punon në një ofiçinë, si mekanik, dhe sigurisht që fiton.
— Mirë. Më bëhet qejfi për Karlosin.
— Mendoj, — vazhdoi Uejnrajti, — se do të ishte mirë që të

konsultoheni me njërin nga juristët tanë të bankës. Mund ta rregulloj unë këtë punë. Juristi do t'ju ndihmonte për të ngritur padinë kundër burrit tuaj dhe, pastaj, do të interesohem unë që të mos ju ngarkojnë me detyrime financiare për veprimet juridike.
— E pse do ta bënit këtë?

— Kemi një borxh ndaj jush.
Huanita tundi kokën.
— Jo.
Uejnrajti po pyeste veten nëse ajo e kishte kuptuar mirë.
— Shikoni. Kjo do të thotë se gjykata do të lëshonte një urdhër dhe se burri juaj do të ishte i detyruar t'ju dërgonte para për mbajtjen e vajzës.
— Dhe, a do ta bënte kjo Karlosin burrë?
— Ka rëndësi kjo?
— Ka rëndësi që Karlosi të jetë i detyruar të bëjë diçka? Ai e di shumë mirë që unë jam këtu dhe se Estela është me mua. Në rast se do të donte të na jepte nga paratë e tij, do të na i dërgonte. Si no, para ke?[1]) — shtoi ajo me zë të qetë.

Kjo ishte si një dyluftim me një hije. Duke e humbur durimin, ai tha:
— S'do t'ju kuptoj kurrë!
Papritur, Huanita buzëqeshi:
— S'është nevoja të më kuptoni.

Ndërsa po përshkonin, në heshtje, pjesën e vogël të rrugës që mbetej deri te banka, Uejnrajti po mendohej trishtueshëm për dështimin që kishte pësuar. Në qoftë se Huanita do ta kishte falënderuar për ofertën e tij, ajo do të kishte treguar, së paku, se e merrte atë seriozisht. U mundua të kuptonte mënyrën se si arsyetonte ajo dhe vlerësimet që bënte. Ishte e qartë se ajo vlerësonte shumë pavarësinë e saj. Ndoshta, mendoi ai, ajo e merrte jetën ashtu si i vinte, me fat ose pa fat, me shpresa ose zhgënjime. Në njëfarë mënyre, ai e kishte zili. Për këtë arsye dhe për tërheqjen fizike që kishte ndier pak më parë, i erdhi keq që nuk e kishte njohur më mirë.

— Zonja Nunjez, — tha më në fund. — Do të doja t'ju pyesja për diçka.
— Po?
— Në qoftë se do të keni ndonjë problem, një problem të vërtetë, diçka në të cilën unë do të mund të ndihmoja, a do të më thërrisnit?

Kjo ishte oferta e dytë e këtij lloji që i ishte bërë Huanitës brenda pak ditëve.
— Ndoshta.
Dhe kjo qe, deri mjaft kohë më vonë, biseda e fundit midis Uejnrajtit dhe Huanitës. Ai e ndjente se kishte bërë ç'ishte e mundur dhe, tani, kishte gjëra të tjera për të bërë. Njëra prej tyre ishte çështja, për të cilën kishte folur me Aleks Vandervurtin para dy muajve: të fuste në gjirin e shkelësve të ligjit një informator të fshehtë, me qëllim që të arrihej te burimi i letërkrediteve të falsifikuara, të cilat vazhdonin t'i shkaktonin seksionit Kiçarxh humbje të mëdha financiare.

Uejnrajti kishte gjetur një ish të burgosur, të cilin ai e njihte vetëm me emrin «Vik», që ishte i gatshëm — për para — t'i futej këtij rreziku të madh. Takimin e parë të fshehtë e kishin bërë; dhe për qenë marrë masa të veçanta fshehtësie e kujdesi. Tani duhej organizuar një takim i dytë.

Uejnrajti shpresonte me gjithë zemër që të mund t'ia dorëzonte drejtësisë falsifikatorët e letërkrediteve, ashtu siç kishte bërë me Majlls Istinin.

Javën tjetër, kur Istini u paraqit përsëri para gjykatësit Anderud — kësaj radhe për vendimin — Nolan Uejnrajti ishte i vetmi përfaqësues i Fërst Merkëntaill Emerikën Benkut në sallën e gjyqit.

Gjykatësi, me qetësi të plotë, zgjodhi disa dokumente dhe i vendosi para tij dhe, pastaj, i hodhi një vështrim të ftohtë Istinit, që rrinte në këmbë para tij.

— Keni gjë për të thënë?

— Jo, zoti kryetar. — Mezi i dëgjohej zëri.

— Kam marrë një raport nga nëpunësi që mbikëqyr qëndrimin e shkelësve të ligjit. — Gjykatësi Anderud u ndal për t'i hedhur një sy të shpejtë njërit prej dokumenteve që pati zgjedhur pak më parë — duket se e keni bindur që jeni sinqerisht i penduar për fajet, për të cilat e keni pranuar se jeni fajtor. — I shqiptoi fjalët «sinqerisht i penduar», sikur të kishte qenë fjala për diçka të neveritshme që mbahet me majat e gishtave, duke e bërë kështu të qartë se ai nuk ishte aq naiv sa të kishte të njëjtin mendim. — Mirëpo, — vazhdoi ai, — pendimi, qoftë i sinqertë ose jo, jo vetëm që vjen me vonesë, por edhe nuk mund ta zbehë dhe ta zbusë fajin e rëndë të orvatjes suaj keqdashëse për të hedhur përgjegjësinë e veprimeve tuaja keqbërëse mbi një grua të re, të pafajshme dhe që s'dyshonte për asgjë; një personi, që, për më tepër, ishte nën përgjegjësinë tuaj, si funksionar banke që ishit dhe që ju besonte, si një eprori të saj.
Në bazë të provave ekzistuese është e qartë se ju do të kishit vazhduar në këtë orvatjen tuaj, deri sa viktima juaj e pafajshme të paditej në vendin tuaj, të deklarohej fajtore dhe të dënohej. Për fat të mirë, në sajë të vigjilencës së personave të tjerë, kjo nuk ndodhi. Por, sigurisht, jo sepse ju e menduat përsëri këtë çështje, apo për shkak të «pendimit» tuaj.
Nga vendi ku ishte, në pjesën e sallës të rezervuar për publikun, Nolan Uejnrajti e shihte pjesërisht fytyrën e Istinit, e cila, në atë çast, u skuq krejt.
Gjykatësi Anderud e uli edhe një herë vështrimin mbi dokumentet para tij dhe pastaj, i ngriti prapë sytë, duke ia ngulur përsëri të pandehurit.
Gjer tani shqyrtova pjesën më të përbuzshme të sjelljes tuaj.

Kësaj i duhet shtuar edhe faji juaj kryesor: tradhtia me të cilën iu përgjigjët besimit që banka kishte pasur te ju, në cilësinë tuaj si funksionar dhe kjo nuk u bë vetëm një herë, por në pesë raste të ndryshme, me intervale mjaft të gjata njëri nga tjetri. Po të kishte qenë fjala për një akt të vetëm pandershmërie, ai do të mund të shpjegohej me një shtytje të çastit, por një shfajësim i tillë nuk mund të zbatohet për pesë vjedhje, të menduara me kujdes dhe të kryera me dinakëri. Një bankë, në cilësinë e saj si ndërmarrje tregtare, ka të drejtë të pretendojë ndershmëri nga ana e atyre që zgjedh, ashtu siç ju zgjodhën dhe vetë ju, për detyra që kërkojnë besim të madh. Po, një bankë është diçka më tepër se një ndërmarrje tregtare. Ajo është një institucion publik, i bazuar në besimin dhe, prandaj, publiku ka të drejtë të mbrohet nga ata që e abuzojnë këtë besim: nga individë si ju.
Vështrimi i gjykatësit e ndërroi drejtimin, për të përfshirë edhe avokatin e ri, në këmbë pranë klientit të tij, dhe toni i zërit iu bë më i rreptë dhe zyrtar.
— Po të kishte qenë ky një rast i zakonshëm dhe, duke marrë parasysh mungesën e rasteve penale të mëparshme, do të kisha vendosur lirinë kondicionale, me cilën mbrojtja e kërkoi me aq elokuencë javën e kaluar. Mirëpo, nuk është fjala për një rast të zakonshëm, por për një rast të jashtëzakonshëm, për arsyet e lartpërmendura. Prandaj, Istin, do të hyni në burg, ku do të keni tërë kohën e nevojshme për t'u menduar për veprimet tuaja, që ju sollën në këtë gjendje.

Vendimi i kësaj gjykate është që të viheni nën mbikëqyrjen e prokurorit të përgjithshëm për një periudhë prej dy vjetësh.

Mbas një shenje që bëri një ftues publik, një rojë iu afrua Istinit.

Pak minuta mbas vendimit, një bisedë e shkurtër u bë në një dhomë të vogël, të mbyllur me kyç dhe të mbajtur nën mbikëqyrje, një nga dhomat e shumta që ndodhen prapa sallës së gjyqit dhe që janë të rezervuara për të burgosurit dhe avokatët e tyre.

— Gjëja e parë që duhet mbajtur mend, — i tha Majlls Istinit avokati i ri, — është se, një dënim me dy vjet burgim, nuk do të thotë se të dy vjetët do të kalohen patjetër brenda në burg. Mbasi të jetë shlyer një e treta e dënimit, domethënë më pak se një vit, ju mund të bëni kërkesë që të liheni i lirë në mbikëqyrje.

Majlls Istini, me një pamje të hutuar e të pikëlluar, u kufizua të lëvizte kokën.

— Natyrisht, mund të bëni apelim, por nuk është e nevojshme që të vendosni që tani për një gjë të tillë. Ndërkaq, për të qenë i sinqertë, unë nuk jua këshilloj. Së pari, nuk besoj që, gjatë periudhës së apelimit, t'ju lënë të lirë. Së dyti, do të ishte pak e vështirë të motivohej kërkesa, duke qenë se e deklaruat veten fajtor. Së treti, ka mundësi që, në datën e caktuar për gjykimin e çështjes, ju ta keni shlyer dënimin.

— Loja ka marrë fund. Apelim nuk do të bëhet.

— Sidoqoftë, unë do të jem në kontakt me ju, se ndoshta mund të ndërroni mendje. Ndërkaq, më vjen keq që punët morën këtë rrugë.

— Edhe mua, — u përgjigj Istini, me ton tallës.

— Natyrisht, qe pohimi juaj ai që na çoi këtu. Në qoftë se s'do të ishte ai, nuk besoj që padia të kishte qenë në gjendje të provonte tezën e saj, ose, së paku, përsa i përket vjedhjes së gjashtë mijë dollarëve, gjë që ndikoi shumë mbi vendimin. Natyrisht, e di pse e nënshkruat deklaratën e dytë, atë të FBI-së: kujtonit se e para ishte e vlefshme, kështu që nuk kishte ndonjë rëndësi po të bëhej edhe një tjetër. Mirëpo,

përkundrazi, rëndësi pati. Sidoqoftë, ai i sigurimit, Uejnrajti, ju futi mirë në grackë.

I burgosuri tundi kokën në shenjë pohimi.
— Po, po, tani e kuptoj edhe unë.
Avokati shikoi orën.
— Mirë. Tani duhet të shkoj. Kam një proces tjetër.
Një rojë i hapi derën.
Të nesërmen, Majlls Istinin e transferuan në një burg federal, jashtë shtetit.

Kur u mësua në Fërst Merkëntajll Ëmerikën Benk lajmi mbi dënimin e Majlls Istinit, disave, nga ata që e njihnin, u erdhi keq; disa të tjerë qenë të mendimit se e meritonte dënimin. Ata qenë të një mendjeje për një gjë: askush nuk do të dëgjonte më në bankë të flitej për Majlls Istinin.
Vetëm koha do ta provonte se sa i gabuar ishte ky supozim.

Pjesa e dytë

1.

Si një flluskë që ngjitet në sipërfaqen e ujit, shënja e parë e ngatërresave që do të ndodhnin u duk aty nga mesi i janarit.

Ishte një artikull në rubrikën e thashethemeve «Veshi në vrimën e çelësit», në numrin e së dielës të një gazete lokale.

Redaktori shkruante:
«. . . *Në qytet qarkullojnë zëra se, së shpejti, fondet e caktuara për Rajonin Lindor do të pakësohen shumë. Thuhet se këtij projekti shumë të madh për ndërtime dhe restaurime ndërtesash i kanë dalë disa probleme financiare. E kush nuk ka probleme të tilla në ditët tona?...*»

Aleks Vandervurti mori vesh për këtë artikull vetëm të hënën në mëngjes, kur e pa në tryezën e tij të punës, bashkë me gazetat e tjera. Për t'i tërhequr vëmendjen, sekretarja e tij e kishte rrethuar me një vizë të kuqe.

Të hënën pasdite, Eduina i telefonoi për ta pyetur nëse e kishte lexuar dhe nëse e dinte se ç'lëvrinte poshtë kësaj zhurme. Interesimi i Eduinës nuk kishte asgjë të veçantë. Që prej fillimit të punimeve në Rajonin Lindor, dega e saj e bankës ishte marrë me huatë e ndërtimeve, me shumë nga hipotekat që lidheshin me to dhe të gjitha formalitetet e tjera. Tani, projekti i ndërtimeve në Rajonin Lindor përfaqësonte një pjesë të rëndësishme të punës së bankës.

— Në rast se është menduar të bëhet ndonjë gjë,— nguli këmbë Eduina, — dua të vihem në dijeni.

— Me sa di unë, — e siguroi Aleksi, — asgjë s'është ndryshuar.

Pas pak, ai zgjati dorën drejt telefonit, për të pyetur Xherom Petërtonin, por, pastaj, ndërroi mendje. Nuk ishte hera e parë që qarkullonin lajme të pasakta lidhur me Rajonin Lindor. Projekti kishte pasur që në fillim jehonë të madhe dhe ishte e pashmangshme që, herë pas here, të përhapej edhe ndonjë lajm i pasaktë. S'kishte kuptim, mendoi Aleksi, që të shqetësohej presidenti i ri i bankës për një budallallëk të tillë, veçanërisht në një kohë kur ai kishte nevojë për ndihmën e Petërtonit, lidhur me një çështje shumë të rëndësishme që do

të shqyrtonte më shpejti këshilli — rritja në shkallë të gjerë e sektorit të depozitimeve të kursimit.

Megjithatë, disa ditë më vonë, ai filloi ta ndiejë veten më të preokupuar, kur u botua një artikull më i gjatë, kësaj radhe në faqen e zakonshme të lajmeve të gazetës «Tajms Rexhistër».

Në artikull thuhej:

Vazhdon gjendja e ankthit për të ardhmen e Rajonit Lindor, ndërsa shtohen zërat, sipas të cilëve, së shpejti, fondet do të pakësohen së tepërmi, ose do të pezullohen fare.

Projekti i Rajonit Lindor, objektivi me afat të gjatë i të cilit është rregullimi i qendrës tregtare dhe i banimit të qytetit, subvencionohet nga një konsorcium institutesh financiare, me në krye Fërst Merkëntajll Emerikën Benkun.

Sot, një zëdhënës i FMA-së, i pyetur lidhur me këto lajme alarmante, nuk i përgënjeshtroi, por vetëm tha: «Në kohën e duhur do të bëhet një deklaratë».

Siç e parashikon projekti, disa zona banesash janë modernizuar ose rindërtuar. Eshtë përfunduar tanimë ndërtimi i njërës nga gratacielat me apartamente banimi, me qira të ulëta. Një tjetër është në ndërtim e sipër.

Një plan i përgjithshëm dhjetëvjeçar përmban plane të veçanta për zgjerimin e shkollave, ndihmë tregtare për pakicat, kualifikim profesional dhe sigurimin e vendeve të punës, si edhe qendra kulturore dhe pushimi. Gjer më tani, punimet e këtij plani, që kishin filluar dy vjet e gjysmë më parë, kanë ecur simbas parashikimit.

Aleksi e lexoi artikullin në apartamentin e tij, gjatë kohës që po hante mëngjesin. Ai ishte vetëm; Margoti ishte larguar nga qyteti para një jave, për shkak të angazhimeve të saj profesionale.

Sapo mbërriti në Drejtorinë Qendrore, Aleksi thirri Dik Frençin. Ky i fundit, trupmadh dhe i njohur për zakonin që kishte t'ia thoshte tjetrit gjërat në sy, kishte qenë më parë redaktor për çështje financiare dhe, tani, drejtonte me aftësi zyrën e marrëdhënieve publike.

— Së pari, — e pyeti Aleksi, — kush ishte zëdhënësi?

— Unë isha. Dhe po ta them që tani se nuk më pëlqeu fare thënia «deklaratë në kohën e duhur». Mirëpo, Petërtoni më urdhëroi të përdorja pikërisht ato fjalë. Ai nguli këmbë gjithashtu që të mos thosha gjë tjetër.
— Pse, çfarë tjetër mund të thuhej?
— Ma thuaj ti, Aleks. Me sa duket po gatuhet diçka dhe, pavarësisht nëse është e mirë a e keqe, sa më parë që ta shpallim, aq më mirë do të jetë.
Aleksi e përmbajti zemërimin që po i shtohej gjithnjë e më shumë.
— Ka ndonjë arsye që nuk u vura në dijeni të kësaj çështjeje?
Frençi u duk i habitur.
— Unë kujtoja se ti ishe në dijeni. Dje, kur po bisedoja në telefon me zotin Petërton, e kuptova që Roskoi ishte me të, sepse i dëgjoja duke folur së bashku. Më shkoi mendja se edhe ti do të ishe atje.
— Herë tjetër, — tha Aleksi, — të mos të të shkojë mendja për asgjë.
Ai e la të lirë Frençin dhe i tha sekretares së tij të pyeste nëse Xherom Petërtoni ishte i lirë. I thanë se presidenti s'kishte ardhur ende në bankë, por ishte nisur dhe se Aleksi mund të takohej me të në ora njëmbëdhjetë. S'e zinte vendi nga padurimi dhe iu vu punës lidhur me planin e rritjes së depozitimeve të kursimit.
Në ora njëmbëdhjetë, ai përshkoi ato pak metra që e ndanin nga zyra e presidentit: dy dhoma në qoshe të ndërtesës, secila

me një panoramë të tërë ndryshme të qytetit. Që prej emërimit të presidentit të ri, dhoma e dytë mbahej zakonisht me derë të mbyllur dhe askush s'ishte ftuar të hynte brenda. Nëpërmjet sekretareve ishte mësuar se Petërtoni e përdorte këtë dhomë për t'u stërvitur në golf mbi qilim.
Dielli shndriste në qiellin e dimrit pa re, dhe, nëpërmjet xhamit, që zinte pothuajse tërë faqen e murit, ndriçonte kafkën ngjyrë trëndafili të Xherom Petërtonit, pa asnjë qime floku, krejtësisht tullace. Ai ishte ulur në tryezën e punës dhe, në vend të tuidit të tij të zakonshëm, kishte veshur një kostum klasik. Kishte përpara një gazetë, të hapur në mënyrë që të mund të lexohej artikulli mbi Rajonin Lindor, që e kishte shtyrë Aleksin të shkonte atje.
Në një divan, që nuk e zinte dielli, ishte Rosko Hejuordi.
Të tre u përshëndetën.
Petërtoni tha:
— I thashë Roskoit të qëndronte, sepse e merrja me mend se cila mund të ishte arsyeja e vizitës sate. — Preku me gisht gazetën dhe vazhdoi: — Sigurisht, e ke parë këtë.

— E kam parë, — tha Aleksi. — Dhe bisedova edhe me Dik Frençin. Më tha se, dje, ti dhe Roskoi keni diskutuar për përgjigjet që i duheshin dhënë shtypit. Prandaj, pyetja ime e parë është: Përse unë nuk u informova? Edhe unë kam të bëj me Rajonin Lindor, apo jo?

— Qëllimi ishte të të informonim, Aleks. — Xherom Petërtoni dukej i zënë ngushtë. — E vërteta është se u hutuam pak, sepse këmbëngulja e shtypit tregonte se kishte pasur një dekonspirim.

— Një dekonspirim? Lidhur me çfarë?

Qe Hejuordi që u përgjigj:

— Lidhur me një propozim që, të hënën e ardhshme do të paraqes në komisionin e investimeve. Do të sugjeroj që kontributi i tanishëm i bankës për Rajonin Lindor të pakësohet me rreth pesëdhjetë për qind.

Aleksi nuk mbeti i habitur nga fakti se fjalët që qarkullonin ishin të vërteta. Ajo që e çuditi ishte përqindja e madhe e fondeve që mendohej të pakësoheshin.

Ai iu drejtua Petërtonit:

— A duhet të kuptoj nga kjo se je në favor të kësaj marrëzie?

Një cipë e kuqe e mbuloi fytyrën dhe kafkën në trajtë vezake të presidentit.

— Nuk mund të përgjigjem as po e as jo. E kam lënë të vendos të hënën, pavarësisht se dje edhe sot Roskoi vazhdon të më bëjë presion.

— Tamam ashtu, — shtoi Hejuordi, me zë të qetë. — Një taktikë krejtësisht e ligjshme, Aleks. Dhe, po qe se ke ndonjë kundërshtim, më lejo të të përmend se ka pasur plot raste, kur ti ia ke paraqitur Benit mendimet e tua para mbledhjes së komisionit.

— Në qoftë se kam vepruar ashtu, — ia priti Aleksi, — ka qenë fjala për mendime shumë të arsyeshme se në këtë rast.

— Natyrisht, ky është vetëm mendimi yt.

— Jo vetëm imi. Ka dhe të tjerë që mendojnë kështu.

Hejuordi nuk u trondit.

— Mendimi im është se ne mund t'i përdorim paratë e bankës në një mënyrë më të arsyeshme. — U kthye nga Petërtoni: — Meqë ra fjala, Xherom, fjalët që po qarkullojnë mund të jenë të dobishme, në rast se do të vendoset pakësimi i fondeve. Së paku, në këtë mënyrë, vendimi s'do të vinte krejt

i papritur.
— Po qe se e mendon kështu, — tha Aleksi, — atëherë je ndoshta vetë ti që i përhadur këto fjalë.
— Të siguroj që jo.
— Atëherë, si i shpjegoni ato?
Hejuordi mblodhi supet.
— Mendoj se do të jetë një rastësi.
Aleksi tha me vete: A mund të jetë kjo një rastësi, apo ndokush shumë i afërt i Roskoit kishte dashur të shihte pulsin e publikut, në interesin e vetë Roskoit? Po. Ky mund të ishte shumë mirë Harold Ostini; i nderuari Ostin, i cili, si titullar i një agjencie publicitare, sigurisht kishte kontakte të shumta me shtypin. Sidoqoftë, shihej se ishte gati e pamundur të zbulohej gjë.
Xherom Petërtoni ngriti duart:
— I lini argumentet e tjera për të hënën. Atëherë, do t'i shqyrtojmë të gjitha.

— Të mos gënjejmë veten, — nguli këmbë Aleks Vandervurti. — Puna është të përcaktojmë sot se deri në ç'kufi një fitim është i arsyeshëm dhe ku është i tepruar.
Rosko Hejuordi buzëqeshi.
— Sinqerisht, Aleks, çfarëdo fitimi s'e kam quajtur kurrë të tepruar.
— As unë, — shtoi Tom Stroani. — Mirëpo, e pranoj se nuk është një veprim i matur të kërkosh të sigurosh fitime jashtëzakonisht të mëdha, sepse mund të sjellin kokëçarje. Në fund të vitit financiar, jemi të detyruar t'i shpallim fitimet. Mund të na kritikojnë, kur të merren vesh.
— Dhe kjo është një arsye tjetër, — shtoi Aleksi, — përse duhet të mbajmë njëfarë ekuilibri midis fitimit të marrë dhe shërbimit të bërë.
— Duke siguruar një fitim të madh ne u bëjmë një shërbim të mirë aksionistëve tanë, — tha Hejuordi. — Ky është lloji i shërbimit që unë vë në radhë të parë.

Komisioni i bankës për investimet ishte mbledhur në një sallë konferencash. Ai kishte katër anëtarë dhe mblidhej të hënave, një herë në dy javë. Kryesohej nga Rosko Hejuordi dhe anëtarët e tjerë ishin Aleks Vandervurti dhe dy funksionarë të lartë të FMA-së: Tom Stroani dhe Orvil Jangu.

Qëllimi i komisionit ishte të vendoste mënyrat e përdorimit të fondeve të bankës. Vendimet kryesore i kaloheshin pastaj këshillit administrativ për miratim, ndonëse rrallë ndodhte që këshilli të ndryshonte propozimet e komisionit.

Investimet e shqyrtuara nga komisioni rrallë ishin më pak se dhjetë milionë dollarë secili.

Presidenti i bankës merrte pjesë në mbledhjet më të rëndësishme, por pa ndërhyrë drejtpërdrejtë. Ai votonte vetëm në rast se palët e kundërta ishin në numër të barabartë. Atë ditë, Xherom Petërtoni ishte i pranishëm, por s'kishte marrë pjesë ende në diskutim.

Siç qe njoftuar më parë nga Rosko Hejuordi, në shqyrtim ishte propozimi i tij për një pakësim shumë të madh të fondeve të caktuara për Rajonin Lindor.

Në rast se punimet do të vazhdonin me ritmin e parashikuar, brenda pak muajsh do të ishin të nevojshme fonde të tjera për ndërtimet dhe hipotekat. Për këtë financim, kuota që do të jepte Fërst Merkëntaill Ëmerikën Benku ishte prej pesëdhjetë milionë dollarësh. Hejuordi kishte propozuar që kjo shumë të pakësohej përgjysmë.

Ai kishte theksuar që në fillim:

— Do ta bëjmë të qartë për të gjithë se nuk kemi ndërmend të tërhiqemi nga projekti. Shpjegimi që do të japim është thjesht ky: duke pasur parasysh angazhimet tona, na është dashur të bëjmë një shpërndarje të re të kuotave të investimeve. Projekti nuk do të pezullohet, vetëm se do të realizohet më ngadalë se sa ka qenë planifikuar në fillim.

— Në qoftë se e shtron nga pikëpamja e nevojës, — kishte protestuar Aleksi, — realizimi i projektit është që tani më i ngadalshëm nga sa duhej të ishte. Një vonesë akoma më e madhe në realizimin e tij do të ishte gjëja më e keqe që do të bënim në çdo drejtim.

— Po nga pikëpamja e nevojës e shtroj, — kishte theksuar Hejuordi. — Nevojë e bankës.

Hejuordi nuk e kishte zakon të jepte përgjigje të pasjellshme, por ndoshta — kishte menduar Aleksi — ai po vepronte kështu sepse kishte bindjen se vendimi i komisionit do të ishte ashtu siç e dëshironte ai. Aleksi ishte i sigurt që Tom Stroani do të mbante anën e tij, kundër Hejuordit. Stroani, kryeekonomisti i bankës, ishte një djalë i ri, i zellshëm, me një gamë të gjerë çështjesh që e interesonin dhe e tërhiznin. Kishte qenë graduar nga vetë Aleksi, duke kapërcyer mbi shumë kandidatë të tjerë. Mirëpo, Orvil Jangu, përgjegjësi i Thesarit të bankës, ishte pasues i Hejuordit dhe, pa dyshim, do të bashkohej me propozimin e tij.

Në FMA, sikurse në cilëndo bankë tjetër të madhe, rrallë ndodhte që shkalla e vërtetë e fuqisë të përputhej me atë të hierarkisë. Autoriteti i vërtetë ndiqte një rrugë të tërthortë ose me plot dredha, sipas besnikërisë së disa personave, apo disa të tjerëve; kështu që, ata që nuk donin të merrnin pjesë në luftën për pushtet, liheshin më një anë dhe për ta s'interesohej më njeri.

Rivaliteti ndërmjet Aleks Vandervurtit dhe Rosko Hejuordit ishte i njohur mirë, kështu që disa funksionarë të FMA-së kishin zgjedhur njërën anë ose tjetrën, duke i mbështetur shpresat e tyre për gradim në fitoren e njërit kundërshtar apo tjetrit. Kjo çarje pasqyrohej edhe në komisionin e investimeve.

Aleksi kundërshtoi:

— Vitin e kaluar, fitimet tona u ngritën në trembëdhjetë për qind. Siç e dimë të gjithë, ky është një fitim jashtëzakonisht i mirë për cilëndo ndërmarrje ose ent tregtar. Parashikimet për vitin e ardhshëm janë akoma dhe më të mira: pesëmbëdhjetë dhe, ndoshta, gjashtëmbëdhjetë për qind. Duhet, patjetër, të kërkojmë akoma dhe më shumë?

Përgjegjësi i Thesarit, Orvil Jangu, tha:

— Pse jo?

— Kësaj pyetjeje iu përgjigja unë më parë, — ia priti Stroani, — sepse do të ishte një veprim prej miopësh.

— Të mos harrojmë një gjë, — nguli këmbë Aleksi. — Në sektorin bankar nuk është vështirë të sigurohen përqindje të larta fitimi dhe, në rast se një bankë nuk e bën dot këtë, do të thotë se ajo drejtohet nga leshko. E parë nga të gjitha anët, punët shkojnë mirë dhe janë në favorin tonë. Kemi përpara mundësi të mëdha, përvojën tonë dhe ligje të arsyeshme. Ky faktor i fundit është ndoshta më i rëndësishmi. Por, ligjet nuk do të jenë gjithmonë kaq të arsyeshme; domethënë se nuk do të jenë më të tilla, po qe se ne do të vazhdojmë ta teprojmë dhe të refuzojmë përgjegjësinë shoqërore kolektive.

— Nuk e kuptoj se si mund të flitet për refuzim përgjegjësie shoqërore kolektive, — u përgjigj Rosko Hejuordi, — kur ne vazhdojmë të financojmë Rajonin Lindor. Edhe mbas pakësimit që po propozoj të bëhet, kontributi ynë do të ishte mjaft i rëndësishëm.

— I rëndësishëm i thënçin! Ai do të ishte një kontribut minimal, ashtu siç ka qenë gjithmonë kontributi shoqëror i bankave amerikane. Financimi i ndërtimeve publike nga ana e kësaj banke dhe e cilësdo banke tjetër është i tillë që të vjen turp ta mendosh. Pse të gënjejmë veten? Kanë kaluar tanimë disa breza që kur bankat s'i kanë përfillur fare problemet publike. Edhe tani, ne japim vetëm minimalen, sa për t'u dukur se po bëjmë diçka.

Kryeekonomisti, Stroan, pasi u hodhi një sy shënimeve të tij, tha:

— Kisha ndërmend të ngrija çështjen e huave hipotekare, Rosko, por meqë këtë gjë e bëri Aleksi, desha të theksoj se vetëm njëzet e pesë për qind e shumës së depozitimeve të kursimit përdoren tani për huatë hipotekare. Kjo është një përqindje e ulët. Ne mund ta rrisim atë gjer në pesëdhjetë për qind, pa ndikuar në mënyrë të ndjeshme në sasinë e parave që disponon banka. Unë mendoj se kjo duhet bërë.

— Jam plotësisht i këtij mendimi, — tha Aleksi. — Drejtorët e degëve të bankës sonë kërkojnë vazhdimisht para për huatë hipotekare. Investimi jep fitim të mirë dhe, nga përvoja, ne e dimë se rreziku në këtë çështje është i papërfillshëm.

Orvil Jangu kundërshtoi:

— Ashtu është, por i mban të bllokuara për një kohë të gjatë paratë, të cilat mund t'i investojmë gjetiu me një interes më të lartë.

Aleksi qëlloi me padurim tryezën me pëllëmbën e dorës:
— Nganjëherë është edhe detyra jonë kolektive të pranojmë interesa më të ulëta. Ja sepse, jam kundër kësaj orvatjeje për të sakatuar investimet për Rajonin Lindor.

— Ka dhe një arsye tjetër, — shtoi Tom Stroani. — Aleksi e përmendi atë: ligjet. Në kongres po fillojnë të lëvizin. Shumë anëtarë të tij do të donin të dilte një ligj i ngjashëm me atë të Meksikës, i cili i detyron bankat t'u kushtojnë ndërtimeve publike një përqindje të caktuar të depozitimeve të tyre.

— Këtu, te ne, nuk do të miratohet kurrë një gjë e tillë, — ia priti Hejuordi me qesëndi. — Janë bankat ato që kanë ndikimin më të madh në Uashington. — Stroani tundi kokën.
— Nuk i duhet besuar shumë kësaj gjëje.
— Tom, — tha Rosko Hejuordi, — po të bëj një premtim.

Mbas një viti do ta shqyrtojmë përsëri, me imtësi, çështjen e huave hipotekare; ndoshta do të bëjmë ashtu si propozon ti; ndoshta, do ta rrisim shumën e investimeve për Rajonin Lindor. Por, jo sivjet. Dua që ky të jetë një vit fitimesh të mëdha. — I hodhi një vështrim presidentit të bankës, i cili, gjer në atë çast, s'kishte marrë pjesë në diskutime. — Dhe kështu dëshiron edhe Xheromi.

Aleksi e kuptoi më në fund synimin e strategjisë së Hejuordit. Një vit fitimesh të jashtëzakonshme për bankën do ta bënin Xherom Petërtonin, presidentin e saj, një herë në sytë e aksionistëve dhe të këshilltarëve. Petërtoni kishte para tij një periudhë mbretërimi prej vetëm një viti, në fund të një karriere që s'kishte pasur asgjë të veçantë; por, në këtë mënyrë, do të dilte në pension plot lavdi dhe lëvdata. Dhe Petërtoni ishte edhe ai një qenie njerëzore. Prandaj, ishte e kuptueshme që kjo gjë ta tërhiqte.

Pjesa tjetër e skenarit nuk ishte e vështirë të merrej me mend. Xherom Petërtoni, duke qenë mirënjohës ndaj Rosko Hejuordit, do të përkrahte kandidaturën e këtij si pasardhës në postin e presidentit dhe, falë një viti aq të frytshëm, do të ishte në një pozitë aq të fortë, sa të bënte që dëshirat e tij të respektoheshin.

Plani i Hejuordit ishte i menduar aq mirë, saqë Aleksit i dukej e vështirë të gjente ndonjë të çarë në të.
— Ka dhe diçka tjetër, për të cilën s'kam folur akoma, — vazhdoi Hejuordi, — as me ty, Xherom. Mund të kishte ndikuar mbi vendimin tonë të sotëm.

Të tjerët ia ngulën sytë me kureshtje.
— Kam shumë shpresë, ose më mirë, ka shumë të ngjarë që, së shpejti, të fillojmë marrëdhënie të frytshme me Suprënejshnël Korporejshënin. Kjo është një arsye tjetër, që më bën të mos kem dëshirë t'i angazhoj fondet gjetiu.

— Ky është një lajm fantastik! — thirri Orvil Jangu. Edhe Tomi, sado që i habitur, shprehu miratimin e tij.

Suprënejshnël Korporejshëni — ose SuNatKo-ja, siç quhej zakonisht në tërë botën — ishte një ndërmarrje shumëkombeshe vigane, Xhenërëll Moutorsi i komunikacioneve botërore. Nga ana tjetër, ajo zotëronte ose kontrollonte dhjetëra ndërmarrje të tjera, që ushtronin veprimtarinë e tyre në të njëjtën fushë si vetë ajo, ose në fusha të tjera. Thuhej se ndikimi i saj mbi qeveri të ndryshme të çdo ngjyre, nga demokracitë e gjer te diktaturat, ishte më i madhi që kishte pasur ndonjëherë një kompleks tregtar. Vrojtues të ndryshëm pohonin nganjëherë se SuNatko-ja kishte, në të vërtetë, më shumë fuqi se shumica e shteteve sovrane, në të cilat vepronte.

Gjer në atë kohë, SuNatko-ja e kishte kufizuar veprimtarinë e saj bankare në Shtetet e Bashkuara, me tri bankat e mëdha: Benk ov Emerika, Fërst Nejshnël Siti Benk dhe Çeis Menhetën Benk.

Në rast se Fërst Merkëntaill Emerikën Benku do të arrinte të përfshihej në këtë treshe të privilegjuar, prestigji i saj do të rritej jo pak.

— Kjo është një perspektivë entuziazmuese, Rosko, — tha Petërtoni.

— Mendoj se do të kemi më shumë hollësira në mbledhjen tonë të ardhshme, — shtoi Hejuordi. — Ka shumë të ngjarë që Suprënejshnëli të na kërkojë t'i japim një kredi të rëndësishme.

Në këtë çast, Tom Stroani tha:

— Na mbetet ende të votojmë për Rajonin Lindor.

— Mirë, le të votojmë, — tha Hejuordi. Ai po buzëqeshte plot besim, i kënaqur nga efekti që kishte bërë lajmi që u kishte dhënë dhe e ndjente veten të sigurt për përfundimin e votimit.

Siç parashikohej, anëtarët e komisionit u ndanë në dy grupe të kundërta: Aleks Vandervurti dhe Tom Stroani ishin kundër pakësimit të fondeve; Rosko Hejuordi dhe Orvil Jangu, në favor.

Të katër ata e kthyen kokën nga Xherom Petërtoni, të cilit i takonte vota vendimtare.

Presidenti i bankës ngurroi vetëm një çast dhe, pastaj, tha:
— Aleks, në këtë pikë, jam i një mendjeje me Roskonë.

2.

— Asgjë nuk vjen duke ndenjur këtu ulur dhe duke shprehur keqardhje, — tha Margoti. — Ajo që duhet bërë është të luajmë këmbët dhe të bëjmë ndonjë gjë.
— Duke vënë, për shembull, ca dinamit nën atë bankën e mallkuar? — pyeti dikush.
— Jo, asgjë të tillë! Kam miq, atje. Veç kësaj, hedhja në erë e bankave nuk është veprim i ligjshëm.
— Kush thotë se duhet të rrimë brenda kufirit të ligjshmërisë?
— Unë e them — ia priti Margoti me ton të prerë.
— Dhe po qe se ka ndonjë të zgjuar që mendon ndryshe, mund të kërkoni një zëdhënës dhe mbrojtës tjetër.
Në studion e Margot Brekënit ishte mbledhur një të enjte mbrëma komisioni ekzekutiv i Shoqatës së bashkimit të banorëve të Rajonit Lindor. Kjo shoqatë ishte një nga grupet e shumta që ishin krijuar aty, në qendrën e vjetër të qytetit, të cilave Margoti u jepte ndihmë juridike dhe që përdornin studion e saj si vend mbledhjesh, shërbim ky, që, nganjëherë i paguhej, por, në më të shumtën e rasteve, jo.

Për fat të mirë, studioja e saj ishte e thjeshtë: dy dhoma, që dikur kishin qenë dyqani i një bakalli të lagjes. Në mure ishin akoma disa nga raftet e vjetra, që tani mbanin libra drejtësie. Pjesa tjetër e mobiljeve, shumica e të cilave s'shkonin me njëra-tjetrën, ishin gjëra pa vlerë, që Margoti i kishte blerë lirë, pak e nga pak.
Dy dyqane të tjera, në të dy krahët e ish dyqanit të bakallit, ishin braktisur me kohë dhe dyert e tyre ishin të mbyllura me boshte druri. Ndonjë ditë, me pak fat dhe punë, batica e ndërtimeve dhe e restaurimeve të Rajonit Lindor do të vinte dhe do të përfshinte edhe këtë zonë; por, gjer në atë çast, kjo s'kishte ndodhur ende.
Komisioni ishte mbledhur pikërisht për të diskutuar për punimet e ardhshme të Rajonit Lindor.
Dy ditë më parë, me anë të një deklarate publike, *Ërst Merkëntaill Ëmerikën Benku* i kishte bërë realitet fjalët që qarkullonin. Financimi i punimeve të Rajonit Lindor pakësohej me pesëdhjetë për qind dhe kjo hynte në fuqi menjëherë.
Komunikata e bankës ishte përpiluar në një gjuhë burokratike, që përmbante fraza eufemiste, si «mungesë e përkohshme fondesh për investime me afat të gjatë» dhe «gjendja do të rishqyrtohet periodikisht», por askush nuk e besonte këtë pohim të fundit dhe, bile, të gjithë, brenda dhe jashtë bankës, e dinin se cili ishte kuptimi i vërtetë i komunikatës: prerja e afërme e plotë e fondeve dhe, pra, e punimeve.

Komisioni ishte mbledhur për të vendosur se ç'duhej bërë, në rast se mund të bëhej gjë.

Fjala «banorë», në emrin e shoqatës, ishte mjaft elastike. Një pjesë e mirë e anëtarëve ishin banorë të Rajonit Lindor; shumë të tjerë nuk ishin, por shpresonin të bëheshin. Siç kishte thënë pak më parë Dikën Jufrejtsi, punëtor metalurg i

dalluar dhe njëri nga anëtarët e komisionit: «Në qoftë se pritet pjesa më e madhe e fondeve, shumica jonë, që presim të strehohemi, do të mbetet me gisht në gojë.»

Margoti e dinte se Dikëni, e shoqja dhe të pesë fëmijët e tyre, banonin në një apartament të vogël e të vjetër, pa ashensor, plot me minj, që duhej të ishte shembur vite më parë. Ajo ishte përpjekur disa herë ta ndihmonte për të gjetur një banesë tjetër, por pa sukses. Dikën Jufrejtsi kishte shpresuar se do të mund të kalonte në njërën nga ndërtesat e reja të banimit të Rajonit Lindor, por ai e kishte emrin në mes të një liste të gjatë personash dhe familjesh në pritje dhe, një ngadalësim i planit të ndërtimeve, do ta mbante në listën e pritjes edhe për shumë kohë akoma.

Edhe Margoti ishte tronditur nga njoftimi i FMA-së. Ajo ishte e sigurt se Aleksi do të kishte qenë kundër pakësimit të fondeve, por, me sa dukej, nuk ia kishte dalë në krye. Për këtë arsye, ajo s'ishte biseduar akoma këtë çështje me të. Veç kësaj, sa më pak të dinte Aleksi për disa plane që ajo po kurdiste, aq më mirë ishte për të dy ata.

— Me sa kuptoj unë, — tha Seth Orinda, një anëtar tjetër i komisionit, — çfarëdo që të bëjmë ne, të ligjshme ose jo, s'kemi mundësi, asnjëfarë mundësie, për t'i shtyrur ato para nga banka; domethënë, në rast se ata janë të vendosur ta kyçin mirë arkën.

Seth Orinda ishte zezak dhe mësues në një shkollë të mesme. Ai ishte banor efektiv i Rajonit Lindor, por e kishte shumë të zhvilluar ndërgjegjen kolektive dhe merakosej mjaft për fatin e mijëra të tjerëve që prisnin me shpresë të gjenin edhe ata strehim në Rajonit Lindor.

— Mos ji kaq i sigurt, Seth, — i tha ajo. — Bankat kanë, në trupin e tyre, pika të dobëta. Le t'i godasim në një pikë të tillë dhe do të shohësh se sa gjëra të çuditshme mund të dalin nga kjo.

— Në ç'mënyrë t'i godasësh? Me anë të një parakalimi? Një dyndjeje brenda godinave të tyre, duke qëndruar brenda deri sa të zgjidhet çështja? Një demonstratë?

— Jo, — tha Margoti. — Lëri këto, u ka kaluar koha. Janë gjëra të vjetëruara. Demonstratat tradicionale s'i bëjnë më përshtypje askujt, në ditët tona. Ato vetëm se mërzisin njerëzit dhe nuk nxjerrin asgjë në krye.

Ajo i vështroi, njërin pas tjetrit, të gjithë ata që ishin mbledhur në studion e saj: ishin nja dymbëdhjetë veta, të bardhë e të zinj, të përzier. Disa rrinin ulur me kujdes në karrige të lëkundshme dhe dhe arka, të tjerë rrinin galiç në dysheme.

— Më dëgjoni mirë, të gjithë. Thashë se është e nevojshme të ndërmerret një veprim, dhe ka një lloj veprimi që besoj se do të ketë rezultat.

— Zonjushe Brekën! — Nga fundi i sallës u ngrit një grua e re, shtatgjatë. Ishte Juanita Nunjezi, të cilën Margoti e kishte përshëndetir përzemërsisht kur hyri në studio.

— Urdhëroni, zonja Nunjez.

— Edhe unë dua të ndihmoj, por ju e dini se punoj në FMA. Ndoshta nuk duhet të dëgjoj atë që do të thoni tani...

— Ç'është e vërteta, — tha Margoti, duke vlerësuar qëndrimin plot delikatesë të Juanitës. — duhet ta kisha menduar më parë dhe të mos ju kisha lënë ta ndjenit veten keq.

U dëgjuha një murmuritje e përgjithshme mirëkuptimi.

— Ajo që dëgjuat gjer tani, — tha Dikën Jufrejtsi, — është sekrete, apo jo?

Ndërsa Juanita u përgjigj me një lëvizje të kokës, Margoti u nxitua të vërente:

— Të gjithë ne mund të kemi besim te zonja Nunjez. Do të doja që punëdhënësit e saj të kishin të njëjtën sjellje korrekte si ajo.

Sapo doli Juanita Nunjezi, Margoti iu drejtua anëtarëve të tjerë të komisionit. Kishte marrë qëndrimin e saj karakteristik: Duart të mbështetura te beli i hollë, me bërrylat në mënyrë agresive anash. Gjashtë pas marë, kishte hedhur mbrapa flokët e gjatë ngjyrë gështenjë. Ky ishte një gjest i saj i zakonshëm, para se të vepronte, si ngritja e perdes në një shfaqje. Ndërsa vazhdonte të fliste, interesimi i të pranishmeve rritej. Në një pikë të bisedës së saj, Seth Orinda filloi të qeshë me zë të lartë. Aty nga fundi, fytyrat e Dikën Jufrejtsit dhe të tjerëve ishin çelur tërë gaz.
— Oh, sa mirë! — thirri Dikëni.
— Kjo është një ide me të vërtetë e mençur, — shtoi dikush tjetër.
Margoti u vërejti:
— Për të vënë në zbatim planin tonë, kemi nevojë për një numër të madh njerëzish: Në fillim, së paku nja një mijë veta dhe, pastaj, edhe të tjerë.
— Për sa kohë? — pyeti një zë që, gjer në atë çast, s'ishte dëgjuar akoma.
— Le të themi, për një javë. Një javë bankare, domethënë pesë ditë. Në rast se, prapëseprapë, kjo nuk do të mjaftojë, do të na duhet ta zgjasim kohën e veprimeve tona edhe më shumë. Por, nuk besoj që kjo të jetë e nevojshme. Edhe një gjë: të gjithë ata që do të marrin pjesë, duhet të udhëzohen mirë se si të veprojnë.
— Në këtë punë, mund të ndihmoj edhe unë, — tha Seth Orinda.
Fjala e Orindës u pasua nga një kor zërash: «Edhe unë! Edhe unë!»

Zëri i Dikën Jufrejtsit u ngrit mbi të tjerët:
— Unë kam për të marrë edhe disa pushime të prapambetura. Për nder, po e marr tani një javë dhe, po qe nevoja, marr dhe ditë të tjera.
— Shumë mirë! — tha Margoti dhe, me ton të vendosur, vazhdoi: — Na duhet një plan i përgjithshëm. Deri nesër, do ta kem gati. Ju të tjerët, duhet të filloni menjëherë rekrutimin e njerëzve. Dhe, mos harroni, konspiracioni është një gjë e rëndësishme.
Mbas një gjysmë ore, mbledhja u mbyll. Anëtarët e komisionit ishin tani shumë më të gëzuar dhe optimistë, se sa kishin qenë kur u mblodhën.
Margoti i kërkoi Seth Orindës të qëndronte një çast. Kur të tjerët ishin dalë, ajo i tha:
— Seth, kam veçanërisht nevojë për ndihmën tënde.
— Zonjushe Brekën, ju e dini mirë se unë do t'ju jap tërë ndihmën që mundem.
— Kur fillohet një veprim, unë qëndroj zakonisht në vijën e parë. Ti e di këtë, apo jo?
— Sigurisht, e di. — Mësuesit të shkollës së mesme i shndriste fytyra.
— Mirëpo, kësaj radhe, dua të rri mënjanë dhe të mos dal në skenë. Dhe, veç kësaj, nuk dua të dalë emri im kur të ndërhyjnë shtypi, radioja dhe televizioni. Kjo mund t'u shkaktonte ndonjë vështirësi të miqve të mi të ngushtë: atyre të bankës që përmenda pak më parë. Dëshiroj, pikërisht, t'i shmangem një gjëje të tillë.
Orinda, me pamje serioze, tundi kokën.
— E qartë. Nuk shoh ndonjë vështirësi.
— Ajo që kërkoj, në fakt, — në fakt, — vazhdoi Margoti, — është që ti dhe të tjerët të qëndroni në vijën e parë, në vendin tim. Natyrisht, unë do të jem në prapaskenë. Dhe, në rast

nevoje, mund të më thërrisni, ndonëse shpresoj se nuk do të jetë e nevojshme.
— Kjo është për të qeshur, — tha Seth Orinda. — Si mund t'ju thërrasim, kur asnjëri nga ne s'e ka dëgjuar kurrë emrin tuaj?!

Të shtunën mbrëma, dy ditë pas mbledhjes së komisionit ekzekutiv të Shoqatës së banorëve të Rajonit Lindor, Margoti dhe Aleksi ishin ftuar në një darkë të vogël të disa miq të tyre dhe, pastaj, shkuan së bashku në apartamentin e Margotit. Ky ishte më i vogël se banesa elegante e Aleksit dhe gjendej në një pjesë të qytetit më pak të modës; mirëpo Margoti e kishte rregulluar hijshëm, me mobilie të blera pjesë-pjesë, gjatë disa vjetëve, me çmime të arsyeshme. Dhe Aleksit i pëlqente shumë të rrinte atje.
Apartamenti ishte në kontrast të madh me studion e saj.
— E kam ndier shumë mungesën tënde, — tha mbas pak Aleksi. Ai kishte veshur pizhamat dhe një robdëshambrër, të cilat i mbante atje, në apartamentin e saj, dhe ishte ulur në një kolltuk të stilit kuin en[1]). Margoti, e ulur në një sixhade, te këmbët e tij, ia kishte mbështetur kokën te gjunjët, ndërsa ai ia përkëdhelte me ëmbëlsi flokët e gjatë. Herë pas here, gishtat e tij kalonin gjetiu, me shkathtësi e lehtë-lehtë, dhe kështu fillonte ta nxiste, siç ndodhte gjithmonë dhe siç i pëlqente asaj. Margoti lëshoi një psherëtimë kënaqësie. Megjithatë, ndërsa dëshira e dyanshme rritej, kjo vonesë që ia impononinvetes ishte një kënaqësi e veçantë. Kishte kaluar një javë e gjysmë që ata s'ishin parë për shkak të angazhimeve përkatëse të punës së tyre.

— Do ta rifitojmë kohën e humbur, — vërejti Margoti.
Aleksi heshti për disa çaste dhe, pastaj, tha:

— E di, si është puna? Tërë këtë mbrëmje kam pritur të më pjekësh të gjallë për shkak të Rajonit Lindor, kurse ti s'e ke zënë fare me gojë.

Margoti e përkuli edhe më shumë kokën mbrapa, duke e shikuar atë nga poshtë lart, dhe, pastaj, e pyeti qetë-qetë:

— Pse, i dashur, duhet të të pjek të gjallë? Pakësimi i fondeve nuk ka qenë mendimi yt. — Rrudhi ballin dhe shtoi: — Apo ishte mendimi yt?

— Ti e di shumë mirë se s'ishte imi.

— Sigurisht që e di. Sikurse e di edhe se e ke kundërshtuar.

— Po, e kundërshtova, — shtoi ai me keqardhje. — Ama punë bëri dhe kundërshtimi im!

— Ti bëre aq sa mund të bëje. Më shumë se kaq s'mund të kërkohet.

Aleksi ia nguli sytë me dyshim.

— I gjithë ky qëndrim, kjo mënyrë veprimi nuk të përshtatet ty.

— Nuk më përshtatet? Në ç'mënyrë?

— Ti je luftarake. Kjo është një nga arsyet për të cilat të dashuroj. Ti s'e jep veten kurrë për të mundur. Nuk e pranon qetësisht disfatën.

— Ndoshta disa disfata janë përfundimtare. Në këtë rast, s'ke ç'bën fare.

Aleksi drejtoi trupin.

— Se ç'po kurdis, Margot! Unë e kuptoj. Tani, më thuaj si është puna.

Margoti u mendua pak dhe, pastaj, tha:

— Le ta zëmë se ke të drejtë... Shiko, unë s'po pranoj asgjë... por, edhe duke menduar se ke të drejtë, mund të ketë

gjëra që është më mirë të mos i dish. Një gjë që nuk do të doja të të bëj kurrë, Aleks, është të të vë në një gjendje të vështirë.

Aleksi i drejtoi një buzëqeshje të ëmbël.

— Sidoqoftë, diçka ma the! Në rregull, po qe se nuk do, nuk po të pyes më. Vetëm një gjë dua të di: nëse ajo që ke ndërmend të bësh është e ligjshme.

Në çast, fytyra e Margotit u skuq flakë:

— Këtu, avokat jam unë! E vendos unë se çfarë është e ligjshme dhe çfarë nuk është!

— Edhe një avokate e zonja mund të gabojë.

— Jo kësaj radhe. — U duk sikur deshi të vazhdonte me të njëjtin ton, por, pastaj, u qetësua dhe zëri i saj u zbut. — Ti e di mirë se unë gjithnjë veproj brenda ligjit; dhe, ti e di edhe se pse.

— Po, e di, — tha Aleksi. Duke u lëshuar veten përsëri lirisht në kolltuk, ai filloi t'i përkëdhelte përsëri flokët.

Një ditë, pasi ishin njohur mirë, Margoti i kishte treguar se ky parim ishte formuar në mendjen e saj para shumë vitesh, mbas një tragjedie dhe një humbjeje personale.

Në fakultetin e drejtësisë, ku Margoti ishte një studente shembullore, ajo kishte përqafuar, si shumë shokë të tjerë, aktivizmin dhe protestën e drejtpërdrejtë. Ishte koha e angazhimit gjithnjë e më të madh amerikan në Vietnam dhe e përçarjeve të thella në tërë kombin. Ishte gjithashtu periudha, në të cilën po filloheshin të ndiheshin shqetësime dhe të dalloheshin ndryshime në profesionin e juristit; çasti i rebelimit të të rinjve kundër strukturave të vjetra të ligjit; koha e një tipi të ri avokatësh luftarakë, nga të cilët Relf Nederi ishte simboli i pranuar dhe i respektuar.

Më parë në shkollë të mesme dhe, më vonë, në fakultetin e drejtësisë, ajo kishte pasur të përbashkëta pikëpamjet e saj të

pararojës, aktivizmin si dhe veten e saj, me një student të quajtur Gregori — Aleksit s'ia kishte treguar mbiemrin. — Siç ndodhte zakonisht, Gregori dhe Margoti bashkëjetonin.

Muaj me radhë kishte pasur grindje të ashpra ndërmjet studentëve dhe drejtorisë dhe, një nga më të këqijat, kishte ndodhur pas mbërritjes zyrtare të një grupi për të rekrutuar studentë për në ushtri dhe marinë. Shumica e studentëve, duke përfshirë Gregorin dhe Margotin, kërkonin që rekrutuesit të largoheshin. Autoritetet e shkollës kishin refuzuar në mënyrë kategorike.

Në shenjë proteste, studentët militantë kishin zënë ndërtesën e drejtorisë, duke ngritur një barrikadë. Gregori dhe Margoti, të rrembyer nga vala e përgjithshme, kishin marrë pjesë edhe në këtë aksion.

Bisedimet ishin ndërprerë, pa filluar akoma mirë, sidomos sepse studentët kishin paraqitur «kërkesa të papranueshme». Mbas dy ditësh, drejtoria kishte thirrur policinë shtetërore, të cilën e kishte përforcuar pastaj Garda Kombëtare. Ndërtesa e drejtorisë, e cila në fillim kishte qenë rrethuar, ishte marrë pastaj me sulm. Forcat e rendit kishin hapur disa herë zjarr dhe, gjatë përleshjes, kishin thyer ndonjë kokë. Për çudi, të shtënat s'kishin plagosur njeri; por, për fat të keq, njëri nga studentët e dëmtuar në kokë — Gregori — kishte pasur hemoragji cerebrale dhe, pas disa orëve, kishte vdekur.

Në fund, për shkak të indinjatës publike, ishte thirrur para gjyqit polici që kishte dhënë goditjen vdekjeprurëse. Ky ishte një djalë i ri, pa përvojë dhe shumë i frikësuar, të cilin e kishin nxjerrë të pafajshëm.

Margoti, ndonëse e pushtuar nga dhimbja dhe shumë e tronditur, kishte qenë aq objektive sa të kuptonte se vendimi i gjyqit ishte i drejtë. Më vonë, mbasi ishte qetësuar, formimi i

saj juridik e kishte ndihmuar për të vlerësuar dhe sistemuar bindjet e veta.

Asnjëra nga pikëpamjet e saj politike dhe shoqërore nuk ishte dobësuar, as në atë kohë dhe as më vonë. Por ajo kishte pranuar ndershmërisht se studentët u kishin mohuar të tjerëve ato liri, mbrojtës të të cilave e shpallnin veten. Veç kësaj, në zellin e tyre, ata kishin shkelur ligjin, ose sistemin të cilit u kushtoheshin studimet e tyre dhe që duhej t'i kushtohej dhe vetë jeta e tyre.

Edhe një hap tjetër ishte dashur për ta bindur Margotin se, duke qëndruar brenda kufirit të ligjit, do të mund të arriheshin përfundime që, sigurisht, nuk do të ishin më të vogla, por ndoshta edhe më të mëdha.

Siç i kishte thënë Aleksit të parën dhe të vetmen herë që kishin folur për këtë periudhë të kaluar të jetës së saj, ky kishte qenë parimi që e kishte udhëhequr gjithmonë, që nga ajo kohë, në aktivizmin e saj.

Duke qenë gjithnjë e mbështetur te gjunjët e Aleksit, Margoti e pyeti:
— Si shkojnë punët, në bankë?
— Ka ditë që më duket vetja si Sisifi. A të kujtohet?
— Mos është ai, në mitologjinë greke, që ishte dënuar të shtynte lart, gjer në majë të një mali, një shkëmb, që, kur arrinte pranë tij, rrokullisej përsëri poshtë?
— Pikërisht, ai. Duhej të ishte bërë drejtues në një bankë dhe të ishte përpjekur të bënte ndryshime. A do të të them diçka për me bankierët, Margot?

— Pa, ma thuaj.
— Ne kemi sukses, megjithëse na mungon largpamësia dhe imagjinata.
— A mund ta citoj këtë thënie nga ti?
— Po ta bësh këtë, unë do të betohem se s'e kam thënë kurrë.
— Ai u mendua një çast. — Ndërkaq, po e themi dhe të mbetet këtu, bankat zihen gjithnjë në befasi nga ndryshimet

shoqërore; ato nuk u dalin atyre kurrë përpara. Të gjitha problemet që na preokupojnë sot: mjedisi, ekologjia, energjia, pakicat kombëtare ka kohë që ekzistojnë dhe mund të parashikoheshin shumë mirë. Ne, bankierët, mund të ishim në pararojë dhe, përkundrazi, tërhiqemi mbrapa dhe lëvizim përpara vetëm kur jemi të detyruar ta bëjmë këtë, kur na detyrojnë ngjarjet.
— Atëherë, pse vazhdoni punën e bankierit?
— Sepse është një punë e rëndësishme. Pavarësisht nëse hidhemi vullnetarisht apo jo në vijën e parë, puna jonë profesionale është e dobishme dhe e nevojshme. Sistemi monetar është bërë aq i madh, i ndërlikuar dhe i sofistikuar, saqë vetëm bankat mund ta drejtojnë.
— Prandaj, ajo për të cilën kemi më shumë nevojë është t'ju jepet, kohë mbase kohe, një shtytje. Kështu, apo jo?

Aleksi e vështroi dhe një herë me vëmendje, duke iu ngjallur përsëri kureshtja.
— Se ç'po kurdis në atë mendjen tënde ngatërrestare.
— S'pranoj asgjë.
— Çfarëdo që të jetë, shpresoj se s'do të futen përsëri në valle WC-të.
— O zot, jo!

Ata qeshën të dy, kur ra fjala për atë ngjarje që kishte ndodhur para një viti. Ishte fjala për një nga fitoret e Margotit, që kishte tërhequr shumë vëmendjen mbi të.

Kësaj radhe, ajo i kishte shpallur luftë aeroportit lokal, i cili u paguante qindra rojtarëve, kujdestarëve dhe shërbyesve paga më të ulëta nga ato të zakonshmet. Sindikata ishte korruptuar nga drejtoria e aeroportit dhe, prandaj, s'kishte lëvizur as gishtin e vogël. Të dëshpëruar, një grup punonjësish të aeroportit kishin shkuar atëherë te Margoti, e cila po merrte famë me ndërhyrjet e saj në çështje të këtilla.

Margoti ishte interesuar drejtpërdrejtësi në drejtorinë e aeroportit, por përfundimi kishte qenë vetëm një mospranim i

prerë. Prandaj, ajo kishte arritur në përfundimin se duhej tërhequr vëmendja publike dhe se, e vetmja mënyrë për t'ia arritur qëllimit ishte të bëhej qesharak aeroporti dhe ata që e drejtonin. Për të siguruar të dhëna dhe duke shfrytëzuar bashkëpunimin e shumë simpatizuesve të tjerë që e kishin ndihmuar në raste të mëparshme, ajo kishte organizuar një rrjet informatorësh përbrenda aeroportit të madh, duke zgjedhur një mbrëmje me trafik të dendur.

Një gjë që kishte rëndësi, gjatë studimit të gjithanshëm të çështjeve që kishin të bënin me aeroportin, ishte se kur zbrisnin pasagjerët nga fluturimet e mbrëmjes, gjatë të cilave udhëtarëve u shërbeheshin ushqime dhe pije, ata drejtoheshin me shumicë për te WC-të dhe, për orë të tëra, në këto të fundit kishte vazhdimisht njerëz.

Mbrëmjen e së premtes tjetër, domethënë në kohën e trafikut më të dendur të nisjeve dhe mbërritjeve të avionëve, disa qindra vullnetarë, kryesisht punonjës të aeroportit që nuk ishin në shërbim, kishin shkuar në aeroport, sipas udhëzimeve të Margotit. Nga ky çast dhe deri sa u larguan, ata u sollën të qetë, të rregullt dhe s'bënë asgjë në kundërshtim me ligjet.

Misioni i tyre ishte që t'i mbanin të zëna për tërë mbrëmjen të gjitha WC-të publike të aeroportit. Dhe kështu ishte bërë. Margoti dhe ndihmësit e saj kishin përgatitur një plan të hollësishëm dhe, pa shkelur aspak as ligjet e as rregullat, vullnetarisht shkonin secili me qetësi, njëri pas tjetrit, në vendin e caktuar; paguanin dhjetë centët dhe futeshin në WC, duke e vrarë kohën me lexime, radio dore dhe, bile, edhe me ushqime, që disa kishin sjellë me vete. Disa nga gratë kishin marrë me vete ndonjë gjë për të qepur ose për të thurur. Me një fjalë, ky ishte kulmi i një bllokimi të ligjshëm.

Përpara vendeve për të urinuar, në WC-të e burrave, vullnetarë të tjerë kishin formuar radhë të gjata, që ecnin përpara me një ngadalësi të jashtëzakonshme. Në rast se

ndonjë pasagjer hynte në radhë, i duhej një orë për të mbërritur në krye. Pak ishin ata që prisnin aq shumë.

Një grup tjetër i vogël vullnetarësh lëvizte sa andej-këtej, për të shpjeguar se ç'po ndodhte dhe përse.

I tërë aeroporti ishte në rrëmujë, me qindra pasagjerë të zemëruar dhe si në gjëmba, u bënin protesta të ashpra nëpunësve të vijave ajrore përkatëse, të cilët, nga ana e tyre, i drejtoheshin drejtorisë së aeroportit. Kjo e fundit e shihte veten të pafuqishme për të bërë gjë. Ndërkaq, vrojtues të tjerë, jo të interesuar drejtpërsëdrejti dhe pa pasur nevoja të ngutshme, zbaviteshin me pamjen humoristike të gjendjes. Askush nuk ishte indiferent.

Përfaqësuesit e shtypit, të paralajmëruar fshehurazi nga Margoti, kishin ardhur në numër të madh. Reporterët ishin në garë me njëri-tjetrin për të shkruar artikuj, të cilët ishin përhapur me telefon e telegraf në të gjithë territorin kombëtar, pastaj, edhe jashtë shtetit, dhe ishin shfrytëzuar nga gazeta me tendenca të ndryshme, si «Izvestia», «Star» e Johanesburgut dhe «Dhë Tajms» e Londrës. Si përfundim i kësaj, të nesërmen, e tërë bota po qeshte.

Pothuajse të gjithë artikujt përmendnin emrin e Margotit, duke thënë për të fjalë të mira. Disa pohonin se mund të kishte edhe bllokime të tjera të kësaj natyre.

Siç e kishte parashikuar Margoti, të bërit qesharak është një nga armët më të fuqishme që ekzistojnë. Nga fundi i javës, drejtoria e aeroportit kishte deklaruar se do ta merrte në shqyrtim çështjen e pagave dhe, pas një kohe të shkurtër, shtesa ishte dhënë. Veç kësaj, sindikata e korruptuar ishte shkarkuar dhe zëvendësuar me një tjetër më të ndershme.

Margoti lëvizi nga vendi, duke iu afruar edhe më pranë Aleksit.

— Çfarë lloj mendjeje the ti se kisha unë?

— Mendje ngatërrestare.

— Është gjë e mirë, apo e keqe?
— Për mua është e mirë. Më ringjall. Dhe, në më të shumtën e rasteve, çështjet për të cilat ti lufton, më pëlqejnë.
— Në më të shumtën e rasteve? Jo gjithmonë?
— Jo, jo gjithmonë.
— Nganjëherë, gjërat që bëj ngjallin antagonizma. Zëre se një nga këto antagonizma të ketë të bëjë me diçka që ti nuk e beson, ose që nuk të pëlqen. Zëre se emrat tanë janë të bashkuar në një periudhë si kjo, kur ty nuk do të të pëlqente të ndodhte ashtu.
— Do të mësoja të mos më bënte përshtypje. Veç kësaj, kam të drejtë të kem jetën time private, ashtu sikurse dhe ti.
— Ashtu si edhe çdo grua, — shtoi Margoti. — Por, nganjëherë, pyes veten nëse me të vërtetë do të mund të mësohesh të mos të bëjë përshtypje. Dua të them, në qoftë se do të ishim bashkë tërë kohën. Ti e ke të qartë se unë nuk do të ndryshoja, apo jo? Këtë duhet ta kesh të qartë, i dashur. Unë nuk mund të heq dorë kurrë nga pavarësia ime, as që të jem ajo që jam, as që të ndërmarr nisma të ndryshme.

Atij i shkoi mendja te Silia, e cila s'kishte ndërmarrë kurrë nisma dhe, sa shumë kishte dëshiruar ai që ajo ta bënte këtë. Dhe iu kujtua, si gjithmonë me pikëllim, se si ishte katandisur ajo. Megjithatë, prej saj kishte mësuar një gjë. Burri ecën drejt përsosmërisë, në rast se gruaja që ai dashuron është e lirë dhe e përdor këtë liri për të ecur, nga ana e saj gjithashtu, po në këtë rrugë.

Aleksi uli duart te shpatullat e Margotit. Nëpërmes këmishës së natës të hollë, prej mëndafshi, ai ndjente nxehtësinë e ëmbël dhe butësinë e trupit të saj. I tha me ngrohtësi:

— Të dashuroj dhe të dua kështu si je. Në qoftë se do të ndryshoje, do të paguaja një avokate tjetër dhe do të të hidhja në gjyq për prishje të dashurisë.

Pamja ishte aq e pazakonshme, sa që njëri nga funksionarët e degës së bankës, Klif Kesëlmeni, u drejtua për te platforma.

— Zonja D'Orsej, a keni shikuar rastësisht nga dritarja sot?

— Jo, — u përgjigj Eduina. Po shikoja postën e mëngjesit. Pse?

Ishte ora 8.55, ditë e mërkurë, në degën kryesore të Fërst Merkëntajll Ëmerikën Benkut.

— Ç'të them, besoj se do t'ju interesojë, — tha Kesëlmeni. — Jashtë ka një radhë të tillë që s'e kam parë asnjëherë tjetër para orarit të hapjes.

Eduina ngriti sytë. Disa nëpunës po zgjasnin kokën te dritaret për të parë se ç'dodhte në rrugë. Në tërë degën e bankës dëgjohej një gumëzhitje e përgjithshme bisedash, gjë që zakonisht nuk ndodhte aq herët në mëngjes. Të gjitha këto i krijuan asaj përshtypjen e një gjendjeje alarmi.

U ngrit dhe hodhi disa hapa drejt njërës nga dritaret e mëdha të fasadës, që shihnin nga rruga. Ajo që pa, e shtangu në vend. Një radhë e gjatë njerëzish, me nga katër a pesë veta krahas, zgjatej nga porta kryesore e degës së bankës, gjatë gjithë gjatësisë së ndërtesës dhe zhdukej pastaj, mbas qoshes së saj. Dukej sikur të gjithë po prisnin të hapej banka.

Eduina vështronte, e habitur dhe pa u besuar syve të saj.

— Por, ç'djall ...?

— Dikush doli jashtë pak më parë, — i tha Kesëlmeni. — Thuhet se radha shkon gjer në mes të sheshit «Roseli» dhe se vazhdojnë të vijnë akoma njerëz.

— Ka pyetur ndokush se ç'duan?

— Po. Më duket se kishte pyetur njëri nga rojat e sigurimit. I ishin përgjigjur se kishin ardhur për të hapur një llogari.

— Kjo është qesharake! Tërë këta njerëz? Duhet të jenë nja treqind veta, me ç'shoh unë që këtu. S'kemi hapur kurrë kaq llogari të reja brenda një dite.

Kesëlmeni mblodhi supet.

— Unë po ju tregoj ato që më thanë.

Te dritarja, u bashkua me ta edhe Totenhoi, me fytyrën e tij gjithnjë të zymtë.

— I telefonova qendrës së sigurimit, — i tha ai Eduinës. — Më thanë se do të dërgojnë roja të tjera dhe, ndërkaq, po vjen dhe zoti Uejnrajt.

Eduina vërejti:

— Jashtë s'ka asnjë shenjë turbullire. Të gjithë duken të qetë.

Me sa mund të shihej, dy të tretat e pjesëmarrësve të radhës ishin gra dhe shumica ishin zezakë. Shumë nga gratë kishin marrë me vete edhe fëmijët e tyre. Disa nga burrat ishin të veshur me tuta, tamam sikur të kishin ardhur aty drejt e nga puna, ose të ishin duke shkuar atje. Sidoqoftë rroba të zakonshme; vetëm pak ishin të veshur mirë.

Në radhë, njerëzit bisedonin me njëri-tjetrin; disa prej tyre me gjallëri, por pa qëndrim armiqësor. Të tjerë, duke parë se po i vërenin, u buzëqeshnin dhe u bënin shenja me kokë nëpunësve të bankës.

— Shikoni atje! — thirri Klif Kesëlmeni, duke treguar me dorë. Po vinte një grup i televizionit, me telekamera. Ndërsa Eduina dhe të tjerët vështronin, ata filluan të filmonin. – Të qetë a jo, – tha Kesëlmeni, – duhet të ketë, patjetër, një arsye që i shtyn tërë këta njerëz të vijnë këtu sëbashku.
Befas, një mendim i erdhi Eduinës:

– Vijnë nga Rajoni Lindor, – tha ajo. – E vë me bast se prej andej vijnë.
Ndërkaq, edhe nëpunës dhe funksionarë të tjerë, tryezat e punës të cilëve gjendeshin aty pranë, ishin afruar te dritarja dhe po dëgjonin.
Totenhoi tha:
– Duhet ta vonojmë hapjen e bankës, deri sa të kenë mbërritur rojat e tjera.
Sytë e të gjithëve u kthyen nga sahati i murit, që ishte nëntë pa një minutë.
– Jo, – tha Eduina. Pastaj, ngriti zërin që të mund ta dëgjonin të gjithë – Do t'i hapim dyert në orar, si zakonisht. Dhe tani, ju lutem, të gjithë në punë!
Totenhoi u largua me nxitim, ndërsa Eduina u kthye përsëri te platforma, në tryezën e saj të punës.
Nga vendi i saj, Eduina e shihte portën kryesore. Dy kanatet e mëdha u hapën dhe lumi i njerëzve u derdh brenda. Ata që ishin në krye të radhës, u ndalën pak te pragu, shikuan rreth e rrotull me pamje të vendosur dhe, pastaj, shkuan me të shpejtë përpara, të shtyrë nga të tjerët që vinin pas tyre. Në pak çaste, e tërë hapësira e caktuar për publikun u mbush me një turmë që gumëzhinte plot zhurmë. Dega e bankës, e cila, më pak se një minutë më parë, ishte relativisht e qetë, u kthye në një Babel[1]). Eduina pa një zezak të gjatë e të shëndoshë që tundte në dorë një tufë bankënotash njëdollarëshe, duke thënë me zërin e tij të trashë:
– Dua t'i vë paratë e mia në këtë bankë.
Një rojë i tha:
– Nga kjo anë, për llogaritë e reja.
Roja i tregoi vendin ku të shkonte, në të cilin ishte në pritje një nëpunëse e re, me pamje të frikësuar. Zezaku u drejtua tek ajo me një buzëqeshje qetësuese dhe u ul në karrigen para

tryezës së punës. Prapa tij u formua menjëherë një varg i parregullt njerëzish, që prisnin t'u vinte radha.
Me sa dukej, lajmi, sipas të cilit të gjithë ata njerëz kishin ardhur për të hapur një llogari, kishte qenë i saktë.
Eduina e pa burrin trupmadh të mbështetej qetë-qetë te shpindorja e karriges, duke mbajtur gjithnjë në dorë kartëmonedhat. Zëri i tij ngrihej mbi zhurmën e bisedave dhe ajo e dëgjoi të thoshte:
– Nuk nxitohem, dua më parë të më shpjegoni disa gjëra.
Dy nëpunës të tjerë zunë vend me të shpejtë në dy tryeza të tjera pune, aty pranë. Po aq shpejt, dy radhë të tjera të gjata e të gjera u formuan para tyre.
Zakonisht, tre nëpunës ishin më se të mjaftueshëm për hapjen e llogarive të reja; por, në një rast të tillë, dukej se ishin krejtësisht të pamjaftueshëm. Eduina e pa Totenhonë në skajin tjetër të bankës dhe e thirri me telefonin e brendshëm.
– Vendosni tryeza të tjera pune për hapjen e llogarive të reja dhe sillni në to për të punuar tërë personelin që s'është i domosdoshëm gjetiu.
Për shkak të zhurmës së madhe, fjalët mezi dëgjoheshin, edhe duke e mbështetur fort receptorin te veshi.
Totenhoi u përgjigj:
– E keni të qartë se nuk mund të mbarojmë punë me të gjithë këta njerëz sot dhe, sido që të jetë, nuk do të jemi në gjendje të kryejmë punën normale.
– Ma merr mendja, – tha Eduina, – se ky është pikërisht qëllimi i tyre. Sidoqoftë, mundohu t'i shpejtosh veprimet sa më shumë që të jetë e mundur.
Megjithatë, edhe vetë ajo e dinte se për të hapur një llogari të re duheshin së paku jo më pak se dhjetë deri në pesëmbëdhjetë minuta, sado me nxitim që të bëheshin veprimet. Kjo kohë ishte e nevojshme për të plotësuar

shkresurinat e rastit.
Së pari, duhej mbushur formulari i kërkesës, me të gjitha hollësitë, lidhur me vendbanimin, punën, sigurimet shoqërore, familjen. Pastaj, merrej një model i nënshkrimit. Pas kësaj, duhej verifikuar identiteti i kërkuesit. Mbasi të kryheshin këto veprime, nëpunësi ia shpinte dokumentet, për miratim, një funksionari të bankës, i cili, pasi i shqyrtonte, i siglonte. Më në fund, mbushej një librezë kursimi, ose lëshohej një bllok i përkohshëm çeqesh, sipas rastit.
Për rrjedhojë, asnjë nëpunës nuk mund të hapte më shumë se pesë llogari të reja në orë; kështu që, në rastin konkret, të tre nëpunësit do të arrinin në një numër total prej nëntëdhjetë llogarish të reja gjer në mbarim të ditës së punës, duke menduar se ata do të vazhdonin të punonin pa ndërprerje dhe me shpejtësinë maksimale, gjë që s'mund të bëhej. Edhe po të trefishohej numri i nëpunësve, do të arrihej në dyqind e pesëdhjetë llogari të reja, ose diçka më shumë. Mirëpo, vetëm në ato pak minuta që kishin kaluar që kur kishte filluar puna, në bankë ishin futur së paku katërqind veta, ndërsa të tjerë shtyheshin jashtë, për të hyrë dhe, radha jashtë – Eduina u ngrit në këmbë për t'i hedhur një sy – dukej po aq e gjatë sa ç'kishte qenë më parë.

Edhe zhurma brenda bankës shtohej. Tani kishte arritur kulmin.

Një problem tjetër ishte se masa gjithnjë e më e madhe e njerëzve, në hapësirën e caktuar për publikun, i pengonte klientët e zakonshëm të bankës të shkonin në sportelet e arkëtarëve. Eduina pa disa nga ata jashtë bankës, që vështronin këtë skenë të çuditshme, si të shastisur. Pjesa më e madhe e tyre hiqnin dorë dhe largoheshin.

Brenda bankës, disa nga të porsaardhurit i mbanin arkëtarët me muhabet dhe, këta të fundit, meqë s'kishin punë

për shkak të grumbullimit të madh të njerëzve, bisedonin me ta gjithashtu.

Ndërkaq, dy funksionarë po mundoheshin të rregullonin grumbullin e njerëzve, për të lënë njëfarë hapësire të lirë pranë sporteleve, por nuk po kishin shumë sukses.

Sidoqoftë, gjer në atë çast s'ishte parë asnjë shenjë armiqësie. Të gjitha ato, të cilave funksionarët u thoshin ndonjë gjë, përgjigjeshin me edukatë dhe duke buzëqeshur. Dukej, mendoi Eduina, se kishin marrë udhëzime të silleshin sa më mirë.

Mendoi se tanimë ishte koha që ajo të ndërhynte vetë.

Zbriti nga platforma dhe përshkoi me njëfarë vështirësie turmën, gjer te porta e hyrjes kryesore. Të dy rojave, që kishin ardhur pranë saj, duke e hapur rrugën me bërryla, u tha:

– Këtu s'ka më vend. I mbani të tjerët jashtë dhe i fusni ndërsa dalin ata që kanë hyrë më parë. Natyrisht, klientët e zakonshëm do t'i lini të futen sapo të vijnë.

Më i moshuari i të dy rojave e afroi kokën pranë asaj të Eduinës që ajo të mund ta dëgjonte.

– Nuk do të jetë punë e lehtë, zonja D'Orsej. Ndonjë klient edhe mund ta njohim, por shumicën jo. Në bankë vijnë shumë klientë dhe s'mund t'i njohësh të gjithë.

– Edhe një gjë tjetër, – shtoi roja tjetër, – kur vjen dikush, ata jashtë thërrasin: «në radhë!» Në rast se bëjmë favorizime, mund të shkaktohen trazira.

– Nuk do të ndodhin trazira, – e siguroi Eduina. – Përpiquni të veproni sa më mirë.

Pasi u kthye, ajo iu drejtua personave që po prisnin në radhë. Iu desh të ngrinte zërin, sepse zhurma e vazhdueshme nuk e linte të dëgjohej zëri i saj.

– Jam drejtoresha e degës së bankës. A ka mundësi që njëri nga ju të më thotë se pse keni ardhur sot të gjithë këtu?

– Për të hapur një llogari, – u përgjigj një grua me një fëmijë për dore. Buzëqeshi me djallëzi dhe shtoi: – S'ka asgjë të keqe, apo jo?

– Dhe ju, – ndërhyri një zë tjetër, – keni nxjerrë në qarkullim ato njoftimet që thonë se, kushdo mund të hapë një llogari, pavarësisht sa e vogël është shuma fillestare që depozitohet.

– Është e vërtetë, – pohoi Eduina, – dhe, sigurisht, banka nuk do ta shkelë fjalën e saj. Por, duhet të ketë një arsye, meqë keni ardhur të gjithë bashkë.

– Puna është, – ndërhyri një burrë i moshuar, me fytyrë të thatë si të një kufome, – se të gjithë jemi nga Rajoni Lindor.

– Ose, se duam të shkojmë atje, – shtoi një zë më i ri.

Eduina shtoi:

– Nuk arrij akoma të ...

– Ndoshta mund t'jua shpjegoj unë, zonjë; – tha një zezak, në moshë të pjekur, me pamje serioze, që hapi rrugën përmes turmës.

– Ju lutem.

Në të njëjtin çast, Eduina pati përshtypjen se dikush i ishte afruar. U kthye dhe pa se ishte Nolan Uejnrajti. Veç kësaj, para hyrjes së bankës kishin ardhur edhe roja të tjera, në ndihmë të dy të mëparshmëve. Eduina i hodhi një vështrim drejtorit të shërbimit të sigurimit, i cili murmuri:

— Vazhdoni. Çdo gjë është në rregull.
Personi, që ishte afruar, tha:
— Mirëmëngjes, zonjë. Nuk e dija se kishte drejtues të seksit femëror.
— Sigurisht që ka, — ia priti Eduina, — dhe, me kohë, numri

i tyre do të rritet. Shpresoj se besoni në barazinë e të drejtave të grave, zoti ...?
— Orinda, zonjë. Seth Orinda. Dhe, pa dyshim, besoj në atë, sikurse dhe shumë gjëra të tjera.
— Dhe është një nga këto gjërat e tjera që ju bëri sot të vinit këtu të gjithë?
— Në njëfarë mënyre, mund të thuhet se po.
— Në çfarë mënyre, tamam?
— Besoj se e dini që jemi nga Rajoni Lindor.
— Sapo ma thanë.
— Ajo që po bëjmë, mund të përkufizohet si një akt shprese.
— Orinda fliste rrjedhshëm dhe me fjalë të zgjedhura. Ai i kishte provuar shumë herë ato që po thoshte. Ndërkaq, të tjerët kishin heshtur dhe po dëgjonin. — Me sa thuhet, kjo bankë nuk ka para në sasi të mjaftueshme për të financuar më tej punimet në Rajonin Lindor. Sido që të jetë puna, fakti është se i ka pakësuar fondet përgjysmë, kështu që disa nga ne kanë menduar se, shumë shpejt, edhe kjo gjysmë do të hiqet, veçse po u morën masa prej nesh.
Eduina ia priti me ton të prerë:
— Dhe të marrësh masa do të thotë ta bllokosh veprimtarinë normale të bankës?! — Ndërsa po fliste, ajo vuri re në mes të turmës disa fytyra të reja personash që shkruanin me shpejtësi në blloqet e tyre të shënimeve. E kuptoi se kishin ardhur edhe reporterët.
Ishte e qartë se dikush e kishte njoftuar shtypin që më parë, gjë që shpjegonte praninë e punonjësve të televizionit, që ishin jashtë. Eduina po pyeste veten se kush mund të kishte qenë ai.
Seth Orinda u duk i prekur:
— Zonjë, ne erdhëm këtu vetëm për të sjellë tërë paratë që ne të varfrit mundëm të grumbullonim, me qëllim që ta ndihmonim këtë bankë në një periudhë të saj të vështirë.
— Nuk është ky gjest i një fqinjësie të mirë? — ndërhyri një zë tjetër.
— Marrëzi! — thirri Nolan Uejnrajti, — Banka nuk është në gjendje të vështirë.

— Në qoftë se nuk është në gjendje të vështirë, — ia priti një grua, — pse i bëri atëherë Rajonit Lindor atë që i bëri?
— Në komunikatën që nxori, — u përgjigj Eduina, — banka ka sqaruar shumë mirë pozitën e saj. Është çështje përparësie. Veç kësaj, banka ka thënë se shpreson që, në një kohë të mëvonshme, të kthehet përsëri në financimin e plotë fillestar.
— Ndërsa fliste kështu, edhe vetë asaj, këto i dukeshin vetëm fjalë të zbrazëta. Me sa shihej, edhe të tjerët i kishin gjykuar si të tilla, sepse menjëherë u dëgjua një kor thirrjesh dhe talljesh. Kjo ishte një shenjë e parë armiqësie dhe kërcënimi. Seth Orinda u kthye nga turma menjëherë, duke ngritur dorën. Britmat pushuan. Orinda iu drejtua përsëri Eduinës.
— Sido që t'ju duket juve, fakti është se ne të gjithë kemi ardhur për të derdhur para në bankën tuaj. Kjo është ajo që dua të them me fjalët «një akt shprese.» Ne shpresojmë se, kur të na keni parë të gjithëve dhe të keni kuptuar se si i shohim ne gjërat, ndoshta do të ndërroni mendje.
— Dhe, po qe se nuk ndërrojmë?
— Atëherë do të shkojmë të kërkojmë njerëz të tjerë dhe ca para të tjera. Dhe do t'ia dalim mbanë. Sot do të vijnë njerëz të mirë të tjerë, ashtu dhe nesër, edhe pasnesër. Pastaj, gjer në fund të javës, lajmi do të jetë përhapur (ai bëri shenjë me dorë nga gazetarët), kështu që, javën e ardhshme do të vijnë njerëz të tjerë dhe jo vetëm nga Rajoni Lindor. Natyrisht, do të vijnë vetëm për të hapur një llogari, për ta ndihmuar këtë bankë të gjorë të kalojë një periudhë të vështirë. Asgjë tjetër.
Zëra, që vinin nga pika të ndryshme, shtuan gëzueshëm:
— Sigurisht, i dashur, plot njerëz të tjerë!
— Nuk kemi shumë para, por jemi shumë si numër!
— Do t'u themi miqve tanë të vijnë, të na përkrahin!
— Natyrisht, — vazhdoi Orinda, me një shprehje të pafajshme, — shumë nga ata që kanë ardhur sot për të vënë para në bankë, do të kenë nevojë të vijnë nesër për t'i tërhequr, ose pasnesër, ose javën e ardhshme. Shumica e tyre nuk kanë aq shumë para, saqë të mund të lënë këtu një pjesë për një kohë të gjatë. Kur, të jetë prapë e mundur, do të vijnë këtu përsëri për të derdhur. — Në sytë e tij u pa një shkëlqim

djallëzie. — Duam të mos ju lëmë pa punë.
— Po, — tha Eduina. — Këtë e kuptova menjëherë.

Njëra nga reporteret, një vajzë bionde e truphedhur, pyeti:
— Zoti Orinda, sa do të depozitoni ju, të gjithë, në bankë?
— Jo shumë, — u përgjigj Orinda gëzueshëm. — Pothuajse asnjëri s'ka sjellë më shumë se pesë dollarë. Kjo është minimalja që pranon kjo bankë për hapjen e një llogarie të re.
— Shikoi nga Eduina. — Kështu është? — Eduina pohoi me kokë.
Disa banka, siç e dinte si Eduina, ashtu edhe të pranishmit e tjerë, kërkonin një shumë minimale prej pesëdhjetë dollarësh për të hapur një librezë kursimi dhe prej njëqind dollarësh për një llogari rrjedhëse. Disa banka të tjera, përkundrazi, nuk kishin caktuar ndonjë shumë minimale. Fërst Merkantajll Amerikën Benku, duke dashur të nxiste depozituesit e vegjël, kishte vendosur kompromisin prej pesë dollarësh.
Dhe kishte edhe një fakt tjetër: pas depozitimit, të pesë dollarët mund të tërhiqeshin pothuajse të gjithë, sepse, për ta mbajtur llogarinë të hapur, mjaftonte të lihej diçka fare e parëndësishme. Seth Orinda dhe të tjerët e kishin kuptuar shumë mirë këtë mekanizëm dhe kishin ndërmend ta mbysnin degën kryesore të bankës nën një mori veprimesh: derdhjesh dhe tërheqjesh. Eduina mendoi: «Ka shumë mundësi që t'ia dalin në krye.»
Ndërkaq, ata nuk po bënin asgjë ilegale dhe, gjithashtu, nuk mund të provohej se po bënin një veprim pengues.
Me gjithë zemërimin që kishte ndezur prej minutash më parë, Eduina kishte dëshirë të qeshte, ndonëse e kuptonte se nuk duhej ta bënte këtë. U kthye përsëri nga Nolan Uejnrajti, i cili mblodhi supet dhe tha:
— Sa kohë që nuk vërtetohet ndonjë akt i qartë shqetësues, nuk mund të bëjmë gjë tjetër veçse të rregullojmë trafikun.

Pastaj, Uejnrajti iu drejtua Seth Orindës, me ton të vendosur:
— Kemi besim se të gjithë ju do të na ndihmoni të mbajmë rregullin brenda bankës dhe jashtë saj. Rojat tona do të japin udhëzime se sa veta mund të hyjnë çdo herë dhe ku duhet të qëndrojë radha që pret.
Orinda tundi kokën në shenjë pranimi.
— Sigurisht, zotëri. Miqtë e mi dhe unë do të bëjmë çmos për t'ju ndihmuar. As ne nuk duam çrregullime, por presim që të veproni me drejtësi dhe sinqeritet.
— Ç'doni të thoni me këtë?
— Ne, këtu brenda, ashtu edhe ata që janë jashtë, jemi klientë si kushdo tjetër që vjen në këtë bankë. Dhe, ndërsa presim me durim radhën tonë, nuk duam që ndonjërit t'i bëhet trajtim favorizues dhe të futet brenda para nesh që po presim. Pra, dua të them, se kushdo që vjen, cilido qoftë ai, duhet të hyjë në radhë.
— Do të kemi kujdes që të bëhet ashtu.
— Edhe ne do të kemi kujdes zotëri, sepse po të veproni ndryshe, do të ishte një rast i qartë diskriminimi. Dhe, atëherë, do t'i dëgjonit mirë të thirrurat tona!
Ndërkaq, Eduina vuri re se reporterët vazhdonin të merrnin shënime.
Duke çarë rrugën nëpërmes turmës, ajo u drejtua te tryezat e punës që ishin caktuar për hapjen e llogarive të reja: tri të parave u ishin shtuar edhe dy dhe, në atë çast, po përgatiteshin edhe dy të tjera.
Eduina vuri re se te njëra nga tryezat që ishin shtuar për të ndihmuar, punonte Huanita Nunjezi. Ajo e hasi vështrimin e Eduinës dhe të dyja i buzëqeshën njëra-tjetrës. Befas, Eduinës iu kujtua se Huanita banonte në Rajonin Lindor. Pyeti veten nëse kishte pasur ajo gjë më parë dijeni për këtë invadim që iu bë bankës. Pastaj, mendoi: e ç'rëndësi kishte në kishte pasur

dijeni apo jo.
Dy nga funksionarët e gradës së ulët po mbikëqyrnin punën për hapjen e llogarive të reja dhe ishte e qartë se e tërë puna tjetër e ditës do të mbetej shumë prapa.
Zezaku trupmadh dhe i ngjallur, që kishte hyrë në bankë nga të parët, po ngrihej pikërisht kur mbërriti Eduina. Vajza, me të cilën ai kishte kryer veprimet, që nuk ishte më e tronditur, iha:
— Ky është zoti Jufrejts. Sapo hapi një llogari.
— Dikën Jufrejts. Kështu më quajnë zakonisht. — Zezaku zgjati një dorë shumë të madhe. Eduina ia shtrëngoi.
— Mirë se erdhët në Fërst Merkantajll Amerikën Benk, zoti Jufrejts.
— Faleminderit, është një kënaqësi e vërtetë, në fakt, aq e vërtetë, saqë mendoj të fus edhe ndonjë para tjetër të vogël në këtë llogari.
Ai nxori një grusht me monedha të vogla dhe zgjodhi prej tyre një kuorter dhe dy dajms) dhe u drejtua për tek arka.
Eduina e pyeti nëpunësen:
– Sa ishte derdhja e parë?
– Pesë dollarë.
– Shumë mirë. E vazhdoni punën sa më shpejt që të jetë e mundur.
– Sigurisht, zoja d'Orsej, por ky më mori shumë kohë, duke më bërë një numër shumë të madh pyetjesh mbi tërheqjet dhe përqindjet e interesit. Pyetjet i kishte të shkruara në një fletë.
– A munde ta mbash fletën?
– Jo.
– Ka të ngjarë që edhe të tjerët të veprojnë njëlloj. Përpiqu të marrësh një nga ato fletët dhe, pastaj, ma trego mua.
Eduina mendoi se prej saj mund të zbulohej ndonjë gjurmë që të shpinte tek ai që e kishte planifikuar dhe drejtuar me kaq aftësi këtë invadim. Ajo nuk besonte se midis atyre që kishte

parë dhe me të cilët kishte folur, të fshihej personazhi kyç, që e kishte organizuar të gjithë këtë punë.
Ajo kuptoi se edhe diçka tjetër po dilte në dukje: Orvatja për ta paralizuar bankën nuk kufizohej vetëm në hapjen e thjeshtë të llogarive. Ata që i kishin hapur llogaritë formonin tani radhë para sporteleve të arkëtarëve dhe derdhnin ose tërhisnin sasira të vogla parash, me një ngadalësi jashtëzakonisht të madhe, duke u bërë arkëtarëve pyetje ose duke ia nisur muhabetit me ta.
Në këtë mënyrë, klientët e zakonshëm jo vetëm që kishin vështirësi për të hyrë në bankë, por, edhe pasi kishin hyrë, gjenin pengesa të tjera.
Eduina e njoftoi Nolan Uejnrajtin për listat me pyetjet e shkruara dhe udhëzimet që i kishte dhënë nëpunëses së re.
Drejtori i shërbimit të sigurimit e miratoi veprimin e saj dhe tha:
– Edhe unë do të doja t'i shihja.
– Zoti Uejnrajt, — thirri një nëpunës, — në telefon!
Nolani mori receptorin dhe Eduina e dëgjoi duke thënë:
– Në fakt, kjo është një demonstratë, edhe pse jo në kuptimin ligjor. Por është një demonstratë paqësore dhe, po të merrnim vendime të nxituara, do t'i shkaktonim vetes telashe. Përdorimi i forcës është gjëja e fundit që duam.
«Është diçka që të shton forcat; — mendoi Eduina, — të kesh në dispozicion arsyen e shëndoshë dhe urtësinë e Uejnrajtit.»
Ndërsa ky i fundit po vendoste receptorin në vend, i erdhi një mendim.
– Dikush foli për të thirrur policinë, — tha ajo.
– Ata erdhën njëkohësisht me mua, por unë i largova. Do të kthehen menjëherë, po të kemi nevojë për ta. Shpresoj se kjo nuk do të ndodhë. — Uejnrajti bëri me shenjë nga telefoni dhe, pastaj, nga gratataçieli i FMA-së — Lajmi ka mbërritur

në sferat e larta. Ata, lart, i ka zënë tanimë paniku.
– E vetmja gjë që mund të bëjnë është të rifillojnë financimet për Rajonin Lindor.
Për të parën herë që prej çastit që kishte ardhur, një buzëqeshje e lehtë u duk në fytyrën e Uejnrajtit.
– Edhe mua do të më pëlqente të bëhej një gjë e tillë, por kjo nuk është rruga e drejtë për t'ia arritur qëllimit: kur është fjala për paratë e bankës, presionet nga jashtë nuk sjellin asnjë ndryshim.
Eduina filloi:
– Kush e di nëse..., — por, pastaj, ndërroi mendje dhe heshti.
Ndërkaq, turma që zinte hapësirën e caktuar për publikun ishte gjithnjë po aq e shumtë sa më parë dhe zhurma ishte shtuar. Jashtë, radha vazhdonte të zgjatej.
Ora ishte 9.45.

Po në orën 9.45, tri blloqe ndërtesash larg nga gratacieli i FMA-së, Margo Brekeni udhëhiqte veprimet nga vetura e saj Volksvagen, e ndaluar në një vend ku nuk binte në sy.
Në fillim, kishte vendosur të qëndronte larg vendit të aksionit të organizuar prej saj por, pastaj, nuk kishte mundur të rezistonte. Si një kalë lufte që, kur nuhat betejën, godet tokën me thundrat nga padurimi për t'u lëshuar në përleshje, edhe vendimi i saj ishte dobësuar gjithnjë e më shumë dhe, më në fund, ishte venitur.

Megjithatë, ajo vazhdonte të kishte kujdes për të mos vënë në pozitë të keqe Aleksin ose Eduinën dhe kjo kishte qenë arsyeja e mungesës së saj në vijën e parë, të sheshi «Roseli».

Në rast se do të kishte shkuar atje, do ta kishin parë dhe njohur menjëherë gazetarët e televizionit, që kishin qenë paralajmëruar prej saj.

Prandaj, rrinte aty, në veturën e saj, dhe lajmëtarët vinin dhe e njoftonin mbi zhvillimin e gjendjes dhe merrnin udhëzimet e reja.

Një punë e madhe organizative ishte kryer që nga mbrëmja e ditës së enjte.

Të premten, ndërsa Margoti po përfundonte përpunimin e planit të përgjithshëm, Sethi, Dikëni dhe shumë anëtarë të komisionit kishin bërë rekrutimin e përgjegjësve të grupeve, si në Rajonin Lindor, ashtu dhe në afërsi. Megjithëse u kishin shpjeguar njerëzve vetëm në vija të përgjithshme se ç'parashikohej të bëhej, kjo kishte ngjallur një entuziazëm të vërtetë. Pothuajse të gjithë donin të merrnin pjesë në aksionin dhe njihnin të tjerë të cilët mund të mbështeteshin.

Të dielën mbrëma, listat përmbanin një mijë e pesëqind emra. Të tjerë shtoheshin me shumicë. Siç ishte parashikuar nga Margoti, aksioni mund të vazhdonte së paku për një javë ndoshta edhe më shumë, po qe se entuziazmi nuk binte.

Nga vullnetarët që ishin në punë, disa, si Dikën Jufrejtsi, kishin marrë ditët e pushimit të pashfrytëzuara. Të tjerë kishin thënë se nuk do të shkonin në punë për tërë kohën që do të ishte e nevojshme. Por shumica ishin të papunë për shkak të një pakësimi stinor të punës.

Sidoqoftë, pjesën e tyre më të madhe e përbënin gratë, sepse, nga njëra anë, kishin më shumë kohë në dispozicion, por sidomos sepse Rajoni Lindor përfaqësonte në jetën e tyre — më shumë se për burrat — një fener shprese.

Margoti ishte në dijeni të të gjitha këtyre gjërave, qoftë në sajë të shqyrtimit të rezultateve të veprimeve të para, qoftë nga njoftimet e njëpasnjëshme. Njoftimet që kishin ardhur gjer në atë kohë ishin shumë të kënaqshme.

Margoti kishte ngulur këmbë që, tërë kohën, dhe veçanërisht gjatë kontakteve të drejtpërdrejta me përfaqësuesit e bankës, pjesëmarrësit të tregoheshin të përzemërt, të

sjellshëm dhe të gatshëm për të ndihmuar. Kjo qëndronte në themel të shprehjes «akt shprese», të krijuar nga vetë Margoti dhe të figurës së paraqitur prej saj të një grupi njerëzish drejtëpërdrejtë të interesuar — ndonëse me mjete të kufizuara — që nxitonin në «ndihmë» të FMA-së në «gjendje të vështirë».

Margoti e kishte menduar drejt se çdo pohim mbi mundësinë e qenies së Fërst Merkëntajll Amerikën Benkut në vështirësi do të prekte një pikë të ndjeshme. Dhe ndërsa nuk ishte nevoja të fshihej lidhja me Rajonin Lindor në asnjë rast nuk duheshin bërë kërcënime të hapura, si për shembull që paralizimi i degës së bankës do të vazhdonte deri sa të vendosej përsëri financimi i ndërtimeve nga ana e FMA-së. Margoti ia kishte thënë Seth Orindës dhe të tjerëve: «Le të arrijë vetë banka në këtë konkluzion».

Në mbledhjen që kishin bërë për të marrë udhëzimet, ajo kishte theksuar nevojën e shmangies së fjalës dhe veprimit më të vogël që mund të merrej si kërcënim ose frikësim. Pjesëmarrësit e mbledhjes kishin marrë shënime dhe, pastaj, ua kishin kaluar udhëzimet të tjerëve.

Një gjë tjetër që kishin marrë të gjithë ishte lista e pyetjeve që duhet të bënte secili, kur t'i hapej një llogari e re. Edhe pyetjet i kishte përgatitur Margoti. Ka qindra pika, për të cilat çdo klient i një banke ka të drejtë të kërkojë sqarime, ndonëse shumica nuk e vrasin fort mendjen. Pyetje të tilla do të ndihmonin për ta ngadalësuar punën e bankës deri gati në paralizimin e saj.

Po të paraqitej rasti, Seth Orinda do të vepronte si zëdhënës. Për të mësuar fjalimin e shkurtër, të përgatitur nga Margoti, nuk ishte nevoja për shumë prova. Orinda mësonte shpejt.

Dikën Jufrejtsi ishte ngarkuar me detyrën që të vihej në krye të radhës, para bankës, dhe të ishte i pari që të hapte llogarinë.

Kishte qenë Jufrejtsi — askush nuk e dinte nëse Dikën ishte emri i tij i vërtetë ose nëse përfaqësonte një funksion në njërën nga fetë e ndryshme që ekzistonin në zonën ku ai banonte — që e kishte organizuar grupin i cili duhej t'u shpjegonte vullnetarëve se ku të shkonin dhe kur. Ai kishte punuar me një mori bashkëpunëtorësh, që ishin përhapur në të gjithë drejtimet, si fijet e pëlhurës së një merimange.

Për atë të mërkurë, në mëngjes, ishte e domosdoshme që para bankës të formohej një radhë mjaft e gjatë, me qëllim që të bënte përshtypje të madhe. Por, kohë mbas kohe, disa nga pjesëmarrësit duheshin zëvendësuar dhe, të tjerë, duheshin mbajtur si rezervë, për ditët më pas.

Për t'i kryer të gjitha këto ishte organizuar një rrjet ndërlidhjeje, i cili, ndonëse i çalë, e bënte prapëseprapë punën, me anë të përdorimit në shkallë të gjerë të kabinave telefonike publike, pranë të cilave ishte caktuar një numër vullnetarësh. Me përjashtim të ndonjë të mete të vogël, të pashmangshme në një projekt të realizuar në një kohë aq të shkurtër, rrjeti i ndërlidhjes punonte mirë. Të gjitha të dhënat i dërgoheshin Margotit që rrinte në ndenjësen e prapme të veturës së saj Folksvagen. Informatat përmbanin numrin e personave që përbënin vargun para bankës, kohën e nevojshme për hapjen e çdo llogarie, numrin e nëpunësve të rinj të caktuar për hapjen e tyre. Margoti ishte e informuar gjithashtu edhe për grumbullimin e madh që ishte bërë brenda degës së bankës dhe shkëmbimin e fjalëve midis Seth Orindës dhe funksionarëve të FMA-së.

Ajo bëri një llogaritje të shpejtë dhe i tha lajmëtarit të fundit, një djalë thatim që po priste në ndenjësen e përparme të veturës:

— Thuaji Dikënit të mos thërrasë, për herë të, vullnetarë të tjerë. Duket se mjaftojnë për sot. Të zëvendësohen disa nga ata që presin jashtë, por jo më shumë se nga pesëdhjetë veta

dhe u thuaj të kthehen për të tërhequr ushqimin e tyre. Meqë ra fjala, njoftoji të gjithë të mos hedhin letra e mbeturina në sheshin «Roseli» dhe as të fusin ushqime dhe pije brenda bankës.

Biseda për ushqimet i solli ndërmend se paratë kishin qenë problem që në fillim të javës.

Të hënën, të dhënat që i sillte Dikën Jufrejtsi vinin në dukje se shumë nga ata që dëshironin të merrnin pjesë nuk i kishin të pesë dollarët — shuma minimale e nevojshme për të hapur një llogari në FMA. Në fakt, Shoqata e banorëve të Rajonit Lindor s'kishte fare para. Për pak kohë, u duk sikur plani i tyre po dështonte.

Atëherë, Margoti i kishte telefonuar Federatës amerikane të nëpunësve, arkëtarëve dhe punëtorëve të zyrave, e cila ishte sindikata që tani përfaqësonte punonjësit e aeroportit, që ajo kishte ndihmuar para një viti.

Margoti kishte pyetur nëse sindikata mund të ndihmonte, duke i dhënë pesë dollarë hua çdo vullnetari që s'e dispononte këtë shumë. Funksionarët e sindikatës kishin organizuar një mbledhje të ngutshme dhe përgjigjja kishte qenë pozitive.

Të martën, disa nëpunës të sindikatës kishin ndihmuar Dikën Jufrejtsin dhe Seth Orindën për shpërndarjen e të hollave. Të gjithë e dinin se një pjesë e parave nuk do të ktheheshin më kurrë dhe se disa do t'i prishnin të pesë dollarët që u kishin rënë nga qielli, që të martën mbrëma, duke harruar, ose duke mos e vrarë më mendjen për qëllimin që ishin marrë. Mirëpo, ata ishin gjithashtu të bindur se pjesa më e madhe e parave do të përdorej siç kishte menduar Margoti. Po të gjykoje nga ajo që ndodhi të mërkurën në mëngjes, dilte se ata kishin pasur të drejtë.

Sindikata ishte treguar e gatshme, gjithashtu, të ofronte edhe diçka për të ngrënë për çdo vullnetar. Oferta ishte pranuar. Margoti dyshonte se sindikata do të tërhiqte në këtë

mes ndonjë leverdi të sajën, por kjo gjë nuk i sillte ndonjë dëm çështjes së Rajonit Lindor, prandaj kjo s'ishte punë e saj.

I vazhdoi udhëzimet që po i jepte lajmëtarit të ri, duke thënë:

— Radha duhet të qëndrojë deri në orën tre, kur të mbyllet banka.

Ka mundësi, mendoj ajo, që përfaqësuesit e mjeteve të informacionit të duan të fotografojnë disa pamje në kohën e mbylljes së bankës; prandaj, ka rëndësi që ekspozimi i forcës të zgjated gjer në fund.

Programi për të nesërmen mund të bashkërenditej po atë mbrëmje. Në pjesën më të madhe, ai do të ishte një përsëritje e këtij të sotmit.

Për fat të mirë, kushtet meteorologjike — qiell pa re, kohë e butë fare — ishin të favorshme, ashtu si edhe parashikimet për ditët e ardhshme.

— Vazhdoni të theksoni, — i tha Margoti një lajmëtari tjetër, një gjysmë ore më vonë, — se të gjithë duhet të mbajnë një qëndrim miqësor, miqësor, miqësor. Edhe në qoftë se ata të bankës e humbin durimin ose bëhen të pasjellshëm, u duhet përgjigjur me buzëqeshje.

Në ora 11.45, Sethi erdhi t'i raportonte vetë Margotit.

Me një buzëqeshje të kënaqur, ai i dha asaj botimin e parë të një gazete të pasdites.

— Pa shih! Pa shih! — thirri Margoti.

Pothuajse e tërë faqja e parë u kushtohej ngjarjeve të bankës. Ishte shumë më tepër se sa kishte guxuar të shpresonte Margoti.

Titulli kryesor thoshte:

BANKË E MADHE E PARALIZUAR NGA BANORËT E RAJONIT LINDOR

Dhe më poshtë:

Fërst Merkentáilli në vështirësi?
Shumicë e madhe njerëzish për ta ndihmuar me derdhje të vogla.

Pastaj vinin fotografi të ndryshme dhe një artikull në dy kolona.

— Djema! — thirri Margoti, — Si do të shpërthejnë ata të FMA-së!

Në fakt, ashtu ndodhi.

Në katin e 36-të të grataçielit të Fërst Merkentáilli Emerikën Benkut, një mbledhje e ngutshme u organizua në zyrën e presidentit, pak mbas orës dymbëdhjetë. Merrnin pjesë Xherom Petërtoni dhe Rosko Hejuordi, të dy me pamje të zymtë. Pak më vonë erdhi edhe Aleks Vandervurti. Edhe ai kishte pamje serioze, por, sa më shumë që zhvillohej biseda, ai dukej gjithnjë e më pak i interesuar se të tjerët dhe më pas shprehja e fytyrës së tij u bë kryesisht e menduar; bile, në një a dy raste, në të dallohej një nuancë zbavitjeje. I ftuari i katërt për të marrë pjesë në mbledhje ishte Tom Stroani, kryeekonomisti i ri, i zellshëm i FMA-së; i pesti, Dik Frençi, drejtori i zyrës së marrëdhënieve publike.

Frençi hyri me hapin e tij të rëndë, me fytyrë të ngrysur dhe duke kafshuar me nervozizëm një puro të pandezur. Ai mbante në dorë një pako me gazeta të pasdites, të cilat i përplasi në tryezë, njërën pas tjetrës, para të katër burrave.

Xherom Petërtoni, i ulur te tryeza e tij e punës, shpalosi njërën nga gazetat. Sapo lexoi fjalët «FMA-ja në vështirësi?», shpërtheu me zemërim:

— Kjo është një gënjeshtër e ndyrë! Kjo gazetë duhet hedhur në gjyq!

— S'ke fare ku të mbështetesh për një gjë të tillë, — ia priti Frençi me ashpërsinë e tij të zakonshme. — Gazeta s'ka dhënë atë si fakt, por bën vetëm një pyetje dhe, bile, citon dikë tjetër. Edhe pohimi origjinal nuk është keqdashës. — Ai rrinte në këmbë para tyre, me një qëndrim që dukej sikur thoshte «të pëlqen apo jo, kështu është puna», me duart prapa shpinës dhe puron të nxjerrë përpara, si një silur paditës.

Petërtoni u skuq nga zemërimi.

— Sigurisht, keqdashës është! — ndërhyri Hejuordi me ton të prerë, duke u kthyer nga katër të tjerët. Gjer në atë çast, ai po rrinte në këmbë, pranë njërës nga dritaret. — I tërë manifestimi është keqdashës. Edhe një budalla mund ta kuptojë këtë.

Frençi psherëtiu.

— Në rregull. Atëherë, do të shpjegohem më mirë. S'ka dyshim se, kushdo që është prapakësaj pune, është ekspert në çështje juridike dhe marrëdhënie publike. Manifestimi, siç e quan ti, është organizuar me zgjuarsi, në mënyrë që të duket miqësor dhe në dobi të bankës. Pa dyshim, ne e dimë se, në të vërtetë, ai s'është asnjëra nga të dyja. Mirëpo, ne nuk do të jemi kurrë në gjendje ta provojmë këtë. Prandaj, unë sugjeroj që të mos vazhdojmë të humbim kohë me fjalë boshe.

Mori një nga gazetat, e shpalosi në tryezë, në faqen e parë, dhe tha:

— Arsyeja që unë marr një rrogë princore është se jam ekspert për lajmet dhe mjetet e komunikimit. Në këtë çast, përvoja ime më thotë se këto lajme këtu, të cilat, — pavarësisht nëse kjo ju pëlqen apo jo, — janë paraqitur në mënyrë shumë korrekte, po përhapen tani në të tërë vendin dhe do të shfrytëzohen. Pse? Sepse kjo është, në njëfarë mënyre, një histori e Davidit dhe Goliatit, e mpleksur me një interesim njerëzor.

Tom Stroani, që ishte ulur pranë Vandervurtit, tha me zë të qetë:

— Mund të pohoj një pjesë të kësaj që u tha. Lajmi arriti në shërbimin e informacionit të Bursës dhe, menjëherë pas kësaj, aksionet tona u ulën një pikë.

Ka dhe diçka tjetër, – vazhdoi Dik Frençi, tamam sikur të mos e kishin ndërprerë. – Do të bënim mirë të përgatiteshim shpirtërisht për emisionet televizive të mbrëmjes. Me siguri që, për ne, do të flasin të gjitha stacionet lokale dhe, sipas mendimit tim prej eksperti, me këtë çështje do të merren edhe tre stacionet më të mëdha. Dhe po qe se do të ketë një redaktor të vetëm që t'i qëndrojë tundimit të shprehjes «bankë në vështirësi?», jam gati të gëlltis kinoskopin e televizorit tim.
Hejuordi pyeti, me ton të ftohtë:
– A mbarove?
– Jo, akoma. Dua të shtoj se, po të kisha hedhur tërë të ardhurat e mia të këtij viti në një operacion, në një operacion të vetëm, për ta paraqitur bankën nën një dritë të keqe, nuk do të kisha bërë dëm më të madh se sa ai që bëtë ju.
Dik Frençi kishte një teori personale, sipas së cilës një punonjës i mirë i marrëdhënieve publike duhet të jetë i gatshëm çdo ditë të rrezikojë ta humbasë vendin e tij të punës. Në qoftë se përgatitja dhe përvoja e tij kërkojnë që ai t'u paraqesë eprorëve të vet disa fakte jo të këndshme, për të cilat ata do të preferonin të mos u flitej... e po, prapëseprapë, ai duhej ta bënte këtë, me sinqeritet brutal. Sinqeritetti është një mjet që siguron vëmendjen. Të mos veprosh ashtu, ose të përpiqesh të fitosh dashamirësinë me anë të një kujdesi të veçantë në të folur, ose duke heshtur fare, do të thotë të mos kryesh detyrën që ke marrë përsipër.
Ka ditë, kur kërkohet që të mbahet një qëndrim më i prerë se zakonisht. Dhe kjo ishte një ditë e tillë.
Me pamje shumë të vërenjtur, Rosko Hejuordi e pyeti:
– A e dimë tanimë se kush janë organizatorët?
– Saktësisht jo, – u përgjigj Frençi. – Fola me Nolanin, i cili më tha se po punonte për këtë. S'ka dhe shumë rëndësi

tanimë.
– Dhe, në rast se të interesojnë lajmet e fundit nga dega e bankës, – shtoi Tom Stroani, – para se të vija këtu, kalova andej, nëpërmes galerisë, për të parë se si ishte gjendja. Salla ishte akoma plot e përplot me demonstrues. Pothuajse asnjë nga klientët e zakonshëm nuk mund të hyjë brenda.
– Nuk janë demonstrues, – e korrigjoi Dik Frençi. – Meqenëse po flasim për këtë, le ta sqarojmë mirë edhe këtë pikë. Ata s'mbajnë asnjë pankartë dhe s'hedhin parulla, me përjashtim, ndoshta, të fjalëve «akt shprese!». Edhe ata janë klientë dhe këtu qëndron problemi ynë.
– Në rregull, – tha Xherom Petërtoni. – Meqenëse di kaq shumë gjëra për këtë, çfarë sugjeron të bëhet?
Drejtori i zyrës së marrëdhënieve publike mblodhi supet.
– Ju ia hoqët Rajonit Lindor qilimin nga këmbët dhe jeni po ju ata që mund ta vënë atë përsëri në vend.
Tiparet e Rosko Hejuordit u ashpërsuan.
Xherom Petërtoni iu drejtua Vandervurtit.
– Aleks?
– Ju e dini çmendimin kam unë, – tha Aleksi. Ishte hera e parë që po hapte gojën gjatë mbledhjes. – Që në fillim, kam qenë kundër shkurtimit të fondeve dhe vazhdoj të jem edhe tani.
Hejuordi tha me sarkazëm:
– Atëherë do të jesh shumë i kënaqur nga kjo që po ndodh. Dhe mendoj se do të dorëzohesh para këtyre të paudhëve dhe sjelljes së tyre që synon të frikësojë.
– Nuk jam aspak i kënaqur. – Sytë e Aleksit lëshonin shkëndija zemërimi. – E ndiej veten keq dhe të fyer, duke parë se në ç'gjendje e keni vënë bankën dhe jam i blindur se këto që po ndodhin mund të parashikoheshin, ose, së paku, njëfarë proteste, njëfarë kundërshtimi. Por, ajo që ka tani më shumë rëndësi është normalizimi i gjendjes.
– Pra, do të dorëzoheshe, – përfundoi Hejuordi me qesëndi. – Tamam, siç thashë unë.
– Çështja nuk është të dorëzohesh apo të mos dorëzohesh, – ia priti ftohtë Aleksi. – Dilema e vërtetë është: bëmë mirë apo keq që shkurtuam fondet e Rajonit Lindor. Në qoftë se kemi

vepruar keq, atëherë duhet ta anulojmë vendimin tonë dhe të kemi guximin të pranojmë gabimin.
Xherom Petërtoni vërejti:
– Guxim ose jo, po të anulojmë vendimin, do të bëjmë figurë shumë të keqe.
– Nuk besoj, Xherom, – tha Aleksi. – Sidoqoftë, ç'rëndësi do të kishte kjo?
Dik Frençi ndërhyri:
– E di që vendimi i kësaj çështjeje, nga ana financiare, nuk është puna ime. Por, do t'ju them një gjë. Në rast se vendosim tani të ndërrojmë mendje lidhur me Rajonin Lindor, do të bënim figurë shumë të mirë.
Hejuordi i tha Aleksit, me ton therës:

— Në qoftë se mendon që, në këtë rast, guximi është një faktor i nevojshëm, atëherë them se ty të mungon ai. Ti nuk pranon t'i bësh ballë një turme kokëshkretësh.

Aleksi tundi kokën, me padurim.

— Rosko, pusho së foluri me tonin e një sherifi krahinor! Nganjëherë, këmbëngulja për të mos ndrequr një vendim të gabuar është vetëm kryeneçësi dhe asgjë tjetër. Veç kësaj, njerëzit që gjenden atje poshtë, te dega e bankës, nuk janë një turmë kokëshkretësh. Çdo njoftim që kemi marrë e bën të qartë këtë.

Hejuordi tha me një zë, ku ndihej një nuancë dyshimi:

— Duket se ka njëfarë solidariteti me ta. A di ndonjë gjë që s'e dimë ne të tjerët?

— Jo.

— Sidoqoftë, Aleks, — tha Xherom Petërtoni, — nuk më pëlqen mendimi i të hapurit rrugë, ashtu urtë e butë.

Pasi dëgjoi argumentet e të dyja palëve, Tom Stroani tha:

— Sikurse të gjithë e dini, unë isha kundër shkurtimit të fondeve për Rajonin Lindor, por nuk dua të tërhiqem për hunde nga njerëz të jashtëm.

Aleksi psherëtiu.

— Në qoftë se të gjithë e mendoni kështu, do të bënim mirë të pranojmë se, për një kohë, dega e bankës nuk do të shërbejë për asgjë.

— S'ka mundësi që kjo fundrrinë të rezistojë akoma për shumë kohë, — deklaroi Hejuordi. — Unë parashikoj që, po të qëndrojmë në pozitat tona, pa u zënë nga paniku prej kësaj loje mashtruese, i tërë ky manifestim do të marrë fund brenda ditës së nesërme.

— Kurse unë, — tha Aleksi, — parashikoj që ai të vazhdojë gjatë tërë javës së ardhshme.

Të dyja parashikimet dolën të gabuara.

Meqenëse banka nuk hiqte dorë nga qëndrimi i saj i prerë, invadimi i degës së saj kryesore nga ana e përkrahësve të Rajonit Lindor vazhdoi gjatë ditëve të tjera, domethënë të enjten e të premten, deri në orën e mbylljes, të premten mbrëma.

Dega e bankës ishte pothuajse e paralizuar dhe, siç e kishte parashikuar Dik Frençi, ngjarja ngjalli komente në tërë vendin.

Pjesa më e madhe e komenteve kishin karakter humoristik. Mirëpo, investitorët nuk zbaviteshin shumë me ato; në fakt, të premten, aksionet e Ferst Merkëntajll Emerikën Benkut në Bursën e Nju Jorkut u mbyllën me një humbje prej dy pikësh e gjysmë.

Ndërkaq, Margot Brekëni, Seth Orinda, Dikën Jufrejtsi dhe të tjerët, vazhdonin punën me planin e veprimit dhe rekrutimin e njerëzve.

Të hënën në mëngjes, banka kapitulloi.

Gjatë një konference shtypi, të organizuar në mënyrë të ngutshme në ora dhjetë, Dik Frençi njoftoi se banka rifillonte menjëherë financimin e mëparshëm të Rajonit Lindor. Ai shprehu pastaj, në emër të bankës, shpresën se ata që kishin hapur llogari gjatë ditëve të fundit, të mbeteshin klientë të saj.

Prapa kapitullimit kishte shumë arsye të forta. Njëra prej tyre ishte se, të hënën në mëngjes, para orës së hapjes, vargu i njerëzve para degës së bankës dhe në të gjithë sheshin «Roseli» ishte më i gjatë se ditët e tjera, kështu që ishte e qartë se invadimi i javës së mparshme do të përsëritej.

Një gjë akoma më tronditëse qe fakti se një radhë e gjatë ishte formuar edhe para një dege tjetër të FMA-së, në lagjen periferike të Indian Hillit. Kjo ishte diçka krejt e papritur, sepse gazetat e së dielës kishin parashikuar që përkrahësit e Rajonit Lindor ta shtrinin veprimtarinë e tyre në degë të tjera të bankës. Sapo kishte filluar të formohej radha, drejtori i kësaj dege, i alarmuar, i kishte telefonuar Drejtorisë Qendrore, duke i kërkuar ndihmë.

Por, një tjetër qe faktori vendimtar.

Të hënën, në mëngjes, Shoqata amerikane e nëpunësve, arkëtarëve dhe punëtorëve të zyrave — sindikata që i kishte dhënë huadhënies shoqërore të banorëve të Rajonit Lindor dhe kishte ofruar ushqime falas për vullnetarët, e kishte bërë të njohur publikisht ndërhyrjen e saj dhe ishte zotuar ta vazhdonte këtë vepër solidariteti. Një zëdhënës i sindikatës e kishte quajtur Fërst Merkëntajll Emerikën Benkun: «një makinë jashtëzakonisht të madhe dhe egoiste, e ngritur për të pasuruar edhe më shumë të pasurit në kurriz të të varfërve.» Ai kishte shtuar se, së shpejti, do të fillonte një fushatë për të organizuar një sindikatë të nëpunësve të bankës.
Në këtë mënyrë, Shoqata amerikane e nëpunësve, arkëtarëve dhe punëtorëve të zyrave e ktheu balancën dhe këtë e bëri, jo me një fije kashte, por me një ngarkesë të plotë tullash.

Bankat — të gjitha bankat — u trembshin dhe, bile, i urrenin sindikatat. Drejtuesit dhe funksionarët e bankave i përgjonin dhe i vëzhgonin sindikatat, ashtu siç bën gjarpëri me mangustën. Ata parashikonin një kufizim të lirisë së tyre financiare, po të ndërmjetësonin sindikatat. Nganjëherë, frika e tyre ishte e paarsyeshme, por, megjithatë, ajo ekzistonte. Ndonëse sindikatat ishin përpjekur shpeshherë, të pakta kishin qenë ato që kishin bërë, qoftë edhe një hap të vogël përpara, përsa u përket nëpunësve të bankave. Çdo herë, bankierët kishin mundur t'ua hidhnin organizatorëve të sindikatave dhe kishin ndërmend të vazhdonin kështu edhe në të ardhmen. Në rast se gjendja në Rajonin Lindor u jepte sindikatave një pikëmbështetje, kjo duhej zhdukur ipso facto[1]). Dhe, kështu, Xherom Petërtoni, i cili erdhi në zyrë herët dhe plot me një gjallëri jo të zakonshme, autorizoi rifillimin e financimeve. Në të njëjtën kohë, ai miratoi deklaratën zyrtare të bankës, që Dik Frenqi, u shpejtua të bënte.

Menjëherë pas kësaj, për të qetësuar nervat, Petërtoni njoftoi se nuk ishte për asnjëri dhe u tërhoq në dhomën tjetër, për të praktikuar disa goditje të shkurtra golfi mbi qilim.

Më vonë, po atë mëngjes, gjatë një mbledhjeje, kryesisht informative, fillimi i financimeve për Rajonin Lindor u shënua në procesverbal, megjithëse Rosko Hejuordi murmuri, i pakënaqur:

— Me këtë dorëzim, po krijojmë një shembull të keq, për të cilin do të pendohemi.

Aleks Vandervurti nuk foli fare.

Kur deklarata e FMA-së iu lexua përkrahësve të Rajonit Lindor që po mbanin radhë para të dyja degëve të bankës, pati disa brohoritje dhe, pastaj, të dy grupet u shpërndanë në

qetësi. Pas një gjysmë ore, gjendja në të dyja degët e bankës u normalizua përsëri.

E tërë kjo punë do të mund të kishte mbaruar me kaq, mirëpo ndodhi një dekonspirim, i cili, duke gjykuar mbas zhvillimit të ngjarjeve, ndoshta ishte i pashmangshëm. Ai u botua pas dy ditëve, si koment, në të njëjtën rubrikë «Veshi në vrimën e çelësit», nga kishte pasur pikënisjen e tërë kjo çështje.
Në artikull thuhej:
A i keni bërë vetes pyetjen se kush qëndronte, në të vërtetë, prapa përfaqësisë së Rajonit Lindor, që, kësaj jave, vuri në gjunjë FMA-në krenare e të fuqishme? Hija e di. Ajo ishte Margot Brekëni, militantja e të drejtave të femrave dhe mbrojtësja e të drejtave qytetare, e famshme për bllokimin e WC-ve të aeroportit dhe për beteja të tjera, të zhvilluara në favor të të varfërve dhe të shtypurve.
Por, në këtë aksion të fundit, për të cilin ajo ka qenë frymëzuesja e palodhur, zonjusha Brekën dëshi që veprimtaria e saj të mbetej krejt e fshehtë. Ndërsa të tjerët shkonin në vijën e parë, ajo rrinte më një anë, duke iu shmangur çdo kontakti me mjetet e komunikimit, aleatët e saj të zakonshëm.
Edhe për këtë, e pyesni veten pse?
Mos e vrisni mendjen! Margoti ka një mik të zemrës, bashkë me të cilin është parë shumë shpesh: bankieri i mirënjohur Aleksandër Vandervurt, nënpresident ekzekutiv i First Merkëntajll Emerikën Benkut. Edhe ju po të ishit në vend të Margotit dhe të viheshin në rrezik marrëdhënie të kësaj natyre, a nuk do t'i shmangeshit edhe ju çdo publiciteti?
Vetëm për një gjë mbetemi të paqartë: A dinte gjë Aleksi për veprimin kundër bankës së tij? Dhe a e kishte miratuar ai këtë gjë?

— Djall o punë, Aleks, — tha Margoti, — më vjen shumë keq!
— Kështu si vajtën punët, edhe mua më vjen keq.
— Do të doja ta rriep të gjallë atë qelbanik redaktor. E vetmja gjë e mirë që ka bërë është se nuk ka përmendur se jam kushërira e Eduinës.

— Pak veta e dinë këtë, edhe në bankë. Sidoqoftë, për dashnorët bëhet më shumë zhurmë sesa për kushërinjtë.

Pas pak minutash, ora do të ishte dymbëdhjetë të natës. Margoti dhe Aleksi ishin në apartamentin e këtij të fundit. Ky ishte takimi i tyre i parë që kur kishte filluar veprimi kundër degës së bankës. Artikulli në rubrikën «Veshi në vrimën e çelësit» ishte botuar një ditë më parë.

Margoti kishte ardhur para disa minutave, mbasi kishte përfaqësuar një klient në një seancë nate: një pijanec i zakonshëm, por në gjendje të mirë ekonomike, që, kur ishte i pirë, kishte maninë të sulmonte këtë që i dilte përpara. Ai përbënte një nga burimet e pakta konstante të Margotit.

— Them se ai redaktori ka bërë vetëm detyrën e tij, — tha Aleksi. — Dhe, sidoqoftë, është pothuajse e sigurt se, herët a vonë, emri yt do të dilte.

Margoti u përgjigj me keqardhje:

— U përpoqa, me të gjitha mënyrat, t'i shmangesha një gjëje të tillë. Vetëm pak njerëz ishin në dijeni dhe doja që punët të mbeteshin ashtu.

Aleksi tundi kokën.

— E pamundur. Pikërisht sot, Nolan Uejnrajti më tha. Këto janë fjalët e tij: «E gjithë kjo punë e mërzitshme mban firmën e Margot Brekënit». Ai kishte filluar të pyeste njerëz të ndryshëm. Ti e di se, para se të vinte te ne, ai ka shërbyer në polici. Edhe po të mos ishte botuar ai artikull, dikush do të kishte folur.

— Por s'ishte nevoja të përmendnin emrin tënd.

Aleksi buzëqeshi.

— Të them të vërtetën, fjalët «bankier i mirënjohur» më pëlqyen mjaft.

Por buzëqeshja ishte e shtirur dhe ai e pa se Margoti e kishte kuptuar. E vërteta ishte se artikulli e kishte prekur dhe i kishte prishur humorin. Edhe atë mbrëmje ishte akoma me humor të keq, ndonëse e kishte ndier veten pak më mirë, kur i kishte telefonuar Margoti për t'i thënë se po shkonte tek ai.

Ai e pyeti:

— Ke folur sot me Eduinën?

— Po, i telefonova. Nuk m'u duk e tronditur. Ndoshta sepse jemi mësuar me njëra-tjetrën. Veç kësaj, është e kënaqur që projekti i Rajonit Lindor është vënë përsëri në binarë. Edhe ti duhet të jesh i kënaqur.

— Ti e ke ditur gjithmonë se ç'mendim kam pasur unë për këtë çështje, por kjo s'do të thotë se i miratoj metodat e tua të dyshimta.

Aleksi kishte folur me një ton më të ashpër se sa kishte pasur ndërmend, dhe Margoti kundërveproi menjëherë.

— S'ka asgjë të dyshimtë në atë që kam bërë unë ose njerëzit e mi. S'mund të thuhet e njëjta gjë për bankën tënde të mallkuar.

Aleksi ngriti duart, met gishtat e hapur, në qëndrim mbrojtjeje.

— Shiko, të mos grindemi! Jo sonte, së paku, Atëherë, mos thuaj gjëra të tilla.

— Mirë, s'po i them.

Zemërimi i tyre vazhdoi vetëm një çast.

Margoti tha me një pamje të menduar:

— Dëgjo... kur filloi kjo punë, a të shkoi ndopak mendja se mund të isha në këtë mes?

— Po. Pjesërisht sepse të njoh shumë mirë. Veç kësaj, m'u kujtua qëndrimi yt i rezervuar lidhur me Rajonin Lindor, ndërsa unë prisja të më bëje copë e thërrime, mua, bashkë me bankën.

— A ta vështirësoi ty kjo gjë edhe më shumë punën, gjatë kohës që vazhdonte aksioni kundër bankës?

— Po, ma vështirësoi, — u përgjigj me sinqeritet Aleksi. — Nuk dija ç'të bëja: t'i zija me gojë dyshimet e mia, apo të mbaja gojën mbyllur. Meqenëse përmendja e emrit tënd nuk do të kishte ndryshuar gjë në atë që po ndodhte, vendosa të mos flisja. Pastaj, u pa se vendimi im kishte qenë i gabuar.

— Dhe kështu, tani të gjithë janë të bindur se ti ishe në dijeni që në fillim.

— Roskoi, po. Ndoshta edhe Xheromi. Për të tjerët, s'di ç'të them.

Pas një çasti pasigurie, Margoti pyeti:

— Ka... ka shumë rëndësi kjo për ty? — Për herë të parë, gjatë marrëdhënieve të tyre, zëri po i dridhej nga ankthi dhe fytyra i kishte marrë një pamje të shqetësuar.

Aleksi mblodhi supet dhe, pastaj, vendosi ta qetësonte.

— Jo dhe aq shumë. Mos u mërzit; nuk do të vdes nga kjo.

Mirëpo, në të vërtetë, kjo kishte rëndësi për të dhe kishte shumë rëndësi edhe për FMA-në, pavarësisht se ç'kishte thënë ai pak më parë. Ngjarja kishte ndodhur në një çast dyfish të pafavorshëm.

Aleksi ishte i sigurt se të gjithë këshilltarët e kishin lexuar artikullin, ku ishte përmendur emri i tij, si edhe pyetjen: «A dinte gjë Aleksi për veprimin kundër bankës së tij? Dhe a e kishte miratuar ai këtë gjë?» Dhe, në rast se dikush s'do ta kishte lexuar, sigurisht që Rosko Hejuordi do të interesohej që ta lexonte.

Atë mëngjes, në ora dhjetë, Aleksi kishte shkuar te Xherom Petërtoni, sapo presidenti kishte ardhur në bankë. Por, Hejuordi, zyra e të cilit ishte më afër, kishte shkuar atje para tij.

— Eja, Aleks, — tha Petërtoni. Më mirë të bëjmë një bisedë të tre, se sa dy biseda me nga dy veta.

— Para se të fillojmë, Xherom, — tha Aleksi, — dua të jem i pari që të ngre një çështje. E ke parë këtë? — Vuri mbi tryezë një copë të prerë nga rubrika «Veshi në vrimën e çelësit» të ditës së mëparshme.

Hejuordi vërejti menjëherë, me një zë antipatik:

— Kujton se ka njeri në bankë që të mos e ketë parë akoma?

Petërtoni psherëtiu.

— Po, e pashë, Aleks. Nja dhjetë veta më kanë tërhequr, gjer tani, vëmendjen për të dhe, pa dyshim, do të ketë edhe të tjerë.

Aleksi tha, me zë të vendosur:

— Atëherë, ke të drejtën të dish se ato që janë shkruar aty janë krejtësisht gjëra të shpikura me keqdashje dhe djallëzi. Ta them hapur se, para ngatërresave që ndodhën, unë s'dija absolutisht asgjë dhe se, edhe më vonë, kam ditur vetëm ato gjëra që dinit dhe ju të gjithë.

— Shumë njerëzve, — komentoi Rosko Hejuordi, — duke pasur parasysh marrëdhëniet e tua (e theksoi me sarkazëm

fjalën «marrëdhënie»), një gjë e tillë do t'ju dukej se ka pak të ngjarë të jetë ashtu.

— Shpjegimet, — ia priti me ton të ftohtë Aleksi, — ia jap vetëm Xheromit.

Hejuordi nuk pranoi të lihej mënjanë.

— Kur është fjala për emrin e mirë të bankës, të gjithë jemi të interesuar. Përsa i përket të ashtuquajturit shpjegim që dhe, mos pret seriozisht që ndokush të besojë se, duke filluar nga e mërkura, pastaj e enjtja, e premtja dhe, pas pushimit të fundit të javës, e hëna, ti s'dije gjë, s'dije gjë fare se mikesha jote ishte e ndërlidhur në këtë ngatërresë?

— Po, Aleks, — tha Petërtoni, — si e shpjegon këtë?

Aleksi e ndjeu t'i skuqej fytyra. E ndjeu veten përsëri të zemëruar, siç i kishte ndodhur edhe disa herë, që prej ditës së mërparshme, nga fakti se Margoti e kishte vënë në një pozitë të vështirë.

Me qetësinë më të madhe, ai i tha Petërtonit se kishte dyshuar për Margotin që javën e mëparshme dhe se, pastaj, kishte arritur në përfundimin se, të bisedohej për këtë gjë me të tjerë, nuk do të kishte sjellë ndonjë dobi. Ai u tha, gjithashtu, se kishte një javë që s'e kishte parë Margotin.

— Të njëjtin dyshim kishte pasur dhe Nolan Uejnrajti, — shtoi ai. — Kështu më tha sot në mëngjes herët. Por, edhe ai, nuk e kishte zënë më gojë, sepse, edhe për atë, deri në botimin e këtij artikulli, ishte fjala vetëm për një përshtypje personale, për një hamendje.

— Dikush mund të të besojë, Aleks, — tha Rosko Hejuordi; por, toni i zërit dhe shprehja e fytyrës së tij thoshin qartë: unë, jo.

— Mjaft, mjaft, Rosko! — e qortoi me butësi Petërtoni. Pastaj, u kthye përsëri nga Aleksi. — Mirë, Aleks, pranoj shpjegimin tënd. Ndërkaq, besoj se do ta përdorësh ndikimin

tënd mbi zonjushën Brekënin që, në të ardhmen, të ketë mirësinë t'i drejtojë gjetiu artileritë e saj.

— Ose, më mirë akoma, me asnjë drejtim, — shtoi Hejuordi.

Aleksi bëri sikur s'e dëgjoi këtë vërejtje të fundit. Ai i tha presidentit të bankës, me një buzëqeshje të ftohtë, që ishte më shumë një ngërdheshje:

— Patjetër.

— Faleminderit.

Aleksi ishte i sigurt se kjo kishte qenë fjala e fundit e Petërtonit për këtë çështje dhe se marrëdhëniet e tyre do të bëheshin përsëri normale, së paku në sipërfaqe. Për ato që ndodhnin nën sipërfaqe, ai ishte më pak i sigurt. Kishte të ngjarë që, këtej e tutje, në mendjen e Petërtonit dhe të disa të tjerëve, duke përfshirë disa anëtarë të këshillit, besnikëria e tij ndaj bankës të kishte anash një pikëpyetje; ose, mund të lindnin dyshime nëse qëndrimi i tij ishte sa duhej i rezervuar me njerëzit që shoqërohej.

Sidoqoftë, këto dyshime do të gjallëroheshin përsëri në mendjen e këshilltarëve nga fundi i vitit në vazhdim, në kohën kur Petërtoni do të dilte në pension dhe do të zgjidhej presidenti i ri. Dhe, ndërsa, në disa pikëpamje, këshilltarët ishin njerëz me mentalitet të gjerë, përkundrazi, në disa të tjera, ata tregoheshin të ngushtë në mendime dhe me paragjykime.

Përse? Pse të gjitha këto duhet të ndodhnin pikërisht në atë kohë?

Humori i tij i keq u theksua edhe më shumë, ndërsa Margoti i ngulte një vështrim pyetës dhe me një shprehje që pasqyronte shqetësim dhe pasiguri.

Ajo tha, me një pamje akoma dhe më serioze se më parë:

— E shoh se të kam nxjerrë telashe. Prandaj, të mos bëjmë sikur s'ka ndodhur asgjë.

Aleksi qe gati ta siguronte përsëri, por, pastaj, ndërroi mendje, duke e kuptuar se ky ishte një çast ndershmërie reciproke.

— Një gjë tjetër që duhet thënë, — vazhdoi Margoti, — është se kemi folur dhe më parë për këtë gjë, duke e ditur se mund të ndodhte dhe bëmë pyetjen nëse mund të mbeteshim po ai tip që jemi, domethënë të pavarur, dhe të vazhdonim të rrinim bashkë.

— Po, më kujtohet.

— Fakti është, — tha me keqardhje Margoti, — se nuk e prisja të ndodhte kaq shpejt.

Aleksi i hapi krahët, siç bënte shpesh, por ajo u tërhoq, duke tundur kokën.

— Jo, më parë, le të rregullojmë njëherë këtë çështje. Aleksi e kuptoi se marrëdhëniet e tyre, pa ndonjë paralajmërim dhe pa e dashur këtë asnjëri prej tyre, kishin përfunduar në krizë.

— Do të ndodhë prapë, Aleks. Të mos gënjejmë veten. Oh, jo me bankën, por me gjëra të tjera të ngjashme. Dhe unë dua të jem e sigurt se do ta përballoj atë dhe jo vetëm njëherë të vetme, me shpresën që të jetë hera e fundit.

Aleksi e dinte se kjo ishte krejt e vërtetë. Jeta e Margotit ishte plot me luftë e beteja dhe, në të ardhmen, do të vinin përleshje dhe beteja të tjera dhe, pastaj, akoma të tjera. Ndërkaq, edhe në rast se disa prej tyre nuk do të kishin të bënin me të, të tjerat do ta preknin dhe do të uahtronin ndikimin e tyre mbi të.

Po aq e vërtetë ishte dhe ajo që kishte theksuar Margoti se, për këtë çështje, ata kishin biseduar më parë: pikërisht para një jave e gjysmë. Por, në atë rast, biseda e tyre kishte qenë

abstrakte, zgjedhja ishte dukur e errët, në vend që të ishte e qartë dhe e përcaktuar, siç e kishin bërë ngjarjet e fundit.

— Një gjë që mund të bënim ne të dy, — tha Margoti, — është të ndaheshim tani që kemi kujtime të mira dhe s'na ka rrëmbyer akoma ndonjë valë e fuqishme. Pa asnjë ndjenjë mërie kundrejt njëri-tjetrit, por vetëm me një konkluzion të arsyeshëm. Në qoftë se do të bënim kështu, në rast se nuk do të shiheshim më dhe s'do të na shihnin më së bashku, kjo gjë do të merrej vesh shumë shpejt. Kështu ndodh gjithmonë. Dhe, ndonëse nuk do të mund të zhdukte atë që ka ndodhur, do ta lehtësonte për ty mjaft gjendjen në bankë.

Edhe kjo ishte e vërtetë, mendoi Aleksi. Ndjeu një tundim që ta pranonte ofertën, të hiqte nga jeta e tij, në një mënyrë të pastër e të shpejtë, një ndërlikim që kishte të ngjarë të rritej me kalimin e viteve. Dhe e pyeti përsëri veten: Pse vinin së bashku të gjitha këto vështirësi e probleme? Keqësimi i gjendjes së Silias, vdekja e Ben Roselit, lufta për pushtet, tortura e pamerituar, së cilës i ishte nënshtruar atë mëngjes... dhe, tani, Margoti dhe zgjedhja midis dy rrugëve. Përse?

Kjo pyetje bëri që ti vinte në mend diçka që kishte ndodhur vite më parë, kur kishte vizituar qytetin kanadez të Vankuverit. Një grua e re ishte hedhur nga dhoma e saj e hotelit, që ndodhej në katin e njëzetekatërt dhe, para se të kërcente, kishte shkruar me të kuq buzësh në xhamin e dritares: «Përse? Oh, përse?» Aleksi s'e kishte parë kurrë atë dhe, as më vonë, s'e kishte mësuar se cili kishte qenë problemi që ajo e kishte quajtur të pazgjidhshëm; mirëpo, ai kishte zënë dhomë në të njëjtin kat dhe një nëndrejtor i hotelit i kishte treguar dritaren e trishtuar, me shënimin me të kuq buzësh. Këtë gjë s'e kishte harruar kurrë.

Përse, oh, përse, zgjedhim na disa gjëra dhe jo disa të tjera? Ose, pse i zgjedh jeta ato? Pse, për shembull, ai ishte martuar me Silian? Pse ishte çmendur ajo? Pse i shmangej ai akoma ndarjes? Pse Margoti ndjente nevojën të ishte një aktiviste?

Pse ai ishte pothuajse i gatshëm ta humbiste Margotin? Deri në ç'masë kishte ai dëshirë të bëhej president i FMA-së?

Jo dhe aq shumë!

Mori një vendim energjik dhe hodhi tutje trishtimin. Në djall të venë të gjitha këto! As për hir të këshillit administrativ, as për ambicien e tij personale, nuk do të hiqte dorë kurrë nga liria e tij e veprimit dhe nga pavarësia e tij; ose, të hiqte dorë nga Margoti.

— Gjëja më e rëndësishme, — i tha ai asaj, — është pra kjo: ti do, siç e the pak më parë, një «konkluzion të arsyeshëm»?

Me lot në sy, Margoti u përgjigj:

— Natyrisht, jo.

— As unë, Margot. Dhe nuk do ta dua kurrë një gjë të tillë. Prandaj, le të jemi të gëzuar që ndodhi kjo, që provuam diçka dhe që s'do të kemi nevojë ta provojmë herë tjetër.

Kësaj radhe, kur Aleksi i hapi krahët, ajo nuk u tërhoq më.

— Rosko, more djalë! — tha në telefon i nderuari Harold Ostin, zëri i të cilit kishte një tingull vetëkënaqësie. — Fola me Xhorxhin e madh. Na ka ftuar të dy, të premten e ardhshme, për të luajtur golf në ishujt Bahama.

Rosko Hejuordi rrudhi buzët, me një pamje që shprehte dyshim. Ishte në studion e shtëpisë së tij, në Shejkër Hajts, një të shtunë pasdite të muajit mars. Para kësaj bisede telefonike, ai kishte qenë duke shqyrtuar një seri bilancesh financiare dhe dokumente të tjera ishin shpërndarë në dysheme, rreth kelltukut të tij prej lëkure.

— Nuk jam i sigurt nëse mund të lirohem kaq shpejt, ose të shkoj aq larg, — i tha të nderuarit Harold. — Nuk mund të propozojmë një takim në Nju Jork?

— Sigurisht, mund ta propozojmë, vetëm se do të ishim budallenj, sepse Xhorxhi i madh preferon Nasaun dhe i pëlqen të merret me punë tregtare në një fushë golfi: me punë të mëdha, ato që na interesojnë neve, me të cilat ai merret vetë, personalisht.

Asnjëri prej tyre s'kishte nevojë të përmendte mbiemrin e «Xhorxhit të madh», për të ditur se për kë ishte fjala dhe shumë të paktë ishin ata në industri, në banka ose në jetën publike) që mund ta kishin këtë nevojë.

Xh. Xh. Kuortermejni, president i Suprënejshnël Korporejshënit (SuNatKo) ishte një burrë trupmadh, krenar, që kishte më tepër fuqi se shumë kryetarë shtetesh dhe e ushtronte atë fuqi si një sovran. Interesat dhe ndikimi i tij shtriheshin në tërë botën, ashtu si dhe shoqëria aksionare që ai drejtonte. Brenda dhe jashtë SuNatKo-s, Kuortermejnin e admironin, e urrenin, i bënin lajka, e adhuronin si një idhull, ia kishin frikën.

Forca e tij qëndronte në veprimtarinë e tij të kaluar. Para tetë vjetëve, në sajë të disa manovrave të tij financiare, atë e kishin thirrur të ndihmonte Suprënejshnëlin, që, në atë kohë, po lëngonte dhe ishte i zhytur në hua. Gjatë kësaj periudhe tetëvjeçare, ai e kishte mëkëmbur pasurinë e shoqërisë, e kishte zmadhuar dhe rritur jashtë masës, kishte trefishuar kapitalin e saj financiar dhe katërfishuar dividentin. Aksionistët, që ishin bërë të pasur në sajë të tij, e adhuronin dhe i linin tërë lirinë e veprimit që donte. Sigurisht, kishte disa Kasandra që thoshin se ai kishte ngritur një perandori prej kartoni, mirëpo, bilancet financiare të SuNatKo-s dhe të shoqërive të vjetra të shumta, të lidhura e të varura prej saj (ato që Rosko Hejuordi po shqyrtonte kur i kishte telefonuar i nderuari Harold), vërtetonin të kundërtën në mënyrë të pakundërshtueshme.

Hejuordi kishte pasur dy takime me drejtorin e SuNatKo-s: njërin, shumë të shkurtër, në mes të një grumbulli njerëzish,

dhe, tjetrin, në apartamentin e tij, në një hotel, në Uashington së bashku me Harold Ostinin.

Shkaku i takimit të Uashingtonit kishte qenë raportimi, nga i nderuari Harold, i rezultateve të një misioni që ai kishte kryer për llogari të Suprënejshnëlit. Duke qenë se Hejuordi kishte mbërritur kur ata të dy e kishin përfunduar pjesën kryesore të bisedës, ai kishte mësuar vetëm se, në atë punë, kishte të bënte edhe qeveria.

Agjencia publicitare «Ostin» kishte për të gjithë vendin, publicitetin eskluziv të Distilerive Hepëlluajt, një firmë e varur nga Suprënejshnëli, por ishte e qartë se marrëdhëniet personale të të nderuarit Harold me Xh. Xh. Kuor-termejnin shkonin akoma dhe më tej.
Pavarësisht nga përmbajtja e raportit të Ostinit, ishte e qartë se ai ia kishte rregulluar humorin Xhorxhit të madh. Pas njohjes me Hejuordin, ai kishte vërejtur:
— Haroldi më tha se është këshilluar me bankën tuaj të vogël dhe se të dyve do t'ju pëlqente një fetë nga torta ime. Në rregull, së shpejti, do të flasim prapë.
Pastaj, pas një goditje të lehtë në sup të Hejuordit, kishte kaluar në çështje të tjera.
Kishte qenë pikërisht pas kësaj bisede me Xh. Xh. Kuortermejnin që, nga mesi i janarit — para dy muajve — Hejuordi kishte njoftuar komisionin e investimeve se kishte shumë të ngjarë që të filloheshin marrëdhënie treg-tare me SuNatKo-n. Më vonë, e kishte parë se ishte tre-guar pak i nxituar, por tani dukej se perspektivat ishin për-sëri të mira.
— Mirë, — i tha Ostinit në telefon. — Ndoshta do të mund të largohem nga banka të enjten, për një ditë a dy.
— Ja, kështu është më mirë, — u përgjigj zëri i të nderuarit Harold. — Çfarëdo që të kesh në plan, ajo nuk mund të jetë për bankën më të rëndësishme se kjo. Oh, harrova të të them

diçka: Xhorxhi i madh na dërgon avi-onin e tij personal.
Hejuordit i ndriti fytyra.
— Me të vërtetë? A është avion i shpejtë?
— Është një 707. E dija se do të kënaqeshe, — tha Harold Ostini me zë gazmor. — Prandaj do të nisemi të enjten në mesditë, do të kalojmë tërë të premten në Ba-hama dhe do të kthehemi të shtunën. Meqë ra fjala, si të duken bilancet e reja të SuNatKo-s?
— Isha duke i shqyrtuar, kur më more në telefon. — Hejuordi u hodhi një sy letrave të shpërndara rreth koll-tukut të tij. — Pacienti duket i shëndetshëm; bile, me shën-det shumë të mirë.
— Po e the ti, për mua është më se e mjaftueshme.
Ndërsa po e vinte receptorin në vend, te buzët e He-juordit u formua një buzëqeshje e lehtë dinake. Udhëtimi shumë i afërt, vetë qëllimi i tij dhe fakti se do të shkonte në ishujt Bahama me një avion personal, përbënin një te-më të këndshme që mund të përmendej ashtu, sa pa qëllim, gjatë një bisede. Nga ana tjetër, në qoftë se nga kjo dil-te diçka, prestigji i tij do të rritej në sytë e kështillit — ai nuk e harronte për asnjë çast këtë pikësynim, duke pasur parasysh karakterin e përkohshëm të emërimit të Xherom Petërtonit si president i FMA-së.Ishte gjithashtu i kënaqur që do të kthehej të shtunën. Kjo do të thoshte se nuk do të mungonte në ceremoninë fetare të shën Athanasit që do të zhvillohej në kishën e tij, ku ai, me cilësinë e një lektori laik, recitonte çdo të diel, me zë të qartë dhe solemn fragmentin e ditës.
Ky mendim i kujtoi se duhej ta përsëriste fragmentin që do të lexonte të nesërmen, siç e kishte zakon të bënte. Mori nga një raft vëllimin e trashë të Biblës së familjes dhe e hapi në faqen e duhur. Faqja e caktuar kishte proverba dhe përmbante një varg që i pëlqente veçanërisht: drejtësia e lartëson një komb,

kurse mëkata i diskrediton popujt.
Rosko Rejuordi mësoi shumë gjëra nga udhëtimi në ishujt Bahama.
Ai kishte pasur rastin, edhe më parë, të shihte nga afër luks përrallor. Sikurse shumica e funksionarëve të lartë të bankës, ai kishte marrëdhënie shoqërore me pasa-nikë të mëdhenj — klientë të bankës ose jo — të cilëve s'u bënin përshtypje shpenzimet, mjaft që të siguronin zbavitje dhe konfort princor. Pothuajse gjithmonë e kishte pasur zili lirinë financiare që ata gëzonin.
Por, Xh. Xh. Kuortermejni ua kalonte të gjithëve.
Avioni i tij reaktiv 707, që njihej për shkak të një Q-je të madhe në trupin dhe bishtin e tij, u ul në aero-portin ndërkombëtar të qytetit, pikërisht në orën e cak-tuar. Lëvizi përpara, gjer në pistë private, ku i nderu-ari Harold dhe Hejuordi zbritën nga limuzina që i kishte sjellë aty nga qendra e qytetit dhe hipën menjëherë lart, nga pjesa e prapme.
Në një hyrje, të ngjashme me një holl hoteli në mi-niaturë, u pritën nga një kuartet, i përbërë nga një meso-burrë i thinjur, me një përzierje autoriteti dhe respekti, që i vinin vulën e maxhordomit, dhe tri vajza të reja.
— Mirë se erdhët në bord, zotërinj, — tha maxhordomi.
Hejuordi u përgjigj me një lëvizje të kokës. Ai mezi e kishte vënë re atë, sepse e tërë vëmendja e tij ishte tërhequr nga gratë e reja — të tria rreth të njëzetave, me një bukuri që të zinte frymën. Ato po buzëqeshnin ëmbël. Hejuordi mendoi se njerëzit e Kuortermegnit duhet të kishin grumbulluar stjuardesat më të bukura nga shoqëria ajrore TWA, Junajtid dhe Emerikën, dhe, pastaj, nga ato të kishin zgjedhur këto të tria, që ishin si ajka e ushqimit më të pasur. Njëra nga vajzat ishte bionde, si mjal-ti; e dytë ishte brune dhe e treta kishte flokë të gjatë të kuqërremë. Të tria kishin këmbë të gjata,

trupa të zhdërvjellët dhe dielli u kishte dhënë një ngjyrë të shëndetshme prej bronzi. Kjo bënte kontrast me ngjyrën bezhë të zbetë të uniformës së tyre të shkurtër, elegante.

Uniforma e maxhordomit ishte po aq elegante. Mbi xhepin e vogël, në të majtë të gjoksit, të katër kishin një Q të qëndisur.

— Mirëdita, zoti Hejuord, — tha flokëkuqëremja. Zëri i saj, që kalonte në mënyrë të këndshme nga njëri ton në tjetrin, ishte i ngrohtë dhe të bënte për vete. — Unë jam Avrili. Kini mirësinë të më ndiqni. Do t'ju shpiej në dhomën tuaj.

Ndërsa Heuordi po e ndiqte, i habitur që flitej për një «dhomë», të nderuarin Harold po e përshëndetste biondja.

Hejuordi ndoqi Avrilin në një korridor, gjatë të cilit kishte shumë dyer.

Duke kthyer pak kokën anash, ajo tha:

— Zoti Kuortermrejn është duke bërë një banjë me avull dhe masazh. Do të vijë t'ju takojë më vonë, në sallon.

— Banjë me avull? Brenda në avion?

— Po, po. Është pikërisht mbrapa kabinës së komandës. Dhe ka edhe një banjë turke. Zoti Kuortermrejn i pëlqen të bëjë banjë turke ose me avull, kudo që të jetë, dhe e merr gjithnjë me vete masazhatorin e tij personal. — Avrili i drejtoi Hejuordit një buzëqeshje që të vishte sytë: — Në rast se dëshironi të bëni banjë dhe masazh, ka plot kohë për këtë gjatë fluturimit. Do të isha e gëzuar t'ju shërbeja unë vetë.

— Jo, faleminderit.

Vajza u ndal para një dere.

— Kjo është dhoma juaj, zoti Hejuord.

Në atë çast, avioni filloi të lëvizte. Hejuordi, i zënë në befasi, gati sa s'humbi ekuilibrin.

Me një lëvizje të shpejtë, Avrili e mbajti dhe, për një çast, trupat e tyre qenë shumë pranë njëri-tjetrit. Hejuordi pa gishtat e saj të gjatë e të hollë, me thonjtë të lyer me manikyr ngjyrë portokalli të errët; ndjeu shtrëngimin e saj delikat, por njëkohësisht të qëndrueshëm, si dhe një valë parfumi.

Avrili nuk ia hoqi dorën nga krahu.

— Do të ishte më mirë t'ju vija brezin e sigurimit, para shkëputjes së avionit nga toka. Kapiteni nxitohet gjithmonë Zotit Kuortermrejn nuk i pëlqen të humbasë kohë në aeroport.

Para syve të Hejuordit u shfaq një sallon i vogël luksoz, ku e futi vajza. Pastaj, e pa veten të ulur në një kanape të butë dhe shumë të rahatshme, për dy veta, ndërsa gishtat e saj, prekjen e të cilave e kishte provuar pak më parë, po i shtrëngonin në mes një brez sigurimi. Ndonëse nëpërmes brezit, ai i ndjente gishtat të lëviznin dhe ky nuk ishte një ndijim i pakëndshëm.

— Ja, gati!

Reaktivi po e shtonte tani shpejtësinë. Avrili tha:

— Në rast se s'keni kundërshtim, po rri këtu deri sa të ngrihemi në ajër.

U ul në kanape, pranë Hejuordit, dhe vuri gjithashtu një brez sigurimi.

— Jo, — tha Rosko Hejuordi. E ndjente veten të thashtisur, pa e kuptuar arsyen. — S'kam aspak kundërshtim.

Hodhi sytë rreth e rrotull. S'kishte parë kurrë, në një avion, dicka të ngjashme me këtë sallon të vogël, apo kabinë. Hapësira ishte shfrytëzuar më së miri, në mënyrë që të mos flijohej luksi. Tri faqe të sallonit ishin veshur me tik dhe dekoruar me motive të gdhendura me trajtën Q, të stolisur me gjethe të praruara. E katërta përbëhej nga një pasqyrë e vetme,

e cila e bënte hapësirën të dukej edhe më e madhe se sa ishte në të vërtetë. Në faqen nga e majta e Hejuordit ishte vendosur një tryezë pune, me të gjitha gjërat e nevojshme për të punuar, duke përfshirë një telefon me tastierë dhe një teletajp, në kambanën e tij prej qelqi. Pranë ishte një bufe e vogël, e mbushur me lloj-lloj shishesh, në trajta të zvogëluara. Në faqen prej pasqyre, përballë Hejuordit dhe Avrilit, ishte vendosur një ekran televizori, që mund të komandohej nga të dy krahët e kanapesë. Prapa këtij gjendej një derë që palosej në formën e fizarmonikës, e cila dukej se të shpinte në një sallë banjoje.

— A doni ta shihni shkëputjen tonë nga toka? — pyeti Avrili. Pa pritur përgjigjen, ajo preku butonat që komandonin televizorin dhe ekrani u ndez. Ishte e qartë se në pjesën e përparme të avionit duhet të ishte vendosur një telekamerë: në ekran u duk figura, e pastër dhe me ngjyra, e pistës sekondare, që përfundonte në një pistë më të gjerë. Kjo e fundit doli krejt në dukje, kur avioni kaloi tek ajo. Pa humbur kohë, avioni lëvizi me vrull përpara, ndërsa pista dukej sikur kalonte nën ta me shpejtësi prapë dhe, më në fund, shkau poshtë, ndërsa avioni shkëputej nga toka dhe ngrihej lart. Tani ishin në ajër. Rosko Hejuordi pati një ndijim sikur të ishte pezull në ajër dhe kjo nuk ndodhte vetëm për shkak të figurës në ekranin e televizorit. Kur, para tyre, shiheshin vetëm qielli dhe retë, Avrili e mbylli aparatin.

— I merr të gjitha kanalet televizive, — i shpjegoi Hejuordit. Pastaj, tregoi me dorë teletajpin. — Edhe ai mund të lidhet me kanalet e agjencive të shtypit dhe me rrjetin e teleksit. Po të keni nevojë për të, mjafton të telefononi në kabinë dhe thoni kanalin që doni.

Hejuordi vërejti me ngurrim:

— Të gjitha këto e kalojnë pakëz përvojën time normale.

— E di. Këtë efekt bën nganjëherë, por është e çuditshme se me sa shpejtësi adaptohen të gjithë. — Përsëri, vështrimi me ngulm dhe buzëqeshja që të bënte për vete. — Kemi katër kabina të veçanta, si kjo këtu dhe, secila, kthehet shumë lehtë në dhomë fjetjeje. Mjafton të shtypet një buton. Në rast se doni, po e bëj ta shihni.

Hejuordi tundi kokën,

— Tani për tani, nuk më duket e nevojshme.

— Si të dëshironi, zoti Hejuord.

Avrili e hoqi brezin e sigurimit dhe u ngrit. — Po të doni zotin Ostin, ai është në kabinën këtu, prapa kësaj. Pak më tutje, gjatë korridorit, është dhoma kryesore e ndenjies, ku do të jeni i mirëseardhur, kur të jeni gati. Pastaj është dhoma e ngrënies, disa zyra dhe, më në fund, apartamenti privat i zotit Kuortermejn.

— Faleminderit për mësimin e gjeografisë. — Hejuordi hoqi syzet dhe nxori shaminë për të pastruar xhamat.

— Oh, ma lini mua ta bëj këtë! — Me mirësjellje, por edhe me njëfarë vendosmërie, Avrili ia mori syzet nga dora dhe i pastroi me një copë mëndafshi katrore. Pastaj, ia vuri përsëri, me gishtat që i lëvizte lehtë-lehtë, prapa veshëve të tij. Hejuordi mendoi se, ndoshta, duhet të protestonte, por nuk tha gjë.

— Gjatë këtij udhëtimi, zoti Hejuord, detyra ime është të kujdesem vetëm për ju dhe të sigurohem se keni gjithçka që dëshironi.

Hejuordi i bëri vetes pyetjen nëse ishte një trillim i imagjinatës së tij, apo vërtet ajo e kishte theksuar mbi fjalën «gjithçka». Me njëfarë përpjekje, i uroi vetes që të mos kishte qenë ashtu. Në rast të kundërt, ndërlikimet do të ishin mjaft shqetësuese.

— Edhe dy gjëra të tjera, — vazhdoi Avrili. — Ajo po shkonte drejt derës, me trupin e derdhur dhe madhështor. — Në qoftë se keni nevojë për mua, shtypni butonin shtatë te telefoni.

Hejuordi u përgjigj, me ton të vrazhdë:

— Faleminderit, zonjushë, por besoj se s'do të jetë nevojë.

Ajo qëndroi krejt indiferente.

— Dhe, tjetra është: — Në udhëtim e sipër për në Bahama, do të bëjmë një ndalesë të vogël në Uashington, për të marrë nënpresidentin.

— Një nënpresident të Suprënejshnëlit?

Sytë e saj po e shikonin tani me qesëndi.

— Jo, budalla i vogël! Nënpresidentin e Shteteve të Bashkuara.

Pas nja pesëmbëdhjetë minutash, Xhorxh Kuortermejni po e pyeste Rosko Hejuordin:

— O zot, por ç'djalë po ashtu? Qumësht të mamit?

— Është limonatë. — Hejuordi ngriti gotën, duke e vështruar pijen e rëndomtë. — Mua më pëlqen.

Presidenti i Suprënejshnëlit ngriti supet e mëdha.

— Çdo njeri është mësuar me helmin e vet. A janë kujdesur vajzat për ju të dy?

— Asnjë ankesë nga ajo anë, — u përgjigj me një të qeshur i nderuari Harold Ostini. — Si të tjerët, ishte mbështetur në një kolltuk të rehatshëm, në sallonin luksoz të avionit 707. Të këmbët e tij, në sixhade, ishte ulur biondja që i kishte thënë se e quanin Rita.

Avrili tha me zë të ëmbël:

— Po bëjmë ç'mundemi. — Ajo ishte në këmbë, prapa kolltukut të Hejuordit, dhe e kalonte dorën lehtë në shpinën e tij. Ai i ndjeu gishtat në fundin e qafës së tij, ku u ndalën për një çast dhe, pastaj, filluan të lëvizin përsëri.

Para disa çastesh, Xh. Xh. Kuortermejni kishte hyrë në sallon, tërë shkëlqim, i mbështjellë me një peshqir të madh me ngjyrë të kuqe të errët, me buzë të bardha dhe me Q-të e pashmangshme të qëndisura kudo. Dukej si një senator i lashtë romak. Ndiqej nga dy veta: një burrë i heshtur, me fytyrë të ashpër, që kishte veshur një tutë të bardhë gjimnastike — me sa dukej, do të ishte masazhatori — dhe një stjuardesë e katërt, me tiparet delikate japoneze, edhe kjo me një uniformë elegante ngjyrë bezhë të errët. Masazhatori dhe vajza u interesuan për ta ulur Xhorxhin e madh në një kolltuk shumë të gjerë, të ngjashëm me një fron, që dukej qartë se ishte rezervuar për atë. Më në fund, një personazh i tretë, që kishte pritur në fillim mysafirët, kishte dalë në mes të tyre, si me magji, duke sjellë një martini të ftohtë për Xh. Xh. Kuortermejnin.

Nofka «Xhorxhi i madh» i dukej tani Rosko Hejuordit akoma më e përshtatshme se në rastet e mëparshme, kur ishte takuar me të. Nga ana fizike, i zoti i shtëpisë ishte sa një mal — së paku një metër e nëntëdhjetë e pesë i gjatë, me gjoksin e krahët si ata të një kovaci fshati. Koka e tij ishte pesëdhjetë për qind më e madhe se ajo e të tjerëve. Edhe tiparet e tjera ishin në përpjesëtim: sy të mëdhenj, të errët, të dalë, shumë të lëvizshëm dhe depërtues, buzë të trasha dhe të forta, që dukeshin të mësuara të jepnin urdhra, si ato të një rreshteri stërvitjeje të marinës, por për të dhënë urdhra në çështje më të rëndësishme. Veç kësaj, shihje qartë se përzemërsia e sipërfaqshme e tij mund t'ia lëshonte vendin në çast një pakënaqësie të fortë e të vrullshme.

Megjithatë, tek ky trup i madh s'shihje në asnjë shenjë peshe të tepërt. Forma e muskujve dallohej nën peshqirin, me të cilin ishte mbështjellë. Në fytyrë nuk dukeshin shenja

dhjami dhe poshtë mjekrës së tij të fuqishme nuk kishte pala të gushës. Barkun e kishte të sheshtë e të tërhequr.

Përsa i përket llojit tjetër të madhësisë, fusha e veprimit e Kuortermejnit dhe lakmia e tij ndiqeshin dita-ditës nga shtypi financiar. Dhe standardi i jetës së tij në bordin e këtij avioni prej dymbëdhjetë milionë dollarësh, mund të quhej, pa gabuar, si diçka mbretërore.

Masazhatori dhe maxhordomi u zhdukën heshtazi dhe u zëvendësuan nga kryekuzhinieri, tamam sikur të qe fjala për një personazh tjetër, të cilit t'i vinte radha të dilte në skenë. Ky ishte i thatë, si një stekë bilardoje, i zbehtë, me fytyrë të mërzitur, me një uniformë të pastër, të bardhë kuzhine, skufja e lartë e së cilës gati prekte tavanin e kabinës. Hejuordi po pyeste veten se prej sa vetash përbëhej personeli i bordit. Më vonë, mësoi se ata ishin gjashtëmbëdhjetë.

Kryekuzhinieri e drejtoi trupin kur u gjend para kolltukut të Xhorxhit të madh, duke nxjerrë përpara një dosje të madhe prej lëkure të zezë, që kishte në reliev një Q të artë. Xhorxhi i madh hodhi një vështrim dhe një vështrim.

— Ajo ngatërresa te banka jote... — filloi Kuortermejni, duke iu drejtuar Hejuordit. — Demonstratat. Të gjitha të tjerat. A është vënë gjithçka në rregull? Është e fuqishme, tani, banka?

— E fuqishme ka qenë gjithnjë, — u përgjigj Hejuordi. — Askush s'ka dyshuar për këtë.

— Tregu aksionar s'ishte i këtij mendimi.

— Dhe, që kur ka filluar tregu aksionar të jetë barometër i saktë i ndonjë gjëje?

Xhorxhi i madh buzëqeshi lehtë dhe iu drejtua stjuardesës trupvogël japoneze.

— Rrezehënë, më sill kuotat e fundit të FMA-së.

— Po, zoti K, — tha vajza dhe doli me hap të shpejtë.

Xhorxhi i madh bëri shenjë me kokë nga dera.

— Nuk mundet akoma të shqiptojë emrin tim. Më thotë gjithmonë «Zoti K». — Bëri një ngërdheshje. — Por, për të gjitha të tjerat, ia thotë për bukuri.

Rosko Hejuordi u nxitua të thoshte:

— Gjërat që ke dëgjuar për bankën tonë kishin të bënin me një episod banal, të zmadhuar pa masë. Veç kësaj, kjo ndodhi në një kohë, kur po bëheshin ndryshime në drejtimin e bankës. — Mirëpo, ju s'qëndruat të patundur në vendimet tuaja, — nguli këmbë Xhorxhi i madh. — Lejuat që agjitarorët të jashtëm të arrinin qëllimet e tyre. U treguat të dobët dhe u dorëzuat.

— Po, ashtu ndodhi. Dhe ta them sinqerisht se unë nuk isha i një mendjeje. Bile, kundërshtova gjer në fund.

— U duhet bërë gjithnjë ballë atyre dobiçëve! Duhen shtypur në një mënyrë a në një tjetër! S'duhet tërhequr asnjëherë! — Presidenti i Suprënejshnëlit e piu martinin me një gllënjkë. Maxhordomi, që s'u mor vesh se nga doli, mori nga dora e Xhorxhit të madh gotën bosh dhe e zëvendësoi me një tjetër. Gota e veshur tregonte se pija ishte ftohur aq sa duhej.

Kryekuzhinieri po qëndronte akoma në këmbë, në pritje. Kuortermlejni vazhdoi ta injoronte. Tha, nëpër dhëmbë, me tonin e një njeriu që sjell ndërmend ngjarje të kaluara:

— Kishim një stabiliment montimi afër Denverit. Ndodhën plot ngatërresa nga shoqatate punëtorëve. Kërkesa të paarsyeshme për ngritje pagash. Në fillim të këtij viti, sindikata shpalli një grevë, e fundit e një vargu të gjatë. I thashë ndërmarrjes pronare të stabilimentit, e cila është degë e jona, t'i njoftonin ata dobiçë se do ta mbyllnim stabilimentin.

Askush s'deshi të na besonte. Atëherë, bëmë studimet dhe përgatitjet e duhura dhe ia dërguam stampat dhe makinat një dege tjetër, tonës, që ishte në gjendje ta kryente këtë punë suplementare. Stabilimentin në Denver e mbyllëm. Kështu, befas, s'kishte më as stabiliment, as vende pune dhe as paga. Tani të gjithë: nëpunës, sindikatë, këshill bashkiak, qeveri, na luten në gjunjë ta hapim prapë stabilimentin — Shikoi gotën e martinit dhe, pastaj, shtoi me zemërgjerësi: — Mirë. Këtë dhe mund ta bëjmë. Një sektor tjetër produktiv dhe, me kushtet tona. Por, sidoqoftë, ne nuk u dorëzuam...

— Ju lumtë, Xhorxh! — tha i nderuari Harold. — Duhej të kishte edhe të tjerë kështu si ti. Mirëpo, gjendja në bankën tonë ishte pak e ndryshme. Me disa aspekte, jemi akoma në një periudhë kalimtare, që, sikurse e di, filloi me vdekjen e Ben Roslit. Por, brenda pranverës së vitit të ardhshëm, shumë nga ne, këshilltarët, shpresojmë ta shohim Roskonë me timonin mirë në dorë.

— Gëzohem që e dëgjoj këtë. Nuk kam qejf të jap e marr me njerëz që nuk janë në krye. Ata, me të cilët trajtoj çështjet tregtare duhet të jenë në gjendje të marrin vendime dhe të bëjnë që ato të respektohen.

— Të siguroj, Xhorxh, — tha Hejuordi, — se banka do të bashkohet me çdo vendim që do të mund të marrim ne të dy.

Ai e kuptoi se i zoti i shtëpisë kishte vepruar me aftësi, duke e vënë Harold Ostinin, si dhe vetë atë, në rolin e kërkuesve, që është antiteza e rolit normal të bankierëve. Por fakti ishte se një hua e dhënë Suprënejshnëlit nuk do të shkaktonte as kokëçarjen më të vogël dhe do të ishte një burim prestigji për FMA-në. Një rëndësi po aq të madhe kishte fakti se një veprim i tillë mund të ishte parardhësi i një vargu të tërë, meqenëse SuNaTKo-ja përbënte një shembull, që shumë industri e ndiqnin në mënyrë të verbër.

Xhorxhi i madh u kthye befas nga kryekuzhinieri. — Si është puna?

Personazhi i veshur me të bardha u gjallërua dhe i zgjati dosjen prej lëkure të zezë, që vazhdonte ta mbante në dorë që kur kishte hyrë.

— Mënyja, monsieur. Për t'u miratuar.

Xhorxhi i madh nuk denjoi as ta merrte në dorë dosjen, por e shqyrtoi përmbajtjen e saj, ndërsa kryekuzhinieri ia mbante përpara, të hapur. Në një farë pike, i dha një të goditur me gishtin e shtrirë.

— Ndryshoje këtë sallatë Uolldorf, me një Çezar.

— Oui, monsieur.

— Dhe ëmbëlsirën. Jo Glacé Martinique. Një Soufflé Grand Marnier.

— Pa tjetër, monsieur.

I bëri me shenjë se ishte i lirë, pastaj, ndërsa kryekuzhinieri po kthehej për t'u larguar, Xhorxhi i madh shpërtheu me zemërim: — Dhe kur kërkoj bëftek, si e dua unë?

— Monsieur... — Kryekuzhinieri bëri një gjest lutës me dorën e lirë. — Ju kërkova dy herë ndjesë për incidentin e mbrëmshëm.

— Nuk është fjala për këtë. Pyetja që të bëra është: Si e dua?

Me një mbledhje supesh krejt franceze, kryekuzhinieri u përgjigj, pikërisht sikur po përsëriste një mësim të mësuar:

— Të pjekur mirë, por akoma me gjak.

— Mirë, mbaje mend.

Kryekuzhinieri tha, me zë të dëshpëruar:
— Si mund ta harroj, monsieur? — dhe doli me bisht ndër shalë.
— Një gjë tjetër e rëndësishme, — u tha Xhorxhi i madh mysafirëve të tij, — është të mos lihen njerëzit të bëjnë si t'u

dojë qejfi. Unë e paguaj atë bretkosë, sa s'ia vlen lëkura, që ta dijë tamam se si më pëlqen mua ushqimi. Ai e shkeli mbrëmë; jo dhe aq shumë, por mjaft sa të meritonte një qortim të mirë. Në këtë mënyrë, do ta mbajë mend për herë tjetër. Sa ishte kuota? — Rrezehëna ishte kthyer në atë çast, me një fletë në dorë.
— FMA-ja kuoton tani me dyzet e pesë e tre të katërtat, — lexoi vajza, me një theks të fortë japonez.
— Ja, pra, — tha Rosko Hejuordi, — jemi ngritur edhe një pikë tjetër.
— Por jo akoma në nivelin që ishte para se Roseli t'i thoshte lamtumirë kësaj bote, — vërejti Xhorxhi i madh. Ai u ngërdhesh. — Por, kur të merret vesh se po kontribuoni për të financuar Suprënejshnëlin, aksionet tuaja do të ngrihen shumë.
Kjo mund të ndodhë, mendoi Hejuordi. Në botën e ngatërruar të bursës ndodhin gjërat më të pashpjegueshme. Fakti se dikush do t'i jepte hua një tjetri, mund të dukej pa ndonjë rëndësi të madhe... e megjithatë, tregu aksionar kundërvepronte.
Ndërkaq, shumë më i rëndësishëm ishte fakti se Xhorxhi i madh e kishte thënë hapur se njëfarë marrëveshje tregtare do të përfundohej midis Fërst Merkëntajll Ëmeriken Benkut dhe SuNatKo-s. Pa dyshim, hollësitë do të diskutoheshin gjatë dy ditëve të ardhshme. Hejuordi e ndjente se si po i rritej entuziazmi.
Në atë çast, një zile tingëlloi lehtë mbi kokat e tyre. Buçitja e motorëve po pakësohej.
— Mbërritëm në Uashington, — tha Avrili. Ajo dhe vajzat e tjera filluan të sigurojnë burrat në kolltukët e tyre përkatës, me breza të rëndë dhe gishta të lehtë.
Qëndrimi në aeroportin e Uashingtonit qe akoma më i shkurtër se ai i mëparshmi. Me sa dukej, me një pasagjer VIP! 14 karatësh dukej se ishte e siguruar përparësia për uljen, ecjen në pistë dhe ngritjen.

Në këtë mënyrë, më pak se njëzet minuta, avioni ishte ngritur përsëri dhe po fluturonte drejt ishujve Bahama.
Vajza brune, Krista, ishte ngarkuar të kujdesej për nënpresidentin e Shteteve të Bashkuara dhe ky i fundit dukej shumë i kënaqur nga kjo gjë.
Njerëzit e shërbimit sekret, që përbënin rojën e nënpresidentit, ishin sistemuar diku nga pjesa e prapme e avionit.
Mbas pak, Xhorxhi i madh Kuortermjen, që ishte veshur tani me një tunikë të mrekullueshme mëndafshi ngjyrë krem, udhëhoqi gëzueshëm të tjerët nga salloni te dhomat e ngrënies së avionit, një sallë e mobiluar dhe zbukuruar me luks të madh, në të cilën mbizotëronin ngjyra e argjendtë dhe bluja e errët. Atje, të katër burrat, të ulur te një tryezë lisi të gdhendur, poshtë një lampadari prej kristali, — ndërsa Rrezehëna, Avrili, Rita dhe Krista lëviznin këndshëm prapra tyre, — hëngrën një drekë, niveli i shërbimit dhe i kuzhinës së të cilës ishte i tillë, që, edhe restorantet më të mira me famë botërore, do ta kishin vështirë ta arrinin.
Rosko Hejuordi, ndërsa hante nga të gjitha ushqimet, nuk i prekte fare verërat e ndryshme dhe as konjakun tridhjetëvjeçar, që u shërbye në fund të ngrënies. Megjithatë, nuk i shpëtoi pa e vënë re se, në vend të N-së tradicionale të Napoleonit, gotat e rënda me buzë të praruara kishin të gdhendur një Q.

Një diell i ngrohtë, në një qiell blu e krejt pa re, shkëlqente mbi pistën me bar, që çonte në vrimën e pestë të fushës së golfit të Klubit Fordi Klej, në ishujt Bahama;
Fusha dhe klubi që ndodhej pranë saj ishin nga më luksozët dhe më të vlerësuarit në botë.
Përtej fushës së golfit, në largësi, shtrihej një plazh i bardhë, i shkretë, i rrethuar nga ana e brendshme me palma, si një rrip parajse. Një det i shndritshëm, ngjyrë qielli, përkëdhelte ëmbëlsisht buzën e plazhit me valë të vogla. Afro një kilometër nga bregu, një vijë e përbërë prej shkëmbinjsh të

nënujshëm, shkumonte mbi gumat prej korali. Më pranë, në anë të fushës së golfit, shtrihej një qilim lulesh ekzotike, me një bukuri të rrallë — hibiske, bugenvile, poinsetia, frangipani — që dukej sikur luftonin se cila të merrte ngjyrat më të ëmbla.
Ajri i freskët dhe i pastër, i vënë në lëvizje nga një fllad i lehtë, kundërmonte me një aromë jasemini.
— Mendoj, — vërejti nënpresidenti i Shteteve të Bashkuara, — se ky është vendi më afër parajsës, ku mund të arrijë një politikan.
— Koncepti im i parajsës, — ia priti i nderuari Harold Ostin, — nuk i përfshin goditjet e këqija të topit. — U ngërdhesh dhe rrotulloi me forcë në ajër shkopin e tij prej hekuri numër katër, që kishte në dorë. — Duhet të ketë ndonjë mënyrë për t'ia dalë në krye më mirë kësaj loje.
Të katër ata po zhvillonin një ndeshje, fituesit e së cilës do të përcaktoheshin nga numri më i vogël i goditjeve për të gjitha vrimat. Ata ishin ndarë në çifte — Xhorxhi i madh dhe Rosko Hejuordi kundër Harold Ostinit dhe nënpresidentit.
— E di se çfarë duhet të bësh, Harold? — i tha nënpresidenti, Bajron Stounbrixh. — Duhet të kthehesh në Kongres dhe, pastaj, të çash përpara deri në postin që kam unë. Kur të kesh arritur aty, nuk do të kesh punë tjetër, përveçse golfit. Do të kesh në dispozicion tërë kohën që do të duash, për të përmirësuar lojën tënde. Është një e vërtetë historike, botërisht e pranuar, se këta pesëdhjetë vjetët e fundit, pothuajse të gjithë nënpresidentët, në mbarim të mandatit të tyre, ishin më të zotë në golf sesa kishin qenë në fillim të tij. Si për t'i vërtetuar fjalët e veta, ai bëri mbas një çasti goditjen e tretë, me shkopin prej hekuri numër tetë, një goditje shumë e bukur, drejt e te flamuri i vogël.
Me një trup të zhdërvjellët e të shkathët dhe lëvizje plot

gjallëri, Stounbrixhi po zhvillonte një lojë shumë të mirë. Ai kishte lindur në fshat dhe ishte mësuar, që fëmijë, të punonte disa orë në ditë në pronën e familjes dhe, vite me radhë, e kishte mbajtur trupin në formë të mirë.
Në atë çast, tiparet e fytyrës së tij, pak të shëmtuara, u çelën kur topi ra përsëri në tokë, u rrokullis dhe u ndal vetëm një pëllëmbë nga vrima.
— Jo keq, — tha Xhorxhi i madh, ndërsa karreli me shkopinjtë e golfit i erdhi pranë. — Duket se nuk je i mbytur në punë në Uashington, apo jo Baj?
— Oh, s'është për t'u qarë. Muajin e kaluar u mora me mbajtjen në rregull të një numri artikujsh dhe të dhënash, të nxjerra nga gazeta zyrtare. Nga ana tjetër, ndodhi dhe një dekonspirim i ri në Shtëpinë e Bardhë. Me sa duket, ka mundësi që së shpejti të më lënë atje të dredh zinxhirin.
Të tjerët qeshën me mirësjellje. Nuk ishte gjë që s'dihej që Stounbrixhi, ish-guvernator shteti, ish-kryetar i pakicës në Senat, nuk ishte shumë i kënaqur me rolin e tij të tanishëm. Para zgjedhjeve që e kishin ngritur në atë post, kandidati për president kishte deklaruar se donte të përunte një epokë të re pas Uotergejtit, në të cilën nënpresidenti do të kishte një rol aktiv në qeverisjen e vendit. Më vonë, siç ndodh gjithnjë, premtimi kishte mbetur në letër.
Hejuordi dhe Kuortermejni mbërritën gjithashtu te grini ku qëndruan një kohë met Stounbrixhin, ndërsa i nderuari Harold luante i shkujdesur dhe, më në fund, e çoi topin në grin.
Të katër burrat formonin një katërshe heterogjene. Xh. M. Kuortermejni, shumë më i gjatë se të tjerët, ishte veshur shumë mirë dhe me rroba të shtrenjta: pantallona tartan dhe një pulovër Lacoste cardigan. Në kokë mbante një kasketë të kuqe golfi, distinktivi i së cilës vërtetonte se ishte anëtar i

klubit Fordli Kej, gjë që lakmohej shumë.
Nënpresidenti i Shteteve të Bashkuara ishte veshur me një elegancë të përsosur: pantallona prej stofi të thurur, këmishë blu të hapur dhe këpucë bardhë e zi. Harold Ostini përbënte një kontrast të fortë, me një kombinim ngjyrash të ndezura, jargavani dhe trëndafili. Rosko Hejuordi, praktik si gjithmonë, kishte veshur pantallona bojë hiri të errët, këmishë të bardhë me mëngë të shkurtra dhe këpucë të zeza, të lehta. Edhe në një fushë golfi, ai kishte pamjen e një bankieri.

Ecja e tyre përpara, që nga pika e parë ku fillohej loja, kishte qenë si njëfarë kortezhi. Xhorxhi i madh dhe Hejuordi përdornin një karrel elektrik; Stounbrixhi dhe i nderuari Harold, një tjetër. Gjashtë makina elektrike ishin marrë nga njerëzit e shërbimit sekret që shoqëronin nënpresidentin dhe që i rrethonin tani lojtarët përpara, prapa, në të dy krahët, si një skuadrilje kaçatorpedinerësh.

— Dëgjo, Baj, — i tha Rosko Hejuordi. — Në qoftë se do të kishe mundësinë të vendosje mbi përparësinë e masave qeveritare, cilat do të zgjidhje?

Një ditë më parë, Hejuordi ishte drejtuar Bajron Stounbrixhit në mënyrë zyrtare, duke i thënë «zoti nënpresident», por ky ia kishte pritur menjëherë: «T'i lëmë formalitetet dhe le t'i drejtohemi njëri-tjetrit me ti. Veç kësaj... unë kënaqem kur më thërrasin Baj.» Hejuordi, të cilit i pëlqente pa masë t'u drejtohej me ti personave të rëndësishëm, e kishte ndier veten shumë të kënaqur.

Stounbrixhi u përgjigj:
— Po të mund të zgjidhja lirisht, do të përqendrohesha në çështjet ekonomike: rimëkëmbjen e gjendjes financiare, ekuilibrimin e bilancit kombëtar, e kështu me radhë.

Xh. M. Kuortermiejni, që e kishte dëgjuar bisedën e tyre, vërejti: — Janë munduar ta bëjnë këtë disa persona të

guximshëm, Baj, dhe kanë dështuar. Tanimë, është tepër vonë.

— Është vonë, Xhorxh, por jo tepër vonë.
— Do të më pëlqente ta diskutojta këtë çështje me ty. — Xhorxhi i madh u ul galiç, duke menduar goditjen që do të bënte. — Mbas vrimës së nëntë. Tani, përparësi ka futja në vrimë e këtij topi.

Që nga fillimi i lojës, Kuortermiejni kishte qenë më i heshtur se të tjerët dhe më i vëmendshëm në lojë. Kishte një hendikep[1]) prej vetëm tri pikash dhe luante gjithnjë për të fituar. Të fitonte, ose të fuste një top në vrimë, me një numër goditjesh më të vogël se «norma», i shkaktonte të njëjtën kënaqësi (kështu thoshte vetë ai) që ndjente kur Siprejmëshnëli gllabëronte një ndërmarrje tjetër.

Hejuordi luante me kompetencë të qartë: pa asnjë veprim që të binte në sy, por edhe pa asnjë që ta bënte të turpërohej.

Ndërsa të katër shkuan nga karrelet e tyre te pikënisja e gjashtë e lojës, Xhorxhi i madh i tha Hejuordit:
— Mbaji hapur sytë e tu prej bankieri mbi rezultatet e atyre të dyve, Rosko. Saktësia nuk është zakon i natyrshëm për një politikan ose një njeri që merret me publicitet.

— Pozita ime kërkon që të fitoj unë, — vërejti nënpresidenti, — me çdo kusht.

— Oh, rezultatet i mbaj mend unë. — Rosko Hejuordi i ra ballit me dorë. — Këtu i kam të gjitha. Të vrima e parë, Xhorxhi dhe Baji bënë nga katër goditje; Haroldi gjashtë dhe unë një më shumë se normalja. Te vrima e dytë, të gjithë dolëm barabar, me përjashtim të Bajit, që, në mënyrë të pabesueshme, arriti të njëjtin rezultat me një goditje më pak. Të gjithë dolën barabar edhe te vrima e tretë, me përjashtim të Haroldit, të cilit përsëri iu deshën gjashtë goditje. Vrima e katërt qe sukses për ne: me katër goditje Xhorxhi dhe unë, me pesë goditje Baji dhe shtatë Haroldi. Dhe, kjo vrimë e fundit, natyrisht, qe një katastrofë e vërtetë për Haroldin; mirëpo,

partneri i tij mundi të bëjë një goditje tjetër më mirë se ne. Kështu që, gjer tani, ndeshja është barabar.

Bajron Stounbrixhi ia nguli sytë me çudi.
— Kjo është fantastike, gati e pabesueshme.
— E gabove rezultatin tim te vrima e parë, Rosko, — tha i nderuari Harold. — Unë bëra pesë goditje, jo gjashtë.

Hejuordi ia priti, me ton të vendosur:
— Nuk ishte ashtu, Harold. Përpiqu të kujtohesh: Me goditjen e parë, e çove topin atje, te koria e palmave dhe, pastaj, bëre goditjen tjetër për ta nxjerrë. Pas kësaj, bëre goditjen e tretë me shkopin prej druri, por topi nuk arriti te ngastra me bar. Goditjen e katërt e bëre tepër të gjatë dhe, për ta futur topin në vrimë, t'u deshën dy goditje.

— Ke të drejtë, Rosko, — tha Stounbrixhi. — Edhe mua më kujtohet.
— Djall o punë, Rosko, — protestoi Haroldi. — Pa më thuaj, miku i kujt je ti?

— Imi, për perëndi! — thirri Xhorxhi i madh. I hodhi krahun miqësisht Hejuordit dhe i tha: — Ke filluar të më pëlqesh, Rosko, dhe sidomos më pëlqen qëndrimi yt i përmbajtur! — Ndërsa Hejuordi po skuqej, Xhorxhi i madh e uli zërin deri në pëshpëritje, ashtu siç bëhet kur thuhen të fshehta, dhe vazhdoi: — A ishte gjithçka e kënaqshme mbrëmë?

— Krejtësisht e kënaqshme, faleminderit. Udhëtimi kaloi më së miri; mbrëmja e shkëlqyeshme dhe fjeta shumë mirë.

Në të vërtetë, në fillim, Hejuordi s'kishte fjetur mirë; bile, mezi e kishte zënë gjumi. Gjatë pasdites së mëparshme, në shtëpinë e Xh.Xh. Kuortermejnit ishte parë gjithnjë e më qartë se Avrili, flokëkuqja-e-zhdërvjellët dhe e lezetshme, ishte në dispozicion të Rosko Hejuordit për çdo gjë që ai të dëshironte. Kjo shihej qartë, si nga aluzionet e vazhdueshme

të të tjerëve, ashtu edhe nga fakti se vetë Avrili i ngjitej pas gjithnjë e më shumë. Ajo përfitonte nga çdo rast për t'u përkulur nga ai, në mënyrë që flokët e saj të butë t'i çiknin fytyrën dhe përdorte nga preteksti më i vogël, që trupat e tyre të prekeshin. Ishte e vërtetë se Hejuordi nuk e nxiste, por ai, gjithashtu, as nuk tërhiqej.

Po aq qartë shihej se Krista e bukur ishte në dispozicion të Bajron Stounbrixhit dhe, Rita bionde e tërheqëse, në atë të Harold Ostinit.

Japonezja shumë e bukur, Rrezehëna, rrallë gjendej më larg se një a dy hapa nga Xh.Xh. Kuortermejni.

Banesa e Xhorxhit të madh, njëra nga pesë a gjashtë banesat që presidenti i Suprejnëshnëlit kishte në vende të ndryshme, gjendej në kodrën Prospero, mbi Nasaun, prej nga shihej një panoramë e mrekullueshme e detit dhe e ishullit. Shtëpia ndodhej në mes të një parku natyror, i cili ishte rrethuar me mure të larta prej guri. Dhoma e Hejuordit, në katin e dytë, ku e kishte shoëruar Avrili pas mbërritjes së tyre, kishte pamjen më të bukur. Prej aty, nëpërmes drurëve, dukej edhe banesa e fqinjit, e kryeministrit, e mbrojtur nga një patrullë e policisë mbretërore të Bahamas.

Pasdite vonë, ata u mblodhën pranë pishinës, të rrethuar nga një portik me kolona. Pastaj hëngrën darkën jashtë, në tarracë, në dritën e qirinjve. Në këtë kohë, vajzat, që i kishin hequr uniformat e tyre dhe kishin veshur fustane të mrekullueshme mbrëmjeje, ishin ulur në tryezë me burrat. Në darkë shërbenin kamerierë me doreza të bardha, ndërsa për muzikën kishte dy instrumentistë ambulantë. Afrimi i çifteve dhe i tërë grupit ishte bërë edhe më i ngushtë, nëpërmes bisedës së këndshme.

Mbas darkës, ndërsa Stounbrixhi dhe Krista vendosën të rrinin në shtëpi, të tjerët u nisën me tri Rolls-Rojsët që i pritnin sjellë nga aeroporti i Nasaut dhe shkuan në kazinon e Ishullit të Parajsës. Atje, Xhorxhi i madh filloi të luante me

shuma të mëdha dhe dukej se po fitonte. Ostini kishte vënë nganjëherë ndonjë shumë të vogël, ndërsa Rosko Hejuordi s'kishte marrë pjesë fare. Hejuordi ishte kundër lojës së kumarit, por dëgjonte me interesim shpjegimet e Avrilit mbi misteret e skëmë dë fer-it, ruletës dhe bllekxhekut, që ishin të panjohura për të. Për shkak të pështpëritjes konfuze të bisedës së të tjerëve, ndërsa fliste, Avrili e mbante fytyrën pranë fytyrës së tij, siç kishte ndodhur më parë në avion, dhe kjo i kishte shkaktuar atij një ndijim që s'ishte aspak i pakëndshëm.

Mirëpo, pastaj, në një mënyrë aq të befasishme sa që të shastiste, trupi i tij kishte filluar ta ndjente më thellë afërsinë e trupit të Avrilit, kështu që, ato mendime dhe prirje që ai i konsideronte të qortueshme, po bëheshin më të vështira për t'u larguar. Hejuordi e shihte se Avrili e kishte kuptuar luftën e brendshme që ai bënte dhe kjo e zbaviste; mirëpo, sigurisht; kjo gjë nuk i sillte ndonjë ndihmë. Më në fund, në orën dy të mëngjesit, kur Avrili e kishte shoqëruar deri te dera e dhomës së tij, Hejuordit i ishte dashur të bënte një përpjekje vullneti shumë të madhe për të mos e ftuar të hynte brenda, aq më tepër se ajo nuk po shfaqte as nxitimin më të vogël për t'u larguar.

Para se të shkonte në dhomën e saj, të cilën Hejuordi nuk e dinte se ku ishte, ajo i kishte thënë duke buzëqeshur:

— Anës shtratit gjendet një telefon i brendshëm. Në qoftë se dëshiron ndonjë gjë, çfarëdo gjëje, shtype butonin numër shtatë dhe unë do të vij menjëherë.

Kësaj here, Hejuordi s'kishte pasur as dyshimin më të vogël mbi kuptimin e fjalëve «çfarëdo gjëje»... Dhe, me sa dukej, shtata ishte numri i kodit për ta thirrur Avrilin kudo që të ndodhej.

Në mënyrë të pashpjegueshme, ai e kishte ndier se si i ishte trashur gjuha dhe i ishte ndryshuar zëri, kur fliste:

— Faleminderit, nuk do të jetë nevoja. Natën e mirë.

Mirëpo, lufta e tij e brendshme s'kishte marrë fund me kaq. Ndërsa po zvishej, mendimet i ishin kthyer përsëri tek Avrili dhe, me keqardhje të madhe, kishte vënë re se trupi i tij po orvatej të mos zbatonte vendimin e marrë nga vullneti. Kishte shumë kohë, tanimë, që një gjë e tillë nuk ndodhte.

Atëherë kishte rënë në gjunjë dhe i ishte lutur zotit ta mbronte nga mëkata dhe ta çlironte nga tundimi. Pas një farë kohe, u duk se lutja ishte pranuar: trupi u topit nga lodhja dhe, më në fund, e zuri gjumi.

Ndërsa po ecnin gjatë pistës së vrimës së gjashtë, Xhorxhi i madh i pëshpëriti Hejuordit:

— Dëgjo, mik i dashur, po deshe, sonte po të dërgoj Rrezehënën. Është e pabesueshme se sa marifete di ajo lule lotusi.

Hejuordi ishte skuqur dhe kishte vendosur të fliste qartë.

— Xhorxh, unë e vlerësoj shumë shoqërinë tënde dhe dua ta kem miqësinë tënde. Por, duhet të të them se, në një fushë tjetër, mendimet tona ndryshojnë.

Tiparet e tjetrit morën një pamje më serioze.

— Në cilën fushë?

— E kam fjalën për atë të ... moralit.

Xhorxhi i madh po mendohej, ndërsa fytyra e tij, si një maskë, nuk shprehte asgjë. Pastaj, ia plasi gazit me të madhe.

— Morali eh? Dhe a e di se çdo të thotë! — E ndali karrelin, ndërsa i nderuari Harold po bëhej gati të fillonte nga pikënisja, në të majtën e tyre. Në rregull, Rosko, bëj si të duash. Po ndërrove mendje, më njofto.

Me gjithë vendimin e prerë që kishte marrë, gjatë dy orëve që ndoqën këtë bisedë, imagjinata e tij kthehej vazhdimisht te japonezja e brishtë dhe magjepsëse.

Ndërsa po afroheshin në fushën e fushës së golfit, në mbarim të lojës te vrima e nëntë, Xhorxhi i madh vazhdoi me Bajron Stounbrixhin bisedën që e kishin lënë në mes kur loja zhvillohej te vrima e pestë.

— Në Shtetet e Bashkuara dhe vende të tjera, — tha Xhorxhi i madh, — qeveria është në duart e njerëzve që nuk i kuptojnë, ose që nuk duan t'i kuptojnë ligjet e ekonomisë. Kjo është arsyeja, e vetmja arsye, që kemi tani një inflacion kaq të vrullshëm. Ky është shkaku se pse, në të gjithë botën, sistemi monetar po shkatërrohet. Ky është shkaku se pse, çdo problem që ka të bëjë me paranë, mundet vetëm të keqësohet.

— Pjesërisht, jam i një mendjeje me ty, — tha Stounbrixhi. — Nga vetë mënyra se si i shpenzon paratë me të dyja duart Kongresi, njeriu kujton se ato s'kanë të shteruar. Në Dhomën e Deputetëve dhe në Senat, kemi njerëz që konsiderohen me mend, të cilët janë të bindur se për çdo dollar që hyn mund të nxirren jashtë katër ose pesë.

Xhorxhi i madh vërejti me padurim:

— Ky është një fakt që të gjithë afaristët e dinë mirë. E dinë, tanimë, gjë prej një brezi. Problemi nuk shtrohet nëse do të shembet apo jo ekonomia amerikane, por kur do të shembet.

— Unë nuk jam i mendimit që shembja të jetë e pashmangshme. Ne kemi akoma mundësi t'i shmangemi.

— Po, kemi mundësi, por nuk duam. Dhe kështu, do të vijë një çast kur qeveria nuk do të ketë më kreditë e mjaftueshme. Ndonjë budalla beson se kjo nuk do të ndodhë, por, përkundrazi, do të ndodhë patjetër.

Nënpresidenti pështyu - po të ishte duke folur para publikut, do ta mohoja në mënyrë energjike vërtetësinë e këtij pohimi. Këtu, veças, midis nesh, nuk e bëj dot.

— Të parashikosh se si ngjarjet do të ndjekin njëra-tjetrën është një gjë shumë e lehtë, — vërejti Xhorxhi i madh. — Ato do të zhvillohen në një mënyrë shumë të ngjashme si në Kili. Shumë njerëz janë të bindur se Kili është një rast i ndryshëm, i largët. Mirëpo, nuk është ashtu. Ai ishte një kopje në miniaturë e SHBA-së, Kanadasë dhe Britanisë.

— Edhe unë jam i një mendjeje për rrugën e ndjekur nga ngjarjet, — tha mendueshëm i nderuari Harold. — Në fillim, demokraci: të shëndoshë, të njohur në të gjithë botën, efektive. Pastaj, socializëm, në fillim të butë, të matur; pastaj, gjithnjë e më të ashpër. Më në fund, paratë e prishura me të dyja duart, sa të mos mbetet më asgjë. Dhe, pas kësaj, shkatërrimi nga ana financiare, anarkia, diktatura.

— Edhe për një pus të kishte qenë fjala, — vërejti Bajron Stounbrixhi, — nuk besoj se do të bënim kaq poshtë.

— Nuk është e thënë që kjo të jetë e pashmangshme, — ia priti Xhorxhi i madh. — Mjafton që disa nga ne, të pajisur me zgjuarsi dhe fuqi, të mendohen me kohë dhe të marrin masat e duhura. Kur të vijë shembja financiare, në SHBA do të mbeten akoma dy armë të fuqishme që do të na shpëtojnë nga anarkia. Njëra është me natyrë tregtare: një kartel, me shoqëri shumëkombëshe, si ky imi, dhe banka të mëdha, si jotja, Rosko, do të ishin në gjendje të qeverisnin tërë kombin përsa i përket aspektit ekonomik, duke ushtruar disiplinën e nevojshme. Do të jemi në gjendje që të paguajmë pikërisht nga fakti se do të veprojmë në shkallë botërore, duke i vënë burimet tona atje ku inflacioni nuk do të jetë në gjendje t'i përpijë. Arma tjetër e fuqishme përbëhet nga policia dhe ushtria. Këto dy armë, bashkë me biznesin e madh, do të mund të sigurojnë mbajtjen e rendit.
— Me fjalë të tjera, një shtet policor, — tha nënpresidenti, me ton të thatë. — Ideja jote mund të gjejë kundërshtim.
Xhorxhi i madh mblodhi supet. — Ndoshta pak, por jo

shumë. Njerëzit do të pajtoheshin, më në fund, me atë që është e pashmangshme. Sidomos, pasi ta kenë parë të ashtuquajturën demokraci të mbaruar, sistemin monetar të shkatërruar dhe fuqinë blerëse të njerëzve në zero. Veç kësaj, amerikanët nuk kanë më besim në institucionet demokratike. Ju politikanët, u keni vënë minat.
Rosko Hejuordi kishte dëgjuar në heshtje. — Tani, ai tha:
— Ajo që parashikon ti, Xhorxh, është transformimi i sistemit të tanishëm ushtarako-industrial në një qeveri oligarkike.
— Tamam! Dhe sistemi industrialo-ushtarak, unë preferoj ta quaj kështu, bëhet gjithnjë e më i fortë, sa më shumë që ekonomia amerikane dobësohet. Dhe kemi edhe njëfarë organizate. Është pak e shthurur, por po forcohet me shpejtësi.
— Ajzenhaueri ka qenë i pari që ka pranuar ekzistencën e strukturës ushtarako-industriale, — tha Hejuordi.
— Dhe që ka tërhequr vëmendjen për rreziqet që janë të lidhura me të, — shtoi Bajron Stounbrixhi.
— Po, po, — tha Xhorxhi i madh. — Ç'marrëzi! Sepse në fakt, Ajku më shumë se kushdo tjetër mund të dallohte forcën që lidhet me të. E kupton?
Nënpresidenti piu një gllënjkë nga ponçi i tij Planter. — Meqenëse s'jam duke folur në publik, po të përgjigjem: po.
— E di se ç'mendoj? — i tha Xhorxhi i madh. — Ti duhet të bashkohesh me ne!
I nderuari Harold Pyeti:
— Xhorxh, sa kohë mendon ti se na mbetet akoma?
— Tetë ose nëntë vjet, më thonë ekspertët e mi. Brenda kësaj periudhe, shembja e sistemit monetar është e pashmangshme.
— Ajo që më tërheq si bankier, — tha Rosko Hejuordi, — është mendimi se disiplina mund të vendoset, më në fund, në ekonomi dhe në qeveri.

Xh. Xh. Kuortermlejni nënshkroi llogarinë e barit dhe u ngrit.
— Dhe këtë do ta shohësh. Ta premtoj.
Hipën përsëri në vetura dhe u drejtuan për te pista e vrimës së dhjetë.
Xhorxhi i madh i tha me zë të lartë nënpresidentit:
— Baj! Deri tani ke luajtur shumë më lart mundësive të tua, gjë që të nderon. Tani, na trego pak golf ekonomik dhe të disiplinuar. Je në krye vetëm me një pikë dhe mbeten akoma për t'u luajtur edhe nëntë vrima të vështira.
Xhorxhi i madh dhe Rosko Hejuordi po prisnin në rrugëzën e karrelit elektrik, ndërsa Harold Ostini po mendohej për gjendjen e tij lidhur me vrimën e katërmbëdhjetë; pasi kish kërkuar në çdo anë, një agjent i shërbimit sekret e kishte gjetur topin e tij nën një kaçube bibisku. Xhorxhi i madh ishte i kënaqur dhe i qetë, sepse ai dhe Hejuordi kishin fituar në dy vrima dhe, tani, ishin në krye, me një pikë.
Qe pikërisht në atë çast që u paraqit, në një mënyrë krejt të rastësishme, mundësia aq e shpresuar nga Hejuordi.
— Pra, bankës sate do t'i pëlqente të punonte pak me Suprënejshnëlin.
Hejuordi u mundua të fliste, edhe ai, në një vijë të përgjithshme.
— Po, na ka shkuar mendja për këtë.
— Jam duke e zgjeruar shtrirjen e Suprënejshnëlit jashtë shtetit, me anë të blerjes së shumicës së aksioneve të shoqërive-kyçe të vogla në sektorin telefonik dhe radioteleviziv. Disa janë shtetërore dhe të tjerat private. Veprojmë me kujdes, në rast nevoje duke u dhënë ryshfete politikanëve vendas: në këtë mënyrë, s'u shmangemi agjitacioneve nacionaliste. Suprënejshnëli furnizon një teknologji të përparuar dhe një shërbim efektiv, që nuk mund t'i zotërojnë kombet e vogla, dhe një sistem të standardizuar

komunikacionesh, në shkallë botërore. Nga këto, nxjerrim fitime të mira. Edhe tre vjet dhe të kemi siguruar kontrollin, me anë të degëve tona, të dyzet e pesë për qind të rrjeteve të komunikacioneve të mbarë botës. Askush tjetër nuk mund të arrijë në këtë përqindje. Për Amerikën, kjo është e rëndësishme dhe do të jetë, bile, jetike përsa i përket tipit të lidhjes industrialo-ushtarake, për të cilën folëm.
— Po, — tha Hejuordi, — e kam shumë të qartë.
— Nga banka jote dua një kredi prej pesëdhjetë milionë dollarësh. Me taksën primare, sigurisht.
— Natyrisht, për çdo operacion do të zbatohej interesi primar. — Hejuordi e dinte se, çfarëdo huaje t'i jepej Suprënejshnëlit, kjo do të përfitonte nga përqindja minimale e interesit. Në fushën bankare është e qartë se klientët më të pasur paguajnë interesin më të ulët, ndërsa interesat më të larta u rezervohen klientëve më pak të pasur. — Megjithatë, duhet të respektojmë kufizimet e vendosura nga ligjet federale.
— Në djall kufizimet! Ka një mijë mënyra për t'iu shmangur, të cilat përdoren çdo ditë. Ti e di këtë po aq mirë sa dhe unë.
— Po, e di se ka mënyra veprimi dhe rrugë të tërthorta. Të dy burrat po i referoheshin një ligji të procedurës bankare, që e ndalonte çdo bankë t'i jepte një klienti vetëm një hua më të madhe se dhjetë për qind të shumës së përgjithshme të kapitalit shoqëror dhe të tepricave të derdhjeve. Qëllimi i këtij ligji ishte t'i dilej përpara një falimentimi të mundshëm dhe të ruhej interesi i depozituesve. Përsa i përkiste Fërst Merkëntajll Ëmerikën Benkut, një hua prej pesëdhjetë milionë dollarësh Suprënejshnëlit e tejkalonte mjaft këtë kufi.
— Një mënyrë shumë e thjeshtë, — tha Xhorxhi i madh, — është të ndahet shuma ndërmjet degëve tona. Pastaj, ne e mbledhim përsëri në mënyrën dhe vendin ku na nevojitet.

— Po, ashtu mund të bëhet, — tha Hejuordi mendueshëm. Ai e dinte mirë se kjo mënyrë veprimi cenonte frymën e ligjit, ndonëse e respektonte atë nga ana formale. Por, e dinte gjithashtu se ajo që kishte thënë Xhorxhi i madh ishte e vërtetë: mënyra të tilla veprimi përdoreshin çdo ditë nga bankat më të mëdha dhe më me prestigj.

Mirëpo, edhe duke e lënë më një anë këtë veçanti, ai kishte mbetur i habitur nga madhësia e shumës së kërkuar. Ai kishte parashikuar një shumë prej nja njëzet ose njëzet e pesë milionë dollarësh, si fillim, me një rritje të mundshme progresive, që do të bëhej në të njëjtën kohë me zhvillimin gradual të marrëdhënieve midis Suprënejshnëlit dhe bankës. Tamam sikur të lexonte në mendjen e tij, Xhorxhi i madh tha:
— Unë nuk bëj kurrë biseda tregtie me shifra të vogla. Në rast se pesëdhjetë milionë janë më shumë se sa mund të japë banka juaj, e lëmë këtë bisedë. Do t'i drejtohem Çeizit.
Hejuordit iu duk sikur po i shpëtonte nga duart puna e rëndësishme dhe e vështirë, për të cilën ai kishte shkuar atje, me shpresë që ta siguronte.
— Jo, jo, — tha Hejuordi me nxitim dhe zjarr. — Nuk janë shumë.
Solli në mend angazhimet e tjera të FMA-së. Askush tjetër nuk i dinte ato më mirë se ai. Po, të pesëdhjetë milionët për SuNatKo-n mund të siguroheshin. Natyrisht duheshin mbyllur rubinete të tjerë, ose të pakësoheshin në mënyrë drastike huatë dhe hipotekat me shuma të vogla. Dhe kjo mund të bëhej. Një hua e vetme e madhe ishte shumë më rentabël se sa një numër shumë i madh huash të vogla, po kjo mund të thuhej edhe për mbledhjen e tyre.
— Kam ndërmend ta rekomandoj nxehtësisht këtë kredi në mbledhjen e ardhshme të këshillit administrativ, — tha Hejuordi, me ton të vendosur. — Dhe jam i sigurt se do të miratohet.
— Mirë, — u kufizua të thotë partneri i tij.
— Natyrisht, pozita ime do të ishte më e fortë, në qoftë se do

të mund të njoftoja që në këshillin administrativ të Suprënejshnëlit do të jetë një përfaqësues i bankës.
Xhorxhi i madh e kishte drejtuar ndërkaq karrelin gjer te pika ku gjendej topi i tij. Para se të përgjigjej, ai ia nguli sytë gjatë dhe, pastaj, tha:
— Kjo mund të rregullohet. Në rast të tillë, do të prisja investime të shumta nga ana e seksionit tuaj fiduciar në aksione të Suprënejshnëlit. Është koha që disa blerje të reja të bëjnë që të ngrihen kuotat.
Hejuordi, që po ndjente veten gjithnjë e më të sigurt se do ta përfundonte marrëveshjen, u përgjigj:

— Kjo është një gjë që mund të shqyrtohet, bashkë me çështjet të tjera. Natyrisht Suprënejshnëli do të ketë të ne një llogari aktive dhe është çështja e kompensimit të bilancit... Kjo ishte procedura e zakonshme e bisedimeve midis bankës dhe klientit dhe, në thelb, përfaqësonte një të vërtetë të përgjithshme: Ma kruaj ti shpinën; edhe unë do ta kruaj tënden.
Xh. Xh. Kuortermejni, duke nxjerrë një shkop hekuri nga çanta prej lëkure aligatori, ma ton të acaruar:
— Mos më mërzit me hollësitë. Administratori im, Inçbek, do të vijë sot këtu dhe, nesër, do të kthehet bashkë me ne. Mund të bisedosh me të.
Ishte e qartë se biseda e shkurtër për çështje tregtare kishte përfunduar.

Me sa dukej, loja jo e mirë e të nderuarit Harold po fillonte të ndikonte mbi partnerin e tij.
— Po më hipnotizon, — u ankua në një rast Bajron Stounbrixhi. Dhe pas pak: — Ta marrë djalli! Harold, goditjet e gabuara që bën ti janë ngjitëse si lia. Njeriu duhet të vaksinohet, para se të luajë me të.
Cilido që të ishte shkaku, stili dhe rezultatet e nënpresidentit u keqësuan gjithnjë e më shumë.
Duke qenë se Ostini nuk e përmirësoi lojën e tij, me gjithë qortimet e bëra, te vrima e shtatëmbëdhjetë, Xhorxhi i madh dhe Rosko Hejuordi ishin akoma në krye, me një pikë më

shumë. Kjo gjendje i interesonte Xh. Xh. Kuortermejnit. Në goditjen fillestare të vrimës së tetëmbëdhjetë, Xhorxhi i madh e hodhi topin pothuajse treqind metra në qendër të fushës; pastaj, drejt e në vrimë, duke siguruar fitoren.
Ndërsa Bajron Stounbrixhi po e përgëzonte, me një të qëlluar pak a shumë energjike të pëllëmbës së dorës në sup, Xhorxhi i madh tha:
— Mendoj se kjo do ta ngrejë më shumë se kurrë kuotën time në Uashington.
— Varet nga ajo që do, — ia priti nënpresidenti, që shtoi, me ton kuptimplotë: — Dhe sa i përmbajtshëm je.
I nderuari Harold dhe Stounbrixhi i paguan Xh. Xh. Kuortermejnit nga njëqind dollarë secili, që ishte shuma e vënë me bast para fillimit të lojës. Hejuordi, për shkak të skrupujve të tij të zakonshëm të ndërgjegjes, nuk kishte pranuar të vinte bast.
Xhorxhi i madh, me qëndrim shumë bujar i tha:
— Më pëlqeu loja jote, partner. — Pastaj, duke u kthyer nga dy të tjerët: — Besoj se Roskoi e meriton një vlerësim për këtë. A jeni të një mendjeje?
Pas gjestit pohues të tyre, Kuortermejni goditi kofshën e tij me pëllëmbën e dorës dhe tha:
— E gjeta! Një vend në këshillin administrativ të Suprënejshnëlit. Si të duket si çmim?
Hejuordi buzëqeshi:
— Jam i sigurt se po bën shaka.
Fytyra e presidentit të SuNatKo-s u bë në çast serioze:
— Unë nuk bëj kurrë shaka, kur flitet për Suprënejshnëlin.
Hejuordi kuptoi se kjo ishte mënyra e Xhorxhit të madh për ta përfunduar bisedën që kishte mbetur pak pezull. Sigurisht, të pranoje postin e këshilltarit, do të thoshte edhe të pranoje angazhimet e marra...
Ngurrimi i tij vazhdoi vetëm disa sekonda:
— Po qe se e ke seriozisht, jam shumë i lumtur të pranoj.
— Do të njoftohet javën e ardhshme.
Oferta kishte qenë aq e shpejtë dhe tronditëse saqë Hejuordi e kishte akoma të vështirë ta besonte. Ai kishte menduar se

dikush tjetër nga këshilltarët e Fërst Merkëntajll Emerikën Bankut do të ftohej të bënte pjesë në këshillin administrativ të Suprënejshnëlit. Të zgjidhej vetë ai dhe personalisht nga Xh. Xh. Kuortermejni ishte nder i dyfishtë. Këshilli i Suprënejshnëlit, siç ishte i përbërë tani, përmbante ajkën e botës financiare.
— Sikur të kishte lexuar në mendjen e tij, Xhorxhi i madh u zgjodh.
— Midis gjërave të tjera, mund të kesh kujdes edhe paratë e bankës sate.
Hejuordi pa të nderuarin Harold t'i hidhte një vështrim pyetës. Bëri një shenjë fare të vogël me kokë dhe fytyra e këshilltarit të FMA-së u çel.

8.

Mbrëmja e dytë në shtëpinë e Xh. Xh. Kuortermejnit kishte, që në fillim, diçka të ndryshme, diçka të imët e gati të pakapshme. Dukej sikur midis tetë të pranishmëve — burra e vajza — të ishte vendosur një intimitet i qetë që nuk ekzistonte në mbrëmjen e mëparshme. Rosko Hejuordi e dalloi dhe mendoi se e merrte me mend arsyen.

Intuita i thoshte se Rita kishte kaluar natën e mëparshme me Harold Ostinin dhe Krista me Bajron Stounbrixhin. Shpresonte që të dy burrat të mos mendonin të njëjtën gjë për atë dhe Avrilin. Ishte i sigurt se zoti i shtëpisë nuk e mendonte një gjë të tillë. Kjo vërtetohej nga vërejtjet që ai kishte bërë në mëngjes. Kishte të ngjarë që Xhorxhi i madh të ishte gjithnjë në dijeni të çdo gjëje që ndodhte, ose që mund të ndodhte, në shtëpinë e tij.

Sidoqoftë, kalimi i mbrëmjes përsëri pranë pishinës dhe, pastaj, në tarracë, për të ngrënë darkën, ishte në vetvete diçka shumë e kënaqshme. Rosko Hejuordi e veten të merrte pjesë gëzueshëm dhe lirshëm në të.

Në të vërtetë, atij po i pëlqenin kujdeset e vazhdueshme të Avrilit, e cila nuk dukej të ishte aspak e prekur nga

mospranimi i tij i natës së mëparshme. Duke qenë se e kishte provuar se mund t'u qëndronte tundimeve të saj të qarta, ai nuk e shihte të nevojshme t'i mohonte tani vetes edhe shoqërinë e saj të këndshme. Dy arsye të tjera për gjendjen e tij në eufori ishin arritja e marrëveshjes midis Suprënejshnëlit dhe Fërst Merkëntail Amerikën Benkut dhe sigurimi i papritur dhe shumë i dëshiruar i një vendi për vetë atë në këshillin administrativ të SuNatKo-s. Hejuordi s'kishte as dyshimin më të vogël se të dyja këto gjëra do ta rrisnin shumë prestigjin e tij brenda FMA-së. Që tani, emërimi i tij si president i bankës i dukej më i afërt.

Pak më parë, gjatë pasdites, ai kishte pasur një bisedë të shkurtër me administratorin e Suprënejshnëlit, Stenli Inçbekun, që kishte ardhur atë ditë, siç kishte thënë Xhorxhi i madh. Inçbeku ishte një njujorkez dinamik, me prirje të bëhej tullac. Ai ishte marrë vesh me Hejuordin që hollësitë e huasë për SuNatKo-n t'i diskutonin të nesërmen, gjatë fluturimit të kthimit për në Veri. Pastaj, ishte tërhequr me Xh. Xh. Kuortermejnin, me të cilin kishte ndenjur pjesën më të madhe të pasdites. Ndonëse duhet të ishte diku në shtëpi, Inçbeku s'ishte parë më as kur u pinë aperitivët, as për të ngrënë darkë.

Nga ana tjetër, pak më parë, Rosko Hejuordi kishte parë nga dritarja e dhomës së tij Xh. Xh. Kuortermejnin dhe Bajron Stounbrixhin duke shëtitur në park për gati një orë, të zhytur në një bisedë. Ata ishin shumë larg shtëpisë kështu që nuk mund të dëgjonte se ç'thoshin; por, me sa dukej, Xhorxhi i madh kërkonte ta bindte nënpresidentin për diçka dhe, ky i fundit, e ndërpriste herë pas here për t'i bërë ndonjë pyetje. Hejuordit i kujtohej se si, në mëngjes, në fushën e golfit, Kuortermejni kishte zënë me gojë «kuotat e tij në Washington» dhe pyeste veten se për cilat nga interesat e shumta të Suprënejshnëlit po diskutohej. Por, kishte arritur në përfundimin se këtë s'do ta mësonte kurrë.

Pas darkës, në muzgun e freskët dhe të parfumuar të tarracës, Xhorxhi i madh ishte bërë përsëri mikpritësi gazmor

dhe i përzemërt. Duke mbajtur në dorë një gotë brendi, të stolisur me Q-në e pashmangshme, ai tha:

— Sonte nuk do të dalim. Do të organizojmë një mbrëmje këtu.

Maxhordomi, kamerierët dhe muzikantët ishin tërhequr me takt.

Rita dhe Avrili, që ishin duke pirë shampanjë, thirrën së bashku:

— Një mbrëmje, këtu!

Baj Stounbrixhi ngriti zërin që të dëgjohej mbi atë të vajzave.

— Çfarë lloj mbrëmjeje?

— Mbrëmje vallëzimi! — deklaroi Krista, me gjuhën që s'e zotëronte më dhe aq mirë, për shkak të verës dhe shampanjës që kishte pirë. Pastaj, e korrigjoi veten: — Jo, jo, një mbrëmje notimi! Dua të notoj.

Stounbrixhi ia priti, sikur të donte ta sfidonte:

— E çfarë të pengon?

— Asgjë, Baj, asgjë prej gjëje, i dashur! — Me disa lëvizje të shpejta, Krista la në tavolinë gotën e shampanjës, hodhi tutje këpucët, zbërtheu kopsat e fustanit dhe, me një të shkundur të trupit, fustani i gjatë, i gjelbër, që kishte veshur, u gjend te këmbët e saj. Tani ishte me kombinazon, të cilin e nxori nga lart, nga koka, dhe e flaku tutje. Si kishte mbetur me asnjë tjetër në trup.

Krejt e zhveshur buzagaz, me trupin me përpjesëtime të përsosura, me gjinj të ngritur e të fortë dhe me flokët e zinj si pendë korbi, e ngjashme me një skulpturë të gjallëruar, të Majolit[1]) zbriti me qëndrim dinjitoz shkallët drejt pishinës së ndriçuar dhe u zhyt në të. Notoi gjer te buza përballë dhe,

pastaj, u kthye dhe u thirri të tjerëve:
— Është e mrekullueshme! Ejani!
— Për zotin!, — thirri Stounbrixhi. — Po vij menjëherë!
Hoqi me nxitim këpucët, këmishën sportive, pantallonat; pastaj, krejt i zhveshur, si Krista, por me pamje shumë pak tërheqëse, vrapoi poshtë dhe u zhyt në ujë.
Rita dhe Rrezehëna, kjo e fundit duke qeshur me zë të mprehtë, po zhvisheshin gjithashtu.
— Prisni, — thirri Harold Ostini. — Ia mbërriti sportisti!
Rosko Hejuordi, që e kishte vërejtur Kristinën me një përzierje hutimi dhe admirimi, e pa Avrilin krejt pranë tij.
— Rosi, i dashur, ma tërhie pak poshtë zinxhirin. — Ajo i ktheu shpinën.
Duke ngurruar, ai u mundua ta arrinte zinxhirin, pa u ngritur nga karrigia.
— Ngrihu, budalla i madh, — tha Avrili. Kur Hejuordi u ngrit, ajo u mbështet tek ai, me kokën gjysmë të kthyer, ndërsa ngrohtësia dhe parfumi i saj po i zinin frymën.
— Nuk po e hap dot!
Ai e kishte të vështirë të përqendrohej.
— Jo, duket se është ...
— Lëre se e bëj vetë. — Avrili zgjati me shkathtësi njërën dorë prapa shpinës dhe e hapi zinxhirin. Bëri një shkundje të shpatullave dhe fustani shkau poshtë.
Ajo i valëviti flokët e saj të kuqërremë me gjestin që Hejuordi e njihte tanimë mirë.
— Atëherë, ç'pret? Ma zbërthe sutienin.
Hejuordi filloi ta zbërthente me duart që i dridheshin dhe sytë që s'shkëputeshin prej saj. Sutieni ra poshtë. Duart e Hejuordit nuk lëvizën nga vendi ku ishin.
Me një lëvizje të rrjedhshme dhe plot hijeshi, Avrili bëri një gjysmë rrotullimi, u përkul përpara dhe e puthi Hejuordin në

buzë. Duart e tij mbetën aty ku ishin. Pa dashur, gishtat iu përkulën, duke u shtrënguar. Valë të njëpasnjëshme elektrike, sensualiteti i përshkuan trupin.
Avrili lëshoi një psherëtimë kënaqësie.
— Oh, ... sa bukur! A do të vish të notojmë?

Ai tundi kokën.
— Atëherë, shihemi pastaj. — Dhe Avrili u largua, e ngjashme me lakuriqësinë e saj me një perëndeshë greke, dhe u bashkua me pjesët të tjerët, që bënin lloj-lloj kërcimesh në ujin e pishinës.
Xh. Xh. Kuortermlejni s'kishte lëvizuar ende nga karrigia, edhe mbasi e kishte larguar atë nga tryeza. Ndërsa pinte brendin e tij me gllënjka të vogla, ai e vëzhgonte Hejuordin me një vështrim depërtues.
— As mua nuk më pëlqen të futem në ujë. Por, mendoj se nganjëherë, kur njeriu është i sigurt se ndodhet midis miqsh, duhet të bëjë si të jetë rasti.
— Ashtu është, ke të drejtë; dhe, sigurisht, e ndiej veten midis miqsh. — Pasi u ul përsëri, Hejuordi hoqi syzet dhe filloi t'i pastronte. Tani e kishte përsëri veten në dorë. Çasti i dobësisë së marrë kishte kaluar. — Natyrisht, problemi është se, nganjëherë, njeriu shkon diçka më tutje se ç'kishte ndërmend të shkonte. Sidoqoftë, e rëndësishme është që të mos humbasësh kontrollin e vetvetes.
Xhorxhi i madh gogësiti.
Ndërsa ata po bisedonin, të tjerët, pasi kishin dalë nga pishina, po fshiheshin dhe po vishnin rrobdëshambre me kapuç, që ishin të radhitur pranë pishinës.
Pas dy orësh, ashtu siç kishte bërë edhe natën e mëparshme, Avrili e shoqëroi Hejuordin gjer te dera e dhomës së tij. Në fillim, kur ishin poshtë, Hejuordi kishte vendosur të ngulte

këmbë që ajo të mos e shoqëronte; por, pastaj kishte ndërruar mendje, duke pasur besim në forcën e ripërtëritur të vullnetit të tij dhe duke qenë shumë i sigurt se nuk do t'u nënshtrohej nxitjeve erotike. Ai e ndjente veten bile aq të shpenguar saqë i tha me zë gazmor:
— Natën e mirë, zonjushe. Dhe ... s'kam harruar, numri yt është shtata, por të siguroj se nuk do të kem nevojë për asgjë.
Avrili i drejtoi një buzëqeshje enigmatike, pastaj u kthye dhe u largua. Hejuordi e mbylli derën me çelës dhe, duke fishkëllyer lehtë, u përgatit për të rënë në shtrat.
Por gjumi s'po e merrte.
Ai ndenji zgjuar rreth një orë, në shtratin shumë të butë, ndërsa kuvertën e kishte hedhur te këmbët. Nga dritarja e hapur dëgjohej zukama e insekteve të natës dhe, në largësi, zhurma e valëve në bregdet. Me gjithë qëllimet e tij shumë të mira, mendimet i përqendroheshin tek Avrili.
Avrili ... siç e kishte parë dhe prekur ... me një bukuri që të zinte frymën, krejt e zhveshur ...
Dhe; ndërkaq trupi i tij, i përshkuar nga dëshira të zjarrta e të papërmbajtura, s'donte t'ia dinte fare për mendimet e qëllimet e tij të pastra.
Ai u mundua të mendonte për diçka tjetër: për punë të bankës, huanë për Suprënejshnëlin, funksionin e këshilltarit të premtuar nga Xh. Xh. Kuorpermejni, po mendimet i ktheheshin përsëri tek Avrili, gjithnjë më të fuqishme, tepër të fuqishme e nuk mund t'i largonte dot. Hejuordit iu kujtuan këmbët e saj, kofshët e saj, buzët e saj, buzëqeshja e saj e ëmbël, ngrohtësia dhe parfumi i saj, gatishmëria e saj...
U ngrit dhe filloi të ecë poshtë e lart në dhomë, duke dashur t'i jepte një drejtim tjetër zjarrit që po e digjte. Por nuk ia arriti qëllimit. U ndal para dritares dhe pa jashtë hënën — hënë e ngrënë — që ishte ngritur në qiell dhe hidhte një dritë të

bardhë qiellore mbi kopshtin, mbi plazhin, mbi detin. I erdhi ndërmend një varg i harruar prej kushedi sa kohësh: «Nata është bërë për dashuri ... në dritën e hënës.
Filloi të ecte përsëri dhe, pastaj, u kthye te dritarja, duke qëndruar aty në këmbë, pa lëvizur.
Dy herë qe gati të lëshohej drejt komodinës, mbi të cilën ishte telefoni i brendshëm dhe, të dyja herët, mundi ta ndalë veten vetëm me forcë vullneti.
Herën e tretë nuk u kthye mbrapa. E zuri me duar aparatin, me një rënkim që ishte një përzierje pikëllimi, vetëqortimi, nxitjeje të fuqishme, shijimi paraprak hyjnor.
Pa ngurrim tjetër, me vendosmëri, ai shtypi butonin numër shtatë.

Para se Istini të hynte në burgun e Drumonburgut, as përvoja e as fantazia e tij nuk e kishin përgatitur për skëterrën e pamëshirshme dhe poshtëruese të burgut.
Kishin kaluar gjashtë muaj nga zbulimi i përvetësimeve të tij të paligjshme dhe, katër muaj, që prej procesit dhe dënimit të tij.
Në çastet e rralla, kur objektiviteti qëndronte mbi vuajtjen e trupit dhe ankthin shpirtëror, Majlls Istini mendonte se, në qoftë se shoqëria kishte dashur të ushtronte mbi një njeri si ai një hakmarrje aq të egër dhe barbare, ajo kishte shkuar shumë përtej qëllimeve të atyre, që nuk e kishin provuar kurrë personalisht, purgatorin shtazarak të burgut. Dhe, në rast se qëllimi i një ndëshkimi të tillë, thoshte ai me vete, ishte që ta zhvishte një njeri nga gjithçka njerëzore dhe ta kthente në një kafshë me instinktet më të ulëta, atëherë burgu ishte sistemi më i përshtatshëm.
Atë që burgu s'e kishte bërë dhe s'do ta bënte kurrë, thoshte me vete Majlls Istini, ishte t'i kthente shoqërisë, kur të dilte,

një pjesëtar të saj më të mirë se sa kishte qenë kur ishte futur brenda. Sado i shkurtër të jetë qëndrimi i një njeriu në të, e vetmja gjë që mund të bëjë burgu është ta degradojë dhe ta bëjë edhe më të keq se sa ishte më parë; ai vetëm se mund ta shtojë urrejtjen ti ndaj «sistemit» që e ka dërguar atje; vetëm ta pakësojë edhe më shumë mundësinë që të mund të bëhet, ndonjëherë, një qytetar i dobishëm dhe që respekton ligjet. Dhe, sa më e gjatë të jetë periudha e burgimit, aq më të vogla bëhen mundësitë e ringjalljes morale.

Në këtë mënyrë, koha është ajo që, më shumë se çdo gjë tjetër, e bren dhe më në fund e shkatërron dëshirën që mund të ketë një i burgosur, në kohën kur futet në burg, për t'u spastruar moralisht.

Edhe në qoftë se dikush kapet fort mbas ndonjë mbeturine vlerash morale, ashtu siç kapet një notar që po mbytet mbas një brezi shpëtimi, kjo u detyrohet forcave të brendshme të tij dhe jo për meritë, por në kundërshtim me veprimin negativ të burgut.

Majllsi përpiqej të rezistonte, mundohej të ruante diçka nga pjesa më e mirë e tij, luftonte që të mos kthehej krejt në një kafshë pa ndjenja, i zhytur në një dëshpërim të plotë dhe në një pezmatim të egërsuar. Ishte një gjë shumë e lehtë të shkisje në një gjendje shtazarake, po aq e lehtë sa të ecje me këmbë e duar. Pjesa më e madhe e të burgosurve kështu përfundojnë. Është fjala për ata që i kanë humbur ndjenjat njerëzore para se të burgosen, gjendja e të cilëve, më zonë, keqësohet edhe më shumë; si të tjerë; që i ka brejtur koha e kaluar brenda në burg, koha dhe mungesa e ndjenjave njerëzore e qytetarëve përtej mureve të burgut, indiferentë ndaj mizorive të kryera — të gjitha këto në emër të shoqërisë — prapa atyre mureve.

Megjithatë, në favor të Majllsit ekzistonte një mundësi e rëndësishme: ai ishte dënuar me dy vjet, gjë që i jepte të drejtën — pas katër muajve — të bënte kërkesë për t'u lënë në liri të mbikëqyrur.

A nuk guxonte ta merrte parasysh mundësinë që të mos ia pranonin këtë kërkesë. Rrjedhojat ishin tëpër të tmerrshme. Nuk besonte se mund të kalonte aty brenda dy vjet, pa dalë prej andej, krejtësisht dhe në një mënyrë të pandreqshme i degraduar në mendje dhe në trup. «Qëndro!» — i thoshte vetes ditë e natë. — Qëndro!, shpreso, në shpëtimin e lirisë së mbikëqyrur!»

Në fillim, menjëherë pas arrestimit, ndërsa priste proçesin, kishte menduar se po të qëndronte i mbyllur në një qeli, do të çmendej. I kujtohej se dikur kishte lexuar se, sa kohë që s'e ke humbur lirinë, rrallë ndodh që ajo të çmohet me tërë vlerën e saj. Dhe është e vërtetë që askush nuk e kupton se ç'do të thotë liri fizike e lëvizjeve — qoftë edhe vetëm për të kaluar nga një dhomë në tjetrën, ose të dalë pak jashtë nga shtëpia — deri sa kjo liri të mos i jetë hequr krejtësisht.

Megjithatë, krahasuar me kushtet që ekzistonin aty në burg, periudha para proçesit kishte qenë periudhë e një trajtimi luksi.

Qelia e Drumonburgut, në të cilën e kishin mbyllur, kishte një madhësi prej dy metrash me dy e gjysmë, si të gjitha të tjerat, në të katër radhët e vendosura njëra mbi tjetrën të secilit prej të katër krahëve të burgut. Kur kishte qenë ndërtuar burgu, më se një gjysmë shekulli më parë, çdo qeli kishte qenë parashikuar për të mbajtur vetëm një njeri. Mirëpo, tanimë, për shkak të rritjes së madhe të popullsisë së brendshme, të gjitha qelitë — duke përfshirë dhe atë të Istinit — kishin nga katër veta. Të burgosurit, pothuajse gjithmonë, mbaheshin të mbyllur në qelitë e tyre tetëmbëdhjetë orë në ditë.

Pak kohë mbas ardhjes së Majllsit, për shkak të një revolte që kishte plasur në një krah tjetër, të gjithë të burgosurit i kishin lënë të mbyllur për shtatëmbëdhjetë ditë me radhë. Në fund të javës së parë, britmat e dëshpëruara të një mijë e dyqind burrave, që kishin arritur në prag të marrëzisë, u kishin shtuar vuajtjeve të shumta edhe një torturë tjetër.

Qelia e Majllsit istinit kishte katër shtretër të vegjël të fiksuar në mur dhe, për të katër burrat, kishte një lavaman dhe vetëm një nevojtore allaturka. Duke qenë se presioni i ujit në tubacionet e vjetra e të ndryshkura ishte i vogël, nga rubineti i lavamanit rridhte zakonisht vetëm një currill uji; dhe, nganjëherë; edhe ky ndalej krejt. Për të njëjtën arsye, shpesh nuk punonte as sifoni i nevojtores. Të rrije i mbyllur në një qeli në të cilën kryenin nevojat e tyre katër burra, ishte në vetvete e vështirë, por të rrije edhe në atë erë të keqe, duke pritur që të vinte uji në sasi të mjaftueshme për ta eliminuar, ishte një gjë e tmerrshme, e neveritshme. Letra higjenike dhe sapuni, ndonëse përdoreshin me kursim, nuk ishin kurrë të mjaftueshme. Ai e shihte se rojat që vështronin nga ajo anë, e dinin mirë se ç'po ndodhte, por kjo gjë vetëm se i zbaviste.

Një herë në javë, të burgosurit mund të bënin dush, për një kohë të shkurtër. Ndërmjet kohës që kalonte nga njëri dush te tjetri, trupat e të burgosurit djersiheshin dhe mbanin erë, gjë që përbënte edhe një torturë tjetër.

Salla e dusheve ishte një ndërtesë njëkatëshe, në të cilën rojat i çonin të burgosurit në grupe prej pesëdhjetë vetash. Këta të fundit zhvisheshin, duke i lënë rrobat e tyre në koshe prej telash metalike dhe, pastaj, krejt lakuriq dhe duke u dridhur në sallën pa ngrohje, vendoseshin nën dushet, duke pritur që një rojë të lëshonte ujin.

Roja, që hapte e mbyllte rubinetin, rrinte lart, në një platformë, nga e cila e kishte tërë sallën si në pëllëmbë të dorës. Nga ana tjetër, edhe sasia dhe temperatura e ujit vareshin vetëm nga tekat e tij. Në rast se të burgosurit ishin të ngadalshëm ose të zhurmshëm, roja mund t'u lëshonte cirkata

uji akull të ftohtë, duke shkaktuar britma zemërimi dhe proteste, ndërsa të burgosurit hidheshin si të tërbuar sa nga njëra anë te tjetra, në orvatje të kota për të shpëtuar; ose, ndonjë herë tjetër, roja u lëshonte me djallëzi ujë gati të valuar, duke arritur të njëjtin rezultat.

Pikërisht në sallën e dusheve, javën e dytë që ishte në burg, Majllsi u përdhunua nga një grup të burgosurish. Sado të këqija që kishin qenë ato që kishte parë dhe provuar gjer në atë kohë kjo qe më e keqja nga të gjitha. Majllsi duhet t'i kishte humbur krejt ndjenjat, por, pas-taj, erdhi përsëri në vete. Dëgjoi fishkëllimën e bilbilit të një roje. Ishte sinjali i grumbullimit në oborrin e burgut.

Me duart që i dridheshin, pa ditur as vetë mirë se ç'po bënte, Majllsi mori nga koshi rrobat e tij dhe filloi t'i vishte. Pjesa më e madhe e grupit të tij prej pesëdhjetë të burgosurish kishin dalë tanimë në oborr. Një grup tjetër, që sa kishte mbaruar me dushin, ishte gati të kalonte në vendin e caktuar për veshje e zhveshje.

Roja briti me zemërim për të dytën herë:
— Qelbanik i mallkuar, lëviz të thashë!

Majllsi u tërhoq zvarnë törë pjesën tjetër të ditës: kthimi në qeli, më vonë, në mensë, ku nuk mundi ta gëlltiste supën pa shije, të cilën zakonisht e hante, i detyruar nga uria; dhe, më në fund, kthimi në qeli. Tre shokët e qelisë nuk denjuan t'i hidhnin asnjë vështrim, tamam sikut të kishte qenë i gërbulët. I dërrmuar nga dhembja fizike e morale, Majllsi fjeti pak: një gjumë plot shqetësim; pastaj, u zgjua dhe nuk e zuri më gjumi për orë të tëra, duke i ardhur pështirë dhe për të vjellë në ajrin e ndyrë të qelisë; pastaj ra përsëri në gjumë dhe u zgjua prapë pas një kohe të shkurtër.

Majllsin e transferuan pas një a dy ditësh. Natyrisht, ky transferim që rezultati i faktit se njëfarë shumë të hollash kishte ndërruar pronar.

— Paratë i vunë djemtë e «Rrugicës Mafia». Ata të duan ty, vogëlush, — i tha një zezak trupmadh.
— Më duan mua?

Majllsi istini, sikurse dhe të burgosurit e tjerë, ishte në dijeni të së ashtuquajturës «Rrugicë Mafia», e quajtur ndryshe «Kolonia Italiane». Kjo ishte një radhë qelish, ku rrinin ingranazhet e mëdha të krimit të organizuar, kontaktet e të cilit me botën jashtë burgut dhe ndikimi i tij bënin që drejtori i burgut t'i respektonte dhe bile, sikurse thuhej, t'ua kishte frikën. Privilegjet që gëzonin ata aty në Drumonburg ishin legjendare.

Këto privilegje përmbanin vende kyçe në organizimin e brendshëm të burgut, një liri më të madhe lëvizjeje dhe ushqim të cilësisë së parë: ushqimi, furnizohej fshehurazi nga rojat, ose vidhej drejtpërdrejtë në magazinë. Majllsi kishte dëgjuar të thuhej se banorët e «Rrugicës Mafia» ushqeheshin shpeshherë me biftekë dhe ushqime të tilla të shijshme, të gatuara në furnela me skara (që ishin të ndaluara), në vende të veçuara. Nga ana tjetër, qelitë e tyre ishin të pajisura me sende luksi, si televizorë dhe llamba dielli[1]). Por, vetë Majllsi, s'kishte pasur as kontaktin më të vogël me «Rrugicën Mafia» dhe as e kishte përfytyruar që ndokush atje të kishte dijeni për ekzistencën e tij.

— Thonë se ti je djalë i aftë.

Një pjesë e misterit u sqarua pak ditë më vonë, gjatë kohës së «shëtitjes», kur një i burgosur me emrin LaRoka, me barkun sa një vozë dhe fytyrë dinake, iu afrua Majllsit. Të gjithë e dinin se LaRoka, ndonëse nuk «banonte» në «Rrugicën Mafia», ishte në kontakt me atë ambient; ai kryente detyrat e lajmëtarit.

LaRoka i tha Majllsit:
— Kam për ty një mesazh nga ana e rusit.

Majllsi u drodh, duke e ndier veten befas keq. Igor Ominski, i quajtur «rusi», ishte fajdexhiu, të cilit ai i detyrohej

akoma disa mijëra dollarë, pa logaritur shumën e rëndësishme që duhej të ishte rritur, ndërkohë, nga interesi.

Kishin qenë pikërisht kërcënimet e Ominskit, para gjashtë muajsh, që e kishin shtyrë Majllsin të bënte vjedhjen e të gjashtëdhjetë mijë dollarëve në bankë, pas së cilës kishin dalë pastaj në dritë edhe përvetësimet e tij të mëparshme.

— Ominski e di se e ke mbajtur sqepin mbyllur, — vazhdoi LaRoka, — Atij i pëlqen mënyra si veprove dhe thotë se je djalë i mirë.

Ishte e vërtetë se, gjatë hetuesisë, ai s'kishte zënë me gojë as emrin e organizatorit të basteve dhe as të fajdexhiut, nga të cilët kishte shumë frikë. I qe dukur se, duke përmendur emrat e tyre, nuk do të fitonte asgjë, por, përkundrazi mund të humbiste shumë. Sidoqoftë, në këtë çështje s'kishin ngacmuar shumë, as Nënndarja dhe as Byroja Federale e Hetimeve.

— Meqenëse nuk u zbërtheve, — vazhdoi LaRoka, — Ominski më ka thënë të të njoftoj se, gjatë kohës që je brenda, ai e mban në vend sahatin.

Majllsi e kapi menjëherë kuptimin e kësaj shprehjeje. Kjo do të thoshte se, gjatë kohës që ai ndodhej në burg, interesi i huasë nuk do të merrej parasysh. I njihte mire fajdexhinjtë, sa të kuptonte se lëshimi që i ishte bërë s'ishte i paktë, Mesazhi shpjegonte, nga ana tjetër, se si kishte qenë e mundur për «Rrugicën Mafia» në sajë të kontakteve të saj me jashtë, të kishte marrë vesh për të.

— Falënderojeni nga ana ime zotin Ominski, — tha Majllsi. Ndërkaq ai s'kishte as idenë më të vogël se si do të mundej ta shlyente borxhin, mbasi të dilte nga burgu dhe, bile, as se si do të bënte për të jetuar.

LaRoka i tha:

— Dikush do të të kërkojë, para se të dalësh jashtë. Ndoshta do të mund të merremi vesh.

Pasi bëri një përshëndetje me kokë, që përfshinte edhe Karlin, ai u largua.

Javën tjetër, Majllsi pati raste të tjera për të parë LaRokën, i cili shumë herë kërkoi shoqërinë e tij, si edhe të Karlit. Një gjë që dukej se tërhiqte në mënyrë të veçantë LaRokën dhe të burgosur të tjerë ishte kompetenca e Majllsit për historinë e parave. Në njëfarë mënyre, ajo që kishte qenë një herë vetëm një interesim dhe një lloj zbavitjeje e preferuar në kohën e lirë, bëri që Majllsi të fitonte atë lloj respekti që të burgosurit ushqejnë për ata, origjina dhe krimet e të cilëve janë intelektuale, në ndryshim nga ato që janë vetëm të dhunshme. Në shkallën shoqërore të burgjeve, një grabitës rrugësh është në shkallën më të ulët, ndërsa ai që di të bëjë mashtrime dhe përvetësime të paligjshme, është pothuajse në krye.

Ajo që e magjepste sidomos LaRokën ishte përshkrimi nga Majllsi i falsifikimeve masive të bëra nga qeveri të ndryshme të parave të vendeve të tjera. «Këto kanë qenë gjithmonë falsifikimet më të mëdha,» — kishte thënë një ditë Majllsi, duke folur para një grupi të përbërë nga pesë a gjashtë të burgosur, që tregonin interesim për ato që po dëgjonin.

Ai përmendi shembullin e qeverisë britanike, e cila, duke u orvatur që të shpartallonte revolucionin francez, vendosi shtypjen e sasive të mëdha të kartëmonedhave franceze të falsifikuara. Kjo gjë u bë me gjithë faktin se, i njëjti krim, po të kryhej nga persona privatë, dënohej me varjen e fajtorëve, (dënim që mbeti në fuqi në Angli deri në vitin 1821). »Vetë revolucioni englez, — kishte vazhduar Majllsi, — filloi me falsifikimin zyrtar të bankënotave angleze. Por, falsifikimi më i madh në të gjithë historinë u bë në Luftën e Dytë Botërore, gjatë së cilës Gjermania shtypi njëqind e dyzet milionë sterlina, në valutë angleze, dhe një sasi të panjohur në dollarë amerikanë. Të gjitha në cilësi shumë të mirë. Edhe anglezët

shtypën kartëmonedha gjermane dhe, po ashtu, siç flitej, edhe pjesa më e madhe e aleatëve të tjerë.»

— Pa shikoni çfarë njerëzish! — tha LaRoka. — Dobiqër si ata që na kanë rrasur ne këtu brenda. E vë me bast se edhe tani bëjnë para të falsifikuara.

Një pjesë të gjërave që mësonte nga Majllsi, ai ua referonte shokëve të «Rrugicës Mafia» dhe i ishte mirënjohës Majllsit për prestigjin që i jepte kjo gjë.

— Kur të dalësh jashtë, unë dhe njerëzit e mi do të të ndihmojmë, — i tha një ditë, duke e plotësuar më mirë premtimin e mëparshëm. Majllsi e dinte tanimë se lirimi i tij dhe i LaRokës do të bëheshin, pak a shumë, në të njëjtën kohë.

Të fliste për historinë e parasë ishte për Majllsin njëfarë argëtimi mendor, diçka e largonte — së paku për një kohë — tmerrin e së tanishmes. Dhe njëfarë lehtësimi ia jepte edhe pezullimi i interesit të huasë nga ana e rusit. Mirëpo, të gjitha këto nuk e ndalonin, përveçse për periudha kohe të shkurtra, ta ndjente veten një qenie të ulët dhe të përbuzur. Kështu ndodhi që filloi të mendonte për vetëvrasje.

Vetëvrasja filloi t'i dukej një zgjidhje logjike: një ilaç për të gjitha të këqijat, një mbarim, një çlirim. Kjo mund të bëhej, ndonëse ishte e vështirë në një burg me aq shumë njerëz. Të varej? Që kur e kishin sjellë aty, së paku nja pesë herë — zakonisht natën — kishte dëgjuar të thirrura «Po varet! Po varet!», ndërsa rojat, duke mallkuar, lëshoheshin me vrap, si trupa sulmi hinin llozit të zhbllokonin portat e një radhe qelish, shpërthenin derën e njërës prej tyre dhe nxitonin ta ulnin, kandidatin për varje, para se të vdiste. Në tri nga këto raste, rojat kishin arritur tepër vonë dhe të burgosurit kishin duartrokitur me britma dhe të qeshura të ngjethura. Menjëherë pas kësaj, meqenëse vetëvrasësit i shkaktonin kokëçarje të mëdha drejtorit të burgut, roja e natës ishte

përforcuar. Mirëpo, në çdo rast, masat që merreshin nuk kishin jetë të gjatë.

Majllsi e dinte metodën që përdorej për t'u varur. Njomej një rrip çarçafi ose kuverte, me qëllim që të mos grisej (mënyra më e mirë dhe e shpejtë ishte të urinohej mbi të); pastaj, lidhej mirë te një tra i tavanit, që mund të arrihej nga njëri prej shtretërve të sipërm. Çdo gjë bëhej në heshtje, ndërsa shokët e qelisë flinin...
Por, në fund, vetëm një gjë e kishte përmbajtjur, një gjë e vetme. Asnjë mendim tjetër nuk do të kishte mundur ta ndalte.
Ai donte kur të dilte nga burgu, të shkonte e t'i kërkonte ndjesë Huanita Nunjezit.
Pendimi i tij, në kohën kur ishte dënuar, kishte qenë i vërtetë. Majllsi kishte brejtje të ndërgjegjes për përvetësimet që kishte bërë në Fërst Merkëntajll Emërikën Benk; ku e kishin trajtuar mirë, gjë që ai ua kishte shpaguar me të kundërtën. Shpeshherë, e pyeste veten se si kishte mundur ta mbyste zërin e ndërgjegjes së tij gjer në atë pikë.
Nganjëherë, kur mendonte tani për këtë gjë, i dukej sikur kishte qenë në zotërimin e një kllapie. Bastet, standardi i një mënyre jetese më të lartë se mundësitë e tij, marrëzia e të kërkuarit para nga një fajdexhi, përvetësimet e herëpashershme.... Të gjitha këto i dukeshin tani si një varg marrëzish të kryera nga një i marrë. Duhet të kishte humbur çdo kontakt me realitetin, ashtu siç ndodh kur të kanë zënë ethe shumë të forta. Mendja e tij duhej të kishte pësuar një deformim të tillë sa të mos mund ta dallonte më sjelljen e mirë dhe vlerat morale.
Në ç'mënyrë tjetër e kishte pyetur ai veten me mijëra herë, mund të shpjegohej fakti që ai kishte rënë aq poshtë sa të hidhte mbi Huanita Nunjezin fajin për një shkelje ligjore, të

kryer nga ai vetë?
Gjatë procesit e kishte ndier veten aq të turpëruar saqë s'kishte pasur as guximin të hidhte sytë nga Huanita.
Mirëpo tani, pasi kishin kaluar gjashtë muaj, skrupujt e tij për bankën ishin pakësuar. Ai ishte sjellë shumë keq me FMA-në, por aty në burg do ta paguante gjer në qindarkën e fundit. Për perëndi, po e paguante!
Mirëpo, as Drumonburgu me gjithë gjendjen e tmerrshme që ekzistonte atje, nuk mund ta shlyente atë që ai i detyronte Huanitës. Asgjë s'do të mund ta bënte këtë. Prandaj, ai duhet të shkonte ta takonte dhe t'i kërkonte që ta falte.
Kështu, Majllsi rezistoi, sepse për të bërë këtë gjë duhej të jetonte.

— Këtu është Fërst Merkëntajll Emërikën Benku, — tha në telefon me shpejtësi operatori valutor i FMA-së. Ai e mbante receptorin, si zakonisht, midis supit dhe veshit të majtë, në mënyrë që t'i kishte duart e lira. — Dua gjashtë milionë dollarë gjer nesër. Sa është interesi juaj?
Nga bregu perëndimor në Kaliforni, u dëgjua zëri i një operatori valutor të bankës vigane që zvonriste fjalët Benk ov Emërika.
— Trembëdhjetë e gjashtëdhjetë e dy e gjysmë.
— Pak si i lartë, — tha operatori i FMA-së.
— Zor që të ulet.
Operatori i FMA-së ngurroi, duke u munduar të kuptonte parashikimet e tjetrit dhe duke pyetur veten se ç'drejtim po merrte përqindja e interesit të huave. Ishte mësuar që mos t'i tërhiqej vëmendja nga shushuritja e vazhduar e zërave në Qendrën Valutore — një pikë nevralgjike në gratacielin e Drejtorisë Qendrore të FMA-së, e ruajtur nga njerëz të sigurimit, për të cilën pak klientë të bankës kishin dijeni dhe që një numër shumë i vogël të privilegjuarsh e kishin parë. Por, në qendra si kjo, një bankë e madhe i siguron — ose i humbet — pjesën më të mirë të fitimeve të saj.

Nevoja për të përballuar çdo të papritur bëjnë që bankat të mbajnë mënjëanë një sasi të caktuar parash, për të qenë në gjendje t'ju përgjigjen kërkesave të mundshme, por asnjë bankë nuk dëshiron të ketë një sasi tepër të madhe parash të pashfrytëzuara, ose shumë pak para. Operatorët valutorë kujdesen për t'i mbajtur ato në ekuilibër.
— Prisni një çast, ju lutem, — i tha operatori i FMA-së kolegut të San Fransiskos. Shtypi buttonin që të vazhdonte të ishte në linjë, pastaj një buton tjetër të thirrjeve automatike. Një zë tjetër u dëgjua:
— Meniufekçërers Henovër Trast, Nju Jork.
— Dua gjashtë milionë dollarë gjer nesër. Sa është interesi juaj?
— Trembëdhjetë e shtatëdhjetë e pesë.
Në bregun lindor, përqindja e interesit ishte në ngritje.
— Falemnderit.
— S'ka gjë.

Operatori i FMA-së e mbylli komunikimin me Nju Jorkun dhe u lidh përsëri me San Fransiskon.
– Në rregull, po e marr.
– Atëherë, ju shes gjashtë milionë me trembëdhjetë e gjashtëdhjetë e dy e gjysmë, – tha Banka e Amerikës.
– Në rregull.
Ky operacion ishte kryer për njëzet sekonda dhe ishte një nga mijëra operacionet e këtij lloji, që kryheshin çdo ditë ndërmjet bankave rivale, në një garë nervash dhe mprehtësie, në të cilën trajtoheshin çështje që kishin të bënin me shuma me shtatë shifra. Operatorët valutorë ishin gjithnjë të rinj, rreth tridhjetëvjeçarë, të shkathët dhe ambiciozë; të shpejtë në marrjen e vendimeve, të aftë të punonin nën presion, pa humbur toruan. Megjithatë, duke qenë se marrëveshjet e përfunduara me sukses mund t'i sillnin përfitime karrierës së tyre dhe gabimet, ta dëmtonin, tensioni ishte i vazhduar; prandaj, një periudhë prej tre vjetësh, pa ndërprerje, në këtë punë, quhej si maksimumi i kohës që mund të kalohej aty. Pas kësaj periudhe, fillonin të shiheshin shenja ezaurimenti.

Në atë çast, si në San Fransisko ashtu edhe në Fërst Merkëntajll Emerikën Benk, regjistrohej operacioni i sapopërfunduar, i cili i kalohej një kompjuteri dhe, më në fund, i transmetohej Qendrës Valutore të Rezervës Federale. Atje, rezervat e Bankës së Amerikës do të shënoheshin si debitore për shumën prej gjashtë milionë dollarësh dhe ato të FMA-së kreditore për të njëjtën shumë. FMA-ja do t'i paguante Bankës së Amerikës interesin e caktuar për përdorimin e parave të saj, për të gjithë periudhën e këtij përdorimi.

Ndërkaq, në të gjithë vendin, veprime të ngjashme kryheshin ndërmjet bankave të ndryshme.

Ishte një e mërkurë nga mesi i prillit.

Aleks Vandervurti kishte shkuar në Qendrën Valutore, që ishte në bankë në varësinë e tij. E përshëndeti me një lëvizje të kokës operatorin që ishte në një platformë të ngritur, i rrethuar me ndihmës, që i jepnin të dhëna dhe i plotësonin shkresat e nevojshme. Djaloshi, i zhytur në një veprim të ri, iu përgjigj përshëndetjes së Aleksit me një lëvizje të dorës dhe një buzëqeshje të përzemërt.

Në lokalin e madh, si një sallë koncertesh dhe të ngjashëm në disa anë me kullën e kontrollit të një aeroporti me trafik të madh, kishte operatorë të tjerë që merreshin me tituj dhe obligacione dhe ndihmoheshin nga asistentë, llogaritarë, sekretarë. Të gjithë ishin të angazhuar në punë që t'i siguronin bankës – duke dhënë ose marrë hua, duke investuar, shitur, investuar përsëri.

Prapa operatorëve punonin gjashtë inspektorë valutorë, në tryeza pune më të mëdha dhe elegante.

Si operatorët, ashtu edhe inspektorët, kishin përballë një tabelë shumë të madhe, me gjerësinë e vetë lokalit, në të cilën dilnin kuota, përqindje interesash dhe të dhëna të tjera. Shifrat ndryshoheshin vazhdimisht.

Një operator titujsh, që punonte ju shumë larg vendit ku ishte ndalur Aleksi, u ngrit në këmbë dhe njoftoi me zë të lartë:
– Ford end Junaitid Oto Uërkers sapo njoftoi se ka përfunduar një kontratë të re dyvjeçare. – Disa operatorë të tjerë ngritën menjëherë receptorët e telefonave. Për shkak të efektit të tyre të menjëhershëm mbi kuotat e titujve, lajmet e rëndësishme me karakter industrial dhe politik komunikoheshin gjithnjë në këtë mënyrë nga i pari që vihej në dijeni.

Mbas pak sekondash, një dritë e gjelbër në tabelën e madhe u shua dhe u zëvendësua me një dritë të verdhë që herë shuhej e herë ndizej. Ky sinjal i njoftonte operatorët që të mos merrnin angazhime, deri sa të njoftoheshin kuotat e reja. Një dritë e kuqe, që ndizej e shuhej (e përdorur rrallë), ishte paralajmërim për ndryshime shumë më të mëdha dhe më të rëndësishme.

Ndërkaq, veprime valutore, që po vëzhgonte Aleksi, mbeteshin gjithnjë kollona kryesore e të gjithë veprimtarisë së Qendrës.

Ligjet federale u impononin bankave që të mbanin para gjer në shtatëmbëdhjetë e gjysmë për qind të shumës së përgjithshme të depozitimeve në llogari rrjedhëse. Gjobitjet në raste shkeljeje të dispozitave ishin të rrepta. Mirëpo, nga ana tjetër, ishte politikë bankare jo e mirë të lije të pashfrytëzuara shuma të mëdha të hollash, edhe për një ditë të vetme.

Për këtë arsye, bankat bënin një kontroll të vazhduar të të gjithë sasisë së parasë që hynte ose dilte. Arka qendrore kontrollonte pa pushim rrymën e parave, ashtu siç bën mjeku me pulsin e pacientit. Në rast se depozitimet e një instituti bankar, si ishte Fërst Merkëntajll Emerikën Benku, e kalonin vlerën e parashikuar, Banka ua jepte hua menjëherë shumën e tepërt, me mprehtësinë e opratorit të saj valutor, bankave të

tjera që kishin mungesë rezervash. Në qoftë se, përkundrazi, tërheqjet e klientëve kishin qenë më të mëdha se zakonisht, atëherë ishte FMA-ja që kërkonte hua.

Gjendja e një banke ndryshonte nga njëra orë në tjetrën, kështu që një bankë që mund të kishte qenë huadhënëse në mëngjes, mund të ishte huamarrëse në mesditë dhe, përsëri, huadhënëse para orarit të mbylljes. Në këtë mënyrë, një bankë e madhe mund të trajtonte gjatë një dite më se një miliard dollarë.

Mbi këtë sistem mund të bëheshin dhe shpeshherë bëheshin dhe dy vërejtje të tjera. Së pari: bankat janë zakonisht më të shpejta kur kërkojnë një fitim për veten e tyre se sa për klientët. Së dyti: bankat interesohen shumë më tepër për interesat e veta sesa për interesat e atyre që u kanë besuar paratë.

Aleks Vandervurti kishte shkuar në Qendrën Valutore pjesërisht për të parë pulsin e rrymës së parave, siç bënte shpeshherë, dhe pjesërisht për të diskutuar mbi zhvillimin e ngjarjeve që kishin ndodhur gjatë javëve të fundit, për të cilat ishte mjaft i merakosur.

Aleksin e shoqëronte Tom Stroani, kryeekonomisti i FMA-së dhe anëtar i komisionit të investimeve. Ai e kishte zyrën aty pranë dhe kishte hyrë në Qendrën Valutore bashkë me Aleksin. Në janar, ai kishte qenë kundër shkurtimit të fondeve për Rajonin Lindor, por, tani, ishte në favor të propozimit për dhënien e kreditit Suprënejshnëlit.

Në atë çast, ata të dy po diskutonin pikërisht për SuNatKo-n.

— Merakosesh tepër, Aleks, — nguli këmbë Tom Stroani. — Përveç faktit se është një operacion pa rreziqe, ne do të kemi përfitime të mëdha. Për këtë jam i bindur.

Aleksi iu përgjigj me padurim:

— Nuk ka operacione pa rreziqe. Nga ana tjetër, më shumë se për Suprënejshnëlin, jam i shqetësuar për rubinetat që do të na duhet të mbyllim në sektorë të tjerë.

Të dy e dinin se për cilat «rubineta» të Fërst Merkentajll Ëmerikën Benkut, e kishte fjalën Aleksi. Para pak ditëve, anëtarët e komisionit të investimeve kishin marrë një memorandum propozimesh, të hartuar nga Rosko Hejuordi dhe të miratuar nga presidenti i bankës, Xherom Petërtoni. Për të bërë të mundur dhënien e kreditit prej pesëdhjetë milionë dollarësh Suprënejshnëlit, propozohej të shkurtoheshin në mënyrë drastike fondet për huatë dhe hipotekat e vogla.

— Në rast se krediti miratohet dhe ne i bëjmë këto shkurtime, — vërejti Tom Stroani, — kjo do të jetë vetëm një masë e përkohshme. Pas tre muajve, ose ndoshta edhe më pak, fondet do të vijnë përsëri në nivelin e tanishëm.

— Ti mund ta besosh atë, Tom. Unë jo.

Aleksi e kishte ndier veten të rënë moralisht edhe para se të vinte aty. Biseda me riun Stroan e mërziti edhe më shumë.

Propozimet Hejuord-Petërton ishin në kundërshtim jo vetëm me bindjet e tij, por edhe me instinktet e tij financiare. Ishte gabim, mendonte Aleksi, t'i drejtoje fondet e bankës — në një masë aq të madhe dhe në dëm të shërbimit publik — në një hua të vetme industriale, edhe pse financimi i industrisë ishte shumë më rentabël. Por edhe duke e parë këtë çështje vetëm nga pikëpamja tregtare, madhësia e angazhimit të bankës ndaj Suprënejshnëlit — nëpërmjet degëve të SuNatKo-s — e shqetësonte mjaft.

Ai e dinte se, përsa i përkiste këtij angazhimi, ai ishte në pakicë; kishte mbetur vetëm. Të gjithë funksionarët e tjerë të lartë të bankës ishin shumë të kënaqur për lidhjen e marrëdhënieve tregtare me Suprënejshnëlin dhe Rosko Hejuordit i ishin drejtuar përgëzime të përzemërta që i kishte përfunduar bisedimet me sukses. Megjithatë, Aleksi

vazhdonte të ishte i merakosur, ndonëse dhe vetë ai nuk arrinte të shpjegonte arsyen. Sigurisht, nga ana financiare, Suprënejshnëli dukej të ishte në gjendje shumë të mirë: bilancet e saj tregonin se shoqëria shumëkombëshe vigane rrezatonte shëndet nga të gjitha poret e saj. Dhe, po të shihej nga ana e prestigjit, SuNatKo-ja ishte në një nivel me shoqëri si Xhenerël Motors, IBM, Exxon, Dypon dhe US Steel.

Ndoshta, mendoi Aleksi, dyshimet dhe rënia e tij moralisht e kishin origjinën te fakti se, gjatë javëve të fundit, ndikimi i tij në sferat e larta të bankës kishte filluar të binte. Përkundrazi, ylli i Rosko Hejuordit ishte duke u ngritur lart me shpejtësi. Hejuordi gëzonte tanimë besimin e plotë të Petërtonit, një besim që ishte përforcuar shumë më tepër pas suksesit të shkëlqyeshëm të arritur gjatë qëndrimit prej dy ditësh të Hejuordit në ishujt Bahama me Xh. Xh. Kuartermejnin. Aleksi e dinte se rezervat që ai mbante ndaj një suksesi të tillë shikoheshin nga të tjerët vetëm si diçka të shkaktuar nga zilia.

Veç kësaj, Aleksi e shihte se kishte humbur edhe ndikimin që kishte pasur mbi Stroanin dhe të tjerët, të cilët, deri pak kohë më parë, mbanin anën e tij.

— Duhet të pranosh, — tha Stroani, — se puna me Suprënejshnëlin është me përfitim. E dëgjove se Roskoi mundi të bindë ata të pranojnë një bilanc kompensimi prej dhjetë për qind?

Bilanci i kompensimit ishte një kompromis, në të cilin arrihej mbas pazarllëqesh të gjata ndërmjet bankës dhe huamarrësve. Banka kërkonte që një pjesë e paracaktuar e çdo huaje të mbahej në një llogari rrjedhëse pa përfitim interesi për depozituesin, po që banka mund ta dispononte për përdorim të saj dhe investim. Kështu, një huamarrës nuk mund ta përdorte plotësisht huanë e dhënë dhe, pra, paguante një përqindje interesi shumë më të madhe se ajo që ishte caktuar. Në rastin e Suprënejshnëlit, siç e kishte vënë në dukje

Tom Stroani, në llogarinë e rregullt të SuNatKo-s do të mbeteshin — krejt në përfitim të FMA-së — së paku pesë milionë dollarë.

— Mendoj, — tha Aleksi, me ton sarkastik, — se do të jesh në dijeni të faqes tjetër të kësaj pune me kaq përfitim.

Tom Stroani u duk sikur po e ndjente veten ngushtë.

— E po, kam dëgjuar se është arritur një marrëveshje. Megjithatë, nuk besoj se mund të quhet «faqja tjetër».

— Po, po, ashtu mund të quhet, djali ta marrë! Të dy ne e dimë se SuNatKo-ja ka ngulur këmbë dhe Roskoi ka pranuar që të bëjmë investime të rëndësishme në aksionet e saj.

— Edhe po të jetë ashtu, s'ka asgjë me shkrim.

— Natyrisht që s'ka! Askush s'do të ishte aq budalla. — Aleksi ia nguli sytë djaloshit. — Ti ke mundësinë t'i shohësh shifrat. Sa kemi blerë gjer tani?

Stroani pati një çast ngurrimi, pastaj u drejtua për te tryeza e punës së njërit nga inspektorët. U kthye prej andej, me një fletë letre në dorë.

— Deri më sot, nëntëdhjetë e shtatë mijë aksione, — tha dhe, pastaj, shtoi: — Kuota e fundit ishte pesëdhjetë e dy.

Aleksi ia priti me pamje të zymtë:

— Në Suprënejshnël do të jenë duke fërkuar duart. Blerjet tona i kanë ngritur tanimë aksionet e tyre me pesë dollarë. — Bëri me mend një llogari të shpejtë — Pra, javën e kaluar, i kemi dhënë Suprënejshnëlit afro pesë milionë dollarë nga depozitimet që janë në administrimin fiduciar. Pse?

— Ky është një investim shumë i mirë. — Stroani u mundua të tregohej i shpenguar. — Do të nxjerrim fitime për të gjithë jetimët dhe gratë e veja dhe institucionet kulturore, për paratë e të cilave ne përkujdesemi.

— Ose, i flakim nga dritarja duke e tradhtuar kështu besimin e tyre. Tom, ç'dimë ne për SuNatKo-n më tepër nga ç'dinim para dy javëve? Pse gjer në këtë javën e fundit s'kishim blerë asnjë aksion të vetëm të Suprënejshnëlit.

Djaloshi qëndroi një çast në heshtje, pastaj tha në një mënyrë sikur donte të mbrohej:

— Ndoshta Roskoi mendon se, tani që ka një vend në këshillin e tyre administrativ, mund ta vëzhgojë SuNatKo-n më nga afër.

— Po më zhgënjen, Tom. Përpara s'ke qenë kurrë i pandershëm me veten tënde, veçanërisht kur e di se si janë në të vërtetë punët. — Ndërsa Stroani po skuqej, Aleksi vazhdoi: — E ke idenë se çfarë skandali do të shpërthente në qoftë se SEC-i do të vinte të ngatërrohej në këtë punë? Ka konflikt interesash, shkelje të ligjit mbi huatë bankare, financim të veprimeve tregtare të bankës me paratë e depozitimeve fiduciare...

Stroani tha me ton të ftohtë:

— E di, e di, ashtu është, por kjo nuk do të ishte hera e parë as te ne.

— Për fat të keq, kjo është e vërtetë, por kjo nuk e bën gjendjen aspak më të pëlqyeshme.

Çështja e etikës së investimeve nuk ishte e re. Zyrtarisht, bankat ngrinin një barrierë të brendshme — e quajtur nganjëherë «muri kinez» — midis interesave të veta dhe depozitimeve fiduciare. Por, realiteti ishte i ndryshëm.

Kur një bankë kishte miliarda dollarë depozitime fiduciare; ishte e pashmangshme t'i investonte në mënyrë që të nxirrte edhe fitime për veten e saj. Firmat, të të cilat banka bënte investime të rëndësishme, e kishin heshtazi të qartë se duhet të preferonin në praktikën e tyre bankare dhe, shpeshherë, u kërkohej që të caktonin në këshillin e tyre administrativ një

anëtar të këshillit të vet bankës. Në rast se nuk bënin asnjërën nga të dyja, aksionet e tyre, që ishin në zotërim të bankës, zëvendësoheshin me të shpejtë me të tjera dhe pësonin një tronditje të madhe e serioze, për shkak të shitjes tek të tyre.

Gjendja ishte e njëjtë për agjentët e këmbimit, që trajtonin masën shumë të madhe të blerjeve e shitjeve të titujve, për llogari të një banke të madhe: dhe ata duhej të përdornin vetëm sportelet e saj. Zakonisht, kështu bënin. Në rast të kundërt, mandati aq i dëshiruar i narkohej një agjenti tjetër.

Me gjithë propagandën e zyrës së marrëdhënieve publike të bankave, interesat e klientëve të depozitimeve fiduciare, duke përfshirë vejushat dhe jetimët proverbialë, kalonin shpesh në radhë të dytë, pas interesave private të vetë bankave. Kjo ishte një nga arsyet që rezultatet e seksioneve fiduciare ishin përgjithësisht aq të varfra.

Në këtë mënyrë, Aleksi e dinte se gjendja që ekzistonte midis Suprënejshnëlit dhe FMA-së nuk ishte një rast i veçantë dhe i vetëm. Sidoqoftë, fakti që ta dije nuk e bënte më të pëlqyeshme.

— Aleks, — tha papritur Tom Stroani, — është më mirë ta dish se nesër, në komisionin e investimeve, kam ndërmend të përkrah huanë për Suprënejshnëlin.

— Më vjen keq që dëgjoj një gjë të tillë.

Por ky lajm nuk ishte i papritur. Dhe Aleksi i bëri pyetjen vetes se edhe sa kohë duhej akoma, deri sa ai të mbetej aq vetëm dhe i izoluar, saqë të mos mund ta mbante më postin e tij në bankë. «Jo dhe shumë kohë,» — tha me vete.

Pas mbledhjes së të hënës së komisionit të investimeve, gjatë së cilës propozimet lidhur me Suprënejshnëlin do të miratoheshin me siguri nga shumica e anëtarëve, të mërkurën do të mblidhej dhe këshilli administrativ, duke pasur në rend të ditës, po ashtu, çështjet lidhur me Suprënejshnëlin. Aleksi

ishte i sigurt se i vetmi mendim i kundërt në të dyja mbledhjet do të ishte mendimi i tij.

I hodhi edhe një herë sytë Qendrës Valutore tërë gjallëri, të angazhuar në punë për të siguruar fitime dhe pasuri; krejtësisht e ngjashme — në parimet themelore — me tempujt e lashtë të parasë të Babilonisë e të Greqisë. Në vetvete, mendoi ai, kjo tregti, këto para dhe kjo pasuri nuk ishin qëllime të ulëta dhe pa vlerë. Vetë ai u ishte kushtuar të treve ndonëse jo në mënyrë të verbër dhe me disa rezerva që lidheshin me skrupujt e tij moralë, me shpërndarjen racionale të pasurisë dhe etikën bankare. Mirëpo, siç e tregonte historia, kur kishte perspektiva për fitime të jashtëzakonshme, ata që shprehnin rezerva të tilla i detyronin të heshtnin ose i mënjanonin.

Çfarë mund të shpresonte të bënte një njeri, i mbetur krejt vetëm në opozitë, kundër forcave jashtëzakonisht të fuqishme të afaristëve e të parasë, që përfaqësoheshin në rastin e tij nga Suprënejshnëli dhe shumica e këshillit të FMA-së?

«Pak, — përfundoi me pamje të zymtë Aleks Vandervurti. — Ndoshta aspak».

Mbledhja e këshillit administrativ të Fërst Merkentëill Emerikën Benkut, që u bë javën e tretë të prillit, mbeti e paharrueshme nga shumë pikëpamje.

Në rend të ditës ishin dy çështje të rëndësishme lidhur me rrugën që duhet të ndiqte banka, të cilat u dhanë shkas diskutimeve të zjarrta — njëra ishte kredia për Suprënejshnëlin; tjetra, propozimi për zgjerimin e depozitimeve të kursimit dhe për hapjen e shumë degëve të tjera të bankës në periferi të qytetit.

Atmosfera që do të mbizotëronte në mbledhje ishte e qartë edhe para fillimit të saj. Rosko Hejuordi, gazmor dhe i qetë, me një kostum elegant bojë hiri të çelët, erdhi para kohës së caktuar dhe filloi të përshëndeste, të dera, këshilltarët e tjerë që po vinin njëri pas tjetrit. Nga përzemërsia e përshëndetjeve

të tyre ishte e qartë se pjesa më e madhe e këshilltarëve jo vetëm që ishin në dijeni, nëpërmjet thashethemeve të mjedisit financiar, të marrëveshjes me Suprënejshnëlin, por e shihnin këtë gjë me sy shumë të mirë.

— Përgëzime, Rosko, — tha Filip Xhohensëni, president i Mid Kontinent Rabërit. — Po e çon me të vërtetë këtë bankë drejt grupit të bankave më të mëdha. Kështu, gjithnjë përpara, mik i dashur!

— Me fytyrën që i shndriste nga kënaqësia, Hejuordi u përgjigj:
— E çmoj përkrahjen tënde, Fil. Dua ta dish se kam në mend edhe projekte të tjera.
— Do t'i realizosh, mos ki frikë.
Në atë çast hyri një Këshilltar nga Veriu, i quajtur Fllojd LëBerr, president i shoqërisë Xhenërël Kejbel end Suitshgir Korporejshën. Në të kaluarën, LëBerri s'ishte treguar kurrë shumë i përzemërt me Hejuordin, por tani ia shtrëngoi dorën fort e me përzemëri.
— M'u bë shumë qejfi, kur mësova se do të marrësh pjesë në këshillin e Suprënejshnëlit. — E uli zërin dhe shtoi: — Reparti im i shitjeve ngul këmbë për të vendosur lidhje me SuNatKo-n. Do të doja të bisedonim së shpejti për këtë gjë.
— E lëmë për javën e ardhshme, — tha Hejuordi. — Rri i qetë, do të kesh tërë ndihmën time.
I kënaqur, LëBerri shkoi të zërë vend te tryeza e këshillit. Harold Ostini, që e kishte dëgjuar bisedën e shkurtër, i shkeli synë Hejuordit.
— Udhëtimi ynë i vogël dha fruta të mira. Si duket, po ngjitesh lart.
Atë ditë, i nderuari Harold kishte më shumë se çdo herë tjetër pamjen e një play-boy, në moshë të pjekur. Ai kishte veshur një xhaketë me kuadrate skoceze, pantallona ngjyrë kafe të çelur, këmishë me vizatime të gjalla dhe një kravatë papion, blu të hapur. Flokët e bardhë e të gjatë ishin rregulluar sipas modës së fundit.
— Harold, — tha Hejuordi, — po qe se ka ndonjë gjë që

mund të bëj, në këmbim të...
— Do të ketë, — e siguroi i nderuari Harold dhe shkoi të zërë vend në tryezën e këshillit.
Edhe vetë Leonard L. Kingsudi, presidenti energjik i Northam Stelit dhe përkrahësi më i zjarrtë i Aleks Vandervurtit në këshill, tha fjalë të mira në kalim e sipër.
— Dëgjova se e rregullove punën me Suprënejshnëlin, Rosko. Më të vërtetë, një punë e klasit të parë.
Edhe këshilltarë të tjerë i shprehën gjithashtu përgëzime të ngjashme.
Ndërmjet atyre që mbërritën të fundit ishin Xherom Petërtoni dhe Aleks Vandervurti. Presidenti i bankës, me kokën e tij të ndritshme tullace, pa asnjë fije floku, dhe me pamjen e tij të zakonshme të një fisniku fshati, shkoi menjëherë në krye të tryezës së gjatë vezake. Aleksi, me një dosje plot me letra në dorë, u ul në vendin e tij të zakonshëm, në mes të krahut të majtë.

Petërtoni trokiti me çekanin e tij të vogël për të tërhequr vëmendjen e këshilltarëve dhe, pasi kreu me të shpejtë disa çështje rutine, njoftoi:
— Çështja e parë e rëndësishme për t'u shqyrtuar sot është: Kredia për t'u miratuar nga këshilli.
Rreth tryezës u dëgjua një fështërimë fletësh që ktheheshin ndërsa këshilltarët shfletonin fashikullin tradicional bojë qielli të FMA-së, që përmbante të dhënat mbi kreditë dhe që ishte përgatitur për këshillin administrativ.
— Si zakonisht, zotërinj, ay keni hollësitë e propozimeve të drejtorisë. Sikurse e dini, rëndësi të veçantë ka sot kredia për Suprënejshnël Korporejshënin. Personalisht, jam shumë i kënaqur me kushtet e vendosura dhe rekomandoj nxehtësisht miratimin tuaj. Po ia lë Roskoit, — të cilit i takon merita e sigurimit të këtij klienti të ri e të rëndësishëm të bankës, — detyrën që t'ju paraqesë një kuadër të përgjithshëm të çështjes dhe t'ju përgjigjet pyetjeve.

— Faleminderit, Xherom. — Rosko Hejuordi i vuri përsëri syzet, që sapo i kishte pastruar, për forcë zakoni, dhe u përkul përpara në karrige. Lëvizjet e tij dukeshin më pak të prera se zakonisht dhe zëri, i këndshëm dhe i sigurt.
— Zotërinj, para se të miratohet një kredi për një shumë të konsiderueshme, është me vend të sigurohesh për solidaritetin ekonomik të huamarrësit, edhe kur është fjala për një shoqëri të klasit të parë, siç është Suprënejshnëli. Në shtojcën «B» të fashikullit tuaj (rreth tryezës u dëgjua përsëri një fështërimë fletësh), do të gjeni një përmbledhje, që e kam përpiluar vetë unë, mbi gjendjen e tanishme dhe parashikimet për fitimet e të gjithë grupit të SuNatKo-s, duke përfshirë të gjitha degët e saj. Përmbledhja është mbështetur mbi bilancet e miratuara nga revizorët e llogarive dhe mbi të dhëna të tjera që m'u dërguan, me kërkesën time, nga administratori i Suprënejshnëlit, zoti Stenli Inçbek. Siç mund ta shihni, shifrat janë të shkëlqyeshme. Rreziku është minimal.
— Unë nuk e di se ç'emër ka në sferat financiare Inçbeku, — tha një këshilltar, Uolles Speri, pronar i një fabrike instrumentesh shkencore, — por di se ç'emër ke ti, Rosko, dhe, në rast se i miraton këto shifra, ato për mua janë shumë të mira.

Edhe shumë të tjerë, rreth tryezës, u bashkuan me të, duke shprehur miratimin e tyre.

Aleks Vandervurti nuk i kishte ngritur sytë nga blloku i shënimeve, në të cilin po vizatonte figura të vogla.

– Të faleminderit, Uolles. Ju faleminderit, zotërinj, – Hejuordi buzëqeshi lehtë. – Shpresoj se besimi juaj do të shtrihet mbi veprimin që kam rekomanduar.

Megjithëse rekomandimet ishin shënuar në fashikullin bojë qielli, Hejuordi foli për ato.

– T'u jepet menjëherë një kredi prej pesëdhjetë milionë dollarësh Suprënejshnëlit dhe degëve të saj dhe të shkurtohen njëkohësisht financimet në sektorë të tjerë. Këto financime, – siguroi Hejuordi, – do të rifillojnë «sapo një gjë e tillë të bëhet e mundur dhe të shihet me vend», – por nuk e përcaktoi saktësisht se kur. Ai përfundoi, duke thënë: – Ia rekomandoj nxehtësisht këshillit këtë veprim, duke e garantuar se fitimet tona do të jenë me të vërtetë shumë të mira.

Ndërsa Hejuordi mbështetej përsëri në shpinoren e karriges së tij Xherom Petërtoni njoftoi:

– Mbledhja kalon në shqyrtimin e çështjes dhe diskutime.

– Sinqerisht, – tha Uolles Speri, – këto nuk më duken fare të nevojshme. Çdo gjë është e qartë. Sipas mendimit tim, ky është një operacion bankar i shkëlqyer, prandaj propozoj të miratohet.

Disa zëra thirrën së bashku:

– Edhe unë!

– Propozimi pranohet, – tha Xherom Petërtoni. – Jemi gati për të votuar? – Me sa dukej, ashtu mendonte, mbasi e kishte ngritur tanimë çekanin e vogël.

– Unë jo, – u përgjigj Aleks Vandervurti. Shtyu mënjanë bllokun e shënimeve dhe lapsin dhe shtoi: – Dhe mendoj se askush nuk duhet të votojë, para se të jetë bërë një diskutim i thelluar i çështjes.

Me një psherëtimë, Petërtoni e uli poshtë çekanin e vogël. Për mirësjellje, Aleksi e kishte njoftuar që më parë për qëllimet e tij, por Petërtoni kishte shpresuar se Aleksi, duke parë entuziazmin pothuajse të përgjithshëm të këshillit, do të kishte ndërruar mendje.

– Më vjen shumë keq, – vazhdoi Aleksi, – të mos jem i një mendjeje para këshillit me kolegët e mi Xherom dhe Rosko.

Mirëpo, detyra dhe ndërgjegjja më shtyjnë që të mos e fsheh shqetësimin dhe kundërshtimin tim ndaj kësaj huaje.

– Çfarë ka që s'ecën? Nuk i pëlqen Suprënejshnëli mikeshës sate?

Kjo pyetje thumbuese ishte bërë nga Forest Riçardsoni, prej shumë kohësh këshilltar i FMA-së, i njohur për rreptësinë dhe qëndrimin e tij të prerë. Ai ishte princi trashëgimtar i konservave të mishit.

Aleksi u skuq nga zemërimi. S'kishte dyshim se këshilltarëve u kujtohej se, para tre muajsh, emri i tij ishte lidhur publikisht me veprimin e organizuar nga Margoti, por, sidoqoftë, ai nuk donte të bëheshin aty vërejtje mbi jetën e tij private. Megjithatë, e mbajti veten për të mos dhënë një përgjigje të ashpër, që e kishte në majë të gjuhës, dhe tha:

– Zonjusha Brekën dhe unë rrallë flasim për çështje që kanë të bëjnë me bankën. Të siguroj se, për këtë, s'kemi folur fare.

Një këshilltar tjetër pyeti:

– Por, çfarë është pikërisht që nuk të pëlqen te kjo çështje, Aleks?

– Gjithçka.

Rreth tryezës u dëgjuan pasthirrma që shprehnin habi dhe zemërim. Fytyrat e kthyera nga Aleksi shprehnin një mungesë të plotë solidariteti.

Xherom Petërtoni tha me ton të prerë:

– Do të ishte më mirë t'i paraqisje qartë kundërshtimet e tua.

– Sigurisht, ashtu do të bëj, – Aleksi hapi dosjen që kishte sjellë me vete dhe nxori një fletë.

– Së pari, jam kundër shumës së angazhimit tonë në favor të një huamarrësi të vetëm. Jo vetëm që kjo përfaqëson një përqendrim të rrezikut që bëhet në një mënyrë të pamatur, por, nga ana tjetër, është edhe e paligjshme, sipas nenit 23A të ligjit mbi rezervat federale.

Rosko Hejuordi u hodh në këmbë.

– Nuk e pranoj fjalën «e paligjshme».

– Të mos pranosh nuk do të thotë të ndryshosh realitetin, – ia priti Aleksi me të qetë.

– Ajo që the nuk ishte e vërtetë! Ne e sqaruam se kredia nuk do t'i jepej Suprënejshnëlit vetëm, por edhe disave nga firmat e lidhura me të, siç janë Hepeluajt Distilers, Grinpascërs Lend, Atlas Xhet Lizing, Këribien Fajriens dhe Internejshnël Bejkris. — Hejuordi ngriti lart një dosje bojë qielli. Ndarjet e shumta janë të shënuara këtu fare qartë!
— Të gjitha ato shoqëri janë të kontrolluara nga Suprënejshnëli.
— Por janë edhe shoqëri të krijuara shumë kohë më parë, solide, me të drejta të plota.
— Atëherë, pse sot dhe, në të gjitha rastet e tjera, kemi folur gjithmonë vetëm për Suprënejshnëlin?
— Për thjeshtësi dhe lehtësi, — iu përgjigj Hejuordi, me pamje krejt të kënaqur.
— Edhe ti e di shumë mirë, — nguli këmbë Aleksi, — se, sapo paratë e bankës t'u kenë kaluar shoqërive të varura, Xh. M. Kuortermejni do, të mundet t'i zhvendosë ato ashtu si t'i leverdisë.
— Prisni një çast! — e ndërpreu Harold Ostini, duke u përkulur përpara në karrigen e tij dhe duke përplasur dorën në tryezë, për të tërhequr vëmendjen, — Xhorxhi i madh Kuortermejn është miku im i dashur. Unë nuk mund të rri

këtu e të dëgjoj qetë-qetë të paditet për veprime jo të ndershme.
— S'bëra asnjë padi për veprime të pandershme, — ia priti Aleksi. — Unë po flas vetëm për një praktikë të zakonshme. Ndodh shpesh që shuma të mëdha parash të transferohen ndërmjet degëve të Suprënejshnëlit. Këtë e tregojnë bilancet e tyre. Dhe kjo konfirmon faktin se ne po ia japim kredinë një huamarrësi të vetëm.
— Shkoni! — tha Ostini, duke e hequr vështrimin nga Aleksi dhe duke e kthyer nga anëtarët e tjerë të këshillit, — po përsëris vetëm se e njoh mirë Kuortermejnin dhe, po ashtu, edhe Suprënejshnëlin. Siç e di mirë shumica nga ju, isha unë që e organizova takimin e Roskoit me Xhorxhin e madh, gjatë të cilit u formulua marrëveshja për këtë kredi. Duke pasur parasysh çdo aspekt të operacionit, them se ai është jashtëzakonisht i mirë për bankën.
Pati një çast heshtjeje, që u prish nga Filip Xhohensëni.
— Nuk ka mundësi Aleks, — pyeti presidenti i Mid Kontinent Rabërit, — që të jesh pak ziliqar se në lojën e golfit të Bahamas u ftua Roskoi dhe jo ti?
— Jo. Ato që thashë nuk kanë të bëjnë fare me çështje personale.

Një këshilltar tjetër komentoi, me një ton zëri që shprehte dyshim:
— S'duket ashtu.
— Zotërinj, zotërinj! — Xherom Petërtoni trokiti me forcë çekanini e tij të vogël.
Aleksi e kishte pritur një gjë të tillë. Duke mbajtur gjakftohtësinë, vazhdoi:
— Po e përsëris se kjo kredi është shumë e madhe për një huamarrës të vetëm. Nga ana tjetër, të bësh sikur nuk është fjala për një huamarrës të vetëm është një orvatje e papeshuar mirë për të shkelur ligjin dhe të gjithë ne, këtu, e dimë këtë. —

Ai hodhi një vështrim sfide rreth e qark tryezës.
— Unë nuk e di, — ia priti Rosko Hejuordi, — dhe them se interpretimi yt është tendencioz.
Në këtë çast u bë e qartë se ishte fjala për një rast të jashtëzakonshëm. Në mbledhjet e këshillit, të gjithë ishin zakonisht të një mendjeje; ose shfaqej ndonjë mosmarrëveshje e vogël, për të cilën këshilltarët shkëmbenin mendime të qeta e tërë mirësjellje. Diskutimet e ashpra dhe me ton të inatosur ishin në fakt të panjohura.
Leonard L. Kingsudi e mori fjalën për herë të parë. Me ton pajtues, ai tha:
— Aleks, e pranoj se pohimet e tua e kanë njëfarë baze, por fakti është se veprime të këtij lloji bëhen çdo ditë midis bankave dhe shoqërive të mëdha.
Ndërhyrja e presidentit të Northam Stelit ishte kuptimplote. Në mbledhjen e fundit të dhjetorit, ai kishte qenë përkrahësi më i zjartë për emërimin e Aleksit si president i FMA-së.
— Sigurisht, — vijoi Kingsudi, — edhe shoqëria ime e përdor këtë metodë financimi, por unë s'e ndiej veten fajtor për këtë.
Me keqardhje, sepse e dinte se po humbiste një mik, Aleksi tundi kokën dhe u përgjigj:
— Më vjen keq, Len. Unë vazhdoj të mos e shoh si një gjë të drejtë, ashtu sikurse nuk më duket e drejtë që ta lëmë vetën të hapur për një padi konflikti interesash për faktin se Roskoi do të hyjë në këshillin e Suprënejshnëlit.
Leonard Kingsudi shtrëngoi buzët dhe nuk foli më.
Por foli Filip Xhohensëni. Ai i tha Aleksit, me ton të hidhur:

– Në qoftë se, mbas kësaj vërejtjes së fundit, pret që ne të besojmë se s'ke asgjë personale, je i marrë.

Rosko Heuordi u mundua, por pa sukses, të fshihte një buzëqeshje

Aleksi u ngrit në fytyrë. Pyeti veten nëse kjo do të ishte mbledhja e fundit e këshillit, në të cilën po merrte pjesë; mirëpo, e fundit apo jo, ai kishte ndërmend ta çonte deri në

fund atë që kishte nisur. Bëri sikur nuk i kishte dëgjuar fare fjalët e Xhohensënit dhe vazhdoi:

– Si bankierë, ne nuk duam të mësojmë. Nga të gjitha anët: nga Kongresi, konsumatorët, vetë klientët tanë, shtypi na padisin se i përjetësojmë konfliktet e interesave me anë të pjesëmarrjeve të kryqëzuara në këshillat administrative. Po të jemi të ndershëm me vetveten, duhet të pranojmë se pjesa më e madhe e padive janë të vërteta. Të gjithë e dinë se shoqëritë e mëdha vajgurore janë të lidhura ngushtë midis tyre, pikërisht me metodë të përfaqësuesve që kanë në këshillat administrative të bankave. Dhe ky është vetëm një shembull. Megjithatë ne vazhdojmë, pa hequr dorë, me të njëjtën metodë kryqëzimesh të së njëjtës shkallë: ti do të hysh në këshillin tim dhe unë në tëndin. Kur të bëhet Roskoi këshilltar i Suprënejshnëlit, interesat e kujt do të vërë në radhë të parë? Të Suprënejshnëlit apo të FMA-së? Dhe, kur të marrë pjesë në mbledhjet e këshillit tonë, a do të favorizojë SuNatKo-n kundrejt shoqërive të tjera, për faktin se është këshilltar atje? Aksionistët e të dyja shoqërive kanë të drejtë të kërkojnë përgjigje për këto pyetje dhe, po ashtu, edhe legjislatorët dhe publiku. Dhe, për më tepër, në qoftë se së shpejti nuk do të japim disa përgjigje bindëse, në rast se heqim dorë nga qëndrimi ynë aq mendjemadh, i tërë sistemi bankar do të gjendet para ligjeve të rrepta kufizuese. Dhe ne do t'i meritonim.

– Atëherë, për rrjedhojë logjike, – Forest Ricardsoni ndërhyri, – gjysma e anëtarëve të këtij këshilli mund të paditen për konflikt interesash.

– Pikërisht ashtu. Dhe po afrohet gjithnjë e më shumë çasti, kur banka do të jetë e detyruar të përballojë një gjendje të tillë dhe ta ndreqë.

Riçardsoni tha nëpër dhëmbë:

– Mund të ketë mendime të tjera mbi këtë pikë. – Shoqëria e konservave të mishit, sikurse të gjithë e dinin, kishte marrë

kredi të shumta nga FMA-ja dhe Riçardsoni kishte bërë pjesë në mbledhjet e këshillit, në të cilat ishin miratuar huatë e ndryshme të njëpasnjëshme që i ishin dhënë nga banka.

Pa marrë parasysh qëndrimin armiqësor që sa vinte e shtohej ndaj tij, Aleksi vijoi:

– Jam gjithashtu i merakosur nga aspekte të tjera të huasë për Suprënejshnëlin. Për të pasur në dispozicion paratë e nevojshme, do të na duhet të pakësojmë financimet e vogla dhe huatë hipotekare, kështu që, në këta dy sektorë, banka nuk do të jetë në gjendje të kryejë funksionin e saj të shërbimit publik.

Xherom Petërtoni ia priti me ton të pezmatuar:

– U tha qartë se këto pakësime janë vetëm të përkohshme.

– Sigurisht, – pranoi Aleksi, – mirëpo, askush nuk është në gjendje të thotë se sa e përkohshme do të jetë, ose se sa do të humbasë banka nga materiale dhe morale, gjatë tërë kohës që do të vazhdojë ky pakësim. Dhe, përveç të dy sektorëve që përmenda, ka edhe një të tretë; ai i obligacioneve bashkiake. – Hapi dosjen dhe nxori një fletë tjetër. – Në gjashtë javët e ardhshme, në të gjithë shtetin do të ketë njëmbëdhjetë emetime obligacionesh. Në qoftë se banka jonë nuk do të marrë pjesë në blerjet, së paku gjysma e këtyre obligacioneve do të mbeten pa u shitur. – Zëri i tij u bë më depërtues. – Mos është ndoshta qëllimi i këtij këshilli, pas një kohe kaq të shkurtër nga vdekja e Benit, të heqë dorë nga një traditë që është respektuar gjatë tre brezash Roselësh?

Për herë të parë që nga fillimi i mbledhjes, këshilltarët shkëmbyen vështrime që tregonin se ishin zënë ngushtë. Që nga koha e themeluesit të bankës, Xhovani Roselit, Fërst Merkentajll Ëmerikin Benku kishte qenë në vendin e parë përsa i përkiste blerjes dhe sistemimit të mëtejshëm të obligacioneve të emetuara nga këshillat e vegjël bashkiakë të shtetit. Për këtë ndihmë nga ana e bankës më të madhe të

shtetit, këto obligacione – që s'kishin qenë kurrë ndonjëherë të mëdha, as të rëndësishme dhe as të njohura mirë – do të mbeteshin në fakt pa treg, duke lënë, për rrjedhojë, të zbuluara kërkesat ekonomike të komuniteteve përkatëse. Kjo traditë kishte qenë respektuar gjer në fund nga i biri i Xhovanit, Lorenci, dhe nga i nipi, Beni. Nuk ishte fjala për një punë me shumë përfitim, ndonëse nuk përbënte sigurisht humbje, mirëpo, ajo përfaqësonte një shërbim publik të rëndësishëm dhe, veç kësaj shërbente për të kthyer te komunitetet e vogla një pjesë të parave që qytetarët përkatës depozitonin në vetë bankën.
— Xherom, — sugjeroi Leonard Kingsudi, — ndoshta do të ishte e nevojshme ta shikoje edhe një herë këtë çështje.
U dëgjuan disa murmuritje pëlqimi.
Rosko Hejuordi bëri një vlerësim të shpejtë.
— Xherom .../a. mundem?
Presidenti i bankës pohoi me kokë.
— Duke pasur parasysh ndjenjat e këshillit, — deklaroi Hejuordi, me zë të shtruar, — s'ka dyshim se mund t'i rishikojmë llogaritjet dhe të caktojmë përsëri një pjesë të fondeve për obligacionet bashkiake, pa ndikuar mbi marrëveshjet me Suprënejshnëlin. Sugjeroj që këshilli, mbasi bëri të qarta ndjenjat e tij, të na e lërë Xheromit dhe mua përpunimin e hollësive. — Ra në sy që nuk e përmendi Aleksin.
Këshilltarët shprehën miratimin e tyre me lëvizje të kokës dhe me zë.
Aleksi kundërshtoi:
— Ky nuk është një angazhim i plotë dhe nuk merr parasysh rifillimin e financimeve të vogla dhe të huave hipotekare.
Anëtarët e tjerë të këshillit mbajtën një heshtje kuptimplote.
— Besoj se i dëgjuam të gjitha pikëpamjet, — tha Xherom

Petërtoni. — Ndoshta, tani, mund ta vëmë në votë propozimin në tërësi.
— Jo, — tha Aleksi, — ka akoma dhe një çështje të fundit.
Petërtoni dhe Hejuordi shkëmbyen një vështrim gjysmë të nënshtruar dhe gjysmë të zbavitur.
— Fola më parë për një konflikt interesash, — deklaroi Aleksi. — Tani dua t'i tërheq vëmendjen këshillit lidhur me një tjetër, akoma dhe më të madh. Që prej përfundimit të bisedimeve për dhënien e huasë Suprënejshnëlit e deri dje pasdite, seksioni ynë fiduciar ka blerë (ai u hodhi një sy shënimeve) njëqind e njëzet e tre mijë aksione të SuNatKo-s. Në të njëjtën periudhë dhe, pothuajse sigurisht për shkak të blerjeve në masë, të bëra me paratë e klientëve tanë fiduciarë, kuota e SuNatKo-s është ngritur me shtatë pikë e gjysmë dhe, jam i sigurt, se kjo gjë ka qenë biseduar dhe vendosur si një kusht....
Zëri i tij u mbyt nga një kor protestash nga ana e Rosko Hejuordit, Xherom Petërtonit dhe këshilltarëve të tjerë.
Hejuordi u hodh përsëri në këmbë, me sytë që i lëshonin shkëndija:
— Ky është një shtrembërim i bërë me qëllim.
Aleksi ia priti: — Blerja e aksioneve nuk është shtrembërim.
— Por është interpretimi yt. SuNatKo-ja është një investim i shkëlqyer për depozitimet tona fiduciare.
— Çfarë e bën atë në mënyrë të befasishme kaq të mirë?
Petërtoni protestoi me zjarr:
— Aleks, veprimet specifike të seksionit fiduciar nuk janë çështje që diskutohen këtu.
Filip Xhohensëni thirri:
— Jam i një mendjeje.
Harold Ostini dhe shumë të tjerë thanë, gjithashtu, me zë të lartë:

— Edhe unë!
— Janë a s'janë çështje që diskutohen këtu, — nguli këmbë Aleksi, — unë ju paralajmëroj të gjithëve se, gjërat që po ndodhin, janë në kundërshtim me ligjin Glas-Stigoll të vitit 1933 dhe se këshilltarët mund të konsiderohen përgjegjës për ...
Nja pesë a gjashtë zëra të tjerë të zemëruar shpërthyen njëkohësisht. Aleksi e kuptoi se kishte prekur një pikë të ndjeshme. Edhe në rast se anëtarët e këshillit e kishin të qartë lojën dyfishe të përshkruar prej tij, prapëseprapë ata preferonin të mos i mësonin hollësitë. T'i dije, do të thoshte të përziheshe në to dhe të kishe përgjegjësi. Këshilltarët s'donin as njërën gjë dhe as tjetrën.
Mirë, mendoi Aleksi, u pëlqen apo jo, tani e dinë. Duke e ngritur zërin, në mënyrë që të dëgjohej mbi zërat që protestonin, ai vazhdoi me ton të vendosur:
— E paralajmëroj këshillin se, po të miratohet kredia për Suprënejshnëlin, me të gjitha shpenzimet e saj, do të pendohemi. — U mbështet në shpinoren e karriges, duke thënë: — Kaq kisha.
Menjëherë, pasi Xherom Petërtoni trokiti me çekiçin e tij të vogël, zhurma shurdhuese u qetësua.
Petërtoni, më i zbehtë se më parë, njoftoi:

– Në qoftë se s'e do fjalën ndokush tjetër, mund të kalojmë në votimin.
Mbas pak çastesh, propozimi për t'i dhënë kredinë Suprënejshnëlit u miratua. E vetmja votë kundër ishte ajo e Aleks Vandervurtit.

Kur u hap përsëri mbledhja e këshilltarëve, pasi ata hëngrën drekë, qëndrimi i tyre i ftohtë kundrejt Vandervurtit ishte më i theksuar se më parë. Zakonisht, për t'i kryer të gjitha çështjet e përfshira në rendin e ditës, mjaftonte një

mbledhje prej dy orësh, në mëngjes. Mirëpo, kësaj here, punët ishin zgjatur.
Duke ditur qëndrimin jo miqësor të kështilltarëve, Aleksi i kishte sugjeruar, gjatë drekës, Xherom Petërtonit që mocioni i tij të shtyhej për në mbledhjen e muajit të ardhshëm. Por, Petërtoni ia kishte pritur me ton të prerë:
– S'është gjë që bëhet. Po qe se kështilltarët janë me humor të keq, vetë e ke fajin dhe, prandaj, mbaje vetë përgjegjësinë.
Kjo ishte një përgjigje tepër e ashpër nga ana e një njeriu me sjellje aq të butë si Petërtoni; por, ajo ilustronte valën e kundërshtimit që kishte shpërthyer kundër Aleksit. Veç kësaj, kjo e bindi se ora e ardhshme do të ishte kohë e humbur kot, pa asnjë frut. Tanimë dukej se propozimet e tij ishin të destinuara të hidheshin poshtë për keqardhje, në rast se jo për arsye tjetër.
Ndërsa kështilltarët po zinin vend, Filip Xhohensëni i dha tonin mbledhjes; duke shikuar herë pas here orën, në një mënyrë që binte në sy.
– M'u desh të anuloja një takim që kisha sot pasdite, – tha me ton të pakënaqur presidenti i Mid Kontinent Rabërit, – dhe kam edhe shumë punë të tjera, prandaj le të mos e zgjasim shumë.
Disa të tjerë tundën kokën, në shenjë pohimi, duke treguar se ishin të një mendjeje.
– Nuk do t'ju marr shumë kohë, zotërinj, – premtoi Aleksi, pasi Xherom Petërtoni kishte njoftuar mocionin e tij.

– Mendoj të ilustroj katër pika. – Ndërsa fliste, i numëronte ato, duke mbyllur gishtat. E para: banka jonë po humbet një punë të rëndësishme dhe rentabël, duke hequr dorë nga mundësitë e mëdha që siguron një zgjerim i depozitimeve të kursimit. E dyta: ky zgjerim do të shtonte stabilitetin e vetë bankës. E treta: sa më shumë të presim, aq më e vështirë do të jetë të ecim me një hap me konkurrentët tanë të shumtë. E katërta: ekziston mundësia për të siguruar një funksion udhëheqës, të cilin ne dhe bankat e tjera duhet ta

ushtrojmë, me anë të kthimit në zakonet e kursimit individual, kolektiv dhe kombëtar, që janë lënë pas dore tanimë prej shumë kohe.
Ai përshkroi disa mënyra se si Fërst Merkantajll Ëmerikën Benku mund të siguronte një avantazh mbi konkurrentët e saj; një përqindje më të lartë interesi për depozitimet, brenda kufirit maksimal të lejuar nga ligji; kushte më të favorshme për depozitimet e kushtëzuara prej një gjer në pesë vjet; mundësinë për të lëshuar çeqe për depozitimet e kursimit, për aq sa e lejonin ligjet bankare; dhurata për ata që hapnin llogari të reja; një fushatë të madhe reklamash, lidhur me programin dhe të nëntë degët e reja të bankës që do të hapeshin.
Për të paraqitur mocionin, Aleksi e kishte lënë vendin e tij të zakonshëm dhe kishte dalë në skajin e tryezës së gjatë vezake. Petërtoni e kishte lëvizur karrigen e tij pak anash. Me kërkesën e Aleksit, ishte i pranishëm edhe kryeekonomisti i bankës, Tom Stroani, i cili kishte përgatitur grafikët, të vendosur mbi këmbalecë, në mënyrë që të gjithë mund t'i shihnin.
Rosko Hejuordi, i përkulur përpara në karrige, dëgjonte me fytyrën që s'shprehte asgjë.
Në një pushim që bëri Aleksi, Fllojd LëBerri ndërhyri:
– Desha të bëj një pyetje.
Petërtoni, të cilit i ishte kthyer përsëri mirësjellja e tij e zakonshme, iu drejtua Aleksit:
– Do t'u përgjigjesh pyetjeve ashtu siç dalin, apo në fund, pasi ta kesh mbaruar?
– Ta dëgjojmë atë të Fllojdjt.
– Nuk është pyetje, – sqaroi LëBerri, pa buzëqeshur. – Është fjala për një fakt të dokumentuar. Unë jam kundër zgjerimit të sektorit të kursimit, sepse po ta bënim këtë gjë, do ta hapnim barkun tonë me vetë duart tona. Tani, ne kemi depozitime të mëdha në llogari të instituteve finaciare...

— Tetëmbëdhjetë milionë dollarë nga institucionet e kursimit e të huasë, — tha Aleksi. (E kishte parashikuar kundërshtimin e LëBerrit, që ishte i drejtë. Të pakta ishin bankat që qëndronin të vetmuara; të tjerat mbanin lidhje financiare me institucione të tjera dhe Fërst Merkëntail Amerikën Benku nuk bënte përjashtim. Disa institucione lokale kursimi dhe huaje kishin depozitime të rëndësishme pranë FMA-së dhe, propozime të mëparshme për zgjerimin e sektorit ishin lënë nga frika se mos i tërhiqnin këto shuma.)
— E kam pasur parasysh, — shtoi Aleksi.
LëBerri nuk ishte akoma i kënaqur.
— E ke pasur, gjithashtu, parasysh që, në rast se fillojmë t'u bëjmë konkurrencë vetë klientëve tanë, do të humbasim edhe gremçin e fundit të kësaj pune?
— Nuk besoj se do ta humbisnim krejt. Vetëm një pjesë. Sidoqoftë, puna e re që do të siguronim, do ta kompensonte atë që do të humbisnim.
Këtë e thua ti!
Aleksi nguli këmbë:
— Mua më duket një rrezik i pranueshëm.
Leonard Kingsudi ndërhyri, me ton të qetë:
— Për Suprënejshnëlin ishte në kundërshtim me çdo rrezikim.
— Nuk jam kundër çdo rrezikimi. Ky është një rrezikim shumë më i vogël dhe s'mund të krahasohet me tjetrin. Fytyrat e shumë këshilltarëve rreth tryezës shprehnin dyshim.
LëBerri tha:
— Do të doja të dija se ç'mendon Roskoi.
Dy të tjerë thanë menjëherë mbas tij:
— Po, po, të dëgjojmë Roskonë!
Sytë u kthyen nga Hejuordi, që e kishte ngulur vështrimin me duart e tij, të bashkuara me njëra-tjetrën. Ai tha, me ton të

qetë:
— Nuk është e këndshme të silurosh një koleg.
— Pse jo, — pyeti dikush, — këtë dëshirë ai të të bëjë ty.
Hejuordi buzëqeshi:
— Preferoj të mos e ul veten aq poshtë. — Fytyra e tij mori përsëri pamje serioze: — Sidoqoftë, mendoj se Fllojdi ka të drejtë. Një zgjerim i sektorit të kursimeve do të na bënte të humbisnim patjetër një punë të rëndësishme, kundrejt një pune të re, që, në fakt, është vetëm në perspektivë. Kjo do të thotë; të lësh atë që është e sigurt, për të pasigurtën. — Tregoi një nga grafikët e Stroanit, në të cilin ishin shënuar vendet e mundshme për të vendosur degët e reja të bankës, që mendohej të hapeshin. — Mund të shihni se pesë nga degët e reja, që propozohet të hapen, gjenden në afërsi të shoqatave që kanë depozitime të mëdha pranë FMA-së. Mund të jeni të sigurt se këtë do ta vënë re edhe ata.
— Vendet për vendosjen e këtyre degëve, — u përgjigj Aleksi, — janë zgjedhur me kujdes pas studimeve të kujdesshme demografike. Ato duhet të jenë atje ku ka njerëz. Agjencitë e kursimit e të huasë janë vendosur aty më parë. Në shumë pikëpamje, ato janë më largpamëse se bankat, si e jona. Por, kjo nuk do të thotë se ne duhet të qëndrojmë larg përgjithmonë.
Hejuordi mblodhi supet.
— Unë e thashë mendimin tim. Do të shtoj vetëm një gjë: Jam në kundërshtim me të gjithë projektin e degëve të bankës, të konceptuar si dyqane tregtie.
Aleksi ia priti me gjallëri:
— Por, dyqane janë! Dyqane parash: dega bankare të së ardhmes. — E kishte të qartë se çdo gjë po i shkonte mbrapsht. Kishte menduar që çështjen e degëve të bankës ta trajtonte më vonë. Sidoqoftë, tanimë kjo s'kishte më rëndësi.

— Nga përshkrimi që u bëhet, — tha Fllojd LëBerri, i cili i kishte hedhur një sy të shpejtë një raporti informativ që Tom Stroani u kishte shpërndarë këshilltarëve, — duket sikur është fjala për pastërtira automatike.
Hejuordi, që po e lexonte me vëmendje raportin, shtoi:
— Krejt ndryshe nga stili ynë i zakonshëm. Asnjë grimcë dekori.
— Do të bënim mirë të linim mënjanë diçka nga dekori dhe të siguronim më shumë fushë pune, — ia priti Aleksi. — Po, ato degë të bankës mund të duken si pastërtira automatike, por, prapësepraprë, ato përfaqësojnë tipin e degës bankare që do të mbizotërojë në një të ardhme shumë të afërt. Po ju bëj një parashikim: as ne dhe as konkurrentët tanë nuk mund të vazhdojnë më të punojnë në varret e praruara që janë degët e tanishme të bankave. Çmimi i terrenit dhe shpenzimet e ndërtimeve janë bërë të papranueshme. Pas nja dhjetë vjetëve, së paku gjysma e degëve të tanishme të bankave nuk do të jenë më ashtu siç i shohim tani. Ato do të ngrihen në vende më pak të kushtueshme dhe do të jenë plotësisht të automatizuara; do të jenë të pajisura me makina në vend të arkëtarëve; me ekrane televizive për t'iu përgjigjur pyetjeve të klientëve dhe të gjitha këto të lidhura me një kompjuter qendror. Duke projektuar degët e reja të bankës, ku përfshihen edhe këto të nënta, për të cilat po flasim, këto ndryshime duhet t'i adoptojmë që tani.
— Aleksi ka të drejtë, — tha Leonard Kingsudi. — Ne vetë, në industritë tona, po e shohim se si automatizimi po fut këmbët më shpejt se sa e prisnim.
— Një gjë pa aq e rëndësishme, — vazhdoi Aleksi, — është se kemi mundësi të dalim në krye të kësaj gjendjeje me mjaft përfitim, domethënë në rast se kjo bëhet me mprehtësinë dhe reklamën e duhur. Reklama dhe fushata publicitare duhen

zhvilluar në shkallë të gjerë dhe organizuar mirë. I shikoni shifrat, zotërinj. Së pari, depozitimet tona të tanishme të kursimit janë mjaft më të ulëta se ...
Ai vazhdoi të flasë duke shfrytëzuar grafikët dhe duke kërkuar herë pas here, ndonjë sqarim Tom Stroanit. E dinte se shifrat dhe propozimet, për të cilat ai dhe Tom Stroani kishin punuar aq shumë, ishin të studiuara mirë dhe logjike. Megjithatë, ai e ndjente një kundërshtim të qartë nga ana e disa këshilltarëve dhe, një mungesë të plotë interesi, nga ana e të tjerëve. Në njërin prej vendeve nga fundi, një këshilltar mbuloi gojën me dorë, për të ndalur një gogësimë.
Ishte e qartë se Aleksi kishte humbur. Projekti për zgjerimin e depozitimeve të kursimit dhe të degëve të bankës do të hidhej poshtë dhe do të kishte edhe vlerën e një vote «mosbesimi» ndaj tij. Si dhe më parë, ai i bëri përsëri pyetjen vetes se edhe për sa kohë do të mund të vazhdonte të mbante postin e tij në FMA. E ardhmja e tij dukej pak a shumë e mbyllur dhe, nga ana tjetër, ai nuk mund të bënte pjesë në një grup njerëzish, që do të punonin nën urdhërat e Hejuordit.
Vendosi të mos humbiste më kohë.
— Kaq, zotërinj. Nuk e shoh më të nevojshme të vazhdoj, veçse po qe se ka pyetje të tjera.
Dhe, sigurisht, nuk priste pyetje të tjera dhe aq më pak mund të parashikonte përkrahje nga personi prej të cilit ajo i erdhi, në një mënyrë aq të papritur sa edhe të çuditshme.
— Aleks, — tha Harold Ostini, me një buzëqeshje dhe ton miqësor, — dua të falënderoj. Sinqerisht ato që the më kanë bërë përshtypje. Mocioni yt ishte bindës. Veç kësaj, mendimi për ato degët e reja të bankës më pëlqen shumë.
Fytyra e Hejuordit, i ulur pak karrige më tutje, shprehu habi të madhe dhe ai u kthye të vështronte Ostinin. I nderuari Harold bëri sikur s'e vuri re dhe iu drejtua të tjerëve rreth tryezës:

— Mendoj se këtë propozim duhet ta shqyrtojmë në mënyrë objektive; duke lënë mënjanë mosmarrëveshjet që kishim në mëngjes.
Leonard Kingsudi pohoi me kokë, i ndjekur nga disa këshilltarë. Të tjerët e shkundën plotësisht plogështinë e tregtesë së ushqimit dhe u bënë më të vëmendshëm. Ostini nuk ishte më kot «dekani» i këshillit administrativ të FMA-së. Atij i shkonte mjaft fjala te të gjithë dhe dinte t'i bënte të tjerët të ndërronin mendje, për t'iu përshtatur mendimit të tij.
— Në filim të mocionit tënd, — tha Ostini, duke iu drejtuar Aleksit, — fole për t'u kthyer në kursimin individual dhe për funksionin udhëheqës që bankat, si kjo jona, do të mund të kishin në këtë drejtim.
— Tamam, ashtu.
— A mund ta zhvillosh më shumë këtë koncept?
Aleksi ngurroi:
— Besoj se po.
— A duhej ta bënte këtë? Ai nuk çuditej me atë që ndodhi. Tani e kishte shumë të qartë se pse Ostini kishte ndryshuar qëndrimin e tij.
Reklama dhe fushata publicitare. Pak më parë, kur ai kishte sugjeruar zhvillimin në shkallë të gjerë dhe të organizuar mirë të një fushate të tillë, e kishte parë se si Ostini kishte ngritur kokën dhe ishte treguar mjaft i interesuar. Nga e gjithë kjo, s'ishte vështirë të kuptohej se ç'lëvrinte në kokën e tij. Agjencia publicitare «Ostin» në sajë të funksionit të të nderuarit Harold si këshilltar dhe të ndikimit të tij në FMA, kishte monopolin e fushatës publicitare të bankës. Një fushatë e tillë, ashtu siç e parashikonte Aleksi, do t'i sillte fitime të mëdha agjencisë «Ostin».
Veprimi i Ostinit ishte një konflikt interesash në trajtën e tij, më trashanike — i njëjti konflikt interesash që Aleksi kishte

sulmuar në mëngjes lidhur me emërimin e Rosko Hejuordit si anëtar në këshillin administrativ të Suprënejshnëlit. Aleksi kishte pyetur: Interesat e kujt do të vinte Roskoi në radhë të parë? Ata të Sipërmejshmërit apo të aksionistëve të Fërst Merkentajll Emerikën Benkut? Tani, një pyetje e ngjashme duhej t'i bëhej Ostinit.

Përgjigjja ishte e qartë. Ostini po hapte sytë për interesat e veta; FMA-ja vinte në radhë të dytë. Pavarësisht besimi që Aleksi kishte te projekti, për të cilin po flitej, një përkrahje – e dhënë për arsye egoiste – ishte amorale dhe një shkelje besimi.

A duhej ta thoshte këtë Aleksi? Po ta thoshte do të shkaktonte një valë proteste akoma dhe më të madhe se ajo e mëngjesit dhe do të humbiste përsëri. Këshilltarët e përkrahnin njëri-tjetrin si anëtarët e masonerisë. Veç kësaj, një qëndrim i tillë do t'i kishte dhënë fund atij pak pushteti që i kishte mbetur akoma. Prandaj, a ia vlente barra qiranë? A ishte më të vërtetë e nevojshme një gjë e tillë? Mos e kërkonte detyra e tij që ai të ishte rojtar i ndërgjegjes së këshillit? Aleksi s'ishte aspak i sigurt për këtë. Ndërkaq, këshilltarët po e vëzhgonin dhe po prisnin.

– Po, – tha ai, – siç ma kujtoi Haroldi, fola për kursim dhe për të dalë në krye me anë të shfrytëzimit të mjeteve të reja të teknikës. – Aleksi u hodhi një sy shënimeve, të cilat, pak minuta më parë, kishte vendosur të mos i përdorte. – Është thënë shpesh, – vazhdoi ai, – se qeveria, industria dhe tregtia e çdo tipi qofshin mbështeten mbi kredinë. Pa kredi, pa hua, pa financime (të vogla, të mesme ose të mëdha) ekonomia do të dekompozohej dhe qytetërimi do të merrte fund. Bankierët e dinë këtë më mirë nga të gjithë.

Megjithatë, po bëhet gjithnjë e më i madh numri i atyre që janë të mendimit se huatë dhe financimet kanë arritur një nivel të marrë, përtej kufirit gjer ku një gjë e tillë mund të konsiderohet e arsyeshme. Kjo është e vërtetë sidomos përsa u përket qeverive. Qeveria e Shteteve të Bashkuara ka krijuar

një mal të vërtetë huash, që nuk do të jemi kurrë në gjendje t'i lajmë. Edhe qeveri të tjera janë në kushte të këqija; në rast se jo edhe më të këqija. Kjo është arsyeja e vërtetë e inflacionit dhe e humbjes së fuqisë blerëse të monedhës, qoftë këtu te ne, qoftë në vende të tjera.

Krahas huave të qeverisë janë edhe huatë jashtëzakonisht të mëdha të kolektivitetit. Më në fund, një herë në nivel financiar më të ulët, miliona individë kanë marrë hua, që nuk janë në gjendje t'i paguajnë. Shuma totale e të gjitha huave në Shtetet e Bashkuara është prej dy mijë e pesëqind miliardë dollarësh. Huaja e konsumit kombëtar po i afrohet tani shumës prej dyqind miliardë dollarësh. Gjatë këtyre gjashtë viteve të fundit kanë falimentuar më se një milion amerikanë. Diku, gjatë rrugës sonë, në shkallë kombëtare, kolektive, individuale, kemi humbur të vërtetën e jashtë të kursimit dhe nikoqirlëkut, të balancimit të shpenzimeve me të ardhurat, të mbajtjes së huave brenda një kufiri të pranueshëm.

Humori i këshilltarëve ishte bërë më i qetë. Po ashtu, edhe Aleksi vazhdoi me ton më të qetë:

– Do të më pëlqente të mund të pohoja se ekziston një rrugëdalje nga gjendja që përshkrova. Nuk jam i bindur për këtë. Mirëpo, rrugëdaljet krijohen nga veprime të vendosura, të cilat ndërmerren diku. Përse kjo të mos bëhet këtu?

Në kohën tonë, depozitimet e kursimit përbëjnë një veprim të matur financiar, më shumë se çdo përdorim tjetër që mund të bëhet me paratë. Dhe ne kemi nevojë, qoftë në shkallë kombëtare qoftë individuale, për veprime të tjera të matura. Një mënyrë për ta arritur këtë qëllim është të sigurohet një rritje shumë e madhe e depozitimeve të kursimit.

Po t'i përvishemi punës si duhet, mund të sigurohen rritje kolosale. Edhe në qoftë se vetëm kursimet individuale nuk munden të rimëkëmbin kushtet ekonomike të mbarë kombit, ato do të përbëjnë së paku një hap të madh drejt këtij qëllimi.

Ja sepse ekziston mundësia e një funksioni udhëheqës dhe ja sepse besoj që kjo bankë duhet ta ushtrojë atë.

Aleksi u ul përsëri. Pas pak sekondave i shkoi në mend se s'kishte thënë asgjë për dyshimet e tij lidhur me ndërhyrjen e Ostinit.

Leonard Kingsudi e theu heshtjen e shkurtër që ndoqi fjalën e Aleksit.

– Mendoj se ato që dëgjuam përmbajnë një dozë të mirë të vërtete dhe arsyeje të shëndoshë, edhe pse këto dy gjëra nuk janë gjithnjë të këndshme për t'u dëgjuar.

Filip Xhohensëni tha nëpër dhëmbë:

– Në shumë gjëra jam i një mendjeje me ato që tha Aleksi.

– Unë jam krejtësisht i një mendjeje! – thirri i nderuari Harold. – Sipas mendimit tim, këshilli duhet ta miratojë projektin për zgjerimin e depozitimeve të kursimit dhe të degëve të bankës, ashtu siç është paraqitur. Unë kam ndërmend të votoj në favor dhe ju ftoj edhe ju të tjerët të bëni po ashtu.

Kësaj here, Rosko Hejuordi nuk u tregua i çuditur. Fytyra e tij kishte vetëm një pamje të tendosur. Aleksi mendoi se edhe Hejuordi duhej t'i kishte marrë me mend arsyet e Ostinit.

Diskutimi u zgjat edhe nja pesëmbëdhjetë minuta të tjera, dhe, pastaj, Xherom Petërkoni trokiti me çekanin e tij të vogël dhe i ftoi të pranishmit të votonin. Propozimi i Aleksit u miratua pothuajse njëzëri. Kundër qenë vetëm Fllojd LëBerri dhe Rosko Hejuordi.

Ndërsa po dilte nga salla e këshillit, Aleksi vuri re se qëndrimi i mëparshëm armiqësor ndaj tij nuk ishte zhdukur. Disa këshilltarë lanë të kuptohej qartë se e ndjenin veten akoma të fyer, për shkak të qëndrimit të tij të ashpër ndaj Suprënejshnëlit. Mirëpo, fitorja e papritur e pasdites e kishte

bërë më të qetë, më pak pasimist, përsa i përkiste punës së tij në FMA.

Harold Ostini e ndali:

— Aleks, kur mendon se mund të nisësh me zbatimin e planit të depozitimeve të kursimit?

— Menjëherë. — Duke mos dashur të dukej i panjerëzishëm, Aleksi shtoi: — Faleminderit për përkrahjen tënde.

Ostini tundi kokën.

— Duhet të vij te ti, bashkë me dy a tre nga djemtë e mi të agjencisë për të diskutuar hollësitë e fushatës.

— Shumë mirë. E lëmë për javën e ardhshme.

Kështu, Ostini e kishte konfirmuar, pa humbur kohë dhe qetë-qetë, deduksionin e Aleksit. «Por, — mendoi ky, — po të jemi të sinqertë, duhet të pranojmë se agjensia publicitare «Ostin» punon mirë, prandaj mund të zgjidhet për këtë fushatë qoftë edhe vetëm për arsye merite.»

Ndërkaq, ai po kërkonte të gjente pretekste për t'u shfajësuar dhe këtë e dinte. Nga vetë fakti se, para disa minutave kishte heshtur, ai kishte shkelur parimin, mjaft që të arrinte qëllimin e dëshiruar. Pyeti veten se ç'do të mendonte Margoti për këtë.

I nderuari Harold u përshëndet në mënyrë të sjellë:

— Atëherë, mirupafshim së shpejti.

Rosko Hejuordi, që doli nga salla e këshillit menjëherë para Aleksit, mori në atë çast nga një punonjës i bankës një zarf të mbyllur. E hapi dhe nxori prej tij një fletë të palosur. Ndërsa po e lexonte, fytyra i ndriti; i hodhi sytë orës së tij dhe buzëqeshi. Aleksi tha me vete: «Përse?»

Fleta përmbante një njoftim të thjeshtë. Ishte shkruar me makinë nga sekretarja e vjetër, e besuar e Hejuordit, Dora Kellëgen, dhe e njoftonte se kishte telefonuar zonjusha Dëvero, që kishte thënë se ishte në qytet dhe se priste që ai t'i telefononte. Ishte shënuar edhe një numër telefoni.

Hejuordi e njohu numrin: ishte i hotelit «Kolumbia Hilton.» Zonjusha Dëvero ishte Avrili.

Kishin pasur edhe dy takime të tjera, pas udhëtimit në ishujt Bahama, para një muaji e gjysmë. Të dy takimet ishin bërë në «Kolumbia Hilton» dhe, në të dy rastet, sikurse ndodhi atë natë në Nasau, kur Hejuordi shtypi butonin numër shtatë për ta thirrur Avrilin në dhomën e tij, ajo e kishte çuar në një lloj parajse, në një vend kënaqësish dhe ekstazash erotike, për të cilat Roskoi s'kishte ëndërruar kurrë se ekzistonin.

Atëherë kishte filluar Hejuordi të kuptonte gjithnjë e më qartë se ç'pasion dhe madhështi kishin në vetvete njohja e thellë reciproke, lartësimi i botës shpirtërore, kënaqësia e përbashkët, kur jep dhe merr, të cilat ai dhe Beatrisa s'i kishin provuar kurrë.

Ky zbulim i tij vinte tepër vonë për atë dhe Beatrisën, pa thënë edhe se Beatrisa mund edhe të mos e mirëpriste fare. Por, për Roskonë dhe Avrilin kishte akoma kohë dhe këtë e kishin treguar dy takimet e tjera pas Nasaut.

Hejuordi i hodhi sytë orës dhe buzëqeshi. Kjo kishte qenë buzëqeshja që kishte parë Vandervurti.

Natyrisht, do të shkonte tek Avrili sa më parë që të ishte e mundur; kjo do të thoshte ta ndryshonte krejt programin e pasdites dhe mbrëmjes, por kjo s'kishte rëndësi. Edhe në atë çast, mendimi se do ta shihte përsëri e nxiste aq shumë saqë trupi i rekëtinte dhe i dridhej si ai i një të riu.

Që nga fillimi i marrëdhënieve me Avrilin, kishte pasur raste kur ai kishte ndier brejtje të ndërgjegjes. Kohët e fundit, në kishë, gjatë shërbimit fetar të së dielës, s'i ishte hequr nga mendja një frazë nga fragmenti që kishte lexuar përpara besimtarëve, para se të shkonte në ishujt Bahama: «Drejtësia e ekzulton një komb, por mëkata i diskrediton popujt.» Në çaste të tilla ngushëllohej me fjalët e Krishtit në Ungjillin e shën Janit: «Kush nga ju është i larë dhe s'ka bërë asnjë mëkatë, le të hedhë gurin e parë». Dhe, gjithashtu: «Ju gjykoni sipas mëkatit, por unë s'gjykoj asnjëri». Ai e kishte lënë veten, bile, të mendonte — me një lehtësi që jo shumë kohë më parë do ta kishte tronditur pa masë — se Bibla, sikurse statistikat, mund të përdoren për të vërtetuar gjithçka.

Sidoqoftë, të dredhoje me fjalë nuk sillte asnjë dobi. Helmi që kishte marrë nga Avrili ishte më i fortë se çdo brejtje e ndërgjegjes.

Ndërsa po shkonte për në zyrën e tij, e cila ndodhej në të njëjtin kat me sallën e këshillit, po mendonte me vete, tërë gaz, se takimi me Avrilin e mbyllte shumë mirë këtë ditë triumfuese, në të cilën ishin miratuar propozimet e tij lidhur me Suprënejshnëlin dhe prestigji i tij profesional te këshilltarët ishte ngritur në zenit. Natyrisht, ai kishte mbetur i zhgënjyer nga përfundimi i seancës së pasdites dhe i zëmëruar nga ajo që e quante si një tradhti nga ana e Harold Ostinit, ndonëse e kishte kuptuar menjëherë se ç'arsye egoiste e kishin shkaktuar këtë gjë. Megjithatë, nuk kishte shumë frikë që projekti i Vandervurtit të mund të kishte sukses të madh. Rritja e fitimeve atë vit, si rrjedhojë e marrëveshjeve me Suprënejshnëlin, do të ishte shumë më e rëndësishme.

Kjo i solli ndërmend se duhej të merrte një vendim për gjysmë milionin e dollarëve të tjerë, të kërkuar si hua nga Xhorxhi i madh Kuortermirë, në favor të një firme tjetër të tij, Q-Investmentsit.

Fytyra iu vrenjt pak. Ai dyshonte se në të gjithë këtë çështje të Q-Investmentsit kishte disa çrregullime të vogla,

megjithëse kjo gjë nuk dukej shumë serioze, duke pasur parasysh angazhimet reciproke ndërmjet bankës dhe Suprënejshnëlit.

Vetë ai, para rreth një muaji, e kishte ngritur këtë çështje në një promemorie, me karakter të fshehtë që ia kishte dërguar Xherom Petërtonit.

Dje më telefonoi dy herë nga Nju Jorku Xh. Xh. Kuortermirni i Suprënejshnëlit për të më folur për një shoqëri private të quajtur Q-Investments. Është fjala për një grup të vogël, president i të cilit është vetë Kuortermirni dhe një nga anëtarët është këshilltari ynë Harold Ostini. Grupi ka blerë tanimë, me kushte të leverdishme, sasi ra të mëdha aksionesh të zakonshme nga firma të ndryshme të lidhura me Suprënejshnëlin dhe ka në plan edhe blerje të tjera.

Xhorxhi i madh do nga ne një hua prej një e gjysmë milioni dollarësh në favor të Q-Investmentsit, me të njëjtën përqindje të ulët interesi të huasë së dhënë Suprënejshnëlit, por pa ndonjë bilanc kompensimi. Ai më theksoi se bilanci i kompensimit të SuNatKo-s e kundërbalanconte mjaft vlerën e kësaj huaje personale — gjë që është e vërtetë, por është po aq e vërtetë se, në një rast të tillë, nuk do të kemi garanci.

Po shkoj se më ka telefonuar edhe Harold Ostini, për të më kërkuar që të jepet kjo hua.

Në të vërtetë, i nderuari Harold ia kishte përmendur hapur Hejuordit detyrimin që i kishte për përkrahjen e vendosur që i kishte dhënë në kohën e vdekjes së Ben Roselit. Kjo ishte një përkrahje për të cilën Hejuordi do të vazhdonte të kishte nevojë edhe për tetë muaj të tjerë, domethënë deri sa të dilte në pension Xherom Petërtoni.

Promemoria, drejtuar Petërtonit, vazhdonte:

Sinceristht, përqindja e interesit e kërkuar për këtë hua është shumë e ulët dhe, të heqësh dorë nga bilanci i kompensimit, do të përfaqësonte një veprim të qartë

zemërgjerësie. Por, duke marrë parasysh punën me përfitim që na ka siguruar Xhorxhi i madh me Suprënejshnëlin, mendoj se është me vend t'i pranojmë kushtet e tij.

Prandaj, unë e miratoj këtë hua. A je dhe ti i një mendjeje?

Xherom Petërtoni ia kishte kthyer Hejuordit promemorien, së cilës i kishte shtuar me laps një «po» lakonike, mbas pyetjes në fund. Meqënëse e njihte Petërtonin, Hejuordi dyshonte që ai t'i kishte kushtuar promemories më shumë se një vështrim të nxituar.

Hejuordi s'e kishte parë të nevojshme që të njoftonte Aleks Vandervurtin, dhe, nga ana tjetër, huaja nuk ishte aq e madhe sa të kërkohej miratimi i komisionit të investimeve. Prandaj, mbas disa ditëve, e kishte siguruar vetë propozimin, gjë që ishte plotësisht brenda kufijve të autoritetit të tij.
Ajo që nuk përfshihej në autoritetin e tij – dhe që ai s'ia kishte thënë askujt – ishte një operacion personal që ishte përfunduar midis tij dhe Xh. Xh. Kuortermejnit.
Gjatë bisedës së dytë telefonike për Q-Investmentsin, Xhorxhi i madh, (i cili në të vërtetë nuk po fliste nga Nju Jorku por nga një degë e SuNatKo-s në Çikago), kishte thënë:
– Fola për ty me Harold Ostinin. Të dy jemi të mendimit se ka ardhur çasti që edhe ti të hysh për të bërë pjesë në grupin tonë. Prandaj, të kam caktuar dy mijë aksione, të cilat në llogarinë tonë do të shënohen si plotësisht të likuiduara. Në vend të emrit, në të është shënuar fjala «prurësit». Kështu ruhet më mirë fshehtësia. Po t'i dërgoj me postë.
Hejuordi ishte munduar të kundërshtonte:
– Faleminderit, Xhorxh, por nuk besoj se mund të pranoj.
– O zot, pse jo?
– Do të ishte në kundërshtim me etikën.
Xhorxhi i madh kishte qeshur me të madhe.
– Rosko, mos jeto në hënë! Gjëra të këtilla ndodhin çdo ditë

ndërmjet bankave dhe klientëve. Këtë e di shumë mirë edhe ti.
Po, Hejuordi e dinte që ndodhnin, megjithëse jo «çdo ditë»; por, vetë ai, s'ia kishte lejuar kurrë vetes një gjë të tillë.
Para se Hejuordi të mund të përgjigjej, Kuortermejni kishte ngulur këmbë:
– Dëgjo, mik i dashur, mos u bëj budalla. Në qoftë se kjo të bën ta ndjesh veten më mirë, atëherë po themi se aksionet janë një kompensim për konsultimet e tua mbi investimet.
Por Hejuordi e dinte mirë se s'kishte dhënë asnjëherë ndonjë këshillë a mendim për investimet, as atëherë dhe as më vonë.
Pas nja dy ditëve, me postë rekomande ajrore, mbërritën çertifikatat aksionare të Q-Investmentsit, në një pliko të mbyllur plot me vula dhe me shënimin PERSONALE. As Dora Kellëgeni s'e kishte hapur.

Atë mbrëmje, në shtëpi, duke studiuar bilancet e Q-Investmentsit, të cilat Xhorxhi i madh ua kishte bashkëngjitur çertifikatave, Hejuordi kishte parë se të dy mijë aksionet kishin një vlerë neto prej njëzet mijë dollarësh. Më vonë, në rast se Q-Investmentsi do t'i shkonin punët mbarë, ose do të bëhej publike, vlera e tyre do të rritej shumë më tepër.
Në atë çast, Hejuordi kishte pasur nxitjen që t'ia kthente aksionet Xh. Xh. Kuortermejnit; mirëpo, pastaj, duke shqyrtuar përsëri gjendjen financiare të tij – e dila nuk ishte më e mirë se ç'kishte qenë disa muaj më parë – kishte ngurruar. Më në fund i ishte dorëzuar tundimit dhe, atë javë, i kishte depozituar certifikatat në kasketën e tij, të siguruar në degën e bankës së Edunitis. Kishte thënë shumë herë me vete, se nuk po i merrte para bankës. Në fakt, për shkak të marrëveshjes me Suprënejshnëlin, ishte e vërtetë e kundërta. Prandaj, në rast se Xhorxhi i madh donte t'i bënte një dhuratë

si mik, pse të sillej si njeri i trashë dhe të mos e pranonte? Por, fakti se e kishte pranuar, vazhdonte ta preokuponte, sidomos kur Xhorxhi i madh i kishte telefonuar, në fund të javës së kaluar — kësaj here nga Amsterdami, — duke kërkuar një hua tjetër prej një gjysmë milioni dollarësh, në favor të Q-Investmentsit.
— Është paraqitur një rast me të vërtetë i rrallë për grupin tonë, Q, për të blerë në Holandë një numër të madh aksionesh, vlera e të cilëve do të ngrihet së shpejti gjer në qiell. Me telefon s'mund të të them më shumë, por ki besim tek unë.
— Sigurisht që kam besim, por banka do të ketë nevojë për hollësira.
— Do t'i marrësh nesër. — Dhe Xhorxhi i madh kishte shtuar me një ton kuptimplotë: — Dhe mos harro se tani je nga tanët.
Hejuordi kishte pasur edhe një ndjenjë tjetër të pakëndshëm: Xh. Xh. Kuortermejni interesohej më shumë për investimet e tij private sesa për administrimin e Suprënejshnëlit. Por lajmet e ditës së nesërme e kishin qetësuar. Gazeta «Uoll Strit Zhurnëll» dhe të përditshmet e tjera përmbanin artikuj të gjatë mbi thithjen e një industrie të madhe evropiane nga Kuortermejni, në llogari të SuNatKo-s. Ky ishte një grusht shteti tregtar i vërtetë, që i kishte ngritur edhe më shumë aksionet e Suprënejshnëlit në bursat e Nju Jorkut dhe të Londrës dhe që e bënte akoma dhe më të sigurt huanë që FMA-ja i kishte dhënë shumëkombëshes vigane.

Kur Hejuordi po hynte në zyrë, zonja Kollëgen i drejtoi buzëqeshjen e saj të zakonshme, të një gruaje të moshuar.
— Njoftimet e tjera janë në tryezën e punës, zoti Hejuord.
Ai tundi kokën, por mbasi hyri në zyrën e tij të veçantë, shtyu më një anë shkresurinat që e prisnin dhe u përqendrua përsëri

në shqyrtimin e dokumenteve lidhur me huanë e re për Q-Investmentsin, të cilave u mungonte vetëm autorizimi. Pastaj, i la edhe ato dhe mori telefonin që lidhej drejtpërdrejt me linjën e jashtme dhe formoi numrin e «parajsës».

Dhoma e fjetjes, siç e kishte vënë re Hejuordi kur kishte mbërritur, kishte stilin e zakonshëm të Hiltonit: e pastër dhe e rehatshme, por praktikisht një kuti pa personalitet. Dhomat komunikonin në një sallë ndenjieje, të mobiluar në të njëjtën mënyrë si të tjerat. Si herët e tjera, edhe kësaj radhe, Avrili kishte zënë një apartament.

Hejuordi kishte mbërritur pasdite vonë. Pasi kishin bërë dashuri, ata kishin fjetur pak, pastaj ishin zgjuar; kishin bërë prapë dashuri — ndonëse jo me sukses të plotë — dhe, pastaj, kishin fjetur edhe një herë tjetër. Tani po visheshin. Hejuordi shikoi orën: ishte tetë.

E ndjente veten të këputur fizikisht të rraskapitur. Më shumë se çdo gjë tjetër, dëshironte të kthehej në shtëpi dhe të shtrihej në shtrat — vetëm. Tha me vete edhe sa kohë akoma duhet të rrinte, para se të mund të largohej, pa bërë figurë të keqe.

Avrili u kthye nga salla e ndenjies, ku kishte vajtur për të telefonuar, dhe i tha:

— Porosita darkën, zemër. Do ta sjellin shpejt.

— Kjo është e mrekullueshme, e dashur.

Ajo electrostatic veshur një këmishë që i puthitej krejt pas trupit dhe një fustan të hollë, gati të tejdukshëm. S'kishte fare sutien. Filloi të krihte flokët e gjatë, që i ishin prishur. Hejuordi ndenji në shtrat, duke e soditur. Me gjithë lodhjen që ndjente, ai admironte çdo lëvizje të saj, të shkathët dhe sensuale. Krahasuar me Beatrisën, që ai e shihte çdo daily, Avrili ishte aq e re! Befas, e ndjeu veten plak dhe pa shpëtim nga kjo gjendje.

Shkuan në dhomën e ndenjies, ku Avrili tha:
— Le të hapim shampanjën!
Shishja ishte në një kovë me akull, mbi bufe. Hejuordi e kishte vënë re edhe më parë. Akulli ishte shkrirë tanimë pothuajse i gjithë, por shishja ishte akoma e ftohtë. Ai u mundua më kot ta hapte, me lëvizje që tregonin mungesë përvoje, duke tërhequr herë telin e herë tapën.
— Mos u mundo ta hapësh, — i tha Avrili. — Përkule shishen dyzet e pesë gradë, pastaj, mbaje tapën të shtrënguar fort dhe rrotulloje shishen.
Në këtë mënyrë, shishja u hap me lehtësi. Ajo dinte aq shumë gjëra...
Pasi ia mori shishen, Avrili mbushi dy gota. Hejuordi tundi kokën.
— Ti e di që unë nuk pi kurrë, e dashur.
— Do të të bëjë ta ndiesh veten më të ri. — Ajo i zgjati njërën gotë.
Duke i bërë lëshim dhe kur po e merrte gotën, ai e pyeti veten nëse ajo kishte lexuar në mendjen e tij.
Pas dy gotave të tjera, kur sollën darkën, ai e ndjeu veten me të vërtetë më të ri.
Mbasi doli kamerieri, tha:
— Duhet të më kishe lënë të paguaja unë. — Një çast më parë, kishte nxjerrë portofolin, por Avrili s'e kishte lënë dhe kishte firmosur fletën e llogarisë.
— Pse, Rosi?
— Sepse duhet të më lejosh të të kthej një pjesë të shpenzimeve që ke bërë. — Hejuordi e dinte se Avrili kishte një apartament në Griniç Vilexh. — Janë shpenzime tepër të mëdha që t'i përballosh vetëm.
Ajo e vështroi me kureshtje dhe, pastaj, shpërtheu në një të qeshur, me tinguj të argjendtë.

— Beson se i paguaj unë këto? — Tregoi me dorë dhomat, darkën, shampanjën, — Me paratë e mia? Rosi, duhet të jesh i marrë!
— Por, atëherë, kush i paguan?
— Suprënejshnëli, natyrisht, budalla i vogël! Të gjitha janë në ngarkimin e tij: hoteli, darka, udhëtimi, koha ime.
— Ajo shkoi pranë karriges së tij dhe e puthi. Buzët e saj ishin të plota dhe të njoma. — Prandaj, mos u bëj merak.
Hejuordi qëndroi pa lëvizur, në një heshtje të habitur, duke u munduar të merrte veten nga goditja që i kishin dhënë fjalët e Avrilit. Energjia e krijuar ngadalë dhe me ëmbëlsi nga shampanja i rridhte akoma në tërë trupin, por mendja ishte e qartë dhe e mprehtë.

«Kohën time»... Ja se çfarë e kishte lënduar në mënyrë të veçantë. Deri në atë çast kishte kujtuar se, kur i telefononte Avrili për të pyetur nëse mund të shiheshin, këtë e bënte sepse asaj i pëlqente të rrinte me të dhe se ajo ishte e kënaqur — si vetë ai — nga lidhjet që ekzistonin ndërmjet tyre.

Si kishte mundësi të ishte treguar aq naiv? Ishte e natyrshme që të gjithë këtë ta kishte organizuar Kuortermëjni dhe që kjo të ishte në ngarkim të Suprënejshnëlit! Mjaftonte pak urtësi për ta kuptuar. Apo, ndoshta, ai s'kishte dashur ta thellonte më parë këtë punë, sepse nuk donte ta dinte? Edhe diçka tjetër: Në qoftë se Avrili paguhej për kohën e saj, çfarë ishte ajo? Një prostitutë? Por ai vetë, atëherë, çfarë ishte? Mbylli sytë. «Shën Luka/18 - 13, — mendoi. — Zot, ki mëshirë për mua, mëkatarin.»

Mbetej vetëm një gjë për t'u bërë, natyrisht. Dhe kjo duhej bërë menjëherë. Të zbulohej se sa ishte shpenzuar deri në atë çast dhe t'i dërgohej Suprënejshnëlit një çek personal për shlyerjen e shpenzimeve. Filloi të bëjë llogaritje, por konstatoi se nuk kishte asnjë ide për shpërblimin e Avrilit. Instinkti i thoshte se nuk duhej të ishte i vogël.

Sidoqoftë, dyshonte që kjo të ishte një zgjidhje e urtë. Mendja e tij prej administratori pyeste: me çfarë emri figuronte kjo pagesë në regjistrat e Suprènejshnëlit? Dhe, veç kësaj, ku do ta gjente ai tërë shumën e nevojshme që duhej? Dhe, më në fund: çdo të ndodhte, kur ai do të kishte përsëri dëshirë për t'u takuar me Avrilin? Që tani e dinte se kjo dëshirë do t'i vinte shpejt.

Zilja e telefonit tingëlloi, duke prishur heshtjen që mbretëronte në sallën e ndenjies. Avrili u përgjigj, tha disa fjalë dhe, pastaj, thirri:

— Është për ty.

— Për mua?

Sapo Hejuordi mori receptorin, në aparat u dëgjua një zë i fortë:

— Ç'kemi, Rosko?

Hejuordi u përgjigj ftohtë:

— Ku je, Xhorxh?

— Në Uashington. Ç'rëndësi ka. Kam lajme shumë të mira për SuNatKo-n, për bilancin e tremujorit të fitimeve. Do të lexosh për këtë në gazetat e nesërme.

— Më thirre për të më thënë këtë?

— Mos të... ndërpreva?

— Jo.

Xhorxhi i madh qeshi.

— Kjo ishte vetëm një telefonatë mirësjelljeje, mik i dashur. Vetëm sa për të dëgjuar se ajo puna është në rregull.

Hejuordi e kuptoi që, në rast se donte të protestonte, ky ishte çasti i përshtatshëm. Por, të protestonte për çfarë? Për faktin se ia kishin vënë Avrilin bujarisht në dispozicion? Apo

për gjendjen veçanërisht të vështirë në të cilën e ndjente tani veten?

Zëri buçitës i Xhorxhit të madh i dha fund dilemës së tij:

— Atëherë, ajo kredia për Q-Investmentsin u miratua?

— Jo përfundimisht.

— Po e merrni punën me të qetë, eh?

— Jo, aspak. Ka procedura që duhen ndjekur.

— Mirë. Sidoqoftë, lëvizni ca, përndryshe do të detyrohem t'ia kaloj këtë punë një banke tjetër dhe, ndoshta, edhe një pjesë të asaj të Suprënejshnëlit.

Kërcënimi ishte i qartë. Hejuordi nuk u çudit, sepse presionet dhe lëshimet janë një komponent normal i veprimtarisë bankare.

— Do të bëj çmos, Xhorxh.

U dëgjua një si murmuritje.

— Avrili është akoma aty?

— Po.

— Ma jep pak.

Hejuordi i kaloi receptorin Avrilit. Ajo dëgjoi për një çast dhe, pastaj, tha:

— Në rregull, do ta bëj. — Buzëqeshi dhe vuri përsëri në vend receptorin.

Pastaj shkoi në dhomën e fjetjes. Hejuordi dëgjoi krismën e një brave valixheje dhe, pas një çasti, Avrili erdhi përsëri, me një pliko kartoni në dorë.

— Xhorxhi më tha të të jepja këtë pliko.

Ishte e njëjta tip plikoje dhe me të njëjtat vula, si ajo që Hejuordi kishte marrë me certifikatat e aksioneve të Q-Investmentsit.

— Xhorxhi më ngarkoi të të them se është një kujtim i çasteve tona të bukura në Nasau.
Aksione të tjera? Nuk besonte të ishte ashtu. Mendoi mos ta pranonte, por kureshtja ishte e fortë.
Avrili shtoi:
— Nuk duhet ta hapësh këtu. Prit, kur të jesh larguar.
Hejuordi shikoi orën.
— Është koha të largohem, e dashur.
— Edhe për mua. Duhet të kthehem po sonte në Nju Jork.
U përshëndetën. Do të mund ta kishin ndier veten ngushtë gjatë ndarjes, por falë qëndrimit të shpenguar dhe me përvojë të Avrilit, kjo nuk ndodhi.
Ajo e përqafoi dhe, ndërsa ishin ashtu të pushtuar, i pëshpëriti:
— Je shumë i dashur, Rosi. Do të shihemi prapë, së shpejti.
Me gjithë gjërat që kishte mësuar, Hejuordi e ndjeu se pasioni i tij për atë nuk kishte ndryshuar. Dhe sado që të kushtonte «koha e saj», mendoi ai, një gjë ishte e sigurt: ajo që jepte Avrili, në këmbim, ishte me vlerë të madhe.
Rosko Hejuordi mori një taksi, që e çoi nga hoteli te gratacieli i Fërst Merkentajll Ëmerikën Benkut. Rojës që ndodhej në sallën kryesore i tha se pas pesëmbëdhjetë minutave i duhej një veturë me shofer për t'u kthyer në shtëpi. Pastaj hipi me ashensor në katin e tridhjetë e gjashtë dhe mbërriti në zyrën e tij, duke përshkuar korridore të shkreta dhe duke kaluar anash zyrave pa njerëz.
Pasi u ul te tryeza e tij e punës, hapi plikonë me vula që i kishte dhënë Avrili. Brenda kishte një pliko tjetër më të vogël, që përmbante nja dhjetë copë fotografi të zmadhuara.
Atë natë të dytë në Bahama, kur vajzat dhe burrat kishin bërë banjë krejt lakuriq në pishinën e Xh. M. Kuortermvjnit, fotografi duhet të kishte ndenjur i fshehur mirë. Kishte të ngjarë që të kishte përdorur një teleobjektiv, duke qëndruar i

padukshëm prapa kaçubave të harlisura. Sigurisht, do të kishte përdorur film me ndjeshmëri të madhe, sepse Hejuordi s'kishte parë asnjë vezullim drite. Sidoqoftë, e gjithë kjo s'kishte rëndësi. Fakti ishte se dikush i kishte bërë këto fotografi.
Ato tregonin Ritën, Kristinën, Rrezehënën, Avrilin, Harold Ostinin duke u zhveshur dhe pa rroba. Dhe, pastaj, Rosko Hejuordin, të rrethuar nga vajzat lakuriqe, me një pamje të magjepsur, gjë që ishte një kryevepër e vërtetë. Dhe përsëri Hejuordin duke hapur zinxhirin e fustanit dhe duke zbërthyer sutienin e Avrilit. Dhe, pastaj, Avrili duke e puthur, me gjinjtë të kapura nga duart e tij. Rastësisht, ose me qëllim, nënpresidenti Stounbrixh paraqitej gjithnjë vetëm nga shpina. Nga pikëpamja teknike dhe artistike fotografitë ishin shumë të mira. Dukej se ishin marrë nga një profesionist. Si jo, mendoi Hejuordi, me tërë ato para që kishte, Xhorxhi i madh Kuortermvjni ishte mësuar t'i bëhej çdo gjë shërbimi më i mirë.
Një veçori kuptimplote: në asnjërën nga fotografitë nuk shihej presidenti i Suprënejshnëlit.
Hejuordi ishte i tmerruar. Pse ia kishin dërguar këto fotografi? A mos paraqisnin ato një kërcënim? Apo ishin vetëm një shaka pak e rëndë? Dhe ku ishin negativet dhe, ndoshta dhe kopjet e tjera? Filloi të kuptojë se Kuortermvjni ishte njeri që mund të kuptohej me vështirësi, veprimet e të cilit ishte vështirë të parashikoheshin; ndoshta ishte edhe i rrezikshëm. Nga ana tjetër, me gjithë tronditjen që kishte pësuar, e ndjente veten të magjepsur. Ndërsa shikonte fotografitë, njomi me gjuhë mekanikisht buzët. Nxitja e parë që kishte pasur kishte qenë që t'i griste e t'i zhdukte ato fotografi, por tani nuk mund ta bënte më.
Me habi, konstatoi se ishte në zyrë që prej gati një gjysmë ore. Ishte e qartë se nuk mund t'i merrte në shtëpi ato fotografi. Po atëherë? I futi përsëri me kujdes në pliko dhe këtë e futi në një sirtar të tryezës së punës, në të cilin mbante dokumente të ndryshme personale. Për forcë zakoni, hapi një sirtar tjetër, ku zonja Kellëgen, para se të largohej në mbrëmje, linte praktikat

në vazhdim. Në krye të të tjerave ishte praktika lidhur me huanë suplementare për Q-Investments-in. Hejuordi mendoi: Pse ta vononte këtë punë? Pse të ngurronte? A ishte me të vërtetë nevoja të konsultohej edhe një herë të dytë me Petërtonin? Huaja ishte e sigurt, sikurse ishin Xh. Xh. Kuortermvjni dhe Suprënejshnëli. Duke hequr dokumentet e tjera, ai shënoi me nxitim «miratuar» dhe shtoi siglën e tij.

Pas disa minutave ndodhej përsëri në sallën poshtë. Shoferi po e priste dhe limuzina ishte ndalur pranë trotuarit.

Nolan Uejnrajtit i takonte tani rrallë të shkonte në morgun e qytetit. I kujtohej se, për herë të fundit, kishte qenë atje para tre vjetëve, për të identifikuar trupin e një roje banke, të vrarë gjatë një veprimi grabitjeje me armë. Kur punonte në polici, vizita në morg dhe ekzaminimi i viktimave të dhunës kriminale kishte qenë një pjesë e nevojshme dhe e shpeshtë e punës së tij. Por, edhe atëherë, ai nuk ishte mësuar kurrë. Morgët, me atmosferën e tyre të vdekjes dhe erën e kufomave, e preknin thellë dhe, nganjëherë, i shkaktonin edhe krupë. Ashtu po ndodhte edhe në atë çast.

Rreshteri i policisë, me të cilin ishte lënë takimi, ecte gjakftohtë dhe i qetë krahas Uejnrajtit, gjatë një korridori të ndriçuar keq dhe hapat e tyre jehonin mjaft në dyshemenë e vjetër prej pllakash të plasaritura. U printe shërbyesi i morgut, i cili të linte përshtypjen se, së shpejti, dhe ai vetë do të bëhej një klient i atij vendi. Ai mbante këpucë me sholla gome, prandaj ecja e tij e ngathët ishte e heshtur.

Rreshteri, emri i të cilit ishte Timbëruell, ishte një djalosh trupmadh dhe i ngjallur, me flokë të shpupuritur dhe që kishte nevojë të ngutshme për t'u rruar. Shumë gjëra kishin ndryshuar, po mendonte Nolan Uejnrajti, gjatë dymbëdhjetë vjetëve që kishin kaluar nga koha kur ai kishte qenë togër policie.

Timbëruelli tha:
— Në rast se i vdekuri do të jetë njeriu që kërkoni, kur e keni

parë për herë të fundit?
— Para shtatë javëve. Nga fillimi i marsit.
— Ku?
— Në një bar të vogël, nga ana tjetër e qytetit.
— E di ku është. Po pastaj, keni pasur lajme për atë?
— Jo.
— Dini gjë se ku banonte?
Uejnrajti tundi kokën.

— S'donte që unë ta dija, kështu që nuk ngula më këmbë.

Nolan Uejnrajti s'kishte qenë i sigurt as për emrin e tij. Ai i kishte dhënë një emër, por sigurisht që ky emër do të ishte i rremë. Gjithçka që dinte ishte se «Viku» ishte një ish i burgosur, që kishte nevojë për para dhe pranonhte të luante rolin e informatorit të fshehtë.

Në tetor, pas këmbënguljeve të vazhdueshme të Uejnrajtit, Aleks Vandervurti e kishte autorizuar të angazhonte një informator, për të gjetur burimin e letërkrediteve Kiçarxh të falsifikuara, që qarkullonin në sasi shumë të madhe. Uejnrajti kishte përhapur lajmin se kërkohej të merrej një informator, duke shfrytëzuar kontaktet e tij me botën e krimit. Pas njëfarë kohe, me anë të ndërmjetësve të tjerë, një takim ishte rregulluar ndërmjet atij dhe Vikutt. Të dy ishin marrë vesh. Kjo kishte ndodhur në dhjetor. Drejtorit të shërbimit të sigurimit i kujtohej mirë, sepse procesi i Majlls Istinit kishte ndodhur gjithashtu po atë javë.

Dy takime të tjera ishin bërë, gjatë muajve të mëvonshëm, midis Vikutt dhe Uejnrajtit, çdo herë në një bar të ndryshëm dhe të veçuar; dhe, në të tria rastet, Uejnrajti i kishte dhënë Vikutt para, pa ditur se ç'do të merrte si këmbim më vonë. Sistemi i tyre për të rënë në kontakt ishte i njëanshëm: Viku mund t'i telefononte Uejnrajtit, për t'u marrë vesh për një takim në një vend që e zgjidhte ai, por Uejnrajti nuk kishte mundësi ta thërriste nga ana e tij. Mirëpo, ai e kuptonte mirë mosbesimin e Vikutt dhe e kishte pranuar këtë marrëveshje.

Viku nuk i pëlqente, por dhe vetë ai nuk kishte pritur të ndodhte ndryshe. Ish i burgosuri ishte finok, i paqëndrueshëm, me hundën që gjithnjë i formonte një pikë dhe nganjëherë i pikonte, si edhe simptoma të tjera të toksikomanit. Ai shfaqi përbuzje për gjithçka dhe të gjithë, duke përfshirë dhe vetë Uejnrajtin. Buzët i kishte gjithnjë të shtrembëruara në një ngërdheshje. Por, në takimin e tyre të tretë, në mars, Nolani kishte mësuar se ndoshta Viku kishte rënë në një gjurmë.

Ai kishte folur për disa fjalë që qarkullonin, sipas të cilave një sasi e madhe bankënotash njëqind dollarëshe, të falsifikuara me cilësi të lartë, do të futej së shpejti në qarkullim, me anë të një rrjeti shpërndarësish, me shumicë e me pakicë. Sipas një lajmi tjetër, prapë shpërndarësve punonte, diku në errësirë, një organizatë e fuqishme dhe e përgatitur në këtë fushë veprimtarie, e cila merrej edhe me sektorë të tjerë, duke përfshirë atë të letërkrediteve. Kjo informatë e dytë ishte e errët dhe Uejnrajti kishte dyshuar se Viku e kishte shpikur nga koka e tij, për të krijuar përshtypjen se kishte zbuluar diçka. Por, ajo mund të ishte edhe e vërtetë.

Viku kishte vazhduar, duke deklaruar se ishte premtuar një pjesë e vogël aktive në operacionin lidhur me paratë e falsifikuara. Ai mendonte se, pasi të ishte futur në organizatë dhe të kishte fituar besimin e krerëve të saj, do të mundej të vepronte më thellë brenda organizatës. Nja dy hollësi, të cilat, sipas mendimit të Uejnrajtit, Viku nuk mund t'i shpikte vetë, mbasi s'kishte as njohuritë dhe as aftësitë e nevojshme për të bërë një gjë të tillë, e bindën drejtorin e shërbimit të sigurimit se pjesa themelore e informatave ishte e vërtetë, kështu që edhe plani i menduar nga Viku nuk ishte pa kuptim.

Uejnrajti ishte nisur gjithnjë nga mendimi se kishte të ngjarë që, kushdo që prodhonte letërkreditë Kiçarxh të falsifikuara, të ishte i pleksur edhe në forma të tjera falsifikimi.

Këtë ia kishte thënë Aleks Vandervurtit në tetor. Për një gjë ishte i sigurt: orvatja për t'u futur në organizatë do të ishte një veprim shumë i rrezikshëm dhe, në rast se informatori zbulohej, mund t'i lante mirë duart nga kjo botë. Prandaj, e kishte quajtur si detyrë që t'ia tërhiqte vëmendjen Vikut për këtë dhe, si falënderim për shqetësimin e tij, kishte marrë një ngërdheshje përbuzëse.

Pas këtij takimi të tretë, Viku s'ishte parë më.

Një ditë para vizitës në morg, Uejnrajtit i kishte tërhequr vëmendjen një lajm i shkurtër, i botuar në gazetën «Tajms-Rexhister», që fliste për gjetjen e një kufome që lundronte në lumë.

— Duhet t'ju paralajmëroj, — i tha rreshteri Timbëruell, — se ajo që ka mbetur nga ai njeri, s'është e bukur për t'u parë. Mjeku ligjor thotë se duhet të ketë ndenjur një javë në ujë. Veç kësaj e ka trupin të çarë e të copëtuar, tamam sikur i ka shkuar sipër helika e ndonjë barke.

Duke pasur gjithnjë përpara shërbyesin e vjetër, ata hynë në një sallë të gjatë dhe me tavan të ulët, të ndriçuar shumë. Ajri ishte i ftohtë dhe kundërmonte nga dezinfektantët. Një faqe muri ishte zënë krejtësisht nga një lloj skedari vigan, me sirtarë me çelik të paoksidueshëm, të pajisur secili me nga një numër. Nga prapa skedarit dëgjohej zukama e një aparati për uljen e temperaturës së ajrit.

Shërbyesi vështroi me sytë e tij miopë një tabelë të vogël që e kishte me vete dhe, pastaj, shkoi te një sirtar aty nga mesi i sallës. Tërhoqi dorezën dhe sirtari u hap pa zhurmë, duke shkarë mbi kushineta najloni. Brenda ishte trajta e parregullt e një trupi, i mbuluar me një fletë karte mbrojtëse.

— Ja trupi që kërkove, shef, — tha plaku.

Me të njëjtën indiferencë, sikur të kishte treguar përmbajtjen e një arke me kastravecë, ai hapi fletën e kartës.

Uejnrajti e ndjeu veten keq; i vinte për të vjellë dhe do të donte të mos kishte ardhur fare.

Dikur ky trup kishte pasur një fytyrë. Tani s'kishte më. Qëndrimi në ujë, kalbëzimi dhe diçka tjetër — ndoshta një helikë, siç kishte thënë Timbëruelli — i kishin prerë dhe çarë indet. Vende-vende, dilnin në dukje copa kockash të bardha.

Të dy vëzhguan kufomën në heshtje dhe, pastaj, rreshteri e pyeti:

— A gjete ndonjë shenjë identifikimi?

— Po, — u përgjigj Uejnrajti. Po shikonte njërën faqe të fytyrës, në qoshen e nofullës, aty ku ajo që mbetej nga vija e flokëve bashkohej me qafën. Njolla e kuqe në trajtë molle — pa dyshim një nishan që nga lindja — ishte akoma e dukshme në mënyrë të qartë. Syri i tij i stërvitur e kishte vënë re në të tre takimet që kishte pasur me Vikun. Ndonëse buzët aq të gatshme për t'u ngërdheshur nuk ishin më, s'kishte dyshim se trupi ishte i agjentit të tij të fshehtë. Ia tha Timbëruellit, që pohoi me kokë.

— Ne e identifikuam me anë të shenjave të gishtërinjve. Sigurisht, nuk ishin nga më të qartat, por, sidoqoftë, ia arritëm qëllimit. — Rreshteri nxori një bllok shënimesh dhe e hapi. — Emri i tij i vërtetë ishte Klarens Hugo Levinson, por përdorte edhe disa emra të tjerë. Kishte një dosje të gjatë penale, por pjesa më e madhe me gjëra jo të rëndësishme.

— Gazeta thoshte se kishte vdekur nga goditjet me thikë dhe jo për shkak mbytjeje.

— Kështu u vërtetua nga autopsia. Por, më parë, është torturuar.

— Nga e dini këtë?

— I ka tekstilet të shtypura. Mjeku ligjor tha se duhet t'ia kenë shtrënguar me një morsë deri sa kanë plasur. Do t'i shohësh?

Pa pritur përgjigjen e Uejnrajtit, shërbyesi hoqi pjesën që mbetej, të fletës së kartës.
Me gjithë rrëgjimin e organeve gjenitale, të shkaktuar nga qëndrimi në ujë, autopsia kishte nxjerrë në dritë mjaft elemente për të vërtetuar pohimin e Timbëruellit. Uejnrajti u përcoll.
— Oh, Krisht! — ia bëri me shenjë shërbyesit plak: — Muloje prapë.
Pastaj i tha Timbëruellit, me një zë që shprehte padurim:
— Dalim që këtej.

Para një kafeje të fortë, të zezë, në një bar të vogël që ndodhej nja gjysmë blloku ndërtesash nga morgu, Timbëruelli po thoshte:
— I varfri! Çfarëdo që të ketë bërë, askush nuk e meriton një fund të tillë. — Ndezi një cigare dhe i ofroi edhe Uejnrajtit, i cili tundi kokën.
— Besoj se e kuptoj se si e ndjeni veten, — i tha Timbëruelli.
— Për disa gjëra, jeni mësuar, por ka të tjera që ju fusin në mendime.
— Po.
— Kam nevojë për një deklaratë. Një përmbledhje të gjërave që më thatë rreth marrëveshjes tuaja me të ndjerin. Në qoftë se për ju është njësoj, do të ishte mirë të shkonim në zyrën e policisë së rrethit, sapo të kemi mbaruar këtu.
— Në rregull.
Rreshteri nxori tymin e duhanit rrathë-rrathë dhe piu një gllënjkë kafe. — Cila është tani gjendja e letërkreditive të falsifikuara?
— Numri i tyre në qarkullim është gjithnjë e më i madh. Ka ditë që duket sikur ka shpërthyer një epidemi. Kjo gjë po u kushton bankave, sikurse tonës, shumë para.
Timbëruelli vërejti, me ton që shprehte dyshim:
— Doni të thoni se kjo gjë po i kushton shumë para publikut. Bankat, si juaja, ua kalojnë humbjet të tjerëve. Kjo është arsyeja se përse drejtuesit tuaj s'e vënë aq shumë ujin në zjarr.

— Përsa i përket kësaj pike, nuk mund të them se e keni gabim. — Uejnrajti mendoi për të gjitha rastet, kur kishte kërkuar — më kot — një shtesë fondesh për të luftuar falsifikimet e ndryshme.
— Po cilësia e atyre letërkreditive të mirë është?
— E shkëlqyer.
Rreshteri murmuriti:
— Pikërisht kështu na tha dhe shërbimi sekret lidhur me paratë e falsifikuara që qarkullojnë në qytet. Janë me shumicë të madhe. Mendoj se ju e dini këtë.
— Po, e di.
— Ndoshta ky i gjori, që vdiq, kishte të drejtë kur me ndonte se të dyja gjërat vinin nga i njëjti burim.
Asnjëri prej tyre s'po fliste, kur Timbëruelli tha papritur:
— Ka diçka që duhet t'ju paralajmëroj. Ndoshta e keni menduar edhe vetë.
Uejnrajti po priste.
— E patë se si e kishin katandisur Levinsonin. Nuk ka mundësi që t'u ketë rezistuar torturave. Prandaj, duhet t'i ketë zbrazur të gjitha, duke përfshirë edhe marrëveshjen që kishte me ju...
— Po, e kam menduar.
Timbëruelli tundi kokën:
— Nuk besoj që ju të jeni në rrezik tani për tani, por, për ata që vranë Levinsonin, ju përfaqësoni një armik. Në qoftë se ju merreni vesh me dikë tjetër, që është në kontakt me ta dhe ata e mësojnë këtë gjë, ky dikush tjetër do të mbarojë keq.
Uejnrajti hapi gojën për t'u përgjigjur, por rreshteri nuk i la kohë.
— Dëgjoni, nuk po ju them se nuk duhet të angazhoni një informator tjetër. Kjo është puna juaj dhe unë nuk dua të asgjë për të, së paku, jo tani. Por, po ju them këtë: në rast se do ta angazhoni, tregohuni shumë, shumë i kujdesshëm dhe mos përdorni kontakte të drejtpërdrejta. Kjo është më e pakta që mund të bëni për t'i shmangur atij rreziqe shumë të mëdha.
— Faleminderit për paralajmërimin, — tha Uejnrajti. Po mendonte akoma për trupin e Vikut, siç e kishte parë kur

shërbyesi plak kishte hequr fletën e kartës mbrojtëse. — Por, dyshoj shumë që të mund të ketë një informator të dytë.

Pjesa e tretë

Ndonëse vazhdonte ta kishte të vështirë të përballonte shpenzimet me pagën e saj të arkëtares prej 98 dollarësh në javë (83 dollarë, pasi i mbaheshin shuma të vogla të ndryshme), Huanita ia dilte mbanë, në njëfarë mënyre, nga njëra javë në tjetrën, të mbante veten e saj dhe Estelën dhe të paguante çerdhen e vajzës. Ajo kishte mundur ta ulte pak edhe këstin e agjencisë së huave, që ia kishte lënë në kurriz i shoqi, Karlosi, kur e kishte braktisur. Në mënyrë të njerëzishme, agjencia e huave kishte bërë një kontratë të re, me këste mujore më të vogla; por, tani, afati i pagesës zgjatej për tre vjet të tjerë dhe interesi ishte më i madh.

Në bankë, megjithëse mbas padisë së gabuar tregoheshin të kujdesshëm me të dhe personeli bënte çmos për të qenë i afrueshëm dhe i sjellë, Huanita s'kishte krijuar me asnjëri marrëdhënie të ngushta miqësore. Nga natyra e saj, ajo nuk ishte e prirur për të vendosur me lehtësi marrëdhënie shoqërore. Ajo kishte një mosbesim instinktiv kundrejt njerëzve, pjesërisht të natyrshëm dhe pjesërisht të krijuar nga përvoja. Gjëja kryesore në jetën e saj, kulmi drejt të cilit synonte çdo ditë pune që kryente, ishin orët e mbrëmjes që kalonte së bashku me Estelën.

Dhe, tani, ishin bashkë.

Në kuzhinën e apartamentit të tyre të vogël, por të rehatshëm, në Rajonin Lindor, Huanita po përgatiste darkën, e ndihmuar - dhe nganjëherë e penguar - nga e bija trevjeçare. Të dyja po bënin gati një byrek për ta futur në furrë: Huanita po i shtronte përsipër petët me mish, ndërsa Estela i kishte marrë së ëmës pak brumë dhe, me gishtat e vockël, po i jepte trajta të ndryshme, sipas fantazisë së saj.

— Mami! Shiko, kam bërë një kështjellë magjike.

Ato qeshën të dyja.

— Sa e bukur, shpirtja ime! — thirri me dashuri Huanita. — Do ta vëmë kështjellën në furrë, bashkë me byrekun, kështu të dyja do të bëhen magjike.

Huanita kishte përdorur për byrekun mish lope të konservuar, qepë, një kokërr patate, karota të freskëta dhe një kuti bizele. Perimet e kompesonin në vëllim sasinë e vogël të mishit. Ajo s'kishte mundësi të përdorte më shumë mish, por ishte kuzhiniere me mendje pjellore dhe byreku do të ishte i shijshëm e i ushqyeshëm.
Kishte njëzet minuta që e kishte futur në furrë dhe duheshin edhe dhjetë të tjera që të bëhej gati dhe, gjatë kësaj kohe, Huanita po i lexonte Estelës përralla të Hans Andersenit, të përkthyera spanjisht, kur te dera e apartamentit, u dëgjuan të trokitura. Huanita e ndërpreu leximin dhe vuri veshin e habitur. Asaj i vinin rrallë njerëz për vizitë dhe ishte një gjë jo e zakonshme që kjo të bëhej kaq vonë. Pas disa çastesh, trokitja u dëgjua përsëri. Me njëfarë shqetësimi, pasi i bëri shenjë Estelës të rrinte aty ku ishte, Huanita u ngrit dhe shkoi me ngadalë drejt derës.
Apartamenti zinte tërë katin e poshtëm të një ndërtese, që shumë kohë më parë kishte qenë banesa e një familjeje të vetme, por që, pastaj, ishte ndarë në disa banesa të veçanta. Punimet që ishin bërë për rregullimin e Rajonit Lindor i kishin ruajtur ndërtesat që ekzistonin që më parë, duke bërë aty-këtu ndonjë modernizim ose riparim. Mirëpo, vetëm punimet e ndërtimit dhe të rregullimit të Rajonit Lindor nuk e ndryshonin faktin që ky i fundit ndodhej në një zonë të dëgjuar për numrin e madh të krimeve, veçanërisht të grabitjeve nëpër shtëpi dhe të vjedhjeve. Prandaj, megjithëse në çdo ndërtesë s'kishte asnjë apartament të pabanuar, pjesa më e madhe e banorëve i mbyllnin dyert me shul. Në katin përdhes të ndërtesës, ku banonte Huanita, gjendej një portë e madhe, e cila përbënte një mbrojtje të mirë, por, shpeshherë, banorët e linin hapur.
Sapo të dilje nga apartamenti i Huanitës ishte një platformë e ngushtë, në krye të disa shkallëve. Duke mbajtur veshin te dera, Huanita pyeti:
— Kush është? — Nuk mori përgjigje, por u dëgjua përsëri një trokitje e lehtë, por këmbëngulëse.
U sigurua që zinxhiri i brendshëm mbrojtës ishte në vend dhe,

pastaj, rrotulloi çelësin në bravë dhe e hapi derën disa centimetra — aq sa e lejonte zinxhiri.
Në fillim, për shkak të ndriçimit të dobët, nuk pa gjë, por pastaj dalloi një fytyrë dhe dëgjoi një zë që i tha:
— Huanita, a mund të flas me ty? Kam nevojë të të them diçka, të lutem! Do të më lësh të hyj?
Habia e madhe e shtangu Huanitën në vend. Ishte Majlls Istini. Megjithatë, as zëri dhe as fytyra nuk ishin ata të Istinit që njihte. Fytyra e tij, të cilën ajo mund ta shihte tani më mirë, ishte e zbehtë dhe e tërhequr, ndërsa zëri i pasigurt dhe lutës. Deshi të fitonte kohë për t'u menduar.
— E dija se ishe në burg.
— Dola. Sot. — Pastaj, korrigjoi veten: — Jam në liri të mbikëqyrur.
— Pse erdhe këtu?
— M'u kujtua adresa jote.
Huanita tundi kokën, gjithashtu pa e hequr zinxhirin.
— Nuk pyeta për këtë. Pse erdhe tek unë?
— Sepse gjatë tërë muajve që kalova atje brenda, s'kam bërë tjetër veçse kam menduar të të shihja, të flisja me ty, të shpjegoja ...
— S'ka asgjë për të shpjeguar.
— Ka, si jo! Huanita, të lutem shumë, mos më dëbo! Të lutem!
Prapa Huanitës u dëgjua zëri i qartë e tingëllues i Estelës, që pyeti:
— Mami, kush është?
— Huanita, — tha Majlls Istini, — s'ke përse të frikësohesh, as për veten tënde e as për vogëlushen. S'kam me vete gjë tjetër, përveç kësaj. — Dhe tregoi një valixhe të vogël, në gjendje të keqe. — Vetëm gjërat që më dhanë prapë, kur dola.
— Por ... — Huanita e kishte me mëdyshje.
Me gjithë mosbesimin që kishte, kureshtja e saj ishte e fortë. Pse kishte dashur Majllsi ta takonte? Duke thënë me vete se, ndoshta, pastaj do të pendohej, ajo e mbylli me ngadalë derën dhe i hoqi zinxhirin.
— Faleminderit. — Majlls Istini hyri me hap të pasigurt,

pikërisht sikur të kishte frikë se mos Huanita ndërronte mendje.
— Mirëmbrëma, xhaxhi, — tha Estela, — je miku i mamit?

Për një çast, Istini u duk i turbulluar, pastaj u përgjigj:
— S'kam qenë gjithmonë, fatkeqësisht.
Vogëlushja me flokët e zinj e shikoi në sy.
— Si e ke emrin?
— Majlls.
Estela qeshi nën hundë.
— Je shumë i thatë.
— Po, e di.
Tani që shihej mirë Huanita mbeti edhe më e habitur nga ndryshimi që ai kishte bërë. Në ato tetë muaj që kishin kaluar që nga hera e fundit që e kishte parë, ai ishte dobësuar aq shumë saqë qafa dhe trupi i tij ishin tharë dhe faqet i ishin bërë gropë. Kostumi i zhubrosur ishte shumë i gjerë, sikur të ishte prerë për një njeri dy herë më të shëndoshë se ai. Dukej i lodhur dhe i dobët.
— A mund të ulem?
— Po. — I bëri me shenjë drejt një karrigeje të thurur me thupra shelgu, ndonëse vetë vazhdoi të qëndronte në këmbë, përballë tij. Ajo i tha me një ton, që, pa kuptim, ishte paditës:
— S'ke ngrënë mirë në burg.
Ai tundi kokën, duke buzëqeshur lehtë për herë të parë.
— S'mund të thuhet se ishte një jetë plot bollëk e shije të hollë. Besoj se duket.
— Si me kuenta. Duket.
Estela pyeti:
— Ke ardhur për darkë? Mami im ka bërë byrek.
Ai ngurroi.
— Jo.
Huanita e pyeti me të shpejtë:
— Ke ngrënë sot?
— Në mëngjes. Hëngra diçka te stacioni i autobusëve.
Nga kuzhina vinte era e byrekut, që pothuajse ishte gati. Instinktivisht, Majllsi ktheu kokën në atë drejtim.

— Atëherë, do të hash me ne. — Huanita vuri edhe një pjatë tjetër në tryezën e vogël, ku ajo dhe Estela hanin zakonisht. Këtë veprim e bëri me një mënyrë krejt të natyrshme. Në çdo shtëpi portorikane, edhe në më të varfrën, tradita e kërkon që ç'ke në sofër, qoftë shumë apo pak, të ndahet me mysafirin. Gjatë darkës, Estela fliste vazhdimisht dhe Majllsi u përgjigjej pyetjeve të saj. Shihej se tensioni që kishte pasur në fillim, po i kalonte. Disa herë kishte hedhur sytë përqark apartamentit, të mobiluar thjesht, por në mënyrë të këndshme. Huanita ishte e zonja në punët e shtëpisë; asaj i pëlqente të qetësonte me thjeshtësi. Karrigia, e thurur me thupra shelgu, në të cilën u ul më parë Majllsi, ishte njëra nga të dyja karriget që Huanita i kishte blerë lirë dhe, pastaj, i kishte lyer me bojë të kuqe kineze. Për dritaret, ajo kishte bërë perde të thjeshta dhe jo të shtrenjta, me pëlhurë shumë të fortë, ngjyrë të verdhë të ndezur. Muret ishin stolisur me një pikturë me stil primitiv dhe me disa afishe agjencish udhëtimesh.
Huanita dëgjonte dy të tjerët, por vetë fliste pak. Ajo kishte akoma brenda saj dyshim e mosbesim. Cila ishte arsyeja e vërtetë e ardhjes së Majllsit? A do t'i shkaktonte ai ngatërresa të tjera, si ato që i kishte shkaktuar më parë? Përvoja i thoshte se një gjë e tillë mund të ndodhte. Megjithatë, tani për tani, ai dukej i padëmshëm — fizikisht i dobët pak i frikësuar, dhe, moralisht, ndoshta i dërrmuar. Huanita kishte mjaft ushtrime praktike për t'i kuptuar të gjitha këto.
Ndërkaq, ajo nuk ndiente ndonjë armiqësi kundrejt tij, ndonëse Majllsi qe orvatur t'ia hidhte asaj fajin për zhdukjen e parave, që i kishte vjedhur vetë. Koha e kishte bërë të harrohej atë veprim të ulët. Bile, edhe në fillim, kur e kishin demaskuar, ajo kishte pasur më shumë një ndjenjë lehtësimi se sa urrejtjeje. E vetmja gjë që dëshironte tani Huanita për veten e saj dhe për Estelën ishte t'i linin të qeta.
Me një fshirëtimë, Majlls Istini shtyu mënjanë pjatën. S'kishte lënë asgjë në të.
— Faleminderit. Ka shumë kohë që s'kisha ngrënë gjëra kaq të mira.
Huanita e pyeti:

— Ç'mendon të bësh?
— Nuk e di. Nesër do të filloj të kërkoj ndonjë punë.
Ai mori frymë thellë dhe u duk sikur qe gati për të thënë diçka tjetër, por ajo i bëri shenjë të priste.
— Estelita, shkojmë shpirt. Është koha për gjumë!

Mbas pak, e larë, me flokët të krehur me furçë dhe me një palë pizhamas ngjyrë trëndafili, Estela erdhi t'u thoshte natën e mirë. Sytë e saj të mëdhenj e të ndritshëm e shikuan Majllsin tërë seriozitet.

— Babi im ka ikur. Po ti, do të ikësh?
— Po, mbas pak.
— Kështu mendova edhe unë. — Ajo ngriti fytyrën e saj që ta puthnin.

Pasi e mbuloi mirë Estelën në shtrat, Huanita doli nga dhomën e fjetjes dhe mbylli derën. U ul përballë Istinit, me duart të bashkuara në prehër.

— Tani mund të flasësh, — i tha atij.

Ai ngurroi, duke njomur buzët me gjuhë. Tani që kishte ardhur çasti, dukej i pavendosur, e sikur s'fliste dot. Pastaj tha:

— Tërë kohën që... më mbajtën në burg... kam dashur të të kërkoja të falur. Të kërkoja të falur për çdo gjë që kisha bërë, por sidomos për atë që të bëra ty. Më vjen turp. Nga njëra anë, nuk e di se si ndodhi; nga ana tjetër, mendoj se e di.

Huanita mblodhi supet.

— Ajo që u bë, u bë. Ç'rëndësi ka tanimë?
— Ka rëndësi për mua. Të lutem, Huanita, më lër të të tregoj pjesën tjetër se si ndodhi.

Atëherë, si nga një pus nafte në shpërthim, fjalët filluan të dilnin në mënyrë të papërmbajtshur. Ai foli për zgjimin e ndërgjegjes së tij dhe drejtjet e saj; për marrëzitë e lojës së kumarit dhe basteve, para një viti, dhe se si ai kishte qenë plotësisht nën ndikimin e tyre, si në ethe të forta që

shtrembëronin vlerat morale dhe ndijimet. Ai i tha Huanitës se, kur hidhte sytë mbrapa, i dukej sikur dikush tjetër kishte pasur në zotërim mendjen dhe trupin e tij. Ai e pranonte fajin e tij për vjedhjen e bankës, por pohonte se ajo që i kishte bërë Majllsi filloi të fliste, kundërveprimi instinktiv i Huanitës kishte qenë dyshimi, që nuk u zhduk krejtësisht edhe pasi ai vazhdoi. Huanitën e kishin mashtruar dhe dëmtuar aq shpesh në jetë, saqë tanimë nuk mund të besonte plotësisht në asgjë. Megjithatë i dukej se ato që thoshte Majllsi ishin të vërteta dhe e ndjente veten të pushtuar nga një mëshirë e madhe.

Pa dashur, po krahasonte Majllsin me Karlosin, të shoqin që ishte larguar. Karlosi kishte qenë njeri me karakter të dobët, po kështu edhe Majllsi. Mirëpo, në njëfarë mënyre, fakti që Majllsi kishte dashur të kthehej si fajtor, për t'i kërkuar të falur, tregonte një forcë dhe burrëri që Karlosi nuk e kishte pasur kurrë.

Befas, ajo pa anën komike të të gjithë kësaj pune: në jetën e saj, burrat — për një arsye a një tjetër — ishin plot me të meta dhe nuk të binin në sy. Ata ishin gjithashtu pa fat, ashtu si dhe vetë ajo. Që gati duke qeshur, por e përmbajti veten, sepse Majllsi s'do ta kishte kuptuar.

Ai i tha, me ton shumë serioz:

— Huanita, dua të të kërkoj diçka. A do të më falësh?

Huanita e shikoi drejt e në sy.

— Dhe, po qe se do të më falësh, do të ma thuash?

Gazi i heshtur u zhduk; sytë e saj u mbushën me lot. Këtë, ajo mund ta kuptonte. U ngrit në këmbë.

— Majlls, — i tha, — ngrihu dhe më vështro.

Ai iu bind dhe ajo i tha me ëmbëlsi:

— Ke vuajtur shumë.Po, të fal.

Muskujt e fytyrës së tij u kontraktuan dhe, pastaj, Huanita e mbajti, kur ai shpërtheu në vaj.

Kur Majllsi u qetësua dhe ata u ulën përsëri, Huanita foli për gjëra praktike.

— Ku do ta kalosh natën?
— S'e di mirë. Do të gjej ndonjë vend.

Ajo u mendua pak dhe, pastaj i tha:

— Mund të rrish këtu, po deshe. — Dhe, duke vënë re habinë e Majllsit, ajo shtoi me të shpejtë: — Mund të flesh në këtë dhomë vetëm për sonte. Unë do të jem në dhomën e fjetjes me Estelën. Dera jonë do të jetë e mbyllur me kyç.

— Ajo nuk donte keqkuptime.

— Në qoftë se, me të vërtetë, kjo nuk të shqetëson, — u përgjigj Majllsi, — për mua do të ishte mirë. Dhe ju s'keni pse të merakoseni për asgjë.

Mbas pak, duke qenë se të dy e ndjenin veten shumë të lodhur, Huanita shkoi në dhomën e fjetjes, tek Estela.

Në mëngjes, nëpërmjet derës së dhomës së fjetjes, ajo e dëgjoi Majllsin që po ngrihej. Pas një gjysmë ore, kur doli nga dhoma e fjetjes, ai kishte ikur.

Në tryezën e dhomës së ndenjes ishte vënë, në mënyrë që të binte në sy, një copë letër.

Huanita,
Me gjithë zemër, të falemnderit!
Majlls.

Ndërsa po përgatiste mëngjesin për vete dhe Estelën, ajo u habit kur ndjeu se i vinte keq që Majlls kishte ikur.

Aleks Vandervurti e kishte shfrytëzuar mirë periudhën prej katër muajsh e gjysmë, që kishte kaluar, që kur këshilli administrativ i FMA-së kishte miratuar programin e tij të

zgjerimit të depozitimeve të kursimit dhe të degëve të bankës. Ishin bërë mbledhje pothuajse të përditshme midis personelit të bankës dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm për të diskutuar si për projektet e reja, ashtu edhe për ato që ishin në zhvillim e sipër. Punohej gjatë pushimeve të fundit të javës dhe ditëve të festave e të pushimit, me nxitjen dhe këmbënguljen e Aleksit, i cili donte që programi të hynte në veprim para mbarimit të verës dhe të ishte në funksionim të plotë aty nga mesi i vjeshtës.

Riorganizimi i sektorit të depozitimeve të kursimit ishte shumë i lehtë për t'u kryer brenda kohës së parashikuar. Shumica e gjërave që Aleksi donte të bëheshin — duke përfshirë krijimin e katër tipeve të reja depozitimesh kursimi, me përqindje interesi më të larta dhe në përshtatje me nevojat e ndryshme — ishin studiuar që më parë, me porosinë e tij. Tani, puna ishte që ato të viheshin në praktikë dhe të bëheshin realitet. Ndërsa, gjërat që duheshin nisur krejt nga fillimi përbënin, ndër të tjera, një fushatë të gjerë publicitare për të tërhequr depozitues të tjerë dhe, kjo punë — pavarësisht në kishte këtu konflikt interesash apo jo — u përgatit me shpejtësi e kompetencë nga agjencia «Ostin». Tema e fushatës së kursimit ishte parulla:

FËRST MERKËNTAILL ËMERIKËN BENKU
JU SHËRBEN PËR KURSIMIN TUAJ

Në ditët e para të gushtit, njoftime të botuara në dy faqe nga gazeta të ndryshme shpallnin të mirat e kursimit, të bëra sipas mënyrës së propaganduar nga FMA-ja. Ato tregonin gjithashtu vendet ku ishin vendosur tetëdhjetë degë të bankës, të shpërndara në të gjithë territorin e shtetit, të cilat i ofronin dhurata, kafe dhe «këshilla miqësore financiare» cilido që hapte një llogari të re. Vlera e dhuratës varej nga shuma e depozitimit fillestar dhe periudha e deklaruar, gjatë së cilës nuk do të prekej. Një fushatë paralele depërtonte brenda nëpër shtëpitë, me anë të njoftimeve të bëra me televizion dhe radio.

Përsa u përkiste nëntë degëve të reja të bankës — «dyqanet tona të parave», sikurse i quante Aleksi — dy ishin hapur në javën e fundit të korrikut, tri të tjera në ditët e para të gushtit dhe katër të tjerat që mbeteshin, do të ishin gati para fillimit të shtatorit. Meqenëse të gjitha ishin vendosur në lokale të marra me qira, gjë që nuk kërkonte të bëheshin ndërtime, por vetëm disa punime transformimi, kishte qenë e mundur të ecej përpara me njëfarë shpejtësie.

Qenë pikërisht «dyqanet e parave» — emër që u përgjithësua me shpejtësi — që e tërhoqën më shumë vëmendjen që në fillim. Për ato u bë një publicitet edhe më i madh se sa kishte qenë parashikuar, si nga Aleks Vandervurti, ashtu dhe nga zyra e marrëdhënieve publike të FMA-së ose nga agjencia «Ostin». Dhe zëdhënësi i të gjitha këtyre ishte Aleksi, që po dilte gjithnjë e më shumë në pah dhe për të cilin flitej gjithnjë e më shumë.

Ai s'ishte kërkuar një gjë të tillë; kjo ndodhi vetvetiu.

Një reportere e gazetës së mëngjesit «Tajms-Rexhister», e ngarkuar që të bënte një reportazh mbi degët e reja të FMA-së, kishte vajtur të rëmonte në «morgun» e gazetës, për të gjetur të dhëna të mëparshme, që të përbënin një sfond për ngjarjet që do të përshkruante, dhe kishte zbuluar lidhjen e vogël të Aleksit me manifestimin e organizuar në shkurt, në favor të financimeve të Rajonit Lindor. Pas një bisede me kryeredaktorin, ata kishin arritur në përfundimin se Aleksi përbënte një subjekt të mirë për një reportazh të zgjeruar, gjë që doli se ishte e vërtetë.

Në rast se doni të përfytyroni bankierin modern (shkruante reporterja,) mos mendoni një funksionar solemn që i peshon fjalët, të veshur me kostum të errët, me xhaketë me dy radhë kopsash, me buzët gjithnjë të gatshme për të thënë «jo», por mendoni Aleks Vandervurtin.

Në fillim, mund të themi se zoti Vandervurt, funksionar shumë i lartë i Fërst Merkëntajll Emerikën Benkut të qytetit tonë, nuk ka pamjen e një bankieri. Kostumet e tij duken sikur kanë dalë nga faqet e modës së revistës «Iskuajr»; mënyra se si sillet e vepron është e ngjashme me ato të Xhoni Karstonit dhe, kur është fjala për hua të vogla, ai është i prirur — me përjashtime të rralla — të thotë «po». Por, ai ka besim gjithashtu te kursimi dhe pohon se, shumica nga ne, nuk e kemi më urtësinë e prindërve dhe gjyshërve tanë.

Nga ana tjetër, Aleks Vandervurti është edhe një përkrahës i teknikës moderne bankare, diçka nga e cila arriti pikërisht kësaj jave në lagjet e jashtme të qytetit tonë.

Rruga e re e politikës bankare mishërohet me degë të bankës që s'kanë fare një pamje të tillë — gjë që duket krejt logjike, meqenëse zoti Vandervurt (i cili, sikurse thamë, nuk ka pamjen e një bankieri) është këtu te ne forca shtytëse për realizimin e tyre.

Kësaj jave shkova me Aleks Vandervurtin për t'u hedhur një sy degëve të reja të bankës, të cilat ai i quan «degë bankare të një të ardhmeje që ka hedhur tanimë hapat e parë».

Këtë punë e kishte rregulluar Dik Frençi, drejtori i zyrës së marrëdhënieve publike të FMA-së. Reporterja ishte një mesogrua bionde, e flashkët, e quajtur Xhil Pikok. Ajo nuk kishte fituar ndonjë çmim Pulicer, por tregonte interesim për çështjen dhe ishte e përzemërt.

Aleksi dhe zonja Pikok ishin në njërën nga degët e reja të bankës, që ndodhej në qendrën tregtare të një lagjeje të jashtme. Ajo ishte afërsisht madhësinë e një dragstori, e ndriçuar shumë mirë dhe me pajisje të këndshme. Pajisjet kryesore ishin dy arka automatike Dokjutell prej çeliku të paoksidueshëm, të cilat klientët i përdornin vetë, dhe një kabine me një aparat televiziv me qark të mbyllur. Arkat automatike, shpjegoi Aleksi, ishin të lidhura drejtpërdrejt me kompjuterët e Drejtorisë Qendrore të FMA-së.

— Në ditët tona, — vazhdoi ai, — kushtet janë të tilla që publiku pret t'i bëhen shërbime. Ja sepse nga të gjitha anët kërkohet që bankat të rrinë më shumë kohë hapur dhe me një orar më të përshtatshëm për klientët. Dyqane parash si këto do të rrinë hapur njëzet e katër orë në ditë dhe të shtatë ditët e javës.

— Po personeli si do të punojë, me turne? — pyeti zonja Pikok.

— Jo. Gjatë ditës do të jetë një nëpunës për të dhënë ndonjë ndihmë të rastit. Gjithë kohën tjetër, do të jenë vetëm klientët.

— S'keni frikë se mos ndodhin grabitje?

Aleksi buzëqeshi.

— Këto arka automatike janë ndërtuar si fortesa, me të gjitha sistemet e alarmit që njihen sot dhe, telekamerat, një për çdo degë banke, janë të lidhura me qendrën tonë të kontrollit. Problemi ynë i menjëhershëm nuk është sigurimi, por është që të bëjmë që klientët tanë t'i përshtaten konceptit të ri të këtyre degëve të bankës.

— Duket se dikush i është përshtatur tanimë, — tha zonja Pikok.

Ndonëse akoma herët, ora ishte nëntë e gjysmë, në degën e bankës gjendeshin nja 10-12 veta dhe të tjerë po vinin. Pjesa më e madhe ishin gra.

— Studimet që kemi bërë, — shpjegoi Aleksi, — tregojnë se gratë i pranojnë më shpejt ndryshimet që bëhen në sistemet e shitjes dhe ka të ngjarë që kjo të jetë arsyeja pse se dyqanet e shitjes me pakicë i përqafojnë me aq lehtësi ndryshimet e reja. Burrat janë më të ngadalshëm për t'iu përshtatur, por, pastaj, binden nga gratë.

Radhë të vogla ishin formuar para të dy arkave automatike, por, praktikisht, nuk kishte humbje kohe. Veprimet bëheshin

me shpejtësi, sapo klienti të fuste në të çarën përkatëse një kartë identifikimi prej plastmasi dhe të shtypte një kombinim të thjeshtë butonash. Disa po depozitonin para ose çeqe; të tjerë, po tërhisnin para. Nja dy veta do të paguanin llogarinë e letërkredite të tyre, ose ishin për shërbime të tjera. Çfarëdo operacioni të ishte, makina gëlltiste ose nxirrte jashtë letra ose para me shpejtësinë e dritës.

Zonja Pikok bëri me shenjë drejt arkave automatike.

— Mësuan njerëzit t'i përdorin këto më shpejt a më ngadalë se sa e parashikonit ju?

— Shumë, shumë më shpejt. Në fillim ka njëfarë vështirësie t'i bindësh njerëzit t'i përdorin makinat; por, pasi i kanë provuar njëherë, ata mbeten shumë të kënaqur dhe i pëlqejnë.

— Dëgjohet gjithnjë të thuhet se njerëzit preferojnë të kenë të bëjnë me qenie të tjera njerëzore sesa me makina. Pse të ndodhë ndryshe në sektorin bankar?

— Sipas studimeve, që përmenda pak më parë, del se ata nuk duan që veprimet e tyre të mësohen nga të tjerë.

Xhil Pikoku shkroi pastaj në numrin e së dielës:

Në të vërtetë, për këto veprime nuk ka dijeni askush dhe jo vetëm lidhur me ato arkat automatike, që duken sikur të kenë të bëjnë me përbindëshin Frankenështajn.

Hyra në kabinën automatike të degës së bankës dhe u ula përballë një kamere televizive dhe një ekrani. Hapa një llogari dhe, pastaj, u mori vesh për një hua.

Herët e tjera, kur kam marrë hua nga një bankë, s'e kam ndier kurrë veten të qetë e të shpenguar. Kësaj radhe nuk ndodhi ashtu, sepse fytyra që ishte para meje në ekran nuk i përkiste ndonjë njeriu aty. I zoti i asaj fytyre, një njeri-fantazmë, emrin e të cilit unë nuk e dija, gjendej shumë milje larg.

— Për saktësi, shtatëmbëdhjetë milje, — i kishte thënë Aleksi. — Nëpunësi, me të cilin ju folët, ndodhet në një sallë operative të Drejtorisë sonë Qendrore. Prej andej, ai dhe nëpunësit e tjerë mund të vihen në kontakt me cilëndo degë banke, të pajisur me lidhje televizive me qark të mbyllur.

Zonja Pikok pyeti:

— Me ç'shpejtësi është duke u modifikuar, atëherë, sistemi bankar?

— Nga pikëpamja teknologjike, ne po zhvillohemi më shpejt se fluturimet në hapësirë. Këto që po shihni këtu përfaqësojnë hapin më të rëndësishëm përpara, që prej futjes së llogarisë rrjedhëse dhe, mbas nja dhjetë vjetëve, ose dhe më pak, shumica e bankave do të jenë organizuar në këtë mënyrë.

— A do të mbetet dhe ndonjë numër arkëtarësh si më parë?

— Edhe për pak kohë, por ata janë të destinuar të zhduken shpejt. S'do të ketë kaluar shumë kohë dhe figura e arkëtarit që i numëron kartëmonedhat dhe monedhat një e nga një dhe, pastaj, ia kalon në sportel klientit, do të duket si diçka shumë primitive, po aq e prapambetur sa ç'duket sot figura e bakallit të dikurshëm që peshonte sheqerin, bizelet dhe gjalpin dhe i fuste vetë në qese letre.

— Sa e trishtuar është e gjithë kjo, — tha zonja Pikok.

— Ashtu ndodh shpeshherë me përparimin.

Pastaj, unë pyeta nja dhjetë persona të ndryshëm se ç'mendoninh për dyqanet e reja të parave. Të gjithë, pa përjashtim, ishin entuziastë.

Po të gjykosh nga numri i madh i klientëve që po i përdorin, popullariteti i tyre është përhapur gjerësisht. Veç kësaj, zoti Vandervurt më tha se popullariteti i tyre ndihmon për një nxitje të përgjithshme drejt kursimit...

Në të vërtetë nuk qe shumë e qartë nëse ishin dyqanet e parave që i jepnin nxitje rrymës së kursimit, apo anasjelltas. Ajo që u bë e qartë ishte se parashikimet më optimiste të FMA-së për programin e zgjerimit të depozitimeve të kursimit po arriheshin dhe tejkaloheshin me një shpejtësi fenomenale. «Dukej, — sikurse Aleksi i kishte thënë Margot Brekënit, — sikur humori i publikut dhe planet e zhvillimit të FMA-së të ishin sinkronizuar në mënyrë magjike.»

— Ndali vetëlëvdatat dhe pije lëngun e portokallit, — i ishte përgjigjur ajo.

Ishte kënaqësi të gjendeshe të dielën në apartamentin e Margotit. Akoma me pizhama dhe rrobdëshambër, Aleksi po lexonte për herë të parë artikullin e Xhil Pikokut në gazetën «Sandi Tajms-Rexhister», ndërsa Margoti po përgatiste mëngjesin me bazë vezësh.
Aleksi ishte shumë i kënaqur, kur po hanin. Margoti e lexoi gjithashtu artikullin dhe pranoi:
— S'është artikull i keq. — U përkul përpara dhe e puthi.
— Më vjen mirë për ty.
— Ky është një publicitet më i mirë se ai i fundit që më psonise.
Margoti ia priti gëzueshëm:
— S'dihet si merr fund kjo punë. Shtypi ta jep dhe shtypi ta merr. Ka mundësi që nesër të të sulmojnë ty dhe bankën tënde.
Aleksi psherëtiu.
— Shumë shpesh ke të drejtë.
Por, kësaj here, ajo nuk kishte të drejtë.
Një version i përmbledhur i artikullit të Xhil Pikokut u shit dhe u përdor nga gazetat në dyzet qytete të tjera. Agjencia e lajmeve Essoshieted Pres, duke parë interesimin e gjerë dhe të përgjithshëm, e përhapi lajmin në tërë territorin kombëtar; po

kështu bëri dhe Junajted Pres Internejshnël. Gazeta «Uoll Strit Zhurmëll» dërgoi një reporter dhe, mbas disa ditëve, Fërst Merkentajll Ëmerikën Benku dhe Aleks Vandervurti dolën në faqen e parë të një reportazhi mbi automatizimin e operacioneve bankare. Një degë e NBC-së dërgoi një grup të televizionit për të marrë në intervistë Aleksin në njërin nga dyqanet e parave dhe shiriti video u transmetua nga rrjeti i NBC-së, gjatë lajmeve të mbrëmjes.

Pas çdo veprimi publicitar që bëhej, fushata e kursimit merrte hov të ri dhe punët shkonin më së miri në dyqanet e parave. Pa u nxituar, nga pozita e saj e lartë, gazeta «Nju Jork Tajms» po e mendonte mirë këtë çështje dhe merrte shënim. Pastaj, një të dielë, nga mesi i gushtit, në faqen kushtuar çështjeve ekonomike e financiare, botoi një intervistë me titull: NJË BANKIER RADIKAL PËR TË CILIN DO TË DËGJOJMË TË FLITET AKOMA.

Intervista e «Nju Jork Tajmsit» përbëhej nga një numër pyetjesh e përgjigjesh. Fillonte me automatizimin dhe, pastaj, shtrihej në një fushë më të gjerë.

Redaktori: Çfarë nuk funksionon veçanërisht mirë, në ditët tona, në sistemin bankar?

Vandervurti: Prej shumë kohësh, ne, bankierët, i bëjmë punët ashtu siç na intereson neve. Jemi aq të preokupuar për mirëqenien tonë, saqë shumë pak e vrasim mendjen për interesat e klientëve tanë.

Redaktori: Mund të jepni një shembull?

Vandervurti: Po. Klientët e bankave, veçanërisht individët, duhet të merrnin më shumë para, si interes, sesa marrin tani.

Redaktori: Në ç'mënyrë?

Vandervurti: Në shumë mënyra: nëpërmjet të depozitimeve të tyre dhe të kursimit dhe të depozitimeve të kushtëzuara; pastaj duhet paguar interes edhe për llogaritë rrjedhëse.

Redaktori: Le të fillojmë me depozitimet e kursimit. Sigurisht, ka një ligj federal që cakton një interes maksimal për depozitimet pranë bankave tregtare.
Vandervurti: Po, dhe qëllimi i tij është të mbrojë arkat e kursimit dhe të huasë. Meqë ra fjala, ka edhe një ligj tjetër që i ndalon arkat e kursimit e të huasë t'u lëshojnë çeqe klientëve të tyre dhe kjo është bërë për të mbrojtur bankat tregtare. Mirëpo, duhet që lidhjet të pushojnë së mbrojturi bankat dhe, në vend të tyre, të mbrojnë klientët.
Redaktori: Me fjalët «të mbrojnë klientët», doni të thoni që klientët të përfitojnë nga maksimumi i interesit dhe të gjitha shërbimet që mund të kryejnë bankat?
Vandervurti: Po, atë dua të them.
Redaktori: Përmendët depozitimet e kushtëzuara.
Vandervurti: Rezerva Federale ua ka ndaluar bankave të mëdha si për shembull bankës në të cilën unë punoj, që të zhvillojnë fushatë publicitare për depozitimet e kushtëzuara me afat të gjatë dhe me përqindje të lartë interesi. Ky lloj depozitimi i kushtëzuar është veçanërisht i dobishëm për ata që janë në prag të pensionit dhe duan të shtyjnë pagesën mbi të ardhurat e tyre për më vonë, në vitet kur këto të ardhura do të jenë më të vogla. Lidhur me këtë ndalim, Rezerva Federale paraqet arsye që nuk qëndrojnë, por arsyeja e vërtetë është të mbrojë bankat e vogla nga të mëdhatë, duke qenë se këto të fundit janë vetvetiu më të afta dhe me në gjendje për të ofruar kushte më të favorshme. Si zakonisht, ai që merret parasysh i fundit është publiku dhe ata që humbasin janë individët.
Redaktori: Le ta sqarojmë mirë këtë pikë. Ju thoni se banka jonë qendrore — Rezerva Federale — preokupohet më shumë për bankat e vogla se sa për publikun?
Vandervurti: Po, ashtu them, dhe s'e luan topi, sepse ashtu është.

Redaktori: Le të kalojmë te llogaritë rrjedhëse. Dihet që disa bankierë pohojnë se, nga ana e tyre, ata që do të paguanin interes për llogaritë rrjedhëse, por ua ndalon ligji federal.

Vandervurti: Herën e parë që të dëgjoni në të ardhmen ndonjë bankier t'ju thotë një gjë të tillë, e pyesni se kur ka ndodhur që miqtë tanë të fuqishëm në Uashington të kenë bërë ndonjëherë diçka për ta ndryshuar këtë ligj. Në rast se është bërë ndonjë përpjekje në këtë drejtim, unë s'kam dëgjuar asnjëherë të flitet për të.

Redaktori: Pra, ju supozoni se, në të vërtetë pjesa më e madhe e bankierëve nuk duan që ai ligj të ndryshohet?

Vandervurti: Unë nuk e supozoj, por e di që ashtu është. Ligji që ndalon pagimin e interesit mbi llogaritë rrjedhëse është shumë i leverdisshëm për atë që zotëron një bankë. Ai hyri në fuqi në vitin 1933, menjëherë pas depresionit të madh, me qëllim që të forcoheshin bankat, mbasi, në vitet e fundit para tij, shumë banka kishin falimentuar.

Redaktori: Por kjo ka ndodhur më se dyzet vjet më parë.

Vandervurti: Pikërisht ashtu. Ka shumë kohë që nevoja e këtij ligji nuk ndjehet më. Do t'ju them edhe diçka. Në qoftë se në këtë çast do të mblidhnim shumat e të gjitha llogarive rrjedhëse të vendit tonë, do të kishim një total prej më se dyqind miliardë dollarësh. Mund të jeni i sigurt se bankat e marrin interesin e këtyre parave, ndërsa depozituesit, klientët e bankave, nuk marrin asnjë sent.

Redaktori: Duke qenë se edhe vetë ju jeni bankier dhe se edhe banka juaj nxjerr përfitime nga ligji për të cilin po flasim, si shpjegohet që jeni në favor të një ndryshimi të tij?

Vandervurti: Pikë së pari, unë jam përkrahës i bindur i paanësisë. Së dyti, bankat kanë nevojë për të gjitha patericat e ligjeve mbrojtëse. Sipas mendimit tim, pa ato, ne do të mund të bënim një shërbim publik më të mirë dhe do të kishim fitime më të mëdha.

Redaktori: Nuk janë bërë rekomandime në Uashington për ndryshimet që folët?

Vandervurti: Po, raporti i Komisionit Hant, në 1971, dhe, si rezultat i tij, propozimi i një ligji që do të kishte qenë në përfitim të konsumatorëve. Mirëpo, propozimi u bllokua në Kongres nga interesat e veçanta të disa grupeve, duke përfshirë miqtë tanë të fuqishëm që përmenda më parë, gjë që pengoi ecjen përpara.

Redaktori: A prisni të mbahet një qëndrim armiqësor nga ana e bankierëve të tjerë, për shkak të sinqeritetit tuaj në këtë intervistë?

Vandervurti: Të them të drejtën, këtë gjë se s'kishi menduar.

Redaktori: Përveç sistemit bankar, a keni ndonjë mendim të përgjithshëm mbi gjendjen e sotme ekonomike?

Vandervurti: Po, por një mendim i përgjithshëm nuk duhet të kufizohet në ekonominë.

Redaktori: Atëherë, e thoni pikëpamjen tuaj, pa kufizime.

Vandervurti: Problemi ynë më i madh dhe e meta jonë më e madhe si komb është se, sot, pothuajse çdo gjë është e drejtuar kundër individit dhe në favor të institucioneve të mëdha: shoqëritë e mëdha, biznesi i madh, sindikatat e mëdha, bankat e mëdha, qeveritë e vendeve të mëdha. Kështu që individi, jo vetëm që gjen vështirësi për të përmirësuar standardin e tij të jetës dhe për ta ruajtur atë, por shpesh i duhet të përballojë edhe vetë problemin e të jetuarit. Dhe, kur ndodhin fenomene negative — inflacion, zhvlerësim, depresion, deficit ekonomik, rritje taksash, deri dhe luftë — nuk janë institucionet e mëdha që dëmtohen, ose, së paku, dëmtohen pak, por është individi që e pëson.

Redaktori: A shihni ndonjë paralele historike me këtë gjendje?

Vandervurti: Sigurisht. Mund të duket e çuditshme, por mendoj se më e afërta me ne është Franca, në prag të Revolucionit. Në atë kohë, me gjithë gjendjen e trubullt dhe një ekonomi të sëmurë të gjithë besonin se veprimtaria tregtare do të vazhdonte si zakonisht. Mirëpo, pleba — e përbërë nga individë që ishin rebeluar — përmbysi tiranët që e shtypnin. Unë nuk dua të them se kushtet tona tani janë krejtësisht të njëjta, por, në shumë pikëpamje, ne i afrohemi mjaft tiranisë ndaj individit. Dhe t'u thuash njerëzve që nuk munden të ushqejnë familjet e tyre, për shkak të inflacionit, «s'kemi pasur kurrë një periudhë më të mirë se kjo», është njësoj si t'u thuash «jepu të hanë ëmbëlsira». Prandaj, them që, në qoftë se duam ta shpëtojmë atë që e quajmë mënyrën tonë të jetesës dhe lirinë individuale, që ne deklarojmë se i vlerësojmë shumë, do të ishte më mirë të mendonim dhe të vepronim në interes të individit.

Redaktori: Dhe me rastin tuaj, ju do të filloni të veproni në mënyrë që bankat t'u shërbejnë më shumë interesave të individëve?
Vandervurti: Po.

— I dashur, kjo është e mrekullueshme! Jam krenare për ty dhe të dashuroj më shumë se kurrë, — e siguroi Margoti Aleksin, pasi lexoi bocat e intervistës, një ditë para botimit. — Kjo është gjëja më e ndershme që kam lexuar ndonjëherë. Por, bankierët e tjerë do të të urrejnë. Ata do të duan të të hanë të gjallë.
— Disa po, — tha Aleksi. — Të tjerë, jo.
Por, tani që i shihte të shtypura pyetjet dhe përgjigjet, e ndjente veten pak të shqetësuar, me gjithë valën e suksesit që po e ngrinte edhe më lart.

— Po të mos kish qenë fjala për gazetën «Nju Jork Tajms», do të të kishin kryqëzuar, — i tha Luis d'Orseji Aleksit. — Në qoftë se atë që the do t'ia kishe thënë cilësdo gazetë tjetër të vendit, këshilltarët e bankës sate do të të kishin mohuar dhe shpërrur si një njeri të ulët e të përbuzshëm. Por kjo s'bëhet

kur është fjala për gazetën Tajms. Ajo të ka veshur një petk respektueshmërie, megjithëse nuk jam në gjendje të të them se pse ndodh kështu.
— Luis, i dashur, — i tha Eduina d'Orseji, — a mund ta ndërpresësh fjalimin tënd për të na hedhur përsëri verë?
— S'po mbaj fjalim. — I shoqi u ngrit nga tryeza dhe mori një shishe tjetër vere Klos dë Vuzho '62. Atë mbrëmje, Luisi dukej më i dobët dhe i paushqyer se asnjëherë tjetër. Ai vazhdoi: — Unë po flas qartë për gazetën «Nju Jork Tajms», e cila, sipas mendimit tim, është një fletushkë që i ka kaluar koha, me pirje nga e majta, prestigji i pajustifikueshëm i së cilës është një nga provat e qarta të budallallëkut amerikan.
— Ajo e ka tirazhin më të madh se buletini yt, — vërejti Margot Brekëni. — Mos është kjo një arsye që s'të pëlqen?

Ajo dhe Aleks Vandervurti ishin mysafirë të Luisit dhe Eduinës në apartamentin elegant, që bashkëshortët kishin në Kullën Kajman. Në tryezë shndriste kristali dhe argjendi në dritën e ëmbël të qirinjve. Nga njëra faqe e sallës së madhe të ngrënies, nga një dritare e gjerë, shiheshin dritat që drithëronin në qytetin e largët. Në mes të dritave, një vijë e zezë gjarpëruese shënonte rrjedhën i lumit.
Kishte kaluar një javë që prej botimit të intervistës së dhënë nga Aleksi, e cila kishte ngjallur plot polemika.
Luisi nguli pirunin në copën e mishit të viçit dhe iu përgjigj me ton përbuzës pyetjes së Margotit:
— Buletini im financiar, që botohet dy herë në muaj, është simbol i cilësisë dhe intelektit të lartë, kurse shumica e gazetave të përditshme, duke përfshirë edhe Tajmsin, janë vulgare në të gjitha pikëpamjet.
— Pushoni së ngacmuari njëri-tjetrin, ju të dy! — Eduina u kthye nga Aleksi: — Kësaj jave, në degën e bankës, së paku nja dhjetë klientë më thanë se e kishin lexuar intervistën dhe se e admironin çiltërsinë tënde. Si u prit ajo në qendër?
— Me mendime të ndryshme.
— E vë me bast se e di njërin që ka qenë kundër. Fitove. —

Aleksi qeshi. — S'ka dyshim se Roskoi s'ishte në krye të atyre që më duartrokasin.

Kohët e fundit, qëndrimi i Heuordit ishte bërë akoma më i ftohtë se më parë. Aleksi dyshonte se Heuordi i mbante mëri, jo vetëm për popullaritetin që ai po gëzonte, por edhe për shkak të sukseseve që kishin pasur programi i kursimeve dhe i dyqaneve të parave, për të cilat Rosko Heuordi ishte shprehur kundër.
Një parashikim tjetër i Heuordit dhe i përkrahësve të tij në këshillin administrativ, që kishte dalë i gabuar, kishte të bënte me të tetëmbëdhjetë milionë dollarët, të depozituara nga institucionet e kursimit dhe të huave. Ndonëse drejtoritë përkatëse shfryen e turfulluan, ato nuk i tërhoqën depozitimet që kishin pranë Fërst Merkëntaill Emerikën Benkut. dhe, me sa dukej, as që kishin ndërmend ta bënin këtë.

— Me përjashtim të Roskoit dhe të disa të tjerëve, — tha Eduina, — kam dëgjuar se, tani, numri i pasuesve të tu midis personelit është rritur shumë.

— Ndoshta jam si një modë kalimtare, që del në dukje dhe pastaj, zhduket shpejt, siç ndodh me modën e fustaneve dhe të rrobave, në përgjithësi.

— Ose, përkundrazi, një modë e përhershme; — vërejti Margoti. — Kam vënë re se ti di t'i bësh njerëzit për vete.

Aleksi buzëqeshi. Gjatë javës së kaluar, kishte qenë diçka zemërdhënëse të dëgjoje përgëzime nga njerëz që ai i respektonte, (si Tom Stroani, Orvil Jangu, Dik Frençi, Eduina dhe shumë të tjerë), duke përfshirë edhe disa funksionarë të gradës së ulët, të cilëve s'u kishte ditur më parë as emrin. Shumë këshilltarë i kishin telefonuar, duke i thuruar lëvdata. «Po i sjell shumë dobi figurës publike të bankës, — i kishte thënë Leonard L. Kingsudi dhe, nganjëherë, kalimi i Aleksit nëpër korridoret dhe zyrat e Drejtorisë Qendrore kishte qenë thuajse triumfues, me nëpunësit dhe sekretarët që e përshëndetnin dhe i buzëqeshnin ngrohtësisht.

— Meqë ra fjala për personelin, Aleks, — tha Luis d'Orseji, — kjo më kujton se në Drejtorinë tuaj Qendrore keni diçka që ju mungon: Eduina. Ka ardhur koha që ajo të gradohet. Sa kohë që kjo nuk bëhet, jeni ju që humbisni.

— Si mund të flasësh kështu, Luis? — Edhe në dritën e qirinjve mund të shihej se sa shumë ishte skuqur Eduina. — Ky është një takim midis miqsh. Edhe sikur të mos ishte kështu, një vërejtje e tillë do të ishte pa vend. Aleks, të kërkoj ndjesë.

Luisi, i qetë, i hodhi së shoqes një vështrim mbi lentet e syzeve dhe tha:

— Ti mund të kërkosh ndjesë, e dashur, unë jo. Unë e di mirë zotësinë dhe vlerën tënde. Për më tepër, e kam zakon të tërheq vëmendjen e të tjerëve për gjithçka që shoh me vlerë.

— Shumë mirë, tri brohoritje për ty, Luis! — thirri Margoti. — Aleks c'thua për këtë? Kur do të kalojë kushurira ime e nderuar te gratacieli?

Eduina po fillonte të zemërohej.

— Pushoni, ju lutem! Po më vini në pozitë shumë të vështirë.

— Askush s'duhet ta ndiejë veten në pozitë të vështirë. — Aleksi piu një gllënjkë verë, duke e shijuar si një njeri që i njihte cilësitë e saj. — Oh... '62-shi ka qenë një vit i mbarë për verërat e Burgonjës. Po aq i mirë sa dhe viti '61. Si thoni, nuk është kështu?

— Ashtu është — pranoi i zoti i shtëpisë. — Për fat të mirë, kam siguruar një sasi të madhe nga prodhimi i të dy viteve.

— Këtu jemi midis miqsh, — vazhdoi Aleksi, — prandaj mund të flasim me zemër të hapur, duke e ditur se gjërat që bisedojmë mbeten ndërmjet nesh. S'kam pse të mos jua them se kam menduar për një gradim të Eduinës dhe se i kam vënë

syrin edhe postit ku mund të kalojë. Se kur mund ta bëjë këtë, si edhe disa ndryshime të tjera, kjo varet nga ato që do të ndodhin muajt e ardhshëm, gjë që edhe Eduina e di shumë mirë.

— Po, e di, — tha Eduina. Ajo e dinte gjithashtu se në bankë ishin në dijeni të besnikërisë së saj ndaj Aleksit. Që nga vdekja e Ben Roselit dhe, bile, edhe më parë, e kishte kuptuar se, emërimi i Aleksit si president i bankës, do të kishte hapur sigurisht rrugën edhe për karrierën e saj. Por, në qoftë se në vend të tij do të emërohej Rosko Hejuordi, kishte pak të ngjarë që ajo të ngjitej qoftë edhe një shkallë tjetër të vogël në FMA.

— Diçka tjetër që do të më pëlqente të shoh, — shtoi Aleksi, — është një vend për Eduinën në këshillin administrativ.

Margotit i ndriti fytyra.

— Ja, kësaj i thonë të flasësh si duhet! Kjo do të ishte një hap i mirë përpara në favor të Lëvizjes për Çlirimin e Grave.

— Jo! — ndërhyri Eduina në mënyrë energjike. — Mos më përzieni me Lëvizjen për Çlirimin e Grave! Çdo gjë që kam bërë, e kam bërë vetëm me forcat e mia, duke u përpjekur në një garë të ndershme me burrat. Me parullat e saj, që kërkojnë favorizime dhe preferenca, sepse jemi gra, Lëvizja për Çlirimin e Grave e ka çuar prapa, në vend që ta çojë përpara, barazinë e sekseve.

— Gjepura! — Fytyra e Margotit shprehte habi të madhe. — Tani mund të thuash kështu, sepse ke qenë me fat dhe je një nga gratë e zakonshme.

— S'është punë fati, — ia priti Eduina. — S'i jam trembur punës.

— Dhe, aspak fat?

— Eh, jo shumë.

Margoti nguli këmbë:

— Megjithatë duhet të kesh pasur edhe fat, sepse je grua. Puna në bankë ka qenë gjithmonë njëfarë monopoli i burrave, ndonëse pa asnjë arsye.

– Nuk mund të qenë përvoja një arsye? – pyeti Aleksi.

– Jo. Përvoja është një perde tymi, e ngritur nga burrat, për të përjashtuar gratë. Nuk ka asgjë mashkullore në punën e bankës. Ajo që kërkohet është të kesh mend, gjë që gratë i kanë, nganjëherë më shumë se burrat. Dhe gjithçka tjetër përmblidhet në punën me shkresurinat, në të menduarit e të folurit dhe, e vetmja punë fizike, është ngarkimi dhe shkarkimi i parave nga makinat e blinduara, gjë që, pa dyshim, roja të seksit femëror do të mund ta bënin gjithashtu.

– Nuk dua të hyj në debate për këtë, – tha Eduina, – vetëm se dua të bëj një vërejtje: ke mbetur pak mbrapa nga koha. Monopoli i burrave është thyer tanimë nga njerëz si unë dhe po minohet gjithnjë e më shumë. Kush ka nevojë për çlirimin e grave? Unë, sigurisht, jo!

– Edhe ti nuk e ke minuar dhe aq monopolin e burrave, – ia priti Margoti. – Përndryshe do të ishe tanimë në grataçiel dhe jo vetëm të flisje për të, siç po bëjmë sonte. Luis d'Orseji ia plasi gazit.

– Të zuri, e dashur!

– Në sektorin bankar ka të tjera që kanë shumë nevojë për çlirimin e grave, – përfundoi Margoti, – dhe do të kenë nevojë edhe për shumë kohë akoma.

Aleksi u mbështet prapa, në shpinoren e karriges. Si gjithmonë, atij i pëlqenin diskutimet, në të cilat merrte pjesë Margoti.

– Pavarësisht se ç'mund të thuhet për darkat tona, – vërejti ai, – një gjë është e sigurt: ato nuk janë kurrë të mërzitshme.

Luisi lëvizi kokën, në shenjë pohimi:

– Meqenëse unë qeshë që e hapa këtë bisedë, më lejo të të them se jam i kënaqur për qëllimet që ke lidhur me Eduinën.

– Shumë mirë, – tha e shoqja, me ton të vendosur. – Edhe unë të falënderoj, Aleks. Por, mjaft me kaq. Le të mos flasim më për këtë.

Dhe ashtu bënë.

Margoti u tregoi për një padi të ngritur kundër një magazine të madhe, e cila i mashtronte sistematikisht klientët, lidhur me çmimet. Shuma e shënuar në dëftesat mujore që u dërgoheshin klientëve ishte gjithnjë disa dollarë më e madhe nga sa duhej të ishte. Në qoftë se ndonjë klient ankohej, diferenca shpjegohej duke thënë se ishte bërë një gabim me makinën e shkrimit, por rrallë ndodhte që kjo t'i binte ndokujt në sy.

– Kur njerëzit shohin një shumë të shtypur me makinë, mendojnë se duhet të jetë në rregull. Ajo që ata harrojnë, ose nuk e dinë, është se makinat mund të rregullohen në mënyrë që të bëjnë gabime. Edhe në këtë rast, kështu u veprua. – Margoti shtoi se magazina kishte arkëtuar në mënyrë të paligjshme dhjetëra mijëra dollarë, siç kishte ndërmend ajo ta provonte në gjykatë.

– Ne, në bankë, nuk programojmë gabime, – tha Eduina, – por ato mund të bëhen, pavarësisht nëse përdoren makina apo jo. Ja sepse u rekomandoj gjithmonë njerëzve që t'i verifikojnë nxjerrjet e llogarisë që marrin nga banka.

Gjatë hetimeve të saj lidhur me magazinën, u tregoi Margoti të tjerëve, atë e kishte ndihmuar një detektiv privat, i quajtur Vernon Xheks. Ai ishte treguar i zellshëm dhe mendjemprehtë. Ajo nuk i kurseu lëvdatat për të.

– Kam dëgjuar për të, – tha Luis d'Orseji. – Ai ka bërë hetime për SEC-in, në një rast rast kur unë kisha denoncuar një çështje. Një njeri me të vërtetë i aftë.

Ndërsa po dilnin nga salla e ngrënies, Luisi i tha Aleksit:

– Si thua, shkojmë të pimë një puro dhe një konjak në studion time? Eduinës s'i pëlqen era e puros.

Pasi kërkuan ndjesë, të dy burrat zbritën në katin e mëposhtëm të banesës së d'Orsejve, e cila zinte dy kate. Mbasi u futën në sancta sanctorum të Luisit, Aleksi hodhi sytë rreth e përqark me kureshtje.

Salla ishte mjaft e gjerë. Dy faqet e saj ishin plot me rafte me libra, ndërsa raftet e faqes së tretë ishin me gazeta e revista. Si raftet e librave, ashtu edhe ato të gazetave e revistave ishin të mbushura plot e përplot. Kishte tri tryeza pune, mbi njërën nga të cilat ishte një makinë shkrimi elektrike dhe të tria ishin plot me libra, letra dhe dosje.

– Kur nuk ka më mundësi të vazhdohet puna në njërën tryezë, – shpjegoi Luisi, – kaloj te tjetra.

Nga një derë e hapur shihej një sallë tjetër, e cila gjatë kohës së punës duhet të shërbente si zyrë për sekretaren dhe ku mbahej edhe arkiva. Luisi hyri atje dhe, pas pak, u kthye me gota likeri dhe një shishe kurvazie.
— Shpesh i kam bërë vetes pyetjen, — tha Aleksi, — se ku qëndron sekreti i një buletini financiar që ka sukses.
— Mund të të flas vetëm për timin, të cilin ekspertët e mbajnë si më të mirin. — Luisi i dha Aleksit njërën nga gotat me konjak dhe i bëri me shenjë drejt një kutie të hapur me puro.
— Urdhëro, janë Makanudos. Më të mirat që ekzistojnë dhe të përjashtuara nga taksat.
— Si e ke rregulluar këtë punë?
Luisi qeshi.
— Hidhi një sy shiritit prej letre përqark çdo puroje. Duke

paguar diçka fare të vogël, i është hequr shiriti që kishte dhe, në vend të tij, është vënë një tjetër, i cili, siç e sheh, ka të shkruar: Buletini Financiar D'Orsej. Ky është publicitet, ose shpenzim për të siguruar të ardhura, kështu që, çdo herë që pi një puro, mendoj me kënaqësi se është në kurriz të Xha Semit[1]).

Pa bërë komente, Aleksi mori një puro dhe i mori erë me kënaqësi. Kishte shumë kohë që nuk gjykonte një njeri për manevrat që bëheshin për t'u shpëtuar taksave. Kongresi i kishte bërë të ligjshme dhe kush mund të kritikonte një qytetar se pse përfitonte prej tyre?

— Përsa i përket pyetjes sate, — tha Luisi, — buletini financiar D'Orsej nuk ka sekrete. — I ndezi puron Aleksit, pastaj ndezi dhe të tijën dhe e thithi me kënaqësi të madhe. — Qëllimi i tij është të ndihmojë elitën të bëhet më e pasur, ose, së paku, të ruajë atë që zotëron.

— Këtë e kam kuptuar.

Në çdo numër, siç e dinte edhe Aleksi, kishte plot këshilla mbi mënyrën se si duhej vepruar për t'u pasuruar gjithnjë e më shumë: shitje ose blerje titujsh, valuta për t'u blerë ose për t'u hequr qafe, mallra për t'u tregtuar. Bursa të huaja për t'u pasur parasysh ose mënjanuar, të çara të ligjit që të pasurit t'u shpëtonin taksave, operacione me anë të bankave sviceranе, situata politike që mund të kenë ndikim mbi paratë, gjendje financiare në prag të falimentimit, që, ata me njohuritë e duhura mund t'i shfrytëzojnë me përfitim. Lista ishte gjithnjë e gjatë; toni i buletinit, autoritar dhe i prerë, pa kuptime të dyfishta.

— Për fat të keq, — shtoi Luisi, — në sektorin e buletineve financiare ka plot sharlatanë dhe mashtrues që dëmtojnë botimet serioze e të ndershme. Disa nga të ashtuquajturat buletine financiare përmbajnë vetëm artikuj të nxjerrë nga

rubrikat mbi ekonominë që botojnë gazetat, kështu që s'kanë asnjë vlerë: të tjerë, marrin një përqindje nga agjencitë dhe nga vetë të interesuarit për të përhapur lajme burse, pavarësisht se, më në fund, mashtrimi del në shesh. Buletinet financiare, të denja për t'u quajtur kështu, nuk janë më shumë se pesë a gjashtë dhe, këtu hyjmë edhe ne.
«Më këdo tjetër, — mendoi Aleksi, — un-i i vazhdueshëm do të bëhej shumë i mërzitshëm»; mirëpo, me Luis d'Orsej-n nuk ndodhte kështu, ndoshta sepse mbështetej në një mori faktesh dhe argumentesh. Edhe përsa u përkiste ideve të tij politike të së djathtës ekstreme, Aleksi kishte vënë re se mund t'i filtronte, duke lënë të dilte jashtë vetëm një produkt distilimi i pastër financiar, sikurse çaji kur kalon nëpër kullesë.
— Më duket se ti je një nga abonentët e mi, — tha Luisi.
— Po, nëpërmjet bankës.
— Na, merre një kopje të numrit të ri. Mbaje edhe po qe se të vjen kopja e rregullt, me postën e së hënës.
— Faleminderit. — Aleksi e pranoi broshurën në ngjyrë blu të hapur, që binte pak në sy. Origjinali ishte shtypur në makinë, me radhë të ngushta dhe, pastaj, ishte fotografuar e shkurtuar dhe, më në fund, ishte shtypur në cianografi. Mirëpo, ajo që i mungonte buletinit nga ana estetike, kompensohej me këshillat e vlefshme financiare që përmbante. Luisi lëvdohej se, kushdo që i ndiqte këshillat e tij, mund ta shtonte, brenda vitit, me njëzet e pesë gjer në pesëdhjetë për qind kapitalin e tij, sado që të ishte ky i fundit dhe, në disa vjet, ta dyfishonte dhe, bile, ta trefishonte.
— Por, cili është sekreti yt? — pyeti Aleksi. — Si shpjegohet që ke kaq shpesh të drejtë?
— Truri im është si një kumpjuter duke ka tridhjetë vjet që e furnizoj me të dhëna. — Luisi thithi një herë puron dhe, pastaj, trokiti ballin e tij me gishtin tregues që ishte kockë e

lëkurë. — Këtu brenda është grumbulluar dhe ruhet edhe njohuria më e vogël financiare që kam mësuar gjatë gjithë kësaj kohe. Nga ana tjetër, unë di të lidh çdo të dhënë me të gjitha të tjerat dhe të ardhmen me të kaluarën. Veç kësaj, kam diçka që nuk e ka kompjuteri: gjenialitetin e lindur për çështjet financiare.
— Atëherë, pse i hyn këtyre telasheve me buletinin financiar. Pse të mos përpiqesh për t'u pasuruar vetë?
— Nuk do të gjeja kënaqësi në atë rrugë; do të ishte një fushë veprimi pa konkurrencë. — Luisi u ngërdhesh. — Pastaj, edhe kështu nuk po më shkon dhe aq keq.
— Në rast se më kujtohet mirë, kuota juaj e abonimit...
— Është prej treqind dollarësh në vit dhe dy mijë dollarësh në orë për konsultime personale.
— Shumë herë kam pyetur veten se sa abonentë mund të kesh ti.
— Ka edhe të tjerë që e bëjnë këtë pyetje. Kjo është një e fshehtë që e ruaj me kujdes.
— Më falni, nuk kisha ndërmend të fusja hundët në punët e tua.
— S'është nevoja të kërkosh ndjesë. Po të isha në vendin tënd, edhe unë do të isha kureshtar.
«Sonte, — mendoi Aleksi, — Luisi duket më shumë komunikues se kurdoherë tjetër.»
— Mund të të vë në dijeni të kësaj të fshehte, — tha Luisi. — Çdo njeriu ia ka ënda të levdohet pakëz. Kam më se pesë mijë abonentë të buletinit.
Aleksi bëri me mend një llogari të shpejtë dhe fishkëlleu lehtë. Kjo do të thoshte të ardhura vjetore prej më se një milion e gjysmë dollarësh.
— Veç kësaj, — vijoi Luisi, — botoj një libër në vit dhe bëj rreth njëzet konsultime në muaj. Honoraret e të drejtat e

autorit i mbulojnë të gjitha shpenzimet, kështu që të ardhurat nga buletini mbeten vetëm fitime.
— Kjo është e çuditshme! — tha Aleksi. Por ndoshta, — mendoi ai pastaj, — mund të mos ishte ashtu. Kush ndiqte këshillat e Luisit mund ta qindfishonte shumën e investuar. Nga ana tjetër, si të ardhurat e abonimeve, ashtu edhe honoraret e konsultimeve nuk ngarkoheshin me taksa.
— A ke ndonjë këshillë të përgjithshme për t'u dhënë njerëzve, që kanë një sasi parash për të investuar ose për të kursyer?
— Po, sigurisht! Të kujdesen vetë për ato.
— Ta zëmë se është fjala për një njeri që s'di gjë nga këto punë...
— Duhet të interesohet. Të mësosh nuk është punë dhe aq e vështirë dhe, të kujdesesh për paratë e tua, mund të jetë edhe kënaqësi. Pa dyshim, duhet të dëgjosh pak edhe këshilla, por me njëfarë dyshimi dhe në mënyrë të matur. Pas njëfarë kohe, njeriu e mëson se kush duhet të ketë besim dhe te kush jo. Duhet lexuar shumë, duke përfshirë buletine financiare si imi. Por nuk u duhet dhënë kurrë të tjerëve e drejta të marrin vendime në vendin tënd, veçanërisht agjentëve të këmbimit, që përfaqësojnë rrugën më të shpejtë për të humbur atë që ke, dhe seksioneve fiduciarë të bankave.
— Nuk keni besim te seksionet fiduciarë?
— Aspak, Aleks, edhe tie di shumë mirë se rezultatet e seksionit fiduciar të bankës sate dhe të bankave të tjera kanë qenë të tmerrshme. Për llogaritë e mëdha kujdesen, deri diku, persona të veçantë. Llogaritë e mesme dhe të vogla futen të gjitha në një thes, ose janë në mëshirën e disa nëpunësve të paaftë, të paguar keq, që nuk dinë të dallojnë mirë debitin nga krediti.
Aleksi u ngërdhesh, por nuk protestoi. E dinte shumë mirë se,

me përjashtime të vogla, ato që kishte thënë Luisi ishin të vërteta.
Të dy burrat mbetën për disa çaste në heshtje, duke pirë konjak në dhomën e mbushur me tym. Aleksi filloi të shfletonte numrin e fundit të buletinit, duke i hedhur një sy përmbajtjes së artikujve të ndryshëm, të cilët do t'i shihte me hollësi më vonë. Disa materiale, lidhur me gjendjen e tregut aksionar, ishin aq të mbushura me shkurtime enigmatike, saqë dukeshin të shkruara në shifër. Të tjera përmbanin këshilla të zakonshme, lidhur me investimet. Aleksi lexoi:
Përbërje e rekomanduar valutash:
Franka zvicerane : 40%
Gilda holandeze : 25%
Marka gjermane : 20%
Dollarë kanadezë : 10%
Shilinga austriake : 5%
Dollarë US : 0%

Luisi këshillonte gjithashtu që 40% e kapitalit të mbahej në shufra ari, monedha ari dhe aksione të minierave të arit. Pastaj vinte shtylla e zakonshme e titujve ndërkombëtarë, me udhëzimet përkatëse për secilin. Aleksi u hodhi një sy të shpejtë listave për t'u «blerë», për t'u «mbajtur» dhe për t'u shitur. Ai u ndal te shtylla për t'u «shitur» dhe, gati u hodh përpjetë, kur i zuri syri te «Suprënejshnëli» — «të shiten menjëherë me çmimin e tregut.»

— Luis, pse thua të shiten aksionet e Suprënejshnëlit? Dhe «menjëherë me çmimet e tregut»? Ka vite që ti i klasifikon: «për t'u mbajtur me afat të gjatë».

I zoti i shtëpisë u mendua një çast, para se të përgjigjej.

— Nuk jam shumë i qetë lidhur me SuNatKo-n. Kam marrë shumë informata negative nga burime që s'kanë lidhje

midis tyre. Ka pasur edhe disa lajme mbi humbje të mëdha, të cilat nuk janë shpallur. Po ashtu, ka pasur edhe lajme mbi qarkullime llogarish të parregullta ndërmjet degëve të saj. Gjithashtu edhe një lajm nga Uashingtoni, ndonëse i pakonfirmuar, sipas të cilit Xhorxhi i madh Kuortermrejn po manovron për të siguruar një subvencion qeveritar, si ai që iu dha shoqërisë Lokhid. Të gjitha këto mund të jenë, ose jo, shenja paralajmëruese për ngatërresa në të ardhmen. Sidoqoftë, për siguri, u kam sugjeruar klientëve të mi të largohen prej saj.

— Por, të gjitha ato që the mbështeten në fjalë që qarkullojnë dhe lajme të pakonfirmuara. Fjalë të tilla qarkullojnë për çdo firmë. Çfarë ka konkretisht?

— Asgjë. Këshilla ime për të «shitur» mbështetet vetëm në instinktin tim. Ka raste, kur unë veproj duke u mbështetur tek ai dhe ky, tani, është një rast i tillë.

Luis d'Orseji la në një tavllë duhani bishtin e puros dhe vuri në një tryezë gotën e tij të zbrazët.

— Kthehemi te zonjat?

— Mirë, — u përgjigj Aleksi, dhe e ndoqi, por mendjen e kishte akoma te Suprënejshnëli.

— S'do ta kisha besuar kurrë, — tha me ton të ashpër Nolan Uejnrajti, se do të kishte pasur guximin të vije këtu.

— As unë. — Zëri i Majlls Istinit tregonte se një ç'gjendje shpirtërore të tronditur ishte. — Mendova dje të vija, por pastaj e pashë se s'e bëja dot. Sot, u solla jashtë vërdallë për nja një gjysmë ore, para se të merrja guximin për të hyrë brenda.

— Ti mund ta quash guxim, kurse unë e quaj paturpësi. Tani që je këtu, çfarë do?

Të dy burrat ishin përballë njëri-tjetrit, në këmbë, në zyrën e Nolan Uejnrajtit. Ata përbënin një kontrast të madh: drejtori

i shërbimit të sigurimit, me paraqitje të hijshme, i zi, fytyrën me pamje të rreptë; ish i burgosuri Istin, i rrëgjuar, i zbehtë, i pasigurt, shumë i ndryshëm nga funksionari i gjallë dhe i përzemërt që punonte në FMA më pak se një vit më parë.

Zyra e Uejnrajtit, e krahasuar me zyrat e tjera të bankës, kishte një pamje pak a shumë spartane. Muret ishin lyer thjesht dhe mobiljet ishin prej metali bojë hiri, duke përfshirë edhe tryezën e punës së Uejnrajtit. Dyshemeja ishte e mbuluar me një qilim, por të hollë dhe të një lloji ekonomik. Banka nuk i kursente paratë dhe artin dekorativ në seksionet që sillnin fitime, por shërbimi i sigurimit nuk bënte pjesë në to.

— Atëherë, — përsëriti Uejnrajti. — Çfarë do?

— Erdha për të parë nëse mund të më ndihmoni.

— Përse të të ndihmoj?

Djaloshi ngurroi para se të përgjigjej dhe, pastaj, tha me zë akoma të dridhshëm:

— E di që ju ma hodhët me atë pohimin e parë, natën që u arrestova. Avokati im më tha se ishte një veprim i paligjshëm dhe se nuk do të kishte qenë e mundur të përdorej në gjykatë. Ju e dinit këtë, por më latë të besoja se ishte një pohim i rregullt, prandaj e nënshkrova pa ngurrim atë pohimin e dytë në FBI, pa dyshuar që të kishte ndonjë ndryshim...

Uejnrajti ia nguli sytë, duke i mbyllur përgjysmë qepallat, me dyshim.

— Para se të përgjigjem, dua të di diçka. A ke me vete ndonjë aparat incizimi?

— Jo.

— Pse të kem besim në fjalën tënde?

Majllsi mblodhi supet dhe, pastaj, i ngriti duart sipër kokës, në mënyrën e mësuar nga kontrollet policore dhe në burg.

Për një çast, u duk sikur Uejnrajti nuk do të pranonte ta kontrollonte, por, pastaj, e bëri këtë me gjeste të shpejta profesionale. Majllsi i uli përsëri krahët.

— Jam dhelpër e vjetër, unë. — tha Uejnrajti. — Çunakë si ti, kujtojnë se janë të zgjuar dhe se mund ta fusin tjetrin në thes dhe, pastaj, t'i ngrenë padi. Pra, në burg, ke mësuar dhe ligjet, eh?
— Jo. E vetmja gjë që mësova është ajo lidhur me pohimin.
— Shumë mirë. Ti e preke këtë çështje dhe unë do të të përgjigjem. Sigurisht se e dija që s'kishte vlerë ligjore. Sigurisht që ta hodha. Edhe diçka tjetër: në rrethana të njëjta, do ta bëja përsëri. Ti je fajtor, apo jo. Ishe duke çuar në burg Nunjezin. Prandaj ç'rëndësi kanë stërhollimet?
— Unë mendoja vetëm se...
— E di se çfarë mendoje ti. Ti mendoje të vije prapë këtu, të më gjeje nën rrahje shumë të forta të ndërgjegjes, kështu që, në një gjendje të tillë, të isha i gatshëm të pranoja çfarëdo plani që do të kishe ti, ose çfarëdo gjëje që do të doje ti. Mirëpo, unë e kam ndërgjegjen të qetë dhe nuk jam i gatshëm për gjëra të tilla.
Majlls Istini murmuriti:
— S'kishte asnjë lloj plani dhe më vjen keq që erdha.
— Por, atëherë, çfarë do?
Për disa çaste, ata mbetën në heshtje dhe dukej se po studionin njëri-tjetrin. Pastaj, Majllsi tha:
— Punë.
— Këtu? Duhet të jesh i marrë.
— Pse? Do të isha nëpunësi më i ndershëm që ka pasur ndonjëherë banka.
— Deri sa ndokush do të të shtynte të vidhje përsëri.
— S'do të ndodhë më kurrë! — Për një çast të shkurtër u duk përsëri forca e dikurshme e Majlls Istinit. — Është e mundur

që ju të mos... që askush të mos arrijë të kuptojë se kam mësuar diçka? Unë e kam parë se ç'të ndodh kur vjedh. Kam mësuar të mos e bëj më, kurrë më. Nuk besoni se tanimë nuk ka në botë asnjë tundim, të cilit të mos i rezistoj, vetëm për të mos rrezikuar që të futem përsëri në burg?
Uejnrajti ia priti me ton të vrazhdë:
— Ajo që unë besoj ose nuk besoj nuk ka asnjë rëndësi. Banka ka rregullat e veta dhe njëra prej tyre thotë që të mos merret më në punë një njeri që ka qenë i ndjekur penalisht. Edhe po të doja, s'do të mund ta ndryshoja.
— Por mund të provonit. Ka edhe këtu punë, për të cilat dosja penale nuk ka rëndësi dhe ku nuk ka mundësi të kryesh veprime të pandershme. Nuk mund të më jepet mua një punë e tillë?

— Jo. — Pastaj, pyeti me kureshtje: — Por, pse ke kaq dëshirë për t'u kthyer këtu?
— Sepse gjetiu nuk munda të gjej asnjë lloj pune, as edhe punën më të vogël, asgjë. Zëri iu mek. — Dhe sepse kam uri.
— Çfarë the se ke?
— Zoti Uejnrajt, që prej tri javësh që kam dalë nga burgu, jam në liri të mbikëqyrur. Ka më se një javë që më janë mbaruar paratë. U bënë tri ditë që s'kam vënë gjë në gojë. Tani e ndiej se jam në prag të dëshpërimit. — Zëri që kishte filluar t'i mekej, u pre krejt. — Të vija këtu... te ju... duke e marrë me mend se çdo të më thoshit... ishte e fundit...
Ndërsa dëgjonte, shprehja e fytyrës së Uejnrajtit u bë diçka më pak e ashpër. Ai bëri me shenjë nga një karrige dhe tha:
— Ulu!
Doli nga zyra, i dha sekretares së tij pesë dollarë dhe i tha: — Shko në bufe dhe bli dy senduiçe me rosto dhe një gjysmë litër qumësht.

Kur u kthye në zyrë, Majlls Istini ishte akoma i ulur aty ku i kishte thënë ai, me trupin të lëshuar dhe me një shprehje të shastisur.
— Nuk të ndihmoi ndopak gjyqtari yt mbikëqyrës?
Majllsi u përgjigj me ton të hidhur:
— Më tha se kishte në ngarkim njëqind e shtatëdhjetë e pesë veta; se duhej të takohej me secilin prej tyre një herë në muaj dhe ç'mund të bënte ai për një të vetëm? Punë s'ka. Të vetmet gjëra që bën janë paralajmërimet.
Uejnrajti e dinte nga përvoja se për çfarë paralajmërimesh ishte fjala: të mos shoqërohej me shkelës të tjerë të ligjit, që i kishte njohur në burg, të mos shkonte në strofkat e tyre. Të shkelje njërin apo tjetrin nga këto paralajmërime dhe të kapeshe në flagrancë, do të shkaktonte kthimin e menjëhershëm në burg. Mirëpo, në praktikë, këto rregulla ishin po aq të shkëputura nga realiteti sa edhe arkaike. Një i burgosur në liri të mbikëqyrur, pa mjete financiare, kishte tërë botën kundër tij dhe, shpeshherë, nuk i mbetej tjetër për të jetuar veçse të bashkohej me të tjerët që ishin si vetë ai. Kjo ishte edhe një nga arsyet se pse përqindja e të burgosurve që ktheheshin përsëri në burg ishte aq e lartë.
Uejnrajti pyeti:
— Është e vërtetë se ke kërkuar punë?
— S'lashë vend pa kërkuar dhe nuk bëja as naze.

Gjatë të tri javëve që kishte kërkuar, vetëm një herë kishte qenë gati të gjente punë, si ndihmës pjatalarës, në një restorant italian të kategorisë së tretë, që frekuentohej shumë. Vendi ishte i lirë dhe pronari, një burrë me një fytyrë si të rrahur me kamxhik, dukej se donte ta merrte në punë. Mirëpo, kur Majllsi i kishte treguar çështjen e burgut, siç e dinte se duhej ta bënte, kishte parë se si tjetri kishte hedhur sytë nga arkëtarja, aty pranë. Prapëseprapë, pronari i

restorantit kishte ngurruar, por e shoqja, një tip rreshteri, nga ata që drejtojnë stërvitjen e ushtarëve, me fustan, kishte thënë me ton të vendosur: «Jo! Nuk mund të bëjmë një gjë, që, më vonë, të dalë e rrezikshme.»

— Ju luta të dyve, por pa asnjë dobi.

Në vendet e tjera, gjendja e tij, si i burgosur në liri të mbikëqyrur, e kishte zhdukur edhe më shpejt çdo mundësi për të gjetur punë.

— Po të kisha mundësi të bëja diçka për ty, ndoshta do ta bëja. — Toni i Uejnrajtit ishte më i butë nga ç'kishte qenë në fillim të bisedës. — Por, nuk mundem. S'ka asgjë këtu. Më beso.

Majllsi tundi kokën, me pamje të zymtë.

— Po, e merrja me mend.

— Po tani, ku do të kërkosh?

Para se ai të kishte kohë të përgjigjej, hyri sekretarja dhe i dha Uejnrajtit një qese letre dhe kusurin e pesë dollarëve. Kur doli vajza, ai nxori nga qesja qumështin dhe senduiçet dhe i vuri në tryezë, ndërsa Istini u përcoll dhe lëpiu buzët.

— Mund të hash këtu, po deshe.

Majllsi u afrua me të shpejtë dhe i hoqi mbështjellësen senduiçit të parë, me lëvizje të shpejta. Duke parë se në ç'mënyrë hante, si i gëlltiste me shpejtësi copat e senduiçit njërën pas tjetrës, Uejnrajti nuk pati më dyshim se ishte me të vërtetë i uritur. Dhe, ndërsa po e vëzhgonte, në mendjen e tij filloi të formohej një mendim.

Në fund, Majllsi piu dhe gllënjkën e fundit të qumështit nga kupa prej kartoni dhe fshiu buzët. Asnjë thërmijë s'kishte mbetur nga të dy senduiçet.

— Nuk iu përgjigje pyetjes sime, — tha Uejnrajti. — Ku do të kërkosh, tani?

U pa se Istini ngurroi për një çast dhe, pastaj, murmuroi pa gjallëri:

— Nuk e di.

— Ndërsa unë mendoj se ti e di dhe se po gënjen për herë të parë, që kur ke hyrë këtu.

Majlls Istini mblodhi supet.

— Ç'rëndësi ka tanimë?

Pa iu përgjigjur pyetjes, Uejnrajti tha:

— Ja se si e mendoj unë se është puna: Gjer tani, ti ke ndenjur larg njerëzve që ke njohur në burg. Mirëpo, meqenëse këtu nuk sigurove gjë, ke vendosur të shkosh tek ata, edhe me rrezikun që të të shohin dhe ta humbasësh përsëri lirinë.

— Çfarë djall mundësie tjetër më mbetet? Dhe, pastaj, kur i di këto gjëra, pse më pyet?

— Pra, ke mundësi të vihesh në kontakt me ta.

— Po t'u përgjigjem po, — tha Istini me përbuzje, — e para gjë që do të bëni, pasi të jem larguar, është t'i telefononi gjykatësit të mbikëqyrjes.

— Jo. — Uejnrajti tundi kokën. — Çfarëdo që të vendosim, të premtoj se nuk do ta bëj këtë.

— Ç'doni të thoni me «çfarëdo që të vendosim»?

— Mund të dalë ndonjë punë për ty, me kusht që të jesh i gatshëm për të marrë parasysh disa rreziqe. Rreziqe të mëdha.

— Çfarë lloj rreziqesh?

— Le të mos flasim një herë për këtë. Po të jetë nevoja do të kthehemi prapë, më vonë. Më parë, më fol për njerëzit që ke njohur kur ishe brenda dhe për ata, me të cilët mund të biesh në kontakt tani. Duke e ndier mosbesimin e Istinit,

Uejnrajti shtoi: — Të jap fjalën se nuk do të përfitoj, pa pëlqimin tënd, nga çdo gjë që do të më thuash.

— Si ta di unë se nuk është fjala për një kurth, ashtu si ndodhi herën tjetër?

— Nuk mund ta dish. Duhet ta pranosh rrezikun, duke pasur besim tek unë. Ose të bësh kështu, ose do të dalësh nga kjo zyrë, për të mos u kthyer më.

Majllsi rrinte në heshtje, duke u menduar dhe duke njomur buzët, me të njëjtin gjest nervozizmi që kishte bërë më parë. Pastaj, papritur, pa asnjë shenjë të jashtme që të tregonte vendimin e tij, filloi të flasë.

Foli për takimin e parë që kishte pasur me të dërguarin e «Rrugicës Mafia», në burgun e Drumonburgut. Tregoi se mesazhi vinte nga fajdexhiu Igor Ominski dhe thoshte se ai, Istini, ishte «djalë i mirë», sepse nuk e kishte nxjerrë emrin e Ominskit dhe të organizuesit të basteve, në kohën e arrestimit të tij dhe më vonë. Në shenjë mirënjohjeje, interesi i huasë së dhënë Istinit nuk do të llogaritej për tërë kohën e qëndrimit të tij në burg. — Lajmëtari i «Rrugicës Mafia» tha se Ominski e kishte ndaluar orën gjatë kohës që unë isha brenda.
— Por, tani, je jashtë, — theksoi Uejnrajti, kështu që ora po ecën përsëri.
Majllsi u duk i preokupuar.
— Po, e di. — Ai e dinte dhe ishte munduar të mos e mendonte gjatë kohës që kërkonte punë. Veç kësaj, kishte ndenjur larg vendit ku i kishin thënë se mund të vihej në kontakt me fajdexhiun Ominskin dhe të tjerët. Ky vend ishte Palestra Shtatë-Shtatë, afër qendrës së qytetit, dhe ky njoftim i ishte bërë pak ditë para se të dilte nga burgu. Ai ia tregoi tani Uejnrajtit.
— E qartë, — tha drejtori i shërbimit të sigurimit të bankës.
— Nuk e njoh Palestrën Shtatë-Shtatë, por kam dëgjuar të

flitet për të. I ka dalë nami se frekuentohet nga njerëz të ligj. Një gjë tjetër që i kishin thënë Majllsit në Drumonburg ishte se, nëpërmes kontakteve që do të bënte, do të gjendeshin mënyra të ndryshme që ai të fitonte para për të jetuar dhe për të filluar shlyerjen e borxhit. Majllsi s'kishte pasur nevojë për sqarime më të hollësishme për të kuptuar se, pa dyshim, ato mënyra nuk ishin të ligjshme. Kjo bindje dhe frika se mos e kthenin përsëri në burg, e kishin mbajtur gjer në atë kohë larg nga Palestra Shtatë-Shtatë.

— Pra, kisha të drejtë. Me t'u larguar prej këtu, do të vrapoje tek ata.

— Oh, zot! Zoti Uejnrajt, nuk doja të shkoja atje! Dhe, as tani nuk dua!

— Dëgjo, në qoftë se merremi vesh, ti do të kesh mundësinë t'i zgjidhësh të dyja problemet e tua.

— Si? Në ç'mënyrë?

— A ke dëgjuar ndonjëherë të flitet për agjentë të fshehtë?

I habitur, Majlls Istini u përgjigj:

— Po.

— Atëherë, dëgjo mirë.

Uejnrajti filloi të shpjegojë.

Para katër muajsh, kur drejtori i shërbimit të sigurimit të bankës kishte parë trupin e mbytur dhe të sakatuar të informatorit të tij — Vikut — ai kishte vendosur të mos angazhonte më agjentë të fshehtë. Por, rasti që i paraqitej tani — dëshpërimi i Istinit dhe kontaktet krejt të gatshme — ishte tepër premtues dhe nuk kishte si të mos e përfillte.

Nga ana tjetër, numri i letërkreditive tregtare të falsifikuara po merrte përpjesëtime të mëdha, ndërsa burimi i tyre mbetej i panjohur. Metodat e zakonshme për zbulimin e prodhuesve dhe shpërndarësve të tyre kishin dështuar dhe kërkimet e hetimet pengoheshin nga fakti se ligjet federale nuk e quanin

si krim falsifikimin e letërkreditive. Veprimi mashtrues për të nxjerrë fitime të paligjshme duhej provuar; qëllimi për të bërë një gjë të tillë nuk ishte i mjaftueshëm. Për këto arsye, organet e rendit interesoheshin më shumë për format e tjera të falsifikimit, kështu që interesimi i tyre për çështjen e letërkreditive ishte vetëm i rastit. Nga ana e tyre, bankat s'kishin bërë përpjekje serioze për ta ndryshuar këtë gjendje, gjë që shkaktonte keqardhjen e profesionistëve, si të Nolan Uejnrajtit.

Drejtori i shërbimit të sigurimit të bankës ia shpjegoi të gjitha këto Majlls Istinit dhe, pastaj, i ilustroi një plan kryesisht të thjeshtë. Majllsi do të shkonte te Palestra Shtatë-Shtatë dhe, atje, do të njihej me sa më shumë njerëz që të kishte mundësi; do të përpiqej të siguronte simpatinë e tyre dhe do të pranonte çdo rast që do të paraqitej për të fituar para.

— Kjo punë ka dy rreziqe, — tha Uejnrajti, — këtë duhet ta kesh të qartë. Po qe se kryen ndonjë veprim në kundërshtim me ligjin, do të arrestohesh dhe procedohesh dhe askush nuk do të ketë mundësi të të ndihmojë. Rreziku tjetër është që të të fusin prapë në burg, edhe pa bërë gjë, mjaft që gjykatësi mbikëqyrës të mësojë se je përzier me ata njerëz.

Sidoqoftë, vazhdoi Uejnrajti, në qoftë se nuk ndodhte asnjëri nga këto dy raste, Majllsi duhet të përpiqej ta zgjeronte rrethin e personave që do të njihte, duke i bërë veshët katër dhe duke grumbulluar fakte. Në fillim, duhej të ishte i kujdesshëm dhe të mos tregohej shumë kureshtar.

— Vepro me qetësi dhe me hapa të matur, — i tha Uejnrajti.

— Mos u nxito, ki durim. Leri të tjerët të vijnë te ti.

Vetëm pasi të kishte fituar besimin e tyre, ai mund të fillonte të punonte më me ngulm dhe të mësonte më tepër. Atëherë, me shumë kujdes, ai do të mund të hetonte lidhur me

letërkreditet e falsifikuara, duke treguar për to interesim personal dhe duke kërkuar të arrijë te burimi.

— Në këto raste, ka gjithnjë një njeri, — shpjegoi Uejnrajti, — që njeh një tjetër, i cili, nga ana e tij, njeh një të tretë, që është i ngarkuar me një detyrë të vogël. Ja se në ç'mënyrë mund të arrihet te burimi.
Kohë më kohë, shtoi Uejnrajti, Istini do t'i raportonte mbi gjithçka, por jo drejtpërdrejt.
Çështja e të raportuarit, i solli ndërmend Uejnrajtit se e kishte për detyrë t'i tregonte Majllsit për vdekjen e Vikut. Ai e bëri këtë, duke ia treguar të gjitha hollësitë. Ndërsa fliste, vuri re se si Istini po zbehej dhe iu kujtua ajo natë tek apartamenti i Istinit, kur ky kishte shfaqur aq qartë frikën instinktive që kishte ndaj dhunës fizike.
— Çfarëdo që të ndodhë, — tha Uejnrajti, me ton të prerë, — nuk dua që, më vonë, të thuash apo të mendosh se nuk të kam paralajmëruar për rreziqet. — U ndal pak dhe, pastaj, shtoi: — Dhe tani, le të flasim për paratë.
Në qoftë se Majllsi pranonte të punonte si informator i fshehtë për llogari të bankës, deklaroi drejtori i shërbimit të sigurimit, ai i garantonte një pagë prej pesëqind dollarësh në muaj, deri sa, në një mënyrë a një tjetër, të mbaronte bashkëpunimi. Paratë do të paguheshin me anë të një ndërmjetësi.
— A do të merrem më punë në bankë?
— Në asnjë mënyrë.
Përgjigjia ishte e qartë, energjike, përfundimtare, Uejnrajti i shpjegoi Majllsit se, zyrtarisht, banka nuk duhej të ishte fare e pleksur në këtë çështje. Në rast se ai, Majlls Istini, e pranonte këtë detyrë, kjo ishte puna e tij dhe varej vetëm prej tij. Në qoftë se do t'i dilnin ngatërresa dhe do të mundohej të përziente Fërst Merkëntajll Emerikën Benkun në to, kjo e fundit do ta mohonte dhe do të deklaronte se gënjente. — Sapo mbaroi procesi yt dhe u burgose, — deklaroi Uejnrajti, — as që kemi dëgjuar të flitet më për ty.
Majllsi bëri një ngërdheshje.

— E kuptoj, por kjo është e njëanshme.
— Tamam, ashtu është! Mirëpo, mos harro një gjë: Ti erdhe tek unë dhe jo unë te ti. Prandaj, si është përgjigjja? Po apo jo?
— Po të ishit në vendin tim, ç'përgjigje do të jepnit?
— Unë nuk jam në vendin tënd dhe as që ka të ngjarë që të jem ndonjëherë. Por do të të them se si e shoh unë këtë gjë. Kështu si janë punët, s'të mbetet shumë për të zgjedhur.

Për një çast, humori i dikurshëm dhe natyra e gëzueshme e Majlls Istinit dolën në dukje përsëri.
— Si duket s'kam hiç fat: kokë, humbas; pilë, humbas. A mund t'ju bëj një pyetje?
— Çfarë?
— Po qe se çdo gjë shkon mirë, në qoftë se shtie në dorë ... në qoftë se ju shtini në dorë provat që duhen, a do të më ndihmoni pastaj të gjej një punë këtu, në bankë?
— Këtë nuk mund të ta premtoj. Ta thashë një herë se rregullat si kam bërë unë.
— Por ju keni mjaft ndikim, sa t'i ndryshoni.
Uejnrajti u mendua, para se të përgjigjej. Ai tha me vete: në rast se çdo gjë do të përfundonte mirë, ai do të shkonte tek Aleks Vandervurti dhe do të fliste me të në të mirë të Istinit. Suksesi i kësaj pune meritonte që të bëhej një orvatje e tillë. Tha me zë të lartë:
— Do të përpiqem, por s'të premtoj asgjë më shumë se kaq.
— Jeni njeri i ashpër, — tha Majlls Istini. — Në rregull, do ta bëj.
Kaluan në problemin e ndërmjetësit.
— Këtej e tutje, — tha Uejnrajti, — ne të dy s'mund të kemi më kontakte të drejtpërdrejta. Kjo është shumë e rrezikshme. Njëri nga ne mund të jetë nën vëzhgim dhe të ndiqet. Kemi nevojë për një njeri që të jetë në gjendje të dorëzojë mesazhet, në të dy drejtimet, si edhe paratë; dikush që të ketë besimin e plotë të ne të dyve.
Majllsi tha me ngadalë:
— E tillë do të ishte Huanita Nunjezi. Sigurisht, në rast se pranon.

Uejnrajti vështroi me mosbesim.
— Arkëtarja që ti ...
— Po. Por ajo më fali. — Në zërin e tij ndjehej një tingull i përzier ngazëllimi dhe emocioni. — Shkova në shtëpinë e saj dhe, përëndia e bekoftë, më fali!
— Si është e mundur?
— Pyeteni, — tha Majlls Istini. — S'ka asnjë arsye që ajo të pranojë, por unë mendoj ... mendoj se mund të pranojë.

A kishte qenë i drejtë supozimi i Luis d'Orsejit për Suprënejshnëlin? Sa e fortë dhe e qëndrueshme ishte gjendja e saj? Ky mendim vazhdonte ta mundonte Aleks Vander-vurtin.

Biseda e Aleksit me Luisin për SuNatKo-n ishte bërë të shtunën mbrëma dhe, gjatë tërë pjesës tjetër të pushimeve të fundit të javës, Aleksi kishte menduar për rekomandimin e buletinit financiar «D'Orsej» që të shiteshin aksionet e SuNatKo-s me çmimet e tregut dhe për dyshimet e Luisit mbi gjendjen e shumëkombëshes vigane. Kjo ishte për bankën një çështje shumë e rëndësishme, bile jetike. Megjithatë, Aleksi e kuptonte se gjendja ishte delikate dhe se ai duhej të vepronte me shumë kujdes.

Pikë së pari, Suprënejshnëli ishte tani një klient shumë i rëndësishëm dhe çdo klient ka të drejtë të indinjohet, në qoftë se në bankën me të cilën ai ka lidhje, qarkullojnë fjalë në disfavor të tij, sidomos kur ato janë të rreme. Dhe Aleksi e kishte të qartë, se, sapo të fillonte të bënte pyetje andej-këtej, lajmi për to, si edhe për burimin e tyre, do të përhapej me shpejtësi.

Mirëpo, a ishin të rreme fjalët që thuheshin për Suprënejshnëlin? Sigurisht — siç e kishte pranuar Luis d'Orseji — ato nuk ishin konfirmuar. Por, të tilla kishin qenë edhe fjalët që ishin përhapur në fillim për falimentime të mëdha e të bujshme për Pen Sentrlin, Ekuëti Fandingun, Frenklin Nejshnël Benkun, Sekjuriti Nejshnël Benkun, Sekjuriti Nejshnël Benkun, Amerikën Benk & Trastin, US Nejshnël Benk ov San Diegon, e të tjera. Ishte edhe Lokhidi,

që nuk kishte falimentuar, por kishte shpëtuar në çastin e fundit, në sajë të një ndërhyrjeje qeveritare. Aleksit iu kujtuan, me një rrëqethje shqetësimi, fjalët e Luis d'Orsejit, që tha se presidenti i SuNatKo-s, Kuortermeyni, po përpiqej të siguronte në Uashington një hua, si ajo që i ishte dhënë Lokhidit; vetëm se Luisi kishte folur për «subvencion», gjë që i përshtatej më shumë realitetit.

Natyrisht, kishte mundësi që Suprënejshnëli të kishte vetëm një mungesë të përkohshme të hollash, gjë që u ndodh nganjëherë edhe shoqërive më të fuqishme. Aleksi shpresonte që kjo — ose dhe diçka edhe më pak serioze... të ishte e vërtetë. Sidoqoftë, duke qenë se ishte një funksionar i lartë i FMA-së, sigurisht që ai nuk mund të rrinte duarkryq, duke shpresuar. Pesëdhjetë milionë dollarë të bankës kishin përfunduar në arkat e SuNatKo-s. Veç kësaj, duke përdorur fonde që banka e kishte për detyrë që t'i ruante, seksioni fiduciar kishte investuar shuma të mëdha në aksionet e Suprënejshnëlit, gjë që i shkaktonte rrëqethje Aleksit, sa herë që e mendonte.

Vendosi që, për korrektësi, të informonte së pari Rosko Hejuordin.

Të hënën, në mëngjes, doli nga zyra e tij dhe përshkoi korridorin e shtruar me moketë të katit të tridhjetë e gjashtë për te zyra e Hejuordit. Kishte marrë me vete numrin e fundit të buletinit financiar «D'Orsej», që i kishte dhënë Luisi të shtunën mbrëma.

Hejuordi s'kishte ardhur akoma. Aleksi hyri në zyrën e tij, duke i bërë një përshëndetje miqësore me kokë sekretares së vjetër, zonjës Kellëgen, dhe e vuri buletinin në tryezën e punës të Hejuordit. E kishte futur në rreth të kuq këshillën e Luisit lidhur me SuNatKo-n dhe i bashkëngjiti, me një kapëse aktesh, një pusullë, ku kishte shkruar:

Rosko,
Mendova se do të ishte mirë t'i hidhje një sy.
A.

Pastaj, Aleksi u kthye në zyrën e vet.

Pas një gjysmë ore, Hejuordi u fut me vrull në zyrën e tij, me fytyrën flakë të kuqe.

— Ti e ke vënë në tryezën time të punës këtë fyerje të neveritshme të inteligjencës?

Aleksi bëri me shenjë nga pusulla e tij që i ishte bashkëngjitur buletinit.

— Duket se po.

— Atëherë, — ia priti Hejuordi, — ki mirësinë të mos më dërgosh më marrëzira të tjera, të shkruara nga ai injorant mendjemadh!

— Shiko, Rosko! S'ka dyshim që Luis d'Orseji është mendjemadh dhe mua nuk më pëlqen një pjesë e gjërave që ai shkruan, ashtu sikurse është e qartë se nuk të pëlqejnë edhe ty, por ai nuk është injorant dhe ia vlen që disa nga pikëpamjet e tij të dëgjohen.

— Ti mund ta mendosh ashtu, por të tjerët jo. Të sugjeroj të lexosh këtë. – Hejuordi hodhi mbi buletinin një revistë të hapur.
Aleksi i hodhi sytë, i çuditshur nga furia e tjetrit.
– E kam lexuar.
Ishte revista «Forbes» dhe artikulli në fjalë, prej dy faqesh, përmbante një sulm shumë të ashpër kundër Luis d'Orsejit. Artikulli i ishte dukur Aleksit i gjatë në akuza dhe i varfër në fakte. Por, në vetvete, artikulli tregonte diçka që Aleksi e dinte tanimë: sulmet kundër Buletinit Financiar «D'Orsej» ishin të shpeshta nga ana e shtypit të specializuar zyrtar.
Aleksi vërejti:

– Gazeta «Uoll Strit Zhurnëll» kishte diçka të ngjashme para një viti.
– Atëherë çuditem se si ti nuk e pranon faktin se D'Orseji nuk ka aspak praktikën dhe as kualifikimin e duhur për të qenë konsulent financiar. Në njëfarë mënyre, më vjen keq që e shoqja punon te ne.
Aleksi ia priti, me ton të prerë:
– Eduina dhe Luis d'Orseji e kanë zakon të mos i përziejnë aspak punët e tyre përkatëse dhe, jam i sigurt, se këtë e di edhe ti. Përsa i përket kualifikimit, po të përmend se plot ekspertë, të mbushur me diploma dhe tituj, s'kanë nxjerrë gjë në krye lidhur me parashikimet financiare, ndërsa, shumë shpesh, Luis d'Orseji e ka bërë këtë.
– Jo përsa i përket Suprënejshnëlit.
– Je gjithnjë i bindur se SuNatKo-ja është në gjendje të mirë?
Aleksi e bëri pyetjen e fundit, me ton të qetë, pa u nisur nga qëndrimi antagonist, por vetëm për të ditur mendimin e tij. Mirëpo, efekti që ai pati mbi Hejuordin qe gati ai i një shpërthimi. Sytë e tij lëshuan shkëndija nëpërmes qelqeve pa skelet dhe fytyra iu skuq edhe më shumë.
– Jam i sigurt se asgjë nuk do të të kënaqte më shumë se sa një dështim i SuNatKo-s dhe, si rrjedhim, imi.
– Jo, kjo nuk...
– Lërmë të mbaroj! – Muskujt e fytyrës së Hejuordit u kontraktuan, ndërsa po i shpërtente zemërimi. – Kam parë shumë nga manevrat e tua të ulëta, që synonin të përhapnin dyshim, siç është edhe shpërndarja e kësaj paçavureje. – Ai bëri me shenjë nga buletini «D'Orsej». – Dhe, tani, po të them të pushosh dhe të heqësh dorë nga këto. Suprënejshnëli ka qenë dhe është një shoqëri solide dhe në forcim e ngritje të vazhdueshme, me fitime të mëdha dhe e drejtuar nga njerëz të aftë. Llogarinë e SuNatKo-s në bankë e sigurova unë,

pavarësisht se ti mund të kesh zili për këtë; pra, kjo është puna ime. Tani, po të paralajmëroj: mos u përziej në këtë punë!
Hejuordi u kthye dhe doli jashtë.
Aleks Vandervurti mbeti disa minuta duke u menduar për atë që kishte ndodhur. Shpërthimi i zemërimit të Rosko Hejuordit e kishte habitur. Gjatë atyre dy vjetëve e gjysmë që njiheshin dhe punonin së bashku, kishte pasur raste të ndryshme, kur s'kishin qenë të një mendjeje dhe, nganjëherë, kishin shfaqur edhe antipati reciproke, por Hejuordi s'e kishte humbur kurrë kontrollin e vetvetes, siç kishte ndodhur atë mëngjes.
Aleksi tha se e merrte me mend arsyen. Nën zhurmën e sipërfaqshme, Rosko Hejuordi duhet të ishte i merakosur. Sa më shumë që Aleksi mendonte për këtë, aq më shumë e ndjente veten të bindur.
Më parë, Aleksi kishte qenë i shqetësuar për Suprënejshnëlin. Tani dilte pyetja: a ishte i shqetësuar për SuNatKo-n gjithashtu edhe Hejuordi? Në qoftë se puna qëndronte kështu, ç'duhej bërë?
Ndërsa po mendohej, kujtesa e tij solli një copë të një bisede, të bërë pak kohë më parë. Ai shtypi një buton të telefonit të brendshëm dhe i tha sekretares:
– Shiko se mos lidhesh me zonjushe Brekënin.
U deshën pesëmbëdhjetë minuta, para se zëri i Margotit të dëgjohej duke thënë:
– Shpresoj se ke arsye të fortë që më thirre. M'u desh të dilja nga salla e gjyqit.
– Ki besim tek unë, Margot. – Ai nuk humbi kohë. – Të shtunën mbrëma, me sa kohët e fundit kishe përdorur një gjurmues privat lidhur me çështjen e asaj magazinës së madhe...
– Po, Vernon Xheksin.

– Mendoj se edhe Luisi e njeh, ose ka dëgjuar të flitet për të.
– Ashtu është.
– Dhe Luisi tha se ishte një njeri i aftë, që kishte punuar për llogari të entit të kontrollit të tregut aksionar.
– Po, edhe këtë e dëgjova. Ka të ngjarë që arsyeja të jetë sepse Vernoni është i diplomuar në shkenca ekonomike.

Aleksi ua shtoi këtë informatë të tjerave.
— A është ai njeri, fjalë pak dhe i besueshëm?
— Plotësisht.
— Ku mund ta gjej?
— E gjej unë. Më thuaj ku e do dhe kur?
— Në zyrën time, Margot. Që sot ... patjetër.

Aleksi e vëzhgoi burrin me paraqitje të shkujdesur, deri diku tullac, që s'binte fare në sy, të ulur përballë tij, në pjesën e zyrës të rezervuar për bisedat. Kishte kaluar gjysma e pasdites.
Aleksi mendoi se Xheksi duhej të ishte rreth të pesëdhjetave. Ai të bënte përshtypjen e një bakalli të një qyteti të vogël dhe me gjendje ekonomike jo shumë të mirë. Këpucët i kishte të shtrembëruara dhe në xhaketë kishte një njollë lyre. Aleksi ishte informuar se Xheksi, para se të punonte për llogari të vet, kishte qenë inspektor finance.
— Më kanë thënë, gjithashtu, se jeni i diplomuar në shkenca ekonomike.
Tjetri mblodhi supet, me një gjest përçmues.
— Shkollë nate. E dini si është. Koha në dispozicionin tuaj ...
— Zëri iu pre, duke e lënë pezull dhe të paplotësuar shpjegimin.
— Po nga kontabiliteti kuptoni? A keni shumë njohuri në këtë fushë?
— Mjaft. Tani po përgatis provimet për llogaritar.
— Shkollë nate, mendoj. — Aleksi po fillonte ta kuptonte se çfarë tipi ishte Vernon Xheksi.
— Ashtu. — Një buzëqeshje që mezi mund të dallohej.
— Zoti Xheksi, — filloi Aleksi.

— Zakonisht më thërrasin vetëm Vernon.
— Vernon, kam ndërmend t'ju besoj një hetim. Kjo punë kërkon një qëndrim shumë të përmbajtshur dhe sidomos ka rëndësi që të kryhet me shpejtësinë më të madhe. A keni dëgjuar për Supreneishnël Korporejshënin?
— Sigurisht.
— Dua të bëhet një hetim mbi gjendjen financiare të kësaj shoqërie. Por do të jetë e nevojshme që të jetë ..., kam frikë se s'ka një shprehje tjetër për këtë ..., një punë spiunazhi nga jashtë.
Xheksi buzëqeshi përsëri.

— Zoti Vandervurt, ky është pikërisht lloji i punës që bëj unë. — Kësaj radhe kishte folur me ton më të gjallë.
Ata u morën vesh se, për këtë punë, duhej një muaj, me ndonjë raport që do të mund t'i dërgohej herë pas here Aleksit, në rast se do të shihej e nevojshme. Do të mbahej fshehësi e plotë lidhur me rolin hetues të bankës. Nuk do të bëhej asgjë e paligjshme. Shpërblimi do të ishte prej pesëmbëdhjetë mijë dollarësh, përveç shpenzimeve të arsyeshme. Gjysma e shumës do të paguhej menjëherë dhe pjesa tjetër mbas dorëzimit të raportit përfundimtar. Aleksi do ta rregullonte që shuma të nxirrej nga fondi i posaçëm i FMA-së. Ai e dinte se, ndoshta, në të ardhmen do t'i duhej ta përligjte këtë shpenzim; por, pastaj, tha me vete se do të shqetësohej për këtë gjë, kur t'i vinte koha.
Më vonë, kur Xheksi ishte larguar, i telefoni Margoti.
— E angazhove?
— Po.
— A të bëri përshtypje të mirë?
Aleksi deshi të ishte i sinqertë.
— Në të vërtetë, jo.
Margoti qeshi me ngadalë.
— Do të të bëjë. Prit e do ta shohësh.
Por, Aleksi shpresonte që kjo të mos ndodhte. Ai shpresonte me gjithë zemër që nuhatja e Luis d'Orsejit të ishte gabuar, që

Vernon Xheksi të mos zbulonte gjë, që fjalët që thuheshin për Supreneishnëlin të ishin vetëm fjalë dhe asgjë më shumë.

Atë mbrëmje, Aleksi shkoi për të parë Silian në Qendrën Klinike, siç bënte herë pas here. Ai kishte filluar t'u trembej gjithnjë e më shumë këtyre vizitave; çdo herë, mbas tyre, largohej me një depresion të thellë, por vazhdonte t'i bënte, i shtyrë nga një ndjenjë detyre. Apo, fajit? Këtë nuk e dinte mirë.
Si zakonisht, një infermiere e shoqëroi te dhoma e veçantë e Silias. Kur u largua infermierja, ai nisi të bisedonte për çdo gjë që i shkonte në mendje, por, më shumë se një bisedë, ky ishte një monolog i kotë, mbasi Silia nuk jepte asnjë shenjë se po e dëgjonte dhe, bile, se ishte e ndërgjegjshme për praninë e tij. Një herë, gjatë një vizite të mëparshme, ai kishte thënë me qëllim fjalë pa lidhje dhe pa kuptim, për të parë nëse do të ndryshonte shprehja e zbrazët e fytyrës së saj. Asgjë s'kishte ndryshuar. Më vonë, ai e kishte ndier veten të turpëruar dhe s'kishte përsëritur më këtë gjë.

Megjithatë, gjatë këtyre vizitave, i ishte bërë zakon të fliste si t'i vinte, pothuajse pa ua vënë veshin as ai vetë gjërave që thoshte, ndërsa mendja i shkonte gjetiu. Atë mbrëmje, ndër të tjera, ai kishte thënë: «Në ditët tona, Silia, njerëzit kanë lloj-lloj problemesh; probleme për të cilat askush s'mendonte deri pak vjet më parë. Çdo gjë e dobishme, që shpiket ose zbulohet nga njerëzimi, sjell me vete dhjetëra pyetje ose vendime, me të cilat, më parë, s'ka qenë e nevojshme të ndesheshim. Le të marrim, për shembull, hapësen elektrike të kutiave të konservave. Kur e ke një të tillë (dhe unë e kam një në apartamentin tim), del problemi i prizës së murit; kur ta përdorësh, si ta pastrosh, si t'ia bësh kur prishet. Të gjitha këto probleme, njeriu s'do t'i kishte, po të mos ishin hapëset elektrike të kutiave të konservave dhe, në fund të fundit, kush e ndien nevojën e tyre? Meqë ra fjala për probleme, unë kam

disa tani, personale dhe të bankës. Sot na doli një problem i madh. Në disa pikëpamje, ti je për t'u pasur zili, e vetmuar dhe pa probleme...»

Aleksi e preu fjalën, duke e kuptuar se po thoshte, në rast se jo fjalë pa kuptim, së paku marrëzira. Asnjë qenie njerëzore nuk është për t'u pasur zili, kur jeta e saj katandiset në një muzgëtirë tragjike. Dhe Silias nuk i kishte mbetur tjetër. Në ato muajt e fundit, ky fakt ishte bërë dhe më i qartë se më parë. Gjer para një viti, kishte mbetur akoma ndonjë gjurmë e bukurisë së saj të brishtë, të ngjashme me atë të një vajze të mitur. Tani, të gjitha këto ishin zhdukur. Flokët e saj, dikur biondë dhe të dendur, tani ishin venitur dhe rralluar. Lëkura i kishte marrë një ngjyrë të përhimtë; vende-vende, aty ku ajo ishte kruar, shiheshin gërvishtje.

Ndërsa, më parë, rrinte herë pas here kruspull, tani ajo e mbante këtë qëndrim pothuajse vazhdimisht. Dhe, megjithatë ishte dhjetë vjet më e re se Aleksi, ajo kishte marrë pamjen e një shtrige dhe dukej nja njëzet vjet më e vjetër.

Kishin kaluar gati pesë vjet kur kishte hyrë në Qendrën Klinike. Ndërkohë, kushtet e saj ishin bërë kronike dhe shpresat e shërimit ishin shumë të pakta.

Ndërsa vëzhgonte Silian dhe vazhdonte të fliste, Aleksi ndjente mëshirë dhe trishtim, por jo më një ndjenjë tërheqjeje dhe dashurie. Ndoshta, ai duhej të ndjente disa emocione të tilla, por, duke qenë i ndershëm me vetveten, ai e shihte se kjo nuk ishte më e mundur. Prapëseprapë e ndjente veten akoma të bashkuar me Silian, me lidhje që do të këputeshin vetëm me vdekjen e njërit prej tyre.

Iu kujtua biseda me doktor Mekartnin, drejtorin e Qendrës Klinike, gati njëmbëdhjetë muaj më parë, një ditë pasi Ben Roseli kishte njoftuar, në një mënyrë aq dramatike, vdekjen e tij të afërt. Duke iu përgjigjur pyetjes së Aleksit për efektin që mund të kishte mbi Silian ndarja dhe një martesë e re e të

shoqit, psikiatri i kishte thënë: «Kjo mund ta shtynte në një gjendje marrëzie të plotë.»

Më vonë, Margoti kishte deklaruar: «nuk dua të ndiej, në ndërgjegjen time, ose të di se e ndien ti, brejtjen se kemi flakur në një pus pa fund, atë pak gjë që mbetej nga ekuilibri mendor i Silias.»

Atë mbrëmje, Aleksi i bëri pyetjen vetes nëse ekuilibri mendor i Silias gjendej tanimë në një pus pa fund. Por, edhe po të ishte kjo e vërtetë, kjo nuk ia hiqte kundërshtimin që ndjente për të vënë në veprim makinën e pamëshirshme dhe përfundimtare të ndarjes.

Nga ana tjetër, ai s'kishte shkuar të jetonte në mënyrë të përhershme me Margot Brekënin, ose ajo me të. Margoti s'kishte ndonjë kundërshtim, por ai dëshironte të martoheshin dhe ishte e qartë se kjo nuk mund të bëhej para se të bëhej ndarja nga Silia. Megjithatë, kohët e fundit, ai kishte ndier njëfarë padurimi nga ana e Margotit për shkak të pavendosmërisë së tij.

Sa i çuditshëm ishte fakti që ai, i mësuar të merrte me shpejtësi dhe lehtësi vendime të rëndësishme në Fërst Merkentajll Emerikën Benk, tregohej aq i pavendosur kur ishte fjala për jetën e tij private!

Aleksi e kuptonte se thelbi i problemit ishte në ndajimin e tij të vjetër të fajit. Ndoshta — thoshte me vete — vite më parë, me pak më shumë dashuri dhe mirëkuptim, do të kishte mundur ta shpëtonte gruan e tij të re dhe të ndruajtur nga kjo gjendje e tmerrshme. Po t'u kishte kushtuar më shumë kujdes detyrave të tij bashkëshortore se atyre të bankierit, ai mendonte se kjo mund të ishte arritur.

Ja përse shkonte atje, ja pse vazhdonte të bënte për të ato pak gjëra që akoma mund të bënte.

Kur erdhi koha për t'u larguar, ai u ngrit dhe shkoi drejt saj, me qëllim që ta puthte në ballë, si zakonisht. Por, kësaj

here, ajo u tërhoq menjëherë, me një shprehje frike të befasishme në sytë e saj, duke u mbledhur dhe më shumë kruspull. Me një psherëtimë, Aleksi hoqi dorë nga qëllimi i tij.
— Natën e mirë, Silia, — tha ai.
Nuk mori përgjigje dhe doli nga dhoma, duke e lënë të shoqen në botën e saj të vetmuar, në të cilën tani ajo jetonte.

Të nesërmen në mëngjes, Aleksi thirri Nolan Uejnrajtin. Ai i tha drejtorit të shërbimit të sigurimit se honorari që do t'i paguhej Vernon Xheksit do të ishte në ngarkim të zyrës së sigurimit. Aleksi do t'i autorizonte shpenzimet. Ai nuk e vuri në dijeni të çështjes dhe Uejnrajti nuk pyeti se për çfarë hetimesh ishte fjala. Aleksi mendoi se, hepërhë, sa më pak njerëz të ishin në dijeni të planit të tij, aq më mirë ishte. Edhe Nolan Uejnrajti kishte diçka për t'i njoftuar Aleksit. Kjo kishte të bënte me ngarkimin e Majlls Istinit me detyrën e një agjenti të fshehtë të bankës. Kundërvënimi i Aleksit qe i menjëhershëm.
— Jo. Nuk dua që ai njeri të figurojë përsëri në borderotë tona.
— Nuk do të figurojë në bordero, — tha Uejnrajti. — Unë ia bëra të qartë se kjo nuk ishte një marrëre e rregullt në punë. Paga që do të marrë do të jetë me para në dorë, pa asgjë tjetër për të treguar se nga i kanë ardhur.
— Kësaj i thonë ta ndash një qime në katër, Nolan. Në një formë a një tjetër, ai do të jetë në punë te ne dhe, me këtë, s'mund të jem i një mendjeje.
— Mirëpo, Aleks, në këtë mënyrë po më lidh duart dhe s'më lë të bëj punën time.
— Të bësh punën tënde nuk do të thotë të marrësh në punë një vjedhës, të dalë nga burgu.
— Nuk ke dëgjuar se për të zënë një vjedhës duhet një vjedhës tjetër?
— Atëherë, përdor një që të mos ketë vjedhur në këtë bankë.
Vazhduan të paraqitnin argumente të kundërta, nganjëherë edhe me njëfarë nervozizmi. Më në fund, Aleksi pranoi pa

dëshirë. Pastaj pyeti:
— I ka të qarta Istini rreziqet e kësaj pune?
— Po.
— I fole për atë tjetrin që vdiq? — Aleksi kishte mësuar nga Uejnrajti, muaj më parë, se ç'i kishte ndodhur Vikut.
— Po.
— Prapëseprapë, kjo punë nuk më pëlqen fare.
— Do të të pëlqejë akoma dhe më pak, në qoftë se humbjet e shkaktuara nga letërkreditët e falsifikuara do të shtohen me ritmin e tanishëm.
Aleksi psherëtiu.
— Mirë. Është seksioni yt dhe ke të drejtë ta organizosh punën siç e mendon ti vetë dhe, prandaj, të bëra rrugë. Mirëpo, dua të theksoj diçka: në rast se do të kesh përshtypjen se Istini është në rrezik, atëherë nxirre menjëherë jashtë kësaj ngatërrese.
— E kam parasysh.
Uejnrajti ishte i kënaqur që ia kishte dalë në krye kësaj pune, aq më shumë se nuk kishte parashikuar një kundërshtim aq të fortë. Sidoqoftë, në atë çast nuk i dukej me vend të përmendte gjë tjetër, si për shembull, shpresën që kishte për ta përdorur Huanita Nunjezin si ndërmjetëse midis vetë atij dhe Istinit. Në fund të fundit, tha me vete, për të qetësuar ndërgjegjen e tij, Aleksi e dinte në vija të trasha planin e tij. Pse ta mërziste tani me hollësitë?

Huanita Nunjezin po e mundonin dyshimi dhe kureshtja. Dyshimi, sepse ajo s'kishte as simpati e as besim te drejtori i shërbimit të sigurimit të bankës, Nolan Uejnrajti; kureshtja, sepse nuk arrinte të kuptonte se për ç'arsye ai donte ta takonte dhe, për më tepër, në fshehtësi.
Kjo gjë s'kishte të bënte me vetë atë, që, personalisht, e kishte siguruar një ditë më parë Uejnrajti, duke i telefonuar në degën kryesore të bankës. Ai donte vetëm që ata të dy të kishin një bisedë vetëm për vetëm, «për të ditur nëse do të pranonit të ndihmonit një njeri.»

— Ju?
— Jo pikërisht.
— Po, atëherë, kë?
— Më mirë t'jua them veças.
Nga zëri, Huanita kishte kuptuar se Uejnrajti po përpiqej të tregohej i përzemërt. Por ajo s'kishte besim te një përzemërsi e tillë, duke sjellë ndërmend ashpërsinë mizore të tij, kur mbi të rëndonte dyshimi se kishte vjedhur. As të kërkuarit ndjesë nga ai, më vonë, nuk e kishte fshirë atë nga kujtesa. Ajo dyshonte që ndonjë gjë të mund ta bënte ndonjëherë këtë.

Mirëpo, Uejnrajti ishte një funksionar i lartë i FMA-së dhe vetë ajo një nëpunëse e thjeshtë.

— Mirë, ishte përgjigjur Huanita, — jam këtu dhe, herën e fundit që hodha sytë nga galeria pashë se ishte e hapur. Ajo kish menduar se Uejnrajti donte të vinte aty në degën e bankës, ose t'i kërkonte asaj të shkonte në drejtori, por, ai e kishte çuditur.

Do të ishte më mirë të mos takoheshim në bankë, zonja Nunjez. Kur t'jua kem shpjeguar se për çfarë është fjala, do ta kuptoni arsyen. Po sikur të vij t'ju marr sonte në shtëpi? Do të mund të bisedonim në makinë, gjatë një shëtitjeje të vogël.

— Jo, nuk mundem. — Huanita po tregohej më e matur se kurdoherë tjetër.

— Domethënë, nuk keni mundësi sonte?

— Jo.

— Atëherë, nesër?

Huanita kishte ngurruar, duke u munduar të vendoste.

— Do t'ju njoftoj.

Në rregull. Më thërrisni nesër. Sa më herët që të jetë e mundur. Ndërkaq, ju lutem të mos i thoni askujt se kemi

pasur bashkë këtë bisedë. — Pastaj, Uejnrajti e kishte prerë lidhjen.

Dhe ja, tani ishte e nesërmja — e marta e javës së tretë të shtatorit. Aty nga ora dhjetë, Huanita e kuptoi se po të mos e thërriste ajo Uejnrajtin, këtë gjë do ta bënte ai.

Ishte akoma e shqetësuar. Nganjëherë, ajo i nuhaste që më parë ngatërresat që do të ndodhnin dhe, tani, po i parandjente ato në mënyrë të qartë. Në fillim, ajo kishte menduar të këshillohej me zonjën D'Orsej, të cilën e shihte në anën tjetër të sallës, në tryezën e saj të punës, mbi platformë, por ngurroi, duke iu kujtuar porosia e Uejnrajtit që të mos e zinte në gojë me asnjeri bisedën e tyre. Kjo sidomos e kishte ngjallur kureshtjen e saj.

Atë të martë, Huanita nuk punonte në arkë, por, te llogaritë e reja. Pranë saj ishte një telefon. Ajo ia nguli sytë për një kohë të gjatë dhe, pastaj, ngriti receptorin dhe formoi numrin e brendshëm të sigurimit. Mbas disa çastesh, zëri i thellë i Nolan Uejnrajtit pyeti:

— Atëherë, sonte?

Kureshtja qe më e fortë se gjithçka.

— Po, por s'kam shumë kohë — Huanita shpjegoi se mund ta linte vetëm Estelën veç një gjysmë ore, jo më shumë.

— Mjafton. Në ç'orë dhe ku?

Po binte muzgu, kur vetura Mastën II e Nolan Uejnrajtit u ndal te trotuari i ndërtesës, ku banonte Huanita Nunjezi. Pak çaste më vonë, ajo doli nga porta kryesore, duke e mbyllur atë me kujdes prapa saj. Uejnrajti e hipi në makinë, e ndihmoi për të vënë brezin e sigurimit dhe, pastaj, i tha:

— Faleminderit që erdhët.

— Një gjysmë ore — ia kujtoi Huanita. — Jo më shumë. — Nuk bëri as përpjekjen më të vogël për t'u treguar e

përzemërt dhe që në atë çast e ndjente veten të shqetësuar që e kishte lënë Estelën vetëm.

Uejnrajti tundi kokën në shenjë pohimi dhe nisi makinën. U larguan nga trotuari dhe u futën në trafikun e rrugës. Kaluan në heshtje dy blloqe ndërtesash dhe, pastaj, u kthyen nga e majta, duke u futur në një rrugë me trafik më të madh, që shkëlqente nga dritat e dyqaneve dhe lokaleve të shumta.

Uejnrajti tha:

— Mora vesh se Istini kishte ardhur t'ju shihte. — Nga kush e mësuat? — ia priti ajo me ton të ftohtë. — Ma tha vetë. Më tha, gjithashtu, se e kishit falur.

— Në qoftë se jua ka thënë ai, atëherë e dini.

— Huanita.. a mund t'ju quaj kështu?

— Mendoj se po. Ky është emri im.

Uejnrajti psherëtiu.

— Huanita, unë jua kam thënë edhe më parë se më vjen keq se si ndodhën punët midis nesh. Unë ju jap të drejtë edhe në rast se më mbani akoma mëri.

Huanita u zbut pakëz.

— Bueno, por do të ishte më mirë të më thoni se çfarë doni.

— Dua të di nëse je e gatshme për të ndihmuar Istinin.

– Ah, për atë qenka fjala!
– Po.
– Pse duhet ta ndihmoj unë. Nuk është e mjaftueshme që e fala? – Për mendimin tim, më se e mjaftueshme, por qe ai që më tha se ndoshta ju mund...
Ajo e ndërpreu...
– Për çfarë lloj ndihme është fjala?

– Para se t'ju përgjigjem, dua të më premtoni se nuk do t'i zini me gojë me asnjeri ato që do të themi tani.
Huanita ngriti supet.
– S'kam se kujt t'ia them. Sidoqoftë, ju premtoj.
– Istini do të bëjë një punë gjurmimi, në shërbim të bankës, ndonëse jo në mënyrë zyrtare. Në qoftë se do të ketë sukses, kjo mund ta ndihmojë për t'u rehabilituar, gjë që ai e dëshiron.
– Uejnrajti pushoi së foluri gjatë kohës që po parakalonte një kamion me rimorkio që ecte me shpejtësi të vogël dhe, pastaj, vazhdoi: – Puna është me rrezik dhe do të ishte akoma më me rrezik në rast se ai do të më raportonte mua drejtpërdrejt. Na duhet një njeri që t'i transmetojë mesazhet nga njëri te tjetri, një ndërmjetës.
– Dhe vendosët që të jem unë?
– Askush s'ka vendosur gjë. Unë po ju pyes nëse jeni e gatshme për ta bërë këtë. Kjo do ta ndihmonte Istinin për t'u rrezikuar sa më pak.
– A është Majllsi i vetmi që do të ndihmohej nga e gjithë kjo?
– Jo, – pranoi Uejnrajti. – Do të më ndihmonte dhe mua, si dhe bankën.
I kishin lënë prapë dritat e qytetit dhe po përshkonin një urë mbi lumë. Atje, shumë poshtë, uji shkëlqente në ngjyrë të zezë në errësirën që sa vinte e shtohej. Ura ishte metalike dhe, duke kaluar mbi të, rrotat e veturës fshkëllenin. Në fund të urës dilje në një autostradë ndërshtetërore. Uejnrajti u fut në të.
– Më flisni pak për atë punën e gjurmimit që përmendët pak më parë, – tha Huanita. – Më tregoni më shumë rreth saj. – Ajo fliste me zë të ulët dhe pa gjalëri.
– Në rregull. – Uejnrajti i shpjegoi se Majlls Istini do të vepronte në mënyrë të fshehtë, duke shfrytëzuar kontaktet që kishte vendosur kur kishte qenë në burg. Ai i tregoi gjithashtu, se çfarë lloj provash duhej të kërkonte Majllsi. Uejnrajti

mendoi se ishte e kotë t'i fshihte ndonjë gjë, sepse atë që ai mund të mos ia thoshte tani, Huanita do ta zbulonte më vonë. Kështu që ai i tregoi edhe për vrasjen e Vikut, duke mos përmendur vetëm hollësitë më të shëmtuara. – Nuk them se Istinit do t'i ndodhtë e njëjta gjë, – përfundoi ai. – Nga ana ime, unë do të bëj ç'është e mundur për të mos lejuar që të ndodhë një gjë e tillë. Por desha t'ju flas për këtë gjë, ashtu siç i fola edhe atij, për t'i ditur rreziqet që i kanosen. Prandaj, po qe se ju e ndihmoni, kjo do të ndihmonte për ta mbrojtur.
– Po mua, kush do të më mbronte?
– Praktikisht, ju nuk i nënshtroheni asnjë rreziku. Të vetmet kontakte që do të kishit, do të ishin ato me Istinin dhe me mua. Asnjeri nuk do të dinte gjë dhe ju nuk do të kompromentoheshit. Për këtë mund të rrini e qetë.
– Në qoftë se jeni kaq i sigurt, atëherë pse u takuam ne në këtë mënyrë?
– Kjo është vetëm një masë e thjeshtë sigurimi, për të mënjanuar mundësinë që ndokush të na shohë dhe të dëgjojë se ç'themi.
Pas një çasti heshtjeje, Huanita pyeti:
– Kaq, e gjitha? S'keni gjë tjetër për të më thënë?
– Jo s'kam tjetër.
Tani po kalonin në një autostradë. Uejnrajti ecte me 70km në orë në krahun e djathtë, ndërsa makina të tjera e parakalonin me shpejtësi. Nga drejtimi i kundërt i autostradës po afroheshin drejt tyre me shpejtësi tri radhë dritash makinash. Huanita rrinte e heshtur me sytë e ngulur drejt përpara. Uejnrajti pyeste veten se ç'mendonte ajo dhe cila do të ishte përgjigjja e saj. Shpresonte që të ishte po.
Sikurse edhe në raste të tjera, kjo grua e re, me trupin e një vajze të mitur dhe fytyrën e gjallëruar, i dukej provokuese dhe tërheqëse. Kokëfortësia bënte pjesë në forcën e saj tërheqëse;

po ashtu edhe kundërvënia i saj i ëmbël femëror në veturën e vogël të mbyllur. Ai s'kishte pasur të bënte me shumë gra, pas ndarjes me të shoqen, dhe, në çdo rast tjetër, do ta kishte provuar fatin me Huanitën, por tani kishte gjëra më të rëndësishme për t'i kërkuar asaj dhe s'mund të merrej me qejfet e veta.
Ishte gati të thoshte diçka, kur Huanita u kthye nga ai. Edhe në gjysmë errësirën brenda makinës, ai pa se si i lëshonin shkëndija sytë.
— Ju duhet të jeni i marrë, i marrë, i marrë! — Zëri i saj u ngrit edhe më shumë nga zemërimi. — Për çfarë më morët, për budallaçkë, torollake? Thoni se s'ka asnjë rrezik për mua! Po sigurisht që ka rreziqe dhe këto bien të gjitha mbi mua! Dhe, për çfarë? Për lavdinë e zotrisë së sigurimit Uejnrajt dhe të bankës! — Shiko...
Huanita vazhdoi të vjellë vrer, pa ia vënë veshin ndërprerjes së tij dhe zemërimi i dilte nga goja si një lumë llave.
— Qenkam unë një objektiv kaq i lehtë? Mos vallë fakti që jam vetëm dhe portorikane duhet të më bëjë t'i pranoj të gjitha shkeljet e padrejtësitë e kësaj bote? Ju-ve aq ju bën për njerëzit që i përdorni dhe si i përdorni. Më ktheni në shtëpi! Ndërkaq, çfarë lloj pendejade është kjo? — Eh, qetësohuni! — i tha Uejnrajti. Kundërveprimi i saj e kishte habitur. — Ç'është pendejada?
— Marrëzi! Pendejada se ju sakrifikoni një jetë njerëzore për letërkreditet tuaja të mallkuara! Pendejada që Majllsi është i një mendeje me këtë!
— Ai erdhi tek unë për të më kërkuar ndihmë. Nuk shkova unë tek ai.
— Dhe këtë e quani ndihmë, ju?
— Për punën që do të bëjë, do të marrë para. Edhe për këto kishte nevojë. Nga ana tjetër, siç jua thashë, ai më sugjeroi që

të drejtohesha te ju.
— Por, atëherë, ç'kishte ai që s'ma kërkoi vetë këtë? Mos ka humbur gojën? Apo ka turp dhe fshihet prapa fustaneve të mami Uejnrajtit? — Në rregull, në rregull, — protestoi Uejnrajti. — E kuptova ç'doni të thoni. Po ju çoj përsëri në shtëpi.
Aty pranë gjendej një urë kalimi për të dalë nga autostrada. Ai u kthye drejt saj, e përshkoi dhe mori drejtimin e qytetit. Huanita rrinte e heshtur, gjithë duke turfulluar nga zemërimi. Në fillim ishte munduar ta mendonte te dhe ta shqyrtonte me qetësi atë që po i propozonte Uejnrajti. Por, gjatë kohës që ai fliste dhe ajo e dëgjonte, mendja e saj mbushej plot me dyshime dhe pyetje; dhe, pak më vonë, ndërsa po e analizonte secilën prej tyre, atë e kishte kapur një zemërim aq i madh, i cili, më në fund, kishte shpërthyer. Përveç zemërimit, Huanita kishte ndier një urrejtje dhe neveri të re për njeriun ulur në krah të saj. Të gjitha kujtimet e dhimbshme të ngjarjes së saj të mëparshme me atë iu shfaqën, të zmadhuara, përsëri para syve. Dhe zemërimi që ndjente s'kishte të bënte vetëm me propozimin që i ishte bërë vetë asaj, por edhe me mënyrën se si ai dhe banka kishin ndërmend ta përdornin Majllsin.
Por, në të njëjtën kohë, Huanita ishte e inatosur edhe me Majllsin. Pse s'i ishte drejtuar asaj drejtpërdrejt? S'ishte burrë ai? Huanitës iu kujtua se, më pak se tri javë më parë, ajo kishte admiruar kurajën e tij, kur kishte ardhur tek ajo, me petkun e të penduarit, për të kërkuar ndjesë. Mirëpo, sjellja e tij e tanishme, ky lloj manovrimi, me ndërmjetësinë e një personi tjetër, dukej se përputhej më shumë me pandershmërinë e tij, të kohës kur ishte përpjekur tia hidhte asaj fajin e veprimeve të veta të dënueshme.
Befas, mendimet i morën një drejtim tjetër. Mos po tregohej ajo e rreptë, e padrejtë? Duke analizuar vetveten, ajo i bëri

vetes pyetjen. Mos ishte zhgënjimi për faktin se Majllsi s'ishte kthyer më tek ajo, pas atij takimi të parë në apartamentin e saj, që e shtynte të zemërohej. Dhe a nuk acarohej më shumë ky zemërim nga keqardhja për faktin se Majllsi, për të cilin kishte simpati, pavarësisht nga ç'kishte ndodhur, ishte zëvendësuar në këtë çast dhe përfaqësohej nga Nolan Uejnrajti, të cilin ajo e përbuzte?
Zemërimi i saj, që nuk vazhdonte kurrë gjatë, filloi të bjerë. Ai u zëvendësua nga një ndijim pasigurie. Huanita e pyeti Uejnrajtin:
— Po ju, si do t'ia bëni tani?
— Çfarëdo vendimi që të marr, sigurisht që nuk kam ndërmend t'jua tregoj juve. — Zëri i Nolanit ishte i ashpër dhe përpjekja e tij për të qenë i përzemërt ishte zhdukur.
Huanita pyeti veten, me një shqetësim të papritur, se mos ishte treguar e ashpër, pa qenë nevoja. Ajo kishte pasur shumë mirë mundësi të mos pranonte kërkesën, pa përdorur fyerje. Po sikur Uejnrajti të kërkonte në bankë ndonjë mënyrë për t'ia shpaguar? Mos kishte rrezikuar, në këtë mënyrë, punën e saj, tek e cila mbështetej për të mbajtur Estelën? Shqetësimi i Huanitës u shtua edhe më shumë. Ajo pati përshtypjen se kishte rënë në një grackë. Ajo mendoi edhe diçka tjetër: Po të ishte e sinqertë, gjë që kërkonte të ishte, duhej të pranonte se për shkak të vendimit të saj, nuk do të kishte mundësi për ta parë më Majllsin.

Makina po ngadalësonte shpejtësinë. Tani ishin pranë kthesës, që të çonte përsëri tek ura.

Duke u habitur edhe vetë, Huanita tha me një zë të hollë e pa gjallëri:

— Shumë mirë, do ta bëj.
— Do të bëni, çfarë?

— Do të bëj... çfarë ishte, punën e...
— Ndërmjetësit. — Uejnrajti i hodhi një vështrim anash. — Jeni e sigurt?
— Si, estoy segura. Jam e sigurt.

Për herën e dytë atë mbrëmje, Uejnrajti psherëtiu.

— Jeni një tip i çuditshëm.
— Jam grua.
— Po, tha ai dhe, në zërin e tij ishte kthyer përsëri dëshira nga përzemërsia e mëparshme. — E kisha vënë re. — Ai e ndali veturën një bllok e gjysmë ndërtesash nga Rajoni Lindor dhe la motorin të ndezur. Nxori dy zarfe nga një xhep i brendshëm i xhaketës, njëri i fryrë dhe tjetri më i vogël, dhe i dha Huanitës të parin.
— Këtu janë paratë. I mbani deri sa Istini të vihet në kontakt me ju. — Ai i shpjegoi se zarfi përmbante katërqind e pesëdhjetë dollarë, paga mujore për të cilën ishin marrë vesh, pa pesëdhjetë dollarët e parapagimit, që Uejnrajti ia kishte dhënë Majllsit para një jave.
— Brenda kësaj jave, — shtoi ai, — Istini do të më telefonojë dhe unë do t'i them një fjalë në kod, që e kemi caktuar më parë. Emri juaj nuk do të përmendet fare. Por, ai do ta dijë se duhet të vihet në kontakt me ju, gjë që do ta bëjë brenda një kohe të shkurtër.

Huanita bëri shenjë me kokë. Ajo dëgjonte me vëmendje, duke regjistruar në mendjen e saj çdo të dhënë.

— Mbas kësaj telefonate, Istini dhe unë nuk do të kemi më kontakte të drejtpërdrejta. Të gjitha mesazhet tona, në njërin apo tjetrin drejtim, do të kalojnë nëpërmjet jush. Do të ishte më mirë që ju të mos i shkruanit, por t'i mësonit përmendsh. E di që keni një kujtesë të mirë.

Duke thënë këto fjalë, Uejnrajti buzëqeshi dhe, papritur, Huanita buzëqeshi me të madhe. Ishte me të vërtetë gjë për të qeshur që Uejnrajti të mbështetej pikërisht në këtë aftësi të saj

të veçantë, që dikur kishte qenë shkaku i telasheve të saj me bankën dhe me vetë atë!

— Meqë ra fjala, — tha drejtori i shërbimit të sigurimit, — duhet të më jepni numrin e telefonit tuaj. Nuk e gjeta në numërator.
— Nuk e keni gjetur, se nuk kam telefon. Kushton tepër.
— Sidoqoftë, duhet ta instaloni. Do të keni nevojë për të. Istini mund të dojë t'ju thërrasë, kështu edhe unë. Bëni menjëherë kërkesën dhe banka do t'ju kthejë shumën e paguar për instalimin.
— Do të përpiqem, por kam dëgjuar se duhet të presësh shumë kohë, para se të marrësh telefon në Rajonin Lindor.
— Atëherë, lëreni të merrem unë me këtë punë. Nesër do të thërres shoqërinë e telefonave dhe të siguroj se telefonin do ta keni së shpejti.
— Shumë mirë.

Tani, Uejnrajti hapi zarfin e dytë, më të vogël.

— Kur t'i jepni Istinit paratë, i jepni gjithashtu edhe këtë.

«Kjo» ishte një letërkrediti Kicarch, lëshuar në emër të H.E. LYNCOLP. Prapa saj, hapësira për nënshkrim ishte bosh.

Le ta nënshkruajë Istini, me këtë emër, por me shkrimin e tij të zakonshëm. I thoni se emri është i rremë, por në qoftë se merren tri germat e para dhe dherma e fundit, formohet fjala HELP (ndihmë). Është pikërisht në këtë mënyrë që Istini do të mund të na njoftojë se ka nevojë për ndihmë, në rast se është në rrezik.

Uejnrajti i shpjegoi Huanitës se kompjuteri i seksionit Kicarch ishte programuar në mënyrë që të jepte alarmin sapo ajo letër krediti të paraqitej në cilindo dyqan, si mjet pagese, kështu që ai do të dinte jo vetëm se Istini kishte nevojë për ndihmë, por edhe se ku gjendej.

— Ai mund ta përdorë atë në rast se e sheh se është në rrezik, si edhe po të ketë zbuluar ndonjë gjë shumë të rëndësishme dhe do përforcime. Duke pasur parasysh se çdo gjë mund të ketë ndodhur gjer atëherë, unë do të vendos se ç'duhet bërë. Ju i thoni të blejë diçka me vlerë më të madhe se pesëdhjetë dollarë, kështu tregtari do të telefonojë patjetër, për të marrë konfirmimin. Pas kësaj, Istini duhet të mos largohet shumë nga ai vend, për të më dhënë kohë të mbërrij atje.
Uejnrajti përfundoi:
— Ndoshta, ai nuk do të ketë asnjëherë nevojë për këtë letërkrediti. Por, në qoftë se do t'i duhet ta përdorë, ky është një sinjal që askush tjetër nuk mund ta dijë:
Me kërkesën e Nolanit, Huanita i përsëriti udhëzimet e tij pothuajse fjalë për fjalë. Uejnrajti e vështroi me admirim.
— Jeni me të vërtetë shumë e aftë!
— De que me vale, muerta?
— Ç'do të thotë?
Huanita ngurroi, pastaj përktheu:
— E ç'më hyn në punë, po qe se kam vdekur?
— Mos u bëni më merak! — Duke u zgjatur, ai i preku lehtë duart e saj të kryqëzuara. — Të premtoj se gjithçka do të shkojë më së miri.
Në atë çast, besimi i Uejnrajtit ishte ngjitës. Mirëpo, kur Huanita qe përsëri në shtëpi dhe pasi e vuri Estelën në shtrat, parandjenja e saj për rreziqe që po afroheshin u shfaq përsëri dhe nuk iu nda më.

Palestra Shtatë-Shtatë kundërmonte nga avulli i kaldajës, urinës së vjetër, djersës, pijeve alkoolike. Megjithatë, pasi të kaloje njëfarë kohe aty brenda erërat e ndryshme përziheshin dhe formonin një erë të vetme që të zinte hundën, por që, për

çudi, ishte e pranueshme, kështu që era e freskët që hynte brenda rastësisht dukej si diçka e çuditshme dhe e huaj. Palestra ishte një ndërtesë katërkëndëshe, me tulla të murrme, në trajtë kubike dhe gjendej në një rrugicë pa krye, mjaft të rrënuar, jo shumë larg nga qendra e qytetit.
Faqja e saj e përparme mbante shenjat e një gjysmë shekulli shfrytëzimi dhe moskujdesi, të cilëve, kohët e fundit, u ishin shtuar edhe vizatime të shkruara me dorë. Në majë të ndërtesës ishte vendosur mbajtësja e një shtizë flamuri, të cilën askujt si kujtohej ta kishte parë ndonjëherë me flamur. Hyrja kryesore përbëhej nga një portë e fortë, me një kanatë, pa asnjë shënim, nga e cila kalohej drejtpërdrejt në një trotuar, që binte në sy nga të çarat dhe plasaritjet, bidona mbeturinash të përmbysur dhe ndyrësira të panumërta qensh. Në korridorin, që ndodhej menjëherë mbas portës kryesore të hyrjes, boja e mureve të të cilit kishte filluar të ripej e të binte pjesë-pjesë, rrinte zakonisht si rojë një boksier, me fytyrën xhunga-xhunga nga goditjet, që linte të hynin anëtarët dhe i largonte, me sjellje të ashpër, të tjerët; por, nganjëherë, ai mungonte; dhe, kështu ndodhi kur erdhi aty Majlls Istini që mundi të futej brenda pa vështirësi.
Ishte mesjavë, pak para orës dymbëdhjetë. Nga fundi i ndërtesës, në katin përdhes, vinte një zhurmë kakofonike zërash. Majllsi shkoi në atë drejtim, gjatë një korridori jo shumë të pastër, në faqet e mureve të të cilit ishin varur fotografi të zverdhura kampionësh boksi. Në fund të korridorit, një derë e hapur të çonte në një bar, në një sallë në gjysmë errësirë, prej nga vinin zërat. Majllsi hyri brenda.
Në fillim nuk mundi të shihte gati fare dhe bëri disa hapa me ngurrim, duke u përplasur me një kamerier që ecte me nxitim, e që mbante një tabaka me gota të mbushura plot. Kamerieri lëshoi një sharje, por mundi në njëfarë mënyre, të mos

rrëzonte asgjë dhe vazhdoi rrugën e tij. Dy burra, të ulur te banaku, në frona të lartë, nga ata që përdoren në bare, kthyen kokën. Njëri prej tyre tha:
— Mik i dashur, ky këtu është një klub privat. Në qoftë se nuk je anëtar, mbathja!
Tjetri u ankua:
— Dembeli, Pedroja, është zhdukur përsëri. Ç'portier! Ej, kush je ti? Çfarë do?
— Po kërkoj Xhuls LaRokën.
— Shiko gjetiu, — urdhëroi burri i parë. — Këtu nuk ka njeri me këtë emër.
— Hej, Majlls, i dashur! — Nga gjysmëerrësira u duk një figurë trashaluqe, me barkun sa një vozë. U pa fytyra e njohur si e nuses së lalës. Ishte Xhuls LaRoka, që në burgun e Drumonburgut shërbente si i dërguari i «Rrugicës Mafia» dhe kishte filluar të shoqërohej me Majllsin. Kishte dalë nga burgu, në liri të mbikëqyrur, pak para Majllis Istinit.
— Ej, Xhuls! — thirri Majllsi.
Eja, eja, — LaRoka zuri krahun e Majllsit me gishtat e tij të trashë. — Është miku im, — u shpjegoi të dy burrave të ulur, të cilët kthyen shpinën me indiferentizëm.
— Dëgjo, — tha Majllsi. — Kam ngelur teneqe. Nuk mund të paguaj. — Ai kaloi me lehtësi në argonë[1]) e mësuar në burg.
— Mos u bëj merak. Eja të pish nja dy birra nga unë. — Ndërsa po kalonin ndërmjet tavolinave, LaRoka e pyeti: — Ku ke qenë?
— Duke kërkuar punë. Jam përtokë, Xhuls. Kam nevojë për ndihmë. Para se të dilja, më pate thënë të të drejtohesha ty.
— Sigurisht, sigurisht. — U ndalën në një tavolinë, ku ishin ulur dy burra të tjerë. Njëri ishte koskë e lëkurë, me një fytyrë të ngrysur, të vrarë nga lija. Tjetri kishte flokë të gjatë biondë, çizme kauboj dhe syze të errëta. LaRoka afroi edhe një karrige

tjetër.
— Ky, këtu, është miku im, Majllsi.
Nga gryka e burrit me syze të errëta u dëgjuan ca tinguj të trashë. Tjetri pyeti:
— Ai që i di të gjitha për brumin[2])?
— Po, ky është. — LaRoka i thirri me zë të lartë kamerierit për të sjellë birrë dhe, pastaj, iu drejtua burrit me të cilin kishte folur në fillim: — Hajt, jepi, bëji një pyetje.
— Pyetje për çfarë?
— Për paratë, budalla! — ndërhyri burri me syze të errëta. U mendua pak. — Ku ka dalë dollari i parë?
— Kjo është e lehtë, — i tha Majllsi. — Shumë njerëz kujtojnë se dollari është shpikur në Amerikë. Mirëpo, nuk është ashtu. Ai ka ardhur nga Bohemia, në Gjermani. Në fillim quhej thaler, por meqenëse evropianët e tjerë nuk mund ta shqiptonin këtë fjalë, ata e shtrembëruan shqiptimin e saj në dollar dhe ky shqiptim mbeti.

Një nga rastet e para kur flitet për këtë çështje, është te Makbeti: «dhjetë mijë dollarë për shpenzimet tona të përgjithshme».
LaRoka thirri me zë krenar:
— E more, nuk është ashtu siç ju thashë? Ky djalë i di të gjitha!
— Shiko! Jo të gjitha, — ia priti Majllsi, — përndryshe do të dija të fitoja tani ca para.
Dy gota me birrë u përplasën në tavolinë, para tyre. LaRoka nxori para nga xhepi dhe ia dha kamerierit.
— Para se të bësh para, — i tha pastaj Majllsit, — duhet të paguash Ominskin. — U përkul përpara, duke mos ua varur dy të tjerëve. — Rusi e di se ke dalë nga burgu. Ka kërkuar të të shohë.
Sapo dëgjoi emrin e fajdexhiut, të cilit ai i kishte akoma së paku tre mijë dollarë, Majllsi u mbyt në djersë të ftohta. Kishte edhe një hua tjetër-pak a shumë e njëjta shumë. Këtë

të fundit ia detyronte organizuesit të basteve, me të cilin kishte pasur të bënte; por, në atë çast, mundësia për ti paguar dukej e largët. Ndërkaq, ai e kishte ditur se vajtja atje, dalja përsëri në qarkullim, do të bënin që të hapeshin llogaritë e vjetra dhe se, po të mos paguante, do të merreshin masa të rrepta.
E pyeti LaRokën:
— Si mund të paguaj, qoftë edhe vetëm një pjesë të shumës që kam borxh, kur nuk gjej dot punë?
Barkmadhi tundi kokën:
— Pikë së pari, duhet të takohesh me rusin.
— Ku? — Majllsi e dinte se Ominski nuk kishte zyrë dhe lëvizte si ta kërkonte puna.
LaRoka bëri me shenjë nga birra.
— Thaje gotën dhe, pastaj, shkojmë bashkë tek ai.

— Shikoje këtë çështje nga vështrimi im, — tha burri i veshur në mënyrë elegante, duke vazhduar të hante drekë. Duart e tij, me unaza diamanti në gishtat, lëviznin me shkathtësi mbi pjatë. — Ne të dy kishim një marrëveshje tregtare. Unë e mbajta angazhimin tim, ndërsa ti nuk e mbajte tëndin. Më thuaj pak, ku më shpie mua kjo punë?

— Dëgjoni, — iu lut Majllsi, — ju e dini se ç'më ndodhi dhe unë e çmoj shumë që ju e ndalët orën, ashtu si bëtë. Mirëpo tani, nuk mund të paguaj. Dua të paguaj, por nuk mundem. Ju lutem, më jepni pak kohë.
Igor Ominski, i quajtur «rusi», tundi kokën me flokët e rregulluar nga një berber sipas modës dhe preku me gishtat e tij, për të cilët kujdesej dhe u bënte shërbimet e nevojshme, faqen ngjyrë trëndafili, të rruar me shumë kujdes. Ai i jepte mjaft rëndësi pamjes së tij dhe, duke qenë se i kishte mundësitë, jetonte dhe vishej shumë mirë.
— Koha, — tha ai me zë të ulët, — është para. Nga të dyja këto ke pasur mjaft tanimë.
Duke qenë i ulur përballë tij, në restorant, Majllsi ishte kishte

përshtypjen se ishte një mi përpara një kobre. Nga ana e tij e tavolinës nuk kishte ushqime, as dhe një gotë ujë, që do ta kishte ndihmuar shumë, sepse i ishte tharë goja dhe frika po i gërryente stomakun. Në qoftë se në atë çast do të kishte pasur mundësi të shkonte te Nolan Uejnrajti për të anuluar marrëveshjen e tyre, e cila e kishte rrezikuar në këtë mënyrë, ai do ta kishte bërë këtë menjëherë. Mirëpo, duhej të rrinte aty, i mbytur në djersë të ftohta, ndërsa Ominski hante peshk dhe LaRoka i vëzhgonte nga banaku i barit, ku ishte larguar me takt.

Shkaku i frikës së Majllsit ishte i thjeshtë. Ai e merrte me mend madhësinë e veprimtarisë tregtare të Ominskit dhe e dinte fuqinë e tij absolute.

Majllsi kishte parë një herë në televizion një shërbim të posaçëm gjatë të cilit, Ralf Salernosit, autoritetet në fushën e kriminalitetit amerikan, i ishte bërë pyetja: në qoftë se do të ishit i detyruar të jetonit në mënyrë të paligjshme, çfarë lloj shkelësi ligji do të preferonit të ishit?» Eksperti nuk kishte ngurruar: «fajdexhi.» Ato që Majllsi kishte mësuar në burg dhe para tij, e vërtetonin këtë mendim.

Një fajdexhi si Ominski, ishte një bankier që grumbullonte fitime jashtëzakonisht të mëdha, me rrezik minimal, duke dhënë hua të mëdha e të vogla, pa qenë i penguar nga asnjë rregull ose normë. Klientët vetë vinin tek ai; rrallë ndodhte që ai të shkonte t'i kërkonte ose të kishte nevojë ta bënte këtë. S'kishte nevojë të zinte me qira lokale të shtrenjta dhe punën e tij mund ta kryente në një makinë, në një bar ose duke ngrënë drekë, siç po bënte në atë çast. Kontabiliteti i tij ishte shumë i thjeshtë, zakonisht në kod dhe veprimtarive të tij financiare, pothuajse gjithmonë me para në dorë, nuk mund t'u gjendej burimi. Humbjet e shkaktuara nga hua që mbeteshin pa u shlyer, ishin të parëndësishme. Ai nuk paguante taksa federale,

shtetërore ose të qytetit. Ndërkaq, përqindja e interesit vjetor që kërkonte ishte 100 për qind e, shpeshherë, edhe më e lartë. Sipas Majllsit, Ominski duhej të kishte «në punë», së paku dy milionë dollarë. Një pjesë e kësaj shume ishte e tij, pjesa tjetër e krerëve të grupeve keqbërëse, të cilëve u siguronte fitime të mira, duke mbajtur për vete komisionin përkatës. Ishte kështu një gjë normale që një kapital fillestar prej 100.000 dollarësh, i investuar në veprime fajdeje, të rritej në pesë vjet, në një milion e gjysmë, pra një fitim prej 140 për qind. Asnjë investim tjetër në botë nuk mund të krahasohej me të.
Nga ana tjetër edhe klientët e një fajdexhiu nuk ishin gjithnjë njerëz në gjendje jo të mirë ekonomike. Ishte për t'u çuditur se sa shpesh ndodhte që zotërinj të nderuar dhe ndërmarrje të njohura u drejtoheshin fajdexhinjve, kur shteronin burimet e tyre të kreditit. Nganjëherë, në vend të shlyerjes, fajdexhinjtë bëheshin ortakë, ose pronarë të një ndërmarrjeje. Me të drejtë i quanin peshkaqenë. Gryka e tyre ishte e madhe dhe e pangopshme.
Shpenzimet e tyre më të mëdha shkaktoheshin nga rastet kur u duhej të detyronin kthimin me forcë të krediteve; por prapëseprapë ky ishte një shpenzim minimal, mbasi fajdexhinjtë e dinin mirë se nga borxhlinjtë e shtruar në spital, me ndonjë gjymtyrë të thyer, mund të nxirrreshin pak para, ose aspak; dhe ata e dinin mirë gjithashtu, se tagrambledhësi i tyre më i mirë ishte frika.
Mirëpo, frika ka nevojë të mbështetet mbi një bazë konkrete, prandaj kur një huamarrës bënte bisht, ndëshkimi nga ana e tipave kriminelë, të marrë në këtë punë me pagesë, ishte i shpejtë dhe i ashpër.
Përsa u përket rreziqeve që i kanosnin, këto ishin të vogla, krahasuar me forma të tjera të shkeljes së ligjeve. Të paktë ishin fajdexhinjtë që procedoheshin dhe akoma më të paktë

ata që dënoheshin. Arsyeja ishte mungesa e provave. Klientët e fajdexhinjve e mbanin gojën mbyllur, pjesërisht nga frika dhe pjesërisht nga turpi, se kishin pasur nevojë për shërbimet e tyre. Dhe ata që i kishin rrahur, nuk ngrinin kurrë padi, duke e ditur se, po ta bënin këtë, do të merrnin një mësim akoma dhe më të rëndë.

Majllsi rrinte si në gjemba, ndërsa Ominski po mbaronte së ngrëni peshkun.
Papritur, fajdexhiu e pyeti:
— A di t'i mbash regjistrat,
— Regjistrat e llogarisë? Si jo, kur punoja në bankë...
Tjetri i bëri shenjë të heshtte. Sy të ashpër e të ftohtë po e vlerësonin.
— Ndoshta mund të të përdor. Kam nevojë për një llogaritar te Shtatë-Shtata.
— Te Palestra? — Majllsit as që i kishte vajtur mendja se ai mund të ishte pronari dhe administratori i saj.
— Atje isha sot, para se...
Tjetri ia preu fjalën,
— Kur flas unë, mbylle gojën dhe dëgjo; vetëm jepu përgjigje pyetjeve që të bëhen. LaRoka thotë se kërkon punë. Po të dhashë punë, të gjitha ato që do të fitosh, do të më kalojnë mua, për të shlyer huanë dhe interesin. Me fjalë të tjera, të kam në dorë. E ke të qartë?
— Po, zoti Ominski. — Majllsi e ndjeu veten të lehtësuar. Më në fund, i kishin dhënë kohë. Pak rëndësi kishte si dhe pse e kishin bërë këtë.
— Do të kesh ushqimin dhe një dhomë, — vazhdoi rusi — Por, të paralajmëroj: mos i zgjat duart nga arka. Po zbulova se ke vepruar ndryshe, do të të vijë keq që s'ke vjedhur edhe një herë në bankë dhe jo mua.
Majllsi u rrëqeth instinktivisht, jo dhe aq nga mendimi i rrezikut që mund t'i vinte nga një vjedhje — gjë që s'kishte ndërmend ta bënte — se sa nga përfytyrimi se ç'do t'i ndodhte në rast se Ominski do të mësonte se një judë ishte futur në

kampin e tij.
— Xhulsi do të të shoqërojë dhe do të rregullojë gjithçka. Kaq kisha për të të thënë. — Me një gjest me dorë, Ominski e la të lirë Majllsin dhe i bëri një shenjë me kokë LaRokës, që i vëzhgonte nga banaku i barit. Majllsi priti jashtë restorantit, gjatë kohës që ata të dy bisedonin. Fajdexhiu jepte udhëzime, ndërsa LaRoka tundte kokën.

Mbas pak, Xhuls LaRoka erdhi te Majllsi.
— Je me fat, djalosh! Eja të shkojmë.
Ndërsa ata po largoheshin dhe Ominski po fillonte të hante ëmbëlsirën, një burrë tjetër, që, gjer në atë çast, kishte qenë duke pritur, u ul në karrigen përballë tij.

Dhoma e Majllsit në Palestrën Shtatë-Shtatë gjendej në katin më të lartë të ndërtesës dhe ishte një dhomë e vogël, e mobiluar si mos më keq. Por kjo si prishte punë Majllsit. Ajo përfaqësonte një fillim të dobët, një mundësi të vogël për ta nisur prapë jetën nga e para dhe për të fituar përsëri një pjesë të asaj që kishte humbur, dhe ai e dinte se kjo gjë do të kërkonte kohë e lodhje dhe rreziqe serioze. U mundua që, hëpërhë, të mos mendonte shumë për rolin e tij të dyfishtë duke iu kushtuar punës që të bëhej i dobishëm dhe që të tjerët ta pranonin me kënaqësi midis tyre, siç e kishte porositur Nolan Uejnrajti.
Së pari, filloi të mësonte ndarjen e lokaleve. Përveç sallës së barit pjesa më e madhe e katit përdhes përmbante një palestër gjimnastike dhe një për hendbollin. Në katin e dytë ishin dhoma e banjës me avull dhe të masazhit. Katin e tretë e zinin disa zyra, si dhe një numër dhomash, përdorimin e të cilave e mësoi më vonë. Kati i katërt, më i vogël se të tjerët, përmbante disa dhoma të vogla si ajo e Majllsit në të cilat antarët e klubit kalonin herë pas here natën.
Majllsi nuk pati vështirësi për t'u mësuar me punën e re të llogaritari. Ai ishte i aftë në punë dhe i kreu të gjitha punët e

prapambetura. Ai bëri me zell të gjitha shënimet e duhura në regjistrat përkatës të cilët gjer në atë kohë i kishin mbajtur pa kujdes. Më në fund, i kishte propozuar përgjegjësit që të zbatonte një sistem regjistrimi më praktik, por u tregua i kujdesshëm duke mos kërkuar lëvdata për përmirësimet që kishte bërë.
Përgjegjësi, një ish-organizues ndeshjesh boksi, i quajtur Nethensën, i cili s'e kishte të lehtë punën e zyrës, i ishte mirënjohës. Ai që akoma dhe më shumë mirënjohës ndaj Majllsit kur ky u tregua i gatshëm për të kryer punë të tjera të vogla që s'i takonin, si për shembull riorganizimin e depove dhe të metodave të inventarizimit. Nga ana e tij, Nethensëni e lejoi Majllsin të shfrytëzonte sallën e hendbollit, gjatë kohës së tij të lirë, gjë që i jepte një mundësi tjetër për t'u takuar me anëtarë të palestrës.

Më sa mund të shihte Majllsi, anëtarët e palestrës, të gjithë meshkuj, ndaheshin kryesisht në dy grupe. Në njërin grup bënin pjesë ata që i shfrytëzonin seriozisht pajisjet gjimnastikore e sportive të palestrës, duke përfshirë edhe banjat me avull dhe dhomat për masazh. Këta shkonin e vinin, secili në punë të vet dhe, me pak përjashtime, dukej se nuk e njihnin njëri-tjetrin. Majllsi mendonte se duhej të ishin punëtorë dhe nëpunës të regjistruar në palestër vetëm për ta mbajtur trupin në formë. Ai dyshonte, gjithashtu, se ky grup i shërbente si një perde tymi grupit të dytë, pjesëtarët e të cilit zakonisht nuk i shfrytëzonin veglat dhe pajisjet, përveçse, rastësisht, banjat e avullit.

Pjesëtarët e grupit të dytë mblidheshin kryesisht në sallën e barit ose në dhomat e katit të tretë. Ata ndodheshin sidomos aty në numër të madh, vonë natën, në një kohë kur pjesëtarët e tjerë, që vinin për ushtrime fizike, nuk gjendeshin pothuajse asnjëherë në palestër. Mbas pak kohe, Majllsi e kishte të qartë

se grupi i dytë përbëhej nga ajo që Nolan Uejnrajti e kishte quajtur «llumi».

Një gjë tjetër që Majllsi mësoi në pak kohë ishte se dhomat e katit të tretë përdoreshin si dhoma të fshehta kumari, ku luhej me shuma të mëdha, sidomos me karta e zare. Disave prej klientëve më të rregullt të natës u ra në sy prania e Majllsit, por u qetësuan kur LaRoka u tha se ai «ishte djalë i mirë».

Duke pasur si qëllim që të bëhej i dobishëm, Majllsi filloi të ndihmonte, kur duheshin çuar në katin e tretë pije e senduiçe. Herën e parë, njëri nga të pesë a gjashtë burrat trupmëdhenj që rrinin jashtë dhomave të kumarit — që dukej të ishin roja — ia kishte marrë tabakanë dhe e kishte futur vetë brenda; por, të nesërmen mbrëmja, sikurse dhe netët e tjera, rojat e lanë të hynte në dhomat ku po luhej kumar. Majllsi mori përsipër gjithashtu t'i blinte cigare dhe t'ia sillte lart cilitdo që kishte nevojë duke përfshirë edhe rojat.

S'kaloi shumë kohë dhe vuri re se po fitonte simpatinë e të gjithëve.

Një nga arsyet ishte gatishmëria e tij e përhershme. Një tjetër arsye ishte se po i kthehej humori i tij i gëzuar dhe i qeshur i dikurshëm, me gjithë problemet dhe rreziqet që e prisnin ngaqë ndodhej në atë vend. Një arsye tjetër ishte se Xhuls LaRoka, që dukej se i fuste hundët kudo, ishte bërë si kumbari i tij, ndonëse ai e bënte Majllsin nganjëherë ta ndjente veten si aktor të një teatri varieteje.

Ajo që vazhdonte ta tërhiqte vazhdimisht LaRokën dhe miqtë e tij të ngushtë ishin njohuritë e gjera të Majllsit itidhur me paratë. Një nga subjektet e preferuara ishte historia e parave të falsifikuara të stampuara nga qeveritë, për të cilën Majllsi kishte folur së pari kur ishte në burgun e Drumonburgut. Gjatë javëve të para që kishte kaluar në Palestrën Shtatë-Shtatë me kërkesë të LaRokës, ai e kishte përsëritur se paku nja dhjetë herë, duke ngjallur gjithmonë

komente mbi ata «hipokritët e ndyrë» dhe «ata mashtruesit e mallkuar që janë në qeveri».

Për të pasuruar fondin e tregimeve dhe anekdotave, Majllsi shkoi një ditë tek apartamenti ku kishte banuar para burgimit dhe mori librat e tij. Pjesa më e madhe e sendeve të tij të tjera ishte shitur, shumë kohë më parë, për të paguar qiranë e prapambetur, por portieri i kishte mbajtur librat dhe ia ktheu. Më parë, Majllsi kishte pasur një koleksion monedhash dhe bankënotash por më vonë e kishte shitur, kur kishte hyrë thellë në borxhe. Ai shpresonte që një ditë ta krijonte përsëri një koleksion të tillë, ndonëse kjo perspektivë dukej shumë e largët.

Me ndihmën e librave, të cilët i mbante në dhomën e tij të vogël të katit të katërt, Majllsi u foli LaRokës dhe të tjerëve mbi disa nga format më të çuditshme që kishin marrë paratë gjatë shekujve. Monedha më e rëndë që ka ekzistuar ndonjëherë, tha, ai, është një disk prej guri i përdorur në ishullin Yap, në Paqësor gjer në shpërthimin e Luftës së Dytë Botërore. Shumica e disqeve shpjegoi ai, kishin një diametër prej tridhjetë centimetrash, por njëri ishte i gjerë më se tre metra e gjysmë dhe, kur përdorej për të blerë, transportohej me anë të një purteke që futej në qendër.

— Po, për kusurin, si bëhej? — pyeti dikush në mes të të geshurave të përgjithshme.

— Majllsi u tha se, sigurisht, përdoreshin disqe më të vegjël.

— Nga ana tjetër, — monedha më e lehtë përbëhej nga lloje të rralla pendësh, të përdorura në Hebridet e Reja. Gjithashtu, për shekuj me radhë, kripa është përdorur si para, sidomos në Etiopi; romakët e përdornin për të paguar punëtorët dhe pikërisht nga fjala «salt» (kripë) rrjedh fjala «salary» (pagë, rrogë, rrodhitje). Gjer në shekullin - e

nëntëmbëdhjetë, - u shpjegoi Majllsi, - në Borneo, kafkat e njerëzve kishin vlerën e valutës të ligjshme.

Por, para se këto «konferenca» të përfundonin, biseda kthehej gjithnjë te falsifikimet.

Në një rast si ky, një nga rojat personale, që bënte dhe punën e shoferit, i cili po priste bosin e tij që po luante lart kumar, e mori Majllsin mënjanë.

– Hej, djalosh, ti që flet aq shumë për paratë e falsifikuara pa shikoje një herë këtë! – dhe i tregoi një kartëmonedhë krejt të re njëzetdollarëshe.

Majllsi e mori kartëmonedhën dhe e shikoi me kujdes. Kjo s'ishte gjë e re për të. Duke qenë aq ekspert në këto çështje, kur punonte në Fërst Merkentajll Amerikën Benk, bankënotat e dyshimta ia sillnin gjithmonë atij për t'i parë.

Gorilla po ngërdheshej.

– Jo keq eh, ç'thua?

– Po qe se është e falsifikuar, – tha Majllsi, – kjo është më e mira që kam parë ndonjëherë.

– Kam dhe të tjera si kjo, në qoftë se dëshiron të blesh – dhe roja personale nxori nga një xhep i brendshëm nëntë bankënotat njëzetdollarëshe, të njëjta me të parën. – Djalosh, më jep dyzet dollarë të mirë dhe këto të dyqind janë të tutë.

Majllsi e dinte se aq ishte, në atë kohë, kursi i këmbimit i bankënotave të falsifikuara të cilësisë shumë të mirë. Ai vërejti, gjithashtu, se edhe të tjerat ishin po aq të mira sa dhe e para.

Ngurroi pikërisht në çastin kur gati po e refuzonte ofertën. Ai s'kishte aspak ndërmend të merrej me para të falsifikuara, por i shkoi në mend se mund t'ia dërgonte Uejnrajtit.

– Prit një çast! – i tha gorillës. Shkoi me vrap lart në dhomën e tij, ku mbante të fshehur një sasi të hollash pak më të madhe se dyzet dollarë, të përbërë pjesërisht nga mbetja e paradhënies prej pesëdhjetë dollarësh që i kishte dhënë Uejnrajti, pjesërisht nga bakshishet që i kishin dhënë kumarxhinjtë.

Të nesërmen, ndërsa ishte te tryeza e tij e punës, në një nga zyrat e katit të tretë, Xhuls LaRoka iu afrua dhe i tha duke u ngërdheshur:

– Dëgjova se ia ke nisur tregtisë.

– Pak, – pranoi ai.

LaRoka e afroi më pranë barkun e tij sa një vozë dhe e uli zërin: – A të pëlqen të bësh edhe ndonjë punë tjetër tregtie?

Në mënyrë të matur, Majllsi u përgjigj:

– Varet se çfarë lloj pune është.

– Një udhëtim i vogël për në Luisvil. Të shpiesh atje pak nga ai malli që bleve mbrëmë.

Majllsi ndjeu një shtrëngim në stomak. Po të pranonte dhe ta kapnin, jo vetëm që do të kthehej në burg, por do të mbetej brenda më shumë kohë se herën e parë. Nga ana tjetër, në rast se nuk pranonte t'i hynte këtij rreziku, do të kishte mundësi të fitonte besim të mëtejshëm dhe të mësonte gjëra të tjera?

E vetmja gjë për t'u bërë është të ngasësh një makinë prej këtu atje dhe, pastaj, do të marrësh dyqind dollarë.

– Po më ndali policia? Ti e di se jam në liri të mbikëqyrur dhe s'ma kthyen patentën.

– Patenta s'është problem, mjaft që të kesh një fotografi për dokumente.

– Nuk kam, por mund ta bëj.

– Bëje shpejt.

Gjatë pushimit të drekës, Majllsi shkoi te një stacion i afërt autobusi, kur bëri një fotografi me një aparat automatik. Po atë pasdite ia dha LaRokës.

Pas dy ditësh, ndërsa po punonte, përsëri një dorë vendosi në heshtje një kartë katërkëndëshe në regjistrin para tij. Majllsi i habitur pa se ishte një patentë shtetërore me fotografinë e tij.

Ktheu kokën. Prapa tij ishte LaRoka që po ngërdheshej.

– Më mirë se zyra e patentave, ç'thua?

Majllsi tha me mosbesim:

– Do të thuash se është e falsifikuar?

– Ti, a mund ta dallosh?

– Jo nuk mundem. – Majllsi shikoi patentën, që kishte pamje krejtësisht të njëjtë me një patentë të rregullt zyrtare.

— Si e rregullove këtë punë?
— S'ka rëndësi.
— Jo, me të vërtetë do të doja ta dija. Ti e di që unë interesohem shumë për gjëra të kësaj natyre.
Fytyra e LaRokës u ngrys dhe, për herë të parë, sytë e tij shprehnin dyshim.
— Pse dëshiron ta dish?
— Ta thashë. Interesohem për këto gjëra. Majllsi shpresonte të mos e linte t'i dukej shqetësimi që po ndiente përbrenda.
— Ka pyetje që s'duhen bërë. Kur dikush pyet tepër, njerëzit fillojnë të mendojnë për këtë dhe atij mund t'i ndodhë diçka.
Majllsi ndenji në heshtje, ndërsa LaRoka e vështronte. Pas pak, u duk se çasti i dyshimit kaloi.
— Është për nesër mbrëma, — tha LaRoka. — Në kohën e duhur do të të thonë, se ç'duhet të bësh dhe kur.
Të nesërmen mbrëma, Majllsi mori udhëzimet përsëri nga lajmëtari i përhershëm. LaRoka, i cili i dha çelësat e një makine, faturën e një parkimi dhe një biletë avioni vetëm për një rrugë. Aty nga mbrëmja, Majllsi duhet të merrte makinën

(një shevrolet «Impala» ngjyrë gështenjë), të dilte nga parku i makinave dhe të vazhdonte rrugën natën për në Luisvil. Me të mbërritur atje, të shkonte në aeroportin e Luisvilit dhe aty të parkonte makinën, duke i lënë biletën e parkimit të aeroportit dhe çelësat nën ndenjësen e përparme. Para se ta linte makinën, duhej të fshinte me kujdes të gjitha gjurmët e gishtave të tij dhe, më në fund, të kthehej me avionin e parë të mëngjesit.

Çastet më të vështira për Majllsin qenë ato në fillim, kur po dilte nga parku. Ai ishte shumë i tronditur dhe thoshte me vete: Po sikur policia ta kishte shevroletin nën mbikëqyrje? Ndoshta personi që e kishte ngarë më parë ishte njeri i dyshimtë dhe policia e kishte ndjekur deri atje, duke qëndruar pastaj në pritje e duke vëzhguar zhvillimet e ngjarjes. Majllsi e kishte të qartë se rreziku i kësaj pune ishte i madh, përndryshe nuk do t'ia kishin besuar detyrën e korrierit një njeriu si ai. Dhe, megjithëse nuk kishte të dhëna të sigurta, ai e merrte me mend se paratë e falsifikuara — me shumë të ngjarë në sasi të madhe — gjendeshin në portbagazhin prapa.
Nuk ndodhi asgjë nga ato që kishte pasur frikë, por ai filloi të qetësohej vetëm kur u largua mjaft nga parku dhe arriti pranë kufijve të qytetit.
Në dy raste të ndryshme, në autostradë, filloi t'i rrihte zemra me forcë, kur kaluan makina patrullimi të policisë shtetërore, por askush nuk e ndali, dhe ai mbërriti në Luisvil, pak para agimit, mbas një udhëtimi monoton.
Vetëm një gjë ndodhi që s'ishte e planifikuar. Nja pesëdhjetë kilometra nga Luisvili, akoma në autostradë, Majllsi kishte hyrë në një zonë parkimi. Në errësirë, vetëm me dritën e një elektriku dore, ai e kishte hapur portbagazhin e shevroletit. Aty gjendeshin dy valixhe të rënda, të mbyllura me brava të mira. Për një çast kishte menduar ta hapte me forcë bravën e njërës prej tyre; mirëpo, pastaj, e kishte kuptuar se po të bënte ashtu do ta rrezikonte mjaft veten. Atëherë, e kishte mbyllur përsëri portbagazhin, kishte kopjuar numrin e targës dhe kishte vazhduar udhëtimin.

E gjeti pa vështirësi aeroportin, dhe, pasi i kreu të gjitha udhëzimet, hipi në një avion dhe, para orës dhjetë, gjendej përsëri në Palestrën Shtatë-Shtatë. Askush nuk e pyeti për mungesën e tij.
Gjatë tërë pjesës tjetër të ditës, Majllsi e ndjente veten të këputur nga mungesa e gjumit, por prapëseprapë, ai mundi ta vazhdonte punën. Mbasdite mbërriti LaRoka, tërë qejf, me një puro të trashë në gojë.
— Ke bërë një punë të mirë e të pastër, Majlls. Të gjithë janë shumë të kënaqur.
— Shumë mirë, — tha Majllsi. — Kur do t'i marr të dyqind dollarët?
— I ke marrë. I mori Ominski. Shkojnë në llogari të shumës që i detyrohesh atij.
Majllsi psherëtiu. Duhej ta kishte pritur një gjë të tillë, ndonëse dukej ironike të rrezikonte aq shumë vetëm që të përfitonte fajdexhiu. Ai pyeti LaRokën:
— Nga e mori vesh Ominski?
— Janë të paka ata gjëra që nuk i di ai.
— Para një çasti the se të gjithë kanë mbetur të kënaqur. Kush të gjithë? Në qoftë se bëj një punë si ajo që bëra mbrëmë, do të më pëlqente të dija se për kë e bëj.

– Ta thashë një herë se ka gjëra që nuk është mirë të dihen ose të pyetet për to.
– E kuptova.
Ishte e qartë se qe e pamundur të mësonte gjë tjetër. Majllsi u mundua t'i buzëqeshte LaRokës, ndonëse humori gazmor ia kishte lënë vendin depresionit. Udhëtimi gjatë natës kishte qenë një lodhje e madhe dhe, me gjithë rreziqet serioze që kishte marrë përsipër, e kishte të qartë se kishte mësuar shumë pak gjëra.
Nja dyzet e tetë orë më vonë, akoma i lodhur dhe i dekurajuar, ai i foli Huanitës për dyshimet e tij.

Gjatë muajit që kishte kaluar, nga dita kur kishte filluar punën në Palestrën Shtatë-Shtatë, Majlls Istini ishte takuar dy herë me Huanitën.

Herën e parë — pak ditë pasi Huanita kishte folur me Nolan Uejnrajtin dhe kishte pranuar të luante rolin e ndërmjetëses midis atij dhe Majllsit — të dy nuk e kishin ndier veten të shpenguar. Ndonëse telefoni ishte instaluar me të shpejtë në apartamentin e saj, siç kishte premtuar Uejnrajti, Majllsi s'kishte pasur dijeni për këtë dhe, një mbrëmje kishte marrë autobusin dhe kishte vajtur tek ajo, pa pasur mundësi ta njoftonte më parë. Mbasi kishte shikuar me kujdes te dera, pjesërisht e hapur e apartamentit, Huanita kishte hequr zinxhirin e sigurimit dhe e kishte futur brenda.
– Mirëmbrëma, — kishte thënë Estela. Vajza e vogël brune, Huanita në miniaturë, kishte ngritur sytë e saj të mëdhenj nga një libër me figura dhe po vështronte Majllsin. — Ti je ai burri thanatik që ke ardhur dhe më parë te ne. Tani je më i ngjallur.
– E di, — tha Majllsi. — Kam ngrënë një ushqim magjik, që është për viganë.
Estela qeshi tërë gaz, ndërsa Huanita ishte e vrenjtur. Ai i tha, me një ton që kërkonte ndjesë:
– S'kisha mundësi të të njoftoja se do të vija, por zoti Uejnrajt më tha se më prisje.
– Ai hipokriti!

– Nuk të pëlqen?
– E urrej.
– Unë jo, megjithëse nuk mendoj se është i përsosur. Ka një punë që duhet ta bëjë, apo jo?
– Atëherë, le ta bëjë vetë, pa shfrytëzuar të tjerët.
– Në qoftë se je e këtij mendimi, pse pranove...?
Huanita ia priti:
– Kujton se nuk ia kam bërë edhe unë këtë pyetje vetes? Maldito sea el dia que lo conosi. Atë premtim e bëra në një çast marrëzie, dhe jam penduar.
– S'është nevoja të pendohesh. Askush s'të ndalon të tërhieqesh. — Zëri i Majllsit ishte dashamirës. — Do t'ia shpjegoj unë Uejnrajtit. — Ai u nis drejt derës.
Zemërimi i Huanitës u kthye drejt tij.

– Ashtu, eh? Dhe kujt do t'ia transmetosh mesazhet e tua? — Ajo tundi kokën, e pezmatuar. — Mos ishe i marrë kur pranove një marrëzi të tillë?
– Jo, — tha Majllsi, — E pashë si një mundësi; në njëfarë mënyre, si të vetmen mundësi që më mbetej. Por, s'ka arsye që në këtë çështje të mpleksesh edhe ti. Kur sugjerova emrin tënd, nuk u mendova mirë. Më fal.
– Mami, — ndërhyri Estela, — pse je kaq e zemëruar?
Huanita u përkul dhe përqafoi të bijën.
No te preocupes, mi cielo. Jam e zemëruar me jetën, vogëlushja ime. Zemërohem duke parë se ç'i bëjnë njerëzit njëri-tjetrit. — Pastaj papritur, i tha Majllsit: — Eja, ulu!
– Me gjithë mend e ke?
– Ç'farë? Nëse dua që ti të ulesh? Jo, nuk e kam me gjithë mend. Por, ulu!
Ai u bind.
– Më pëlqen temperamenti yt, Huanita. — Majllsi buzëqeshi dhe ajo mendoi se, për një çast, ai u bë krejt i ngjashëm me Majlls Istinin e dikurshëm, kur punonte në bankë. Ai vazhdoi: — Veç kësaj, më pëlqejnë dhe gjëra të tjera të tuat. Po qe se do ta dish të vërtetën, arsyeja se pse ia sugjerova emrin tënd Uejnrajtit është se kështu do të kisha mundësi të të shihja përsëri.

— Mirë, tani më pe. — Huanita kishte ngritur supet. — Dhe mendoj se do të më shohësh prapë. Prandaj, zbraze raportin tënd të agjentit të fshehtë dhe unë do t'ia transmetoj zotit «merimangë» Uejnrajt, gjithnjë i zënë me endjen e rrjetave të tij.
— E bukura me raportin tim është se nuk kam raport për të bërë. Së paku, jo akoma. Majllsi i foli asaj për Palestrën Shtatë-Shtatë, për pamjen dhe erën që binte atje, ndërsa Huanita shtrembëronte hundën me neveri. Ai i përshkroi, gjithashtu, takimin me Xhuls LaRokën, bisedën me fajdexhiun, rusin Ominski, dhe marrjen e tij në punë si llogaritar. Duke qenë se punonte vetëm prej pak ditësh në Palestrën Shtatë-Shtatë, këto ishin të gjitha që kishte për të raportuar. — Por, së paku,

u futa brenda, siç dëshironte Uejnrajti, — i tha ai Huanitës.
— Të hysh brenda është nganjëherë e lehtë, — tha ajo, — siç ndodh me koshin prej thuprash për karavidhet. Vështirë është të dalësh.
Estela kishte dëgjuar me vëmendje. Pastaj, ajo e pyeti:
— A do të vish prapë?
— Nuk e di. — Ai i hodhi një vështrim pyetës Huanitës, që po i shikonte të dy dhe, pastaj, psherëtiu.
— Si, amorcito!, — i tha ajo Estelës. — Po, do të vijë.
Huanita shkoi në dhomën e fjetjes dhe u kthye me dy zarfet që i kishte dhënë Nolan Uejnrajti. Ajo ia dha ato Majllsit.
— Këto janë për ty.
Zarfi më i madh përmbante para; tjetri, letërkreditin Kiçarxh, lëshuar në emrin e H.E.Lynkolpit. Ajo i shpjegoi mënyrën se si mund të përdorej letërkrediti, si sinjal për të kërkuar ndihmë.
Majllsi futi në xhep letërkreditin, por zarfin me para ia ktheu Huanitës.
— Mbaje ti. Po të ma shohin, mund të fillojnë të dyshojnë. Përdori këto para për vete dhe për Estelën. Unë të jam i detyruar.
Huanita ngurroi. Pastaj, me një zë më të ëmbël se pak më parë, tha:
— Po i mbaj për ty, kur të kesh nevojë.

Të nesërmen, në Fërst Merkentajll Ëmerikën Benk, Huanita ishte lidhur me Nolan Uejnrajtin me një telefon të brendshëm dhe i kishte dhënë raport, duke pasur kujdes që të mos zinte me gojë as emrin e vet, as atë të Majllsit dhe as Palestrën Shtatë-Shtatë. Uejnrajti e kishte falënderuar dhe kaq kishte qenë e gjitha.

Takimi i dytë i Huanitës me Majllsin u bë një javë e gjysmë më vonë, një të shtunë pasdite. Kësaj here, Majllsi kishte telefonuar më parë, për ta njoftuar dhe, kur mbërriti, si Huanita ashtu edhe Estela iu dukën të kënaqura që po e shihnin. Ato ishin bërë gati të shkonin për të psonisur. Ai i

shoqëroi dhe, pasi u sorollatën një kohë në tregun e pambuluar, Huanita bleu salsiçe dhe një lakër. Ajo i tha Majllsit:
— Janë për darkën tonë. — Dëshiron të rrish me ne.
Ai iu përgjigj se donte, duke shtuar se mund të kthehej në Palestër natën vonë, ose dhe të nesërmen në mëngjes.
Ndërsa po ecnin, Estela i tha Majllsit papritur:
— Unë të kam xhan. — Pastaj, ajo kapi dorën e tij me dorën e saj të vogël dhe kështu ecën gjatë gjithë rrugës. Kur e vuri re këtë, Huanita buzëqeshi.
Darka kaloi në mënyrë gazmore, si midis miqsh të vjetër. Pastaj, Estela, vajti të flinte pasi i dha Majllsit puthjen e natës së mirë. Kur mbeti vetëm me Huanitën, Majllsi i raportoi gjërat që ajo duhej t'i transmetonte Uejnrajtit. Ishin ulur pranë njëri-tjetrit, në divan. Kur ai mbaroi, Huanita u kthye nga ai dhe i tha:
— Po deshe, mund të rrish këtu sonte.
— Herën tjetër që ndenja, ti fjete te dhoma, atje. — Ai bëri me shenjë nga dhoma e fjetjes.
— Kësaj here do të rri këtu. Estela ka gjumë të rëndë; ajo nuk do të na shqetësojë.
Majllsi hapi krahët dhe ajo u fut me kënaqësi brenda tyre. Buzët e saj pakëz të hapura, të ngrohta, të njoma dhe sensuale ishin si një parashije gjërash akoma më të ëmbla që do ta ndiqnin. Ndërsa e mbante të shtrënguar, Majllsi e ndjente frymëmarrjen e saj të shpejtohej, ndjente trupin e saj të vogël, si atë të një vajze të mitur, të dridhej nga pasioni i përmbajtur për një kohë tepër të gjatë. Kur u shtrënguan edhe më shumë në krahët e njëri-tjetrit dhe duart e tij filluan të lëviznin andej-këtej, Huanita pshërëtiu thellë, duke shijuar valën e njëpasnjëshme të kënaqësisë dhe me parashijen e ekstazës që do të vinte.

Dy javë më vonë. Edhe kësaj here ishte e shtunë pasdite. Majllsi kishte zbuluar se kjo ishte koha më e përshtatshme për t'u larguar nga Palestra Shtatë-Shtatë, pa rënë në sy mungesa e tij. Ishte akoma i lodhur nga udhëtimi rraskapitës i Luisvilit dhe i dekurajuar për shkak se s'po zbulonte gjë.

Huanita e dëgjoi raportin e tij dhe, pastaj, ai i foli për pasigurinë që ndjente.

— S'po zbuloj asgjë të rëndësishme. Është e vërtetë se tani jap e marr me Xhuls LaRokën dhe me atë tjetrin që më shiti njëzet dollarët e falsifikuar, por këta janë peshq të vegjël dhe pa ndonjë rëndësi. Nga ana tjetër, kur i bëj pyetje LaRokës, si për shembull se prej nga kish-shte ardhur patenta e falsifikuar, ai mbyllet krejt dhe fillon të dyshojë. Përsa u përket peshqve të mëdhenj, si edhe ç'ka prapa Palestrës Shtatë-Shtatë, tani nuk di asgjë më shumë se sa dija kur fillova.

— Sigurisht që s'mund t'i zbulosh të gjitha në një muaj.

— Ndoshta s'ka asgjë për t'u zbuluar, ose, së paku, asgjë nga ato që dëshiron Uejnrajti.

— Ndoshta jo. Por, në qoftë se është kështu, ky nuk është faj i yt. Veç kësaj, ka mundësi që ti të kesh zbuluar më shumë gjëra se sa mendon. Kemi paratë e falsifikuara që më ke dhënë, numrin e targës së makinës me të cilën shkove...

— E cila ka të ngjarë të ketë qenë e vjedhur.

— Le ta zbulojë këtë zoti Sherlok Holms Uejnrajti. — Huanitës i erdhi një mendim: — Po bileta jote e avionit? Ajo që të dhanë për t'u kthyer?

— E përdora.

— Sigurisht, por duhet të kesh matrikulën.

— Ndoshta e... — Majllsi kërkoi nëpër xhepat e xhaketës, e cila qe e njëjta që kishte pasur gjatë udhëtimit në Luisvil.

Gjeti zarfin e shoqërisë ajrore dhe, brenda tij, matrikulën e biletës.

Huanita i mori të dyja.

— Ndoshta ka ndonjë njeri që mund të nxjerrë diçka nga këto. Dhe do të kërkoj të të kthejnë të dyet do-llarët që pagove për paratë e falsifikuara.

— Po kujdesesh shumë për mua.

— Por kë no! Ma se duket, dikush duhet ta bëjë kë-të.

Në atë çast hyri Estela, që kishte qenë te një shoqe e saj, në një apartament aty pranë.

— Mirëmbrëma, — i tha ajo. — A do të rrish përsë-ri?

— Jo sot, — iu përgjigj ai. — Do të largohem mbas pak.

Huanita ndërhyri përsëri menjëherë:

— Ç'arsye ke?

— Asnjë arsye. Vetëm se mendova...

— Atëherë, do të rrish këtu për darkë. Estela do të kënaqet.

— Oh, sa mirë! — thirri Estela. — Ajo e pyeti Majllsin: — A do të më lexosh një përrallë?

Kur ai i tha se po, ajo solli një libër dhe hipi mbi gjurin e Majllsllt.

Pas darke, para se Estela t'u thoshte natën e mirë dhe të shkonte për të fjetur, Majllsi i lexoi edhe një pë-rrallë tjetër.

— Je njeri i mirë, — i tha Huanita, kur po dilte nga dhoma e fjetjes duke mbyllur derën nga pas. Më parë, ndërsa ajo po bëhej gati të çonte vajzën në shtrat, Majllsi ishte ngritur për t'u përshëndetur, po ajo ia kishte bërë me shenjë të ulej, duke thënë:

— Jo, rri.

— Të faleminderit, Huanita. — Majllsi pa se ajo po qante dhe vuri re se edhe nga sytë e tij po rridhnin lot.

— Dua t'ju bëj dy pyetje, — tha Aleks Vandervurti. Zëri tij ishte më pak energjik se zakonisht. Mendjen e kishte të shqetësuar dhe pak të trullosur nga gjërat që sapo kishte lexuar. — E para: Për hir të zotit, më thoni si mundët t'i gjeni të gjitha këto informata? E dyta: Sa të besueshme janë, pra, sa mund të mbështetesh në to?

— Në qoftë se s'keni kundërshtim, — tha Vernon Xheksi, do t'u përgjigjem pyetjeve tuaja, duke filluar nga e dyta.

Ata ishin në zyrën e Aleksit, në grataciellin e Drejtorisë Qendrore të FMA-së. Ishte gati mbrëmje dhe rreth tyre ishte qetësi, mbasi pjesa më e madhe e personelit të katit të 36-të kishte shkuar tanimë në shtëpi.

Gjurmuesi privat, të cilin e kishte ngarkuar para një muaji të bënte një studim të pavarur mbi gjendjen e sipërmarrjes «Korporejshënit — një «punë spiunazhi nga jashtë», siç kishin qenë të një mendjeje se ishte më e drejtë të quhej — kishte pritur qetësisht, duke lexuar një gazetë që Aleksi ta mbaronte së shikuari raportin që ia kishte dorëzuar vetë: shtatëdhjetë faqe, përveç një shtojce me dokumente të fotokopjuara. Paraqitja e Vernon Xheksit ishte edhe më e lënë pas dore — nëse një gjë e tillë mund të bëhej — se herën e mëparshme. Kostumin blu që kishte veshur, me stofin që kishte marrë shkëlqim nga përdorimi, do ta kishte refuzuar edhe Ushtria e Shpëtimit. Çorapet i binin mbi nyjat e këmbëve. Këpucët ishin në një gjendje edhe më të keqe se radhën e kaluar. Ata pak flokë që i kishin mbetur gati në kafkën gati tullace, ishin të ngritur lart e të parregulluar, si një furçë që ka mbetur me pak qime nga përdorimi i gjatë. Sidoqoftë, ishte po aq e qartë se ajo që Xheksit i mungonte në veshje elegante dhe paraqitje të

mirë, plotësohej me aftësinë e tij në fushën e spiunazhit.
— Së pari, përsa i përket besueshmërisë së informatave dhe sa mund të mbështetesh në to, — tha ai. — Po qe se doni të dini nëse faktet që kam paraqitur mund të përdoren, në trajtën e tyre të tanishme, si prova para gjyqit, përgjigjja është jo. Por, jam i sigurt se informatat janë të sakta, sepse s'kam futur në raport asnjë informatë pa u konsultuar më parë dy burime të sigurta dhe, në disa raste, edhe tre. Edhe një gjë tjetër: nami si gjurmues, i aftë për të zbuluar të vërtetën, është kualifikimi im profesional më i rëndësishëm. Ky është një nam i mirë, të cilin kam ndërmend ta ruaj.

Pastaj, ju doni të dini se si kam mundur t'i siguroj të gjitha këto informata. Këtë pyetje ma bëjnë shpesh njerëzit për të cilët punoj. Mendoj se keni të drejtë të kërkoni një shpjegim, megjithëse disa hollësi do t'i mbaj për vete, nën etiketën e «sekretit profesional» dhe të «mbulimit të burimeve».
Kam punuar për njëzet vjet në Ministrinë e Thesarit, pjesën më të madhe të kohës si inspektor finance, dhe i mbaj akoma lidhjet me persona të ndryshëm që kam njohur atje dhe në shumë vende të tjera. Pak njerëz e dinë, zoti Vandervurt, se një nga mënyrat që përdor një gjurmues është ajo me anë të shkëmbimit të informatave rezervate dhe, në punën time, njeriu nuk mund ta dijë kurrë se kur mund të ketë nevojë për të tjerët, ose ata për atë. Ta zëmë se, këtë javë, ju ndihmoni dikë; herët a vonë, ai do t'jua lajë këtë borxh. Në këtë mënyrë, krijohen debitet dhe kreditet, dhe bilanci, nga njëra palë ose tjetra, bëhet me anë të dhënies së informatave të fshehta. Prandaj, kur ndokush më angazhon në një punë, unë nuk shes vetëm aftësinë time në fushën e financës, gjë që më pëlqen të mendoj se është mjaft e mirë, por edhe një rrjet kontaktesh. Disa prej tyre mund t'ju habisin.

— Sa për sot, jam habitur mjaft, — tha Aleksi, duke bërë me shenjë nga raporti që kishte përpara.
— Sidoqoftë, — tha Xheksi, — pjesën më të madhe të informatave e kam siguruar në mënyrën që ju thashë. Pjesën tjetër e nxora duke i vënë shpatullat punës, me durim dhe duke e ditur se në ç'vrima duhej kërkuar.
— E kuptoj.
— Ka edhe një gjë tjetër që dua të sqaroj, zoti Vandervurt. Mendoj se mund të quhet krenari personale. Kam vënë re se, në të dy takimet tona, më keni vështruar në një mënyrë, sikur pamja ime nuk ju ka bërë ndonjë përshtypje kush e di se çfarë. Unë preferoj t'u paraqitem kështu njerëzve, sepse ka të ngjarë që një njeri me pamje të lënë pas dore dhe që s'bie në sy, nuk tërheq vëmendjen ose nuk merret seriozisht prej atyre, nga të cilët dëshiron të nxjerrë të dhëna. Ka edhe një përparësi tjetër, mbasi ata me të cilët bisedoj nuk më vënë rëndësi dhe nuk tregohen të matur. Në qoftë se do të paraqitesha me një pamje si tuajën, do të ndodhte e kundërta. Kjo është arsyeja, por desha t'ju them edhe diçka: ditën që do të më ftoni në dasmën e vajzës suaj, do të jem po aq elegant sa cilido i ftuar tjetër që do të keni.
— Do ta kem parasysh, — tha Aleksi, — po qe se do të kem ndonjëherë një vajzë.
Pasi u largua Xheksi, Aleksi e studioi përsëri raportin me të dhënat aq tronditëse. Ai ishte i mbushur, mendoi Aleksi, me ngatërresat më serioze lidhur me Fërst Merkëntajll Ëmerikën Benkun. Godina e fuqishme e Suprënejshnël Korporejshënit — SuNatKo-ja ishte plot me plasaritje e të çara, gati për t'u shembur.
Aleksit iu kujtua se si Luis d'Orseji kishte folur për fjalë që ishin përhapur mbi «humbje të mëdha, që nuk ishin shpallur... veprime llogarish jo të rregullta midis degëve... Xhorxhi i

madh Kuorpermejn që po orvatej në Uashington për të siguruar një subvencion qeveritar, si ai që i ishte dhënë shoqërisë Lokhid. Vernon Xheksi i kishte vërtetuar të gjitha dhe kishte zbuluar edhe shumë gjëra të tjera.
Aleksi mendoi, se, atë ditë, ishte tepër vonë për të marrë ndonjë masë. Por, i mbetej e tërë nata për t'u menduar për mënyrën më të mirë se si t'i përdorte informatat që kishte marrë.

Fytyra, zakonisht kuqalashe e Xherom Petërtonit u bë mavi. Ai kundërshtoi:
— E marrtë djalli! Kjo që më kërkon është qesharake.
— Nuk po ta kërkoj. — Zëri i Aleksit ishte i tendosur nga zemërimi që e kishte pushtuar që një ditë më parë. — Po, të them ta bësh!
— E ç'ndryshim ka nga ta kërkosh apo ta thuash? Ti do që unë të bëj një veprim arbitrar, pa pasur ndonjë arsye konkrete.
— Do të të jap më vonë plot arsye, më se konkrete. Tani për tani s'ka kohë.
Ata ishin në zyrën e presidentit të FMA-së, ku Petërtoni, kur kishte ardhur në mëngjes, kishte gjetur Aleksin që po e priste.

— Ka pesëdhjetë minuta që është hapur Bursa e Nju Jorkut, — e paralajmëroi Aleksi. — Kemi humbur tanimë shumë kohë dhe po humbasim akoma. Ti je i vetmi njeri që mund t'i japë urdhër seksionit fiduciar t'i shesë të gjitha aksionet e SuNatKo-s që kemi.
— Nuk do ta bëj këtë! — Petërsoni e kishte ngritur zërin. — Dhe, në fund të fundit, ç'djalë është kjo punë? Kush kujton ti se je që na vjen këtu me pallë zhveshur dhe jep urdhra...
Aleksi hodhi një vështrim prapa tij — dera e zyrës ishte e hapur. Ai e mbylli dhe u kthye përsëri pranë tryezës së punës.
— Do të ta them unë se kush jam, Xherom. Jam ai që të

paralajmëroi ty dhe tërë këshillin administrativ kundër rrezikut që vinte nga dhënia SuNatKo-s një hua tepër të madhe. Jam ai që e kundërshtoi me të gjitha forcat blerjen me shumicë të aksioneve të SuNatKo-s, por askush, po ashtu dhe vetë ti, s'deshi të dëgjonte. Dhe tani, Suprënejshnëli po shembet. — Aleksi u përkul përpara te tryeza dhe i dha tryezës goditje të fortë me grusht. Fytyra e tij, me sytë që i lëshonin shkëndija ishte shumë pranë asaj të Petërtonit. — Nuk e kupton? Suprënejshnëli mund të tërheqë me vete në greminë edhe bankën tonë.

Petërtoni u trondit. E lëshoi veten rëndë në kolltukun prapa tryezës.

— A është me të vërtetë në gjendje kaq të vështirë SuNatKo-ja? A je i sigurt?

— Po të mos isha, mendon ti se do të vija këtu dhe do të sillesha në këtë mënyrë? Nuk e kupton se po të jap një mundësi për të shpëtuar diçka nga katastrofa që po vjen? — Aleksi bëri me shenjë nga ora e tij e dorës. — Ka kaluar tanimë një orë që kur është hapur Bursa. Xherom merre telefonin dhe jepe atë urdhrin!

Muskujt e faqeve të presidentit të FMA-së u kontraktuan me nervozizëm. Duke mos qenë një tip i vendosur, ai më shumë kundërvepronte ndaj situatave ekzistuese se sa i krijonte ato. Shpesh ndodhte që ndikimi i fortë i një tjetri ta përkulte, siç po ndodhte tani me Aleksin.

— Për hir të zotit, Aleks, për të mirën tënde, shpresoj që e di se ç'po bën. — Petërtoni zgjati dorën drejt njërit nga të receptorët e telefonave që kishte në tryezë, ngurroi për një çast, pastaj e ngriti.

— Më jep Miçellin, në seksionin fiduciar... Jo, po pres... Miçi? Jam Xheromi. — Më dëgjo me kujdes: Dua t'i shesësh menjëherë të gjitha aksionet e Suprënejshnëlit që kemi... Po,

t'i shesësh, të gjitha. — Dëgjoi pak dhe, pastaj, tha me padurim: — Po, e di se çfarë jehone do të ketë në Bursë dhe e di edhe se çmimi është që tani i ulët. I pashe kuotat e djeshme. Do të kemi humbje, por, prapëseprapë, shiti... Po, e di se nuk është e rregullt. — Ngriti sytë nga Aleksi, si për t'u siguruar. Dora që mbante receptorin i dridhej. — Nuk ka kohë për të bërë mbledhje. Shiti! Mos humb kohë... Po, e marr unë përgjegjësinë.
Pasi vuri në vend receptorin, mbushi një gotë me ujë dhe e piu me një frymë. Pastaj, u kthye nga Aleksi.
— E dëgjove çfarë thashë. Kuota është e ulët dhe shitja jonë do ta ulë edhe më shumë. Do të pësojmë një humbje të mirë.
— Gabohesh, — e korrigjoi Aleksi. — Humbjen do ta pësojnë klientët tanë që patën besim te ne dhe na dhanë kapitalet e tyre për t'i administruar. Dhe, po të kishim pritur edhe pak, humbja do të kishte qenë më e madhe. Sidoqoftë, edhe tani, nuk do të shpëtojmë pa gjë. Brenda një jave, SEC-i mund t'i anulojë këto shitje.
— T'i anulojë? Pse?
— Mund të pretendojë, me plot të drejtë, se e kemi mbajtur për vete një informatë rezervate, që do të kishte bllokuar tregtimin e aksioneve të SuNatKo-s.
— Cilën informatë?
— Se Suprënejshnëli është në prag të falimentimit.
— O zot! — Petërtoni brofi në këmbë dhe u kthye nga ana tjetër, duke murmuritur me vete: — SuNatKo-ja! Jezu Krisht! SuNatKo-ja! U kthye përsëri nga Aleksi dhe e pyeti: — Po huaja jonë? Të pesëdhjetë milionë dollarët?
— E verifikova. Pothuajse të gjithë sasinë e kreditit e kanë tërhequr.
— Po bilanci i kompensimit?
— Ka mbetur diçka më pak se një milion.

Ata mbetën për disa çaste në heshtje, pastaj Petërtoni psherëtiu thellë. Befas ishte qetësuar.
— The se kishe arsye konkrete. Pra, duhet të dish diçka. Do të ishte më mirë të ma thoshe.
— Do të ishte më e thjeshtë në qoftë se lexon këtë. — Aleksi vendosi mbi tryezën e presidentit raportin e Xheksit.
— Do ta lexoj pastaj. Tani më thuaj ti se çfarë është dhe ç'ka në të.
Aleksi i tregoi për fjalët që qarkullonin, për të cilat i kishte folur Luis d'Orseji, lidhur me Suprënejshnëlin dhe për vendimin e tij për të angazhuar për këtë çështje një gjurmues, Vernon Xheksin.
— Ato që ka raportuar Xheksi qëndrojnë, — deklaroi Aleksi.
— Mbrëmë dhe sot në mëngjes, telefonova në disa vende për të pasur konfirmimin e disa pohimeve të tij të veçanta. Gjithçka përputhet. Fakti është se një pjesë e mirë e elementeve që përmbahen në raport mund të zbuloheshin nga cilido me punë të durueshme kërkimi, vetëm se kjo s'u bë nga askush dhe asnjeri s'i bashkoi bashkë elementet e ndryshme. Veç kësaj, Xheksi ka siguruar informata rezervate, duke përfshirë edhe fotokopje dokumentesh. Mendoj se...
Petërtoni e ndërpreu, me ton të mërzitur:
— Mirë, mirë. I lëmë këto një herë. Më thuaj thelbin e çështjes.
— Po ta them me pak fjalë: Suprënejshnëli është pa asnjë qindarkë. Gjatë këtyre tre vjetëve të fundit ka pësuar humbje shumë të mëdha dhe ka mundur të qëndrojë në këmbë në sajë të prestigjit që ka pasur dhe të kredive. Ka kërkuar dhe ka marrë borxhe shumë të mëdha për të larë huatë dhe, pastaj, ka marrë përsëri hua për të larë këto huatë e fundit, e kështu me radhë. Ajo që i mungon janë paratë në dorë.
Petërtoni u hodh:

— Po SuNatKo-ja ka pasur gjithnjë fitime shumë të mira, nga viti në vit, dhe s'ka lënë pa shlyer asnjë aksionist.
— Përkundrazi, tani del se shlyerjet e fundit janë bërë në sajë të huave. Pjesa tjetër përbëhet nga maskime dhe dallavere llogarie. Të gjithë e dimë se si bëhen këto gjëra. Shumë nga shoqëritë më të mëdha dhe më me zë përdorin të njëjtat metoda.
Presidenti i bankës u mendua pak pas këtij pohimi të fundit dhe, pastaj, tha me fytyrë të ngrysur:
— Një herë e një kohë, firma e kryellogaritarit në një fletë bilanci ishte sinonim me ndershmërinë. Kjo s'ndodh më. Aleksi vuri gishtin mbi raportin e Xheksit, që gjendej ndërmjet tyre, në tryezë, dhe tha: – Këtu ka shembur dymflekshëm për gjërat që po flasim. Nga shembujt më kuptimplotë është ai i Grinpas-çërs Lend Divellopmentit. Kjo është një degë e SuNatKo-s.

– E di, e di.

– Atëherë, ndoshta do të dish gjithashtu se Grinpasçërsi ka prona të mëdha tokash në Teksas, Arizona, në Kanada. Pjesa më e madhe e tokave me sipërfaqe të vogël gjendet në vende të thella, ku zhvillimi mund të arrijë ndoshta pas një brezi. Grinpasçërisi ua shet ato spekulatorëve, duke pranuar parapagime të vogla, që shërbejnë për të bllokuar çmimin, ndërsa pagesën e plotë të çmimit e shtyn mjaft përpara, në të ardhmen. Në dy raste të tilla, pagesat e fundit kapin shumën prej tetëdhjetë milionë dollarësh dhe duhet të shlyhen mbas dyzet vjetëve, domethënë në shekullin e njëzetëenjëtë. Këto pagesa mund të mos bëhen kurrë. Megjithatë, në fletë-bilancet e Grinpas-çërsit dhe të Suprënejshnëlit, këto tetëdhjetë milionë shënohen si fitime të tanishme. Dhe këto janë vetëm dy raste. Ka edhe të tjera, që kanë të bëjnë me shuma më të vogla; por, për të gjithë është zbatuar i njëjti sistem minëz

llogaritjeje. Edhe degë të tjera të SuNatKo-s kanë adoptuar të njëjtat metoda.

Aleksi u ndal pak, pastaj shtoi:

– Rezultati i të gjithë kësaj pune ka qenë, natyrisht, që gjithçka të dukej më e madhe se sa ishte në të vërtetë dhe të rritej kuota e aksioneve të SuNatKo-s.

– Dikush mund të ketë siguruar pasuri, – komentoi me keqardhje Petërtoni. – Fatkeqësisht, jo ne. A dihet se sa është shuma e përgjithshme e huave që ka marrë SuNatKo-ja?

– Po, duket se Xheksi ka mundur t'u hedhë një sy deklaratave të ardhurash, që tregonin përqindjet e interesit. Sipas llogaritjeve të tij, huatë me afat të shkurtër të Suprënejshnëlit dhe degëve të saj ngrihej në një miliard dollarë. Nga ky miliard, duket se pesëqind milionë përbëhen nga huatë e bankave. Pjesa tjetër përbëhet kryesisht nga karta tregtare me afat nëntëdhjetë ditësh, që mund të përtërihet vazhdimisht.

Sikurse e dinin ata të dy nga kartat tregtare merrej interes, por garantoheshin vetëm nga emri i mirë dhe prestigji i atij që i nxirrte. «Përtëritja» e një karte tregtare bëhej duke u tërhequr nga qarkullimi dhe me nxjerrjen, në të njëjtën kohë, të një tjetre, të njëvlershme me të mëparshmen, por duke i shtuar edhe interesin.

– Por tani e kanë mbushur kupën dhe s'u jep më kush hua – tha Aleksi, – ose kështu beson Xheksi. Një gjë që e pashë dhe vetë është se blerësit e kartës tregtare po fillojnë të bëhen më të matur dhe të dyshojnë.

– Në këtë mënyrë falimentoi shoqëria Pen Sentrl, – vërejti Petërtoni. – Të gjithë besonin se titujt hekurudhorë ishin gjë e sigurt për t'u blerë dhe për t'u mbajtur, si ato të IBM-së dhe të Xhënërëll Motorsit. Mirëpo, një ditë, papritur, Pen Sentrli falimentoi, mori fund një herë e mirë.

– E ndjekur edhe nga disa të tjera me emër të madh, – ia kujtoi Aleksi.

Të dy patën të njëjtin mendim: Pas Suprënejshnëlit, a do t'i shtohej listës dhe Fërst Merkentajll Ëmerikën Benku?

Fytyra kuqalashe e Petërtonit u zbeh. Ai iu drejtua Aleksit:

– Si është tani gjendja jonë? – Presidenti nuk po kërkonte më të tregonte autoritet, por priste me padurim çdo të thoshte ai.

– Varet shumë se sa kohë akoma do të mund të mbahet Suprënejshnëli. Po qe se mbahet akoma edhe për ndonjë muaj, ka mundësi që shitja jonë e sotme të mos bëjë nësy dhe të mos bëhen hetime për shkeljen e ligjit mbi rezervat federale. Mirëpo, në rast se falimentimi ndodh brenda një kohe të shkurtër, do ta kemi punën pisk: me SEC-in, sepse nuk treguam atë që dinim; me Komisionin e kontrollit e të revizionimit të fondeve, për tejkalim krediti, të pambuluar me garanci; me Rezervën Federale për dhënie huaje më të madhe nga kufijtë e caktuar. Veç kësaj, pa qenë e nevojshme të përmend humbjen e plotë të pesëdhjetë milionë dollarëve, edhe ti e ke të qartë se ç'do të thotë kjo për bilancin e këtij viti, kështu që aksionistët e zemëruar do të kuan të hanë kokën e ndonjërit nga ne. Më në fund, mund të bëhet edhe ndonjë proces kundër kështilltarëve.

– O Krisht! Jezu Krisht! – Petërtoni nxori shaminë dhe fshiu fytyrën dhe kafkën e tij tullace.

Aleksi vazhdoi, i pamëshirshëm:

– Duhet të kemi parasysh edhe diçka tjetër: publicitetin. Në qoftë se Suprënejshnëli do të shembet, do të bëhen hetime. Por, para se të ndodhtë kjo, ka mundësi që shtypi ta nuhasë gjendjen dhe të bëjë hetime për llogari të vet. Disa reporterë të financës janë me të vërtetë të aftë. Kur të fillojnë të fusin hundët nga çdo anë, ka pak të ngjarë që banka jonë t'i

shpëtojë syrit të tyre, kështu që do të mësojnë shumën e humbjeve tona dhe do ta botojnë. Një lajm i kësaj natyre mund të bëjë që të humbasim besimin e klientëve tanë që kanë bërë depozitime te ne dhe të shkaktojë tërheqje shumash të mëdha nga depozitimet.
– E ke fjalën për një dyndje te sportelet për të tërhequr fondet? Kjo as që mund të mendohet.
– Jo, nuk është ashtu. Një gjë e tillë ka ndodhur. Mendo shoqërinë Franklin të Nju Jorkut. Po të kesh depozituar të holla, e vetmja gjë që ka rëndësi për ty është që paratë e tua të jenë të siguruara. Në rast se je i mendimit se nuk është ashtu, atëherë ti i tërheq me nxitim.
Petërtoni piu edhe një gllënjkë tjetër ujë, pastaj e lëshoi veten përsëri në kolltuk. Ishte akoma dhe më i zbehtë se më parë.
– Sugjeroj, – tha Aleksi, – të mblidhet menjëherë komisioni i investimeve dhe të gjendet mënyra, brenda pak ditëve, për të siguruar një sasi me të madhe parash në dorë. Në këtë mënyrë, do të kemi mundësi t'u bëjmë ballë kërkesave të befasishme për të tërhequr para.
Petërtoni pohoi me kokë:
– Në rregull.
– Pasi të jetë bërë kjo, s'na mbetet tjetër për të bërë, veçse të lutemi. – Për herë të parë, gjatë bisedës, Aleksi buzëqeshi. – Ndoshta duhet të ngarkojmë Roskonë për ta bërë këtë. – Roskoi! – thirri Petërtoni, duke u kujtuar papritur për ekzistencën e Hejuordit. – Ai ishte që studioi bilancet e Suprenëjshnëlit, që rekomandoi të jepej huaja, që na siguroi se çdo gjë ishte në kushte shumë të mira.
– Ai nuk mbeti vetëm, – theksoi Aleksi. – Ti dhe këshilli e përkrahët. Edhe shumë të tjerë i shqyrtuan bilancet dhe arritën në të njëjtat konkluzione.
– Ti, jo.

– Unë isha i pasigurt, ndoshta kisha dyshim, por s'mendoja kurrë që SuNatKo-ja të ishte katandisur deri në këtë gjendje.
Petërtoni mori telefonin që pati përdorur më parë.
– I thoni zotit Hejuord të vijë këtu, – Pas ndonjë çasti pritjeje, thirri me zemërim: – Nuk më intereson me kë është! Aq më bën po qe se është edhe me vetë perëndinë. E dua këtu, tani!
– Përplasi receptorin dhe fshiu fytyrën.
Dera u hap me ngadalë dhe hyri Hejuordi. Ai tha:
– Mirëmëngjes, Xherom – dhe i bëri Aleksit një shenjë të ftohtë përshëndetjeje me kokë.
Petërtoni tha me zë serioz:
– Mbylle derën!
Me pamje të habitur, Hejuordi e mbylli derën.
– E kuptova se duhet të ishte diçka e ngutshme, përndryshe do të preferoja...
– Thuaji për Suprenëjshnëlin, Aleks, – e ndërpreu Petërtoni.
Tiparet e fytyrës së Hejuordit mbetën si të ngrira.
Me qetësi, duke radhitur faktet një e nga një, Aleksi përseriti thelbin e raportit të Xheksit. Zemërimi që kishte ndier në mbrëmjen e ditës së mëparshme dhe po atë mëngjes – zemërim ndaj marrëzisë dhe lakmisë dritëshkurtër që e kishin sjellë bankën në buzë të greminës – tani e kishte lënë. Ndiente vetëm keqardhje për këtë humbje të madhe, për të gjitha ato përpjekje të bëra më kot. I kujtoan, gjithashtu me keqardhje, projektet e ndryshme shumë të vlefshme që ishin lënë, me qëllim që paratë të përdoreshin për të plotësuar huanë që do t'i jepej Suprenëjshnëlit. Së paku, mendoi ai, duke vdekur, Ben Roseli s'kishte qenë i pranishëm në këto rrethana kaq të vështira.
Rosko Hejuordi e çuditi. Aleksi kishte pritur që ai të kundërshtonte, bile edhe të zemërohej, ndërsa asgjë e tillë nuk ndodhi. Hejuordi e dëgjoi në heshtje, duke bërë herë pas here

ndonjë pyetje, por nuk bëri komente të tjera. Aleksi dyshoi se ato që ai po thoshte ishin vetëm një zgjerim i atyre gjërave që Hejuordi i kishte ditur që më parë, ose që i kishte përfytyruar. Kur Aleksi mbaroi së foluri, në zyrë ra heshtja.
Petërtoni, që e kishte marrë prapë njëfarë sigurie në vetvete, tha:
– Sot pasdite do të bëjmë një mbledhje të komisionit të investimeve, për të vendosur mbi problemin e parave në dorë. Rosko, vihu ndërkohë në kontakt me Suprenëjshnëlin, për të parë se sa mund të kthejmë përsëri në dorë nga huaja jonë, po qe se do të ketë mundësi të shtiem diçka në dorë.
– Është një hua pa kushte, – tha Hejuordi. – Mund të kërkojmë kthimin e saj në çdo çast.
– Atëherë, kërkoje menjëherë; në fillim me gojë, pastaj me shkrim. Nuk ka shumë shpresë që SuNatKo-ja të ketë në dispozicion pesëdhjetë milionë dollarë në dorë; edhe një shoqëri në gjendje shumë të mirë nuk mban në arkë një shumë të tillë. Por, ka mundësi që të ketë diçka, megjithëse nuk kam shumë shpresë. Sidoqoftë, do ta hedhim vallen sipas avazit.
— Po kërkoj në telefon menjëherë Kuortermiejnin, — tha Hejuordi. — A mund ta marr atë raportin?
Petertoni shikoi nga Aleksi.
— S'kam kundërshtim, — tha Aleksi, — por sugjeroj që të mos bëhen kopje. Dhe sa më pak njerëz të kenë dijeni për të, aq më mirë do të jetë.
Hejuordi bëri një shenjë pranimi. Ai dukej si në gjemba, sikur mezi priste që të largohej.

Aleks Vandervurti kishte pasur pjesërisht të drejtë, kur kishte dyshuar se Hejuordi ishte në dijeni. Në të vërtetë, Hejuordi kishte dëgjuar fjalë, sipas të cilave Suprënejshnëli

ishte duke kaluar një periudhë të vështirë dhe, ditët e fundit, kishte mësuar se karta tregtare e SuNatKo-s nuk po shihej me sy të mirë nga investuesit. Veç kësaj, ai kishte marrë pjesë — për herë të parë — në një mbledhje të këshillit administrativ të Suprënejshnëlit dhe e kishte kuptuar se informatat që u ishin dhënë këshilltarëve nuk ishin të plota dhe në përputhje me realitetin. Por, duke qenë «i ri» në këshill, ai nuk kishte bërë pyetje, duke pasur ndërmend që ta shqyrtonte më vonë këtë çështje. Mbas asaj mbledhjeje, kishte vënë re se aksionet e Suprënejshnëlit kishin rënë dhe, vetëm një ditë më parë, kishte vendosur t'i sugjeronte seksionit fiduciar të bankës që ta «dehtësonte» sasinë e aksioneve, duke e konsideruar këtë si një veprim të kujdesshëm e të matur. Mirëpo, kur Petertoni e thirri atë mëngjes, ai s'e kishte vënë akoma në praktikë qëllimin e tij. Megjithatë, asgjë nga ato që kishte dëgjuar ose marrë me mend, nuk të bënin të mendoje që gjendja të ishte aq e ngutshme ose e keqe sa ç'tregohej në raportin që kishte sjellë Vandervurti.

Ndërkaq, pasi dëgjoi esencën e raportit nga zëri i Vandervurtit, Hejuordi nuk shprehu ndonjë kundërshtim. Instinktivisht e kishte kuptuar se, sado serioz dhe impresionues që të ishte, ai përmbante vetëm të vërtetën. Kjo kishte qenë arsyeja se pse, pjesën më të madhe të kohës, Hejuordi kishte ndenjur i heshtur, mbasi s'kishte gjë për të thënë në atë fazë, kur të dy të tjerët e dinin si ishin punët. Por, mendja e tij kishte filluar menjëherë të vepronte, duke dhënë sinjalealarmi, ndërsa ai analizonte mendimet, peshonte mundësitë, rrugët e mundshme të shpëtimit për veten e tij. Kishte disa gjëra që duheshin bërë me të shpejtë, por, pikë së pari, duhet të studiohej raporti i Xheksit, për t'i plotësuar gjërat që ai dinte. Me t'u kthyer në zyrën e tij, Hejuordi përfundoi me nxitim bisedën e punës, që kishte ndërprerë për

shkak të thirrjes së Petertonit, dhe filloi ta lexojë me vëmendje raportin.
Pas pak, konstatoi se Aleks Vandervurti i kishte përmbledhur me kujdes pikat kryesore të raportit e të dokumenteve të bashkëngjitura. Ato që Vandervurti s'i kishte zënë me gojë ishin disa hollësi mbi manevrat që kishte bërë në Uashington Xhorxhi i madh Kuortermiejni për të siguruar një hua qeveritare, me qëllim që Suprënejshnëli të përballonte vështirësitë që kishte për të holla në dorë. Kërkesa për një hua të tillë u ishin drejtuar disa anëtarëve të Kongresit, ministrisë së tregtisë dhe Shtëpisë së Bardhë. Raporti thoshte, në një pikë, se Kuotermiejni kishte ftuar nënpresidentin, Bajron Stounbrixhi ia kishte paraqitur propozimin këshillit të ministrave, por ky i fundit nuk e kishte pranuar.
Hejuordi mendoi me hidhërim, se tani e dinte se për çfarë kishin folur Xhorxhi i madh dhe Stounbrixhi në Bahama, në parkun e vilës së Kuortermiejnit. Dhe, ndërsa, më në fund, makina politike e Uashingtonit kishte marrë një vendimet e saj më të urta, duke e hedhur poshtë kërkesën për t'i dhënë hua Suprënejshnëlit, Frerst Mërkëntajll Emerikën Benku — me nxitjen e Roskoit — ia kishte dhënë nga ana e saj pa ngurrim. Xhorxhi i madh kishte dhënë prova se ishte një mjeshtër i madh i bindjes, me metoda të tërthorta. Hejuordit i dukej sikur po i dëgjonte akoma fjalët e tij: «Po qe se pesëdhjetë milionë janë për bankën tuaj një shumë tepër e madhe, e lëmë këtë punë. Do t'i drejtohem Çezit!') Kjo ishte një dredhi shumë e vjetër, por ai, Hejuordi — bankieri dinak dhe me përvojë — kishte rënë brenda, si një fëmijë.

Ndërkaq, së paku një gjë ishte e mirë. Hollësitë e udhëtimit të nënpresidentit në Bahama, ishin të sakta. Veç kësaj, raporti nuk prekte fare Q-Investmentsin, gjë që ishte një lehtësim i madh për Hejuordin.

Hejuordi pyeti veten nëse i kishte vajtur mendja Xherom Petërtonit te huaja suplementare prej dy milionë dollarësh që FMA-ja i kishte dhënë Q-Investmentsit, shoqërisë private të drejtuar nga Xhorxhi i madh. Kishte të ngjarë që jo. Edhe Aleks Vandervurti nuk dinte gjë, megjithatë, herët a vonë, do ta mësonte. Sidoqoftë, gjëja më e rëndësishme ishte që të veprohej në një mënyrë që askush të mos merrte vesh se ai kishte pranuar atë, «shpërblimin» prej dy mijë aksionesh të Q-Investmentsit. I erdhi shumë keq që s'ia kishte kthyer ato Xh. Xh. Kuortermejnit, siç kishte menduar në fillim. Tani ishte tepër vonë për ta bërë këtë; por, së paku, mund t'i hiqte nga kaseta e siguruar dhe t'i zhdukte. Kjo ishte gjëja më e mirë për t'u bërë. Për fat të mirë, në të nuk ishte shënuar emri i tij, por fjala «prurësit».

Ai e kuptoi se, për një kohë, duhej ta linte më një anë rivalitetin e tij me Aleks Vandervurtin dhe të përqendrohej në çështjet jetike që kishte përpara. Nuk kishte iluzione rreth efektit që falimentimi i Suprënejshnëlit do të kishte mbi pozitën e tij në këshillin administrativ dhe në bankë, në përgjithësi. Do ta shihnin si një njeri pa pikë vlere dhe do të bëhej objekti ku do të drejtoheshin qortimet dhe përbuzja e të gjithëve. Por, ndoshta, me anën e një veprimi të shpejtë dhe me pak fat, nuk ishte akoma tepër vonë për të shpëtuar. Po t'i shtinte prapë në dorë paratë e huasë, do ta konsideronin si hero.

Puna e parë që duhej bërë ishte të vihej në kontakt me Suprënejshnëlin. I tha sekretares, zonjës Kellëgen, të lidhej në telefon me Xh. Xh. Kuortermejnin.

Pas disa minutave, sekretarja e njoftoi:

— Zoti Kuortermejn është jashtë shtetit. Zyra e tij nuk thonë në mënyrë të qartë se ku është. Ata nuk japin informata të tjera.

Ky ishte një fillim jo i mbarë. Hejuordi ia priti:

— Atëherë, thërrisni Inçbekun. — Që prej takimit të tyre të parë në Bahama, ai kishte pasur disa biseda me Stenli Inçbekun, administratorin e Suprënejshnëlit.

Në aparat u dëgjua zëri i Inçbekut, me theksin e tij hundor njujorkez.

— Rosko, për çfarë mund të të shërbej?

— Po mundohem të mësoj se ku ndodhet Xhorxhi. Duket se njerëzit tuaj nuk...

— Është në Kosta Rika.

— Dua të flas me të. Me çfarë numri mund ta thërres?

— Ka dhënë urdhër që të mos e lidhin me telefon.

— Është për një gjë të ngutshme.

— Atëherë, ma thoni mua.

— Shumë mirë. Kërkojmë kthimin e huasë. Po jua bëjmë njoftimin tani, ndërsa kërkesa me shkrim do t'ju vijë me postën e mbrëmjes.

Për disa çaste ra heshtje. Pastaj Inçbeku tha:

— S'besoj ta keni seriozisht.

— E kam shumë seriozisht.

— Po, pse?

— Mendoj se mund ta kuptoni. Sidoqoftë, besoj se nuk doni që të flas për arsyet në telefon.

Inçbeku heshti përsëri; një heshtje që ishte mjaft kuptimplotë në vetvete. Pastaj ia ktheu:

— Banka juaj po vepron në mënyrë qesharake dhe të paarsyeshme. S'ka as një javë që Xhorxhi i madh më tha se s'kishte kundërshtim që ju ta shtonit shumën e huasë me pesëdhjetë për qind.

Hejuordi u shtang nga paturpësia e Inçbekut; mirëpo, pastaj, iu kujtua se në Suprënejshnël, në sajë të Kuortermejnit, paturpësia ishte dhënë njëherësh frytet e saj. Por, tani, kjo nuk do të ndodhte më. Në qoftë se huaja do të na kthehet menjëherë, — tha Hejuordi, — çdo informatë që kemi do të mbetet midis nesh. Për këtë, ju garantoj.

Puna është, mendoi ai, nëse Xhorxhi i madh, Inçbeku, apo të tjerë që dinin të vërtetën mbi SuNatKo-n, kishin ndërmend të fitonin kohë. Në rast se po, FMA-ja mund të siguronte një avantazh ndaj kreditorëve të tjerë.

— Pesëdhjetë milionë dollarë! — tha Inçbeku. — Gjithë këto para s'i disponojmë në dorë.

— Banka jonë do të pranonte disa pagesa me këtë, me kusht që derdhjet të bëhen nga periudha të afërta me njëra-tjetrën.

Në fakt, problemi i vërtetë ishte tjetër: ku do t'i gjente SuNatKo-ja pesëdhjetë milionë dollarë, në gjendjen e saj të tanishme, kur i kishte arkat bosh? Hejuordi vuri re se po djersitej. E ndiente veten të përshkruar nga një përzierje nervozizmi, pasigurie dhe shprese.

— Do ta bisedoj me Xhorxhin e madh, — tha Inçbeku. — Por, kjo punë s'do t'i pëlqejë. — Kur të flisni me të, i thoni se dua të diskutoj, gjithashtu, huanë që i kemi dhënë shoqërisë Q-Investments.

Hejuordi nuk ishte i sigurt, por, ndërsa po vendoste në vend receptorin, iu duk sikur dëgjoi një rënkim.

Pastaj, në qetësinë e zyrës së tij, ai u mbështet te shpina e kolltukut të rrotullueshëm, duke u qetësuar nga tensioni që kishte pasur. Ngjarjet e gjashtëdhjetë minutave të fundit kishin qenë si një goditje e fortë në kokë. Tani, ndërsa po binte tensioni, kundërveprimi i tyre po bëhej gjithnjë e më i fortë dhe ai e ndiente veten të dërrmuar e të vetmuar. Dëshironte të linte çdo gjë dhe të largohej për një kohë. Po ta

kishte në dorë të zgjidhte, ai e dinte se nga ç'anë do të drejtohej. Nga Avrili. Mirëpo, që nga takimi i tyre i fundit, më se një muaj më parë, ai s'kishte dëgjuar më për të. Më parë, kishte qenë gjithmonë ajo që e kishte thirrur; ai s'i kishte telefonuar asnjëherë.

Nën nxitjen e çastit, hapi një bllok xhepi adresash, që e mbante gjithnjë me vete, dhe kërkoi një numër telefoni, që i kujtohej se e kishte shënuar. Ishte i Avrilit, në Nju Jork. E formoi këtë numër në telefonin e jashtëm.

Dëgjoi sinjalin e ziles dhe, pastaj, zërin e ëmbël dhe të këndshëm të Avrilit:

— Alo, — Zemra filloi t'i rrihte me të shpejtë, duke dëgjuar zërin e saj.

— Mirëdita, Rosi! — thirri ajo, kur ai i tha se kush ishte. Ka mjaft kohë që nuk shihemi, e dashur. Po pyesja veten se kur mund të takoheshim përsëri.

Ai e kuptoi se ajo po ngurronte.

— Por, i dashur Rosi, ti nuk je më në listë.

— Listë? Çfarë liste?.

Një tjetër çast ngurrimi.

— Ndoshta s'duhet ta kisha thënë këtë.

— Jo, jo, të lutem, ma thuaj. Përveç ne të dyve, askush tjetër nuk do të dijë gjë për këtë.

— Mirë pra, është fjala për një listë rezervate, të hartuar nga Suprënejshnëli, emrat e personave, për të cilët ne duhet të përkujdesemi me shpenzimet e tij.

Hejuordi pati befas ndijimin e një litari që po e shtrëngonte në grykë.

— Kush e ka këtë listë?

— Nuk e di. Ne, vajzat, e kemi, por nuk e di se kush tjetër mund ta ketë.

Ai filloi të mendohej, tërë shqetësim, dhe tha me vete; Ç'u bë, u bë. Ndoshta duhej ta ndjente veten të kënaqur që nuk ishte më në një listë të tillë; megjithatë, e pyeti veten, me një grimë xhelozie, se kush mund të ishte tani në të. Ndërkaq, shpresonte që kopjet e vjetra t'i kishin zhdukur me kujdes. E pyeti Avrilin:

— A do të thotë kjo se nuk mund të vish më të më takosh?

— Jo pikërisht ashtu, por, në rast se vij, duhet të paguash ti, Rosi.

— Dhe sa do të ishte kjo? — Ndërsa po bënte këtë pyetje, ai po pyeste njëkohësisht dhe veten nëse ishte me të vërtetë ai që po fliste.

— Është bileta e avionit nga Nju Jorku, — u përgjigj Avrili me ton praktik. — Dhe hoteli, si dhe dyqind dollarë për mua.

Hejuordit iu kujtua se një herë, kishte pyetur veten se sa para kishte prishur Suprënejshnëli për të. Tani e dinte. Ai e largoi pak receptorin, ndërsa ndjente se brenda tij po zhvillohej një luftë e fortë midis arsyes së shëndoshë dhe dëshirës, ndërmjet zërit të ndërgjegjes dhe faktit se çdo të thoshte për të të ishte vetëm me Avrilin. Nga ana tjetër, paratë e nevojshme ishin më shumë nga sa mund t'i lejohej atij. Mirëpo, ai e dëshironte atë. E dëshironte aq shumë...

E afroi përsëri receptorin.

— Kur mund të vish?

— Të martën e javës së ardhshme.

— Jo më parë?

— Kam frikë se jo, i dashur.

Ai e kuptoi se po vepronte si i marrë. Nga ajo ditë gjer të martën, do të ishte duke pritur, si në radhë, prapa njerëzve të tjerë, e drejta e përparësisë të të cilëve — kushedi se për cilat arsye – ishte më e madhe se e drejta e tij. Por, nuk kishte si t'ia bënte dhe i tha:
– Shumë mirë. Të martën.
Vendosën që Avrili të zinte vend në hotelin «Këlumbia Hilton» dhe t'i telefononte prej andej.
Hejuordi filloi të ndjente parashijen e ëmbëlsisë që e priste.
Pastaj iu kujtua se duhet të bënte dhe një gjë tjetër: të zhdukte çertifikatat aksionare të Q-Investmentsit.
Zbriti me ashensor në katin përdhes dhe përshkoi galerinë që çonte në degën kryesore të bankës. I deshën vetëm pak minuta për të marrë nga kaseta e vet të katër çertifikatat, secila për pesëqind aksione. U ngjit përsëri lart, me qëllim që t'i fuste vetë në makinën për prishjen e dokumenteve.
Por, pasi u kthye në zyrën e tij, filloi ta mendonte këtë punë ndryshe. Herën e fundit që e kishte verifikuar, aksionet vlenin njëzet mijë dollarë. Pse t'i zhdukte në atë çast? Fundi i fundit, po të ishte e nevojshme, këtë gjë mund ta bënte në çdo kohë. Pasi ndërroi mendje, i vuri në një sirtar të tryezës së tij të punës, ku mbante dokumentet personale.

Rasti i madh iu paraqit, Majlls Istinit, kur ky e priste më pak se kurdoherë tjetër.
Dy ditë më parë, hija e llahtarshme e burgut kishte filluar t'i dilte përsëri para syve me tërë tmerrin e saj, ndërsa ai ishte i vrarë dhe i rënë moralisht, i bindur se skllavërimi i tij në Palestrën Shtatë-Shtatë nuk do të jepte asnjë rezultat, veçse do ta fuste gjithnjë e më thellë në botën e krimit. Majllsi ia kishte shfaqur Huanitës dekurajimin e tij, që i ishte kthyer përsëri, pasi ishte zhdukur përkohësisht, kur ata bënin dashuri.
Të shtunën, ai ishte takuar me Huanitën. Të hënën mbrëma, Nejt Nethensëni, administratori i Palestrës Shtatë-Shtatë,

kishte dërguar për ta thirrur. Si zakonisht, Majllsi po ndihmonte për t'u çuar pije dhe sanduiçe kumarxhinjve, në katin e tretë.

Kur hyri në zyrën e administratorit, pa se me Nethensënin ishin dhe njerëz të tjerë. Njëri prej tyre ishte fajdexhiu, rusi Ominski, dhe tjetri me pamje të fuqishme dhe tipare trashanike, që Majllsi e kishte parë disa herë në Palestrën Shtatë-Shtatë dhe kishte dëgjuar ta thërrisnin Toni Ber!) Marino. Nofka «Ber» dukej se i përshtatej shumë mirë. Marinoja kishte një trup të rëndë e të fuqishëm, lëvizje të ngathëta dhe diçka që të bënte të mendoje për një egërsi të mbuluar, por të gatshme për t'u shfaqur në çdo çast. Fakti që Toni Beri kishte autoritet shihej qartë nga respekti me të cilin i silleshin të tjerët. Çdo herë ai vinte në Palestrën Shtatë-Shtatë me një veturë kadillak, i shoqëruar nga një shofer dhe një shoqërues, që dukej qartë se ishin rojat e tij.
Nethensëni dukej i shqetësuar dhe tha:
– Majlls, u kam thënë zotit Marino dhe zotit Ominski se sa i dobishëm je treguar këtu, te ne. Ata duan që të bësh një shërbim për ...
Ominski ia preu shkurt:
– Prit jashtë.
– Si urdhëroni! – Nethensëni doli jashtë me nxitim.
– Në një veturë, jashtë, është një plak, – i tha Ominski Majllsit. – Merr disa nga njerëzit e zotit Marino të të ndihmojnë për ta sjellë brenda, por ki kujdes që të mos ju shohë njeri. Fute në njërën nga dhomat pranë dhomës sate dhe merr masa për t'u siguruar që ai të mos lëvizë prej andej. Mos e lër vetëm më shumë se e ke të domosdoshme dhe, në rast se duhet të largohesh, mbylle brenda. Do të përgjigjesh po qe se ai largohet prej këtej.
Duke ndier njëfarë shqetësimi, Majllsi pyeti:
– Duhet ta mbaj me forcë?
– Nuk do të jetë e nevojshme.
– Plaku i dëmtuar. Nuk do të na nxjerrë telashe, – tha Toni Beri. Për një trup aq të madh, zëri i tij i lartë dhe i hollë të

çudiste. – Mos harro se, për ne, ai është i rëndësishëm, prandaj trajtoje mirë. Por, mos e lër të pijë alkool. Ai do të të kërkojë. Mos i jep asnjë pikë. E kuptove?
– Po, – tha Majllsi. – Mos doni të thoni se tani është pa ndjenja?

— Është bërë tapë, — u përgjigj Ominski. — Ia ka shtruar një javë të tërë. Detyra jote është të kujdesesh për të dhe të mos e lësh të pijë. Mos u merr me punën tënde gjatë tri a katër ditëve që ai do të jetë këtu. — Pas një çasti, shtoi: — Bëje punën mirë dhe do të kesh te ti edhe më shumë besim.
— Do të bëj çmos, — tha Majllsi. — A ka ndonjë emër ai plaku? Duhet ta thërras në njëfarë mënyre.
Dy të tjerët vështruan njëri-tjetrin. Ominski u përgjigji:
— Deni. S'është nevoja të dish më shumë.

Pas disa minutash, jashtë Palestrës Shtatë-Shtatë, shoqëruesi-shofer i Toni Berit pështyu me neveri në trotuar, duke thënë:
— O zot! Ky plak qelbanik kundërmon si nevojtore.
Shoqëruesi i dytë dhe Majllsi po shikonin një trup pa lëvizje, të shtrirë në ndenjësen e mbrapme të një veture doxh, që ishte ndalur pranë trotuarit. Dera e prapme e makinës, nga ana e trotuarit, ishte e hapur.
— Do të përpiqem ta pastroj, — tha Majllsi. E kishte fytyrën të rrudhosur në një ngërdheshje të shkaktuar nga era e keqe që vinte nga të vjellët. — Por, duhet ta çojmë brenda.
Shoqëruesi i dytë thirri:
— E marrtë djalli! Ta heqim qafe sa më parë!
Të dy ata u zgjatën brenda veturës dhe ngritën trupin. Në rrugën e ndriçuar keq, nga barra që ata kishin ngritur mund të dallohej vetëm një tufë flokësh të thinjur, gropat e zbehta të faqeve, të mbuluara me qime të parruara prej shumë ditësh, sytë e mbyllur dhe goja e hapur, ku dukej mishi i dhëmbëve, pa dhëmbë. Rrobat ishin pis dhe të grisura.

— Mos ka vdekur? — tha shoqëruesi i dytë, ndërsa po e nxirrnin nga vetura.
Pikërisht në atë çast, ndoshta për shkak të lëvizjes, një çurg të vjelle shpërtheu nga goja e hapur dhe ra mbi Majllsin. Shoqëruesi-shofer, që për vete nuk u bë pis asnjë pikë, u ngërdhesh. — Jo, nuk ka vdekur. Jo, akoma. — Pastaj, ndërsa Majllsi po villte gjithashtu, shtoi: — Më mirë ty se sa mua, djalosh.
E mbartën trupin e palëvizshëm brenda ndërtesës dhe, pastaj, duke kaluar nga shkallët e prapme, gjer lart, në katin e katërt. Majllsi kishte marrë çelësin e një dhome dhe hapi derën. Ishte një dhomë e ngjashme me dhomën e tij, në të cilën të vetmet mobilje ishin një shtrat tek, një komo, një karrige, një legen për t'u larë dhe disa rafte. Veshja e faqeve të murit me panele mbaronte nja tridhjetë centimetra nga tavani, duke e lënë të zhveshur pjesën tjetër.
Majllsi i hodhi një vështrim dhomës dhe u tha të dy shoqëruesve: — Prisni një çast. — Zbriti poshtë shkallëve me të shpejtë dhe shkoi në palestër, ku mori një dyshek gome. U kthye përsëri në dhomë dhe e shtroi atë mbi shtrat.
Të dy shoqëruesit vendosën mbi të plakun.
— Mbaje me shëndet, Majlls, — tha shoqëruesi-shofer. — Shkojmë tani, para se të vjellë edhe unë.
Duke e përmbajtur neverinë, Majllsi e zhveshi plakun, që vazhdonte të ishte i pandërgjegjshëm, dhe e pastroi me një sfungjer. Pastaj, duke e ngritur dhe tërhequr, mundi ta hiqte dyshekun prej gome dhe të shtrinte në shtrat trupin që tani ishte më i pastër dhe kundërmonte më pak. Gjatë këtyre veprimeve, plaku lëshonte, herë pas here, ndonjë rënkim. Ai pati edhe një kontraktim tjetër të stomakut, por kësaj here nxori vetëm një curril shkume, që Majllsi e fshiu me sfungjer. Pasi e mbuloi me çarçafin dhe batanijen, plaku u duk se po

pushonte më i qetë.
Kur ia kishte hequr pak më parë rrobat, Majllsi i kishte lënë në dysheme. Tani i mblodhi dhe i futi në dy trasta platmasi, për t'u larë dhe pastruar. Ndërkaq, ia boshatisi të gjitha xhepat. Në njërin xhep të xhaketës gjeti një protezë dhëmbësh. Xhepat e tjerë përmbanin sende të ndryshme: një krehër, një palë syze me xhama të trashë, një stilograf dhe një laps automatik, të dy prej ari, një tufë çelësash; veç këtyre, në një xhep të brendshëm, tri letërkredite Kiçarxh dhe një portofol, plot me kartëmonedha.
Majllsi mori protezën, e shpëlau dhe e vuri në një gotë me ujë, pranë shtratit. Aty pranë, vuri edhe syzet. Pastaj shikoi letërkreditet dhe portofolin.
Letërkreditet ishin lëshuar në emër të Fred W. Riordanit, R.K. Benetit, Alfred Shauit. Të tri letërkreditet ishin nënshkruar, por, megjithëse me emra të ndryshëm, në secilën prej tyre shkrimi ishte i njëjtë. Majllsi i shikoi me kujdes edhe një herë, për të parë datën e lëshimit dhe të mbarimit të afatit të vlerës së tyre: të tria ishin akoma të vlefshme. Me sa mund të kuptonte ai, ato nuk dukeshin të falsifikuara.
Pastaj, shikoi me kujdes portofolin. Në një të ndarë plastmasi të tejdukshëm ishte një patentë shoferore. Plastmasi ishte zverdhur dhe nëpërmjet tij nuk shihej mirë, prandaj Majlsi e nxori patentën dhe zbuloi se, poshtë saj, ishte një patentë e dytë dhe, poshtë kësaj, një e tretë. Emrat e patentave korrespondonin me ata të letërkrediteve, por të tri fotografitë e patentave ishin të njëjta. Majlsi i shikoi me kujdes. Me përjashtim të ndonjë ndryshimi të vogël, që tregonte se fotografitë nuk ishin bërë në të njëjtën kohë, s'kishte dyshim se ato ishin të plakut të shtrirë në shtrat.

Majlsi nxori paratë nga portofoli për t'i numëruar. Kishte ndërmend t'i kërkonte Nejt Nethensënit t'i fuste letërkreditet

dhe portofolin në kasafortën e palestrës, por më parë donte të dinte se sa para po dorëzonte. Shuma ishte më e madhe nga ç'ishte pritur — pesëqind e dymbëdhjetë dollarë, pothuajse gjysma në bankënota të reja njëzetdollarëshe. Majlsi i shikoi me kujdes disa prej tyre, duke kontrolluar cilësinë e kartës me majat e gishtave. Pastaj i hodhi një vështrim plakut dhe pa se ishte i zhytur në një gjumë të thellë. Pa zhurmë, doli nga dhoma dhe përshkoi korridorin e katit të katërt për te dhoma e tij. Pas pak çastesh, u kthye përsëri me një lente zmadhuese xhepi, me anë të së cilës i shqyrtoi përsëri bankënotat njëzetdollarëshe. Intuita e tij s'e kishte gabuar. Ato ishin të falsifikuara, por me cilësi shumë të mirë, si ato që ai kishte blerë një javë më parë, atje, në Palestrën Shtatë-Shtatë.

Po mendohej: paratë, ose së paku gjysma e tyre, ishin të falsifikuara. Pa dyshim se ishin të falsifikuara edhe tri patentat dhe kishte të ngjarë që të vinin nga i njëjti burim si ato që Xhuls LaRoka i kishte dhënë para një jave në udhëtimin për në Luisvil. Prandaj, a nuk kishte të ngjarë gjithashtu që edhe letërkreditet të ishin të falsifikuara? Kishte mundësi që, më në fund, të ishte pranë burimit të letërkrediteve Kiçarxh të falsifikuara, që Nolan Uejnrajti donte ta gjente me çdo kusht. Ndjeu se po pushtohej nga entuziazmi, si edhe nga njëfarë shqetësimi që i dha rrahje më të shpejta të zemrës.

Duhet të merrte disa shënime për gjërat e reja që kishte zbuluar. Kopjoi mbi një pecetë letre të dhënat e letërkrediteve dhe të patentave, duke i hedhur sytë, herë pas here, nga plaku, për t'u siguruar se ishte gjithnjë në gjumë.

Pastaj, mbylli dritën, kyçi derën e dhomës nga jashtë dhe e çoi poshtë portofolin dhe letërkreditet.

Atë natë, ai fjeti me copa, me derën gjysmë të hapur, duke e pa-sur të qartë përgjegjësinë e tij lidhur me plakun Deni. Ai e kaloi kohën duke vrarë mendjen për rolin dhe identitetin e plakut. Çfarë lidhje kishte Deni me Ominskin dhe Toni Ber Marinon? Pse e kishin sjellë aty? Toni Beri kishte thënë: «ai është i rëndësishëm për ne.» Pse?

U zgjua ndaj të gdhirë dhe shikoi orën: 6. 45. U ngrit nga shtrati, u la me të shpejtë, u rrua dhe u vesh. Nga dhoma, në anën tjetër të korridorit, nuk dëgjohej asnjë zhurmë. Ai shkoi atje, futi pa zhurmë çelësin në bravë, e hapi pak derën dhe shikoi brenda. Gjatë natës, Deni e kishte ndryshuar pozicionin, por ishte akoma në gjumë dhe gërhiste lehtë. Majlsi mori dy trastat prej plastmasi me rrobat, e mbylli përsëri derën me çelës dhe zbriti poshtë.

U kthye pas njëzet minutave, me një tabaka, duke sjellë kafe të fortë, feta buke të thekura dhe vezë të rrahura.

— Deni! — Majlsi i shkundi supin. — Deni, zgjohu!

Asnjë kundërveprim. E provoi përsëri. Më në fund, sytë e Denit u hapën, e vështruan dhe, menjëherë, u mbyllën përsëri.

— Largohu! — murmuriti plaku. — Largohu! S'jam akoma gati për skëterrën.

— Unë s'jam djalli, — tha Majlsi. — Jam një mik. Toni Beri dhe rusi më kanë porositur të kujdesem për ty.

Sytë tërë sklepa u hapën përsëri.

— Ata kelyshët e Sodomës më paskan gjetur, eh? Kjo duhej pritur. Më gjejnë gjithmonë. — Fytyra iu kontraktua nga dhimbja. — O Krisht! Sa më dhemb koka!

— Kam sjellë kafe. Të shohim nëse do të të bëjë mirë. — Majlsi pushtoi me njërin krah shpatullat e Denit, duke e ndihmuar të ngrihej dhe të qëndronte ulur në shtrat. Pastaj i dha filxhanin e kafesë. Plaku e rufiti, duke u ngërdheshur.

Papritur u gjallërua.

— Dëgjo, biro. Për të ardhur përsëri në formë, kam nevojë për një gotë pije. Merr para... — Hodhi sytë rreth e përqark.

— Paratë e tua janë në rregull, — tha Majlsi. — Janë në kasafortën e palestrës. Mbrëmë, i çova unë poshtë.

— Jemi në Palestrën Shtatë-Shtatë?
— Po.
— Më kanë sjellë këtu edhe një herë tjetër. E po, mirë, biro, meqë e di se mund të paguaj, hidhu gjer poshtë të bari për një gllënjkë...

Majlsi e ndërpreu me ton të vendosur:
— Jo, i dashur, s'ka gllënjkë as për ty e as për mua.
— Nuk do të pendohesh. — Sytë me sklepa shndritën me djallëzi.

— Le të themi dyzet dollarë për një shishe. Ç'thua?
— Më vjen keq, Deni. Më kanë dhënë urdhra të prerë.
— Majllsi e peshoi mirë atë që do të thoshte dhe, pastaj, tha me guxim: — Veç kësaj, po t'i përdor ato njëzetdollarëshet e tua, mund të më arrestojnë.
Kjo që njëlloj sikur të kishte shtënë me një kobure. Deni u hodh përpjetë, me një shprehjealarmi e dyshimi në fytyrë.
— Kush the ti se je... — Ai u ndal me një rënkim dhimbjeje dhe një ngërdheshje, ndërsa dorën e vuri te koka që i dhimte.
— Duhej që dikush t'i numëronte paratë e tua. Këtë e bëra unë.
Plaku tha me një ton që s'shprehte bindje:
— Ato bankënota njëzetëshe janë të mira.
— Sigurisht që janë të mira, — pranoi Majllsi. — Nga më të mirat që kam parë. Pothuajse po aq të mira sa ato që dalin nga qendra qeveritare ku priten paratë.
Deni ngriti sytë. Shihej se ishte në mes dy nxitjesh: kureshtjes dhe dyshimit.
— Si shpjegohet që kupton kaq shumë nga këto gjëra?
— Para sev të hyja në burg, punoja në bankë.
Pati një çast heshtjeje, pastaj plaku pyeti:
— Pse të futën brenda?
— Përvetësime të paligjshme. Tani jam në liri të mbikëqyrur.
U pa qartë se Deni u qetësua.
— E marr me mend se do të jesh në rregull. Përndryshe nuk do të ishe në punë te Toni Beri dhe rusi.
— Ashtu është, — tha Majllsi. — Jam në rregull. Puna është

që të jesh ashtu edhe ti. Prandaj, pikërisht tani do të shkojmë në sallën e banjës me avull.
— S'kam nevojë për avull, por për një gllënjkë pijë. Vetëm një, biro, — iu lut Deni. — Një vetëm, të betohem. Nuk duhet t'ia mohosh një plaku një nder kaq të vogël.
— Do të nxjerrësh me djersë ca nga alkooli që ke pirë atëherë mund t'u japësh një të lëpirë gishtave.
Plaku rënkoi.
— Njeri pa zemër! Zemërgur!
Në njëfarë mënyre ishte si të përkujdeseshe për një fëmijë. Majllsi e mbështolli Denin në një robëdeshambër dhe e çoi poshtë. E shoqëroi krejt të zhveshur në disa dhoma me avull, e fërkoi me një peshqir dhe, më në fund, e shtriu në një shtrat masazhi, ku vetë ai filloi t'i bëjë goditjet në formë breshërie, si dhe fërkimet. Duke qenë se ishte akoma shumë herët, në palestër dhe në sallat e banjës me avull nuk kishte njerëz dhe vetëm pak nga punonjësit kishin ardhur. Edhe kur e çoi plakun prapë lart, ai nuk takoi njeri.

Majllsi e rregulloi përsëri shtratin, duke vënë çarçaf të tjerë, të pastër dhe Deni, tanimë i qetësuar dhe i bindur, u fut brenda. E zuri gjumi pothuajse menjëherë dhe, ndryshe nga nata e mëparshme, shprehja e fytyrës së tij ishte e qetë, gati engjëllore. Për çudi, pa e kuptuar as ai vetë, Majllsi kishte filluar të ndjente njëfarë simpatie për të. Me kujdes, ndërsa plaku flinte, ai i vuri poshtë kokës një peshqir dhe e rroi.

Vonë, në mëngjes, Majllsin e zuri gjumi ndërsa po lexonte në dhomën e tij.
— Ej, Majlls! Djalosh, luaj bythët! — Ky zë i mprehtë ishte i Xhuls LaRokës.

Majllsi u hodh përpjetë dhe pa te pragu i derës figurën e njohur barkmadhe. Gzjati instinktivisht dorën për t'u siguruar se çelësi i dhomës së Denit ishte akoma aty ku e kishte lënë. U qetësua duke parë se ishte.
— Kam këtu placka të atij pijanecit plak, — tha LaRoka, që

kishte në dorë një valixhe fibre. — Ominski më tha të ta jepja ty.

LaRoka, lajmëtari kudo i pranishëm!
— Në rregull. — Majllsi u shtri dhe shkoi te lavamani, ku lau fytyrën me ujë të ftohtë. Pastaj, i ndjekur nga LaRoka, hapi derën e dhomës së Denit. Kur ata të dy hynë brenda, Deni u ngrit në shtrat me kujdes dhe po i vështronte duke ndenjur ulur. Ndonëse akoma i dobët dhe i zbehtë, ai kishte një pamje më të mirë nga çishte pasur gjatë gjithë kohës, që kur e kishin sjellë atje. E kishte vënë protezën e dhëmbëve, si edhe syzet.
— O plak dembel dhe i kotë! — thirri LaRoka. — Ti s'vlen për gjë tjetër, veçse t'u nxjerrësh të tjerëve telashe!

Deni drejtoi trupin, duke e vështruar paditësin e tij me neveri.
— S'jam aspak i kotë e i pavlefshëm, siç e di mirë ti dhe të tjerët. Sa për dehjën, kushdo ka dobësitë e veta. — Bëri me shenjë nga valixhja. — Në rast se më ke sjellë rrobat, nxirri jashtë dhe vendosi në ndonjë vend.

LaRoka, i qetë, u zgërdhi.
— Duket se e more prapë veten, o dhelpër plakë. Shihet se Majllsi ka bërë me ty një punë të mirë.

— Xhuls, — tha Majllsi, — a mund të rrish pak këtu, sa të shkoj poshtë e të marr një llambë rrezesh ultraviolet për Denin? Besoj se do t'i bënte mirë.

— Si jo, shko.

— Desha, më parë, të të them diçka. — Majllsi doli nga dhoma, i ndjekur nga LaRoka.

Duke e ulur zërin, e pyeti:

— Xhuls, ç'është e tërë kjo punë? Kush është ky Deni?

— Vetëm një plak i marrë. Herë pas here ua mbath këmbëve dhe shkon e bëhet xurxull. Dhe kështu, dikujt nga ne i duhet ta gjejë dhe ta sjellë prapë pijanecin në vete.

— Pse? Dhe prej nga ua mbath ai këmbëve?

Sytë e LaRokës morën një shprehje dyshimi, siç kishte ndodhur edhe para një jave.

— Po fillon të bësh prapë pyetje, djalo. Çfarë të thanë Toni Beri dhe Ominski?

— Vetëm se quhet Deni.

— Po qe se duan të të thonë më shumë, këtë do ta bëjnë ata, jo unë.

Pasi u largua LaRoka, Majllsi rregulloi llambën me rreze ultraviolet dhe e vendosi nën të Denin, për një gjysmë ore. Tërë pjesën tjetër të ditës, plaku e kaloi shtrirë ose duke dremitur. Në mbrëmje, Majllsi i solli lart darkën. Deni e hëngri pothuajse të gjithë. Ky ishte vakti i parë që po hante plotësisht që prej njëzet e katër orësh që ndodhej atje.

Të nesërmen, e mërkurë, Majllsi e përsëriti kurën me banjën me avull dhe llambën me rreze ultraviolet dhe, pak më vonë, ai dhe Deni luajtën shah. Plaku kishte një mendje të mprehtë e të djallëzuar dhe ishte po aq i aftë sa Majllsi. Tanimë ishte i qetë dhe i përzemërt dhe linte të kuptohej qartë se i pëlqente shoqëria dhe kujdesi që tregonte për të Majllsi.

Pasditen e dytë, dukej se plaku kishte dëshirë të bisedonte.

— Dje, — tha ai, — ai krimbi LaRoka më tha se ti di plot gjëra për paratë.

— Këtë ua thotë të gjithëve. — Majllsi i tregoi për pasionin që kishte për këtë gjë dhe interesimin që kjo kishte ngjallur në burg.

Deni i bëri edhe disa pyetje të tjera dhe, pastaj, i tha:

— Po qe se s'ke kundërshtim, do të dëshiroja që tani të më ktheheshin paratë e mia.

— Po shkoj t'i marr, por, ndërkaq, duhet të të mbyll me kyç përsëri.

— As mos e ço nëpër mend se dua të pi. Tani për tani nuk më tërheq më. Një zdërhallje si kjo e fundit më mjafton për njëfarë kohe. Duhet të kalojnë muaj, pa të fus përsëri alkool në gojë.

— Kënaqem që e dëgjoj këtë. — Sidoqoftë, Majllsi e mbylli derën me kyç.

Kur i mori prapë paratë e tij, Deni i shpërndau mbi shtrat dhe i ndau në dy grupe, njëri nga të cilat përmbante vetëm bankënotat e reja njëzetdollarëshe, ndërsa tjetri përbëhej nga bankënota të ndryshme, në pjesën më të madhe të ndotura. Nga grupi i dytë, Deni mori tri kartëmonedha dhjetëdollarëshe dhe ia dha Majllsit. — Këto janë për interesimin që tregove për disa gjëra të vogla, biro, si për protezën e dhëmbëve, rrojtjen, llambën me rreze ultraviolet. I çmoj shumë gjërat që bëre.

— Dëgjo, nuk është nevoja të ...

— Merri. Meqë ra fjala, janë para të mira. Tani, më thuaj një gjë.

— Po pata mundësi, do ta them.

— Si mund të kuptosh se këto njëzetdollarëshet janë të falsifikuara?

— Nuk e kuptova menjëherë. Mirëpo, me lente zmadhuese shihet se disa viza të figurës së Endriu Xheksonit nuk janë të qarta.

Deni pohoi me kokë, me një pamje që thoshte se ishte në dijeni.

— Ky është ndryshimi midis shtypjes me një stampë çeliku, që përdoret nga qeveria, dhe fotolitografisë. Sidoqoftë,

një fotolitograf i klasit të parë mund të arrijë në përfundime të shkëlqyera.

— Në këtë rast ia ka arritur qëllimit. Disa pjesë të bankënotave janë gati të përsosura.

Në fytyrën e plakut u formua një buzëqeshje e vogël.

— Ç'mund të thuash për kartën?

— Më gënjeu. Zakonisht, një kartëmonedhë e falsifikuar mund të kuptohet edhe vetëm duke e prekur me majat e gishtave. Por këto, jo.

Deni tha me ngadalë:

— Kartë e posaçme, me qind për qind fije pambuku. Njerëzit kujtojnë se s'ke ku ta gjesh kartën e përshtatme. S'është e vërtetë. Mjafton të dish ku ta kërkosh.

– Në rast se interesohesh, – tha Majllsi, – në dhomën time kam disa libra që flasin për paratë; bile, njëri është botuar nga vetë shërbimi i fshehtë i Shteteve të Bashkuara.
– Mos e ke fjalën për «Mësoni të njihni paratë tuaja»?
Fytyra e Majllsait shprehu habi dhe plaku u zgërdhi. – Ai është manuali i falsifikuesit. Thotë se ç'duhet të shikosh për të dalluar nëse një bankënotë është e falsifikuar. Radhit të gjitha gabimet e bëra nga falsifikuesit. Ka bile edhe fotografitë!
– Po, – tha Majllsi, – e di.
Deni vazhdoi, duke u zgërdhirë:
– Dhe qeveria e jep, pikërisht sikur të ishte fjala për një gjë të parëndësishme! Mjafton të shkruash në Uashington dhe të vjen me postë. Ka qenë një falsifikues shumë i zoti, i quajtur Majk Lendres, që ka shkruar një libër, në të cilin thoshte, ndër të tjera, se njohja e parasë është një gjë e domosdoshme për një falsifikues.
– Lendresi u arrestua, – theksoi Majllsi.

– Kjo ndodhi se punonte me budallenj që s'kishin as organizatë.
– Duket se dini shumë gjëra mbi këtë çështje.
– Diçka. – Deni u ndal, mori një bankënotë të mirë dhe një nga të falsifikuarat dhe i krahasoi. U kënaq nga ky krahasim dhe buzëqeshi. – A e di ti, biro, se monedha amerikane është më e lehta për t'u kopjuar dhe stampuar. Fakti është se ka qenë projektuar në mënyrë të tillë që skalitësit e shekullit të kaluar të mos ishin në gjendje ta riprodhonin me instrumentet që kishin në atë kohë. Mirëpo, që nga ajo kohë, është shpikur makina multilite dhe fotolitografia, kështu që, sot, me një pajisje të mirë dhe pak durim, një njeri i aftë mund të bëjë bankënota që vetëm një ekspert mund t'i dallojë nga të mirat.
– I kam dëgjuar këto dhe më parë, – tha Majllsi, – por sa nga ato hyjnë në qarkullim?
– Tani ta shpjegoj. – Deni ishte shumë i kënaqur që po fliste për subjektin e tij të preferuar. – Askush s'e di me saktësi se ç'sasi stampohet çdo vit pa u zbuluar, por kjo është një sasi e madhe. Qeveria thotë tridhjetë milionë dollarë, nga të cilat një e dhjeta është në qarkullim. Por këto janë shifra zyrtare dhe e vetmja gjë e sigurt lidhur me çfarëdo shifrë zyrtare është se vlera e saj është më e madhe ose më e vogël se realiteti, në varësi të asaj që qeveritarët duan të bëjnë që të besohet. Në këtë rast, ata duan të besohet se kjo vlerë është e vogël. Sipas mendimit tim, çdo vit stampohen bankënota të falsifikuara me një vlerë prej shtatëdhjetë milionë dollarësh, ndoshta njëqind.
– Po, po ka mundësi të jetë kështu, – tha Majllsi. I kujtua se sa para të falsifikuara ishin zbuluar në bankë dhe mendoi se, së paku, një sasi e njëjtë duhet t'i kishte shpëtuar zbulimit.
– A e di se cila është monedha më e vështirë për t'u riprodhuar?
– Jo, nuk e di.

– Çeku i udhëtarit[1]) i shoqërisë Amerikan Ekspress. Dhe e di se pse?
Majllsi tundi kokën në shenjë mohimi.
– Sepse është stampuar me një bojë qielli të veçantë, që është pothuajse e pamundur të riprodhohet me një matricë fotolitografike. Askush nga ata që marrin vesh nga kjo punë nuk do ta humbiste kohën kot duke u përpjekur për ta riprodhuar, kështu që çeket e Am-Exit, janë më të sigurta se paratë amerikane.
– Qarkullojnë fjalë, – tha Majllsi, – se, shpejti, do të ketë në qarkullim bankënota të reja amerikane, me ngjyra të ndryshme për vlera të ndryshme, siç kanë bërë në Kanada.
– Nuk janë fjalë, por fakte. Sasira të mëdha kartëmonedhash me ngjyra janë stampuar dhe i ka grumbulluar Thesari. Ato do të jenë më të vështira për t'u riprodhuar nga cilado kartëmonedhë që është vënë në qarkullim gjer tani.
Deni buzëqeshi me djallëzi. – Po të vjetrat do të mbeten në qarkullim edhe për mjaft kohë; ndoshta për aq kohë sa më mbetet akoma për të jetuar.
Majllsi ndenji në heshtje, duke menduar për gjërat që kishte mësuar. Më në fund, tha:
– Ti më bëre pyetje, Deni, dhe unë t'u përgjigja. Tani, kam edhe unë një pyetje.
– Kjo s'do të thotë se do të të përgjigjem, biro. Por, bëje një herë pyetjen.
– Kush je ti dhe çfarë je?
Plaku e vështroi Majllsin nga koka te këmbët, duke u menduar, ndërsa fërkonte mjekrën me gishtin e madh të njërës dorë. Disa nga mendimet e tij i lexoheshin në fytyrë: një nxitje sinqeriteti, në luftë me qëndrimin e rezervuar. Befas, Deni vendosi të flasë:
— Jam shtatëdhjetë e tre vjeç, — tha ai, — dhe jam mjeshtër

zejtar. Kam punuar si stampues tërë jetën time dhe vazhdoj të jem më i miri në këtë punë. Stampimi nuk është vetëm një zeje, por edhe një art. — Bëri me shenjë nga bankënotat njëzetdollarëshe që ishin akoma mbi shtrat. — Ato janë fruti i punës sime. Unë i kam bërë matriçet. Unë i kam stampuar.
Majllsi pyeti:
— Po patentat dhe letërkreditet?
— Në krahasim me bankënotat — tha Deni, — ato janë të lehta si bukë e djathë. Sidogoftë, edhe ato unë i kam bërë.

Si në ethe nga padurimi, Majllsi priste rastin për t'i njoftuar Nolan Uejnrajtit — me anë të Huanitës — të rejat që kishte mësuar. Mirëpo nuk kishte mundësi të largohej nga Palestra Shtatë-Shtatë dhe rreziku që një gjë të tillë ta bënte me anë të telefonit i dukej tepër i madh.
Të enjten në mëngjes, të nesërmen e ditës kur Deni i kishte treguar hapur mjaft gjëra, plaku dukej se e kishte marrë plotësisht veten nga orgjia e tij alkoolike. Ishte e qartë se i pëlqente shoqëria e Majllsit dhe luajti përsëri shah me të. E vazhdoi edhe bisedën që kishte bërë një ditë më parë, ndonëse në një mënyrë më të përmbajtur. Ndërkaq, nuk ishte e qartë në do ta shpejtonte Deni kohën e largimit të tij, në rast se e dëshironte këtë gjë. Sidogoftë, hipërhë, nuk shfaqte ndonjë dëshirë dhe, bile, dukej i kënaqur me qëndrimin e tij në atë dhomën e vogël të katit të katërt.
Gjatë bisedave të fundit që kishin pasur, si të mërkurën ashtu edhe të enjten, Majllsi ishte përpjekur të mësonte gjëra të tjera mbi veprimtarinë e Denit si falsifikues parash, duke bërë edhe ndonjë pyetje të maskuar mbi selinë e organizatës. Mirëpo, Deni kishte ndërruar gjithmonë bisedë dhe Majllsi e kishte pasur të qartë se Denit i vinte keq që i ishte hapur në atë mënyrë. Duke sjellur ndërmend këshillën e Uejnrajtit («mos u nxito, ki durim»), Majllsi vendosi të mos kërkojë tepër nga fati.
Me gjithë ngazëllimin që ndjente, kishte një mendim që e trishtonte. Ato që kishte zbuluar gjer në atë çast mjaftonin për

arrestimin dhe burgosjen e Denit. Mirëpo, ai vazhdonte të kishte simpati për plakun dhe i vinte keq kur mendonte për fatin që me siguri, e priste. Prapëseprapë, thoshte me vete se kjo ishte e vetmja rrugë që duhej ndjekur për të siguruar reabilitimin e tij.
Si Ominski, fajdexhiu, ashtu dhe Toni Ber Marino, ishin të pleksur me Denin, ndonëse nuk ishte e qartë se në ç'mënyrë. Majllsi nuk bëhej merak për fatin e rusit Ominski,ose të Toni Berit, por ndjente ta përshkonte një rrëqethje e ftohtë tmerri kur i shkonte mendja se ata mund të viheshin në dijeni — siç e mendonte se kjo duhet të ndodhte herët a vonë — të rolit të tij prej tradhtari.
Të enjten, afër mbrëmjes, Xhuls LaRoka erdhi përsëri.
— Kam një mesazh nga Toni, — i tha ai Denit. — Nesër në mëngjes të dërgon veturën.
Deni u mjaftua me një lëvizje të kokës, por Majllsi pyeti:
— Veturën për ta çuar ku?
Si Deni, ashtu edhe LaRoka, i hodhën një vështrim depërtues, pa u përgjigjur, dhe ai u pendua që s'e kishte mbyllur gojën.
Atë mbrëmje, duke vendosur që t'ia hynte një rreziku të pranueshëm, Majllsi i telefonoi Huanitës. Ai priti deri sa e mbylli Denin në dhomën e tij, pak para mesnatës, pastaj zbriti në katin përdhes, ku gjendej një telefon me pagesë. Futi një monedhë dhe formoi numrin e Huanitës. Pas tingëllimit të parë të ziles, u dëgjua zëri i saj që tha me zë të ulët:
— Alo!
Telefoni ishte instaluar në mur, pa kabinë, pranë barit, dhe Majllsit iu desh të pështpëriste me kujdes që të mos e dëgjonte ndokush.
— Ti e di kush jam, por mos zë në gojë emra.
— Po, — murmuri Huanita.
— Thuaj mikut tonë se këtu kam zbuluar gjë të rëndësishme, me të vërtetë të rëndësishme. Pothuajse gjithçka ai donte të dinte. S'mund të them më shumë, por do të vij tek ai nesër mbrëma.
— Në rregull.

Majllsi e vendosi receptorin në vendin e tij.
Në të njëjtin çast, një magnetofon, i fshehur në bodrumin e palestrës, i cili ishte hapur automatikisht kur Majllsi pati ngritur receptorin, po ashtu automatikisht u mbyll.

Disa vargje të Gjenezës vezullonin herë pas here në mendjen e Rosko Hejuordit, si reklamat e projektuara në ekran për një fraksion sekonde: mund të hash lirisht nga frutet e çdo peme të këtij kopshti, por jo nga ato të pemës së njohjes së të mirës dhe të keqes, sepse dita që do ta bësh këtë, do të shënojë mbarimin e sigurt të jetës sate.

Kohët e fundit, Hejuordin e mundonte një pyetje: mos ishte bërë marrëdhënia e tij e paligjshme me Avrilin, që kishte nisur atë të shtunë me hënë, në Bahama, pema e tij e së mirës dhe e së keqes, nga e cila ai do të këpuste më të hidhurën e frutave? Dhe mos ishte ndoshta kjo prapësi që po ndodhte — dobësia ekonomike e papritur dhe alarmuese e Suprënejshnëlit, që mund të shkaktonte dështimin e synimeve të tij ambicioze në bankë — një ndëshkim që i jepte perëndia?

Nga ana tjetër, në rast se i priste menjëherë dhe në mënyrë të vendosur të gjitha lidhjet me Avrilin dhe e fshinte atë krejtësisht nga mendja e tij, a do ta falte perëndia? A do t'ia kthente ai, në shenjë përdëllimi, fuqinë Suprënejshnëlit dhe, me anë të kësaj, të bënte që të lulëzonte përsëri fati i shërbëtorit të tij, Roskoit? Mendoi se po, duke sjellë në mend fjalët e Nehemisë... «O zot, Ti je i dhembshur, i mëshirshëm, i gatshëm për të falur, i durueshëm dhe zemërgjerë...»

E keqja qëndronte në faktin se s'mund të ishte i sigurt.

Një gjë tjetër që e vështirësonte ndarjen nga Avrili ishte se ajo do të vinte në qytet të martën, siç e kishin vendosur javën e mëparshme. Duke qenë i zhytur në një mori problemesh, Hejuordi mezi priste çastin që ta takonte.

Gjatë tërë ditës së hënë dhe mëngjesit të së martës, ai rrinte në zyrë, i pavendosur dhe tërë ngurrim se ç'duhej të bënte, mbasi e kishte të qartë se mund t'i telefononte Avrilit në Nju

Jork dhe ta anulonte takimin. Ai i dinte oraret e avionëve që vinin nga Nju Jorku dhe, të martën, kur kishte kaluar një pjesë e mirë e paradites, e pa se tanimë ishte tepër vonë dhe e ndjeu veten të lehtësuar nga mendimi se s'kishte më mundësi të merrej vendim.

Avrili telefonoi pasdite vonë, duke përdorur numrin që nuk ishte shënuar në numërator dhe që komunikonte drejtpërdrejt me zyrën e tij.

— Ç'kemi, Rosi? Jam në hotel. Apartamenti 432. Shampanja është në akull, por unë jam tërë zjarr për ty.

Hejuordit i erdhi keq që s'i kishte sugjeruar të zinte një dhomë, në vend të një apartamenti, meqë do të paguante ai. Për të njëjtën arsye, shampanja iu duk diçka e panevojshme, e tepërt dhe i bëri vetes pyetjen nëse do të shikohej si një mungesë mirësjelljeje, në rast se i sugjeronte ta kthente atë. Mendoi se kishte të ngjarë që ashtu të shikohej.

— Mbas pak do të jem me ty, e dashur, — i tha ai.

Bëri një kursim të vogël, duke shkuar në hotelin «Kolumbia Hilton» me një veturë dhe shofer të bankës. Hejuordi i tha shoferit:

— Mos më prit!

Sapo hyri në apartamentin 432 krahët e saj e pushtuan dhe buzët e saj të plota u ngjitën tërë pasion pas buzëve të tij. Hejuordi e shtrëngoi fort, duke ndier t'i pushtonte menjëherë tërë trupin nxitja dhe joshja që njihhte tanimë mirë dhe dëshironte me aq zjarr. Pas disa çastesh, Avrili u shkëput nga përqafimi, duke i bërë një përkëdhelje në faqe.

— Rosi, pse të mos heqim qafe më parë anën ekonomike të kësaj pune? Kështu që, pastaj, s'do të kemi më nevojë të merremi me të.

Hejuordi u shtang nga prakticiteti i saj i papritur. I bëri vetes pyetjen nëse kështu bëhej gjithnjë — së pari pagesa dhe

pastaj kënaqësia? Mendoi se nuk ishte një veprim i gabuar. Në qoftë se lihej për më vonë, klienti, jo më nën nxitjen e çastit dhe me dëshira të plotësuara, mund të mos kishte shumë dëshirë për të paguar.

— Shumë mirë, — tha ai. — Kishte futur që më parë dyqind dollarë në një zarf, të cilin ia dha Avrilit. Ajo i nxori paratë dhe filloi t'i numëronte. Ai e pyeti:

— Nuk ke besim tek unë?

— Dua të të pyes diçka, — i tha ajo. — Ta zëmë se unë derdh para në bankën tënde, a i numëron ato arkëtari?

— Sigurisht, i numëron.
— E po, Rosi, edhe njerëzit kanë po aq të drejtë sa edhe bankat të kujdesen për veten e tyre. — Ajo mbaroi së numëruari dhe vërejti:
— Këto janë të dyqind dollarët për mua. Pastaj kemi biletën e avionit dhe taksinë, që bëjnë njëqind e njëzet dollarë; apartamentin, tetëdhjetë e pesë, shampanjën e bakshishet, njëzet e pesë. Le të themi, edhe nja dyqind e pesëdhjetë dollarë të tjerë? Këto duhet t'i mbulojnë të gjitha shpenzimet.
I tronditur nga shuma totale, ai protestoi:
— Kjo është një goxhë shumë parash.
— Edhe unë jam një goxhë grua. Kjo nuk është më shumë nga ç'shpenzonte Suprënejshnëlit, kur paguanin ata dhe, atëherë, nuk dukej se ti bëheshe merak për këtë. Veç kësaj, gjëja e mirë, paguhet shumë.
Zëri i saj kishte një nuancë të ftohtë e të vendosur dhe ai e pa se kishte përpara një Avril tjetër, më dinake dhe më të ashpër se krijesa që lëshonte gjithnjë rrugë dhe ishte aq e etur për të kënaqur të tjerët, siç kishte qenë ajo deri pak më parë. Pa dëshirë, Hejuordi nxori dyqind e pesëdhjetë dollarë nga portofoli dhe ia dha.
Avrili e futi tërë shumën e të hollave në një ndarje të brendshme të çantës së saj.
— Në rregull! Mbaruam me këtë punë! Tani mund të merremi me dashuri.

Ajo u kthye nga ai dhe e puthi tërë afsh, duke lëvizur njëkohësisht gishtat e saj të gjatë e të shkathët nëpër flokët e tij. Dëshira për të, që ishte topitur për një çast, filloi t'i ngjallej Hejuordit përsëri.
— Rosi, i dashur, — i murmuriti ajo, — kur erdhe këtu, kishe një pamje të lodhur dhe të preokupuar.
— Kohët e fundit kam pasur disa probleme në bankë.
— Atëherë, do të bëj që t'i harrosh. Tani do të të jap ca shampanjë dhe, pastaj, edhe veten time. — Avrili e hapi me shkathtësi shishen e shampanjës, që ishte në kovën me akull, dhe mbushi dy gota. Ata pinë së bashku. Kësaj here, Hejuordi as që e mori mundimin të përmendte se bënte pjesë në ata njerëz që nuk vënë pije alkoolike në gojë. Pas pak, Avrili filloi ta zhvishte atë dhe veten...
... Çasti magjik kaloi. Ai do të mbetej, mendoi Hejuordi, si një kujtim tjetër i ëmbël, duke iu shtuar të tjerëve.

Ndenjën për një kohë të shtrirë, në një molisje të ëmbël, ndërsa jashtë, muzgu po ia lëshonte vendin errësirës dhe dritat e qytetit po ndizeshin. Avrili u ngrit e para. Ajo shkoi në dhomën e ndenjies dhe u kthye me dy gota me shampanjë, të cilat i pinë pak nga pak, në shtrat, duke biseduar.
Pas pak, Avrili tha:
— Rosi, dua të më japësh një këshillë.
— Lidhur me çfarë? (Ç'e fshehtë e një vajze të re do t'i thuhej tani në mirëbesim?)
— A duhet t'i shes aksionet e mia të Suprënejshnëlit?
I zënë në befasi, ai e pyeti:
— Ke shumë nga ato?
— Pesëqind. E di se për ty nuk janë një kapital i madh, por për mua po. Ato përfaqësojnë rreth një të tretën e kursimeve të mia.
Hejuordi bëri me të shpejtë një llogari me mend: «kursimet» e Avrilit ishin afërsisht shtatë herë më të mëdha se të tijat.
— Ç'ke dëgjuar për SuNatKo-n? Ç'të shtyn ta bësh këtë pyetje?
— Pikë së pari, Suprënejshnëli e ka pakësuar shumë numrin e

klientëve që na dërgon me shpenzimet e veta dhe, pastaj, kam dëgjuar se ka mungesë parash dhe nuk i shlyen llogaritë. Disa nga vajzat e tjera i kanë këshilluar t'i shesin aksionet e tyre, por unë s'i kam shitur akoma të mijat, sepse tani vlejnë më pak se kaq kur i bleva.
— E ke pyetur Kuortermiejnin?
— S'e kemi parë fare kohët e fundit. Rrezehëna... Të kujtohet Rrezehëna, apo jo?
— Po. — Hejuordit iu kujtua se Xhorxhi i madh i kishte ofruar t'ia dërgonte atë vajzën e lezetshme japoneze në dhomën e tij. Pyeti veten se si do të kishte përfunduar ajo punë, po të kishte pranuar.
— Rrezehëna thotë se Xhorxhi ka shkuar në Kosta Rika dhe se, ndoshta, do të rrijë atje. Ajo thotë gjithashtu se, para se të nisej, ka shitur mjaft nga aksionet e SuNatKo-s që kishte.
Hejuordi tha me vete se pse s'i kishte rënë në mend, disa javë më parë, ta shfrytëzonte Avrilin si burim informatash.
— Po të isha në vendin tënd, do t'i shisja që nesër aksionet, qoftë edhe me humbje.
Avrili psherëtiu.

– Të fitosh para është një punë mjaft e vështirë, por është akoma dhe më e vështirë t'i ruash ato.
– E dashur, sapo the një të vërtetë financiare themelore. Për një çast ra heshtje dhe, pastaj, Avrili tha:
– Do të të kujtoj si një njeri simpatik, Rosi.
– Faleminderit. Edhe unë do të ruaj një mendim të veçantë për ty. Ai mendoi: të dy e kishin pranuar se kjo ishte hera e fundit që takoheshin. Një arsye ishte e rendit praktik: ai nuk ishte më në gjendje, nga ana ekonomike, t'i vazhdonte marrëdhëniet me Avrilin. Veç kësaj, kishte ndijimin se po përgatiteshin ndryshime të mëdha, se po afrohej çasti i zgjedhjes së një krize. Kush e dinte se ç'do të ndodhte pas kësaj?
Pikërisht, kur po fillonin të bënin prapë dashuri, atij i ra në mend preokupimi që kishte pasur jo shumë kohë më parë për zemërimin e perëndisë. Ndoshta perëndia – i ati i Krishtit, që

kishte njohur dobësinë njerëzore dhe kishte ndenjur e folur me aq shumë mëkatarë dhe kishte vdekur bashkë me vjedhës – do ta kuptonte atë. Do të kuptonte dhe do të falte të vërtetën e pamohueshme se çastet më të ëmbla në jetën e Rosko Hejuordit kishin qenë ato që ai kishte kaluar në shoqërinë e një prostitute.

Kur doli nga hoteli, Hejuordi bleu një gazetë të mbrëmjes. I tërhoqi vëmendjen një titull në dy kolona, në gjysmën e poshtme të faqes së parë:

SHQETËSIM PËR SUPRËNEJSHNËL KORPOREJSHËNIN
SA ËSHTË NË GJENDJE TË PAGUAJË SHUMËKOMBËSHJA VIGANE?

Askush nuk e mësoi se cili kishte qenë pikërisht fakti, në rast se një fakt i tillë kishte ekzistuar, që kishte shkaktuar shembjen përfundimtare të Suprënejshnëlit. Ndoshta kishte qenë një incident i veçantë; ose, mund të kishte qenë pesha e përbashkët e shumë incidenteve të tilla, që kishte shkaktuar prishjen e ekuilibrit të balancës, siç bën një presion shumë i madh mbi armaturën që mban një çati, deri sa kjo s'qëndron më dhe papritur shembet.
Siç ndodh gjithmonë me falimentimin financiar të një ndërmarrjeje publike, muaj më parë kishin filluar të dukeshin simptoma të ndryshme dobësie, por vetëm vëzhguesit më të mprehtë, si për shembull Luis d'Orseji, e kishin kuptuar natyrën e tyre dhe kishin tërhequr vëmendjen e një numri të vogël të privilegjuarish.
Natyrisht, të brendshmit – duke përfshirë edhe Xhorxhin e madh Kuortermejn, i cili, siç u mësua më vonë, kishte shitur pjesën më të madhe të aksioneve të tij me ndërmjetësinë e një personi tjetër, në kohën kur duhej se punët e SuNatKo-s shkonin shumë mirë – ishin në dijeni të gjendjes së vërtetë më

shumë se kushdo tjetër dhe kishin marrë me të shpejtë masat e duhura. Të njëjtën gjë kishin bërë dhe të tjerë, të njoftuar nga informatorë të fshehtë, ose nga miq, që, në këtë mënyrë, lanin një nder a favor që u ishte bërë më parë.
Pastaj vinin ata, si Aleks Vandervurti, që kishin marrë informata të veçanta dhe kishin hequr qafe me të shpejtë të gjitha aksionet e SuNatKo-s që kishin, duke shpresuar se, në konfuzionin e madh që do të ndodhte, veprimi i tyre nuk do të binte në sy. Institucione të tjera – banka, institute investimi dhe të fondeve reciproke – duke parë se aksionet e SuNatKo-s vazhdonin të binin dhe duke e ditur funksionimin e brendshëm të punës, e kishin kuptuar shpejt gjendjen dhe ishin shpejtuar t'i shisnin aksionet e tyre.
Është e vërtetë se kishte ligje federale që ndalonin shitblerjen e titujve, në bazë lajmesh që s'ishin akoma zyrtare. Por këto ligje kishin mbetur në letër. Duke qenë se zbatimi i tyre ishte i vështirë, praktikisht ato shkeleshin çdo ditë. Herë-herë, kur ndodhte ndonjë rast flagrant, ky mbyllej me një gjobë të vogël. Por edhe kjo ishte një gjë e rrallë.
Si zakonisht, të fundit që e mësuan se kishte diçka që s'shkonte mirë ishin depozituesit, masa e madhe naive që besonte ç'i thuhej, që shpresonte.
Njoftimi i parë publik për gjendjen e vështirë në të cilën gjendej SuNatKo-ja u dha nga një lajm agjencie, të transmetuar nga Asoshiejtid Presi dhe botuar në gazetat e pasdites – pikërisht artikulli që kishte lexuar ai Hejuordi duke dalë nga hoteli "Kolumbia Hilton." Të nesërmen në mëngjes, shtypi kishte botuar edhe disa hollësi të tjera. Gazetat e mëngjesit, duke përfshirë edhe «Uoll Strit Zhurnëllin», botonin reportazhe me të dhëna më të shumta. Prapëseprapë, hollësitë ishin të pakta dhe, prandaj, shumë njerëz e kishin të vështirë të besonin që një ndërmarrje aq e mjaftë se

Suprënejshnëll Kor-porejshëni të mund të ishte në gjendje të vështirë.
Nuk kaloi shumë kohë dhe ky besim mori një goditje të fortë. Në orën dhjetë, në Bursën e Nju Jorkut, aksionet e Suprënejshnëllit nuk u hapën për veprimet e zakonshme me pjesën tjetër të tregut. Arsyeja që u dha ishte një prishje e balancës së kërkesave. Kjo do të thoshte se specialistin tregtar të SuNatKo-s e kishte mbuluar batica e kërkesave për «shitje» dhe nuk mund të sigurohej një tregtim i rregullt i aksioneve. Veprimet e tregtimit të SuNatKo-s u hapën në orën njëmbëdhjetë, kur mbërriti një urdhër për blerjen e 52.000 aksioneve. Mirëpo, në atë kohë aksionet e saj kishin rënë në 19, ndërsa një muaj më parë ishin kuotuar në dyzet e tetë e gjysmë. Pasdite, kuotimi u mbyll në 10.
Kishte të ngjarë që, të nesërmen, Bursa e Nju Jorkut ta bllokonte tregtimin, por para saj ndërhyri enti i kontrollit të tregut aksionar, i cili njoftoi se kishte hapur një anketë mbi Suprënejshnëlin dhe se shitblerja e aksioneve të SuNatKo-s pezullohej deri në përfundimin e saj.
Vazhduan edhe pesëmbëdhjetë ditë tërë ankth për aksionistët dhe kreditorët që kishin mbetur të SuNatKo-s, investimet dhe huatë përkatëse të të cilëve i kalonin të pesë miliard dollarët. Ndërmjet atyre që prisnin — të tronditur, tërë shqetësim dhe padurim — ishin dhe funksionarët e këshilltarët të Fërst Merkentajll Ëmerikën Benkut.

Suprënejshnëli nuk mundi të «qëndronte në këmbë edhe për disa muaj», siç kishin shpresuar Aleks Vandervurti dhe Xherom Petërtoni. Prandaj ekzistonte mundësia që operacionet e fundit në tituj të SuNatKo-s — duke përfshirë edhe shitjen e fundit të madhe të aksioneve nga seksioni fiduciar i FMA-së — të anuloheshin. Kjo mund të bëhej në dy

mënyra: ose me një urdhër të SEC-it, pas një ankese; ose, me anë të një padie të ngritur nga ana e blerësve të aksioneve, të cilët të pretendonin se FMA-ja kishte qenë në dijeni të kushteve të Suprënejshnëlit, por i kishte mbajtur të fshehta. Në rast se një gjë e tillë do të ndodhte, kjo do të përfaqësonte një humbje edhe më të madhe për titullarët e depozitimeve fiduciarë se ajo që kishin pësuar gjer në atë kohë.
Veç kësaj, duhej parashikuar dhe një mundësi tjetër, e cila kishte mjaft të ngjarë të ndodhte. Huaja prej pesëdhjetë milionë dollarësh, dhënë SuNatKo-s, të mos kthehej më, të ishte një humbje e plotë. Po të ndodhte kështu, FMA-ja do të pësonte, për herë të parë në historinë e saj, një humbje të madhe për vitin në vazhdim, gjë që e shtonte mundësinë që të mos u paguante aksionistëve përpjesët e aksioneve në mbyllje të vitit financiar. Edhe kjo do të ndodhte për herë të parë. Në sferat e larta të bankës mbizotëronte një gjendje shpirtërore e pezmatuar dhe pasigurie.
Vandervurti e kishte thënë që më parë se kur të dilte në dritë çështja e Suprënejshnëllit, shtypi do të fillonte të fuste hundët dhe do ta fuste në valle Ërst Merkentajll Ëmerikën Benkun. Edhe në këtë pikë, parashikimi i tij kishte qenë i drejtë. Gazetarët, që vitet e fundit kishin shpresuar të ndiqnin shembullin e Bershtajnit dhe Udordit, heronjve të Uotrgejtit të gazetës «Uashington Post», iu vunë punës dhe rrëmuan thellë. Përpjekjet e tyre u kurorëzuan me sukses. Brenda pak ditëve filluan të dalin në dritë hollësi lidhur me manevrat e Kuortermëjnit dhe me «kontabilitetin kinez» të Suprënejshnëlit, si edhe me shumën jashtëzakonisht të madhe të borxheve, po ashtu edhe me operacione të tjera financiare, duke përfshirë edhe huanë prej pesëdhjetë milionë dollarësh, të dhënë nga FMA-ja.
Kur agjencitë e lajmeve transmetuan lajmet e para mbi lidhjet

e FMA-së me Suprënejshnëlin, Dik Frençi, drejtori i zyrës së marrëdhënieve publike të FMA-së, kërkoi të bëhej një mbledhje e ngutshme, në nivel presidencial. Dhe ashtu u bë. Ishin të pranishëm Xherom Petërtoni, Rosko Hejuordi, Aleks Vandervurti dhe vetë Dik Frençi, si zakonisht, me puron e pandezur në cep të buzës.
Fytyrat dhe i tërë qëndrimi i tyre pasqyronin gjendjen serioze, në të cilën ndodhej banka. Petërtoni kishte një pamje të zymtë, e mila si hiqej që prej disa ditëve. Hejuordi dukej i këputur, i turbulluar dhe nën një tension të fortë nervor. Aleksi ishte pushtuar nga një zemërim që kishte ardhur gjithnjë duke u rritur, për shkak të faktit se ishte përfshirë në një katastrofë, për të cilën ishte paralajmëruar kolegët e tij dhe që në asnjë mënyrë nuk duhet të kishte ndodhur.
— Brenda një ore, ose edhe më pak, — tha Dik Frençi, — do të më bombardojnë me pyetje për hollësi lidhur me operacionet tona me SuNatKo-n. Dua të di qëndrimin tonë zyrtar dhe ç'përgjigje duhet të jap.
Petërtoni pyeti:
— Jemi të detyruar të japim përgjigje?
— Jo, — tha Frençi, — por, në rast se e shohim punën kështu, askush s'është gjithashtu i detyruar të bëjë harakiri.
— Pse të mos pranojmë, — sugjeroi Rosko Hejuordi, — që jemi kreditorë të Suprënejshnëlit, pa dhënë hollësi të tjera?
— Sepse s'kemi të bëjmë me meshko, ja sepse. Midis gazetarëve do të ketë edhe komentatorë me përvojë të çështjeve financiare, që i dinë ligjet bankare. Prandaj, pyetja e tyre e dytë do të jetë: Si shpjegohet që banka juaj i ka dhënë hua një debitori të vetëm një shumë kaq të madhe të depozituar te ju?
Hejuordi ia priti me ton të ftohtë:
— Nuk është fjala për një debitor të vetëm. Huaja u nda

ndërmjet Suprënejshnëlit dhe firmave të tjera të lidhura me të.
— Kur të them një gjë të tillë, — tha Frençi, — do të përpiqem të bëj sikur e besoj. Hoqi puron nga goja, e la në tavolinë dhe nxori një bllok shënimesh. Kështu pra, më jepni hollësi. Pavarësisht se ç'do të bëjmë ne, kjo punë do të dalë në shesh; por, do të bënim një përshtypje më të keqe, në rast se do të na e nxirrnin me marë, si një dhëmb të prishur.
— Para se të vazhdojmë, — tha Hejuordi, — ndoshta duhet t'ju përmend se ne s'jemi e vetmja bankë së cilës Suprënejshnëli i ka para hua. Të tilla janë Fërst Nejshnël Siti, Bënk ov Amerika dhe Çejz Menhetëni.
— Por të gjitha ato janë në krye grupimesh bankash, — theksoi Aleksi, — kështu që, çdo humbje ndahet me bankat e tjera. Me sa dimë ne, banka jonë është e vetmja që ka një kredit aq të madh, pa pjesëmarrjen e të tjerave. — Nuk iu duk se ishte rasti për të shtuar se ai i kishte paralajmëruar të gjithë, duke përfshirë edhe këshilltarët, se një përqëndrim i tillë rreziku ishte me pasoja për FMA-në dhe, ndoshta, edhe i paligjshëm. Por, ndërkaq, vazhdonte të ndjente një shije të hidhur në gojë.
Ata përpiluan kopjen e një deklarate, në të cilën pranohej shuma e madhe që i ishte dhënë hua Suprënejshnëlit nga Fërst Merkitail Bënku dhe lihej të ndjehej njëfarë shqetësimi. Veç kësaj, shprehej shpresa që shumëkombëshja të mund ta kapërcente këtë çast të vështirë, ndoshta me një drejtim të ri, gjë për të cilën FMA-ja do të ushtronte presion, dhe t'i ulte humbjet në minimum. Por kjo ishte një shpresë e kotë dhe të gjithë të pranishmit e dinin këtë.
Dik Frençit iu dha njëfarë lirie veprimi, për ta zgjeruar deklaratën, po ta shihte një gjë të tillë të nevojshme dhe u vendos që ai të ishte i vetmi zëdhënës i bankës.
Frençi tha:

— Shtypi do të përpiqet të bjerë në kontakt me secilin nga ju, veç e veç. Në qoftë se doni që deklarata jonë të mbetet e pranueshme, m'i kaloni mua thirrjet telefonike dhe e udhëzoni personelin tuaj të veprojë njëlloj.
Po atë ditë, Aleks Vandervurti i shqyrtoi përsëri masat e jashtëzakonshme që kishte parashikuar dhe përgatitur për të përballuar gjendjen, në rast se vërtetoheshin disa rrethana të caktuara.

— Ka diçka të sëmurë në tërë këtë zhurmë që bëhet për një bankë në gjendje të vështirë, — vërejti Eduina d'Orseji.
Ajo po shfletonte gazetat e shpërndara nga të gjitha anët, në sallën e konferencave të zyrës së Aleks Vandervurtit, në grataciellin e FMA-së. Ishte ditë e enjte, të nesërmen e konferencës së shtypit të Dik Frençit.
Gazeta lokale «Tajms-Rexhistër» kishte një titull që zinte tërë gjerësinë e faqes së parë:

NJË BANKË LOKALE PARA NJË HUMBJEJE SHUMË TË MADHE NË VAZHDËN E FALIMENTIMIT TË SUNATKO-S

Në një mënyrë më të përmbajtur, gazeta «Nju Jork Tajms» informonte kështu lexuesit e saj:

BANKA FMA DEKLAROHET NË GJENDJE TË SHLYEJË DETYRIMET E SAJ
ME GJITHË PROBLEMET QË KA PËR TË SHTËNË PËRSËRI NË DORË SHUMAT
E DHËNA HUA

Këto njoftime ishin dhënë gjithashtu në lajmet e së mërkurës mbrëma dhe të të enjtes në mëngjes.
Të gjitha reportazhet përmbanin një deklaratë të nxituar të Rezervës Federale, sipas së cilës Ferst Merkëntajll Ëmerikën Benku ishte plotësisht në gjendje të shlyente detyrimet
e veta dhe, prandaj, njerëzit që kishin depozituar para në

të nuk kishin sepse të dilarmoheshin. Pavarësisht nga kjo, Rezerva Federale e kishte vënë FMA-në në «listën e zezë» dhe, atë mëngjes, i kishte dërguar një ekip inspektorësh. Ishte e qartë se kjo ishte e para e një vargu vizitash të këtij lloji nga ente të ndryshme kontrolli.
Tom Stroani, ekonomisti i bankës, iu përgjigj vërejtjes së Eduinës:
— Në të vërtetë, nuk është diçka e sëmurë që nxit vëmendjen dhe zhurmën që bëhet kur një bankë është në gjendje të vështirë. Unë mendoj se është më tepër frika. Frikë nga ana e njerëzve që kanë depozituar të holla, se mos falimenton banka dhe ata humbasin paratë e tyre. Po ashtu, edhe një frikë tjetër, me rrjedhoja më të gjera: frika se falimentimi i një banke ndiqet nga të tjera, gjer në shembjen e tërë sistemit.
— Ajo që më tremb, — tha Eduina, — është efekti i këtij publiciteti.
— Edhe mua kjo më shqetëson, — shtoi Aleks Vandervurti. — Prandaj duhet ta ndjekim gjendjen me kujdes për të parë efektin që do të ketë.
Aleksi e kishte organizuar këtë mbledhje për të vendosur mbi strategjinë që duhej ndjekur. Midis atyre që merrnin pjesë, kishte shefa të seksioneve që kishin në varësi administrimin e degëve të bankës, mbasi të gjithë e kishin të qartë se çdo mungesë besimi nga ana e publikut te FMA-ja, do të ndihej së pari te degët e saj. Më parë, Tom Stroani kishte njoftuar se, nga mbarimi i ditës së mëparshme dhe atë mëngjes, tërheqjet kishin qenë më të mëdha se zakonisht dhe derdhjet më të vogla, ndonëse ishte akoma shumë shpejt për të pohuar se ishte fjala për një prirje të qartë. Fatmirësisht nuk ishin shfaqur shenja paniku midis klientëve të bankës, ndonëse drejtorët e të tetëdhjetë e katër degëve të FMA-së ishin udhëzuar që të njoftonin menjëherë sapo të vëreheshin shenja të tilla. Bankat vazhdojnë të jetojnë pas tronditjesh të tilla, në sajë të zërit të mirë që mund të kenë dhe besimit të të tjerëve — bimë delikate, që një fat jo dashamirës ose një publicitet jo i favorshëm mund të bëjnë që të fishken.

Një nga qëllimet e mbledhjes ishte që të bëhej e qartë se ishin kuptuar mirë masat që duheshin marrë, në rastin e një krize të papritur. Rezultati qe i kënaqshëm.
— Kaq tani për tani, — u tha Aleksi të tjerëve. — Do të mblidhemi përsëri nesër, në të njëjtën orë.
Por kjo nuk u bë.
Në orën 10.15 të ditës së nesërme, e premte, drejtori i degës së bankës së FMA-së në Tilersvil, nja tridhjetë kilometra më në veri, i telefonoi Drejtorisë Qendrore dhe thirrja e tij iu kalua menjëherë Aleks Vandervurtit.
Kur iu paraqit drejtori — Fergës W. Getuik — Aleksi e pyeti me një zë plot shqetësim:
— Si është puna?
— Dyndje te sportelet, ser. Dega e bankës është mbushur plot me njerëz. Më shumë se njëqind nga klientët tanë të rregullt, me libreza dhe blloqe çekesh në duar, janë vënë në radhë. Ndërkaq vazhdojnë të vijnë të tjerë. Tërheqin të gjitha depozitimet e tyre, gjer në dollarin e fundit, ose dhe i mbyllin fare llogaritë. — Zëri i drejtorit ishte ai i një njeriu të alarmuar, që mundohet të duket i qetë.
Aleksin e përshkoi një rrëqethje e ftohtë. Një dyndje te sportelet — tmerri i të gjithë bankierëve — Pikërisht kësaj i trembëshin, gjatë ditëve të fundit, më shumë se çdo gjëje tjetër, ai dhe funksionarët e tjerë të lartë të bankës.
Një dyndje e tillë do të thoshte se ishte krijuar një panik publik, një humbje e plotë besimi. Akoma më keq, kishte mundësi që, me t'u përhapur lajmi për këtë, e njëjta gjë të ndodhte gjithashtu edhe në degët e tjera të FMA-së, duke u përhapur me rrëmbimin e një zjarri që nuk mund të shuhet dhe që përfundon në një katastrofë. Asnjë bankë, as edhe më e madhja dhe më e qendrueshmja, nuk mund të disponojë një sasi aq të madhe parash në dorë, sa të paguajë menjëherë

pjesën më të madhe të personave që kanë hapur llogari në të, në rast se të gjithë do të kërkonin para në dorë. Prandaj, në qoftë se dyndja do të vazhdonte, rezervat e parave që disponoheshin do të mbaroheshin dhe FMA-ja do të detyrohej
të mbyllte dyrt, ndoshta përgjithmonë.
Një gjë e tillë kishte ndodhur më parë me banka të tjera. Për shkak të kombinimit të një drejtimi jo të mirë, veprimesh të pavolitshme dhe fati të keq, kjo mund t'i ndodhte cilësdo bankë.
Puna e parë që duhej bërë, mendoi Aleksi, ishte të siguroheshin ata që donin të tërhiqnin paratë e tyre, se, për këtë, nuk do të hasnin asnjë vështirësi. E dyta ishte që, ajo që ndodhi, të mbetej e kufizuar e të mos përhapej në degët e tjera.

Udhëzimet që i dha drejtorit të degës së bankës së Tilersvilit qenë të përcaktuara mirë:
— Fergjiz, ju dhe personeli juaj duhet të veproni sikur të mos ketë ndodhur asgjë e jashtëzakonshme. Ktheni, pa bërë diskutime, çfarëdo shume që njerëzit duan të tërheqin nga llogaritë e tyre; dhe, mos u sillni nëpër bankë me pamje të preokupuar, por gazmore.
— Nuk do të jetë punë e lehtë, sër, por do të përpiqem.
— Nuk duhet vetëm të përpiqeni, por ta bëni. Në këtë çast, e tërë banka jonë mbështetet në shpatullat tuaja.
— Po, sër.
— Do të vijmë në ndihmën tuaj sa më parë që të jetë e mundur. Sa para keni në thesar?
— Rreth njëqind e pesëdhjetë mijë dollarë, — u përgjigj drejtori. — Mendoj se, me ritmin e tanishëm, do të mund të vazhdojmë për një orë, jo më tepër.
— Do t'ju sjellim para, — e siguroi Aleksi. — Ndërkaq, nxirrini paratë që keni nga thesari dhe vendosini në tryeza dhe vende ku njerëzit të mund t'i shohin mirë. Pastaj, shkoni

pranë klientëve tuaj dhe bisedoni me ta. Flisni me ta; sigurojini se banka jonë është në gjendje shumë të mirë, pavarësisht nga ato që kanë lexuar në gazetat, dhe u thoni se të gjithë mund t'i marrin përsëri paratë e tyre.

Aleksi e vendosi receptorin në vend dhe, me një aparat tjetër, thirri pa humbur kohë Stroanin.
— Tom, filloi në Tilersvil. Dega e bankës atje ka nevojë të ngutshme për ndihmë dhe për para. Vëre në zbatim planin numër një të gjendjes së jashtëzakonshme.

Rrethi i Tilersvilit, siç ndodh me vetë njerëzit, ishte në atë fazë zhvillimi, kur bëhen përpjekje për «të gjetur rrugën» që duhet ndjekur. Ai ishte një përzierje e veprimtarisë së një lokaliteti tregtar dhe veprimtarisë bujqësore, që tanimë i kishte lëshuar pjesërisht vendin qytetit që po zhvillohej me shpejtësi, por ruante akoma mjaft nga tiparet e origjinës së vet, sa t'i qëndronte edhe për njëfarë kohe urbanizimit.

Banorët e tij përbëheshin nga përzierja e dy grupeve: familjet e vjetra konservatore, të lidhura ngushtë me veprimtarinë bujqësore e tregtare, dhe banorët e ardhur rishtas. Shumë nga këta të fundit ishin vendosur ayty sepse ishin neveritur nga humbja e vlerave morale të qytetit, prej nga ishin larguar, dhe donin të gëzonin, bashkë me familjet e tyre, diçka nga zakonet e vjetra, të qeta, fshatareke, para se këto të zhdukeshin. Rezultati i kësaj shkrirjeje të të dy grupeve ishte një aleancë heterogjene fshatarësh të mirëfilltë dhe të tjerë që synonin të bëheshin të tillë, të cilët i shikonin me mosbesim ndërmarrjet e mëdha dhe manovrimet politiko-ekonomike që bëhen zakonisht në qytete, duke përfshirë dhe ato të bankave.

Autori i dyndjes për te sportelet e degës lokale të FMA-së kishte qenë një postier llafazan, që merrej me thashetheme. Gjatë gjithë ditës së enjte, ndërsa shpërndante letra dhe pako, ai s'kishte pushuar së thëni djathtas e majtas: «E keni dëgjuar se Frëst Merkëntajll Emerikën Benku ka marrë të tatëpjetën?

Thuhet se kushdo që ka para atje dhe nuk do t'i ketë tërhequr brenda ditës së nesërme, do t'i humbasë të gjitha.»

Vetëm pak qenë ata që i besuan fjalët e tij, por lajmi u përhap dhe, pastaj, u përforcua nga reportazhe të gazetave, si edhe emisionet televizive të mbrëmjes. Ankthi i fshatarëve, tregtarëve dhe banorëve të ardhur rishtas u rrit nga njëra orë në tjetrën dhe, të premten në mëngjes, të gjithë kishin arritur në përfundimin: pse të rrezikohemi? T'i tërheqim menjëherë paratë tona.

Qytetet e vogla kanë telegrafin e tyre të xhunglës. Lajmi për vendimin që ishte marrë qarkulloi me shpejtësi dhe, aty nga ora dhjetë e mëngjesit, njerëzit filluan të drejtoheshin me shumicë drejt degës së FMA-së.

Kështu, nga fije të vogla thurej tapiceria e madhe.

Ndërkaq, në grataçielën e FMA-së, një pjesë e atyre që kishin dëgjuar shumë pak ose aspak për ato që po ndodhnin në Tilersvil, po viheshin tani mirë në dijeni të gjendjes së krijuar. Ata do të mësonin edhe më shumë për të, pasi të fillonte vënia në zbatim me shpejtësi e planit numër një të Vandervurtit, i përgatitur për raste të jashtëzakonshme.

Sipas udhëzimeve të Tom Stroanit, së pari u konsultua kompjuteri qendror i bankës. Një programator shkroi në tastierë pyetjen: cilat janë shumat totale të depozitimeve dhe të llogarive rrjedhëse të degës së bankës së Tilersvilit? Përgjigjia u dha në çast dhe pasqyronte gjendjen ekzistuese, mbasi makinat llogaritëse të degës së bankës ishin lidhur me kompjuterin.

Depozitime ..... 26.170.627,54 dollarë
Llogari rrjedhëse ..... 15.042.767,18 „
Totali ..... 41.213.394,72 „

Pastaj, kompjuterit iu kërkua: zbrit nga ky total shumat përkatëse të llogarive të palëvizshme dhe të fondeve komunale (mendohej se asnjëra prej tyre nuk do të prekej, as

edhe në rastin e një dyndjeje për në sportelet).
Kompjuteri u përgjigj:

Llogari të palëvizshme e fonde komunale
..... 21.430.964,61 dollarë
Diferenca ..... 19.782.430,11 „

Rreth njëzet milionë dollarë, të cilët depozituesit e rrethit të Tilersvilit mund t'i tërhiqnin dhe që dukej se kishin ndërmend ta bënin.
Një ndihmës i Stroanit e kishte njoftuar tanimë Thesarin Qendror, njeriun e fortë të të cilit Aleks Vandervurtit kishte vendosur të bënte një ekspozim force, si një ngritje flamuri; ose, siç e kishte thënë vetë Aleksi: «Kur do të shuash një zjarr, duhet siguruar më shumë ujë se sa duhet.»
Gjatë dyzet e tetë orëve të fundit, duke parashikuar atë që po ndodhte, shuma e mbajtur në Thesarin Qendror të bankës ishte shtuar me anë të tërheqjeve të jashtëzakonshme që ishin bërë nga Rezerva Federale. Kjo e fundit ishte vënë në dijeni të planeve për të përballuar një gjendje të jashtëzakonshme, në rast se kjo do të vërtetohej, dhe i kishte miratuar.
Një shumë e madhe në bankënota dhe monedha metalike, të numëruara dhe futur në thasë me etiketa, ku shënohej totali që përmbanin, u ngarkua në makina transporti të blinduara, ndërsa një grup rojash të armatosura mbikëqyrnin vendin e ngarkimit. Ishin gjashtë makina të tilla, disa prej të cilave i kishin thirrur me radio, duke i tërhequr nga detyra të tjera, që do të udhëtonin veç e veç, të shoqëruara nga policia — si masë sigurimi për shkak të shumës së madhe që transportohej. Si masë tjetër kundër çdo orvatjeje për grabitje, shuma e parave u nda në tri nga makinat e transportit, ndërsa tri të tjera nuk kishin gjë brenda.
Njëzet minuta pas thirrjes së drejtorit të degës së bankës së Tilersvilit, makina e parë e blinduar ishte gati për të dalë nga

gratacielli i FMA-së dhe, pas pak, u fut në rrymën e trafikut, duke u drejtuar për në Tilersvil.
Ndërkaq, që më parë, ishin nisur punonjës të tjerë të bankës, ose me veturat e tyre, ose me ato të parkut të makinave të FMA-së.
Në krye të tyre ishte Eduina, që ishte ngarkuar me drejtimin e këtij operacioni.
Sapo e njoftuan, Eduina u nis menjëherë, pasi njoftoi nëndrejtorin më të vjetër në shkallë hierarkike dhe mori me vete tre pjesëtarë të personelit të degës së bankës: një funksionar të seksionit të huave, Klif Kesëlmenin, dhe dy arkëtare. Njëra prej këtyre ishte Huanita Nunjezi.
Në të njëjtën kohë, disa vartës të degëve të tjera të bankës në qytet kishin marrë udhëzime të shkonin drejtpërdrejt në Tilersvil, ku do të viheshin në dispozicion të Eduinës. Synohej që të mos i hiqej shumë personel cilësdo degë të bankës, mbasi mund të ndodhnin dyndje të tjera në sportelet e tyre. Ishin përgatitur gjithashtu edhe plane të tjera për raste të jashtëzakonshme, por kjo kishte një kufi, pasi nuk ishte e mundur të përballoheshin njëkohësisht më shumë se dy a tri dyndje të tilla.
Grupi i drejtuar nga Eduina përshkoi me shpejtësi galerinë që çonte në gratacielin e FMA-së. Nga salla e hyrjes, ata zbritën me ashensor në garazhin e nëndheshëm të bankës, ku I priste një veturë që ishte caktuar për ta. Makinën do ta ngiste Kesëlmeni.

Kur po hipnin në veturë, panë Nolan Uejnrajtin duke shkuar me nxitim drejt Mëstangut të tij, që ishte në vendqëndrimin e makinave të bankës. Drejtori i shërbimit të sigurimit ishte njoftuar për veprimin në vazhdim dhe kishte ndërmend të mbikëqyrte personalisht transportimin e të njëzet milionë dollarëve. Në largësi të vogël, do ta ndiqte një

makinë tjetër me gjashtë roja të armatosura. Ndërkaq ishte njoftuar edhe policia e rrethit të Tilersvilit.

Aleks Vandervurti dhe Tom Stroani ndenjën në Drejtorinë Qendrore. Zyra e Stroanit, ngjitur me Qendrën Valutore, ishte bërë selia e komandës së përgjithshme. Detyra e Aleksit ishte që, nga kati i tridhjetë e gjashtë, ta ndiqte vazhdimisht zhvillimin e gjendjes në secilën nga degët e ndryshme të bankës, për të ditur në çast nëse po ndodhnin ngatërresa të tjera.

Aleksi e kishte mbajtur Pëtërtonin në dijeni të gjendjes dhe, tani presidenti i bankës dhe Aleksi po prisnin me shqetësim zhvillimin e saj, ndërsa në mendjen e secilit prej tyre vazhdonin të bëheshin dy pyetje: A do të mund të bllokohej dyndja e sporteleve në Tilersvil? A do ta mbyllte atë ditë Fërst Merkëntajlli Ëmerikën Benku pa ndodhur edhe gjetiu dyndje të tjera të tilla?

Fergës Getuiku, drejtori i degës së bankës së Tilersvilit, kishte shpresuar që edhe ato pak vite që i kishin mbetur, gjer sa të dilte në pension, do të kalonin të qeta dhe pa tronditje. Ishte në të gjashtëdhjetat, i sjellë, i ngjallur, faqekuq, me sy blu dhe flokë të thinjur, anëtar i klubit Rotari[1]). Në rininë e tij kishte pasur njëfarë ambicje, por tanimë kishte kohë që e kishte lënë mënjanë, duke e kuptuar me urtësi se roli i tij në jetë ishte ai i një zbatuesi të thjeshtë dhe se nuk do të bëhej kurrë udhëheqës, por vetëm një pasues. Drejtimi i një dege të vogël banke i përshtatej shumë mirë aftësive dhe kufizimeve të tij.

Ai e kishte kaluar mirë në Tilersvil dhe, gjer në atë ditë, vetëm një ngjarje e pakëndshme e kishte turbulluar punën e tij në bankë. Para disa vjetësh, një grua, që duhej të kishte një zemërim të fshehtë me bankën, kishte marrë me qira një kasetë të siguruar dhe kishte futur në të një send të mbështjellë me gazetë; pastaj, ajo ishte nisur për në Evropë, pa e lënë adresën e saj. Pas disa ditësh, në degën e bankës filloi të ndjehej një erë e keqe. Në fillim u dyshua për ndonjë

çarje në tubacionet e shkarkimit të tualeteve, që cilat u kontrolluan, por pa rezultat, ndërsa era e keqe po shtohej gjithnjë e më shumë. Klientët ankoheshin dhe personeli mezi qëndronte brenda. Në fund, dyshimet u përqendruan në sallën e kasetave të siguruara, ku dukej se era e keqe ishte më e fortë. Atëherë u bë pyetja: cila kasetë?

Kishte qenë pikërisht Fergës Getuiku, që i kishte kaluar me radhë kasetat, duke u marrë erë, kishte treguar më në fund njërën, e cila lëshonte një erë të qelbur të padurueshme. Pas kësaj, ishin dashur katër ditë veprime ligjore, para se të merrej autorizimi i gjykatës për ta hapur kasetën. Brenda ishin mbeturinat e një peshku të madh, që dikur duhet të kishte qenë i freskët. Edhe tani, Getuikut i dukej sikur e ndjente në ajër njëfarë mbeturine të asaj ere të tmerrshme.

Mirëpo, ngjarja e asaj të premteje ishte shumë më serioze sesa ajo e një peshku të mbyllur në një kasetë të siguruar. Getuiku shikoi orën. Kishin kaluar një orë e dhjetë minuta që kur kishte telefonuar në Drejtorinë Qendrore. Megjithëse katër arkëtarët vazhdonin të jepnin para pa pushim, numri i njerëzve që grumbulloheshin në bankë po bëhej gjithnjë e më i madh, dhe të tjerë vazhdonin të vinin, ndërsa ndihma e premtuar s'kishte mbërritur akoma.

— Zoti Getuik! — Një arkëtare i bëri me shenjë.

— Po? — Getuiku u drejtua nga arka. Nga ana e publikut, në krye të një rreshti në pritje, ishte një rritës pulash, një klient i rregullt i bankës, të cilin Getuiku e njihte mirë. Drejtori i tha me ton gazmor: — Mirëmëngjes, Stiv.

Mori si përgjigje një lëvizje të ftohtë me kokë, ndërsa arkëtarja i tregonte dy çeqe të tërhequra nga dy llogari të ndryshme. Ato i kishte dorëzuar rritësi i pulave dhe përfaqësonin një shumë prej 23.000 dollarësh.

— Janë në rregull. — tha Getuiku, dhe i sigloi të dy.

Me zë të ulët, ndonëse të dëgjueshëm për personat e parë që ishin në radhë, arkëtarja tha:

— S'na kanë mbetur aq para sa të mund të paguajmë një shumë kaq të madhe.

Sigurisht, Getuiku e kishte të qartë këtë. Që prej orës që ishte hapur, banka s'kishte pushuar së paguari dhe ishin bërë edhe më parë disa tërheqje shumash të mëdha. Por, vërejtja e arkëtares ishte e pavolitshme. Me ata që ndodheshin në radhët e para po ua përsëritnin tanimë të tjerëve para tyre.

— E dëgjove? Thonë se nuk kanë më para!

— Për Krisht! — Rritësi i pulave u përkul përpara tërë zemërim, duke përplasur grushtin. — Do të bëje mirë të m'i paguaje këto çeqe, Getuik, përndryshe do të futem aty brenda dhe do ta bëj copë-copë bankën tënde të mallkuar!

— Nuk është nevoja, Stiv. Nuk është nevoja as për kërcënime dhe as për të bërtitura. — Forgës Getuiku ngriti zërin, duke dashur që të dëgjohej mbi korin e komenteve që ishte ngritur papritur nga turma — Zonja e zotërinj, ndodhemi përpara një mungese të përkohshme parash në dorë, për shkak të tërheqjeve shumë të mëdha që u bënë në mëngjes, por ju siguroj se një sasi e madhe parash është duke ardhur dhe, së shpejti, do të jetë këtu.

Fjalët e tij të fundit u mbuluan nga thirrje proteste të zemëruara. «Si mund të mbetet një bankë pa para?» ... «I duam tani! ...» «Lëri budallallëqet!» ... «Ku janë paratë?...» «Do të rrimë këtu, deri sa banka të na paguajë ato që na detyron!»

Getuiku ngriti duart lart.

— Edhe një herë, ju siguroj se ...

— Mua s'më interesojnë sigurimet tuaja të kota. — Këto fjalë u thanë nga një grua e veshur mirë. Getuiku e dinte që

ajo s'kishte shumë kohë që banonte në Tilersvil. Gruaja nguli këmbë: — Dua paratë e mia, tani, menjëherë!

— Shumë e drejtë! — thirri një burrë prapa saj. — Dhe kjo vlen edhe për ne të tjerët!

Disa veta, që prisnin në radhë, u shtynë përpara duke ngritur zërin, me fytyrat që shprehnin zemërim dhe preokupim. Dikush hodhi një paketë ciguresh, që e goditi Getuikun në fytyrë. Befas ai e pa se si një grup i zakonshëm qytetarësh, shumicën e të cilëve e njihte mirë, ishte kthyer papritur në një turmë armiqësore. Shkaku, natyrisht, ishin paratë; paratë që u bëjnë njerëzit të çuditshëm qenieve njerëzore; i bëjnë të pangopur, u kallin datën dhe, nganjëherë, i bëjnë si me kafshët. Ekzistonte edhe një frikë e mirëfilltë: mundësia, siç e mendonte ndokush, që të humbisnin çdo gjë që kishin, të gjitha paratë e tyre, bashkë me sigurinë për të ardhmen. Dhuna, e cila pak çaste më parë as që mund të mendohej, tani dukej si diçka e afërt. Për herë të parë, pas aq vitesh, Getuiku ndjeu frikë fizike.

Ju lutem! — u lut ai. — Ju lutem, dëgjoni! — Zëri i tij u mbulua nga poterja që sa vinte e shtohej.

Papritur, brenda një çasti, zhurma u pakësua shumë. Dukej se diçka po ndodhte jashtë, në rrugë. Ata që ishin në fund të radhës zgjatnin kokën për të parë. Pastaj, porta e hyrjes u hap krejtësisht dhe një numër njerëzish u futën brenda.

Në krye të tyre ishte Eduina, e ndjekur nga Klif Kesëlmeni dhe të dyja arkëtaret. Prapa tyre vinte një numër i madh rojash që mbanin në krahë thasë të rëndë kanavace, të shoqëruar nga roja të tjera me revolverë në duar. Pastaj vinin nja pesë a gjashtë nëpunës të ardhur nga degë të tjera të bankës. Kortezhin e mbyllte, si një engjëll mbrojtës vigjilent, Nolan Uejnrajti.

Me zë të lartë dhe të qartë, që jehoi në degën e bankës të mbushur plot me njerëz, por tani pa zhurmë, Eduina tha:

— Mirëmëngjes, zoti Getuik. Më vjen keq që u vonuam kaq shumë, por kishte shumë trafik. Më thanë se ju nevojiteshin njëzet milionë dollarë. Një të tretën e sollëm, tjetra është duke ardhur.

Ndërsa Eduina po fliste, Klif Kesëlmeni, Huanita, rojat e të tjerët u drejtuan për në vendin e rezervuar për personelin e bankës, pranë sporteleve. Njëri nga punonjësit që kishte ardhur për të ndihmuar filloi menjëherë të merrej me paratë që sapo kishin sjellë dhe, pas pak, arkëtaret u shpërndanin me shumicë bankënota të reja që kërcisnin në duar.

Turma në bankë u grumbullua rreth Eduinës. Dikush pyeti:

— Është e vërtetë? Keni para në sasi të mjaftueshme sa të na paguani ne të gjithë?

— Sigurisht që është e vërtetë. — Eduina i vështroi rreth e përqark ata që e rrethonin dhe tha: — Unë jam zonja D'Orsej, funksionare e Fërst Merkentajll Emerikën Benkut. Pavarësisht nga fjalët që mund të keni dëgjuar, banka jonë është e fortë, në gjendje që t'u përgjigjet detyrimeve të saj dhe nuk ka probleme që të mos mund t'i zgjidhë. Kemi rezerva të mjaftueshme për t'ia kthyer paratë e tij çdo depozituesi që do të dëshironte një gjë të tillë, këtu në Tilersvil, ose në cilëndo degë tjetër të bankës sonë.

Gruaja e veshur mirë, që kishte folur më parë, tha:

— Ndoshta këto janë të vërteta, ose ndoshta ju i thoni këto vetëm me shpresë që t'ju besojmë. Sidoqoftë, unë do t'i tërheq sot paratë e mia.

– Kjo është e drejta juaj, – u përgjigj Eduina.

Fergës W Getuiku, që ishte i pranishëm në këtë skenë, e ndjeu veten të lehtësuar nga mendimi se nuk ishte më në qendër të vëmendjes së përgjithshme. Veç kësaj, ai e ndjente se tensioni që ekzistonte pak më parë, ishte ulur; aty-këtu shiheshin bile disa buzëqeshje, ndërsa në sportele sillnin sasia

të tjera parash. Por, megjithëse humori i përgjithshëm ishte bërë më i qetë, turma s'kishte hequr dorë nga qëllimi i saj. Tërheqjet vazhdonin me ritëm të shpejtë dhe ishte e qartë se dyndja për në sportelet nuk ishte ndalur.

Ndërkaq, përsëri si legjionarët e Cezarit, rojat e bankës dhe shoqëruesit, që kishin dalë jashtë të makinat e blinduara të transportit, u kthyen prapë me thasë të tjerë parash.

Askush nga ata që kishin qenë atë ditë në bankë atë ditë në Tilersvil nuk do ta harronin pamjen e asaj sasie aq të madhe parash të ekspozuar para syve të publikut. Edhe vetë punonjësit e FMA-së s'kishin parë kurrë aq shumë para, në një rast të vetëm. Duke zbatuar udhëzimet e Eduinës, e cila vepronte sipas planit të Aleks Vandervurtit, pjesa më e madhe e të njëzet milionë dollarëve që ishin sjellë për t'i bërë ballë gjendjes së krijuar, ishte ekspozuar në vende ku mund të shihej nga turma. Personeli kishte sjellë në hapësirën prapa arkave të gjitha tryezat e punës dhe tavolinat që disponoheshin dhe, sipër tyre, kishte vendosur grumbujt e bankënotave dhe të monedhave metalike, menjëherë sapo ishin regjistruar.

Siç kishte thënë më vonë Nolan Uejnrajti, i tërë ky operacion ishte «ëndrra e një grabitësi banke dhe ankthi i një përgjegjësi të shërbimit të sigurimit». Për fat të mirë, edhe në rast se ndonjë vjedhës e kishte marrë vesh se ç'po ndodhte, këtë gjë e mësoi tepër vonë.

Eduina mbikëqyrte gjithçka, duke vepruar me kompetencë dhe pa prekur autoritetin e Fergës W. Getuikut.

Qe ajo që i tha Kesëlmenit të fillonte ofertën e huave.

Pak kohë para orës dymbëdhjetë, ndërsa dega e bankës vazhdonte të ishte plot me njerëz dhe radha jashtë saj vazhdonte të zgjatej, Kesëlmeni mori një karrige dhe hipi në të.

– Zonja e zotërinj, – njoftoi ai, – më lejoni t'ju paraqitem. Jam një funksionar i ngarkuar me punën e huave dhe punoj në një degë të bankës së qytetit, gjë që do të thotë se kam autoritet të miratoj huara më të mëdha se ato që jepen zakonisht këtu. Prandaj, në qoftë se ndonjëri nga ju ka ndërmend të kërkojë një hua dhe do të ketë një përgjigje të shpejtë, ky është një rast i mirë për ta bërë këtë. Unë do të dëgjoj me shumë mirëkuptim dhe do të ndihmoj cilindo që do të ketë ndonjë problem. Zoti Getuik, i cili tani është i zënë me punë të tjera, më tha me dashamirësi se mund të shfrytëzoja tryezën e tij të punës, prandaj atje do të më gjeni. Shpresoj se do të vini të flisni me mua.

Një burrë, që e kishte njërën këmbë të thyer në allçi, ia priti nga vendi ku gjendej në radhë:
– Unë po vij menjëherë, sapo të kem tërhequr paratë e mia. Meqenëse kjo bankë ka marrë rrokullimën, ia vlen të marr një hua, kështu që s'do të jem i detyruar ta shlyej.

– Këtu s'ka asgjë që të ketë marrë rrokullimën, – tha Klif Kesëlmeni. Pastaj pyeti: – Ç'i keni bërë asaj këmbe?

– U rrëzova në errësirë.

– Nga ato që thoni, duket se jeni akoma në errësirë. Kjo bankë është në gjendje më të mirë se cilido nga ne të dy. Dhe desha t'ju them dhe diçka: në qoftë se do të merrni para hua, këto do të na i ktheni, përndryshe do t'jua thyejmë këmbën tjetër.

U dëgjuan disa të qeshura, kur Kesëlmeni po zbriste nga karrigia dhe, mbas pak kohe, disa veta u drejtuan për te tryeza e punës e drejtorit që të bisedonin për marrjen e një huaje.

Mirëpo, ndërkaq, tërheqja e llogarive vazhdonte. Paniku ishte zhdukur, por dukej se asgjë – as ekspozimi i forcës, as sigurimet për aftësinë e bankës që t'i plotësonte detyrimet e saj, as psikologjia e zbatuar – nuk ishte në gjendje ta ndalte dyndjen për te sportelet e degës së bankës së Tilersvilit.

Në orët e para të pasdites, për funksionarët e dekurajuar të FMA-së mbetej tanimë për t'u mësuar vetëm përgjigjja e një pyetjeje: Edhe sa kohë do të kalonte, gjersa të përhapej virusi i kësaj epidemie?

Pasdite, Aleks Vandervurti, që kishte folur disa herë në telefon me Eduinën, u nis për Tilersvil. Ai ishte tani shumë më i preokupuar se në mëngjes, kur shpresonte akoma që dyndja për te sportelet të mund të bllokohej me të shpejtë. Fakti që ajo vazhdonte, do të thoshte se gjatë pushimeve të fundit të javës, paniku do të përhapej midis depozituesve, kështu që, degë të tjera të FMA-së do të mbuloheshin nga një baticë njerëzish që do të vinin për të tërhequr paratë e tyre.

Deri në atë çast, ndonëse në disa degë të tjera të bankës tërheqjet kishin qenë të mëdha, akoma s'kishte ndodhur asgjë e ngjashme me atë që po shihej në Tilersvil. Por ishte e qartë se kjo gjendje nuk mund të vazhdonte edhe shumë kohë.

Për të shkuar në Tilersvil, Aleksi mori një veturë dhe shofer nga parku i makinave të bankës. Atë e shoqëronte Margot Brekëni. Margoti kishte përfunduar atë mëngjes një seancë gjyqi më shpejt se parashikohej dhe kishte ngrënë drekë në bankë me Aleksin. Pastaj, me kërkesën e tij, ajo kishte ndenjur me të, duke marrë pjesë në këtë mënyrë në tensionin që ndihej tanimë në katin e tridhjetë e gjashtë të gratacielit.

Në veturë, Aleksi u mbështet në shpinore, duke shijuar këtë interval pushimi, që ai e dinte se do të ishte i shkurtër.

– Ky vit ka qenë i vështirë për ty, – tha Margoti.

– Bie në sy kjo?

Ajo kaloi me delikatesë gishtin tregues në ballin e tij.

– Këtu ka më shumë rrudha dhe, në tëmthat, ka më shumë thinja.

Aleksi u ngërdhesh.

– Jam plakur edhe më shumë.

– Jo dhe aq.

– Atëherë do të thotë se ky është çmimi që duhet paguar kur njeriu jeton në tension. Këtë po e paguan edhe ti, Margot.

– Po, po e paguaj edhe unë, por rëndësi ka të dish të dallosh se cilat janë tensionet e rëndësishme dhe nëse e vlejnë atë pjesë që ne japim nga vetja jonë.

– Për të shpëtuar një bankë ia vlen të jetosh për një kohë në tension, – ia priti Aleksi me gjallëri. – Në qoftë se tani nuk e shpëtojmë këtë tonën, kjo do të bëjë mbi kokën e një numri të madh njerëzish të pafajshëm.

– Po ata që kanë faj...?

– Në një veprim shpëtimi kërkohet të shpëtohen të gjithë. Ndëshkimet mund të bëhen edhe më vonë.

Në atë çast kishin përshkuar pesëmbëdhjetë nga të tridhjetë kilometrat që e ndanin Tilersvilin nga qyteti.

– Aleks, kaq e keqe është gjendja?

– Po qe se të hënën do të ndodhin dyndje të tjera te sportelet, – tha ai, – dhe nuk do të jemi në gjendje t'i ndalim, do të jemi të detyruar ta mbyllim dyert e bankës. Pastaj mund të formohet një bashkim bankash të tjera për të vazhduar veprimtarinë tonë dhe, në këtë mënyrë, të gjithë depozituesit tanë do të mund t'i merrnin përsëri paratë e tyre, por FMA-ja nuk do të ekzistonte më.

– Më e pabesueshmja në të gjithë këtë është se mund të ndodhë një gjë e tillë në një mënyrë kaq të befasishme.

– Gjë që tregon diçka që nuk është kuptuar si duhet nga shumë njerëz, që, në të vërtetë, duhet ta kishin kuptuar. Bankat dhe sistemi monetar, që, në veprimtarinë e tyre

përfshijnë marrje dhe dhënie huash të mëdha, janë të ngjashme me një mekanizëm delikat. Në rast se me këtë veprohet keq, në qoftë se lihet që edhe një pjesë e vetme përbërëse e tij të mos veprojë në harmoni me të gjitha të tjerat, për shkak të lakmisë, politikës, apo thjesht për marrëzi; rrezikohen edhe të gjitha të tjerat. Dhe kur ndodh që është në rrezik i tërë sistemi, ose një bankë e vetme, mjafton që të përhapet lajmi, siç ndodh zakonisht, dhe ç'mbetet do të kryhet nga humbja e besimit nga ana e publikut. Pikërisht një gjë të tillë po shohim tani.

– Nga sa më ke thënë ti dhe nga gjërat e tjera që kam dëgjuar, duket se shkaku i gjendjes së krijuar në bankën tuaj është lakmia.

Aleksi tha me ton të hidhur:

– Lakmia dhe një përqindje e lartë idiotësh në këshillin tonë administrativ. – Ai po fliste më hapur se zakonisht, por kështu po nxirrte dufin dhe e ndjente veten më të lehtësuar.

Për disa çaste mbetën në heshtje, deri sa Aleksi thirri:

– O zot, sa shumë e ndiej mungesën e tij!

– Të kujt?

– Të Ben Roselit.

Margoti i zuri dorën.

– Nuk është ky operacion shpëtimi, pikërisht ajo gjë që do të kishte bërë dhe Beni?

– Ndoshta, – aleksi pshërtiu. – Vetëm se nuk po jep rezultat. Ja sepse do dëshironha që Beni të ishte këtu.

Shoferi uli dritaren e vogël, që ndante vendin e tij nga ai i pasagjerëve, dhe tha:

– Mbërritëm në Tilersvil, sër.

– Të uroj sukses, Aleks, – murmuri Margoti.

Radha e njerëzve jashtë degës së bankës, së cilës i shtoheshin vazhdimisht të tjerë, shihej që kur ndodheshe disa blloqe ndërtesash larg saj. Kur u ndal vetura e FMA-së pranë trotuarit, një makinë transporti mbërriti me shpejtësi dhe u ndal në rrugë, me një zhurmë kërcëllitëse frenash, dhe nga ajo kërcyen poshtë disa burra dhe një vajzë. Në një anë të makinës ishte shënuar sigla WTLC – TV.

— O Krisht! — thirri Aleksi. — Edhe televizionin kishim mangut.

Në bankë, ndërsa Margoti shikonte rreth e përqark me kureshtje, Aleksi bisedoi pak çaste me Eduinën dhe Getuikun dhe pa se s'mbetej pothuajse asgjë tjetër për t'u bërë. Ai tha me vete se kjo ishte një ditë e humbur kot, por ai kishte pasur nevojë të vinte. Mendoi se s'kishte ndonjë gjë të keqe dhe, ndoshta, mund të ndihmonte, në rast se bisedonte pak me disa nga njerëzit që prisnin në radhë. Filloi të kalojë gjatë vargut të njerëzve në pritje.

Kishte, së paku, dyqind veta, që e përfaqësonin mirë popullsinë e Tilersvilit: të rinj, pleq, me moshë të pjekur; disa në gjendje të mirë ekonomike, të tjerë më të varfër, gra me fëmijë, burra me rroba pune, ndërsa të tjerë të pispillosur, sikur të ishin nisur për ndonjë rast të shënuar. Shumica mbanin një qëndrim miqësor, me përjashtim të dy a tre vetave. Në pjesën më të madhe, në ta, binte në sy njëfarë nervozizmi. Në fytyrat e atyre që kishin tërhequr paratë e veta, shihej një shprehje lehtësimi. Një grua e moshuar iu drejtua Aleksit, pa e ditur se ishte një funksionar i bankës.

— Falë zotit, mbaroi edhe kjo punë! Kjo ka qenë dita më me ankth në jetën time. Këto janë kursimet e mia, gjithçka që kam. — Mbante të shtrënguara në dorë nja dhjetë a dymbëdhjetë kartëmonedha dymbëdhjetëdollarëshe. Të tjerë largoheshin nga arkat me shuma më të mëdha ose më të vogla. Përshtypja që kishte pasur Aleksi, me të gjithë ata me të

cilët kishte shkëmbyer disa fjalë, ishte e njëjtë: ndoshta Ërst Merkëntajll Ëmerikën Benku ishte në gjendje të mirë dhe ndoshta jo, por askush nuk donte të rrezikonte të humbiste paratë e tij në një institucion që mund të shembej në çdo çast. Publiciteti që kishte vënë në dukje lidhjet e FMA-së me Suprenejshnëlin, e kishte bërë punën e tij. Të gjithë e dinin se, kishte të ngjarë që, Ërst Merkëntajll Ëmerikën Benku të humbiste një sasi shumë të madhe parash, duke qenë se edhe vetë banka e kishte pranuar një gjë të tillë. Hollësitë s'kishin rëndësi. Edhe ata pak persona, të cilëve Aleksi u kishte përmendur Rezervën Federale, s'kishin shprehur besim as tek ajo. Një pjesë prej tyre kishin theksuar se kontributi i caktuar për sigurimin e secilës bankë, ishte i kufizuar dhe në pamundësi që t'i bënte ballë një përmbysjeje me përmasa të tilla.

Veç kësaj, Aleksi e kuptoi se kishte edhe diçka tjetër, ndoshta edhe më të thellë: njerëzit nuk besonin më në gjërat që u thuheshin, tanimë ata ishin mësuar t'i mashtronin dhe t'i gënjenin. Kohët e fundit ishin gënjyer nga presidenti i tyre, nga funksionarë të tjerë të qeverisë, nga politikanë, nga tregtia, industria, nga punëdhënësit, nga sindikatat, nga publiciteti; nga financa, nga Bursa; nganjëherë, nëpërmjet heshtjes ose shtrembërimeve me qëllim, nga mjetet e informacionit. Lista s'kishte të mbaruar. Mashtrimet ishin grumbulluar njëri mbi tjetrin, gjersa gënjeshtrat ose, duke marrë hipotekën më të mirë, shtrembërimi i fakteve dhe thënia e gjërave përgjysmë, ishin bërë mënyrë jetese.

Kështu pra, pse duhet t'i besonin njerëzit Aleksit, kur ky i siguronte se FMA-ja nuk ishte një anije duke u mbytur dhe se paratë e lëna në arkat e saj nuk rrezikoheshin fare? Sa më shumë kalonte koha dhe afronte mbrëmja, aq më tepër bëhej e qartë se, një gjë të tillë, askush nuk e besonte më.

Aty nga mbrëmja, Aleksi e kuptoi se s'kishte ç'të bënte tjetër dhe se ajo që duhej të ndodhte ishte e pashmangshme. «Si për njerëzit, ashtu edhe për institucionet — mendoi ai — vjen një çast, kur duhet pranuar ajo që është e pashmangshme.»
Që pikërisht në këtë kohë, rreth orës 17.30, kur tanimë, po binte errësira e mbrëmjes së tetorit, që Nolan Uejnrajti erdhi ta njoftonte Aleksin për një shqetësim tjetër që kishte turma në pritje.
— Po fillojnë të shqetësohen, — tha ai, — se banka mbyllet në gjashtë dhe nuk ka mundësi që të gjithë të mbarojnë punë në gjysmën e orës që mbetet.
Aleksi ishte i vendosur dhe ngurronte. Do të kishte qenë punë e thjeshtë ta mbyllte degën e bankës së Tilersvilit sipas orarit; kjo gjë do të kishte qenë gjithashtu krejt e ligjshme dhe askush nuk do të kishte argumente për të kundërshtuar. Ndjeu një dëshirë, të nxitur nga zemërimi dhe dështimi, një nxitje hakmarrëse për t'u thënë atyre që akoma prisnin: Nuk deshët të më besonit mua? Mirë, atëherë rrini e prisni me frikën në bark, gjer të hënën. Ju marrtë djalli! Mirëpo, ngurronte, duke u lëkundur ndërmjet natyrës së tij dhe vërejtjes së Margotit, lidhur me Ben Roselan. Margoti kishte thënë se ajo që po bënte ai tani, ishte pikërisht ajo që do të kishte bërë Beni. Çfarë vendimi do të kishte marrë Beni lidhur me mbylljen e degës së bankës? Aleksi e dinte mirë.
— Do të bëj një njoftim, — i tha ai Uejnrajtit. Më parë kërkoi Eduinën dhe i dha disa udhëzime. Pastaj, shkoi pranë portës së bankës dhe qëndroi në një vend ku mund të dëgjohej mirë edhe nga ata që prisnin jashtë, në rrugë. Vuri re se telekamerat po ktheheshin drejt tij. Grupit të parë të televizionit i ishte shtuar një i dytë nga një stacion tjetër dhe, para një ore, Aleksi kishte bërë një deklaratë për të dy grupet. Punonjësit e televizionit nuk ishin larguar nga banka dhe një operator i

kishte thënë se ata po mblidhnin material suplementar për një shërbim të posaçëm të fundit të javës, pasi, «një dyndje për në sportelet e një banke, nuk është diçka që ndodh çdo ditë».

— Zonja e zotërinj, — filloi Aleksi. Zëri i tij ishte i fortë dhe i qartë. Fjalët i dilnin me lehtësi. — Dëgjova se disa prej jush janë të shqetësuar për shkak të orës së mbylljes së bankës sonte. Mos u shqetësoni. Në emër të drejtorisë së kësaj banke, ju jap fjalën se këtu, në Tilersvil, do të qëndrojmë hapur deri sa t'ju kemi shërbyer të gjithëve.

Nga turma u dëgjua një murmuritje kënaqësie dhe, aty-këtu, disa duartrokitje spontane.

— Ndërkaq, ka diçka që mendoj se është mirë ta kemi të gjithë parasysh. — Heshtja ra përsëri dhe të gjithë po e vështronin me vëmendje. Ai vazhdoi: — Ju këshilloj me këmbëngulje që, gjatë pushimeve të fundit të javës, të mos mbani me vete ose në shtëpitë tuaja shuma të mëdha parash. Për shumë arsye, kjo nuk do të ishte pa rrezik. Prandaj ju rekomandoj të zgjidhni një bankë tjetër dhe t'i depozitoni atje paratë tuaja që do t'i tërhiqni nga kjo. Për t'ju lehtësuar në këtë punë, kolegia ime, zonja d'Orsej, po u telefonon bankave të tjera të kësaj zone, duke u kërkuar të rrinë hapur më gjatë se zakonisht, që t'ju shërbejnë.

Përsëri u dëgjuan murmuritje kënaqësie dhe miratimi.

Nolan Uejnrajti iu afrua Aleksit dhe i pëshpëriti diçka në vesh. Ky njoftoi:

— Informohem se dy banka e kanë pranuar kërkesën tonë. Do të vihemi në kontakt edhe me të tjera.

Një zë burri u dëgjua nga turma që priste jashtë:

— A mund të na rekomandoni një bankë të mirë?

— Po, — u përgjigj menjëherë Aleksi. Unë do të zgjidhja Fërst Merkënteill Emerikën Benkun. Kjo është banka që e

njoh më mirë nga të gjitha të tjerat, për të cilën jam më i sigurt dhe që ka një periudhë shërbimi të gjatë dhe pa asnjë njollë. Do të dëshiroja që ju, të gjithë të shikonit këtë gjë po në këtë prizëm. — Në zërin e tij u ndje, për herë të parë, një nuancë emocioni. Disa nga të pranishmit buzëqeshën ose qeshën pa shumë entuziazëm, por shumica e fytyrave që e vështronin ishin serioze.

— Edhe unë, kështu kam menduar gjithmonë, — tha dikush prapa Aleksit. Ky u kthye. Ai që kishte thënë këto fjalë ishte një burrë i moshuar, më afër të tetëdhjetave se sa të shtatëdhjetave, i rrudhur, i thinjur, i kërrusur, i mbështetur në një bastun. Por, sytë e tij ishin të qartë e depërtues dhe zëri, tingëllues. Në krah të tij ishte një grua, pak a shumë në të njëjtën moshë si ai. Të dy kishin veshje të rregullt, ndonëse rrobat e tyre ishin përdorur për një kohë të gjatë dhe nuk ishin më të modës. Gruaja kishte në dorë një çantë nga ato që përdoren për të psonisur, që shihej se ishte e mbushur plot me blloqe bankënotash. Ata sapo ishin larguar nga sporteli i një arke.

— Ka më se tridhjetë vjet që ime shoqe dhe unë kemi një llogari në këtë bankë, — tha plaku. Nuk na vjen mirë që po e tërheqim tani.

— Por, atëherë, pse e tërhiqni?

— Nuk mund të mos ua vëmë fare veshin të gjitha fjalëve që qarkullojnë. Ka tepër tym, kështu që s'ka se si që, diku, të mos ketë edhe ca zjarr.

— Fjalët që qarkullojnë kanë diçka të vërtetë dhe ne e kemi pohuar këtë, — tha Aleksi. — Për shkak të një huaje që i dhamë Suprënejshnël Korporejshnit, ka të ngjarë që banka jonë të pësojë një humbje. Mirëpo, ajo i ka mundësitë për ta përballuar këtë humbje dhe do ta përballojë.

Plaku tundi kokën.

— Po të isha i ri dhe në punë, do ta merrja në sy rrezikun, duke u mbështetur në fjalët tuaja. Mirëpo, nuk jam i ri dhe s'kam punë. Ato paratë aty, (bëri me shenjë nga çanta), janë gjithçka që na ka mbetur, gjer sa të na vijë fundi. Por nuk janë edhe ndonjë gjë e madhe. Në ditët tona, dollarët nuk kanë as gjysmën e vlerës që kishin në kohën kur punonim dhe i fituam.

— S'ka dyshim, ashtu është, — tha Aleksi. — Inflacioni dëmton shumë rëndë njerëzit e mirë, si ju. Por, për fat të keq, ndërrimi i bankës nuk do t'ju ndihmojë aspak në këtë drejtim.

— Më lejoni t'ju bëj një pyetje, djalosh: Po të ishit në vendin tim dhe këto, këtu, të ishin paratë tuaja, a nuk do të kishit vepruar edhe ju ashtu siç po bëj unë tani?

Aleksi vuri re se të tjerë po afroheshin për të dëgjuar. Aty pranë, pa Margotin. Menjëherë prapa saj ishin dritat e kamerave të televizionit. Një operator ishte përkulur përpara, me një mikrofon në dorë.

— Po, — pranoi Aleksi. — Mendoj se ashtu do të bëja.
Plaku u duk i habitur.
— Sidoqoftë, jeni njeri i ndershëm. Pak më parë, dëgjova këshillën tuaj për të shkuar te një bankë tjetër dhe këtë e vlerësoj mjaft. Tani, bashkë me gruan time, do të shkojmë te një bankë e tillë dhe do t'i depozitojmë paratë tona atje.
— Prisni pak, — tha Aleksi. — A keni makinë?
— Jo. Banojmë dy hapa prej këtu. Do të shkojmë në këmbë.
— Jo me tërë ato para. Mund t'ju grabisin. Po shikoj se mos gjej ndonjë që t'ju shoqërojë gjer te një bankë tjetër. — Aleksi i bëri me shenjë Nolan Uejnrajtit që të afrohej dhe ia shpjegoi se si qëndronte puna.
— Ky është drejtori i shërbimit tonë të sigurimit, — i tha ai çiftit të vjetër.
— Mos u bëni merak, — u tha Uejnrajti, — do të kem kënaqësinë t'ju çoj vetë ynë me makinë.
Plaku nuk lëvizi nga vendi. Vështrimi i tij kalonte sa te fytyra e njërit funksionar të bankës, në atë të tjetrit. — Me të vërtetë

keni ndërmend ta bëni këtë për ne? Pasi i tërhoqëm paratë nga banka juaj? Mbasi ju thamë hapur se nuk kemi më besim te ju?
— Le të themi se kjo përfshihet në shërbimin tonë, — u përgjigj Aleksi. — Veç kësaj, meqë keni qenë me ne për tridhjetë vjet me radhë, duhet të ndahemi si miq të mirë.
Plaku po ngurronte akoma.
— Ndoshta nuk është nevoja të ndahemi. Më lejoni t'ju bëj edhe një pyetje tjetër, si burrat. — Ia nguli Aleksit vështrimin e mprehtë të syve të tij të qartë, depërtues dhe të ndershëm.
— Ju lutem.
— Djalosh, ju ma thatë një herë të vërtetën. Ma thoni tani edhe një herë tjetër, duke pasur parasysh se ç'përfaqësojnë këto kursime për ne që jemi pleq. A janë paratë tona të sigurta në bankën tuaj? Krejtësisht të sigurta?
Për disa sekonda, Aleksi e peshoi mirë përgjigjen dhe të gjitha ngatërresat që mund të rridhnin prej saj. E dinte se jo vetëm të dy pleqtë po prisnin me padurim përgjigjen e tij; por edhe shumë të tjerë. Telekamerat, gjithnjë të pranishme, ishin drejtuar nga ai. I hodhi një vështrim të shpejtë Margotit, që po e shikonte gjithashtu me vëmendje; por me një shprehje tallëse në fytyrë. Ai mendoi për njerëzit që ndodheshin aty, për të gjithë të tjerët që ishin të shqetësuar për fatin e FMA-së; mendoi për ata që mbështeteshin tek ai: Xherom Peitërtoni, Tom Stroani; këshilli administrativ; Eduina e akoma të tjerë; mendoi se çfarë do të ndodhte po të falimentonte FMA-ja, për efektin e dëmshëm dhe me rreze të gjerë veprimi; që do të ndihej jo vetëm në Tilersvil, por edhe shumë më larg. Pavarësisht nga të gjitha këto, ai ndjeu se po i ngjallej një dyshim. Ai e largoi atë dhe, pastaj, u përgjigj me zë të gjallë dhe të fortë:
— Ju jap fjalën. Kjo bankë është krejtësisht e sigurt.
— Eja, Frida! — i tha plaku së shoqes. — Me sa duket, kemi bërë tepër zhurmë për hiç gjë. Eja t'i derdhim prapë paratë në arkë.

Në të gjitha analizat dhe diskutimet që u bënë më vonë, gjatë javëve që ndoqën këto ngjarje, një fakt mbeti i pakundërshtueshëm: dyndja për në sportelet e degës së bankës të Tilersvilit u ndal, kur plaku dhe e shoqja u kthyen prapë tek arka dhe derdhën përsëri paratë që kishin në çantën e tyre të pazarit. Njerëzit që ishin duke pritur, për të tërhequr paratë e tyre dhe që kishin dëgjuar bisedën e shkurtër që ishte bërë midis plakut dhe funksionarit të bankës, ose ulën sytë poshtë, për t'iu shmangur vështrimit të njëri-tjetrit; ose buzëqeshën me drojtje dhe si të turpëruar, para se ta kthenin vështrimin në drejtim tjetër. Lajmi i asaj që ndodhi u përhap me shpejtësi ndër ata që prisnin brenda dhe jashtë dhe, pothuajse menjëherë, njerëzit që ishin në radhë filluan të shpërndaheshin; në një mënyrë po aq të shpejtë dhe misterioze, siç qenë mbledhur. Dikush tha me vonë se kishte qenë fjala për instinktin e kopesë, por të marrë së prapthi. Kur u mbarua punë edhe me ata veta që kishin mbetur, dega e bankës u mbyll vetëm dhjetë minuta më vonë se orari i zakonshëm i së premtes mbrëma. Një numër i vogël funksionarësh të FMA-së, në Tilersvil dhe në grataciellin e Drejtorisë Qendrore vazhdonin të ishin të shqetësuar për të hënën. A do të kthehej përsëri turma? Do të rifillonte dyndja për në sportelet?

Por, të hënën, asgjë e tillë nuk ndodhi, as në Tilersvil dhe as në ndonjë degë tjetër të bankës. Arsyja, sipas mendimit të shumë vëzhguesve, qe një skenë e hapur, e çiltër, e ndershme, prekëse, që u zhvillua ndërmjet një çifti të vjetër dhe një nënpresidenti banke, të pashëm e të çiltër; skenë që bënte pjesë në një shërbim të posaçëm të transmetuar në fund të javës nga televizioni. Shërbimi pati një sukses aq të madh, saqë u transmetua disa herë. Ai ishte një shembull i asaj që quhet «cinéma vérité», që televizioni mund ta bëjë aq mirë;

por që rrallë e realizon. Shumë spektatorë u prekën aq shumë, sa iu mbushën sytë me lot.

Gjatë pushimit të fundit të javës, Aleks Vandervurti e pa transmetimin e televizionit, por nuk bëri komente. Një arsye ishte se vetëm ai i dinte mendimet që kishhte pasur në çastin jetik e vendimtar, kur plaku e kishte pyetur. «A janë paratë tona... krejtësisht të sigurta?» Një tjetër arsye ishte se Aleksi e dinte mirë se para FMA-së shtriheshin akoma mjaft vështirësi dhe probleme.

As Margoti nuk bëri komente për episodin e së premtes mbrëma dhe as që e zuri me gojë të dielën, të cilën e kaloi në apartamentin e Aleksit. Kishte një pyetje të rëndësishme për t'i bërë, por, mendoi me urtësi se nuk ishte koha e përshtatshme për një gjë të tillë.

Midis funksionarëve të lartë që e panë shërbimin e posaçëm të televizionit ishte edhe Rosko Hejuordi, ndonëse nuk e ndoqi deri në fund. Ai e hapi televizionin të dielën mbrëma, menjëherë pasi u kthye në shtëpi; pas një mbledhjeje të famullisë, për më vonë e mbylli, nga zemërimi e xhelozia që ndjeu. Ai vetë kishte tani mjaft probleme serioze dhe s'ishte nevoja të dëgjonte të flitej dhe të shihte sukseset e Vandervurtit. Sidoqoftë, pa folur për dyndjen për në sportelet, ai ishte mjaft i shqetësuar për shkak të disa çështjeve që kishte të ngjarë të dilnin në sipërfaqe gjatë javës që do të vinte.

Ajo ditë në Tilersvil pati një pasojë tjetër, që kishte të bënte me Huanita Nunjezin.

Huanita e kishte parë Brekënin, kur kishte mbërritur atë pasdite në degën e bankës së Tilersvilit. Kohët e fundit, ajo kishte qenë e pavendosur nëse duhej t'i drejtohej Margotit, për t'i kërkuar një mendim. Tani kishte vendosur ta bënte një gjë të tillë. Por, për arsyet e saj, ajo preferonte të mos shihej nga Nolan Uejnrajti.

Çasti i përshtatshëm që priste Huanita ishte paraqitur pak pas mbarimit të dyndjes për në sportelet, ndërsa Uejnrajti ishte i zënë me punë me verifikimin e masave të sigurimit të degës së bankës, gjatë pushimit të fundit të javës, dhe personeli po çlirohej nga tensioni që ishte grumbulluar gjatë ditës. Huanita u largua nga arka, ku ajo po ndihmonte një arkëtare efektive të bankës, dhe shkoi në zonën e rezervuar për drejtorinë. Margoti ishte ulur atje, vetëm, në pritje që të kthehej në qytet me Aleks Vandervurtin.

— Zonjushe Brekën, — i tha Huanita, duke folur me zë të ulët, — më keni thënë një herë se, po të më dilte ndonjë problem, mund t'ju drejtohesha juve.

— Natyrisht, Huanita. Pse, të ka dalë ndonjë problem tani?

Fytyra e vogël e Huanitës ishte ngrysur.

— Po, besoj se po.

— Çfarë lloj problemi?

— Në qoftë se s'keni kundërshtim, a mund të flasim diku gjetiu? — Huanita s'po ia ndante sytë Uejnrajtit, që ishte pranë hyrjes së bodrumeve të thesarit, nga ana tjetër e bankës. Dukej se ishte duke përfunduar një bisedë.

— Atëherë, ejani në zyrën time, — i tha Margoti. — Kur është e volitshme për ju?

Ishin marrë vesh që kjo të bëhej të hënën mbrëma.

Bobina me shiritin magnetik, që ishte incizuar në Palestrën Shtatë-Shtatë, kishte mbetur që prej gjashtë ditësh në raftin që gjendej mbi tryezën e punës ku ndodheshin pajisjet e kontrollit.

Magjistari Uong e kishte shikuar disa herë shiritin, por s'vendoste dot t'i fshinte gjithë sa ishin incizuar në të dhe, po ashtu, t'ua tregonte të tjerëve. Incizimi i çfarëdo bisede

telefonike ishte punë me rrezik dhe akoma më me rrezik ishte ta përdorje atë për ta dëmtuar të tjerët.

Ndërkaq, Magjistari ishte i sigurt se Marinos do t'i pëlqente shumë të dëgjonte një pjesë të shiritit dhe se do ta paguante mirë këtë privilegj. Sido që të ishte Toni Ber Marino, nuk mund të mohohej se tregohej bujar kur ishte fjala për të shpërblyer një shërbim të kryer mirë dhe, kjo ishte arsyeja se pse «Magjistari» punonte herë pas here për të. Ai e dinte mirë se Marino ishte një batakçi profesionist. Vetë ai nuk ishte i tillë.

Magjistari (emri i tij i vërtetë ishte Uejn, megjithëse askush nga ata që e njihnin s'kishte përdorur kurrë këtë emër), ishte një kinezo-amerikan i ri, i zgjuar, i brezit të dytë. Ai ishte gjithashtu ekspert elektronik dhe i specializuar në kërkimin dhe zbulimin e aparaturave elektronike të përgjimit. Nofkën «Magjistari» e kishte fituar nga aftësia e tij e madhe në këtë fushë.

Uongu u siguronte klientëve të tij të shumtë ndihmën e tij teknike, për të mos lejuar që në zyrat dhe banesat e tyre të instaloheshin mjete përgjimi dhe spiunimi dhe të dëgjoheshin bisedat e tyre telefonike. Ishte e çuditshme se sa shpesh arrinte të zbulonte mjete të ndryshme përgjimi, gjë që u bënte mjaft përshtypje klientëve të tij, të cilët, në këto raste, nuk mungonin të tregonin mirënjohjen e tyre. Me gjithë sigurimet e ndryshme zyrtare, që ishin bërë — pak kohë më parë edhe nga vetë presidenti — spiunazhi elektronik vazhdonte të përdorej gjerësisht dhe të lulëzonte në Shtetet e Bashkuara.

Ndërmjet klientëve të Uongut kishte krerë të shoqërive industriale, si edhe bankierë, botues gazetash, kandidatë për postin e presidentit, disa avokatë të dëgjuar, dy-tri ambasada, pesë a gjashtë senatorë, tre guvernatorë shteti dhe një anëtar i Gjykatës së Lartë. Veç këtyre, kishte edhe njerëz të tjerë me rëndësi, të një kategorie tjetër: Doni[1]) i një «familjeje» të mafias, pasuesit e tij dhe ingranazhet e tjera të një niveli më të ulët, ndër të cilët bënte pjesë dhe Toni Marino.

Uongu ua bënte një gjë të qartë klientëve të tij mafiozë, që në fillim: nuk donte të përzihej me veprimtarinë e tyre të paligjshme. Ai nxirrte fitime të mira, duke jetuar dhe punuar pa shkelur ligjet. Nga ana tjetër, mendonte se nuk kishte arsye që t'ua mohonte shërbimet e tij, duke qenë se spiunazhi elektronik ishte pothuajse kudo i paligjshëm dhe se edhe keqbërësit kishin të drejtë të mbroheshin me mjete të ligjshme. Ky rregull pranohej gjithmonë dhe zbatohej pa kundërshtim.

Mirëpo, herë pas here, këta klientë të veçantë linin të kuptohej se do ta vlerësonin dhe shpërblenin mirë çdo informatë të dobishme që ai mund të mësonte gjatë punës së tij. Dhe, kohë mbas kohe, ai u kishte dhënë ndonjë informatë dhe kishte marrë para për të, duke iu dorëzuar këtë mënyrë tundimit më të thjeshtë e më të lashtë: lakmisë.Edhe në atë çast, ai ishte nën veprimin e këtij tundimi.

Një javë e gjysmë më parë, ai kishte bërë kontrollin e zakonshëm të telefonave dhe të lokaleve të Toni Marinos. Ndër këto ishte edhe Palestra Shtatë-Shtatë, në të cilën Marinoja kishte interesa financiare. Gjatë inspektimit — i cili kishte treguar se çdo gjë ishte në rregull — Magjistari ishte zbavitur duke vënë në kontroll njërën nga linjat telefonike, gjë që e bënte herë pas here, në vende të ndryshme; sepse e ndjente si detyrë ndaj vetes së vet dhe klientëve që ta mbante në formë të mirë kompetencën e tij teknike. Për këtë qëllim kishte zgjedhur një telefon me pagesë, që gjendej në katin përdhes të Palestrës Shtatë-Shtatë, dhe e kishte lënë; për dyzet e tetë orë, të lidhur me një magnetofon që e kishte fshehur në qilar. Magnetofoni ishte automatik dhe ndizej e shuhej vetë, çdo herë që përdorej telefoni.

Ishte fjala për një veprim të paligjshëm, por Magjistari nuk ishte bërë shumë merak, sepse incizimet që ndoshta do të bëheshin në shirit, do t'i dëgjonte vetëm ai. Megjithatë, kur kishte dëgjuar, njëra nga bisedat ia kishte tërhequr shumë vëmendjen.

Tani, një të shtunë pasdite, vetëm në laboratorin e tij, ai e mori përsëri bobinën nga rafti ku gjendej, e futi në një magnetofon dhe e dëgjoi prapë atë pjesë ku ishte incizuar biseda.

U dëgjua zhurma e një monedhe metalike të futur brenda dhe ajo e rrotullimit të diskut, kur formohet numri. Një tingëllim zileje. Vetëm një.

Një zë gruaje (i ulët, me një theks të lehtë të huaj): Alo!
Një zë burri (duke pëshpëritur): Ti e di kush jam, por mos zër emra me gojë.
Zëri i gruas: Po.
Zëri i mëparshëm (gjithnjë duke pëshpëritur): Thuaj mikut tonë se këtu kam zbuluar diçka të rëndësishme, shumë të rëndësishme. Pothuajse gjithçka që ai donte të dinte. S'mund të të them më shumë, por do të vij të nesërmen mbrëma.
Zëri i gruas: Shumë mirë.

Një kërcitje. Personi që kishte telefonuar nga Palestra Shtatë-Shtatë e kishte vënë përsëri në vend receptorin.

Uongu nuk e kuptonte se për ç'arsye ishte i bindur që kjo bisedë mund t'i interesonte Toni Marinos. Ishte fjala vetëm për një intuitë, por intuitat e tij i kishin dalë gjithnjë në të kaluarën. Më në fund vendosi dhe, pasi shfletoi një bllok personal shënimesh, shkoi te telefoni dhe formoi një numër.

I thanë se Toni Beri nuk mund ta priste përveç se të hënën, pasdite vonë. U mor vesh për t'u takuar atë ditë dhe në atë kohë dhe, pastaj, duke qenë se tani i ishte futur kësaj valleje, iu vu punës për të nxjerrë nga shiriti edhe ndonjë të dhënë tjetër. E mblodhi prapë bobinën dhe e dëgjoi incizimin përsëri edhe disa herë.

— Farë jude! — Tiparet trashanike të Toni Berit u shtrembëruan nga zemërimi. Zëri i tij, me një tingull të hollë falso, u bë edhe më i mprehtë se zakonisht. — E kishte këtë

shirit të mallkuar dhe, për një javë të tërë, s'i luajti bythët për të ardhur këtu!

Duke u mbrojtur, Uongu tha:
— Unë jam teknik, zoti Marino. Në përgjithësi, gjërat që dëgjoj s'janë puna ime. Mirëpo, pas pak kohe, fillova të mendoja se këtu ndryshonte puna. — Nga njëra anë, ai e ndjente veten të lehtësuar. Të paktën Marinoja s'kishte kundërvepruar me zemërim kur kishte mësuar se ai kishte vënë nën kontroll një linjë telefonike të Palestrës Shtatë-Shtatë.

— Herën tjetër, — hungëroi Marinoja, — mendohu shpejt!

Ishte e hënë. Ata të dy gjendeshin në ndërmarrjen e transportit, ku Marinoja kishte një zyrë dhe, në tryezën e punës që ndodhej ndërmjet tyre, ishte një magnetofon portativ, të cilin Uongu sapo e kishte mbyllur.

Para se të shkonte në takim, ai e kishte incizuar bisedën në një kasetë, duke e fshirë pastaj krejt shiritin e parë.

Toni Beri, pa xhaketë, për shkak të nxehtësisë që kishte në zyrën e ngrohur shumë, të bënte si gjithmonë përshtypje me fizikun e tij. Kishte shpatulla të gjera, si ato të një mundësi, krahë të duarve dhe muskuj krahësh shumë të mëdhenj. E mbushte krejt poltronën ku ishte ulur dhe, bile, një pjesë e trupit i dilte jashtë saj, e jo se ishte i ngjallur, por për shkak të zhvillimit të madh të muskujve. Uongu mundohej të mos e linte veten të frikësohej nga pamja e tij fizike dhe as nga nami që kishte si një njeri i pamëshirshëm. Por, pas pak, për shkak të nxehtësisë që kishte në dhomë, apo për ndonjë arsye tjetër, filloi të djersitej.

Ai u hodh e tha:
— S'kam humbur dhe aq kohë, zoti Marino. Kam zbuluar edhe ca gjëra të tjera që mendoj se mund t'ju interesojnë.

— Si, për shembull?
— Mund t'ju them numrin që u thirr nga Palestra Shtatë-Shtatë. Shikoni, duke kronometruar kohën e çdo rrotullimi të pjesëshëm të diskut, si është incizuar në shirit dhe, pastaj, duke e krahasuar atë me...
— Lëri këto marrëzira. Më thuaj numrin dhe qepe.
— Ja tek është. — Uongu i dha një copë letër.
— A e ke gjurmuar? Numri i kujt është ky?
— Duhet t'ju them se që të gjesh se i kujt është një numër telefoni nuk është punë e lehtë, sidomos sepse ky numër nuk është i shënuar në numërator. Për fat të mirë, kam disa të njohur në shoqërinë e telefonave...

Toni Beri shpërtheu. Përplasi pëllëmbën e dorës në tryezë dhe zhurma qe e ngjashme me atë të një topi.
— Mos i bjer rrotull kur bisedon me mua, ti, dobiç i djallit! Po e pate emrin, thuaje menjëherë!
— Ajo që dua të them, — nguli këmbë Uongu, ndërsa po djersitej edhe më shumë, — është se këto gjëra kushtojnë. M'u desh t'i paguaja një shumë të mirë informatorit tim të shoqërisë së telefonave.
— S'ka dyshim se ke paguar shumë më pak se sa do të shtrydhësh nga unë. Fol, nxirri emrat!

Magjistari u qetësua pak, duke e kuptuar se e kishte arritur qëllimin, mbasi Toni Beri do ta paguante çmimin e kërkuar secili prej atyre të dyve e dinte se, në të ardhmen, mund të ndodhnin edhe raste të tjera si ky.
— Numri i përket zonjës H. Nunjez. Ajo banon në Rajonin Lindor. Ja adresa dhe numri i apartamentit. — Uongu i kaloi një copë letre tjetër. Marinoja e mori, i hodhi një vështrim dhe e vuri në tryezë.
— Ka dhe diçka tjetër që mund t'ju interesojë. Të dhënat tregojnë se telefoni është instaluar me urgjencë, para një muaji. Normalisht, në Rajonin Lindor, ka një listë të gjatë emrash personash që presin t'u instalohen telefona, por kjo nuk ishte fare në listë dhe, pastaj, krejt papritur, u vu në krye të saj.

Pamja gjithnjë e më e zymtë e Marinos i detyrohej pjesërisht zemërimit, për shkak të lajmeve që kishte mësuar, por pjesërisht edhe padurimit. Uongu vazhdoi me nxitim: — Shkurt, dikush ka bërë presion. Informatori im më tha se kërkesa ishte paraqitur nga njëfarë Nolan Uejnrajt, që është drejtori i shërbimit të sigurimit të një banke: Fërst Merkentajll Emerikën Benkut. Ai kishte thënë se telefoni nevojitej, në mënyrë të ngutshme, për punë të bankës. Edhe faturat për atë i shkojnë bankës.

Për herë të parë që prej mbërritjes së teknikut, Toni Beri mbeti për një çast me gojë hapur nga habia. Kjo u pasqyrua në fytyrën e tij për një kohë të shkurtër, por pastaj u zëvendësua nga një shprehje indiferente. Por, ndërkaq, mendja e tij punonte, duke i lidhur gjërat që sapo kishte mësuar me disa fakte që dinte që më parë. Pika ku lidheshin ishte emri «Uejnrajt». Marinoja e dinte se, para gjashtë muajsh, ishte bërë një orvatje për të futur në botën e shkelësve të ligjit një informator të fshehtë, njëfarë Viku. Kur e kishin torturuar, Viku e kishte treguar emrin e atij që e kishte dërguar: Uejnrajtit.

Mos ishte dërguar ndonjë tjetër tani? Në qoftë se kjo ishte e vërtetë, Toni Beri e merrte me mend se cili mund të ishte pikësynimi, por ekzistonin edhe punë të tjera që zhvilloheshin nën mbulesën e Palestrës Shtatë-Shtatë, që ai nuk kishte sigurisht ndërmend t'i linte të zbuloheshin. Toni Beri nuk humbi kohë me ëndërrime të kota. Zëri i burrit, vetëm një pëshpëritje, nuk mund të njihej, por gruaja ishte gjetur, kështu që, çdo gjë që do t'u duhej do ta nxirrnin prej saj. As që i shkoi ndërmend se gruaja mund të mos pranonte të bashkëpunonte. Po qe se do të ishte aq e marrë, kishte plot metoda për ta detyruar.

Marinoja pagoi me të shpejtë Uongun dhe filloi të mendohej. Për njëfarë kohe, ai vazhdoi metodën e matur që përdorte zakonisht: të mos merrte një vendim të

menjëhershëm, por t'i linte mendimet e tij të piqeshin zgjat disa orëve. Mirëpo, kishte humbur mjaft kohë: një javë të tërë.

Më vonë, atë mbrëmje, ai thirri dy nga shoqëruesit dhe u dha një adresë në Rajonin Lindor dhe një urdhër:
— Ma sillni këtu këtë Nunjezin!

— Në qoftë se kjo që më thua është e vërtetë, — i tha Aleksi Margotit, — do t'i jap Uejnrajtit bythëve shqelmin më të fortë që ka ngrënë ndonjëherë.

Margoti ia priti:

— Sigurisht që është e vërtetë. Pse do ta shpikte një gjë të tillë zonja Nunjez? Dhe, sido që ta marrësh, si do të mund ta shpikte këtë?
— Po, — pranoi ai, — e kuptoj se nuk ka mundësi.
— Po të them dhe diçka tjetër, Aleks. Unë kërkoj më shumë se kokën e këtij Uejnrajtit tënd. Shumë më tepër.

Ishte e hënë mbrëma. Ata gjendeshin në apartamentin e Aleksit, ku Margoti kishte ardhur para një gjysmë ore, menjëherë pas bisedës që kishte pasur me Huanita Nunjezin. Kishte mbetur e shtangur dhe e zemëruar sa bëhet nga ato që kishte dëgjuar. Duke folur me njëfarë shqetësimi, Huanita i kishte treguar për marrëveshjen e përfunduar një muaj më parë, në bazë të së cilës ajo ishte bërë ndërmjetëse midis Uejnrajtit dhe Majlls Istinit. Mirëpo, kohët e fundit, kishte filluar ta kuptonte rrezikun ku ishte futur dhe, për rrjedhojë, e ndjente veten dhe më të frikësuar, jo vetëm për veten e saj, por edhe për Estelën. Margoti i kishte kërkuar Huanitës t'i përsëriste ato që kishte thënë, duke i dëgjuar disa herë dhe duke e pyetur për disa hollësi dhe, pastaj, kishte shkuar drejtpërdrejt tek Aleksi.

— Unë e dija se Istini do të luante rolin e informatorit të fshehtë, — Aleksi kishte një pamje të shqetësuar, siç po i ndodhte shpesh kohët e fundit; ecte lart e poshtë në dhomën e ndenjes, duke mbajtur në dorë një gotë uiski, që s'e kishte vënë akoma në gojë. — Nolani më ka folur për planin e tij.

Në fillim e kundërshtova dhe nuk pranova, por, pastaj i lëshova pe, sepse argumentet e tij m'u dukën bindëse. Por, të betohem se nuk më tha asgjë për një marrëveshje të tillë me Nunjezin.
— Të besoj, — tha Margoti. — Ka të ngjarë që s'të ka thënë gjë, sepse e dinte që ti nuk do ta lejoje këtë veprim.
— Po Eduina, e dinte?
— Me sa duket, jo.

I pezmatuar, Aleksi mendoi: edhe në këtë pikë, Nolani kishte shkarë. Si kishte mundësi që ai të ishte treguar aq dritëshkurtër, bile i trashë? Aleksi e dinte se pjesërisht kjo shkaktohej nga fakti se drejtuesit e seksioneve, siç ishte Uejnrajti, tërhiqeshin pas objektivave të tyre të kufizuara, duke mos mbajtur parasysh kuadrin e përgjithshëm.

Ai u ndal para saj, duke e ndërprerë ecjen lart e poshtë.
— Pak më parë, the se kërkoje shumë më tepër se kokën e Nolanit. Ç'do të thotë kjo?
— Gjëja e parë që kërkoj është t'i sigurohet një mbrojtje e menjëhershme klientes sime dhe fëmijës së saj; dhe, me fjalën mbrojtje, kuptoj që të çohet në një vend, ku të mos i nënshtrohet asnjë rreziku. Pasi të jetë bërë kjo, mund të bisedohet për kompensimin që i duhet dhënë.
— Klientja jote?
— I thashë sonte Huanitës në kishte nevojë për ndihmë juridike dhe ajo më kërkoi ta përfaqësoja.
Aleksi u ngërdhesh dhe piu një gllënjkë uiski.
— Kështu që, tani, ti dhe unë jemi kundërshtarë.
— Në këtë kuptim, mendoj se po. — Zëri i Margotit u bë më i ëmbël — Por, ti e di se unë nuk do të përfitoj kurrë nga bisedat tona private.
— Po, e di. Dhe privatisht po të them se për Nunjezin do të bëjmë diçka menjëherë, që nesër. Po qe se do të jetë e nevojshme të largohet për njëfarë kohe nga qyteti, për t'u

siguruar, unë do ta jap pëlqimin tim. Përsa i përket kompensimit, hëpërhë nuk marr angazhim. Dua të dëgjoaj më parë se ç'thotë Nolani dhe, në qoftë se ato që do të thotë ai do të përputhen me thëniet e Nunjezit, bisedojmë prapë.

Aleksi nuk i tha se, të nesërmen në mëngjes, kishte ndërmend të thërriste Uejnrajtin dhe ta urdhëronte të ndërpriste tërë operacionin. Kjo do ta mbronte gjithashtu Huanitën, siç ia kishte premtuar Margotit; dhe, në këtë mënyrë, do të ishin të larë edhe me Istinin. I vinte shumë keq që e kishte lënë veten të bindej nga Nolani dhe e kishte miratuar atë plan. Në fakt, të gjitha instinktet e tij kishin qenë kundër një plani të tillë dhe kishte bërë gabim që i kishte lëshuar rrugë, duke u bindur nga argumentet e tij. Sidoqoftë, rreziqet ishin shumë të mëdha. Për fat të mirë, s'ishte tepër vonë për ta ndrequr gabimin, meqenëse asgjë e keqe s'i kishte ndodhur as Istinit dhe as Nunjezit.

Margoti e vështroi drejt në sy.
— Njëra nga gjërat që më pëlqejnë te ti është ndershmëria. Pra, ti pranon se banka ka njëfarë përgjegjësie kundrejt Huanita Nunjezit?
— Oh, Krisht! — tha Aleksi, dhe e kapërdiu me një gllënjkë uiskin që kishte mbetur në gotë. — Tani kemi aq shumë përgjegjësira, saqë ç'rëndësi ka po të jetë dhe një më shumë?

Edhe një gur duhej; edhe një gur i vetëm, për të plotësuar mozaikun aq të vështirë e të ndërlikuar. Edhe një rast tjetër i favorshëm mund të mjaftonte për ta shtënë në dorë edhe këtë gur të fundit dhe, si përfundim, për t'iu përgjigjur pyetjes: ku ndodhej strofka e falsifikuesve?

Kur e organizoi misionin e dytë të fshehtë, Nolan Uejnrajti nuk kishte pritur prej tij rezultate të bujshme. Ai e konsideronte Majlls Istinin si një investim me afat të gjatë, me anën e të cilit, të mund të siguronte ndoshta, ndonjë informatë të dorës së dytë. Mirëpo, Istini kishte kaluar me shpejtësi, nga një zbulim në tjetrin. Uejnrajti dyshonte nëse

edhe vetë Istini e kuptonte se sa sukses të jashtëzakonshëm kishte pasur.

Të martën në mëngjes, në zyrën e tij të mobiluar thjesht, Uejnrajti i analizoi edhe një herë përparimet që ishin kryer.

— Në raportin e tij të parë, Istini kishte njoftuar vetëm se kishte zënë vend në Palestrën Shtatë-Shtatë. E parë në dritën e ngjarjeve të mëvonshme, kjo ishte në vetvete një gjë e rëndësishme. Më vonë kishte ardhur konfirmimi se Palestra Shtatë-Shtatë ishte një strofkë kriminelësh, duke përfshirë edhe fajdexhiun Ominski dhe Toni Ber Marinon.

— Duke arritur të futej fshehurazi në dhomat ku luhej kumar, Istini kishte bërë një hap tjetër përpara në depërtimin e tij. — Pak më vonë, Istini kishte blerë dhjetë bankënota njëzetdollarëshe të falsifikuara. Pasi u ekzaminuan nga Uejnrajti dhe të tjerë, u pa se ato ishin me të njëjtën cilësi të lartë, si ato që po qarkullonin që prej disa muajsh në atë zonë dhe, pa dyshim, vinin nga i njëjti burim. Istini e kishte dhënë emrin e personit, nga i cili i kishte blerë dhe, këtë të fundit, po e mbikëqyrnin.

— Pastaj, tri gjëra të rëndësishme: patenta e falsifikuar; numri i targës së shevroletit, me të cilin Istini kishte shkuar në Luisvil, në portbagazhin e të cilit kishte pasur, siç dukej, para të falsifikuara; si dhe matrikula e biletës së avionit që i kishin dhënë Istinit për udhëtimin e kthimit. Nga të tria këto gjëra, kahtë dalë se më e dobishmja kishte qenë bileta e avionit. Ajo ishte blerë, bashkë me të tjera, me anë të një letërkrediti Kiçarih të falsifikuar. Drejtori i shërbimit të sigurimit kishte pasur, më në fund, përshtypjen se ishte shumë pranë pikësynimit të tij kryesor: organizatës, e cila prej kohësh po përvetësonte shuma të mëdha parash nga sistemi i letërkreditive *Kiçarxh*. Patenta e falsifikuar vërtetonte për ekzistencën e një organizate me veprime të shumëllojshme dhe efektive, me të cilën ishte bashkuar së fundi edhe një

ingranazh tjetër: ish i burgosuri Xhuls LaRoka. Sa për veturën, ajo kishte qenë e vjedhur. Pasdite, pas udhëtimit të Istinit, ishte gjetur e braktisur në Luisvil.

— Më në fund, gjëja më e rëndësishme nga të gjitha, kishte qenë identifikimi i falsifikuesit material, Denit, bashkë me një numër informatash të tjera, me faktin se tani dihej me siguri burimi i letërkreditive *Kiçarxh* të falsifikuara.

Sa më tepër që grumbulloheshin të dhënat që i vinin me anë të Majlls Istinit, aq më shumë e ndjente Uejnrajti si detyrë që të vinte në dijeni për to personat kompetentë. Prandaj, një javë më parë, ai kishte thirrur në bankë disa agjentë të Byrosë informative dhe të shërbimit të fshehtë. Ky i fundit duhej të vihej në dijeni gjithashtu, për shkak të banknotave të falsifikuara, me qenë se Kushtetuta ia besonte pikërisht shërbimit të fshehtë përgjegjësinë e mbrojtjes së sistemit monetar të Shteteve të Bashkuara. Agjentët e posaçëm ishin i njëjti çift — Inisi dhe Delrimplli — që, gati një vit më parë, kishin zhvilluar hetimet lidhur me shumën që mungonte në arkën e FMA-së dhe patën arrestuar Majlls Istinin; ndërsa agjentët e shërbimit të fshehtë — Xhordën dhe Kuimbi — Uejnrajti s'i kishte njohur më parë.

Inisi dhe Delrimplli i kishin vlerësuar informatat e marra nga Uejnrajti, duke e përgëzuar atë; dy të tjerët diçka më pak. Xhordëni dhe Kuimbi kishin thënë se Uejnrajti duhej t'i kishte vënë në dijeni për të gjitha ato më parë, sapo kishte marrë banknotat e falsifikuara, me ndërmjetësinë e Istinit. Po ashtu edhe Istini, nëpërmjet Uejnrajtit, duhej t'i kishte informuar më parë se të bënte udhëtimin për në Luisvil.

Agjenti Xhordën, një tip i vrenjtur e shtatgjatë, stomaku i të cilit dukej sikur protestonte vazhdimisht, ishte ankuar duke thënë:

— Po të kishim qenë njoftuar me kohë, do të kishim pasur mundësi të ndërhynim kur duhej. Siç janë tani punët, Istini mund të paditet për shkelje të ligjit dhe ju, si bashkëfajtor.

Me ton të qetë e me durim, Uejnrajti kishte theksuar:

— Ju thashë edhe më parë, se Istini s'kishte mundësi të njoftonte njeri; po ashtu, as mua. Ai pranoi t'i futej këtij rreziku dhe mua m'u duk se nuk po vepronte gabim. Përsa i përket padisë; ne as nuk dimë me siguri nëse në atë makinë kishte para të falsifikuara.

— Atje duhet të kenë qenë, patjetër, — llomotiti Xhordëni. — Pikërisht në atë kohë filluan të qarkullojnë në Luisvil. Ajo që nuk dinim akoma ishte se si i kishin shpënë atje.

— Mirë pra, tani e dini, — kishte ndërhyrë Inisi. — Dhe, në sajë të Nolanit, kemi bërë një hap të madh përpara.

Uejnrajti shtoi:

— Po të kishit ndërhyrë, sigurisht që do të kishit shtënë në dorë një sasi të madhe parash të falsifikuara; vetëm se, pas kësaj, Istini do të ishte një kartë e djegur dhe ç'do të ishte më i dobishëm.

Uejnrajti ishte pjesërisht i një mendjeje me pikëpamjen e shërbimit të fshehtë. Agjentët e tij ishin të mbytur në punë, ishin pak, duke pasur parasysh nevojat e shërbimit, ndërsa, vitet e fundit, sasia e parave të falsifikuara në qarkullim ishte rritur tepër. Ata ishin duke luftuar me një kuçedër me një mijë kokë. Sapo zbulonin një burim parash të falsifikuara, veç kur nxirrte kryet një tjetër, pa llogaritur ato që mbeteshin gjithnjë të panjohura. Për t'i hedhur hi syve publikut, deklaratat zyrtare përsëritnin se falsifikuesit ziheshin gjithmonë dhe se me këtë lloj veprimi të dënueshëm dhe të paligjshëm nuk mund të siguroheshin fitime. Në të vërtetë, siç e dinte edhe Uejnrajti, ai veprim siguronte fitime të majme.

Me gjithë fërkimin që kishte ndodhur në fillim, mbledhja kishte dhënë fryte. Për secilin individ, emrin e të cilit e kishte dhënë Istini, ishte hapur një dosje, me parashikim të çastit kur do të mund të bëhej një varg arrestimesh. Falsifikuesi material, Deni, ishte identifikuar si Deniell Kerrigeni, shtatëdhjetë e tre vjeç. «Shumë kohë më parë, — kishte thënë Inisi, — Kerrigeni ka qenë arrestuar tri herë dhe është dënuar dy herë për falsifikime, por këto pesëmbëdhjetë vjetët e fundit s'kemi dëgjuar më të flitet për të: ose s'e ka shkelur më ligjin, ose ka qenë me fat, ose ka vepruar me zgjuarsi.»

Uejnrajti i ra ndërmend dhe, këtë, ua tha edhe të tjerëve, një vërejtje e Denit — të raportuar nga Istini — nga e cila mund të nxirrej si përfundim se ai punonte në një organizatë që funksiononte si duhet.

— Ka mundësi, — kishte thënë Inisi.

Pas kësaj mbledhjeje të parë, Uejnrajti dhe të katër agjentët u takuan shpesh dhe drejtori i shërbimit të sigurimit të bankës u premtoi se do t'i vinte menjëherë në dijeni mbi të dhënat e çdo raporti të ri të Istinit. Të gjithë ishin të mendimit se e dhëna e fundit vendimtare që mungonte ishte lokalizimi i strofkës së falsifikimeve. Deri në atë çast, askush s'mund të thoshte asgjë se ku mund të ndodhej ajo. Megjithatë, shpresat për të gjetur një fill tjetër drejtues ishin të mëdha dhe, në rast se një gjë e tillë do të ndodhte dhe, kur të ndodhte, ata ishin të gatshëm të ndërhynin.

Befas, ndërsa Uejnrajti kishte rënë në mendime, ra zilja e telefonit. Një sekretare i tha se zoti Vandervurt dëshironte ta shihte më parë që të ishte e mundur.

Uejnrajti s'po u besonte veshëve. I ulur përballë Aleksit, te tryeza e tij e punës, protestoi:
— E keni me gjithë mend?
— Sigurisht që po, tha Aleksi, — ndonëse e kam të vështirë të besoj që ta kesh dhe ti, me gjithë mend duke pasur parasysh mënyrën se si e ke përdorur Nunjezin. Nga të gjitha

mendimet e marra që...
— Të marra apo jo, ato dhanë rezultat.
Aleksi nuk ia vuri veshin komentit.
— E vure në rrezik atë grua të re, pa i thënë gjë askujt. Si rezultat i kësaj, tani jemi të detyruar të përkujdesemi për të dhe ka edhe mundësi të kemi dhe ndonjë proces gjyqësor.
— Unë u nisa nga mendimi, — tha Uejnrajti, — se sa më pak njerëz të ishin në dijeni të asaj që bënte ajo, aq më e siguruar do të ishte.
— Jo! Këtë e thua tani, për të gjetur një justifikim. Në të vërtetë, ajo që ke menduar është se, po të ma kishe thënë mua, ose Eduina d'Orsejit, ne do të të kishim ndalur. Në fillim, kundërshtova për Istinin. A ka mundësi të isha më pak i vendosur për Nunjezin?
Uejnrajti fërkoi mjekrën med nyjën e njërit gisht.
— E po, me sa duket ke të drejtë.
— S'ka dyshim që kam!
— Por, sidoqoftë, nuk ka arsye të ndërpritet i tërë operacioni. Për herë të parë jemi shumë pranë një zbulimi të madh lidhur me letekreditet e falsifikuara. E pranoj, bëra gabim duke kërkuar bashkëpunimin e Nunjezit, por veprova drejt përsa i përket Istinit dhe kjo vërtetohet nga rezultatet.
Aleksi tundi kokën, me pamje të vendosur.
— Nolan, e lashë një herë veten të bindesha nga argumentet e tua. Mjaft me kaq. Detyra jonë këtu është të interesohemi që të shkojnë mirë punët e bankës dhe jo të ndjekim kriminelët. Do ta lëmë këtë çështje në duart e shërbimit të fshehtë dhe do të bashkëpunojmë me ta sa të kemi mundësi; mirëpo, nuk do të marrim iniciativa ne vetë. Prandaj të urdhëroj që ta ndërpresësh operacionin që sot, po qe se është e mundur.
— Shiko, Aleks...
— Kam shikuar mjaft dhe ajo që kam parë nuk më ka pëlqyer. Nuk dua që FMA-ja të paditet se ka vënë në rrezik jetën e njerëzve, as edhe atë të Istinit. Ky është një vendim i prerë, prandaj le të mos humbim më kohë me diskutime të tjera.
Ndërsa fytyra e Uejnrajtit pasqyronte një shprehje dekurajimi të plotë, Aleksi vazhdoi: — Gjëja tjetër që dua të bëhet është

që, sot pasdite, të mblidhemi ti, Eduina d'Orseji dhe unë, për të vendosur se në ç'mënyrë ta mbrojmë zonjën Nunjez. Mund të fillosh që tani të mendohesh për këtë gjë. Çfarë mund të jetë e nevojshme...
Një sekretare u duk në pragun e derës së zyrës. Aleksi thirri me ton të zemëruar:
— Çfarëdo që të jetë, më vonë!
Vajza tundi kokën.
— Zoti Vandervurt, në telefon është zonjushe Brekëni. Tha se është një gjë shumë e ngutshme dhe se vetë ju do të donit t'ju ndërprisnin, çfarëdo që të ishte duke bërë.
Aleksi psherëtiu dhe ngriti receptorin e një telefoni.
— Po, Margot?
— Aleks, — tha Margoti, — është për Juanita Nunjezin.
— Ç'i ka ndodhur?
— Është zhdukur.
— Prit një çast. — Aleksi hapi amplifikatorin telefonik, në mënyrë që Uejnrajti të mund të dëgjonte. — Vazhdo!
— Jam shumë në merak. Mbrëmë, para se të largohesha nga Juanita dhe të vija te ti, u morëm vesh se do t'i telefonoja sot në degën e bankës. Ajo ishte plot ankth dhe unë shpresoja t'i jepja një lajm që ta qetësoja.
— E pastaj?

— Aleks, sot nuk ka shkuar në punë. — Zëri i Margotit kishte një tingull shqetësimi e frike.
— E po, ndoshta...
— Të lutem, më dëgjo. Tani jam në Rajonin Lindor. Kur mësova se ajo nuk ishte në bankë, u mundova t'i telefonoja, por nuk më përgjigjej njeri. Atëherë erdha këtu. Bisedova me disa persona që banojnë në të njëjtën ndërtesë me Huanitën. Dy prej tyre e kishin parë duke dalë sot në mëngjes nga apartamenti, në orën e zakonshme, së bashku me vajzën e saj të vogël, Estelën. Huanita e çon gjithmonë në kopsht, para se të shkojë në bankë. Gjeta emrin e kopshtit dhe telefonova. Estela nuk është atje. Sot nuk kanë shkuar atje as vajza dhe as e ëma.

Për një çast, ra heshtje. Zëri i Margotit pyeti:
— Aleks, a po vazhdon të dëgjosh?
— Po, këtu jam.
— Atëherë, telefonova përsëri në bankë dhe, kësaj here, kërkova Eduinën. Ajo e verifikoi vetë këtë gjë. Jo vetëm që Huanita nuk ka shkuar në bankë, por as që ka njoftuar, gjë që s'e ka zakon. Ja sepse jam në merak. Jam e bindur se ka ndodhur diçka e keqe, shumë e keqe.
— A ke ndonjë mendim?
— Po, — ia priti Margoti, — po atë që ke edhe ti.
— Prit, — i tha ai, — Nolani është këtu, me mua.
Uejnrajti, që ishte përkulur përpara për të dëgjuar, e drejtoi trupin përsëri dhe tha me ton të qetë:
— Nunjezin e kanë rrëmbyer. Për këtë s'ka dyshim.
— Kush ta ketë bërë këtë?
— Dikush nga njerëzit e Palestrës Shtatë-Shtatë. Ka të ngjarë që të jenë duke kërkuar edhe Istinin.
— Thua ta kenë shpënë Huanitën te ajo Palestra?
— Jo. Kjo do të ishte gjëja e fundit që do të bënin. Do të jetë në ndonjë vend tjetër.
— S'ke ide se ku?
— Jo.
— Dhe ata që e kanë rrëmbyer, do të kenë marrë edhe vajzën?
— Kam frikë se po. — Sytë e Uejnrajtit kishin një shprehje ankthi. — Më vjen keq, Aleks.
Ti na fute të gjithëve në këtë batak! — tha Aleksi me zemërim. — Dhe tani, për perëndi, duhet të nxjerrësh jashtë tij Huanitën dhe vajzën e saj!
Pasi u përqendrua disa çaste, Uejnrajti tha:

— Puna e parë që duhet bërë është të shihet nëse ka mundësi të paralajmërohet Istini. Në rast se arrijmë ta gjejmë dhe të bëjmë që të shpëtojë, ka mundësi që ai të dijë ndonjë gjë që mund të na çojë te Nunjezi. — Ai kishte në dorë një bllok shënimesh të vogël, të zi, të hapur, dhe po ngrinte receptorin e një telefoni tjetër.

Gjithçka ndodhi aq shpejt dhe në mënyrë aq të papritur, saqë dyert u mbyllën dhe vetura e madhe e zezë u vu në lëvizje, para se Huanita të kishte kohë të thërriste. Ndonëse instinktivisht e kuptonte se tanimë ishte tepër vonë, ajo filloi të thërrasë me të madhe «Ndihmë! Ndihmë!», derisa një grusht e goditi me forcë në fytyrë dhe, pastaj, një dorë me dorashkë i zuri gojën. Megjithatë, duke dëgjuar britmat e tmerruara të Estelës, që ishte pranë saj, Huanita vazhdoi përpjekjet për t'u çliruar, derisa grushti e goditi edhe një herë me forcë. Sytë iu errësuan dhe iu duk sikur tingujt i vinin nga larg, të dobët e të paqartë.

Dita — një mëngjes i qartë dhe i freskët i fillimit të nëntorit — kishte nisur si zakonisht. Huanita dhe Estela ishin ngritur me kohë, për të ngrënë mëngjesin dhe për të parë emisionin e lajmeve në televizorin e tyre të vogël portativ, bardhë e zi. Pastaj, ato kishin dalë si zakonisht në orën 7.30, në mënyrë që Huanita të kishte kohë të mjaftueshme për ta çuar Estelën në kopsht, para se të merrte autobusin për në qendër të qytetit. Kjo rrugë që bënte çdo mëngjes me Estelën ishte për Huanitën një mënyrë e gëzueshme për të nisur ditën. Sapo kishin dalë nga ndërtesa, Estela ishte nisur përpara, duke kërcyer gjatë trotuarit dhe duke thirrur prapa: — «Mami, s'kam shkelur asnjë vizë!» Huanita kishte buzëqeshur, sepse Estela zbavitej shumë duke kapërcyer vizat e të çarat e trotuarit dhe këtë lojë ato e bënin shpesh. Kishte qenë pak a shumë në këtë kohë që Huanitës i kishte rënë në sy — por pa i kushtuar shumë vëmendje — një veturë e madhe, e zezë, me dritare të errëta, me derën e prapme, nga ana e trotuarit, të hapur. Mirëpo, ishte bërë më e vëmendshme, kur Estela ishte afruar veturës dhe dikush i kishte folur nga brenda. Estela i ishte afruar edhe më shumë dhe, befas, nga vetura ish zgjatur me shpejtësi një dorë, që e kishte kapur dhe e kishte tërhequr brenda. Në çast, Huanita ishte lëshuar me vrap drejt derës së

makinës. Kur kishte mbërritur atje, dikush, që ajo s'e kishte parë, i kishte dhënë një të shtyrë nga prapa. Ajo kishte humbur ekuilibrin dhe kishte rënë në veturë, duke gërvishur keqas këmbët. Para se të ngrihej, e kishin tërhequr brenda dhe e kishin vendosur në dyshemenë e veturës, bashkë me Estelën. Dera e prapme ishte mbyllur me forcë, ashtu si dhe një nga dyert e përparme, dhe vetura ishte nisur.

Tani, ndërsa po vinte plotësisht në vete dhe po i sqaroheshin mendimet, dëgjoi një zë që thoshte:
— Për hir të zotit, më thuaj, ç'djalë! të shtyu të merrje edhe këtë fëmijë të mallkuar?
— Duhej marrë, përndryshe do të lëshonte klithma pas klithmash dhe ndonjë budalla mund të thërriste policët. Kurse tani po largohemi qetë-qetë, me shpejtësi dhe pa ngatërresa.

Huanita u mundua të lëvizte. I dukej sikur thika të skuqura në zjarr i përshkonin kokën, duke u nisur nga vendi ku e ishin goditur. Lëshoi një rënkim.
— Dëgjo, bushtër! — tha një zë i tretë. — Po s'ndenje si duhet, do të hash plot të tjera. Dhe mos rri me shpresa se mund të të shohin nga jashtë. Kjo makinë ka xhama, nëpër të cilët shihet vetëm nga brenda.

Huanita ndenji pa lëvizur, duke u munduar të largonte panikun që e kishte pushtuar. Në makinë gjendeshin tre burra: dy në ndenjësen e prapme, të cilët qëndronin mbi të, dhe njëri përpara, në vendin e shoferit. Vërejtija për xhamat e dritareve, nëpër të cilët mund të shihje vetëm nga brenda, e shpjegonte përshtypjen që kishte pasur më parë për një makinë të madhe, me dritare të errëta. Prandaj, ajo që i kishin thënë ishte e drejtë: ishte e kotë përpjekja për të tërhequr vëmendjen e kalimtarëve. Por, ku po e çonin atë dhe Estelën? Dhe pse? Ajo s'kishte as dyshimin më të vogël se përgjigjia e pyetjes së dytë kishte, në njëfarë mënyre, lidhje me punën e saj si ndërmjetëse midis Majllsit dhe Uejnrajtit. Kishte ndodhur ajo gjë, së cilës i trembej prej kohe. E kuptoi se gjendej në një

rrezik shumë të madh. «Por, shën Mëri, pse Estela?» Të dyja ato ishin të shtrënguara njëra me tjetrën, në dyshemenë e veturës, dhe trupi i vogël i Estelës dridhej nga dënesa plot dëshpërim. Huanita lëvizi, duke dashur të shtrëngonte të bijën në krahët e saj dhe ta ngushëllonte.

— Eja, amorcito! Bëhu trimëreshë, vogëlushe.
— Qepe! — e urdhëroi njëri nga burrat.
Një zë tjetër (asaj iu duk se ishte i shoferit) tha:
— Më mirë t'ua lidhim të dyjave gojën dhe sytë.

Huanita ndjeu se po bëheshin lëvizje, dëgjoi një zhurmë të ngjashme me atë të një cohe që griset dhe filloi të lutej me përgjërim: — Jo, jo, ju lutem, jo ... — Fjalët e tjera i mbetën në grykë, sepse i vunë në gojë një copë të madhe shiriti ngjitës, duke ia ngjeshur mirë. Pas pak, një pecë e zezë i mbuloi sytë dhe ajo e ndjeu se po e shtrëngonin fort. Pastaj, ia zunë duart dhe ia lidhën prapa shpinës. Litari ishte shtrënguar aq shumë sa gati i priste kyçet e duarve. Dyshemeja e veturës ishte plot me pluhur, që i mbushte vrimat e hundës. Duke e ndier se po i zihej fryma, ajo e nxirrte frymën me forcë për të liruar hundën dhe, kështu të mbushej sërish... Nga lëvizje të tjera që bëheshin pranë saj, kuptoi se të njëjtën gjë po i bënin edhe Estelën. Ndjeu të pushtohej nga një dëshpërim i madh. Sytë iu mbushën me lot nga zemërimi dhe dëshpërimi që s'kishte mundësi të bënte gjë. «Mallkuar qofsh, Uejnrajt! Mallkuar qofsh, Majlls! Ku jeni tani?... Pse, për bela, kishte pranuar ajo?... Kishte bërë të mundur këtë që po të ndodhte... «Oh, pse? Pse?... Shën Mëri, të lutem, më ndihmo! Ose, së paku, shpëto Estelën!»

Ndërsa kalonte koha dhe shtohej dhemba, si edhe vetëdija se ishte krejt e pafuqishme para kësaj gjëme, mendimet filluan t'i endeshin andej-këtej. Me zor e kuptoi se makina po ecte ngadalë, duke u ndalur herë pas here dhe nisur përsëri, ashtu siç ndodh në trafik të dendur, dhe, pastaj, pas një rruge të gjatë me shpejtësi, ecte përsëri ngadalë, duke u kthyer sa

djathtas, majtas. Udhëtimi dukej pa mbarim. Mbas nja një ore — apo mos kishte kaluar shumë më tepër kohë, a shumë më pak? — Huanita ndjeu një frenim të fortë. Për një çast, zhurma e motorit të veturës u dëgjua edhe më shumë, sikur makina të ndodhej në një hapësirë të mbyllur, dhe pastaj u shua. Ajo dëgjoi gumëzhitjen e një motori elektrik, të cilën e ndoqi një zhurmë e fortë, siç ndodh kur mbyllet automatikisht një derë e rëndë metalike. Më në fund, dyert e makinës u hapën, me një kërcitje menteshash, dhe atë e ngritën në këmbë me egërsi dhe e shtynë përpara. Asaj iu morën këmbët dhe do të ishte rrëzuar, sikur dy duar të mos e kishin mbajtur në kohë. Njëri nga të tre zërat, të cilin e kishte dëgjuar dhe më parë, e urdhëroi:

— Ec, të marrtë djalli!

Me sytë akoma të lidhur, Huanita bëri disa hapa plot ngurrim, gjithnjë me zemër të dridhur nga frika që kishte për Estelën. Nga zhurma, e kuptoi se po ecnin mbi një shtresë çimentoje. Papritur, para këmbëve të saj ndjeu disa shkallë, të cilat filloi t'i zbriste, duke u penguar, ca e mbajtur e ca e shtyrë nga ata që e shoqëronin. Në fund të shkallëve, eci edhe pak. Më në fund, pa asnjë paralajmërim i dhanë një të shtyrë të fortë që e rrëzoi mbrapsht, mbi një karrige të fortë dërrase. I njëjti zë i mëparshëm i tha dikujt:

— Hiqja pecen nga sytë dhe shiritin nga goja!

Ajo ndjeu duar që lëviznin dhe, përsëri, një dhembje tjetër të fortë, kur ia shkëputën me egërsi shiritin ngjitës. Pecja e syve u zgjidh dhe Huanita filloi të kapsalliste sytë, sepse errësira ia kishte lëshuar vendin një drite të fortë, që i binte drejtpërdrejtë në sy.

Mundi të thotë vetëm:

— Por dios, ku është... — para se ta godiste edhe një grusht tjetër.

— Mos e harxho frymën, — i tha njëri nga të tre zërat që kishte dëgjuar më parë në makinë. — Kur të themi ne, do të zbrazesh mirë.
Toni Beri kishte pasione të ndryshme. Njëri prej tyre është erotizmi. Me këtë, sipas pikëpamjes së tij, ai kuptonte disa gjëra që i bënin gratë, mbas të cilave ai e ndjente veten superior ndaj tyre, ndërsa ato vetë, të poshtëruara. Një tjetër ishte pasioni i gjakut dhe ky pasion shtrihej nga përleshjet e këndesave e gjer te përshkrimet e hollësishme, ose raportet me shkrim, të rrahjeve dhe ekzekutimeve që bëheshin me urdhër të tij, duke pasur kujdes ai vetë që të rrinte larg vendit të ngjarjes, për të mos dalë në skenë. Një pasion tjetër, më i butë se dy të tjerët, ishte për xhamat, nëpër të cilët mund të shihet vetëm nga njëra anë.
Këto lloj xhamash (ose pasqyrash), të cilat i jepnin mundësi të shikonte pa u parë nga të tjerët, i pëlqenin aq shumë, saqë i kishte instaluar në vende të ndryshme: në makinat e tij, zyrat, lokalet që frekuentonte, duke përfshirë edhe Palestrën Shtatë-Shtatë, dhe vetë në banesën e tij, që ishte e veçuar dhe ruhej mirë. Në këtë të fundit, një banjë-tualet, që përdorej nga të ftuarit të seksit femëror, kishte një faqe të tërë muri prej xhami të tillë. Nga brenda, dukej si një pasqyrë e bukur, me përmasa shumë të mëdha, por nga ana tjetër gjendej një dhomë e vogël, nga e cila Toni Beri rrinte ulur, me një puro në gojë, dhe kënaqej me pamjen e veprimeve më intime dhe personale që bëheshin pa ditur se i vështronin.
Për shkak të kësaj dëshire kaq të madhe, edhe në qendrën ku kryheshin punimet e falsifikimeve, ku, për arsye sigurimi, ai shkonte rrallë, kishte pasur raste kur xhamat e këtij lloji kishin qenë të dobishëm, siç po ndodhte edhe në atë çast.
Fleta e xhamit ishte futur në një paret ndarës — në të vërtetë një si perde veçuese. Nëpërmjet tij, ai shihte Nunjezin të

lidhur në një karrige, të kthyer drejt tij. Ajo e kishte fytyrën të mavijosur e me xhunga nga goditjet, dhe flokët të prishur. Pranë saj ishte fëmija, e lidhur në një karrige tjetër dhe me fytyrën e vogël, të bardhë si gëlqere. Para disa minutave, kur Marinoja kishte marrë vesh se kishin sjellë atje edhe fëmijën, ishte zemëruar sa s'bëhet, jo sepse i dhimbeshin fëmijët — s'e çante fare kokën për ta — por sepse e ndjente që kjo gjë mund të shkaktonte ngatërresa. Në qoftë se ishte e nevojshme, një i rritur mund të zhdukej, praktikisht pa ndonjë rrezik, por, vrasja e një fëmije ishte një gjë krejt e ndryshme. Ai e dinte se kjo do të shkaktonte neveri te vetë njerëzit e tij dhe, më vonë, njëfarë përbuzje të rrezikshme; po qe se do të merrej vesh. Toni Beri e kishte marrë tanimë vendimin lidhur me këtë çështje. Ishte gjithashtu i kënaqur që, vetë ai, s'ishte parë fare.

Ndezi një puro dhe vazhdoi të vështronte.

Anxheloja, një nga rojat personale të Toni Berit, i cili kishte qenë ngarkuar me drejtimin e veprimit të rrëmbimit, u përkul mbi gruan. Anxheloja ishte një ish kampion boksi, me fizikun e një rinoceronti. Kishte buzë të trasha, të dalura; ishte prepotent dhe i kënaqur me detyrën që i kishin ngarkuar.

— E, lavire, ç'pret, pse s'flet? Hape gojën!

Huanita që po mundohej të shihte Estelën, ktheu kokën nga ai.

— De qué? Të flas, për çfarë?

— Si e ka emrin ai që të telefonoi nga Palestra Shtatë-Shtatë?

Një shkëndijë vezulloi në fytyrën e saj, që tregonte se ajo e kishte kuptuar se për çfarë ishte fjala. Toni Beri e vuri re dhe e kuptoi se tanimë ishte vetëm një çështje kohe dhe, bile, jo shumë të gjatë, deri sa ta mësonin atë emër.

— Bastard!... Fakshë! — Huanita e pështyu. — Canala[1], S'di

gjë fare unë për asnjë Shtatë-Shtatë.
Anxheloja e qëlloi me forcë, saqë i doli gjak nga hunda dhe nga një cep i buzës. Koka e Huanitës u var poshtë. Ai e zuri për flokësh, ia ngriti fytyrën lart, duke përsëritur:
— Kush është ai që të telefonoi nga Palestra Shtatë-Shtatë?
Duke u përgjigjur me vështirësi, nëpërmjet buzëve të enjtura, ajo tha:
— Marikón[2]), nuk do të them asgjë, po nuk e le të lirë vajzën time.
«Ka guxim, bushtra,» tha me vete Toni Beri. Po të kishte pasur një fizik të ndryshëm, edhe mund të ishte zbavitur për ta thyer me mënyra të tjera. Mirëpo, ajo ishte shumë e dobët, gati koskë e lëkurë, gjë që s'ishte sipas shijes së tij. S'kishte kofshë pothuajse fare, vetëm një grusht vithe, thithka të vogla si kokrra kikiriku.
Anxheloja tërhoqi prapa krahun dhe i dha një grusht në stomak. Huanitës iu zu fryma, u palos më dysh, me trupin të përkulur përpara, aq sa e lejonte litari me të cilin e kishin lidhur. Estela, që i shihte dhe i dëgjonte të gjitha, qante me të madhe, me dënesë. Ky zë e mërziti Toni Berin. Kjo punë po zgjatej tepër. Kishte një mënyrë veprimi më të shpejtë. Ai ia bëri me shenjë një roje tjetër personale, Lout, dhe i pëshpëriti diçka. Lou nuk u duk shumë i kënaqur nga urdhri që ishte marrë, por pohoi me kokë. Toni i dha puron që po pinte. Ndërsa Lou shkoi te Anxheloja, nga ana tjetër e paretit, dhe po i thoshte diçka me zë të ulët, Toni Beri Marino hodhi sytë rreth e përqark. Ata gjendeshin në një bodrum, me të gjitha dyert të mbyllura, kështu që, nga jashtë, s'kishte mundësi të dëgjohej gjë; por, edhe po të dëgjohej diçka, kjo s'kishte shumë rëndësi. Shtëpia ku gjendeshin, e ndërtuar pesëdhjetë vjet më parë, ngrihej në një vend të veçuar, në një lagje banesash luksoze, dhe ishte e mbrojtur si një fortesë.

Organizata, e kryesuar nga Toni Beri Marino, e kishte blerë para tetë muajve dhe kishte përqendruar atje tërë veprimtarinë e saj të falsifikimeve. Së shpejti, si masë sigurimi, do ta shisnin dhe do të kalonin në një strofkë tjetër. Në fakt, tanimë, e kishin zgjedhur një ndërtesë tjetër, me pamje të qetë dhe të pafajshme, si kjo e tanishmja. Pikërisht në këtë, mendonte nganjëherë me kënaqësi Toni Beri, qëndronte e fshehta e veprimtarisë së tij të gjatë e me sukses: transferime të shpeshta në zona të qeta dhe të respektueshme, me një trafik drejt qendrës së qytetit dhe anasjelltas, të kufizuar në minimum. Këto masa kaq të rrepta sigurimi kishin dy avantazhe: vetëm një numër i vogël njerëzish e dinin me saktësi se ku ndodhej qendra. Veç kësaj, meqenëse gjithçka ishte e qetë, fqinjët nuk dyshonin për gjë. Ishin përgatitur bile masa sigurimi të hollësishme, lidhur me transferimet. Njëra prej këtyre ishte përdorimi i disa arkave prej dërrase — që nga jashtë dukeshin si mobilie shtëpie — të cilat i mbulonin të gjitha makineritë, kështu që, për një vëzhgues të rastit, e gjithë kjo dukej si një ndërrim i zakonshëm banese. De i zakonshëm ishte edhe kamioni që përdorej për këtë qëllim. Ai vinte nga një prej ndërmarrjeve të transportit, me anën e të cilave organizata zhvillonte një veprimtari të ligjshme, që mbulonte atë të vërtetën. Ekzistonin edhe plane për raste të jashtëzakonshme, duke përfshirë edhe kamionë shumë të shpejtë.
Mendimi për mobiliet e rreme kishte qenë i Deni Kerrigenit. Që prej kohës që Toni Marino e kishte futur në organizatë, nja dhjetë vjet më parë, plaku kishte pasur edhe shumë mendime të tjera të mira, përveç faktit se kishte dhënë prova që ishte kampioni i falsifikuesve. Para asaj kohe, Toni dinte vetëm se Kerrigeni ishte një zejtar i zoti dhe se kishte vesin e alkoolit dhe të frekuentimit të mejhaneve. Me urdhrin e tij, plakun e kishin marrë, e kishin dezinfektisur dhe, pastaj, e

kishin vënë në punë, gjatë së cilës ai kishte arritur rezultate të jashtëzakonshme.
Toni Beri kishte formuar bindjen se nuk kishte gjë që Deni të mos mund ta tamponte në mënyrë të përsosur — para, pulla poste, certifikata aksionesh, çeqe, patenta shoferësh, triska të asistencës sociale, e të tjera. Kishte qenë mendimi i Denit ai që të prodhoheshin mijëra letërkredite të falsifikuara. Me anë të rys hfetit dhe të një aksioni të përgatitur me kujdes, ata kishin shtënë në dorë një sasi të mirë fletësh plastmasi, me anën e të cilave bëheshin letërkreditet Kiçarch, dhe sasia e tyre ishte e mjaftueshme për disa vjet. Gjer në atë kohë, fitimet kishin qenë shumë të mëdha.

E vetmja e metë e plakut ishte se, herë pas here, kthehej në zakonin e vjetër e bëhej tapë dhe, kështu, nuk punonte për një javë ose dhe më shumë. Kur ndodhte kjo, ekzistonte edhe rreziku që të llapte tepër, prandaj e mbanin mbyllur. Mirëpo, Deni ishte dinak dhe, nganjëherë, gjente mënyrën për të marrë arratinë, siç kishte ndodhur pak kohë më parë. Ndërkaq, kohët e fundit, këto raste ishin bërë më të rralla, sidomos për shkak se Deni po e grumbullonte pjesën e tij të parave në një llogari bankare në Svicër dhe ëndërronte të shkonte atje, mbas një ose dy vjetësh, për të tërhequr paratë, duke hequr dorë një herë e mirë nga çdo veprimtari. Mirëpo, Toni Beri e dinte se ky ishte i vetmi operacion i pijanecit që nuk do të kishte sukses. Ai kishte ndërmend ta shfrytëzonte atë gjatë gjithë kohës që ishte akoma në gjendje të punonte dhe, veç kësaj, Deni dinte shumë gjëra dhe nuk do të ishte një veprim i matur ta lije të largohej.

Por, në qoftë se Deni Kerrigëni ishte i rëndësishëm, jo më pak e rëndësishme ishte edhe organizata që e mbronte dhe hidhte në treg gjithçka që ai prodhonte. Pa një sistem efektiv shpërndarjeje, plaku do të kishte qenë njësoj si pjesa më e madhe e njerëzve të kategorisë së tij: një falsifikues pa ndonjë vlerë të veçantë, ose krejt pa vlerë. Prandaj, ajo që e

preokuponte më shumë Toni Berin ishte kërcënimi nën të cilin ndodhej organizata. Mos ishte futur brenda saj një spiun, një informator? Në rast se kjo gjë ishte e vërtetë, nga kishte ardhur ai? Dhe ç'gjëra kishte zbuluar gjer tani ai, ose ajo?

Ai i ktheu përsëri sytë të shihte ç'po ndodhte nga ana tjetër e dhomës me shikim të njëanshëm. Anxheloja kishte në dorë puron e ndezur. Buzët e tij të trasha ishin kontraktuar në një ngërdheshje. Me njërën këmbë, i shtyu të dyja karriget, në mënyrë që Nunjezi dhe vajza e saj e vogël të ishin ballë për ballë. Pastaj, e thithi puron disa herë me radhë, deri sa maja e saj u skuq mirë. Më në fund, si rastësisht, iu afrua karriges ku ishte lidhur fëmija.

Estela, duke u dridhur në mënyrë të dukshme, ngriti drejt tij sytë e saj, në të cilët lexohej qartë tmerri që e kishte pushtuar. Pa u ngutur, Anxheloja zuri dorën e djathtë të vajzës së vogël, i shikoi pëllëmbën dhe e ktheu nga ana tjetër. Pastaj, gjithnjë me ngadalë, hoqi nga goja puron dhe e shtypi në shpinën e dorës së vogël të Estelës, pikërisht sikur kjo të kishte qenë një tavllë duhani. Estela lëshoi një klithmë, një britmë therëse, nga dhembja e padurueshme. Përballë saj, Huanita, duke qarë e duke thirrur fjalë pa lidhje e pa kuptim, përpiqej e dëshpëruar të çlirohej nga litari që e mbante të gozhduar në karrigen.

Puroja nuk ishte shuar. Anxheloja thithi edhe një herë. Pastaj, me të njëjtën ngadalësi si më parë, ngriti dorën tjetër të Estelës.

Huanita thirri:
— Jo, jo, déjela quieta! Do të ta them.

Anxheloja po priste me puron të ngritur në gjysmë lartësie.

Huanita belbëzoi:
— Njeriu që kërkoni... është Majlls Istini.
— Për kë punon?

Me zërin e saj, që ishte kthyer në një pëshpëritje të dëshpëruar, ajo u përgjigj:
— Për Fërst Merkëntaill Emerikën Benkun.

Anxheloja e lëshoi puron poshtë dhe e shtypi me thembër. Hodhi një vështrim pyetës drejt vendit ku mendonte se duhej të ishte Toni Ber Marino dhe, pastaj, kaloi nga ana tjetër e paretit.

Fytyra e Toni Berit ishte e tendosur. Ai tha me zë të ulët:
— Kapeni atë. Shkoni dhe kapeni atë krimb dhe silleni këtu.

— Majlls, — tha Nejt Nethensëni, me një zë më të dëshpëruar se zakonisht, — i thuaj atij mikut tënd, që s'pushon së telefonuari, kushdo qoftë ai, se kjo palestër nuk është në dispozicion të personelit, por të administrusesve të saj.
— Cili mik? — Majlls Istini që s'kishte qenë gati tërë pasditen në Palestrën Shtatë-Shtatë, për të plotësuar disa nevoja të saj, i hodhi Nethensënit një vështrim të habitur.
— E nga ta di unë? Dikush telefonoi katër herë, duke të kërkuar ty. Nuk e tha emrin dhe as nuk la ndonjë porosi.

— Nethensëni shtoi me padurim: — Ku është libreza e llogarisë?
Majllsi ia dha. Ndërmjet punëve të tjera që kishte kryer, kishte shkuar dhe në bankë për të vënë në llogari disa çeqe.
— Sapo mbërriti një sasi konservash të ndryshme, — tha Nethensëni. — Arkat janë në magazinë. Merre listën dhe kontrolloi, në bazë të faturave. — Ai i dha Majllsit disa fletë dhe një çelës.
— Patjetër, Nejt. Dhe më fal që të shqetësuan me telefonin. Por administratori ishte kthyer nga ana tjetër dhe po drejtohej për në zyrën e tij, në katin e tretë. Majllsi ndjente një farë simpatie për të. Ai e dinte se Toni Ber Marino dhe rusi Ominski, bashkëpronarë të Palestrës Shtatë-Shtatë, i bënin gjithnjë vërejtje dhe i kërkonin llogari për mënyrën se si e

administronte ai Palestrën.
Ndërsa po shkonte te magazina, që gjendej në pjesën e prapme të katit përdhes, Majllsi pyeti me vete se kush mund t'i kishte telefonuar. Kush mund të kishte dashur të fliste me të dhe, bile, me këmbëngulje? Me sa dinte ai, vetëm tre persona, që s'kishin të bënin me botën e krimit, kishin dijeni që ai ndodhej atje: gjykatësi mbikëqyrës, Huanita dhe Nolan Uejnrajti. Gjykatësi? — Kjo kishte shumë pak të ngjarë. Herën e fundit që Majllsi i kishte bërë vizitën e rregullt mujore, ai ishte treguar indiferent dhe tërë nxitim. E vetmja gjë që i interesonte ishte që ai të mos i shkaktonte ngatërresa. Kishte marrë shënim se ku punonte Majllsi dhe kjo kishte qenë e gjitha. Atëherë, Huanita? Jo. Ajo ishte me mend dhe dinte si të vepronte. Veç kësaj, Nethensëni kishte folur me një burrë. Pra, mbetej Uejnrajti.
Mirëpo, as Uejnrajti nuk duhet t'i kishte telefonuar... «Apo ndoshta...?» A nuk do ta kishte marrë parasysh rrezikun, në rast se do të kishte qenë nevoja ta njoftonte për diçka me të vërtetë të ngutshme... siç do të ishte, për shembull, një paralajmërim?
Çfarë paralajmërimi? Se ai ishte në rrezik? Se kishin zbuluar që ishte spiun, apo se kishte mundësi ta zbulonin?
Zemra filloi t'i rrihte më me shpejtësi. Ai tha me vete se, kohët e fundit, kishte menduar se nuk ishte në rrezik dhe e kishte quajtur veten të sigurtë; ndërsa, në të vërtetë, s'kishte pasur kurrë siguri, por vetëm rrezik, i cili ishte akoma edhe më i madh se në fillim, sepse tani ai dinte shumë gjëra.
Kur iu afrua derës së magazinës, i zhytur në këto mendime, duart i dridheshin aq shumë, saqë me zor mundi ta fuste çelësin në bravë. Pyeti veten: mos po fillonte të trembej nga hiçgjë dhe të kishte frikë nga hijet? Ndoshta; por, një parandjenjë i tha se jo. Atëherë, ç'duhej të bënte? Ndoshta, ai

që kishte telefonuar më parë, do të përpiqej përsëri të lidhej me të. Por, a ishte një veprim i urtë të priste gjersa ai të telefononte përsëri? Majllsi vendosi në çast: veprim i rrezikshëm apo jo, do t'i telefononte vetë Uejnrajtit. Ndërkaq, e kishte hapur derën e magazinës. E tërhoqi përsëri që të shkonte te një telefon me pagesë, që ndodhej aty pranë — po ai që kishte përdorur para një jave e gjysmë për të biseduar me Huanitën. Në atë çast dëgjoi një zhurmë njerëzish në skajin tjetër të korridorit. Disa burra po hynin nga rruga dhe dukeshin shumë të nxituar. Pa e ditur se pse, Majllsi e hapi përsëri derën dhe hyri në magazinë, duke u fshehur brenda. Dëgjoi disa zëra që flisnin së bashku dhe, pastaj, një zë që pyeti:

— Ku gjendet ai bukuroshi, Istini?

Ai e njohu zërin e Anxhelos, njërit nga rojat personale të Marinos.

— Besoj se lart, në zyrë. — Ky ishte Xhuls LaRoka. — Çfarë ka...?

— Toni Beri do ...

Zërat u shuan, ndërsa burrat nxitonin lart shkallëve. Por Istini kishte dëgjuar mjaft sa të kuptonte se kishte ndodhur ajo gjë, së cilës i trembej. Brenda një minute dhe, ndoshta, edhe më pak, Nethensëni do t'i thoshte Anxhelos dhe të tjerëve se ai ishte në magazinë dhe, ata, do të zbrisnin për ta zënë.

E zuri një e dridhur e fortë nëpër të gjithë trupin, por, megjithatë, ai u përpoq të mendonte se ç'duhej të bënte. Të dilte nga ana e përparme e ndërtesës ishte e pamundur. Edhe në rast se nuk takohej me burrat që do të ishin duke zbritur shkallët, kishte të ngjarë që ata të kishin lënë ndonjë rojë përjashta. Atëherë, nga porta e prapme? Ajo përdorej rrallë dhe nga ajo dilesh në një oborr, pranë një ndërtese të braktisur. Më tej vinte një hapësirë e zbrazët dhe, më tutje,

hapej një labirint rrugësh të ngushta, të lëna pas dore. Mund të përpiqej t'i humbte në to gjurmët e tij, ndonëse kishte pak të ngjarë që të mund t'i shpëtonte një ndjekjeje. Ata që do ta ndiqnin, mund të ishin të shumtë dhe të kishin edhe një makinë, ose dhe më shumë se një. Ai vetë ishte në këmbë. Ndërkaq, nga mendja e tij mori këtë mesazh: Kjo është mundësia jote e fundit! Mos humb më kohë! Nisu menjëherë! E mbylli derën e magazinës dhe e mori çelësin. Ndoshta ata do të humbisnin disa minuta të çmueshme për të hapur me forcë derën, duke pandehur se ai do të ishte strukur brenda.

Pastaj ia dha vrapit.

U ndal një çast për të hapur shulin e derës së prapme ... Edhe një çast tjetër, për ta mbyllur nga jashtë, në mënyrë që të mos kuptohej se nga ç'anë kishte ikur ... Pastaj u lëshua përsëri me vrap gjatë oborrit që ishte anash ndërtesës së braktisur ... Kohë më parë, kjo ndërtesë kishte qenë një fabrikë; oborri ishte tani i mbushur me mbeturina të ndryshme: arka të vjetra ambalazhi, kutia konservash të zbrazëta dhe, pranë një vend-ngarkimi, deri dhe shasia e ndryshkur e një kamioni. Ishte si një vrapim me pengesa, ndërsa minjtë iknin të trembur nga çdo anë. Ai kërcente mbi tulla, mbeturina të ndryshme, një qen të ngordhur... U pengua diku dhe ndjeu një dhembje të fortë në nyellin e këmbës, por vazhdoi të vraponte... Gjer në atë çast nuk kishte dëgjuar ta ndiqte njeri... Pastaj, kur arriti pranë labirintit të rrugëve të ngushta, që përfaqësonin për të një farë sigurie, dëgjoi një zhumë hapash që vraponin prapa tij dhe një zë që thirri:

— Ja tek është, këlyshi i bushtrës.

Majllsi e shtoi shpejtësinë e vrapit. Ai ndjente tani te këmbët kontaktin e fortë të rrugëve të asfaltuara dhe të trotuarëve. Mori kthesën e parë që i doli nga e majta, pastaj, nga e djathta dhe, menjëherë pas kësaj, përsëri nga e majta. E dëgjonte prapa tij, zhurmën e hapave ... Ai nuk i njihte këto

rrugë, por ndjenja e tij e orientimit i thoshte se po shkonte drejt qendrës së qytetit. Në qoftë se do të mund të mbërrinte atje, do të kishte mundësi të zhdukej në mes të turmës dhe kjo do t'i jepte kohë të mendohej ç'të bënte: ndoshta, t'i telefononte Uenrajtit, për t'i kërkuar ndihmë. Ndërkaq, vazhdonte të vraponte me shpejtësi, pa iu zënë fryma. Nyelli i këmbës i dhimbte akoma, por jo shumë. Orët e kaluara në fushën e hendbollit të Palestrës Shtatë-Shtatë e kishin mbajtur në formë dhe, tani, po jepnin frytet e tyre... Zhurma e hapave, prapa tij, u dobësua dhe, pastaj, s'po dëgjohej më, por kjo nuk e gënjeu. Kishte të ngjarë që ata që po e ndiqnin të kishin hipur në një makinë dhe të ishin duke shkuar për të zënë vend diku, në mënyrë që ta bllokonin në të dalë të ndonjë rruge. Mori përsëri një kthesë majtas dhe, pastaj, djathtas, duke shpresuar gjithnjë, siç kishte bërë që në fillim, të haste ndonjë mjet transporti: një autobus ose, akoma dhe më mirë, një taksi. Por, s'dukej asgjë ... Si djall ndodh që, sa herë që ke aq shumë nevojë për taksi, s'gjen kurrë një të tillë? ... ose një polic. Donte që rrugët, nëpër të cilat po kalonte, të kishin pasur më shumë njerëz, më shumë gjallëri. Duke vrapuar, binte në sy, por nuk mundej akoma ta ngadalësonte vrapin. Disa kalimtarë e vështruan me kërshëri, por atje njerëzit ishin mësuar të shikonin punët e veta.

Megjithatë, ndërsa vazhdonte të vraponte, pamja rreth tij po fillonte të ndryshonte. Ajo ishte tani më pak e ngjashme me atë të një getoje dhe shfaqte ndonjë shenjë për një mirëqenie më të madhe. Majllsi kaloi para disa dyqaneve mjaft të mëdha. Më tutje, shiheshin disa ndërtesa të larta, që tregonin se qendra e qytetit nuk ishte larg. Por, para se të arrinte atje, ai duhej të përshkonte dy kryqëzime të mëdha rrugësh, njëri prej të cilëve ishte tanimë shumë larg. Pa se drejt këtij kryqëzimi shkonte një rrugë e gjerë, me trafik të dendur dhe, më tutje, pa një kadillak të zi; me dritare të errëta që po kalonte me ngadalë. Kadillaku i Marinos! I duk sikur po ndalonte, kur po përshkonte kryqëzimin, dhe, pastaj, e pa të shpejtonte dhe të zhdukej. S'kishte pasur kohë të fshihej. A e

kishin parë? Mos kishte vazhduar vetura të shkonte përpara për t'u kthyer në kryqëzimin e parë, apo kishte pasur fat dhe s'e kishin vënë re? Ndjeu përsëri të pushtohej nga frika. I shkuan mornica, megjithëse ishte tërë djersë, por vazhdoi të shkonte përpara. S'kishte ç'të bënte tjetër. Lëvizte tani pranë ndërtesave, duke e ngadalësuar pak shpejtësinë. Pas disa çastesh, kur kryqëzimi i rrugëve nuk ishte më shumë se nja pesëdhjetë metra larg një kadillak — e njëjta makinë — ia behu nga një kthesë.

Majllsi e kuptoi se fati e kishte braktisur. Cilëtdo që të ishin në veturë — njëri prej tyre duhej të ishte Anxheloja — nuk mund të mos e shihnin, bile, kishte të ngjarë ta kishin parë tanimë. A kishte më kuptim të rezistonte akoma? Nuk do të ishte më e arsyeshme të hiqte dorë nga çdo qëndresë, ta linte veten ta zinin, të ndodhte ç'të ndodhte? Jo! Sepse ai kishte parë shumë njerëz si Toni Ber Marino, njerëz të këtij kallëpi, së pari në burg dhe pastaj në Palestër, për të ditur se ç'u ndodhte njerëzve që binin në kthetrat e hakmarrjes së tyre. Makina e zezë po e ngadalësonte shpejtësinë. Ata e kishin parë!

Majllsi ndodhej pranë njërit nga dyqanet që e kishte vënë re para disa çasteve. Ai e ndali vrapin, u kthye nga e majta, shtyu një derë xhami dhe hyri brenda. Pa se ky ishte një dyqan artikujsh sportivë. I doli përpara një shegert i dobët, i zbehtë, afërsisht në moshën e tij.

— Mirëdita zotëri. Dëshironi të shikoni ndonjë gjë?
— Ah ... Po. — Majllsi tha pastaj gjënë e parë që i erdhi në mend. — Desha të shoh topa bëullingi!).
— Ngjyra?
— S'ka rëndësi.

Majllsi vëzhgonte ato pak metra trotuar, jashtë dyqanit, që dukeshin nga vendi ku ndodhej. Kishin kaluar disa kalimtarë,

por asnjëri prej tyre s'ishte ndalur, si edhe asnjëri prej tyre s'kishte hedhur sytë brenda.

— Po të urdhëroni nga kjo anë, do t'ju tregoj ç'kemi.

Majllsi e ndoqi shegertin, duke kaluar rafte me ski, stenda xhami, një numër pistoletash për qitje në shenjë, të ekspozuara në një stendë të veçantë. Duke hedhur sytë prapas, Majllsi pa siluetën e një njeriu që ishte ndalur jashtë dyqanit dhe po shikonte brenda, nëpërmes vitrinës. Në atë çast, me të u bashkua edhe një i dytë. Ata rrinin aty, bashkë, pa u larguar. Majllsi pyeti veten nëse do të ishte e mundur të dilte nga ana e prapme e dyqanit, por hoqi dorë menjëherë nga ky mendim. Ata që po e ndiqnin nuk do të bënin edhe një herë të njëjtën gabim. Çfarëdo rrugëdalje nga prapra duhet të ishte zbuluar tanimë dhe duhet ta ruanin.

— Ky është një top shumë i mirë. Kushton dyzet e dy dollarë.
— Po e marr.
— Duhet t'ju marr masat e dorës për ...
— S'ka rëndësi.

A duhej t'i telefononte prej aty Uejnrajtit? Mirëpo, ai ishte i sigurt se, me t'u afruar telefonit, ata që ndodheshin jashtë do të suleshin menjëherë brenda.

Shegerti u duk i habitur.
— Nuk doni që të bëjmë vrimat...
— Thashë se nuk ka rëndësi.
— Si të doni, zotëri. A doni dhe një çantë për të mbajtur topat? Ose dhe një palë këpucë të bukura, për të luajtur bëulling?
— Po, — tha Majllsi. — Po, shumë mirë. — Kështu do ta shtynte akoma dhe shumë çastin kur do t'i duhej të dilte përsëri në rrugë. Pa e kuptuar as vetë se ç'po bënte, ai shikoi me radhë çantat që kishte përpara, zgjodhi njërën kuturu dhe, pastaj, u ul për të provuar këpucët. Që pikërisht kur po provonte një palë këpucë që iu kujtua le tërkrediti Kiçarxh që

i kishte dërguar Uejnrajti, me ndërmjetësinë e Huanitës, ... lëshuar në emër të H.E. Lynkolpit ... H.E.L.P. (ndihmë),

Bëri me shenjë nga topi bëulling, çanta dhe këpucët që kishte zgjedhur.
— Sa?

Shegerti ngriti kokën nga një listë çmimesh që kishte përpara. — Tetëdhjetë e gjashtë dollarë e nëntëdhjetë e pesë sent, përveç taksës.

— Paguaj me letër krediti Kiçarxh, — tha Majllsi. Nxori portofolin dhe i dha shegertit letërkreditin, duke u përpjekur të ndalte dridhjen e duarve.
— Mirë, por...
— E di. Ju duhet autorizimi. Në rregull, telefononi.

Shegerti mori letërkreditin dhe listën e çmimeve dhe kaloi në anën tjetër të një pareti me xham, që kufizonte një hapësirë që shfrytëzohej si zyrë. U kthye pas disa minutave.

Majllsi e pyeti me zë të shqetësuar:
— Në rregull?
— Po, zoti Lynkolp. Gjithçka në rregull.

Majllsi mendoi se çfarë mund të ishte duke ndodhur në atë çast në qendrën Kiçarxh të grataciellit të FMA-së. A do t'i vinin në ndihmë? A kishte akoma ndonjë gjë që mund ta ndihmonte? Pastaj i ra në mend udhëzimi i dytë që kishte marrë, me ndërmjetësinë e Huanitës: Pas përdorimit të letërkreditit, të qëndrohej sa më gjatë aty pranë, për t'i dhënë kohë Uejnrajtit që të vepronte.

— Firmosni këtu, ju lutem, zoti Lynkolp. — Shegerti i paraqiti modularin Kiçarxh, me shumën e shpenzuar. Majllsi u përkul mbi banak për ta nënshkruar.

Kur po e drejtonte përsëri trupin, ndjeu një dorë që e preku lehtë në sup. Një zë i tha me ton të qetë:
— Majllis.

U kthye. Xhuls LaRoka i tha:
— Mos bëj kot zhurmë. Nuk do të sillte ndonjë dobi dhe do ta pësoje edhe më keq.
Prapa LaRokës, me fytyra që s'shprehnin asgjë, ishin Anxheloja dhe Lou, si edhe një i katërt — edhe ky me pamjen e një ish boksieri — të cilin Majllisi s'e kishte parë ndonjëherë. Të katërt e futën në mes; duke i zënë krahët dhe duke e bllokuar.
— Ec, dobiç! — Ky urdhër, i dhënë me zë të ulët, vinte nga Anxheloja.
Majllisi pyeti nëse ishte rasti për të thirrur me të madhe për ndihmë. Por kush mund ta ndihmonte aty? Sigurisht që jo shegerti frikacak, që rrinte si i shtangur, duke vështruar gojëhapur. Jo. Gjahu kishte marrë fund. Presioni në krahët e tij u bë edhe më i fortë. Ata po e tërhiqnin drejt derës, ndërsa ai e shihte se ishte krejt i pafuqishëm dhe s'mund të bënte asgjë.
Shegerti, i hutuar, i ndoqi pas.
— Zoti Lynkolp! Harruat gjërat që bletë.
Iu përgjigj Xhuls LaRoka:
— Mbaji ti, bukurosh. Atij nuk i duhen më.
Kadillaku i zi ishte ndalur pranë trotuarit. Ata e shtynë Majllisin brenda gjithë egërsi, duke hipur edhe vetë. Makina u nis.

Në Qendrën e Kreditit Kiçarxh ishte ora kur, gjatë ditës, puna ishte më intensive. Në dritën e dobët të lokalit, të ngjashëm me një sallë koncertesh, punonte turni i zakonshëm, i përbërë nga pesëdhjetë operatorë, çdonjëri i ulur para një tastiere, lart së cilës ishte një tub katodik, i ngjashëm me kinoskopin e televizorëve.
Për operatorët e re që mori thirrjen, kërkesa e kreditit nga ana e H.R. Lynkolpit, ishte vetëm një nga mijëra kërkesat që merreshin gjatë një dite pune. Operatorët nuk e dinin as edhe nga cili shtet ose qytet vinin thirrjet, me të cilat ata merreshin. Krediti i kërkuar mund të shërbente për të paguar llogarinë e bakallit të një gruaje shtëpiake njujorkeze; për të blerë rrobat e

një fermeri në Kansas; për t'i plotësuar tekat një të veje të pasur nga Çikagoja, që të shtonte edhe ndonjë stoli tjetër të padobishme; për të paguar këstin e një universiteti në Prinston; për t'i dhënë mundësi një të alkoolizuari për të blerë arkën e likereve që, më në fund, do ta çonte në botën tjetër. Por operatorëve nuk u peshonin kurrë hollësi. Në rast se, më vonë, këto ishin të nevojshme, ato mund të nxirreshin në çdo çast nga incizimet, por kjo ndodhte rrallë, arsyeja ishte se kjo nuk kishte rëndësi. Rëndësi kishin vetëm paratë, që ndërronin dorë dhe mundësia e klientit për të shlyer kreditin e dhënë nga banka; asgjë tjetër.Thirrja filloi me ndezjen e një drite në tastierën e operadores. Vajza shtypi një buton dhe foli në mikrofonin e bashkuar me kufjen.

— Numri juaj i regjistrimit në Dhomën e Tregtisë, ju lutem.

Personi që thërriste — shegerti i dyqanit me artikuj sportivë, ku ndodhej Majllis Istini — ia dha. Vajza e shtypi në tastierë dhe numri u duk në ekranin e tubit katodik.

Ajo pyeti:

— Cili është numri i letërkreditit dhe data e mbarimit të afatit?

Një përgjigje tjetër dhe, përsëri, të dhëna të tjera në ekran.

— Shuma e blerjes?

— Nëntëdhjetë dollarë e dyzet e tre.

Shtypje në tastierë. Dalje në ekran. Operatorja shtypi një buton tjetër, duke ia transmetuar të dhënat një kompjuteri që ndodhej disa kate më poshtë.

Brenda një të mijtës së sekondës, kompjuteri i mori të dhënat, konsultoi arkivën e kujtesës së tij dhe dha përgjigjen në ekran.

Miratuar.

Autor. Nr. 7416984.

E ngutshme... Rast i jashtëzakonshëm... Mos... përsërisni, mos e alarmoni tregtarin... Vini në dijeni përgjegjësin tuaj. Zbatoni menjëherë udhëzimet për rastet e jashtëzakonshme, Nr. 17...

— Blerja aprovohet, — i tha operatorja personit që kishte thirrur. — Autorizimi numër...

Ajo fliste me ngadalë, si zakonisht; bile, para se të fillonte, kishte shtypur një buton që ia çonte automatikisht sinjalin

njërës nga të gjashtë kabinat, të ngritura më lart se salla, në të cilat punonin përgjegjësit e sallës. Në atë çast, në atë kabinë, një vajzë tjetër, njëra nga të gjashtë përgjegjësit e sallës në shërbim, lexoi në ekranin e saj përgjigjen e transmetuar nga kompjuteri. Pastaj ajo, shikoi me nxitim listën e udhëzimeve për rastet e jashtëzakonshme, duke kërkuar numrin 17.

Ndërkaq operatorja bëri me qëllim sikur u ngatërrua në numrin e autorizimit dhe ia nisi punës përsëri nga e para. Raste të jashtëzakonshme nuk ndodhin shpesh, por kur një i tillë ndodhte, duheshin ndjekur disa procedura të zakonshme. Njëra nga këto ishte që biseda me tregtarin të zgjatej sa më shumë. Në të kaluarën, kishte ndodhur që të kapeshin vrasës, të shpëtohej një njeri i rrëmbyer, të zgjidheshin raste të ndryshme zhdukjesh, të shtiheshin përsëri në dorë vepra arti të vjedhura, me një vlerë shumë të madhe; një djalë të thirrej në shtratin e vdekjes të s'ëmës ... Të gjitha këto sepse një kompjuter kishte qenë programuar në mënyrë që ta jepte alarmin kur të përdorej, ose mund të përdorej, një letërkrediti e caktuar. Në këto raste, duhej ndërhyrë me shpejtësinë më të madhe dhe, ndërsa të tjerët merreshin me vënien në zbatim të planit të parashikuar, disa çaste të fituara nga një operator mund të ishin një ndihmë e madhe.

Përgjegjësia e sallës filloi zbatimin e udhëzimeve Nr. 17, sipas të cilave ajo duhej të njoftonte menjëherë me telefon N. Uejnrajtin, drejtorin e shërbimit të sigurimit, se letërkrediti i posaçëm Kiçarxh, lëshuar në emër të H.E. Lynkolpit, ishte paraqitur, si dhe vendi ku kishte ndodhur kjo. Duke shtypur disa butone të tastierës së saj, përgjegjësia e sallës mori nga kompjuteri të dhënat plotësuese.

Dyqani i Pitit — Artikuj sportivë

dhe adresën përkatëse. Ndërkaq kishte formuar në telefon numrin e zyrës së zotit Uejnrajt, i cili u përgjigj vetë. Ai u tregua menjëherë shumë i vëmendshëm. Përgjegjësia e sallës e

ndjeu tensionin që e kishte pushtuar atë, ndërsa ai po kopjonte të dhënat e nevojshme.

Pas disa sekondash, për përgjegjësin e sallës, operatoren dhe kompjuterin e qendrës Kiçarxh, ky rast i jashtëzakonshëm ishte mbyllur.

Por jo për Nolan Uejnrajtin.

Pas bisedës së vështirë që kishte pasur një orë e gjysmë më parë me Aleks Vandervurtin, kur kishte mësuar për zhdukjen e Huanita Nunjezit dhe të fëmijës së saj, Uejnrajti s'e kishte lëshuar për asnjë çast telefonin nga dora, duke përdorur nganjëherë edhe dy telefona njëkohësisht. Ishte përpjekur katër herë të lidhej me Majlls Istinin, në Palestrën Shtatë-Shtatë, për ta paralajmëruar për rrezikun që i kanosej. Kishte lajmëruar Byronë e Hetimeve dhe shërbimin e fshehtë. Për rrjedhojë, ata kishin filluar tanimë të hetonin në mënyrë energjike mbi këtë rrëmbim të qartë të Nunjezëve dhe kishte vënë në alarm policinë e qytetit dhe atë shtetërore, duke u dhënë përshkrimet e tyre. Ishte vendosur që, sapo të ishte e mundur, ndoshta po atë pasdite, një numër agjentësh do të vendoseshin në afërsi të Palestrës Shtatë-Shtatë, për të vëzhguar çdo lëvizje dhe për të parë se kush hynte e dilte prej saj.

Kjo ishte e gjitha sa mund të bëhej hëpërhë, lidhur me Palestrën Shtatë-Shtatë. Siç kishte thënë edhe Inisi, agjenti i posaçëm «në qoftë se futemi brenda dhe fillojmë të bëjmë pyetje, kështu do të tregomin se me kë është në kontakt Istini. Nga ana tjetër, s'kemi ku të mbështetemi fare për të marrë një urdhër kontrolli. Veç kësaj, sipas thënieve të vetë Istinit, Palestra Shtatë-Shtatë është më shumë një vend takimi, ku nuk bëhet asgjë e paligjshme, me përjashtim të ndonjë loje kumari.

Inisi kishte qenë pastaj i një mendjeje me Uejnrajtin, se Nunjezin dhe vajzën e saj nuk duhet t'i kishin shpënë në Palestrën Shtatë-Shtatë.

Shërbimi i fshehtë, që dispononte më pak forca të lira se Byroja e Hetimeve po vepronte për të zbuluar vendin e fshehtë, duke u vënë në kontakt me informatorë të ndryshëm, duke shqyrtuar çdo të dhënë ose fakt, sado i vogël që të ishte, që mund të të çonte në një gjurmë. Gjë jo e zakonshme, rivaliteti dhe xhelozitë ndërmjet Byrosë së Hetimeve dhe shërbimit të fshehtë, ishin lënë përkohësisht mënjanë.

Kur mësoi se H.E. Lynkolpi kishte paraqitur letërkreditin, Uejnrajti i telefonoi menjëherë Byrosë së Hetimeve. I kishin thënë se agjentët e posaçëm Inisi dhe Dalrimpli ishin jashtë, me shërbim, por se mund të lidheshin me ta me anë të radios. Uejnrajti u diktoi një mesazh të ngutshëm dhe qëndroi në pritje. Përgjigjja erdhi pak më vonë: të dy agjentët ishin në qendër të qytetit, jo larg adresës së dhënë, dhe po shkonin atje. A mund të vinte edhe ai për t'i takuar?

Uejnrajti e ndjeu veten të lehtësuar kur veproi. Zbriti me të shpejtë poshtë dhe mori makinën e tij. Kur mbriti para dyqanit të artikujve sportivë, pa Inisin që po pyeste disa kalimtarë. Dalrimplli ishte akoma brenda në dyqan, duke plotësuar thëniet e shegertit. Inisi i doli Uejnrajtit përpara dhe i tha, me pamje të zymtë:
— Një vërë në ujë. Kur mbërritëm këtu, kishte mbaruar gjithçka. — Pastaj, ai i tregoi ato pak gjëra që kishin mësuar.
Uejnrajti pyeti:
— Përshkrime?
Inisi tundi kokën.
— Shegerti që i shërbeu Istinit është tmerruar aq shumë, saqë nuk është në gjendje të thotë me saktësi nëse ishin tri veta apo katër. Thotë se gjithçka ndodhi aq shpejt, saqë nuk kishte mundësi të përshkruante ose të identifikonte ndonjërin prej tyre. Dhe 'askujt, as brenda dyqanit dhe as jashtë tij, nuk i kujtohet të ketë parë ndonjë makinë.
Fytyra e Uejnrajtit shprehte shqetësim.

— Po tani? — pyeti ai.
— Ti e di mirë. Edhe ti ke qenë në polici. S'mund të bëjmë gjë tjetër, veçse të presim, duke shpresuar që të ndodhë diçka tjetër.

Huanita dëgjoi një zhurmë hapash dhe disa zëra. E kuptoi se kishin zënë Majllsin dhe po e sillnin atje.
Ajo kish humbur nocionin e kohës. Nuk e dinte fare se sa kohë kishte kaluar prej çastit që kishte thënë emrin e Majlls Istinit, duke e tradhtuar atë, për t'i dhënë fund tmerrit të torturës së Estelës. Pak më vonë, ia kishin vënë përsëri në gojë shiritin ngjitës dhe i kishin kontrolluar e shtrënguar prapë litarët që e mbanin të lidhur te karrigia. Më në fund, të gjithë ishin larguar.
I kujtohej se, për një kohë, kishte dremitur; ose, do të ishte më e drejtë të thuhej se kishte kaluar në një gjendje të pandërgjegjshme, mbasi, e lidhur siç ishte, çdo prehje e vërtetë ishte pamundur. Kur zhurmat e fundit e sollën përsëri në vete, ajo ndjeu një dhembje aq të fortë në gjymtyrët e mpira, saqë do të kishte ulëritur, sikur të mos kishte pasur shiritin në gojë. Ia impononi vetes që të mos pushtohej nga paniku dhe të mos orvatej të çlirohej nga litarët, duke e ditur se, si njëri veprim ashtu dhe tjetri, do të ishin të kotë dhe do të shkaktonin keqësimin e gjendjes së saj.
Së paku, Estelën mund ta shihte. Të dyja karriget kishin mbetur përballë njëra-tjetrës. Vogëlushen e kishte zënë gjumi; ajo i kishte sytë të mbyllur, ndërsa koka i varej; ashtu si kishte lëvizur, kur zhurma e kishte sjellë në vete Huanitën. Edhe Estela e kishte në gojë shiritin ngjitës. Huanita shpresonte që ajo të ishte aq shumë e këputur, sa të mbetej larg realitetit, sa më shumë kohë që të ishte e mundur.
Në dorën e vogël të djathtë të vogëlushes shihej shenja e tmerrshme, e kuqe, e djegies, së shkaktuar nga puroja. Pak kohë pas largimit të burrave, njëri prej tyre — Huanita kishte dëgjuar ta thërrisnin Lou — ishte kthyer me një tub, me një lloj pomade. Kishte lyer me të vendin e djegur, duke i hedhur

një vështrim të shpejtë Huanitës, sikur të donte t'i thoshte se kaq mund të bënte. Pastaj, edhe ai ishte larguar.
Estela kishte vazhduar të fërgëllonte gjatë kohës që po i vihej pomada; pastaj, kishte qarë dhe pak kohë, por, më në fund, e kishte zënë gjumi.
Zhurmat, që kishte dëgjuar Huanita, vinin prapa saj. Kishte të ngjarë që ato të vinin nga një dhomë ngjitur me atë ku ndodheshin tani. Ajo mendoi se dera që i bashkonte të dyja dhomat do të ishte e hapur. Për një çast e dëgjoi zërin e Majllsit, që po protestonte për diçka; pastaj, u dëgjua zhurma e një trupi që rrëzohet, një rënkim dhe, më në fund, heshtje. Ndoshta kaloi një minutë. U dëgjua përsëri zëri i Majllsit, kësaj radhe më i qartë:
— Jo! O zot, jo! Ju lutem! Jo! — Pastaj, ajo dëgjoi një zhurmë të ngjashme me goditjet e një çekani, metal mbi metal. Fjalët e Majllsit u shprehën në një ulërimë të mprehtë, çirrëse, të tmerruar. Një ulërimë, më e llahtarshmja që Huanita kishte dëgjuar ndonjëherë në jetën e saj, e cila vazhdoi për një kohë, pa pushim.

Po të kishte pasur mundësi ta vriste veten, kur ishte në makinë, Majllsi do ta kishte bërë këtë, pa ngurruar. Që kur kishte filluar bashkëpunimin me Uejnrajtin, ai e kishte ditur gjithmonë — dhe kjo kishte qenë, gjatë gjithë kohës, burimi i frikës së tij — se dhe vetë vdekja ishte një gjë e pëlqyeshme, në krahasim me atë që do t'i ndodhte një informatori të zbuluar. Por, prapëseprapë, gjërat të cilave u ishte trembur më parë s'ishin asgjë, krahasuar me torturën e pakonceptueshme që po i bënin tani.

Këmbët i kishte të lidhura fort njërën me tjetrën, gjer lart te kofshët. Dikush ia mbante krahët të shtrirë, duke ia shtrënguar me forcë në sipërfaqen e ashpër të një tavoline druri. Tani po i gozhdonin duart dhe kyçet e duarve te tavolina ... me gozhda marangozi ... Qëllonin fort me çekan ... Një gozhdë kishte hyrë tanimë në kyçin e dorës së majtë dhe

dy të tjera në shpinën e dorës, në pjesën më të gjerë të saj, ndërmjet kyçet dhe gishtave, duke ia puthitur fort mbas sipërfaqes së tryezës ... Goditjet e fundit të çekanit kishin thyer koskë ... Një gozhdë ishte ngulur në dorën e djathtë dhe një tjetër ishte gati për të përshkruar mishra e muskuj ... Asnjë dhembje nuk ishte kurrë, nuk mund të ishte kurrë... O zot, më ndihmo!... më e madhe se kjo. Majllsi përdridhej, ulërinte, lutej, ulërinte përsëri. Por, duart që e mbanin e shtrënguan edhe më shumë. Goditjet e çekanit, që ishin ndaluar për një kohë të shkurtër, filluan përsëri.

— Nuk po ulërin aq shumë sa duhet, — i tha Marinoja Anxhelos, që po ngulte gozhdën. — Pasi të mbarosh me këtë që ke në dorë, provo t'i gozhdosh këtij dobiçi një dy gishtat.

Toni Beri, që po vëzhgonte dhe dëgjonte duke pirë puro, s'e kishte marrë mundimin kësaj here të qëndronte mënjanë, pa dalë në skenë. Istini nuk do të kishte mundësi ta zinte me gojë emrin e tij, sepse, së shpejti do të vdiste. Mirëpo ishte e nevojshme që, më parë, t'i kujtohej atij dhe të tjerëve që do të mësonin se ç'kishte ndodhur — se për spiunët nuk kishte vdekje të lehtë.

Ulërimat e Majllsit e shtuan volumin duke u bërë gati shurdhuese, ndërsa një goditje tjetër iu ngul në gishtin e mesit të dorës së majtë dhe u fut gjer në fund, me çekan. U dëgjua qartë krisma e thyerjes së koskës.

— Kështu është më mirë, — tha Toni Marino.

Anxheloja po bëhej gati ta përsëriste këtë veprim me gishtin e mesit të dorës së djathtë; por Toni Beri e urdhëroi:

— Prit!

Pastaj, iu drejtua Istinit:

— Mjaft me këtë zhurmë të mallkuar! Zbrazi ato që ke në bark!

Britmat e Istinit u shndërruan në dënesa që gati i zinin frymën, ndërsa trupi i fërgëllonte. Duart që e mbanin ishin tërhequr. S'ishte më nevoja të mbahej.

— Mirë, pra, — i tha Toni Beri Anxhelos, — nuk po thotë gjë prandaj vazhdo!

— jo! Jo! Do të flas! Do të flas! Do të flas! — Majllsi mundi, në njëfarë mënyre, t'i përmbante dënesat dhe, tani, zhurma më e fortë që ai bënte shkaktohej nga frymëmarrja e tij, e rëndë dhe e çregullt.

Toni Beri ia bëri me shenjë Anxhelos të largohej pak. Të tjerët qëndronin të grumbulluar rreth tavolinës. Këta ishin: Lou, Panç, Klensi, i katërti nga ata që e kishin rrëmbyer para një ore nga dyqani i artikujve sportivë; LaRoka, me fytyrë të ngrysur, i shqetësuar nga mendimi se sa shumë do t'i kërkohej llogari si shef e bërë garant për Majllsin; tipografi i vjetër, Deni Kerrigeni, gjithashtu i shqetësuar dhe nervoz, megjithëse aty ishte në vendin e tij të punës — ata ndodheshin të laboratorin kryesor të stampimit dhe të skalitjes në metal. Mirëpo, në çaste si këto, ai do të preferonte të rrinte larg, por Toni Beri e kishte thirrur të vinte aty.

Duke i ngulur sytë Istinit, Toni ungëroi:

— Pra, që në fillim, ti ke qenë spiun i një banke të ndyrë?
— Po, — u përgjigj Majllsi, që vazhdonte të merrte frymë me zor.
— Ërst Merkëntailli?
— Po.
— Kujt i raportoje?
— Uejnrajtit.
— Çfarë munde të zbulosh? Ç'i ke thënë atij?
— Për... Palestrën Shtatë-Shtatë... kumarin ... kush vinte atje
— Edhe për mua?
— Po.
— Këlysh bushtre! — Toni Beri e qëlloi me grusht në fytyrë.

Trupi i Majllsit u shty prapa për shkak të forcës së goditjes, por u mbajt nga gozhdët që i bllokonin duart dhe ai u përpoq, në mënyrë të dëshpëruar, të kthehej përsëri në pozicionin e tij të përkulur, që kishte pasur më parë. Ra një heshtje të shkurtër, që prishej vetëm nga dënesat e dhimbshme dhe rënkimet e tij. Toni Beri thithi disa herë puron, pastaj filloi përsëri nga pyetjet.

— Ç'gjë tjetër ke zbuluar, ndyrësirë?
— Asgjë... Asgjë! — I tërë trupi i Majllsit po dridhej në mënyrë të pakontrollueshme.
— Po gënjen, — Toni Beri u kthye nga karrigia. — Më jep atë lëngun që përdor për skalitjet në pllaka metali. — Gjatë tërë kohës, gjer në atë çast, tipografi i vjetër kishte vazhduar ta vështronte Istinin me urrejtje. Ai tundi kokën, duke thënë:
— Menjëherë, zoti Marino.
Deni shkoi te një raft, nga mori një shishe të madhe katërlitërshe, me kapak plastmasi. Etiketa thoshte: ACID NITRIK — Të përdoret vetëm për punime skalitjeje në metal
— Pasi i hoqi kapakun, Deni mbushi me kujdes një enë gjysmëlitërshe. Duke pasur gjithashtu kujdes që të mos derdhte përmbajtjen e saj, ai e solli te tryeza ku ishte gozhduar Majllsi dhe e vendosi në të, bashkë me një furçë të vogël.
Toni Beri mori furçën, e zhyti në acidin nitrik dhe, pastaj, si pa të keq, zgjati dorën dhe e kaloi gjatë njërës faqe të fytyrës së Istinit. Për një sekondë a dy, ndërsa acidi po depërtonte në lëkurë, nuk pati ndonjë kundërveprim. Pastaj, Majllsi lëshoi një britmë të fortë, të shkaktuar nga dhembja e madhe, britmë që kishte një timbër të ndryshëm nga ato të mëparshmet. Ndërsa të tjerët shikonin si të mrekulluar, mishi i njomur me acid nitrik filloi të digjej, duke kaluar nga ngjyra e trëndafiltë në të murrme të errët.
Toni Beri e zhyti përsëri furçën në acid.
— Po të pyes edhe një herë të dytë, dobiç. Pe që se nuk më

përgjigjesh, do ta hash këtë nga faqja tjetër. Ç'gjë tjetër ke zbuluar dhe raportuar?
Majllsi kishte një vështrim të terrorizuar, si ato kafshët e zëna në kurth. Mezi i nxori fjalët:
— Paratë ... e falsifikuara.
— Konkretisht, çfarë?
— Bleva disa nga ato... ia dërgova bankës... Pastaj ... kur shkova në Luisvil ... e kuptova se edhe ato ishin para ... të falsifikuara.
— Pastaj, çfarë tjetër?
— Letër kreditet ... Patentat e shoferëve.
— Dhe e di ti se kush i ka bërë ato? E di se kush i ka stampuar paratë?
Majllsi bëri shenjë me kokë, me aq sa mundej, drejt Denit.
— Kush ta ka thënë këtë?
— Ai .... ma ka thënë.
— Dhe, pastaj, të gjitha këto, ti ia ke çuar të ngrohta atij policit të bankës? A i di ai të gjitha këto?
— Po.
Toni Beri, i xhindosur, u kthye nga karrigia.
— Sarhosh kokëtrashë! Edhe ti nuk je më i mirë se ky. Plaku filloi të dridhej.
— Zoti Marino, nuk isha i pirë. Vetëm se kujtoja që ...
— Qepe! — Toni Beri gati sa s'e qëlloi plakun, por pastaj ndërroi mendje. U kthye përsëri nga Majllsi.
— Çfarë tjetër di ai polici?
— Asgjë tjetër!
— Nuk e di ai se ku bëhet stampimi? Se ku ndodhet ky vend?
— Jo.
Toni Beri e futi përsëri furçën në acid. Majllsi ndiqte me sy çdo lëvizje të tij. Përvoja i thoshte se cila ishte përgjigjja që Marinoja priste prej tij. Thirri me zë të lartë:

— Po! Po, e di!
— Ia ke thënë ti?
I pushtuar nga dëshpërimi, Majllsi gënjeu:
— Po, po!
— Por, nga e mësove këtë? — Furça qëndronte në ajër, mbi enën me acid.
Majllsi e kuptoi se duhej të gjente një përgjigje. Çfarëdo përgjigje që të ishte, veçse ta kënaqte atë. Lëvizi kokën në drejtim të Denit.
— Ai ma ka thënë.
— Gënjeshtar! Gënjeshtar i ndyrë, i neveritshëm, i mallkuar!
— Fytyra e plakut ishte shtrembëruar nga zemërimi: goja i hapur i mbyllur; nofulla e poshtme i dridhej, faqet i fërgëllonin. Deni iu drejtua Toni Berit. — Zoti Marino, kjo është gënjeshtër! Ju betohem! — Por ajo që pa në sytë e Marinos ia shtoi edhe më shumë dëshpërimin. Atëherë, filloi të thërriste kundër Majllsit: — Thuaja të vërtetën, kopil i ndyrë! Thuaja! I xhindosur në kulm, duke e pasur të qartë se çfarë e priste, hodhi sytë në kërkim të ndonjë arme. Pa enën me acidin nitrik. Në çast e ngriti dhe ia hodhi acidin Majllsit në fytyrë.
U dëgjua një ulërimë tjetër, e cila u shua shpejt, ndërsa në ajër përzihej era e acidit dhe e mishit të djegur. Duke humbur ndenjat, Majllsi ra me fytyrë përpara në tryezën, ku ishin të gozhduara duart e tij të sakatuara, të gjakosura.

Megjithëse nuk e kuptonte mirë se ç'po i ndodhte Majllsit, Huanita i dëgjoi me ankth britmat dhe lutjet e tij, gjersa zëri u shua. Atëherë pyeti veten — pa ndier dhembje, sepse tanimë ishte e mpirë gjer në atë pikë, sa të mos ndiente me asnjë emocion — nëse kishte vdekur. U përpoq të përfytyronte se edhe sa kohë i mbetej asaj dhe Estelës, gjer sa edhe ato të

pësonin të njëjtin fat si Majllsi. Që ato të dyja do të vdisnin, kjo ishte një gjë e pashmangshme.

Për një gjë ishte e kënaqur: Estela s'kishte lëvizur akoma, me gjithë zhurmat e shumta. Po qe se do të vazhdonte të mbetej në gjumë, ndoshta nuk do të shihte dhe të provonte çfarëdo llahtarie që mund të ndodhte para fundit të tyre. Huanita iu lut shën Mërisë, gjë që nuk e bënte më prej vitesh, që t'ia lehtësonte vdekjen Estelës.

Pastaj vuri re se nga dhoma tjetër po vinin zhurma të një natyre tjetër. Dukej sikur po lëviznin mobilie, duke hapur dhe mbyllur me zhurmë sirtarë dhe duke përplasur përtokë arka të rënda. Në një çast, u dëgjua zhurma e një numri të madh sendesh metalike që derdheshin në çimento, e ndjekur nga sharje dhe mallkime.

Pastaj, ajo u habit, kur pranë saj u duk ai burri, i quajtur Lou, i cili filloi t'i zgjidhte litarët. Ajo mendoi se do ta çonin në ndonjë vend tjetër. Mbasi e zgjidhi atë, Lou e la aty ku ishte dhe shkoi të zgjidhte Estelën.

— Ngrihuni, — i urdhëroi pastaj të dyja. Estela, akoma e përgjumur, u bind; pastaj, filloi të qante me një zë të mbytur, për shkak të shpirtit ngjitës që i zinte gojën. Huanita deshi t'i shkonte menjëherë pranë, por këmbët nuk e mbanin, kështu që u mbështet te karrigia, ndërsa gjaku po fillonte pak nga pak t'i qarkullonte në trupin dhe gjymtyrët e mpirë.

— Dëgjo, — i tha Lou. — Pate fat, për shkak të vajzës. Kryetari ka vendosur t'ju lërë të shkoni. Tani do t'ju lidhim sytë dhe do t'ju çojmë larg me makinë dhe, pastaj, do t'ju lëmë të lira. Por, në qoftë se do të flisni, në rast se do të thuash edhe një fjalë të vetme, do të të gjejmë kudo që të jesh dhe do të vrasim vajzën.. E kuptove?

Duke mos i besuar akoma ato që sapo kishte dëgjuar, Huanita tundi kokën, në shenjë pohimi.

— Atëherë, lëviz! — Lou tregoi një derë. Dukej se s'kishte ndërmend t'ia lidhte që tani sytë. Me gjithë pleqësinë që e kishte pushtuar para disa çasteve, ajo ndjeu t'i kthehej mprehtësia e saj e zakonshme mendore.

Pasi kishte hipur disa këmbësh shkallësh prej çimentoje, ajo u detyrua të mbështetej te muri dhe të villte. Në dhomën tjetër, nëpër të cilën sapo kishin kaluar, ajo kishte parë Majllsin — ose ç'kishte mbetur nga ai — të shembur mbi një tavolinë, me duart si dy copa mishi e koskash të shtypura e të përgjakura, me fytyrën, flokët dhe lëkurën e kokës aq shumë të djegura sa të mos mund ta njihje, Lou e kishte shtyrë Huanitën dhe Estelën me të shpejtë përpara, por jo aq shpejt sa Huanita të mos shihte realitetin e tmerrshëm. Ajo kishte pasur gjithashtu mundësi të shihte se Majllsi nuk kishte vdekur akoma, ndonëse, sigurisht, ai ishte duke vdekur. Ai lëvizte pak dhe rënkonte lehtë.

— Lëvizni! — tha Lou. Ata vazhduan të ngjitnin shkallët. Figura e Majllsit në ato kushte nuk i hiqej Huanitës nga mendja. Ç'mund të bënte ajo për ta ndihmuar? Sigurisht që, aty, s'mund të bënte asgjë. Por, në qoftë se atë dhe Estelën do t'i linin të lira, nuk kishte mundësi ajo të kthehej, duke sjellë me vete ndihmë? Dyshonte që të ishte në gjendje të bënte një gjë të tillë. Ajo s'dinte fare se ku gjendej ai vend dhe s'shihte asnjë mundësi për ta zbuluar këtë. Por, prapëseprapë, duhet të bënte diçka. Diçka që të shërbente për të qetësuar — së paku pjesërisht — ndjenjën e tmerrshme të fajësisë që e mundonte. Kishte tradhtuar Majllsin. Pavarësisht nga arsyeja, ajo e kishte nxjerrë emrin e tij, kështu që e kishin zënë dhe e kishin sjellë atje, me pasojat që ajo i kishte parë.

Mendoi për diçka, por ky ishte akoma një mendim i paformuar mirë. U përqendrua për ta zhvilluar, duke larguar çdo gjë tjetër nga mendja e saj, përkohësisht edhe Estelën. Thoshte me vete: «mundet që ky plan të mos ketë sukses, por, megjithatë, ka një mundësi të vogël që të realizohet». Suksesi varej nga mprehtësia e shqisave dhe kujtesa e saj. Kishte

rëndësi, gjithashtu, që të mos ia lidhnin sytë, para se të hipte në makinë.

Pasi arritën në krye të shkallëve, u kthyen djathtas dhe hynë në një garazh. Muret përbëheshin nga blloqe çimentoje. Dukej si një garazh i zakonshëm, mjaft i madh për të mbajtur dy vetura. Duke sjellë në mend zhurmat që kishte dëgjuar kur kishin mbërritur në këtë vend, Huanita kuptoi se këtej duhet të kishin kaluar, kur kishin ardhur. Brenda ishte një veturë — jo makina e madhe, me të cilën i kishin sjellë në mëngjes, por një Ford, me ngjyrë të gjelbër të errët. Deshi të shihte targën, por nuk dukej nga vendi ku ndodhej ajo.

Pastaj i ra në sy një gjë shumë e çuditshme. Mbështetëse të njëri prej garazhit ishte një komo prej druri të errët, të lustruar, por ishte e ndryshme nga çdo komo që kishte parë ndonjëherë. Dukej të ishte prerë vertikalisht në dy pjesë, mbasi të dyja pjesët ishin ndarë nga njëra-tjetra. Veç kësaj, Huanita vuri re se brenda ishte bosh. Pranë komosë ndodhej diçka që dukej si një bufe salle ngjënjeje, e prerë në të njëjtën mënyrë të çuditshme. Dy burra po i transportonin jashtë, nga një derë tjetër, gjysmën e parë: njëri ishte me shpinë nga ajo dhe tjetrin e kishte zënë dera dhe nuk dukej.

Lou hapi njërën nga portat e prapme të Fordit.
— Futuni brenda, — urdhëroi ai. Në dorë kishte dy rripa stofi të zi.

E para hyri Huanita. Bëri sikur u pengua dhe ra përpara, duke u kapur pas shpinores së sedilies së përparme. Në këtë mënyrë, ajo pati mundësi t'i hidhte sytë për një sekondë pjesës së makinës para vendit të shoferit dhe të lexonte numrin e shënuar në kontatorin e miljeve: 25714,8. Mbylli sytë, duke ia besuar atë kujtesës së saj. Pastaj hipi në makinë edhe Estela dhe, në fund, Lou, që u lidhi sytë të dyjave dhe u ul në sedilien prapme. E shtyu me sup Huanitën, duke thënë:
— Uluni poshtë, të dyja. Po ndenjët mirë, s'do të pësoni gjë.

Huanita u ul në dyshemenë e makinës, duke pasur Estelën pranë saj, dhe i mblodhi këmbët në mënyrë që të ishte e drejtuar me fytyrë përpara. Dëgjoi të hipë në makinë edhe dikush tjetër, të ndizej motori dhe të hapej duke kërcitur porta e garazhit. Pastaj, vetura u nis.

Prej çastit që u nis vetura, Huanita e përqendroi të gjithë vëmendjen e saj, siç nuk e kishte përqendruar kurrë ndonjëherë tjetër më parë. Synonte të mbante mend drejtimin që do të ndiqnin dhe kohën që do të kalonte. Filloi të numëronte sekondat në mënyrën se si ia kishte mësuar dikur një mik i saj fotograf: *një mijë e NJË, një mijë e DY, një mijë e TRE, një mijë e KATËR*... E ndjeu makinën të ecë prapa dhe të kthehet. Pastaj, numëroi tetë sekonda, gjatë të cilave vetura me sa duket po ecte drejt përpara. Pas kësaj, makina e ngadalësoi shpejtësinë aq shumë, sa gati u ndal. Mos ishte duke dalë në rrugën publike? ... Ashtu dukej. Makina po ecte përsëri me ngadalë. ... Kthesë nga e majta. Tani, më shpejt përpara. Ajo filloi përsëri të numëronte. Dhjetë sekonda. Ngadalësim. Kthesë nga e djathta ... *Një mijë e NJË, një mijë e DY, një mijë e TRE* ... Kthesë nga e majta ... Rritje shpejtësie ... Një copë rrugë më e gjatë në vijë të drejtë ... *Një mijë e DHJETË* ... Nuk po ngadalësohet më ... Por, ja tek po ngadalësohet tani. Një ndalesë katër sekondash; pastaj, përsëri drejt përpara. Ndoshta, makina ishte ndalur te një semafor ... *Një mijë e TETË* ...

«O zot, o zot i dashur, më ndihmo të mbaj mend; bëje këtë për Majllsin!»

... *Një mijë e NËNTË, një mijë e DHJETË.* Kthesë nga e djathta ...

Duhej hequr nga mendja çdo mendim tjetër. Të regjistrohej çdo lëvizje e makinës. Të vazhdonte të numëronte, duke shpresuar, duke u lutur që kujtesa e saj aq e mirë, e cila, kur kishte qenë rasti, e kishte ndihmuar të sillte në mend të gjitha veprimet e arkës ... që e kishte shpëtuar nga dinakëria e Majlls it ... do ta shpëtonte tani këtë të fundit.

... Një mijë e NJËZET, një mijë e njëzet dollarë. Jo! ... «O shën Mëri ... Mos e lër mendjen time të endet andej-këtej»...

Një copë e gjatë rruge drejt, rrugë e asfaltuar, me shpejtësi të madhe... Ajo e ndjeu trupin e saj të përkulej anash nga forca centrifugale ... Një kthesë, me rreze të gjerë, nga e majta ... Ngadalësim, ndalesë. Kishin kaluar gjashtëdhjetë e tetë sekonda ... Kthesë nga e djathta. Të fillohet prapë: *një mijë e NJË, një mijë e DY*...

E kështu me radhë.

Sa më shumë që kalonte koha, aq më shumë pakësohej dhe mundësia që të mbante mend, që të mund të rindërtonte tërë rrugën e përshkruar.

— Flet rreshter Gledstouni, Qendra e komunikimeve të policisë, — tha në telefon një zë monoton dhe me theks hundor. — Kemi urdhër t'ju njoftojmë menjëherë sapo të gjendet Huanita Nunjezi ose fëmija Estela Nunjez.

Agjenti i posaçëm, Inisi e drejtoi në çast trupin.

— Ç'lajme ke, rreshter?

— Sapo morëm një raport me radio. Një grua dhe një fëmijë, që u përgjigjen emrave dhe përshkrimeve që na keni dërguar, janë gjetur ndërsa ecnin në afërsi të kryqëzimit të rrugës Çiviot dhe Shouni Lejk Rod. Tani po i shoqërojnë në rajonin e 12-të të policisë.

Inisi e mbuloi me dorë telefonin dhe i tha me gjysmë zëri Nolan Uejnrajtit:

— Policia. Kanë gjetur Nunjezin dhe fëmijën.

Duart e Uejnrajtit e shtrënguan me forcë buzën e tryezës.

— Pyeti se në ç'gjendje janë.

— Rreshter, — tha Inisi, — a janë të dyja në rregull?

— Ju raportova ato që dimë, shef. Po deshët hollësi të tjera, i telefononi më mirë rajonit të 12-të.

Inisi gjeti numrin e rajonit të 12-të të policisë dhe u lidh me një toger, të quajtur Fezëkerl.

— Sigurisht, jemi të informuar, — tha me një zë të sigurt Fezëkerli. — Prisni pak, sapo mbërriti një raport tjetër.

Agjenti i FBI-së priti disa çaste.

— Me sa na njoftojnë djemtë tanë, gruan e kanë rrahur pak, — vazhdoi Fezëkerli. — E ka fytyrën të enjtur dhe të prerë. Fëmija ka një plagë djegieje në njërën dorë. Asgjë tjetër. Agjentët u kanë dhënë ndihmën e parë.

Inisi ia tha këto Uejnrajtit.

Togeri s'kishte mbaruar akoma.

— Këtu ka diçka të çuditshme.

— Çfarë?

— Agjentët thonë se Nunjezi nuk do të flasë; vetëm ka kërkuar t'i japin një laps dhe letër, të cilët ia kanë dhënë. Tani po shkruan si e marrë. Ka thënë se duhet të shënonte të gjitha ato që i ishin ngulitur në kujtesë.

Inisi murmuriti:

— Jezu Krisht! — Iu kujtua çështja e shumës së parave që mungonin në arkën e bankës dhe e saktësisë së pabesueshme të kujtesës së Huanita Nunjezit, e ngjashme me një numër cirku.

— Dëgjoni, — i tha. Po vijmë menjëherë të ju dhe, aty, do t'ju shpjegoj gjithçka. Por, ju lutem, lidhuni tani me radio me ata agjentët tuaj dhe u thoni të mos i flasin Nunjezit, të mos e shqetësojnë, ta ndihmojnë në çdo gjë që mund t'i shërbejë. Kjo vlen edhe për ju të tjerët, kur Nunjezi të mbërrijë aty. E lini të qetë të shkruajë, në qoftë se do të vazhdojë. Trajtojeni

sikur të ishte fjala për një njeri të posaçëm. — Heshti për një çast, pastaj shtoi: — Dhe e tillë është.

Ecje e shkurtër para, nga garazhi.

Përpara: 8 sek. Pothuajse ndalesë (rrugë private?).

Kthesë nga e majta: 10 sek. shpejtësi mesatare.

Kthesë nga e djathta: 3 sek.

Kthesë nga e majta: 55 sek. rrugë e shtruar. Ecje me shpejtësi.

Ndalesë: 4 sek. (semafor?).

Ecje përpara: 10 sek. Shpejtësi mesatare.

Kthesë nga e djathta. Rrugë e pashtruar mirë (gjatësi e vogël!), pastaj, rrugë e shtruar mirë: 18 sek.

Ndalësim. Ndalesë dhe, menjëherë, nisje përsëri. Kthesë nga e djathta. Ndalesë dhe nisje përsëri: 25 sek.

Kthesë nga e majta dhe, pastaj, drejt përpara. Rrugë e shtruar mirë: 47 sek.

Ndalësim. Kthesë nga e djathta ...

Kur mbaroi, Huanita kishte mbushur shtatë faqe.

Kishin një orë që po bënin një punë intensive në një sallë, në anën e prapme të rajonit të policisë, duke përdorur harta topografike me shkallë të madhe, por s'kishin arritur në asnjë rezultat.

Shënimet e Huanitës i habitën të gjithë sa ishin aty: Inisin dhe Dëlrëmpillin, Xhordënin dhe Kuimbin të shërbimit të fshehtë, dhe vetë Nolan Uejnrajtin. Shënimet ishin të plota në një mënyrë të pabesueshme dhe Huanita thoshte se ishin krejt të sakta. Ajo kishte shpjeguar se, gjer para një çasti se të fillonte të shkruante, nuk besonte se do të mund t'i mbante mend të gjitha ato që kishte grumbulluar pak nga pak në

kujtesën e saj; porse tani ia kishte dalë në krye dhe se ishte krejt e sigurt që çdo gjë e shënuar ishte e saktë.

Përveç shënimeve, ata kishin edhe një element tjetër, me të cilin po merreshin; gjatësia e rrugës së përshkruar.

Para se t'i linin në një rrugë të shkretë të periferisë, keqbërësit ua kishin hequr Huanitës dhe Estelës lidhëset nga sytë dhe shiritin ngjitës nga goja. Duke shfrytëzuar edhe një herë njëfarë ngathtësie të shtrirur dhe pak fat, Huanita kishte mundur t'i hidhte përsëri një vështrim kontatorit të miljeve, i cili shënonte: 25738,5. Kishin përshkuar një largësi prej tridhjetë e shtatë kilometrash e nëntëqind metrash.

Por, a ishte kjo një largësi efektive? Apo ishin endur andej e këtej ndoshta duke u kthyer një copë rrugë edhe prapa, për të krijuar përshtypjen e një rrugë më të gjatë? Edhe me shënimet e Huanitës nuk ishte e mundur të dihej me saktësi. Ata bënë çmos, duke e përshkuar përsëri rrugën në krahun e kundërt, duke pasur parasysh se vetura mund të kishte kaluar nga kjo ose ajo anë; se ajo mund të ishte kthyer në këtë ose atë pikë, se mund të kishte ndjekur këtë ose atë rrugë, gjer në këtë ose atë vend. Megjithatë, secili prej tyre e dinte mirë se sa pak i saktë ishte një përcaktim i tillë, sepse shpejtësitë e ndryshme mund të caktoheshin vetëm me hamendje dhe ndjenjat e Huanitës, kur ajo ishte me sy të lidhur dhe me shiritin ngjitës në gojë, mund ta kishin gabuar gjer në atë pikë, sa të ishin grumbulluar gabime mbi gabime, kështu që e tërë kjo punë bëhej një humbje e kotë kohe. Por ekzistonte njëfarë mundësie për ta përcaktuar, në krahun e kundërt, rrugën e përshkuar, gjer në vendin ku e kishin mbajtur atë; ose, së paku, për të arritur në një pikë mjaft afër tij. Veç kësaj, kuptimplotë ishte fakti se hipotezat e ndryshme, që ishin bërë gjer në atë çast, jepnin rezultate pak a shumë të ngjashme.

Ai që përcaktoi se ç'duhej bërë ishte Xhordëni. Ai shënoi në një hartë topografike të zonës një numër vijash që përfaqësonin rrugët më të mundshme të përshkuara nga makina që kishte transportuar Huanitën dhe Estelën. Pastaj,

në pikat ku niseshin vijat, vizatoi një rreth. – Brenda këtij rrethi, – tha ai, duke e treguar me gisht, – në një pikë të kësaj zone.

Për një çast ra heshtje, gjatë së cilës Uejnrajti dëgjoi zhurmat e stomakut të Xhordënit, siç kishte ndodhur edhe herë të tjera, kur kishin qenë bashkë. Uejnrajti pyeti veten se si ia bënte Xhordëni, kur ishte nevoja të rrinte i fshehur dhe në heshtje. Apo stomaku i tij i zhurmshëm nuk e lejonte të merrte përsipër detyra të kësaj natyre.

– Kjo zonë, – theksoi Delrimpli, – ka një sipërfaqe prej sajë prej gjashtëdhjetë kilometrash katrore.

– Atëherë le të fillojmë një kontroll të imët, pëllëmbë për pëllëmbë, – ia priti Xhordëni, – me makina të ndara në patrulla të veçanta; të gjithë bashkë, ju, ne, duke kërkuar edhe ndihmën e policisë së qytetit.

Toger Fezëkerli, që kishte ardhur më parë, pyeti:

– Dhe çfarë duhet të kërkojmë në të gjithë, zotërinj?

– Në doni t'ju them të vërtetën, u përgjigj Xhordëni, – as unë vetë s'di të them se çfarë.

Huanita ishte në një veturë bashkë me Uejnrajtin dhe Inisin. Uejnrajti ngiste makinën, ndërsa Inisi merrej me dy radiot: një radio e vogël portative për të komunikuar me makinat e tjera, dhe një aparat tjetër të zakonshëm dhënës e marrës që lidhej me selinë e Byrosë së hetimeve.

Më parë, nën drejtimin e togerit, e kishin ndarë zonën në sektorë, që do të kontrolloheshin një për një dhe, tani, pesë vetura po e kontrollonin, duke e përshkuar në të gjitha drejtimet. Personeli ishte ndarë gjithashtu. Xhordëni dhe Delrimpli udhëtonin secili i shoqëruar nga një polic, të cilit i shpjegonin në udhë e sipër veçoritë e këtij operacioni. Në rast nevoje, patrulla të tjera të policisë do të thirreshin për të ndihmuar.

Për një gjë ishin të gjithë të sigurt: vendi ku e kishin mbajtur Huanitën ishte qendra ku prodhoheshin paratë e falsifikuara. Kjo provohej nga përshkrimi i përgjithshëm i bërë nga gruaja e re dhe nga disa hollësi që ajo kishte vënë re. Prandaj, të pesë grupet kishin marrë të njëjtat udhëzime: të kërkonin dhe të njoftonin për çdo lëvizje jo të zakonshme që mund të kishte lidhje me ndonjë organizatë kriminale të specializuar me falsifikime. Të gjithë e pranonin se udhëzimet ishin pak të errëta, por asnjëri s'kishte mundur të gjente diçka më të përcaktuar. Dhe Inisi kishte thënë:

– E ç'mund të bëjmë tjetër?

Huanita ishte ulur në sediljen e prapme të veturës. Kishin kaluar gati dy orë që kur atë dhe Estelën e kishin urdhëruar papritur të zbrisnin nga makina dhe të mos e kthenin kokën nga Fordi me ngjyrë të gjelbër të errët, që ishte nisur përsëri me shpejtësi të madhe dhe me një zhurmë të mprehtë gomas. Pastaj, Huanita nuk kishte pranuar t'i bëheshin mjekime të tjera fytyrës së saj të enjtur e të prerë dhe gërvishtjeve të këmbëve, përveç ndihmës së shpejtë që i kishin dhënë më parë. Ajo e dinte mirë se në ç'gjendje ishte me rrobat e grisura e tërë njolla, por e dinte gjithashtu se, në rast se donte ta gjente Majllsin në kohë, për ta shpëtuar, duhet të linte mënjanë çdo gjë tjetër, duke u ndarë edhe nga Estela, të cilën e kishin shpënë në një spital për t'i mjekuar djegien dhe për ta mbajtur nën vëzhgim. Ndërsa Huanita vazhdonte të plotësonte shënimet e saj, Margot Brekëni, që kishte mbërritur në rajonin e 12-të të policisë pak kohë mbas Uejnrajtit dhe agjentëve ishte përkujdesur për Estelën.

Tani kishte kaluar një pjesë e pasdites.

Pak më parë, puna për të riprodhuar dhe shënuar të gjitha hollësitë e udhëtimit, duke e zbrazur mendjen e saj, siç ndodh kur spastrohet nga gjithçka një qendër komunikacionesh e

mbingarkuar, ia kishte marrë të gjitha energjitë dhe e kishte shkëputur krejt nga gjithçka që ndodhte përreth saj. Megjithatë, menjëherë pas kësaj, ajo ishte vënë në dispozicion të të katër agjentëve që i kishin bërë pyetje të panumërta mbi hollësitë më të vogla, duke shpresuar që ndonjë hollësi e lënë pas dore do t'i afronte më shumë drejt qëllimit të tyre: drejtimit të saktë. Mirëpo, gjer në atë çast, asgjë tjetër s'kishte dalë në dritë.

Por Huanita, e ulur tani prapa Uejnrajtit dhe Inisit, nuk po mendonte tani për hollësitë, por për Majllsin, ashtu siç e kishte parë herën e fundit. Ajo figurë i ishte ngulur thellë në mendje, bashkë me një ndjenjë faji dhe ankthi. Nuk besonte që kjo figurë të mund të zhdukej, të fshihej ndonjëherë. Pyetja që e mundonte vazhdimisht ishte: A do të zbulohej qendra e falsifikimeve kur të ishte tepër vonë për të shpëtuar Majllsin? Mos ishte edhe në atë çast tepër vonë?

Zona e futur në rreth nga agjenti Xhordën, që ndodhej në largësi të vogël nga kufiri lindor i qytetit, kishte karakteristika të ndryshme. Ajo ishte pjesërisht një zonë industriale, me fabrika, magazina dhe një pjesë të gjerë, të zënë nga ndërmarrje të industrisë së lehtë. Kjo pjesë e fondit, ku kishte më shumë të ngjarë të gjendej ajo që kërkonin, ishte sektori të cilit po i kushtonin më shumë vëmendje forcat që kërkonin. Pastaj, pajisur edhe disa qendra tregtare. Pjesa që mbetej ishte zënë nga banesa të ndryshme, që shkonin nga shtëpitë e vogla prej druri e gjer te vilat me njëfarë madhësie.

Në sytë e të dhjetë agjentëve që kërkonin dhe kontrollonin këtë zonë, të cilët lidheshin shpesh me radio me njëri-tjetrin, çdo lëvizje dhe veprimtari në të dukej normale dhe nuk ngjallte ndonjë dyshim. Edhe ato pak ngjarje, që ishin deri diku jashtë normës, përfshihershin në ngjarjet e jetës së përditshme. Në njërën nga qendrat tregtare, një burrë, që po blinte një brez sigurimi, ishte penguar kur po e vinte për ta provuar dhe kishte thyer këmbën. Jo shumë larg prej atje, një

makinë, me pedalin e gazit të bllokuar, kishte përfunduar në fuajenë e një teatri, pa njerëz brenda.

Ndoshta — kishte thënë Inisi, — personi që ka qenë duke e ngarë, ka pandehur se ishte një «drivein»[1]), — por askush s'kishte qeshur. Në zonën industriale zjarrfikësit kishin ardhur me të shpejtë për të shuar një zjarr që kishte shpëthyer në një fabrikë të vogël që prodhonte dyshekë gome. Njëri nga agjentët kishte hyrë brenda, për t'u siguruar. Në njërën nga vilat ishte duke u dhënë një çaj bamirësie. Në një tjetër, një kamion me rimorkio i ndërmarrjes së transportit «Allajëns Ven Lajns» po ngarkonte mobilje shtëpiake. Në një grup shtëpish të vogla njëkatëshe, një numër hidraulikësh po mundoheshin të riparonin tubin kryesor të ujësjellësit, që rridhte. Në një trotuar, dy fqinjë kishin filluar të grindeshin dhe, pastaj, kishin kaluar në kacafytje dhe grushte. Agjenti i shërbimit të fshehtë, Xhordëni, doli nga makina dhe i ndau.

E kështu me radhë.

Në këtë mënyrë kaloi një orë. Nuk kishin bërë asnjë hap përpara, që kur kishin nisur kërkimet.

— Kam një ndjenjë të çuditshme, — tha Uejnrajti. — Një ndjenjë që kam pasur, kur punoja në polici, sa herë që më shpëtonte diçka.

Inisi i hodhi një vështrim.

— E di se ç'do të thuash. Të duket sikur ke diçka mu para hundës dhe nuk arrin ta dallosh.

Uejnrajti u kthye nga Huanita:

— A ka ndonjë gjë, ndonjë gjë të vogël, që s'na e keni thënë?

Ajo tha me ton të vendosur:

— Jua thashë të gjitha.
— Atëherë, le ta shqyrtojmë edhe një herë të gjithë çështjen

nga fillimi.
Pas pak, Uejnrajti e ndërpreu tregimin:
— Kur Istini pushoi së thirruri dhe ndërsa ju ishit akoma e lidhur, u dëgjua një zhurmë e madhe. Kështu, apo jo?
— Ajo e korrigjoi: — *No, una konmosion'!* Zhurmë e lëvizje, gjallëri. Dëgjoja njerëz që lëviznin, objekte të zhvendoseshin, sirtarë që hapeshin e mbylleshin, zhurma të kësaj natyre.
— Ndoshta kërkonin diçka, — sugjeroi Inisi, — por çfarë?
— Kur po dilnit, — vazhdoi Uejnrajti, — nuk kuptatë gjë se ç'mund të kishte qenë arsyeja e tërë kësaj veprimtarie?
— *Por ultima vez, jo no së²!* — Huanita tundi kokën. — Jua thashë se, pasi pashë Majllsin, isha shumë e tronditur që të mund të shihja gjë tjetër. — Ajo ngurroi për një çast. — Po, pashë ata burrat në garazh që transportonin ato mobiliet e çuditshme.
— Po, — tha Inisi, — na folët për këtë. Edhe unë mendoj se është diçka e çuditshme, por nuk i gjetëm ndonjë shpjegim.
— Prisni pak! Ndoshta ka një shpjegim.
Inisi dhe Huanita kthyen sytë nga Uejnrajti. Ky ishte i përqendruar, sikur të ishte duke u munduar të kapte një mendim që donte t'i shpëtonte.
— Po sikur të mos ishin duke kërkuar gjë, por duke paketuar sende të ndryshme, duke u përgatitur që të transportoheshin gjetiu?
— Mundet, — tha Inisi, — por duhet të transferonin makineri, makina stampimi, furnizime të ndryshme dhe jo mobilie.
— Me përjashtim të rastit, — tha Uejnrajti, — që mobiliet të shërbejnë si mbulesë. Mobilie të zgavërta.
Ata vështruan njëri-tjetrin dhe të tre e kuptuan zgjidhjen njëkohësisht.
— O zot! — thirri Inisi. — Ai kamioni i transportit që pamë!
Uejnrajti, duke e rrotulluar timonin gjer në fund, po e kthente makinën mbrapa.

Inisi mori radion portative.
— Të gjitha njësive. Flet Inisi. Kthehuni nga të gjitha

drejtimet drejt vilës së madhe ngjyrë hiri, në skaj të shëtitores *Erlhem*. Kërkoni një kamion me rimorkio të ndërmarrjes së transportit Allajëns. E ndalni dhe i arrestoni të gjithë ata që janë në kamion. Makinat e policisë të thërrasin të gjitha patrullat që ndodhen në këtë zonë. Kodi 10—13.
«Kodi 10—13» do të thoshte: shpejtësi maksimale; të viheshin në veprim sirenat dhe llambat rrotulluese mbi makinat.
Inisi vuri në veprim sirenën e makinës së tyre dhe Uejnrajti shtypi me forcë pedalin e gazit.
— O Krisht! — tha Inisi me një zë që dukej gati në të qarë.
— U kaluam përpara dy herë dhe, të dytën, pothuajse kishin mbaruar së ngarkuari.

— Drejtohu për në bregun perëndimor, — i tha Toni Beri shoferit të kamionit. — Tregohu i qetë dhe sillu sikur të kishe një ngarkesë të zakonshme. Flis çdo natë, por qëndro në kontakt. Ti e di se ku të thërrasësh. Në qoftë se, gjatë udhëtimit, nuk merr urdhra të tjerë, vazhdo rrugën për në Los Anxhelës.
— Në rregull, zoti Marino, — tha shoferi. Ky ishte një njeri i besuar, që e dinte se ç'duhej bërë, sikurse e dinte gjithashtu se do të merrte një shpërblim të majmë, për rrezikun që po kalonte. Për këtë punë e kishte bërë edhe më parë; çdo herë që Toni Beri kishte transferuar pajisjet e qendrës, ku kryheshin punimet e falsifikimit, duke i lëvizur sa në një drejtim në një tjetër, gjersa të kishte kaluar çdo rrezik.
— Mbaroi dhe ngarkimi, — tha mbas pak shoferi. — Atëherë, po nisem. Mirupafshim, zoti Marino.
Toni Beri e përshëndeti me një lëvizje të kokës, duke e ndier veten të lehtësuar. Deri para një çasti, kishte qenë shumë i shqetësuar, gjë që s'i ndodhte zakonisht. Prandaj, kishte qëndruar aty për të mbikëqyrur dhe nxitur të tjerët, ndonëse e dinte se s'ishte mirë të vepronte ashtu. Zakonisht, ai qëndronte gjithnjë larg vendit të veprimeve, për të qenë i

pleksur, në rast se ndodhte ndonjë gjë e papritur. I paguante të tjerët, pikërisht që të merrnin përsipër rreziqe të tilla ... dhe të përfundonin në burg, në vend të tij, po të ishte e nevojshme. Ndërkaq, fakti ishte se prodhimi I parave të falsifikuara — i nisur gati si një lojë — ishte bërë një burim aq i madh parash, në kuptimin e vërtetë të fjalës, saqë nga një veprimtari e dorës së fundit, që kishte qenë në fillim për të, kishte dalë në krye të të gjitha të tjerave. Për këtë gjë kishte meritë organizimi i mirë, si edhe masat shumë të mëdha të sigurimit — siç i pëlqente atij t'i quante — një nga të cilat ishte dhe ndërrimi i qendrës, sikurse po bëhej tani.

Në të vërtetë, kësaj here, Toni Beri nuk ishte i bindur se transferimi ishte i nevojshëm — së paku jo në atë çast — sepse ishte i sigurt që Istini kishte gënjyer, kur kishte thënë se e kishte mësuar nga Deni Kerrigëni vendin se ku ndodhej qendra dhe se ia kishte kaluar këtë informatë bankës. Në këtë çështje, Toni i besonte Kerrigëni, ndonëse sarhoshi plak kishte llapur tepër dhe e meritonte që, së shpejti, t'i bënin ndonjë surprizë jo fort të këndshme, e ci- la ta shëronte një herë e mirë nga vesi i të folurit shumë. Në qoftë se Istini do ta kishte ditur me të vërtetë dhe do t'ia kishte kaluar atë informatë bankës, siç kishte thënë, agjentët e policisë dhe spiunët e bankës do të ishin lëshuar aty me kohë. Toni Beri nuk çuditej për këtë gënjeshtër. Ai e dinte se, në torturë e sipër, njerëzit përshkojnë njërën pas tjetrës dyert e dëshpërimit duke kaluar nga gënjeshtrat në të vërtetën dhe, përsëri, të gënjeshtrat; duke u për- pjekur të gjejnë atë që duan të mësojnë torturuesit e tyre. Toni Beri zbavitej shumë në këtë lloj loje, duke kërkuar që gënjeshtari të binte në kurthin e gënjeshtrave të veta.

Ndërkohë, veprimi më dinak — më dinaku i të gjithëve — ishte transferimi i qendrës. Në rast dyshimi, të zhdukeshe nga ai vend. Dhe, tani, kamioni ishte nisur dhe kishte ardhur çasti për të hequr qafe atë që mbetej nga spiuni Istin Plehu. Për ato

do të kujdesej Anxheloja. Ndërkaq, vendosi Toni Beri, ishte koha që t'ia mbathte prej andej. U zgërdhi, duke e ndier veten shumë të kënaqur. Me të vërtetë një veprim shumë dinak!

Qe pikërisht në këtë çast që ai dëgjoi zërin e dobët, por që vinte duke u rritur gjithnjë e më shumë, të sirenave. Pas pak çastesh, e kuptoi se s'ishte treguar aspak dinak.

— Do të bëjë më mirë të shpejtojë, Herri, — i tha infermieri shoferit. — Ky, këtu s'ka kohë për të humbur.

Autoambulanca po kalonte me sirenat e hapura përmes trafikut të dendur.

— Në atë gjendje që është ai, — ia priti shoferi, duke i mbajtur sytë përpara, te rruga, — mendoj se do t'i bënim një favor po të ndaleshim për të pirë një o dy gota birrë.

— Lëri këto, Herri. — Infermieri i ri i hodhi fshehurazi një vështrim Huanitës, që ishte ulur në një karrige portative dhe po përpiqej të shihte Majllsin, që e zinte trupi i infermierit. E kishte fytyrën të tendosur dhe lëvizte vazhdimisht buzët.

— Ju kërkoj ndjesë, zonjushe. Harruam fare që ishit këtu. Me kohë, kjo punë të bën, deri diku, indiferent.

Huanitës iu desh një çast për të kuptuar ç'po i thoshin. Ajo pyeti, duke bërë me shenjë nga Majllsi:

— Si është?

— Në gjendje të keqe. S'ka kuptim t'ju gënjej. — Infermieri i ri i kishte bërë Majllsit një injeksion morfine dhe i kishte lidhur në krah një sfigmomanometër dhe, tani, ai po i hidhte ujë në fytyrë. Majllsi ishte në një gjendje gjysmë të ndërgjegjshme dhe, me gjithë morfinën, rënkonte nga dhembjet. Tërë kohën, infermieri vazhdonte të fliste:

— Është në gjendje shoku. Edhe kjo vetë do të mjaftonte për ta vrarë, përveç djegieve. Uji shërben për të larë dhe hequr

acidin, ndonëse tani është vonë. Përsa u përket syve, nuk do të doja... Por, më thoni ç'po ndodh?

Huanita tundi kokën, duke mos dashur të humbiste kohë dhe energji duke folur. Zgjati dorën për të prekur Majllsin, që ishte i shtrirë nën një kuvertë. Sytë iu mbushën me lot. U lut, bile dhe pa e ditur nëse ai mund ta dëgjonte:

— Më fal! Oh, më fal!

— Eshtë burri juaj? — pyeti infermieri, që filloi të vërë shina në duart e Majllsit, duke i lidhur me fasha pambuku.

— Jo.

— Mik?

— Po. — Lotët filluan t'i rridhnin edhe më shpejt nëpër faqe. Ishte ajo mikja e tij? A kishte qenë me të vërtetë e nevojshme ta tradhtonte? Dëshironte me gjithë zemër që ai ta falte, ashtu si, dikur, i kishte kërkuar edhe ai asaj ta falte. I dukej sikur do të kishte ndodhur shumë kohë më parë ndërsa në të vërtetë s'ishte ashtu.

— Mbajeni pak, ju lutem, — i tha infermieri. Ai vuri një maskë mbi fytyrën e Majllsit dhe i dha Huanitës një bombol portative me oksigjen. Huanita dëgjoi një vërshellimë nga oksigjeni që dilte dhe e shtërngoi bombolën sikur të mundej në këtë mënyrë të komunikonte me Majllsin, siç kishte dashur që kur e kishin gjetur pa ndjenja, të gjakosur, të djegur, akoma të gozhduar te tryeza.

Huanita dhe Nolan Uejnrajti i kishin ndjekur agjentët federalë dhe ata të policisë lokale brenda në vilën e madhe ngjyrë hiri; por, më parë, Uejnrajti e kishte mbajtur gruan e re, deri sa kishte qenë i sigurt se nuk kishte rrezik të fillonin të shtëna me armë. Mirëpo, ata që gjendeshin në vilë të zënë në befasi, nuk kishin qëlluar dhe as kishin bërë ndonjë rezistencë,

pasi e kishin parë se forcat që i kishin rrethuar ishin në numër më të madh se vetë ata.

Uejnrajti, kishte çliruar duart e Majllsit nga gozhdët, Dalrimplli me fytyrën të bardhë si gëlqere, duke mallkuar me gjysmë zëri, e mbante Istinin, ndërsa gozhdët dilnin njëra pas tjetrës. Huanita kishte pasur një përshtypje të vagëllt edhe për praninë e disa njerëzve të tjerë, në radhë njëri pas tjetrit dhe me pranga në duar, por s'u kishte kushtuar vëmendje. Kur kishte ardhur ambulanca, ajo s'ishte shkëputur nga barela që, kishin sjellë për Majllsin, e kishte ndjekur atë edhe brenda në ambulancë. Askush nuk ishte orvatur ta ndalonte.

Tani kishte filluar të lutej.

Diçka që kishte thënë infermieri, por që ajo s'e kishte kapur menjëherë, e ktheu përsëri në realitetin e gjendjes. Sytë e Majllsit. Qepallat ishin djegur, sikurse pjesa tjetër e fytyrës. Me zë të dridhur pyeti:
— Do të mbetet i verbër?
— Këtë do të mund ta thonë vetëm specialistët. Pothuajse mbërritëm në qendrën e rianimacionit, ku do t'i bëhen kurat më të mira. Unë këtu, s'mund t'i bëj gjë tjetër.

Huanita mendoi se edhe ajo nuk mund të bënte gjë tjetër, veçse të rrinte pranë tij, me dashuri e devocion, gjatë gjithë kohës që ai do të kishte dëshirë dhe nevojë.

Nga dritarja e vogël e ambulancës panë disa ndërtesa me kolona.
— Arritëm, — tha infermieri. Ai masta përmes gishtave pulsin e Majllsit. — Është akoma i gjallë...

Gjatë pesëmbëdhjetë ditëve që kur SEC-i kishte filluar hetimet zyrtare në labirintet financiare të Suprenjshnëlit, Rosko Hejuordi ishte lutur që një mrekulli të mënjanonte katastrofën e plotë. Edhe Hejuordi merrte pjesë në mbledhjet që bëheshin me kreditorë të tjerë të SuNatKo-s, qëllimi i të cilave ishte që ta mbanin — po të kishte mundësi — të gjallë dhe në veprim viganin shumëkombëshe. Mirëpo, ishte

konstatuar se kjo gjë ishte e pamundur. Sa më shumë thelloheshin hetimet aq më tepër dilte në dritë shpërdorimi i saj financiar. Veç kësaj, dukej se kishte të ngjarë që, në fund të hetimeve, disa funksionarë të Suprenjshnëlit të akuzoheshin për veprime mashtruese, duke përfshirë edhe Xh. Xh. Kuortermiejnin, po të supozoje se Xhorxhit të madh do t'i mbushej mendja të kthehej nga skuta e tij në Kosta Rika, gjë që, në atë çast, dukej një perspektivë që s'kishte të ngjarë të vërtetohej.

Prandaj, në ditët e para të nëntorit, u paraqit një peticion falimentimi për Suprënejshnël Korporejshënin, në bazë të nenit 77 të ligjit mbi falimentimet. Megjithëse të gjithë e kishin parashikuar dhe i ishin trembur këtij çasti; kjo gjë pati jehonë të menjëhershme; në shkallë botërore. Mendohej se, bashkë me SuNatKo-n, do të merrnin fund edhe mjaft kreditorë të mëdhenj, si edhe ndërmarrje të lidhura me të dhe shumë kreditorë privatë. Nëse Fërst Merkëntaill Emerikën Benku, do të ishte gjithashtu njëra prej tyre, ose do të mund t'i qëndronte humbjes shumë të madhe që kishte pësuar, mbetej akoma e dyshimtë e për t'u parë.

Nga ana tjetër, s'kishte fare dyshim përsa i përkiste karrierës së Hejuordit. Si autori i katastrofës më të madhe që i kishte ndodhur FMA-së gjatë të njëqind vjetëve të jetës së saj, karriera e tij kishte marrë fund një herë e përgjithmonë. Mbetej akoma për t'u parë nëse Hejuordi sipas ligjeve në fuqi, në bazë të urdhëresave të Rezervës Federale, të Komisionit të kontrollit të monedhave në qarkullim dhe të SEC-it, ishte personalisht përgjegjës para ligjit. Kishte nga ata që mendonin se ashtu ishte. Një ditë më parë, një funksionar i SEC-it, të cilin Hejuordi e njihte mirë, i kishte thënë:
— Rosko si mik që të kam, të sugjeroj të marrësh një avokat.

Në zyrën e tij, pak kohë mbas hapjes së bankës, Hejuordi, me duart që i dridheshin, po lexonte një artikull të «Uoll Strit Zhurnëll», lidhur me peticionin për falimentimin e Suprënejshnëlit. E ndërpreu sekretarja e tij, zonja Kellëgen."

Zoti Hejuord ... ka ardhur zoti Ostin.

Harold Ostini u fut brenda me nxitim, pa pritur që ta ftonin për të hyrë. Ndryshe nga paraqitja e tij e zakonshme, atë ditë ai nuk e kishte më pamjen e një «plejboj» në moshë të pjekur, por dukej vetëm si një plak i pispillosur me tepër kujdes. Fytyra kishte një shprehje serioze, e tërhequr dhe e zbehtë, ndërsa rrathët poshtë syve tregonin moshën dhe një pagjumësi të theksuar.

Ostini nuk humbi kohë për hyrje.
— Ke dëgjuar gjë për Kuortermejnin?
Hejuordi tregoi gazetën.
— Di vetëm ç'thuhet aty. — Gjatë dy javëve të fundit, ai ishte përpjekur disa herë t'i telefononte Xhorxhit më madh në Kosta Rika, por pa sukses. Presidenti i SuNatKo-s rrinte i izoluar. Sipas lajmeve që ishin përhapur, Xhorxhi i madh jetonte në mes të një shkëlqimi feudal, i rrethuar me një ushtri të vogël rojash personale, dhe se nuk kishte ndërmend të kthehej në Shtetet e Bashkuara. Thuhej se ishte i sigurt që Kosta Rika nuk do të pranonte kërkesë për ta dorëzuar, ashtu siç kishte vepruar edhe më parë, në raste kur batajçinjtë të tjerë ishin strehuar atje.
— Mora fund, — tha i nderuari Harold. Zëri gati sa po i pritej. — Në SuNatKo investova tërë pasurinë e familjes dhe, vetë unë, hyra në borxhe për të blerë aksione të Investmentisit Q.
— Si u bë puna e Q-Investmentsit?
Që më parë, Hejuordi ishte përpjekur të zbulonte se cila ishte gjendja e grupit privat të Kuortermejnit, debitor me dy milionë dollarë ndaj FMA-së, përveç të pesëdhjetë milionëve që i detyronte Suprënejshnëli.
— Me të vërtetë, nuk e di?
Hejuordi u zemërua.
— A do të pyesja, po ta dija?
— Ma tha mbrëmë Inçbeku. Ai dobiçi Kuortermejn i ka shitur të gjitha aksionet, prona të Q-Investmentsit (shumica e të cilave ishin tituj të degëve të SuNatKo-s), kur çmimet e tyre

ishin më të lartat. Duhet të ketë mbledhur para me thasë. «Duke përfshirë edhe dy milionët e FMA-së,» — mendoi Hejuordi.
— Po paratë, ku vajtën? — pyeti ai.
— Dobiçi i kishte investuar të gjitha në disa shoqëri që shërbenin si perde maskimi dhe, pastaj, i kishte marrë përsëri. Në këtë mënyrë, Q-Investmentsit i mbeten vetëm aksionet e shoqërive maskuese, domethënë letra pa vlerë. — Ostini shpërtheu në vaj, me gjithë neverinë që i shkaktoi kjo Hejuordit. — Paratë e mia... Paratë e mia... Mund të isha në Kosta Rika, në Ishujt Bahama, në Zvicër... Rosko, Duhet të më ndihmosh që t'i marr prapë... Përndryshe do të mbarojë gjithçka ... do të marr fund.
Hejuordi u përgjigji, me ton të ftohtë:
— S'kam se si të të ndihmoj Harold. — Kishte mjaft halle me pjesën e tij të Q-Investmentsit dhe s'mund të merrej edhe me atë të Ostinit.
— Por, në rast se dëgjon ndonjë gjë të re... po qe se ka ndonjë shpresë...
— Në qoftë se do të ketë, do të të njoftoj.
Hejuordi u çlirua nga Ostini sa më shpejt që pati mundësi. Sapo kishte dalë nga zyra ky i fundit, në telefonin e brendshëm u dëgjua zëri i zonjës Kellëgen që tha:
— Në telefon është një kronist i gazetës «Njusdej», i quajtur Endikot. Është për Suprënejshnëlin dhe thotë se është e rëndësishme të flasë personalisht me ju.
— I thoni se s'kam asgjë për të thënë dhe t'i telefonojë Zyrës së marrëdhënieve publike. — Hejuordit iu kujtuan fjalët që Dik Frenci u kishte thënë funksionarëve të tjerë: «Shtypi do të kërkojë të vihet në kontakt me secilin prej jush... M'i kaloni mua thirrjet telefonike». Kjo, së paku, ishte një peshë që s'ishte nevoja ta mbante ai.
Pas disa çastesh, e dëgjoi përsëri zërin e Dora Kellëgenit: — Më vjen keq, zoti Hejuord.
— Ç'ka?
— Zoti Endikot vazhdon të jetë në linjë. Ai më kërkoi t'ju pyes nëse preferoni që ai të flasë për zonjushën Avril Dëveron

me Zyrën e marrëdhënieve publike apo me ju. Hejuordi ngriti receptorin e një telefoni.
— Ç'do të thotë kjo?
— Mirëmëngjes, zotëri, — tha një zë i qetë. — Më falni që po ju shqetësoj. Jam Brus Endikot, i gazetës «Njusdej».
— I keni thënë sekretares sime se ...
— I thashë vetëm se ka gjëra që ju, zoti Hejuord, do të pëlqenit më mirë t'i bisedoja personalisht me ju, se sa t'i shtroja para Dik Frencit.

A kishte pasur një theksim disi më të fortë mbi fjalën «shtroja»? Hejuordi s'ishte i sigurt. Ai tha:
— Jam shumë i zënë me punë. Mund t'ju jap vetëm disa minuta, jo më shumë.
— Faleminderit, zoti Hejuord. Do t'ju marr shumë pak kohë. Gazeta jonë ka bërë hetime rreth *Suprënejshnël Korporëjshnit*. Siç e dini, kjo çështje ka ngjallur tani interesim të madh. Nesër do të botojmë një shërbim të plotë mbi këtë subjekt. Midis të tjerave, jemi në dijeni edhe të huasë së madhe që i ka dhënë FMA-ja SuNatKo-s. Për këtë, fola me Dik Frençin.
— Atëherë, i keni të gjitha informatat që ju duhen.
— Jo tamam të gjitha, sër. Nga burime të tjera, kemi mësuar se bisedimet për huanë që iu dha *Suprënejshnëlit* u bënë nga ju. Dëshirojmë të dimë se kur u shtrua për herë të parë kjo çështje; dua të them, kur kërkoi SuNatKo-ja para për herë të parë. Mos ju kujtohet rastësisht?
— Kam frikë se jo. Merrem me një numër të madh huash, me shuma të rëndësishme.
— Sigurisht që nuk do të jenë të gjitha me nga pesëdhjetë milionë dollarë.
— Mendoj se i jam përgjigjur pyetjes suaj.
— Ndoshta do të mund t'ju ndihmoj, zoti Hejuord. Mos ka qenë në mars, me rastin e një udhëtimi në ishujt Bahama? Një udhëtim që keni bërë, së bashku me zotin Kuortermethn, nënpresidentin Stounbrixh, dhe të tjerë?
Hejuordi ngurroi:
— Po, ndoshta.

— Nuk mund ta thoni me siguri? — Kronisti fliste me ton të respektueshëm, por ishte e qartë se nuk do të kënaqej me përgjigje dredhuese.
— Po, tani, më kujtohet. Me atë rast ka qenë.
— Ju faleminderit, zoti Hejuord. Në rast se nuk gabohem, atë udhëtimin e keni bërë me avionin privat të zotit Kuortermethn, një 707, apo jo?
— Po.
— Me disa zonjushe, si shoqëruese.
— Them se nuk mund të flitet për shoqëruese. Me sa më kujtohet mua, në avion kishte disa stjuardesa.
— Mos ishte edhe zonjusha Avril Dëvero njëra prej tyre? A nuk e njohët gjatë udhëtimit dhe, pastaj, e takuat përsëri gjatë ditëve të qëndrimit në Bahama?
— Mundet. Emri që thatë më duket emër i dëgjuar.

— Zoti Hejuord, më falni për pyetjen, por a jua kanë ofruar zonjushën Dëveron... nga ana seksuale... në këmbim të një garancie nga ju. për t'i dhënë *Suprënejshnëlit* huanë?
— Sigurisht që jo! — Hejuordi po fillonte të djersitej dë hora, që mbante receptorin, i dridhej. Pyeste veten se sa shumë gjëra mund të dinte ky inkuizitor me zë të qetë e të sjellshëm. Natyrisht, ai mund ta ndërpriste bisedën menjëherë dhe, ndoshta, duhej ta kishte bërë këtë, megjithëse në këtë mënyrë do të kishte vazhduar të mbetej në dyshim.
— Por a u lidhët ju me zonjushën Dëveron me marrëdhënie miqësore pas atij udhëtimit në Bahama?
— Mendoj se ashtu është. Zonjushja Dëvero është një person simpatik e tërheqës.
— Pra, ju kujtohet.
Hejuordi kishte rënë në kurth.
— Po, — pranoi ai.
— Faleminderit, sër. Meqë ra fjala, a e keni takuar më vonë zonjushën Dëveron?
Pyetja ishte bërë ashtu, si rastësisht. Por, «ky Endikoti duhet

t'i dijë të gjitha», — mendoi Hejuordi. Duke u munduar që të mos lejonte t'i dridhej zëri, ai tha:
— Iu përgjigja të gjitha pyetjeve që doja t'u përgjigjesha. — Ju thashë dhe më parë se kam shumë punë.
— Si të dëshironi zoti Hejuord. Por besoj se duhet t'ju vë në dijeni se kemi biseduar me zonjushën Dëveron dhe se ajo na ka ndihmuar shumë.
Ka ndihmuar shumë? Po, Avrili mund ta bënte këtë, mendoi Hejuordi. Sidomos, në qoftë se gazeta e paguante, siç kishte bindjen se do të kishte ndodhur. Por nuk ndjeu mëri kundër saj. Avrili ishte ajo që ishte dhe asgjë s'do ta mundej kurrë ta ndryshonte ëmbëlsinë që ajo kishte dhënë.
Kronisti vazhdoi:
— Zonjusha na dha hollësi mbi takimet e saj me ju dhe, veç kësaj, kemi edhe dëftesat e shumave që i janë paguar hotelit «Kolumbia Hilton» dhe të shumave që *Suprënejshnëli* ka paguar për ju. A dëshironi ta rishikoni, sër, pohimin tuaj se, nga të gjitha këto asgjë nuk ka pasur të bëjë me huanë që *Fërst Merkëntaill Emerikën Benku* dha *Suprënejshnëlit*?
Hejuordi qëndroi i heshtur. Ç'mund të thoshte ai? Në djall të venë të gjitha gazetat dhe gazetarët, zakoni i tyre I neveritshëm për të futur hundët në jetën intime të të tjerëve, rrënimi i tyre i përhershëm! Pa dyshim do të kishin bindur ndonjërin në SuNatKo-së të fliste, të tregonte, të jepte dokumente ose fotokopje të tyre. Iu kujtua se Avrili i kishte folur për një listë të veçantë personash që mund të mbaheshin me shpenzimet e Supremejshnëlit. Për një kohë të shkurtër, në atë listë kishte qenë edhe emri i tij dhe, ndoshta, kronisti e dinte këtë. Natyrisht, ana ironike e kësaj çështjeje ishte fakti se Avrili nuk kishte ndikuar me asgjë në vendimin e tij lidhur me huanë që i ishte dhënë SuNatKo-së. Këtë vendim, ai e kishte

marrë shumë kohë më parë se të ngatërrohej me të. Por, kush do ta besonte?

— Ka edhe një gjë të fundit, zoti Hejuord. — Dukej se Endikoti kishte arritur në përfundimin se nuk do të merrte përgjigje për pyetjen e mëparshme. — A mund t'ju pyes diçka për një shoqëri private me emrin Q-Investments? Për kursim kohe, po ju them se kemi mundur të shtojmë në dorë një kopje të disa regjistrimeve, sipas të cilave del se ju keni në zotërim dy mijë aksione të kësaj shoqërie. A është kështu?

— S'kam gjë për të thënë.

— Zoti Hejuord, a jua kanë dhënë ato aksione si shpërblim, meqenëse e rregulluat çështjen e huasë që iu dha Supremejshnëlit, si dhe të huave të tjera për Q-Investment-sin me një shumë totale prej dy milionë dollarësh?

Pa u përgjigjur, Rosko Hejuordi uli poshtë me ngadalë receptorin e telefonit.

«Gazeta e nesërme», kishte thënë kronisti. Ata do ta botonin të gjithë ngjarjen, sepse ishte e qartë që kishin prova; dhe atë që e zbulonte një gazetë, e merrnin dhe e përhapnin mjetet e tjera të informacionit. Ai s'kishte iluzione dhe asnjë dyshim për atë që do të ndodhte. Mjaftonte vetëm një artikull i vetëm gazete dhe ai do të mbetej krejtësisht i njollosur: në bankë, përpara miqve, në familje, në kishën e tij kudo. Prestigji, ndikimi, krenaria e tij... do të zhdukeshin. Për herë të parë kuptoi se prej çfarë brumi i dobët ishte njeriu. Akoma edhe më e keqe ishte siguria e procedimit kriminal për pranim ryshfetesh, mundësia që t'i bëheshin edhe akuza të tjera, mundësia që të përfundonte në burg.

Nganjëherë e kishte pyetur veten se ç'do të kishin ndier pasuesit e Niksonit, dikur plot kryelartësi, kur i kishin hequr nga postet e tyre, i kishin zhveshur nga funksionet e tyre të larta, për t'i paditur për krime, duke u gjykuar nga anëtarë të

një jurie, të cilët, deri pak kohë më parë ata do t'i kishin trajtuar me përbuzje. Tani e dinte. Ose, së shpejti, do ta dinte.

I erdhi në mend një citat nga Gjeneza: «Ndëshkimi im është më i madh nga sa unë mund të duroj.»

Një telefon, në tryezën e tij të punës, filloi të bjerë, por ai s'ia vuri veshin. Aty, s'kishte më asgjë për të bërë. Kurrë më.

Gati pa e kuptuar as vetë, doli nga zyra e tij dhe nga zyra tjetër ngjitur. Dora Kellëgeni e vështroi me habi dhe i bëri një pyetje, të cilën ai nuk e kapi dhe as do t'i ishte përgjigjur edhe sikur ta kishte kapur. Përshkoi korridorin e katit të 36-të, duke kaluar sallën e këshillit, e cila deri pak kohë më parë kishte qenë arena e ambicieve të tij. Disa persona i drejtuan fjalën, por ai as që e vuri re. Pak më tutje, në sallën e këshillit, ishte një derë e vogël, që përdorej rrallë. E hapi. U gjend para një palë shkallëve që të çonin lart. Filloi t'i ngjiste ato, duke shkuar gjithnjë e më lart, kthesë pas kthese, me të njëjtën shpejtësi, pa u nxituar, por edhe pa u ndalur. Dikur pak kohë pasi kishte qenë mbaruar së ndërtuari gratacieli i FMA-së, Ben Roseli kishte sjellë aty bashkëpunëtorët e tij më të ngushtë, ndërmjet të cilëve edhe Hejuordin. Kishin kaluar edhe nëpër këtë derë tjetër të vogël, që Hejuordi e shihte tani para tij. E hapi dhe doli në një ballkon të ngushtë, pothuajse në majë të ndërtesës, prej nga qytetin e kishte si në pëllëmbë të dorës.

Me të dalë në ballkon, e goditi me forcë era e ftohtë e nëntorit. Ai u përkul drejt saj, duke ndier njëfarë sigurie, si të një përqafimi. Iu kujtua ajo hera tjetër. Ben Roseli kishte shtrirë krahun drejt qytetit dhe kishte thënë: «Zotërinj, këtë, dikur, ishte toka e premtuar e gjyshit tim. Kjo që shihni sot është e jona. Mbajeni mend ashtu siç e ka mbajtur mend gjithmonë ai se, për të fituar, në kuptimin e vërtetë të fjalës, duhet të japim dhe jo vetëm të marrim». Kjo dukej sikur kishte ndodhur shumë kohë më parë, përsa i përkiste epokës, ashtu edhe fjalëve të urta.

Hejuordi hodhi sytë poshtë. Pa ndërtesa më të vogla dhe lumin, gjithkund të pranishëm, me zigzaget e tij; trafikun, njerëzit që lëviznin, si miza të vogla, atje poshtë, në sheshin «Roseli». Zhurmat i vinin lart, të dobësuara dhe të përziera; ato i sillte era.

E kaloi me njërën këmbë parmakun që i vinte gjer në mes dhe që e ndante ballkonin nga një pjesë e dalë, e ngushtë dhe e pambrojtur. Kaloi dhe këmbën tjetër. Deri në atë çast nuk kishte ndier frikë, por tani i tërë trupi i dridhej dhe duart e shtrënguan fort parmakun në shpinën e tij.

Dëgjoi mbrapa zëra të eksituar, një zhurmë këmbësh që ngjisnin shkallët me shpejtësi. Dikush thirri:

— Rosko!

Mendimi i tij i parafundit qe një varg nga libri i parë i Samuelit: «Shko, dhe zoti qoftë me ty! Mendimi i fundit ishte për Avrilin». O më e bukura e grave ... Ngjitu lart, e dashura ime, dhe eja...»

Pastaj, pikërisht në çastin kur disa persona po dilnin me vrap në ballkon nga dera e vogël, Hejuordi mbylli sytë dhe bëri një hap përpara në zbrazësirë.

«Në jetën e çdo njeriu, — mendonte Aleks Vandervurti, — ka një numër të vogël ditësh që i mbeten të ngulitura thellë dhe në mënyrë të dhimbshme në kujtesë, për sa kohë që merr frymë e jeton». Për vetë atë, njëra prej tyre ishte dita fatale, kur — pak më shumë se një vit më parë — Ben Roseli i kishte njoftuar për vdekjen e tij shumë të afërt. Një tjetër do të ishte kjo ditë e fundit.

Akoma i tronditur dhe i vrarë nga ajo që kishte ndodhur, Aleksi ishte në shtëpi dhe priste Margotin, që duhej të vinte mbas pak. Përgatiti për vete edhe një skoç tjetër me selc dhe vuri edhe një dru në zjarrin që po shuhej.

Atë mëngjes, ai kishte qenë i pari që ishte vërsulur në ballkonin, në majë të rrokaqellit. I kishte ngjitur me vrap shkallët, pasi kishte dëgjuar se disa ishin në merak për gjendjen mendore të Hejuordit dhe, nga pyetjet që u kishte bërë më të shpejtë disa të tjerëve, e kishte marrë me mend se për ku do të ishte drejtuar ai. Duke dalë me vrull në ballkon, kishte thirrur me të madhe, por tanimë kishte qenë tepër vonë.

Pamja e Roskoit, që, për një çast, ishte dukur sikur qëndronte pezull në ajër dhe, pastaj, ishte zhdukur me një britmë ngjethëse, që u shua shpejt, e kishte lënë të tmerruar, të dridhur dhe të paaftë të thoshte edhe një fjalë të vetme. Tom Stroani, që ishte pas tij, kishte marrë iniciativën, duke i urdhëruar të gjithë të largoheshin nga ballkoni, urdhër që e kishte zbatuar edhe vetë Aleksi.

Pak më vonë, gjë që tanimë s'kishte më dobi, derën e ballkonit e kishin mbyllur me kyç.

Pasi ishte kthyer poshtë, në katin e trembëdhjetë e gjashtë, Aleksi e ishte mbledhur veten dhe kishte shkuar të njoftonte, për sa kishte ndodhur, Katheron Petërtonin. Pas kësaj, pjesa tjetër e ditës kishte qenë në një përzierje ngjarjesh, vendimesh, hollësish, që kishin ndjekur njëra-tjetrën dhe ishin shkrirë së bashku, deri sa e tëra ishte bërë një epitaf i Hejuordit, akoma i papërfunduar dhe që duhej vazhduar të nesërmen. Por, atë ditë ishin marrë masa për t'u takuar me gruan dhe djalin e Roskoit dhe për të paraqitur ngushëllimet e rastit; u ishin përgjigjur pyetjeve të policisë, së paku pjesërisht; ishin dhënë udhëzimet për ceremoninë e përmortshme. Meqenëse trupi ishte dëmtuar au shumë sa nuk mund të njihej, arkioli do të vulosej sapo të jepte pëlqimin nëpunësi përkatës. Ishte bërë një deklaratë për shtypin, e hartuar nga Dik Frençi dhe e miratuar nga Aleksi. Disa probleme ishin zgjidhur dhe disa të tjera ishin lënë për më vonë.

Përgjigjet e disa pyetjeve të tjera ishin bërë më të qarta Aleksit, pasdite vonë, pak kohë mbasi Dik Frençi e kishte

kështilluar të pranonte të bisedonte në telefon me një kronist të gazetës «Njusdej», njëfarë Endikot, që kërkonte të fliste me të. Me një zë të tronditur, Endikoti i kishte thënë Aleksit se, para disa minutave kishte mësuar nga të teleks i agjencisë Asoshietid Pres lajmin e vetëvrasjes së Rosko Hejuordit. I kishte treguar pastaj për bisedën e tij të mëngjesit me Hejuordin dhe ç'kishte dalë nga ajo.

— Po ta kisha ditur... — kishte përfunduar, duke bëlbëzuar.

Aleksi s'kishte bërë as përpjekjen më të vogël për ta ndihmuar kronistin ta ndjente veten më mirë. Parimet etike të profesionit të tij ishin një problem që Endikoti duhet ta zgjidhte vetë. Por, e kishte pyetur:

— A do ta botojë gazeta juaj prapëseprapë artikullin?
— Po, zoti Vandervurt. Redaksia po përgatit një titull të ri. Me këtë ndryshim, artikulli do të botohet nesër, siç ishte parashikuar.

Atëherë, pse telefonuat?
— Desha vetëm t'i thosha dikujt se më vinte keq për atë që ndodhi.

— E kuptoj, — kishte thënë Aleksi. — Edhe mua më vjen keq.
Atë mbrëmje, Aleksi mendoi përsëri për këtë bisedë. S'kishte dyshim se artikulli i gazetës «Njusdej», kur të botohej të nesërmen, do t'i shkaktonte dëm të madh bankës. Dhe këto dëme po grumbulloheshin njëri mbi tjetrin. Megjithëse Aleksi kishte mundur ta ndalonte dyndjen për në sportelet e degës së bankës së Tilersvilit dhe s'kishin ndodhur më veprime të tilla, as atje dhe as në degë të tjera të bankës, ndaj Fërst Merkëntajll Emerikën Benkut, ishte vërtetuar një rënie e besimit të publikut dhe një pakësim i depozitimeve. Gjatë dhjetë ditëve të fundit, pothuajse dyzet milionë dollarë kishin dalë nga banka, si tërheqje, ndërsa kordhet kishin qenë shumë më poshtë nivelit të tyre të zakonshëm. Njëkohësisht, në Bursën e

Nju Jorkut, aksionet e FMA-së kishin rënë mjaft.
Ishte e qartë se në këtë gjendje nuk ndodhej vetëm FMA-ja. Me t'u përhapur lajmet e para mbi gjendjen e vështirë të Suprënejshnëlit, një atmosferë depresioni kishte rënë mbi investuesit dhe mbi botën e tregtisë, përfshirë edhe bankierët, duke i dhënë shkas një rënieje të përgjithshme të kuotave të aksioneve. Në fushën ndërkombëtare, ishin krijuar dyshime të reja rreth vlerës së dollarit; dhe, tani, kjo u dukej disave si paralajmërimi i fundit, i qartë, para shpërthimit të madh të depresionit botëror.
Shembja e një vigani, kishte menduar Aleksi, kishte bërë që të kuptohej se edhe viganë të tjerë, që mbaheshin njëherë si të pacënueshëm, mund të shembeshin gjithashtu; se as individët, as korporatat, as qeveritë, nuk mund t'i shpëtonin përgjithmonë më të thjeshtit të ligjeve ekonomike: herët a vonë, borxhet duheshin paguar.
Luis d'Orseji, i cili e predikonte që prej njëzet vjetësh këtë doktrinë, kishte shkruar afërsisht të njëjtën gjë në numrin e fundit të buletinit të tij. Aleksi e kishte marrë atë mëngjes me postë. I kishte hedhur një sy dhe, pastaj, e kishte futur në xhep, për ta lexuar me më kujdes në mbrëmje. Tani e nxori nga xhepi.
Nuk i duhet besuar mitit gjerësisht të përhapur, sipas të cilit çështjet financiare të një ndërmarrjeje, ose kombëtare, apo ndërkombëtare, janë diçka komplekse, e ndërlikuar dhe e pakapshme; se nuk mund të sqarohen me një analizë të thjeshtë.
Përkundrazi, është fjala për çështje të thjeshta të ekonomisë shtëpiake, veçse në një shkallë më të gjerë.
Të ashtuquajturat ndërlikime, rrugë të errëta e plot vështirësi, janë një pyll imagjinar. Në të vërtetë, ato nuk ekzistojnë, por janë krijuar nga politikanët që blejnë votat (gjë që do të thotë, të gjithë politikanët), nga intrigantët dhe «ekonomistët» e infektuar nga kinizienizmi[1]). Të gjithë ata përdorin një gjuhë të pakuptueshme, plot me terma të pagarta dhe fjalë të mëdha, për të fshehur atë që bëjnë, apo që kanë bërë.
Gjëja që i tremben më shumë këta njerëz të përbuzshëm është

analiza jonë e thjeshtë kritike e veprimtarisë së tyre, në dritën e qartë dhe të ndershme të arsyes së shëndoshë.
Në fakt, ajo që kanë krijuar këta njerëz — kryesisht politikanët — është, nga njëra anë, një Himalajë me borxhe, të cilat as ata, as ne dhe as sternipërit tanë, nuk do të jemi kurrë në gjendje t'i shlyejmë; nga ana tjetër, ata kanë hedhur në qarkullim një lumë kartëmonedhash, tamam sikur të ishte fjala për letër higjienike dhe, në këtë mënyrë, kanë shkaktuar zhvlerësimin e parave tona të mira — veçanërisht të dollarëve tanë të dikurshëm, të nderuar dhe të garantuar me ar.
Po e theksojmë përsëri: është njësoj si për një ekonomi të thjeshtë shtëpiake; në mënyrë të qartë, ekonomia shtëpiake më inkompetente dhe më e pandershme që ka ekzistuar ndonjëherë në historinë e njerëzimit.
Kjo dhe vetëm kjo është arsyeja themelore e inflacionit.
Kishte dhe më, Luisit i pëlqente më tepër të përdorte shumë fjalë se sa pak, për të mbështetur argumentet e tij.
Nga ana tjetër, si zakonisht, ai u jepte gjithnjë një zgjidhje plagëve financiare.
Dhe gjithmonë mund ta gjeje një zgjidhje; një zgjidhje të gatshme dhe të disponueshme, e po aq të efektshme, sa dhe një brokë me ujë për udhëtarin që po vdes, i djegur nga etja e pashuar.
Ari
Ari, përsëri si bazë e sistemeve monetare të të gjithë botës.

Ari, shtylla më e vjetër dhe e vetme e qëndrueshmërisë monetare. Ari, burimi i vetëm dhe i pakorruptueshëm i disiplinës financiare.

Ari, të cilin politikanët nuk mund ta stampojnë, ose ta prodhojnë, ose ta falsifikojnë, apo t'ia ulin vlerën në mënyra të tjera.

Ari, i cili, për shkak të sasisë së tij krejt të kufizuar, vendos vlerën e tij të vërtetë dhe të qëndrueshme.

Ari, i cili, po të merret si bazë monetare, në sajë të vlerës së tij konkrete, mbron dhe ruan kursimet e ndershme të të

gjithëve nga plaçkitja e batakçinjve, sharlatanëve, inkompetentëve dhe vegimtarëve të ngarkuar me funksione publike.

Ari, i cili — siç është provuar gjatë shekujve — në qoftë se nuk përbën bazën monetare, nuk mund të ndalojë lindjen e një inflacioni të pashmangshëm, të ndjekur nga anarkia; ndërsa, përkundrazi, po qe se përbën bazën monetare, ai bën që inflacioni të frenohet dhe të eliminohet dhe, mbas kësaj, gjendja të stabilizohet.

Ari, të cilin ndoshta perëndia, me urtësinë e saj, e ka krijuar për të kufizuar mospërmbajtjen e njeriut.

Ari, të cilin amerikanët e përmendnin dikur si masë krahasimi, duke pohuar me krenari se dollari i tyre ishte «po aq i mirë sa ari».

Ari, tek i cili, një ditë jo shumë të largët, Amerika duhet të kthehet dhe ta marrë si standard këmbimi. Rruga tjetër, që po bëhet çdo ditë më e qartë, është shpërbërja e ekonomisë së të gjithë vendit. Por, për fat të mirë, me gjithë skepticizmin dhe fanatikët që janë kundër arit, ka shenja që tregojnë se arsyeja e shëndoshë po fillon të mbizotërojë; se në qeveri po fillojnë të mendojnë në një mënyrë më të pjekur.

Aleksi e la poshtë buletinin financiar «D'Orsej». Si shumë të tjerë në ambientin bankar dhe gjetiu, ai kishte qeshur nganjëherë me thirrjet e përgjëruara e plot zhurmë për arin të Luis d'Orsejit, Herri Shulcit, Xhemjs Dajnsit, deputetit Krejn, Ekterit, Braunit, Pikut, e të disa të tjerëve. Mirëpo, kohët e fundit, ai kishte filluar të pyeste veten se mos, në fund të fundit, ishin të drejta pikëpamjet e tyre të thjeshta. Përveç çështjes së arit, ata kishin besim në veprimtarinë e lirë dhe të pavarur të një tregu, në të cilin të gjitha ndërmarrjet pa rezultate të mira mund të falimentonin dhe ato të aftat të kishin sukses dhe të lulëzonin. Ana tjetër e medaljes përbëhej nga pasuesit e teorive të Kinisit, të cilët e urrenin arin dhe kishin besim në një sistem prej amatorësh, në një punë

eksperimentale në ekonomi, duke përfshirë edhe subvencionet e kontrollit, sistem që e quanin «sintoni e hollë». Por, thoshte Aleksi, a nuk kish mundësi që pasuesit e Kinisit të ishin heretikët dhe D'Orseji, Shulci e të tjerët, profetët e vërtetë? Ndoshta. Në epoka të tjera, profetët kishin mbetur gjithmonë vetëm dhe i kishin vënë në lojë, ndonëse disa kishin jetuar aq gjatë, sa të shihnin të vërtetoheshin profecitë e tyre. Kishte vetëm një pikëpamje, me të cilën Aleksi ishte plotësisht i një mendjeje me Luisin dhe të tjerët: ditë të vështira dhe të errëta po afroheshin dhe ishin fare pranë. Në të vërtetë, për FMA-në, ato kishin mbërritur tanimë.

Ai dëgjoi zhurmën e një kyçi që rrotullohej në bravën e derës së jashtme të apartamentit. Dera u hap dhe hyri Margoti. Ajo hoqi pallton me lëkurë me qime deveje dhe e hodhi mbi një karrige.

— O zot, Aleks. S'më hiqet Roskoi nga mendja. Si mundi ta bënte atë? Pse?

Shkoi drejt e te bufeja dhe mbushi një gotë pije.

— Duket se kishte disa arsye, — tha ai me ngadalë.

— Po fillojnë të dalin pak nga pak. Në rast se s'të vjen keq, Margot, nuk e ndiej akoma veten në gjendje të flas për këtë.

— E kuptoj. — Ajo iu afrua pranë Aleksit e shtrëngoi fort dhe e puthi.

Mbas pak, ai tha:

— Më trego për Istinin, Huanitën dhe vajzën e vogël. Që nga dita e mëparshme, Margoti po merrej me sistemimin e të treve.

U ul përballë Aleksit, duke pirë pak e nga pak likerin.

— Tërë këto gjëra, që ndodhën të gjitha sëbashku...

— Ndodh shpesh, — tha Aleksi. Pyeti veten se çfarë tjetër do të ndodhte para mbarimit të asaj dite.

— Së pari, Majlsi, — filloi Margoti. — Është jashtë rrezikut dhe lajmi më i mirë është se, për mrekulli nuk do të mbetet i verbër. Mjekët mendojnë se do t'i ketë mbyllur sytë një çast para se ta godiste acidi nitrik, kështu që qepallat e shpëtuan. Ato janë djegur në mënyrë të tmerrshme, sikurse dhe e tërë fytyra. Do të jetë e nevojshme që ai t'i nënshtrohet një vargu të gjatë ndërhyrjesh të kirurgjisë plastike.
— Po duart?
Margoti nxori nga çanta një bllok shënimesh dhe e hapi.
— Spitali u lidh me një kirurg të Bregut Perëndimor, njëfarë Dr. Xhek Taper, nga Oklendi. Ai njihet si një nga specialistët më të mirë të vendit për riparimet kirurgjikale të duarve. Biseduan me të, në telefon. Tha se do të vinte për ta operuar Majllsin aty nga mesi i javës së ardhshme. Do të paguajë banka, apo jo?
— Po, — tha, Aleksi, — sigurisht.
— Pastaj fola me Inisin. Ai thotë se në këmbim të dëshmisë që Majlls Istini do të bëjë në gjyq, do ta mbrojnë atë dhe do t'i sigurojnë një identitet të ri në ndonjë pjesë tjetër të vendit.
— Ndoshta do të mundën ta marrin në punë edhe Huanitën. Ajo thotë se do ta ndjekë kudo Majllsin. Me ta do të jetë edhe Estela.
Aleksi psherëtiu. Ishte i kënaqur se, pakku, kjo do të kishte një mbyllje të lumtur.
— Çfarë tha Tim Mekartni për fëmijën?
Kishte qenë mendimi i Aleksit që Estela Nunjezin ta dërgonin te dr. Mekartni, psikiatri i Qendrës Klinike. Donte të dinte nëse vajza e vogël kishte pësuar ndonjë dëm psikik, si rezultat i rrëmbimit dhe torturës dhe, në rast se po, sa i madh ishte ky dëm.
Por Qendra Klinike e trishtoi duke i sjellë ndërmend Silian.
— Do të të them diçka, — tha Margoti. — Po të ishim ne aq

në rregull dhe të ekuilibruar sa Estela e vogël, të dy do të ishim më të mirë. Dr. Mekartni tha se e kishte vënë vogëlushen t'ia tregonte tërë ngjarjen, nga fillimi gjer në fund, duke e lënë kështu të shfrynte. Rezultati i kësaj është se Estela nuk do ta ruajë këtë ngjarje thellë në subkoshiencën e saj, por do ta mbajë mend, të qartë, si një ëndërr të keqe dhe asgjë më shumë.
— Kjo ka qenë një ditë shumë e ngarkuar. — Margoti u shtriq, hoqi këpucët dhe i largoi tutje, me një të goditur me këmbë. — Njëra nga gjërat e tjera që kam bërë është dhe biseda që pata me seksionin tuaj të çështjeve ligjore, lidhur me kompensimin për Huanitën. Besoj se mund ta zgjidhim këtë çështje, pa qenë nevoja ta çojmë në gjyq.

— Faleminderit, Margot. — Aleksi i mori të dy gotat, për t'i mbushur përsëri. Në këtë çast ra zilja e telefonit. Margoti u ngrit dhe shkoi t'i përgjigjej.
— Është Leonard Kingsudi. Për ty.
Aleksi përshkoi dhomën e ndenjies dhe mori receptorin.
— Po Len?
— E di se je duke u çlodhur, pas një dite të vështirë, — tha presidenti i këshillit të Northam Stelit, — dhe, gjithashtu edhe unë jam i tronditur nga ajo që i ndodhi Roskoit. Por ajo që duhet të them nuk mund të lihet për më vonë.
Aleksi u ngërdhesh.
— Vazhdoni!
— U bë një mbledhje e ngushtë e këshilltarëve. Sot pasdite, u mblodhëm dy herë, pa logaritur bisedat e shumta në telefon. Nesër, do të bëhet mbledhja plenare e këshillit administrativ.
— Dhe?
— Pika e parë në rendin e ditës do të jetë pranimi i dorëheqjes së Xheromit. Këtë e kërkuan disa nga ne dhe

Xheromi u tregua i një mendjeje. Në të vërtetë, besoj se kështu ka ndier veten të lehtësuar.
«Po, — mendoi Aleksi, — patjetër». Ishte e qartë se Petërtoni nuk ishte nga ai brumë që të mund t'i bënte ballë ortekut të papritur të problemeve, pa folur për vendimet kritike që duheshin marrë në atë çast.
— Pas kësaj, — vazhdoi Kingsudi me çiltërsinë e tij të zakonshme, — ti do të zgjidhesh president. Emërimi do të hyjë në fuqi menjëherë.
Ndërsa dëgjonte, Aleksi e mbajti receptorin me sup dhe ndezi llullën. Para se të fliste, e thithi nja dy-tri herë, duke u menduar.
— Siç erdhën punët, Len, nuk jam i sigurt se e dëshiroj atë post.
— Na kishte vajtur pak a shumë mendja se do të jepje një përgjigje të këtillë dhe, prandaj, më zgjodhën mua që të të telefonoja. Shiko, Aleks, në të vërtetë, unë po flas për diçka që është në favorin tim dhe të këshilltarëve të tjerë. — Kingsudi u ndal për një çast dhe Aleksi e kuptoi se nuk e ndjente veten mirë; të lutej s'ishte punë e lehtë për një njeri me karakterin dhe temperamentin e tij. Por, megjithatë, Kingsudi vazhdoi, ndonëse fliste me njëfarë vështirësie. — Të gjithë e dinë se ti na paralajmërove për Suprënejshnelin, por ne menduam se ishim më të mençur. Faktet treguan se nuk ishte ashtu. S'ua vumë veshin këshillave të tua dhe, pastaj, ndodhën ato që na paralajmërove se do të ndodhnin. Prandaj, Aleks, tani të kërkojmë... ndonëse me vonesë, e pranoj... të na ndihmosh për të dalë nga kjo rrëmujë. Shtoj se disa këshilltarë kanë frikë se mos u ndodhë ndonjë ngatërresë me drejtësinë. Dhe të gjithëve na kujtohet se na kishe paralajmëruar edhe për këtë.
— Më le të mendohem pak, Len.
— Sa të duash.

Aleksi mendoi se duhej të ndjente njëfarë kënaqësie personale dhe, ndoshta, një ndjenjë epërsie, për faktin se tani mund të kënaqej duke thënë: jua kisha thënë; një bindje fuqie, meqenëse tani kishte në dorë kartat fituese.
Mirëpo, ai nuk ndjente asgjë nga këto, përveçse një trishtim të madh për kotësinë dhe humbjen pa kuptim të energjive, sepse — edhe duke supozuar se do të kishte sukses — më e mira që mund të arrihej, për një kohë të gjatë, ishte që banka të kthehej përsëri në kushtet ku e kishte lënë Ben Roseli.
A ia vlente barra qiranë? E për çfarë e gjithë kjo? A mund të justifikoheshin përpjekjet e jashtëzakonshme, puna e rëndë dhe sakrificat personale, tensioni i vazhdueshëm?
Këto ishin mendime abstrakte, por kishte edhe çështje praktike. Edhe në qoftë se Aleksi pranonte të drejtonte FMA-në, në këtë etapë të fundit, nuk kishte asnjë garanci suksesi. Kishte mundësi që t'i duhej të kufizohej, në mënyrë poshtëruese, në të kryesuarit e mbarimit të FMA-së dhe gllabërimit të saj nga ndonjë bankë tjetër. Në këtë rast, do ta mbanin mend për këtë dhe nami i tij si bankier do të merrte fund. Nga ana tjetër, ai e dinte që, në qoftë se kishte një njeri që mund ta shpëtonte FMA-në, ky njeri ishte vetë ai. Ai i kishte aftësitë e nevojshme dhe, veç kësaj, dinte gjithçka lidhur me FMA-në, gjë që një person tjetër, i ardhur nga jashtë, nuk do të kishte kohë t'i mësonte. Më në fund, gjë që ishte akoma më dhe më e rëndësishme, me gjithë problemet e shumta që mbeteshin për t'u zgjidhur, ai kishte besim se mund ta bënte atë.
— Po qe se pranoj, Len, — tha ai, — do të ngul këmbë që të më lihet dorë e lirë për të bërë ndryshime, duke përfshirë edhe ndryshime në këshillin administrativ.
— Patjetër do të të lihet dorë e lirë, — u përgjigj Kingsudi — Këtë ta garantoj unë, personalisht.

Aleksi thithi edhe një herë llullën dhe, pastaj, e la në tryezë.
— Le ta lëmë me kaq sonte. Do të të njoftoj mendimin tim nesër në mëngjes.
E vendosi në vend receptorin e telefonit dhe mori gotën e tij nga bufeja. Margoti e kishte marrë më parë të sajën.
Ajo i hodhi një vështrim me qesëndi.
— Pse nuk e pranove? Kur të dy ne e dimë se do ta pranosh?!
— E kuptove se si ishte puna?
— Sigurisht.
— Pse je kaq e sigurt se do të pranoj?
— Sepse nuk mund t'i rezistosh sfidës. Sepse banka është tërë jeta jote. Çdo gjë tjetër vjen në radhë të dytë.
— Nuk jam i sigurt, — tha ai me ngadalë, — se dua që një gjë e tillë të jetë e vërtetë. — E, megjithatë, kishte qenë e vërtetë, mendoi ai, kur ai dhe Silia ishin bashkë. A ishte kjo akoma e vërtetë? Kishte të ngjarë që përgjigjia të ishte po, siç kishte thënë Margoti. Kishte të ngjarë, gjithashtu, që të ishte e pamundur që njeriu të ndryshonte karakterin e tij.
— Ka kaq kohë që kam dashur të të pyes për diçka, — tha Margoti. — S'ka rëndësi, po të pyes tani.
Ai tundi kokën.
— Fol!
— Ditën e dyndjes në sportelet e Tilersvilit, ata dy pleqtë, që i kishin tërë kursimet e tyre në një çantë për të psonisur, të pyetën: «A janë paratë tona krejtësisht të sigurta në bankën tuaj?» Ti u përgjigje se po. Ishte ti me të vërtetë i sigurt?
— Edhe unë ia kam bërë vetes simë këtë pyetje, — tha Aleksi, — menjëherë pasi ndodhi kjo, si edhe më vonë. Për të qenë i sinqertë, duhet të them se nuk isha.
— Por ti po shpëtoje bankën, apo jo? Dhe ajo vinte në radhë të parë, para çdo gjëje tjetër: para atyre dy pleqve dhe të gjithë të tjerëve; bile, para ndershmërisë, sepse gjëja më e rëndësishme ishte që puna të vazhdonte rregullisht. — Befas, zëri i Margotit shprehu njëfarë emocioni. — Ja, sepse do të përpiqesh ta shpëtosh bankën, Aleks ... para çdo gjëje tjetër. Kështu shkuan punët me ty dhe Silian dhe, — përfundoi ajo

më ngadalë, — kështu do të shkonin me ty dhe mua, po qe se do të ishte nevoja të zgjidhje.

Aleksi mbeti në heshtje. Ç'mund të thoshte ai? Ç'mund të thuhet, kur ndodhesh përballë të vërtetës, së pakundërshtueshme?

— Kështu që, në fund të fundit, — vazhdoi Margoti, — ti nuk je dhe aq i ndryshëm nga Roskoi, ose nga Luisi. — Ajo ngriti nga tryeza buletinin financiar «D'Orsej», me një shprehje neverie në fytyrë. — Stabilitet të veprimtarisë tregtare, para të sigurta, ar, kuota të larta. Këto gjëra në radhë të parë; po njerëzit, veçanërisht njerëzit e zakonshëm, njerëzit e parëndësishëm, këta vijnë shumë më pas. Kjo është humnera e madhe midis nesh, Aleks, dhe kjo do të ekzistojë gjithmonë. — Ai pa se ajo po qante.

Nga korridori u dëgjua tingëllima e një telefoni të brendshëm.

— Djalli i marrtë këto ndërprerjet! — thirri Aleksi. Ai shkoi tek ai telefon që e lidhte me portierin.

— Po, ç'ka?

— Zoti Vandervurt, ju kërkon një zonjë. Zonja Kellëgen.

— Unë s'njoh ndonjë... — Ai e preu fjalën. Mos ishte sekretarja e Hejuordit? — Pyete nëse punon në bankë.

Një ndërprerje.

— Po, zoti Vandervurt, është nga banka.

— Mirë, dërgoje lart.

Aleksi i tregoi për këtë Margotit. Ata pritën me kureshtje. Kur dëgjoi ashensorin që u ndal në katin e tyre, Aleksi shkoi te dera e apartamentit dhe e hapi.

— Lutem, hyni, zonja Kellëgen.

Dora Kellëgen ishte një grua rreth të gjashtëdhjetave, e veshur mirë dhe me pamje tërheqëse. Kishte shumë vjet që punonte në FMA dhe, që prej së paku dhjetë vjetësh ishte sekretare e Rosko Hejuordit. Zakonisht ishte e matur dhe e sigurt në vetvete, por tani dukej e lodhur dhe e shqetësuar. Kishte veshur një pallto kamoshi, me jakë peliceje dhe mbante në dorë një çantë lëkure. Aleksi e njohu si një nga çantat që përdoreshin në bankë.

— Zoti Vandervurt, më vjen keq që po ju shqetësoj... — Jam i sigurt se keni ardhur sepse keni ndonjë arsye të fortë. — Ai e njohu me Margotin dhe, pastaj, e pyeti: — A do t'ju pëlqente një pijë?

— Them se po.

— Një martini. E përgatiti Margoti, ndërsa Aleksi mori pallton e Dora Kellëgenit. Të tre u ulën pranë zjarrit.

— Mund të flisni lirisht para zonjushës Brekënit, — tha Aleksi.

— Faleminderit. — Dora Kellëgeni piu një gllënjkë martini dhe, pastaj, e vuri poshtë gotën. — Zoti Vandervurt, sot pasdite rregullova sirtarët e tryezës së punës të zotit Hejuord. Mendova se mund të kishte gjëra që duheshin kryer, ndoshta dokumente që i duheshin dërguar ndokujt. — Iu mek zëri dhe e preu fjalën. Ajo belbëzoi: — Më falni.

— S'ka gjë, — tha Aleksi, me dashamirësi. — Mos u nxitoni, kemi kohë.

Pasi e mori përsëri veten, zonja Kellëgen vazhdoi:

— Disa sirtarë ishin të mbyllur me kyç. Çelësat e tyre i kam edhe unë, ndonëse nuk i kam përdorur shpesh. Por, sot, i përdora.

Përsëri ra heshtje, ndërsa ata të dy prisnin.

— Në njërin nga sirtarët, — zoti Vandervurt, kisha dëgjuar se nesër në mëngjes do të vinin hetuesit. Mendova... se do të ishte mirë që ju të shihnit se ç'ka brenda dhe se do ta dinit më mirë se unë se ç'duhej bërë.

Zonja Kellëgen hapi çantën prej lëkure dhe nxori dy zarfe të mëdha. Kur ia dha Aleksit, ky pa se të dy ishin hapur. Me kureshtje, nxori gjërat që kishin brenda.

Në zarfin e parë ishin katër certifikata aksionesh, secila e nënshkruar nga Xh.Xh. Kuortermejni dhe me vlerën e pesëqind aksioneve të zakonshme të Q-Investmentsit. Ndonëse në to shënohej fjala «prurësit», Aleksi mendoi se, pa dyshim, ato ishin të Hejuordit. Atij iu kujtuan fjalët që kishte thënë pasdite kronisti i gazetës «Njusdej». Kjo e vërtetonte. Natyrisht, gjykata do të kërkonte prova të tjera. Sidoqoftë, dukej të ishte e sigurt që Hejuordi, funksionar i lartë i bankës dhe njeri i besuar, kishte pranuar një ryshfet poshtërues. Po të ishte gjallë, ky dokumentim do të mjaftonte për ta proceduar penalisht.

Gjendja shpirtërore jo e mirë e Aleksit u rëndua edhe më shumë. Atij s'i kishte pëlqyer kurrë Hejuordi. Ata kishin qenë rivalë pothuajse prej castit të parë, kur Aleksi kishte filluar punën në FMA. Megjithatë, kurrë gjer në atë çast, ai s'kishte dyshuar për ndershmërinë e Roskoit. Kjo provon, mendoi ai, që pavarësisht nga besimi që mund të kesh se e njeh mirë një njeri, në të vërtetë s'e ke njohur kurrë aq sa duhet. Duke shpresuar se s'do të kishte të papritura të tjera, ai nxori gjërat që gjendeshin në zarfin e dytë. Ishin fotografi të zmadhuara të një grupi personash, pranë një pishine. Dy burra dhe katër gra lakuriq dhe Rosko Hejuordi, i veshur. Aleksi dyshoi menjëherë se këto fotografi do të ishin një kujtim i udhëtimit në Bahama, me Xhorxhin e madh Kuortermwjn, udhëtim që, në atë kohë, e kishin ngritur në qiell. Pastaj, ndërsa Margoti dhe zonja Kellëgen e vështronin, ai i hapi ato mbi një

tavolinë: ishin gjithsej dymbëdhjetë copë. I hodhi një vështrim të shpejtë Dora Kellëgenit: ajo i kishte faqet flakë të kuqe, domethënë se ishte skuqur. Ishte skuqur?! Aleksi kishte menduar se këtë s'e bënte më njeri.

Duke shikuar fotografitë, i erdhi për të qeshur. Secila prej tyre — s'kishte fjalë tjetër për këtë— ishte qesharake. Në njërën nga ato fotografi, Roskoi i shikonte si i magjepsur të katër gratë e zhveshura; në një tjetër, po e puthte njëra prej tyre, ndërsa gishtat e tij po i preknin lehtë gjinjtë. Shihej trupi i Harold Ostinit, me mishra të qullëta, organin e flashkët dhe një buzëqeshje prej budallai. Një burrë tjetër, me shpinë nga aparati fotografik, rrinte para grave. Përsa u përket këtyre të fundit… Aleksi mendoi se kishte njerëz të cilëve mund t'u dukeshin tërheqëse, por, sa për vetë atë, Margoti, krejt e veshur, vlente më shumë se ato të katërta bashkë, lakuriq.

Megjithatë, nuk qeshi, për respekt ndaj Dora Kellëgenit. Kjo e kishte pirë martinin gjer në pikën e fundit dhe po ngrihej.

— Zoti Vandervurt, po shkoj.

— Bëtë mirë që m'i sollët këto gjëra, — i tha ai. — E vlerësoj gjestin tuaj. Do të merrem personalisht me to.

— Po ju shoqëroj, — i tha Margoti. I solli pallton zonjës Kellëgen dhe shkoi me të gjer tek ashensori.

Kur u kthye, Aleksi ishte pranë një dritareje dhe po shikonte dritat e qytetit.

— Grua e bukur, — tha Margoti. — Dhe besnike.

— Po, — tha ai, dhe mendoi se, çfarëdo ndryshimesh që të bëheshin të nesërmen dhe ditët e tjera, ai do të kujdesej që zonja Kellëgen të trajtohej me respekt. Veç kësaj, kishte edhe njerëz të tjerë për të cilët ia vlente të mendohej. Do ta gradonte menjëherë Tom Stroanin, duke i lëshuar postin e vet të nënpresidentit. Orvil Jangu ishte shumë i përshtatshëm për

të zënë vendin e Hejuordit. Eduina d'Orseji duhet të bënte një hap përpara dhe të emërohej përgjegjëse e administratës fiduciare. Kishte kohë që Aleksi e mendonte këtë gradim për të dhe parashikonte që, së shpejti, Eduina të ngrihej akoma dhe më lart. Ndërkohë, ajo duhej të emërohej menjëherë anëtare e këshillit administrativ.

Befas i shkoi mendja se po e quante si të pranuar nga ana e tij postin e presidentit të bankës. E po, këtë sapo ia kishte thënë Margoti. Ishte e qartë se kishte pasur të drejtë.

U largua nga dritarja dhe nga errësira e jashtme. Margoti ishte në këmbë, pranë tryezës, dhe po shikonte fotografitë. Papritur, ajo shpërtheu në një gaz të përmbajtur dhe Aleksi bëri atë që do të kishte dashur ta bënte më parë, filloi të qeshë bashkë me të.

— O zot, — thirri Margoti, — ç'gjë për të qeshur e për të qarë!

Kur pushuan së qeshuri, ai u përkul, i mblodhi fotografitë dhe i futi përsëri në zarf. Kishte dëshirë t'i hidhte të gjitha në zjarr, por e dinte se nuk duhej ta bënte këtë: kjo do të kishte qenë shkatërrimi i provave dhe dëshmive që mund të ishin të dobishme. Por, vendosi, për hir të Roskoit, të bënte çmos për të mos lejuar që të tjerë t'i shihnin këto fotografi.

— Për të qarë e për të qeshur, — përsëriti Margoti. — A nuk të duket kështu?

— Po, — tha Aleksi, — dhe në atë çast ai e pati të qartë se kishte nevojë për të dhe se, gjithmonë, do të kishte.

I mori duart, duke sjellë ndërmend gjërat për të cilat po bisedonin, para se të vinte zonja Kellëgen. — Mos mendo për humnera të mundshme ndërmjet nesh, — i tha ai. — Ne kemi gjithashtu edhe plot ura. Ne jemi të përshtatshëm për njëri-tjetrin. Le të jetojmë së bashku përgjithësisht, Margot, duke filluar që tani.

Ajo kundërshtoi, duke thënë.

— Ka të ngjarë që kjo gjë të mos ketë sukses dhe të mos ketë jetë të gjatë. Parashikimet nuk janë në favorin tonë.

— Atëherë, do të përpiqemi të provojmë se janë të gabuara.

— Natyrisht, ka një gjë që është në favorin tonë. — Sytë e Margotit shkëlqyen me djallëzi. — Pjesa më e madhe e çifteve që premtojnë se «do ta dashurojnë njëri-tjetrin dhe do t'i jenë besnik gjer në vdekje», ndahen. Brenda një viti, përfundojnë në gjykatë, për ndarje. Ndoshta, po të fillojmë pa shumë bindje dhe pretendime do të kemi një fat më të mirë se të tjerët.

Duke e pushtuar në krahët e tij, Aleksi tha:

— Nganjëherë, bankierët dhe avokatët flasin tepër.

FUND